



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

RAPORT VJETOR

Për veprimtarinë e Avokatit të Popullit

1 Janar – 31 Dhjetor
Viti 2013

Tiranë, Shkurt 2014



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

RAPORT VJETOR

Për veprimtarinë e Avokatit të Popullit

1 Janar – 31 Dhjetor

Viti 2013

Tiranë, Shkurt 2014

**I nderuar zoti Kryetar i Kuvendit të Shqipërisë,
Të nderuar deputetë dhe deputete,**

Në mbështetje të nenit 63 pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 26 të Ligjit nr. 8454, datë 4.2.1999, plotësuar me Ligjin nr. 8600 datë 10.04.2000, ndryshuar me Ligjin nr. 9398, datë 12.05.2005 “Për Avokatin e Popullit”, kam nderin që, në emër të Institucionit të Avokatit të Popullit, t’ju paraqes raportin për veprimtarinë e tij gjatë vitit 2013.

Me respekt,

AVOKATI I POPULLIT

Igli TOTOZANI

Përmbajtja

Prezantim i shkurtër i strukturës së Raportit Vjetor 2013	8
--	----------

KREU I:

1) Opinione dhe rekomandime për gjendjen e të drejtave të njeriut në Shqipëri	9
2) Përmbledhje e Raporteve të Veçanta drejtuar Kuvendit të Republikës së Shqipërisë	38

KREU II

Veprimtaria e Institucionit të Avokatit të Popullit në zgjidhjen e ankesave konkrete, e ndarë sipas të drejtave dhe lirive të garantuara nga Kushtetuta dhe aktet e tjera ligjore	49
--	-----------

A. E drejta për informim.....	49
B. Kufizime të lirisë së personit	55
- Veprimtaria e Policisë së Shtetit	55
- Veprimtaria e Avokatit të Popullit në lidhje me Forcat e Armatosura	63
C. Çështje të administrimit të drejtësisë	65
- E drejta për një proces të rregullt ligjor.....	65
- Institucioni i Avokatit të Popullit dhe organet e pushtetit Gjyqësor.....	67
- Veprimtaria e Prokurorisë ⁷²	
- Veprimtaria e Zyrave të Shërbimit Përmbartimor Shtetëror	82
- Ndihma ligjore falas	91
D. E drejta e Pronës	92
E. E drejta e mbrojtjes shoqërore të punës	100
F. E drejta për të përfituar nga sistemi i sigurimeve shoqërore	106
G. E drejta për arsimim	114
H. Plotësimi i nevojave të shtetasve me strehim	121
I. Ndihma ekonomike	126
J. Mbrojtja e konsumatorit	130
K. E drejta për kujdes shëndetësor	137
L. Synimi për një mjedis të shëndetshëm	146
M. Problematikat e pushtetit vendor gjatë ushtrimit të veprimtarisë së organeve të tij	149
N. Trajtimi i ankesave të të përndjekurve politikë	157

KREU III

Aktiviteti i Avokatit të Popullit në rolin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës në vitin 2013	163
---	------------

KREU IV

Roli proaktiv i Institucionit të Avokatit të Popullit	243
1. Pritja e qytetarëve	243
2. Veprimtaria e Zyrave Rajonale dhe “Ditët e Hapura”	248
3. Marrëdhëniet me median	251
4. Komunikimi nëpërmjet faqes zyrtare të web-it dhe medias sociale	258
5. Bashkëpunimi i institucionit të Avokatit të Popullit me organizatat jofitimprurëse	262
6. Bashkëpunimi i institucionit të Avokatit të Popullit me zyrat homologe dhe organizata të tjera ndërkombëtare	270
7. Plani Strategjik dhe Plani i Veprimit për institucionin e Avokatit të Popullit 2013 - 2015	286

KREU V

Informacion i përgjithshëm lidhur me veprimtarinë e institucionit të Avokatit të Popullit 291

1. Struktura e zyrës së Avokatit të Popullit gjatë vitit 2013	291
2. Buxheti i Institucionit për vitin 2013	294
3. Statistika përmbledhëse e vitit 2013	296

Shtojca

Lista e Rekomandimeve Legjislative dhe kërkesa drejtuar Gjykatës Kushtetuese	303
--	-----

Prezantim i shkurtër i strukturës së Raportit Vjetor 2013

Hartimi i këtij Raporti Vjetor është bazuar në punën e institucionit të Avokatit të Popullit përgjatë vitit 2013. Shpresojmë që informacioni mbi situatën e lirive dhe të drejtave të njeriut në vend i përfshirë në këtë raport, të jetë i jetë i vlefshëm si për anëtarët e Kuvendit të Shqipërisë dhe organet e administratës publike, ashtu dhe për organizatat vendase dhe ndërkombëtare që punojnë në fushën e të drejtave të njeriut, institucionet homologe në rajon e më gjerë, institucionet arsimore, median dhe publikun e gjerë.

Disa pjesë të raportit mund të kenë më shumë interes për ju se të tjerat. Për t'ju ndihmuar të gjeni informacionin e nevojshëm, sugjerojmë leximin e këtij prezantimi të shkurtër të strukturës së Raportit.

Raporti vjetor për veprimtarinë e Avokatit të Popullit gjatë vitit 2013 është strukturuar në katër krerë, si në vijim:

Kreu i parë synon të reflektojë në mënyrë të përmbledhur çështjet më të rëndësishme të prezantuara gjatë vitit 2013 në punën e institucionit nëpërmjet ankesave, takimeve me qytetarë, inspektimeve, etj., si dhe të prezantojë rekomandimet e Avokatit të Popullit për ndërhyrje dhe përmirësime në standardet e të drejtave të njeriut në Shqipëri.

Në këtë kapitull gjithashtu prezantohen në mënyrë të përmbledhur pesë raportet e veçanta të përgatitura nga institucioni i Avokatit të Popullit gjatë vitit 2013, të cilat synojnë të sjellin në vëmendje të Kuvendit dhe organeve të administratës publike probleme dhe tematika emergjente në fushën e të drejtave të njeriut në vend.

Kreu i dytë fokusohet në mënyrë më të detajuar në problematikat dhe punën e institucionit të Avokatit të Popullit në trajtimin dhe zgjidhjen e ankesave. Kjo pjesë e raportit ofron studime të rasteve konkrete, mënyrën e trajtimit dhe zgjidhjes së dhënë dhe gjithashtu prezanton punën e institucionit për vënien në vend të një të drejte të shkelur apo të mohuar, nëpërmjet rekomandimeve konkrete drejtuar institucioneve shtetërore.

Kreu i tretë analizon veprimtarinë e Avokatit të Popullit në rolin e Mekanizmit Kombëtar të Parandalimit të Torturës përgjatë vitit 2013.

Kreu i katërt vë në pah rolin proaktiv që institucioni i Avokatit të Popullit ka ndërmarrë gjatë vitit, jo vetëm në mbrojtjen por edhe në promovimin e standardeve më të larta të të drejtave të njeriut në vend. Kjo pjesë e raportit paraqet një pasqyrë të përgjithshme të bashkëveprimit me publikun, si dhe bashkëpunimit të institucionit me partnerë të ndryshëm të shoqërisë civile, të medias dhe partnerë ndërkombëtarë. Po kështu, në këtë kapitull prezantohet përmbledhtas Plani Strategjik i institucionit të Avokatit të Popullit për periudhën 2013-2015, dokumenti i cili është hartuar nga institucioni gjatë vitit 2013.

Kreu i fundit përfshin një informacion mbi strukturën e institucionit të Avokatit të Popullit, shpenzimet financiare gjatë vitit 2013, si dhe të dhëna statistikore mbi veprimtarinë e institucionit gjatë këtij viti.

KREU I

1.Opinione dhe rekomandime për gjendjen e të drejtave të njeriut në Shqipëri

Avokatit i Popullit është i vetmi institucion kombëtar me status kushtetues për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut në Shqipëri. Ky institucion është krijuar më 1998, me miratimin e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998 dhe në vitin 1999, Parlamenti i Republikës së Shqipërisë miratoi ligjin nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”. “Kodi i Procedurave Administrative” (nr. 8485, datë 12.5.1999), ligji “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare” (nr. 8503, datë 30.6.1999), ligji “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve” (nr. 9888, datë 10.3.2008), ligji “Për mbrojtjen e konsumatorit” (nr. 9135, datë 11.9.2003), si dhe ligji “Për shëndetin mendor” (nr. 44/2012, datë 19.4.2012) përbëjnë bazën ligjore, ku përcaktohen thuajse të gjitha të drejtat dhe detyrat funksionale të Avokatit të Popullit.

Avokati i Popullit i udhëhequr nga parimet e paanësisë, konfidencialitetit, profesionalizmit dhe pavarësisë, vepron si mbrojtës i të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshëm të qytetarëve nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike, si dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të saj. Po kështu, institucioni i Avokatit të Popullit është angazhuar në një rol proaktiv në promovimin e standardeve më të larta të të drejtave të njeriut në vend, si dhe në krijimin dhe zhvillimin e një kulture të qeverisjes së mirë, elementë këto të domosdoshëm për funksionimin e demokracisë dhe integrimin në Bashkimin Evropian.

Me qëllim konsolidimin e mëtejshëm të institucionit të Avokatit të Popullit, gjatë vitit 2013 një paketë propozimesh për ndryshime në Ligjin për Avokatin e Popullit u hartua dhe i është paraqitur për shqyrtim Ministrisë së Drejtësisë. Me kërkesë të Avokatit të Popullit, programi EURALIUS i Komisionit Evropian, asistoi institucionin për të realizuar një analizë legislative dhe hartimin e propozimeve për ndryshime në Ligjin për Avokatin e Popullit, në përputhje me Parimet e Parisit. Këto propozime tepër të rëndësishme synojnë 1) përcaktimin e misionit të Avokatit të Popullit jo vetëm në mbrojtjen, por edhe në promovimin e të drejtave të njeriut; 2) forcimin e mëtejshëm të pavarësisë së institucionit; si dhe 3) përmirësimin e strukturës së institucionit. Propozimet për ndryshimin e ligjit për Avokatin e Popullit janë dorëzuar në Ministrinë e Drejtësisë në prill 2013, por ende sot nuk kemi një përgjigje dhe jemi në pritje të shqyrtimit të këtyre propozimeve dhe kalimit të tyre për shqyrtim në Kuvendin e Shqipërisë.

Avokati i Popullit është një institucion i pavarur e i paanshëm dhe detyra e tij është të japë një paraqitje reale dhe transparente të konstatimeve dhe gjetjeve të nxjerra gjatë vitit. Në anën tjetër, detyrë e tij është edhe dhënia e opinioneve dhe rekomandimeve të tij për përmirësimin e situatës së të drejtave të njeriut në vend.

Pikërisht, në këtë pjesë të Raportit Vjetor pasqyrohen çështjet më të rëndësishme të trajtuara gjatë vitit 2013 nga institucioni i Avokatit të Popullit të paraqitura nëpërmjet ankesave, takimeve me qytetarë, inspektimeve, etj., si dhe prezantohen rekomandimet tona për ndërhyrje dhe përmirësime në nivelin e standardeve të të drejtave të njeriut në Shqipëri.

Besojmë që kjo panoramë e problematikave, sfidave, arritjeve dhe rekomandimeve përkatëse lidhur me situatën e të drejtave të njeriut në vend, të jetë i vlefshëm si për anëtarët e Kuvendit të Shqipërisë dhe organet e administratës publike, ashtu dhe për organizmat kombëtare dhe ndërkombëtare që punojnë në fushën e të drejtave të njeriut, institucionet homologe në rajon e më gjerë, institucionet arsimore, median dhe publikun e gjerë.

Ekzistenca e kuadrit ligjor në fuqi, që garanton respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut nga ana e institucioneve publike, shpesh herë nuk është e mjaftueshme, pasi është zbatimi konkret i këtyre detyrimeve ligjore që garanton shtetin e së drejtës dhe gëzimin real të të drejtave dhe lirive të njeriut.

Kështu, gjatë vitit 2013, pranë institucionit të Avokatit të Popullit janë depozituar 4346 ankesa. Ky është një numër rekord i ankesave të regjistruara në këtë institucion që prej krijimit të tij. Nga numri total i ankesave të depozituara gjatë vitit 2013, 2943 (68%) ankesa janë konsideruar “brenda juridiksionit dhe kompetencës” të Avokatit të Popullit dhe 1403 (32%) ankesa janë konsideruar si “këshillime dhe orientime” për qytetarët.

Ne jemi në shërbim të qytetarëve, të vendosur dhe të angazhuar plotësisht për të ndërmjetësuar e për t’i dhënë zgjidhje çdo ankese të tyre, rast pas rasti, pasi kështu vendosim në vend një të drejtë të mohuar, apo të shkelur. Kështu, rezulton se gjatë vitit 2013 janë pranuar nga organet e administratës publike dhe i’u është dhënë zgjidhje në favor të qytetarit 1164 rasteve, që kanë qenë brenda juridiksionit dhe kompetencës së institucionit të Avokatit të Popullit.

Një nga masat e rëndësishme që është ndërmarrë në praktikën e pranimit dhe shqyrtimit të ankesave të depozituara pranë institucionin e Avokatit të Popullit, është ngritja dhe funksionimi çdo ditë i një komisioni “ad-hoc” me përbërje nga ekspertë të tre seksioneve dhe Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës, të cilët në rolin e një “zyrë këshillimi”, në varësi të objektit të ankesave bëjnë klasifikimin e tyre, “ankesa brenda juridiksionit dhe kompetencës” për t’u shqyrtuar më tej nga ekspertët sipas të drejtës që mbulojnë, si dhe, në “këshillime dhe orientime” për ankesat që nuk janë objekt i kuadrit ligjor, mbi të cilin funksionon institucioni i Avokatit të Popullit. Kjo mënyrë e klasifikimit të ankesave, ka sjellë uljen e numrit fiktiv të ankesave të shqyrtuara, ka shkurtuar kohën e shqyrtimit të çështjeve që janë jashtë juridiksionit dhe kompetencës së Avokatit të Popullit dhe kthimin e përgjigjeve qytetarëve brenda afateve të përcaktuara në Kodin e Procedurave Administrative dhe Rregulloren e Brendshme të institucionit.

Nga ky riorganizim i praktikës së pranimit dhe trajtimit të ankesave, rezulton se për vitin 2013, prej 2943 ankesash të pranuar për shqyrtim, vetëm 292 ankesa janë jashtë juridiksionit dhe kompetencës së institucionit.

Gjatë vitit 2013, Avokati i Popullit ka vazhduar të shqyrtojë raste me iniciativë nisur nga problematika që qytetarët i kanë bërë publike në median e shkruar dhe atë vizive. Rezulton se gjatë vitit 2013 numri i çështjeve me iniciativë, fillimi i hetimit të të cilave mbështetet në nenin 13 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, ka arritur në 173 raste.

Po kështu, në ushtrim të detyrave të tij, Avokati i Popullit ka vijuar kryerjen e inspektimeve në institucionet publike dhe autoritetet administrative, duke u fokusuar kryesisht në institucionet ku ndodhen persona të cilëve u është e kufizuar liria bazuar në akte të organeve kompetente shtetërore (paraburgim, burgje, spitale psikiatrike, etj), si dhe në qendrat rezidenciale për fëmijë (shtëpitë e fëmijës), qendrat rezidenciale për të moshuarit etj. Gjatë vitit 2013 rezulton se janë realizuar 171 inspektime në të këto institucione në mbarë vendin. Nga këto inspektime, në përputhje me Protokollin Opsional të Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Torturës dhe Trajtimeve të tjera Çnjerëzore e Poshtëruese (OPCAT), gjatë vitit 2013, Avokati i Popullit ka kryer 108 inspektime cilësore dhe të thelluara në funksion të Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës.

Lidhur me problematikat e ankesave të paraqitura gjatë vitit 2013, institucioni i Avokatit të Popullit ka trajtuar raste të shkeljeve të së drejtës për barazi përpara ligjit dhe ndalimin e diskriminimit, shkelje të së drejtës për informim, shkelje të të drejtave të njeriut nga policia, mosrespektim të të drejtave të të burgosurve, zvarritje të procedurave gjyqësore e administrative, shkelje të së drejtës së pronës, të drejtave që rrjedhin nga marrëdhëniet e punës, mosplotësim të nevojave të shtetasve për strehim, probleme me përfitimin nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe ndihmës ekonomike, probleme në ushtrimin e lirë dhe efektiv të së drejtës për arsimim dhe kujdes shëndetësor, etj.

Avokati i Popullit nuk e zgjidh vetë një situatë të krijuar nga shkelja e një të drejte të caktuar të një qytetari që ankohet, por ai bën rekomandime për vënien në vend të kësaj të drejte të shkelur tek organi i administratës publike që sipas tij ka shkaktuar shkeljen e saj. Për të gjitha rastet e trajtuara, kemi bërë ndërhyrjet e nevojshme nëpërmjet paraqitjes së rekomandimeve përkatëse.

Numri total i rekomandimeve drejtuar organeve të administratës publike gjatë vitit 2013 ishte 380 rekomandime në total, prej të cilave 48 janë refuzuar, 247 rekomandime janë pranuar plotësisht, 27 rekomandime janë ende në proces zbatimi. Ndërkohë, deri më datë 14 shkurt 2013 në institucionin e Avokatit të Popullit kishte 58 rekomandime të mbetura pa përgjigje nga organet e administratës publike, edhe pse kthimi i përgjigjes nga këto institucione përbën një detyrim ligjor sipas nenit 22 të Ligjit për Avokatin e Popullit, nr. 8454, datë 4.2.1999, të ndryshuar. Për këto raste jemi detyruar që sipas rastit të përsërisim rekomandimin, të kërkojmë kthimin e përgjigjeve, ose i jemi drejtuar shkallë-shkallë organeve më të larta në hierarki, duke përfshirë këtu Kuvendin e Republikës së Shqipërisë dhe Këshillin e Ministrave.

Gjatë vitit 2013, Avokati i Popullit ka vazhduar të analizojë një sërë praktikash, fenomenesh e situatash shqetësuese për shoqërinë shqiptare, që ndikojnë negativisht në gëzimin e plotë të të drejtave të qytetarëve, apo nuk janë në pajtim me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Kështu, gjatë këtij viti institucioni i Avokatit të Popullit ka përgatitur 5 raporte të veçanta, të cilat janë dërguar në Kuvendin e Shqipërisë. Këto raporte, që do të trajtohen më gjerësisht në seksionin pasardhës të raportit, kanë sjellë në vëmendje të Kuvendit dhe Ekzekutivit probleme dhe tematika emergjente, të cilat janë gjykuar prej Avokatit të Popullit se kanë nevojë për t'u adresuar më mirë prej organeve shtetërore, nëpërmjet përmirësimit të kuadrit ligjor, ose përmirësimit të punës së organeve përgjegjëse për trajtimin dhe zgjidhjen e tyre.

Dëshirojmë të vëmë në pah se pas një periudhë të gjatë, ku prej vitit 2012 asnjë prej raporteve të Avokatit të Popullit¹ nuk ishin trajtuar nga Kuvendi i Shqipërisë, të 12 raportet e veçanta të dorëzuara në Kuvend gjatë vitit 2012 dhe 2013 janë shpërndarë mes anëtarëve të Kuvendit, gjë që ka bërë të mundur bërjen publike të tyre (sipas nenit 28, të Ligjit për Avokatin e Popullit, nr. 8454, datë 4.2.1999, të ndryshuar). Duke konsideruar rëndësinë e tematikave të trajtuara në të tilla raporte, për vitin në vijim Avokati i Popullit mbetet i mendimit se raportet e reja që do të dorëzohen në Kuvend duhet të shqyrtohen në Komisionet përkatëse të Kuvendit, apo në seancë parlamentare.

Në bazë të problematikave të evidentuara nga rastet e trajtuara dhe analizave ligjore të zhvilluara nga institucioni, gjatë vitit 2013 janë përgatitur gjithsej 30 rekomandime për nxjerrje, amendime, apo plotësime të ligjeve të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, akteve nënligjore të Këshillit të Ministrave apo Ministrive përkatëse, si dhe i jemi drejtuar Gjykatës Kushtetuese me qëllim shfuqizimin e akteve nënligjore, apo ndryshimeve ligjore, që në mendimin tonë, çenojnë liritë dhe të drejtat e njeriut. Për një listë të plotë të rekomandimeve për ndryshime ligjore dhe rasteve drejtuar Gjykatës Kushtetuese, ju lutem shihni *Shtojcën I* në fund të raportit.

Avokati i Popullit, në ushtrim të funksionit të tij kushtetues, në mbrojtje të të drejtave dhe lirive të njeriut, ka vazhduar edhe gjatë vitit 2013 shqyrtimin me vëmendje të veçantë të ankesave të ardhura nga individë të komuniteteve vulnerabël, të cilët janë edhe më të rrezikuarit nga shfaqjet e fenomenit të diskriminimit. Ai e konsideron mbrojtjen dhe garantimin e të drejtave të komuniteteve vulnerabël në vend, si një ndër prioritetet e punës së institucionit, dhe si një element të domosdoshëm për progresin e mëtejshëm të integritimit në BE të vendit tonë. Ndonëse këta qytetarë ankohen për shkeljen e një të drejte të caktuar, në thelb rastet përkatëse mbartin elementë të diskriminimit dhe shkeljes së barazisë, të cilat kanë shërbyer si shkak në shkeljen e të drejtave të tjera.

Në këtë kuadër, vëmendje i është kushtuar respektimit të të drejtave të **minoritetit rom**, i cili vazhdon të përballet me një sërë problemesh, që çenojnë liritë dhe të drejtat e themelore të anëtarëve të këtij minoriteti. Pavarësisht parashikimeve ligjore në fuqi, Avokati i Popullit është i mendimit se ende ka shumë për të bërë, për të garantuar në praktikë respektimin e të drejtave, integritimin dhe përfshirjen sociale të këtij minoriteti.

Minoriteti rom është një grup vulnerabël dhe në risk, i cili faktikisht ende sot, në një pjesë të mirë të rasteve, e ka të pamundur të përfitojë nga sistemi ynë social, duke përfshirë këtu strehimin, regjistrimin në gjendjen civile, përfitimin e ndihmës ekonomike, apo edhe arsimimin, punësimin, kujdesin shëndetësor dhe çdo përfitim që sistemi ynë social ua siguron qytetarëve shqiptarë. Për shkak të këtij realiteti, Avokati i Popullit konsideron si mjaft të nevojshme, që për mbrojtjen e interesave jetësore dhe të drejtave të këtij minoriteti, të ndërmerren iniciativa për ndryshime ligjore, të cilat do të mundësonin një diskriminim pozitiv dhe lehtësim të kritereve ligjore për përfitimin e shërbimeve të sistemit aktual social nga anëtarët e minoritetit rom.

¹ Gjatë vitit 2012, institucioni i Avokatit të Popullit përgatiti dhe dërgoi në Kuvendin e Shqipërisë 7 raporte të veçanta.

Lidhur me këtë, pas një periudhe konsultimi të gjerë me aktorë të shoqërisë civile dhe komunitetit ndërkombëtar, Avokati i Popullit së bashku me një sërë organizatash, nisi në shtator të 2013 një paketë me rekomandime për ndryshime legislative në Ministrinë e Linjës për zgjidhjen afatgjate të problematikave që ndesh minoriteti Rom në Shqipëri. Më konkretisht:

- Rekomandim legjislativ për ndryshimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.787/2005 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave dhe të masës së ndihmës ekonomike”(i ndryshuar) – (drejtuar Ministrinë të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë).
- Rekomandim për marrjen e masave për regjistrimin e pjesëtarëve të minoritetit Rom në regjistrat e gjendjes civile në njësitë vendore ku ata kanë vendbanimin aktual. (drejtuar Ministrinë të Brendshme).
- Rekomandim legjislativ për ndryshimin e ligjit 9232/2004 “Për programet sociale për strehimin e banorëve në zonat urbane” (i ndryshuar)- (drejtuar Ministrinë e Zhvillimit Urban dhe Turizmit).

Gjatë vitit 2013, janë përgatitur edhe tre rekomandime të reja për mbrojtjen por edhe promovimin e të drejtave të minoritetit Rom në vend, në kuadër dhe në vazhdim të rekomandimeve që, ECRI (Komisioni Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës) i ka drejtuar Shqipërisë mbi këtë problematikë. Konkretisht janë rekomanduar:

- Realizimi i disa përmirësimeve në Ligjin nr.69 datë 21.06.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të cilat do të parashikojnë dhe garantojnë integrimin në arsim të fëmijëve Romë, nga niveli parashkollor e deri në nivelet e tjera më të larta të arsimit;
- Marrja e masave konkrete, të parashikuara në Strategjinë Kombëtare për Përmirësimin e Kushteve të Jetesës së Minoritetit Rom dhe Planin Kombëtar të Veprimit 2010-2015, “Dekada e Përfshirjes së Romëve”, për përmirësimin e kushteve të jetesës së minoritetit Rom, në një kohë sa më të shpejtë të mundshme;
- Miratimi i një ligji ku të përcaktohet definicioni dhe kriteret e njohjes “de jure” të minoriteteve, në përputhje me parashikimet e Konventës Kuadër të Këshillit të Evropës “Për mbrojtjen e minoriteteve”.

Në tetor 2013 Avokati i Popullit ka hartuar gjithashtu një raport të veçantë mbi problematikat dhe gjendjen e të drejtave të minoritetit rom në vend i cili do të dorëzohet në Kuvendin e Shqipërisë në muajt e parë të vitit 2014 (ndërkohë një tjetër Raport i Veçantë për Minoritetin Rom është përgatitur dhe në vitin 2012). Specialistë të institucionit tonë për më shumë se dy muaj kanë vizituar çdo vendbanim rom, duke krijuar një pasqyrë të qartë të problematikave të hasura nga çdo komunitet, si dhe në bazë të këtyre konstatimeve ka nisur rekomandimet përkatëse në institucionet përgjegjëse. Gjatë këtyre vizitave janë paraqitur pranë ekspertëve tanë rreth 180 ankesa individuale nga anëtarë të komuniteteve romë, të cilat po ndiqen në vijim nga ekspertët e institucionit tonë.

Gjatë muajit gusht 2013 e në vijim, 70 familje të komunitetit rom që ishin stabilizuar prej kohësh në një nga zonat më të populluara të qytetit të Tiranës, zona e ish-dekorit, u

dëbuan për shkak të një plani ndërtimi që do të zhvillohej në atë zonë. Përveç ndjekjes së situatës në terren ditë pas dite nëpërmjet ekspertëve të tij dhe raportimit të vazhdueshëm në rrjetin e organizatave vendase dhe ndërkombëtare, rekomandimet e parashtruara nga Avokati i Popullit kërkonin një zgjidhje emergjente të situatës dhe një zgjidhje afatgjatë të saj. Rekomandimet e dërguara lidhur me këtë rast ishin:

1. Rekomandim Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta për ndërhyrjen urgjente dhe verifikimin e situatës së rëndë sociale, si dhe zgjidhjen e problemit të strehimit të pjesëtarëve të komunitetit Rom në kampin e ish-Dekorit;
2. Rekomandim Bashkisë Tiranë për zgjidhjen e problemit të strehimit të pjesëtarëve të komunitetit Rom në kampin e ish-Dekorit;
3. Rekomandim Shefit të Komisarariatit nr. 2 për hetimin e kallëzimeve penale me objekt cënimin e jetës dhe shëndetit të pjesëtarëve të komunitetit Rom në kampin e ish-Dekorit;
4. Rekomandim Ministrisë së Shëndetësisë për marrjen e masave për trajtimin dhe asistencën e vazhdueshme shëndetësore për pjesëtarët e komunitetit Rom në kampin e ish-Dekorit;
5. si dhe Rekomandimi drejtuar Drejtorisë Arsimore Rajonale Tiranë për marrjen e masave për të mundësuar regjistrimin e fëmijëve të komunitetit Rom, që jetojnë në kampin e ish-Dekorit në rrugën e Kavajës, në shkollat 9-vjeçare pranë vendbanimit aktual të tyre dhe pajisjen e tyre me libra dhe bazën mësimore falas.

Me shumë kënaqësi kemi pritur ndërhyrjen e menjëhershme të Ministrisë së Mirëqënies Sociale dhe Rinisë, të drejtuar nga Ministri i ri, z. Erion Veliaj, dhe stafit të tij gjatë muajve shtator dhe tetor 2013, për gjetjen e një zgjidhje tranzitore dhe stabilizimin e këtij komuniteti në një mjedis të sigurtë dhe ofrimin e një sërë shërbimesh të tjera shëndetësore, sociale, arsimore, etj. Pavarësisht kësaj ndërhyrje, Avokati i Popullit mbetet i mendimit se si për anëtarët e këtij komuniteti, por gjithashtu dhe për një sërë qytetarësh me probleme të strehimit, nevojitet përgatitja e një strategjie afatmesme dhe afatgjatë për të garantuar një zgjidhje sa më të plotë të problematikës së strehimit të shtetasve shqiptarë dhe anëtarëve të minoritetit rom në veçanti.

Pavarësisht legjislacionit në fuqi, **personat me aftësi të kufizuar** mbeten ndër shtetas më të marginalizuara në shoqërinë shqiptare, duke iu mohuar aksesin për disa prej eksperiencave më themelore të jetës së tyre. Ata kanë pak shpresë për të shkuar në shkollë, për të gjetur një punë, për të pasur shtëpinë e tyre, për të krijuar familjen e tyre dhe për të pasur fëmijët e tyre, për të shijuar një jetë sociale, apo edhe për të votuar. Për shumicën dërrmuese të personave me aftësi të kufizuar, dyqanet, lehtësirat publike dhe ato të transportit, por edhe informacioni, janë përgjithësisht shumë të vështira për t'u aksesuar.

Personat me aftësi të kufizuara dhe të drejtat e tyre, përbëjnë një nga misionet më të rëndësishme të institucionit të Avokatit të Popullit. Ato janë pjesë e rekomandimit 11, të përcaktuar nga BE për Shqipërinë, dhe në këtë kontekst por jo vetëm, zhvillimet në legjislacionin dhe politikat për personat me aftësi të kufizuara, si dhe zbatimi i tyre, kanë qenë objekt i diskutimeve, vlerësimeve dhe rekomandimeve të institucionit tonë.

Viti 2013 ka pasur jo pak vështirësi për personat me aftësi të kufizuara, ku duhen përmendur vonesat e krijuara disa here për pagesën e paaftësisë, si dhe për kompensimin e energjisë elektrike, shpenzimeve telefonike, transportit urban dhe interurban, të parashikuara në legjislacionin në fuqi. Për një pjesë dërmuese të këtyre qytetarëve, pagesa e paaftësisë është i vetmi burim jetese dhe për shkak të aftësive dhe mundësive të kufizuara, ata nuk mund të sigurojnë plotësimin e nevojave bazë jetike.

Ne si institucion jemi pozicionuar qartë në anën e qytetarëve të prekur nga kjo situatë, duke bërë rekomandimet përkatëse. Lidhur me situatën e krijuar, Avokati i Popullit ka nisur një rekomandim drejtuar Ministrisë të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dhe Ministrisë së Financave, ku kërkohej lëvrimi sa më parë i fondeve për pagesën e vonuar të personave me aftësi të kufizuara. Dhënia e këtyre pagesave filloi në muajin Dhjetor 2013 dhe nga Qeveria u premtua se nuk do të ketë më vonesa në dhënien e ndihmës ekonomike dhe aftësisë së kufizuara. Përfitimi i pagesave të prapambetura do të vazhdojë nga muaji janar 2014 e në vazhdim.

Duke analizuar situatën e përsëritur të vonesave në dhënien e pagës së paaftësisë personave me aftësi të kufizuara, Avokati i Popullit mendon se pavarësisht vështirësive financiare, apo mosrakordimit mes pushtetit qendror dhe vendor, institucionet shtetërore duhet të kenë kujdes të veçantë për mos përsëritjen e kësaj situate, që cënon rëndë të drejtat e një grupi vulnerabël. Gjithashtu, në çdo rrethanë nuk duhet neglizhuar transparencën ndaj opinionit publik dhe aktorëve të interesuar në trajtimin e kësaj situate, pavarësisht vështirësive që ajo mbart.

Grupet e interesit të personave me aftësi të kufizuara kanë propozuar një projekt ligj për përfaqësimin e tyre demokratik, i cili është mbështetur në vitin 2012 nga deputetët e grupit parlamentar të opozitës së asaj kohe. Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara në disa nene të saj kërkon që këto grupe të mbështeten, konsultohen dhe të përfshihen në jetën publike nëpërmjet organizatave kombëtare, rajonale dhe lokale të përbërë nga anëtarët e grupeve të interesit. Avokati i Popullit mbështet këtë iniciativë të grupeve të interesit dhe të anëtarëve të Parlamentit.

Një tjetër iniciativë gjatë vitit 2013, ka qenë hartimi i një raporti të veçantë nga Avokati i Popullit mbi nivelin e zbatimit të kërkesave të ligjit nr. 7995 "Për nxitjen e punësimit", për punësimin e personave me aftësi të kufizuara nga institucionet publike, raport i cili është dërguar për shqyrtim në Kuvend.

Avokati i Popullit ka vazhduar trajtimin e çështjeve të lidhura me të drejtat e **komuniteti LGBT**. Lesbiket, gay-it, biseksualët dhe transgjinjorët hasen me vështirësi në jetën e tyre të përditshme dhe me kufizime të të drejtave themelore, të cilat parimisht duhet të gëzohen nga të gjithë qeniet njerëzore pa dallim.

Në vijim të Rekomandimit no.11 të Komisionit Evropian, si dhe mbi bazën e propozimeve të ardhura nga komuniteti LGBT, Avokati i Popullit ndërmori një studim krahasues të legjislacionit penal, në lidhje me mbrojtjen që i garantohet anëtarëve të këtij komuniteti. Nga studimi i legjislacionit penal të vendeve të tjera rezulton se ato kanë të zhvilluar konceptin e të ashtuquajturit 'krim të urrejtjes', duke e parashikuar këtë akt në Kodin Penal si vepër penale, ose si rrethanë lehtësuese. Në këtë këndvështrim, Avokati i Popullit, i nisi

një rekomandim Ministrisë së Drejtësisë, ku u propozua që në nenin 50, germa "j", të Kodit Penal, të shtohet si rrethanë rënduese kryerja e veprës penale, e shtyrë nga motive që kanë të bëjnë me orientimin seksual dhe/ose identitetin gjinor. Po kështu, u rekomandua ndryshimi i neneve 119/a dhe 119/b të Kodit Penal, ku të parashikohet si vepër penale shpërndarja e materialeve homofobike si dhe fyerjes nëpërmjet rrjetit kompjuterik për motive të orientimit seksual dhe/ose identitetin gjinor.

Të dyja rekomandimet u morën në konsideratë nga Ministria e Drejtësisë. Në projektligjin e propozuar nga Komisioni i Ligjeve në Kuvendin e Shqipërisë dhe të miratuar nga Kuvendi, u përfshi i plotë rekomandimi i parë. Lidhur me rekomandimin e dytë, ndryshimet në Kodin Penal parashikuan nxitjen e urrejtjes dhe grindjeve, vetëm për shkak të orientimit seksual, si dhe përgatitjen, përhapjen ose ruajtjen e shkrimeve me përmbajtje të tillë, e kryer me çdo mjet ose formë, duke mos përfshirë si shkak të nxitjes së urrejtjes identitetin gjinor.

Avokati i Popullit i konsideron të drejtat e personave LGBT si pjesë të pandashme të tërësisë së të drejtave të njeriut, dhe për këtë është shprehur qartë se nuk duhet të ketë pengesa ligjore për personat e komunitetit LGBT në realizimin e të drejtave, të cilat gëzohen nga pjesa tjetër e shoqërisë. Në këtë drejtim, Në një punë të përbashkët me Këshillin e Europës, Avokati i Popullit, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe grupet e interesit kanë përgatitur dhe paraqitur në dhjetor 2014 pranë institucioneve përkatëse një paketë me rekomandime për ndryshime legislative, përfshirë këtu dhe ndryshime në Kodin e Familjes, ku parashikohet ligjërimi i bashkëjetesës mes personave të të njëjtit seks.

Dhuna me bazë gjinore, e veçanërisht dhuna ndaj grave në familje, vazhdon të mbetet një fenomen mjaft i përhapur dhe problematik për shoqërinë tonë, dhe si rrjedhojë, është përgjegjësia e shtetit, komunitetit dhe individëve të ndërmarrin veprimet e nevojshme për ta ndaluar atë. Është e domosdoshme që qeveria dhe institucionet përgjegjëse të ndërmarrin inisiativat e duhura kundër këtij fenomeni në mënyrë që të respektojë dhe plotësojë të drejtat themelore të grave dhe fëmijëve si pjesë e të drejtave të njeriut.

Në këtë situatë është emergjente konsolidimi i mëtejshëm i mekanizmave të referimit për dhunën në familje, e në këtë drejtim koordinimi ndërmjet institucioneve qendrore dhe vendore duhet të përmirësohet, si edhe duhet të ngrihen strukturat që mungojnë, konkretisht streha publike dhe shërbimet sociale përkatëse për viktimat.

Ndërkohë, është rritur numri i individëve, kryesisht i grave, që i drejtohen gjykatës për arsye të dhunës në familje. Ka pasur një rritje të numrit të gjykatave që kanë lëshuar urdhra mbrojtjeje për viktimat e dhunës në familje. Shtimi i numrit të vendimeve për urdhrat e mbrojtjes të lëshuara nga Gjykata tregon se është rritur ndërgjegjësimi, reagueshmëria dhe besimi i viktimave të dhunës në sistemin e mbrojtjes. Mirëpo, shpejtësisë së gjykatës nuk i përgjigjen strukturat e përmbartimit, të cilat duket se e gjejnë të vështirë në terren zbatimin e vendimeve gjyqësore.

Edhe pse, gratë përbëjnë shumicën e viktimave të dhunës seksuale, ato kanë dhe barrën e provës në rastin kur ky abuzim seksual ndodh. Dhuna përbën elementin kryesor të veprës penale dhe, kur viktimat nuk mund të tregojë prova të shenjave të dhunës, krimi nuk mund

të provohet. Për më tepër, dhuna psikologjike është tepër e vështirë të provohet dhe shpesh i lë autorët të pandëshkuar. Ndërkohë, abuzimet seksuale për shkak të shpërdorimit të varësisë, ose të detyrës mbeten shpesh të heshtura dhe të padenoncuar.

Po kështu, procesi i dëmshpërblimit të gruas që ka pësuar torturë, dhunë seksuale, ose forma të tjera të keqtrajtimit, në praktikë është i vakët. Padia civile në procesin penal përdoret shumë rrallë.

Një hap pozitiv në lidhje me të drejtat e grave dhe barazinë gjinore u mor në maj të 2013, me miratimin e ndryshimeve në Kodin Penal që e cilësojnë përdhunimin dhe dhunën seksuale në martesë si një vepër penale.

Në aspektin ligjor, sfida mbetet përafrimi në vazhdimësi i legjislacionit me standardet ndërkombëtare, si dhe monitorimi i zbatimit të legjislacionit aktual. Në këtë kuadër, dhe në rolin e tij të promovimit të standardeve më të larta të të drejtave të njeriut, Avokati i Popullit ka rekomanduar së fundmi plotësimin e Ligjit Nr. 7961 datë 12.07.1995, "Kodi Punës i Republikës së Shqipërisë", (i ndryshuar) në nenin 32 të tij duke shtuar si dispozitë ligjore në pikën 4 edhe ngacmimin moral në punë nga ana e punëmarrësit, nëpërmjet veprimeve të përsëritura që kanë për qëllim ose sjellin si pasojë degradimin e kushteve të punës në një shkallë të tillë që mund të çojë në cënimin e të drejtave dhe të dinjitetit të personit, në prishjen e shëndetit të tij fizik ose mendor ose në dëmtimin e të ardhmes së tij profesionale. Ky rekomandim i është dërguar për shqyrtim Ministrisë së Drejtësisë.

Bashkëpunimi i vazhdueshëm i Avokatit të Popullit me organizatat jofitimprurëse, që gjatë dy viteve të fundit është materializuar në marrëveshjet e përbashkëta të bashkëpunimit, është përqendruar kryesisht në trajtim (referim) rastesh, ndërgjegjësim komuniteti lidhur me të drejtat e grave-aktivitete të përbashkëta, etj, dhe hartim rekomandimesh. Marrëveshjet e bashkëpunimit të Avokatit të Popullit me organizata të shoqërisë civile në mbrojtje të të drejtave të grave, ka bërë të mundur që vetë shoqëria civile "ta përdorë efektivisht Avokatin e Popullit për të përçarur mesazhe të rëndësishme lidhur me gjendjen e të drejtave të grave ndaj të cilave duhet ndërhyrje ligjore, administrative, etj".

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, në nenin 54 të saj i ka cilësuar **fëmijët** si subjekte që kanë të drejtën e një mbrojtjeje të veçantë nga shteti. Ky përcaktim përbën një bazë të rëndësishme në lidhje me marrjen e masave të duhura e të nevojshme për t'i mbrojtur këta subjekte dhe të drejtat e tyre në çdo situatë e kur është e domosdoshme.

Miratimi i ligjit nr. 10347, datë 04.11.2010 "Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës" konsiderohet dhe përbën një hap përpara në institucionalizimin e të drejtave të fëmijës në vendin tonë, pasi ka parashikuar ndër të tjera mekanizmat institucionale për mbrojtjen e këtyre të drejtave në nivel qendror dhe vendor. Megjithëse ka një numër aktorësh të qeverisjes qendrore e asaj vendore, që kanë në objekt të veprimtarisë së tyre këtë kategori sociale, bashkëpunimi ndërmjet tyre mbart probleme të koordinimit, kompetencave dhe shkëmbimit të informacionit.

Respektimi dhe vlerësimi i dinjitetit të fëmijëve në përgjithësi, dhe veçanërisht i kategorive të fëmijëve jetimë si dhe të fëmijëve që shfrytëzohen për të punuar, janë një sfida e madhe për shoqërinë tonë. Varfëria e dukshme, mbetet një pengesë e madhe për përballimin e

nevojave, mbrojtjen dhe nxitjen e të drejtave të kësaj kategorie fëmijësh. Puna e fëmijëve në përgjithësi dhe fëmijët të rrugës në veçanti, si forma të shfrytëzimit ekonomik dhe punës së detyruar të fëmijëve, përbëjnë një nga shkeljet më të rënda të të drejtave të fëmijëve në Shqipëri. Shkaqet e punës së rëndë të fëmijëve duhen kërkuar tek përjashtimi social, mundësitë e pakta të familjeve për të siguruar të ardhura, si dhe varfëria. Për atë kohë sa nuk punohet për zhdukjen e shkaqeve, shfrytëzimi ekonomik i fëmijëve do të përbëjë një nga shkeljet më të rënda të të drejtave të fëmijëve në vend.

Rastet e dhunës ndaj fëmijëve në familje janë një tjetër fenomen shqetësues. Po kështu, fëmijët janë nga kategoritë më të prekura nga fenomeni i gjakmarrjes. Në këtë drejtim nevojitet që institucionet shtetërore të ndërmarrin hapat e nevojshëm lidhur me këtë fenomen. Më shumë vëmendje duhet kushtuar nga të gjithë institucionet përgjegjëse dhe aktorët e shoqërisë civile, në identifikimin e fëmijëve të ngujuar, që janë jashtë sistemit arsimor dhe koordinimit me shërbime për t'ju garantuar atyre të drejtat që i mohohen me qëllim minimizimin e këtij fenomeni.

Aktiviteti i Avokatit të Popullit për monitorimin e zbatimit të të drejtave të fëmijëve, ka qenë i përqendruar në sigurimin e kushteve sa më të përshtatshme të jetesës e të mirërritjes së fëmijëve, bazuar në përcaktimet e Ligjit nr.8454 date 4.02.1999 "Për Avokatin e Popullit". Avokati i Popullit, me inisiativë, ka vazhduar kryerjen e inspektimeve në një sërë institucionesh rezidenciale publike të përkujdesit shoqëror, si në Shtëpinë e Fëmijës Shkollor Shkodër, Qendrën e Zhvillimit Shkodër, Shtëpinë e Fëmijëve Shkollorë Sarandë, Shtëpinë e Fëmijës 0-6 vjeç Shkodër, në Qendrën e Zhvillimit Pëllumbat Tiranë, etj. Fokusi kryesor i inspektimeve të kryera ka pasur të bëjë me krijimin e standardeve të pranueshme të jetës së përditshme, të fëmijëve që strehohen në këto institucione.

Po kështu, Zyra Rajonale e Avokatit të Popullit në Shkodër ka vazhduar të mbështesë institucionalisht Observatorin për të Drejtat e Fëmijëve në nivel Qarku. Tashmë, së bashku me Observatorin për të drejtat e fëmijëve, kemi arritur të krijojmë mekanizmin e mbledhjes së të dhënave për fëmijët. Ky mekanizëm është i vlefshëm jo vetëm në prezantimin e situatës së zbatueshmërisë të të drejtave të fëmijëve, por edhe në formulimin e politikave të reja e favorizuese për fëmijët drejtuar institucioneve të qeverisjes vendore.

Rëndësi e veçantë gjatë vitit 2013, i është kushtuar lobimit për krijimin e një strukture të veçantë për monitorimin, mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të fëmijëve, bazuar kjo në Konventën e OKB-së për të Drejtat e Fëmijës. Pikërisht ky funksion kërkohet të realizohet nga një institucion plotësisht i pavarur, i krijuar mbi bazën e Parimeve të Parisit, i parashikuar në Kushtetutë dhe me kompetenca të gjera për zhvillimin e hetimeve. Për këtë arsye, kemi rekomanduar që kjo strukturë duhet të jete pjesë e institucionit të Avokatit të Popullit, si një eksponent që i gëzon të gjitha këto karakteristika.

Për këtë arsye, në projekt-buxhetin e Avokatit të Popullit për vitin 2014, kërkuam shtim në staf me ekspertë respektivë për mbrojtjen, trajtimin e ankesave lidhur me të drejtat e fëmijëve, si dhe promovimin e këtyre të drejtave. Me kënaqësi dëshirojmë të vëmë në pah se Ministria e Financave dhe më vijim Kuvendi i Shqipërisë miratuan këtë kërkesë, duke aprovuar buxhetin e nevojshëm për shtimin me dy ekspertë (ndihmës komisionerë) për të drejtat e fëmijëve. Gjithsesi, në këtë drejtim është gjithashtu e domosdoshme të bëhen ndryshimet dhe përmirësimet në Ligjin "Për Avokatin e Popullit" të propozuara

nga EURALIUS në prill 2013, ç'ka do të mundësonte krijimin e një Seksioni të veçantë për fëmijët, si pjesë e institucionit të Avokatit të Popullit. Pra, krijimi i një seksioni të veçantë dhe të specializuar për të drejtat e fëmijëve brenda institucionit të Avokatit të Popullit, është përgjigja për një zgjidhje optimale për çështjet kryesore ku ka probleme me të drejtat e fëmijëve dhe plotësimin e standardit të kërkuar nga OKB-ja, sipas Parimeve të Parisit. Ky seksion do të jetë garantues i zbatimit të Konventës së të Drejtave të Fëmijës dhe do të veprojë për të promovuar të drejtat e tyre në Parlament, Qeveri dhe në shoqërinë civile, do veprojë si mediator në marrëdhëniet ndër-institucionale, do ndikojë gjithashtu në politikat, duke krijuar forume ku do të dëgjohet zëri i fëmijëve, duke riparë aksesin e tyre në sistemin e ankimit dhe për t'ju përgjigjur ankesave individuale.

Avokati i Popullit vëren me shqetësim se edhe gjatë vitit 2013, **fenomeni i gjakmarrjes** vazhdon të kufizojë gëzimin e të drejtave të një numri të konsiderueshëm qytetarësh dhe në disa raste ka rezultuar dhe në humbje jetësh. Duke vlerësuar të drejtën e jetës si të drejtën themelore dhe më të rëndësishme të njeriut të mbrojtur me ligj, si dhe duke njohur rrezikun që fenomeni i gjakmarrjes ka mbi gëzimin e kësaj të drejte (krime vrasjeje, ngujime, si dhe privim të të drejtave dhe lirive të tjera), Avokati i Popullit edhe gjatë këtij viti ka vazhduar dhe intensifikuar përpjekjet institucionale për sensibilizimin e institucioneve shtetërore, shoqërisë civile dhe individëve lidhur me këtë problem të mprenjtë social.

Përveç masave të marra deri më tani nga institucionet përgjegjëse, institucioni i Avokatit të Popullit ka kërkuar zbatimin e menjëhershëm të Ligjit "Për krijimin dhe funksionimin e Këshillit Koordinues në luftën kundër gjakmarrjes" (Ligji 9389, datë 04.05.2005) dhe një angazhim dhe bashkëpunim mes institucioneve të qeverisjes qendrore dhe vendore për t'u përballur me këtë fenomen. Avokati i Popullit konstaton se gjatë vitit 2013 pati lëvizje pozitive nga organet e shtetit. Përveç faktit të pranimit publikisht të këtij fenomeni, organet shtetërore kanë filluar të marrin masa konkrete, të tilla si: ngritjen e grupit të punës ndër-dikasterial për përgatitjen dhe miratimin nga Këshilli i Ministrave të tre akteve nënligjore në bazë dhe në zbatim të Ligjit 9389, datë 04.05.2005 "Për krijimin dhe funksionimin e Këshillit Koordinues në luftën kundër gjakmarrjes".

Avokatit i Popullit në rolin e tij si **Mekanizëm për Parandalimin e Torturës (MKPT)** edhe gjatë vitit 2013 ka ushtruar kontroll të vazhdueshëm në qendrat ku ka **persona të cilëve u privohet liria** në zbatim të një vendimi gjyqësor duke vlerësuar kushtet e trajtimit si dhe respektimin prej administratës së të drejtave dhe lirive të tyre. Përsa i përket ankesave të paraqitura nga personat që vuajnë dënimet në këto institucione janë paraqitur gjithsej 86 ankesa individuale që lidhen me të drejtat e të burgosurve, nga të cilat 56 janë mbyllur dhe 30 janë ende në shqyrtim. Nga rastet e mbyllura 48 kanë rezultuar të pabazuara në ligj dhe 8 janë zgjidhur në favor të ankuesit gjatë shqyrtimit.

Ankesat janë paraqitur nga të burgosurit dhe familjarë të tyre nëpërmjet postës, postës elektronike si dhe duke na telefonuar në numrin pa pagesë të institucionit si dhe në numrin e telefonit për emergjencat. Shërbimi i telefonit është kthyer në mënyrën e parapëlqyer nga të burgosurit për të paraqitur ankesa, veçanërisht në vitin 2013.

Objekti i ankesave ka qenë i larmishëm dhe secila ankesë e pranuar pasqyron një situatë individuale. Numri më i madh i ankesave ka të bëjë me cilësinë e shërbimit shëndetësor;

moskthim përgjigje kërkesës për të përfituar leje të veçantë; refuzim i kërkesës për të përfituar leje shpërblyese; moslirim për arsye të plotësimit të dënimit; mbajtje e padrejtë në dhomën e veçimit; moskthim përgjigje kërkesës për t'u transferuar në një institucion tjetër; refuzim i kërkesës për tu transferuar në një institucion tjetër për asye shëndetësore dhe të afërsisë me vendbanimin e familjes; masë disiplinore e padrejtë; cilësia e ushqimit; mungesë e ngrohjes.

Ashtu si edhe në vitin paraardhës, gjatë vitit 2013 shumë prej burgjeve dhe paraburgimeve në vend vijojnë të vuajnë nga probleme të amortizimit dhe kushteve të papërshtatshme të tyre, veçanërisht të lagështirës (Burgjet 325,313 Tiranë, Rogozhinë, Tepelenë, Lezhë, Kosovë e Lushnjes, Burrel, Paraburgimet Berat, Sarandë, 313 dhe 302 Tiranë), mungesës së ujit, sidomos gjatë periudhës së verës (Burgjet Rogozhinë, Krujë, Paraburgimi Elbasan), kushteve jashtë standardeve të tualeteve, dusheve, ambienteve të ajrimit, dhomave të izolimit, mungesës së ambienteve të edukimit, ushtrimit të riteve fetare, veprimtarisë sportive etj (Burgjet Burrel, Lezhë, Tepelenë, Kosovë e Lushnjes dhe Paraburgimet Sarandë, Berat, 313 dhe 302 Tiranë). Avokati i Popullit ka rekomanduar dhe insiston që të mbyllet burgu i Burrelit, të vazhdojnë të transferohen të sëmuret mendore nga Burgu Krujë etj, në një institucion të specializuar shëndetësor sipas parametrve dhe standardet përkatëse. Gjatë inspektimeve dhe ri-inspektimeve të kryera gjatë vitit 2013, në të gjitha këto institucione është përsëritur nevoja urgjente për investime kryesisht të pjesshme që do të përmirësojnë ndjeshëm kushtet ekzistuese.

-Institucioni i Avokatit të Popullit mendon se një vëmendje e veçantë duhet treguar për trajnimin e stafit të burgjeve, lidhur me të drejtat e të burgosurve gjatë grevave të urisë, takimeve me familjarët, kontrolleve të të dënuarve, ambienteve ku jetojnë. Gjithashtu në respekt të dinjitetit të të dënuarve, familjarëve dhe fëmijëve të tyre duhen trajtuar me një rëndësi të veçantë kontaktet e të dënuarit me familjarët dhe fëmijët e tyre të mitur duke sistemuar vende të përshtatshme, pasi në disa burgje ato nuk ekzistojnë

Përveç problematikave të mësipërme, nga inspektimet që janë kryer prej MKPT-ja kanë rezultuar edhe disa problematika të tjera të cilat janë vlerësuar prej Avokatit të Popullit si të rëndësishme pasi çenojnë të drejtat dhe liritë e njeriut si dhe nuk mundësojnë edukimin dhe riintegrimin e personave të dënuar në jetën normale. Midis këtyre problematikave do të veçojmë punësimin e të burgosurve si dhe mbajtjen në spital burgut të personave që kanë kryer vepra penale por për shkak se janë vlerësuar të paaftë mendërisht është urdhëruar shtrimi i tyre në spital psikiatrik

- Punësim në burg është një kontribut i rëndësishëm në rehabilitimin e të burgosurve dhe në përgatitjen e tyre për t' u integruar në shoqëri. Punësimi ndikon pozitivisht te të burgosurit edhe në forma të tjera. Për shumë prej tyre të ardhurat nga punësimi do të shërbenin për të blerë kartat telefonike për të folur me familjarët dhe miqtë dhe artikuj të tjerë si ushqime, detergjentë etj. Pa këto të ardhura, është e lehtë që një i burgosur të futet në borxh duke sjellë edhe pasoja. Puna gjithashtu i jep të dënuarve një ndjenjë discipline dhe qëllimi, ndërsa të burgosur të papunësuar i kalojnë ditët të mbyllur në dhomat e tyre duke shkaktuar mërzi dhe izolim. Megjithëse puna e të burgosurve duhet të paguhet, kjo e drejtë e tyre vazhdon të mos zbatohet për shkak të mos nxjerrjes së akteve nënligjore. Në lidhje me shpërblyerimin e punës të të burgosurve, i është dërguar rekomandim Ministrisë së Drejtësisë, ku është kërkuar hartimi i projekt vkm-së për përcaktimin e kriterëve të shpërblyerimit të punës të të

burgosurve dhe dërgimin e tij sa më parë për miratim në Këshillin e Ministrave. Aktualisht jemi në pritje të përgjigjes nga Ministria e Drejtësisë.

- Burgjet nuk janë vendi i duhur për personat me probleme të shëndetit mendor. Nuk është gjetur një zgjidhje përfundimtare për strehimin në një ambient spitalor jashtë sistemit të burgjeve të personave që kanë marrë masë nga gjykata për mjekim të detyruar me gjithë hapjen e një sektori të veçantë në paraburgimin e Durrësit. Në vitin 2012 është punuar një rekomandim, drejtuar Ministrisë së Drejtësisë, ku është kërkuar hapja e një institucioni të ri mjekësor për sistemimin e personave me probleme të shëndetit mendor, për të cilët gjykata ka dhënë masë mjeksore “mjekim të detyruar”. Në përgjigjen e Ministrisë së Drejtësisë, të datës 26.07.2012, thuhet se është vendosur që të ndërtohet një godinë e re në territorin e Spitalit të Burgut dhe është sugjeruar përfshirja e këtij projekti në programin IPA 2013.

Gjatë ushtrimit të veprimtarisë së punës së Avokatit të Popullit, **në trajtimin e ankesave të qytetarëve ndaj Policisë** për vitin 2013, janë konstatuar raste të keqtrajtimit të qytetarëve në mjediset e Komisariateve të Policisë, shoqërime të paligjshme të tyre dhe në kundërshtim me dispozitat ligjore për shoqërimin e shtetasve, ndërhyrje të paligjshme të punonjësve të policisë gjatë kryerjes së shërbimit pa paraqitur identifikimin policor, mosvlerësime të kallëzimeve të shtetasve për vepra penale të ndryshme, apo dhe për raste të veprave penale të dhunës në familje etj.

Gjatë kësaj periudhe janë trajtuar raste të ankesave të grupit të antarëve të Shoqatës së ish të Burgosurve Politikë, për shoqërime të paligjshme, veprime jo korrekte në kërkesat e tyre për organizimin e tubimeve paqësore, të cilat kanë konsistuar në, dhënien me vonesë të vendimit për orarin e zhvillimin të tubimeve, jo në vendin e kërkuar prej tyre, në manifestimin e sjelljeve jo korrekte dhe etike ndaj tubuesve, ashtu dhe në dhe në ndjekjen dhe vëzhgimin e padrejtë të antarëve të këtij grupimi.

Mbi shqetësimin e qytetarëve pas ankesës së tyre, apo në raste të tjera filluar me iniciativë pas njoftimeve publike të bëra në media, i kemi Rekomanduar Policisë analizën e rasteve dhe marrjen e masave disiplinore ndaj punonjësve të policisë, përgjegjës për shkeljet e kyera.

Ka një predispozicion të Policisë në shqyrtimin, vlerësimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit dhe në marrjen e masave ndaj punonjësve të policisë që kanë kryer shkeljet por ende shfaqen raste problematike për të cilat duhet të vazhdohet të punohet.

Gjatë vitit 2013, Institucioni i Avokatit të Popullit ka trajtuar ankesa, apo kërkesa të individëve **ish të dënuar politikë të regjimit komunist**, si dhe të trashëgimtarëve të tyre. Problematikat e parashtruara në këto ankesa, apo kërkesa kanë të bëjnë me pretendimet për: mospërfitimin e kësteve të dëmshpërblimit që përfitojnë si ish të dënuar politikë, mospërfitimin në mënyrë të padrejtë të dëmshpërblimit në kushtet e cilësuar nga ligji nr.9831 datë 12.11.2007 “Për dëmshpërblimin e ish të dënuarve politikë të regjimit komunist”, i ndryshuar; caktimin jo korrekt të masës së dëmshpërblimit nga ana e Ministrisë së Drejtësisë; mosgjetjen e eshtrave të të afërmeve ish të dënuar politikë, të vdekur gjatë vuajtjes së dënimit; zvarritjen e procedurave për caktimin e masës së dëmshpërblimit; mundësimin e marrjes së shumës totale të dëmshpërblimit në mënyrë të menjëhershme dhe jo sipas radhës së kësteve të përcaktuara; zvarritjen e procesit të dëmshpërblimit për grupimin e të internuarve, sipas parashikimeve të ligjit.

Edhe gjatë vitit 2013, i është dhënë përparësi dhe janë trajtuar me kujdes ankesat e drejtuara nga këta individë në një këndvështrim shumë më të gjerë se sa një vit më parë dhe konkretisht sa i përket ecurisë së procesit të dëmshpërblimit të ish të dënuarve politikë të regjimit komunist, procesit të munguar dhe të vonuar njëkohësisht të hapjes së dosjeve, si dhe funksionimit të Task-Forcës për kërkimin, gjetjen dhe identifikimin e personave të ekzekutuar gjatë viteve të regjimit komunist.

Së pari, lidhur me ecurinë e procesit të dëmshpërblimit të ish të dënuarve politikë të regjimit komunist, sa i përket parashikimeve të bëra në Ligjin nr.9831 datë 12.11.2007 “Për dëmshpërblimin e ish të dënuarve politikë të regjimit komunist”, i ndryshuar, theksojmë se mbeten ende problematika të pazgjidhura dhe që kërkojnë veprim të shpejtë dhe konkret.

Në këtë drejtim është i nevojshëm realizimi i inisiativës legislative, për një ndryshim në VKM nr.419 datë 14.04.2011 “Për miratimin e afateve dhe të skemës së shpërndarjes së fondeve të dëmshpërblimit, për ish të dënuarit politikë të regjimit komunist”, me qëllim përcaktimin e një afati përfundimtar të arsyeshëm, për përfundimin e procesit të dëmshpërblimit, për ish të përndjekurit politikë të regjimit komunist. Sikurse është evidentuar në rekomandimin tonë drejtuar me shkresën nr.K1/G60-17 datë 12.02.2013, Ministrit të Drejtësisë, ky akt jo vetëm që është nxjerrë me gati dy vjet vonesë nga koha që ka përcaktuar ligji, por në përmbajtjen e dispozitave të tij, vërehet se, afati i shpërndarjes së fondeve të dëmshpërblimit është kthyer nga një çështje afati taksativ të përcaktuar nga norma, në një afat që varet krejtësisht nga ecuria korrekte e miratimit të plotë dhe përfundimit të dëmshpërblimit të shpërndarjes së këstit të dytë, për të gjithë ish të dënuarit politikë. Realisht, kemi një skemë dëmshpërblimi me shpërndarje në tetë këste të barabarta, por me një afat kohor që njeh vetëm një datë fillimi të procesit dhe jo një datë fikse mbarimi.

Përmbajtja e Ligjit nr.9831 datë 12.11.2007, pas ndryshimeve, si dhe e akteve nënligjore të dala në zbatim të tij, veçanërisht e VKM nr.419 datë 14.04.2011, kanë krijuar konfuzion në ecurinë e pritshme të procesit të dëmshpërblimit nga palët e interesuara dhe efektivisht ka çuar në konkluzionin e perceptuar prej tyre, të moszbatimit të ligjit, duke cënuar kështu edhe parimin e sigurisë juridike, si një komponent i rëndësishëm i shtetit të së drejtës. Sa i përket këtij rekomandimi nuk kemi pasur asnjë reagim, ndaj edhe jemi detyruar që t’ia ridërgojmë Ministrit aktual të Drejtësisë në muajin Dhjetor 2013, në pritje të një zgjidhje përfundimtare për këtë çështje.

Po kështu, duhet të fillojë trajtimi i kategorisë së të internuarve, kategori e përfaqësuar prej personave të internuar, ose të dëbuar në kampe, nga regjimi komunist me dëmshpërblimin përkatës, sipas kushteve të parashikuara në Ligjin nr.9831 datë 12.11.2007 “Për dëmshpërblimin e ish të dënuarve politikë të regjimit komunist”, i ndryshuar. Sikurse është evidentuar nga ana jonë, megjithëse individët e interesuar kanë kohë që kanë paraqitur të gjithë dokumentacionin e nevojshëm zyrtar pranë Ministrisë së Drejtësisë për këtë qëllim, ende nuk ka filluar trajtimi i tyre me dëmshpërblim. Ky proces është bllokuar për shkak të mospërmbushjes së detyrimit nga ana e Ministrisë së Drejtësisë për t’i propozuar Këshillit të Ministrave, miratimin e dëmshpërblimit për këtë kategori ish të dënuarish politikë, me VKM përkatëse. Sa i përket këtij rekomandimi nuk kemi pasur asnjë reagim, ndaj edhe jemi detyruar që t’ia ridërgojmë Ministrit aktual të Drejtësisë në muajin Dhjetor 2013, në pritje të një zgjidhjeje përfundimtare për këtë çështje.

Gjithashtu, duhet të plotësohet baza e nevojshme ligjore, e cila do të mundësojë procesin e dëmshpërblimit financiar për kategorinë e personave të internuar, ose të dëbuar gjatë regjimit komunist të përcaktuara në gërmën "c", të nenit 6, të Ligjit "Për dëmshpërblimin e ish të dënuarve politikë të regjimit komunist", i ndryshuar. Pavarësisht kërkesave të subjekteve të interesuara, Këshilli i Ministrave ende nuk ka miratuar skemën e pensionit me VKM përkatës, skemë nga e cila do të përfitojnë dëmshpërblimin këto kategori ish të dënuarish politikë. Në këto kushte i kemi rekomanduar në fillim të vitit 2013 Ministrin të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe Ministrin të Drejtësisë, paraqitjen në një kohë sa më të shpejtë të mundshme në Këshillin e Ministrave, të propozimeve për miratimin e skemës së pensionit për kategorinë e të internuarve ose të dëbuarve nga regjimi komunist. Për këtë rekomandim nuk kemi pasur asnjë reagim, ndaj edhe jemi detyruar që t'ia ridërgojmë Ministrin të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dhe Ministrin të Drejtësisë në muajin Dhjetor 2013, në pritje të një zgjidhjeje përfundimtare për këtë çështje.

Së dyti, Avokati i Popullit në kuadër të mbrojtjes dhe respektimit të të drejtave të njeriut, nisur nga ankesa të paraqitura nga individë ish të persekutuar politikë, por edhe në një kuadër më të gjerë angazhimi institucional për krijimin e standardeve të mirëqeverisjes ka vlerësuar dhe vlerëson se, shoqëria jonë meriton të dijë së cilët e qeverisin dhe mbrojnë interesat e saj, përmes një procesi transparent të hapjes së dosjeve. Në këtë këndvështrim, gjykojmë se një nga çështjet e vonuara dhe ende të pazgjidhura të shoqërisë sonë, e cila vjen nga një eksperiencë paskomuniste, mbetet miratimi i një ligji gjithëpërfshirës e të mbështetur në parimet ekzistenciale të një shoqërie demokratike, për hapjen e dosjeve.

Nevoja për një ligj të tillë është ndër të tjera e lidhur ngushtë edhe me krijimin e besimit në opinionin publik, për kryerjen e një procesi që do të bëjë transparencën e krimeve dhe pasojave të tyre nga sistemi i mëparshëm dhe që do të sigurojë të qeverisurit sot se, klasa aktuale qeverisëse dhe individë në nivele të tjera postesh publike, apo edhe përfaqësues të shoqërisë civile, nuk do të mbartin paragjykimin dhe frymën antidemokratike të përsëritjes të asaj ç'ka ndodhur në të shkuarën.

Shembujt dhe eksperiencat ligjore në këtë drejtim nuk mungojnë ndaj edhe është e arsyeshme dhe e logjikshme që të vlerësohet se, një ligj i ri për hapjen e dosjeve duhet të sigurojë një proces administrativ, i cili:

- Lehtëson aksesin individual në të dhënat që ish shërbimet sekrete kanë mbledhur ndaj personave të interesuar, qofshin këta individë të ndjekur nga ky shërbim dhe që kanë vuajtur pasojat e kësaj veprimtarie, punonjës me kohë të plotë, apo informatorë të vetë shërbimeve sekrete, apo edhe përfitues prej veprimtarisë në fjalë.
- Realizon bërjen e transparencës për individë të implikuar në veprimtarinë represive shtetërore, deri në nivel të përfaqësuesve të shoqërisë civile.
- Ju siguron entiteteve publike dhe private, aksesin në informacion e sipërcituar, në përputhje me qëllimin e vetë procesit.
- Realizon transparencën publike të aktiviteteve represive të ish shërbimeve sekrete, me përcaktimin se, aksesin është personal dhe me kufizime ligjore në publikim.

- Mbron subjektin përkatës të të dhënave nga cënimi i së drejtës për privatësi, cënim i cili mund të shkaktohet nga keqpërdorimi i të dhënave personale të mbledhura nga ish shërbimet sekrete.
- Krijon organe kompetente dhe rregullon funksionimin e tyre, si organe përgjegjëse për kryerjen e procesit të hapjes së dosjeve.

Ne gjykojmë se, një ligj i tillë, për më tepër pas kaq vitesh tranzicion, nuk duhet të kthehet në një ligj “represiv” ndaj disa individëve të caktuar, por në një mundësi reflektimi për shoqërinë në tërësi. Një ligj i tillë do të mund të rregullojë proceduralisht dhe institucionalisht këtë proces “purifikim”i për shoqërinë shqiptare. Duke vlerësuar realisht si një proces të nevojshëm hapjen e dosjeve, institucioni i Avokatit të Popullit përmes një procesi konsultimi me aktorë të shoqërisë civile ka përgatitur një rekomandim i cili do t’i drejtohet së shpejti Qeverisë për të realizuar iniciativën përkatëse ligjore.

Së treti, në institucionin e Avokatit të Popullit, në mënyrë të vazhdueshme janë paraqitur ankesa dhe kërkesa nga Shoqata të të persekutuarve politikë gjatë regjimit komunist, si dhe nga familjarët e personave të ekzekutuar gjatë këtij regjimi, ku kërkohet ndërhyrja e Avokatit të Popullit pranë institucioneve shtetërore kompetente për kërkimin, gjetjen dhe identifikimin e personave të ekzekutuar, gjatë viteve të regjimit komunist, të cilëve ende nuk iu është gjetur vend-varrimi.

Në funksion të kësaj veprimtarie dhe për lehtësimin dhe koordinimin e saj, Këshilli i Ministrave, me Vendimin nr.133 datë 24.02.2010 “Për Krijimin e Task-Forcës për kërkimin, gjetjen dhe identifikimin e personave të ekzekutuar gjatë viteve të regjimit komunist”, ka vendosur krijimin e task forcës në fjalë, duke përcaktuar objektin e punës, përbërjen dhe detyrat e anëtarëve të saj.

Në këto kushte institucioni i Avokatit të Popullit ka filluar në fund të vitit 2013 shqyrtimin dhe një analizë tërësore të problematikës që lidhet me ankesat e sipërcituara, duke kërkuar një informacion të detajuar në lidhje me aktivitetin dhe arritjet e kësaj Task-Force, nga momenti i krijimit të saj, e deri sot. Në informacionin e kërkuar është kërkuar saktësimi i numrit të përgjithshëm të kërkesave të paraqitura pranë Task Forcës, nga subjektet e interesuara, numrin e kërkesave të zgjidhura dhe atyre të refuzuara, si dhe atyre ende pa përgjigje, apo në proces shqyrtimi. Gjithashtu, është kërkuar informacion lidhur me numrin e mbledhjeve të zhvilluara nga kjo strukturë dhe nivelin e bashkëpunimit dhe koordinimit midis ministrive përgjegjëse, për zbatimin e VKM nr.133 datë 24.02.2010, të Këshillit të Ministrave. Si një problematikë që lidhet me kompleksitetin e çështjeve të individëve ish të persekutuar politikë, gjykojmë se një ndërhyrje e nevojshme duhet të kryhet edhe në kuadër të efektivitetit të kësaj strukture, fakt për të cilin do të dërgohet edhe një rekomandim pas paraqitjes së informacionit të kërkuar për këtë qëllim.

Një tjetër problematikë ende e pazgjidhur, pavarësisht sjelljes së saj në vëmendje të institucioneve shqiptare prej Avokatit të Popullit por edhe prej shoqërisë civile dhe qytetarëve është ajo që lidhet me dokumentet e identifikimit të shtetasve shqiptarë, ose e thënë ndryshe me pasqyrimin e **toponimeve të huaja në dokumentet e identifikimit të shtetasve shqiptarë**, kryesisht në pasaporta.

Kjo problematikë e cila është bërë veçanërisht shqetësuese prej vitit 2012 konsistonte në faktin se shtetas shqiptarë të cilët kanë lindur në Greqi nuk janë lejuar të hyjnë në territorin e Republikës Greke për shkak se autoritetet greke kanë pretenduar se emrat e toponimeve greke në këto dokumente nuk janë shkruar sipas rregullave ndërkombëtare. Për më tepër, rezulton se në pasaportat e shtetasve shqiptarë, ndonëse parashikohen 10 fusha të cilat përmbajnë të dhëna në dy gjuhë (shqip dhe anglisht) vetëm njëra prej tyre (shtetësia) është plotësuar në të dyja gjuhët ndërsa të fushat e tjera janë vetëm në gjuhën shqipe.

Për shkak të kësaj problematike, prej të paktën dy vitesh, në mënyrë sistematike dhe të vazhdueshme, u është mohuar hyrja në territorin grek shtetasve shqiptarë që jetojnë dhe punojnë atje, duke sjellë në këtë mënyrë jo vetëm cënimin e të drejtës së lëvizjes së lirë, si e drejtë themelore e njeriut, por edhe dëmtime të interesave pasurore e cenim të dinjitetit të shtetasve shqiptarë.

Institucioni i Avokatit të Popullit, përmes shkresave të tij zyrtare, duke u bazuar edhe në dispozitat kushtetuese dhe ligjore që parashikojnë dhe rregullojnë respektivisht funksionet dhe veprimtarinë e institucionit të pavarur kushtetues për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të individëve në Shqipëri, i ka kërkuar disa herë shpjegime Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Ministrisë së Brendshme lidhur me masat dhe procedurat që po ndiqeshin aktualisht nga autoritetet shqiptare për shmangien e problematikave duke kërkuar të informohet lidhur me shkaqet ligjore që kishin shkaktuar një situatë të tillë, nëse ishin ndërmarrë tashmë hapa konkrete për standardizimin e emrave gjeografik shqiptarë në dokumentat e udhëtimit të shtetasve tanë duke u bazuar edhe në Udhërrëfyesit e Toponimeve të UNGEGN (United Nations Group of Experts on Geographical Names), nëse ishin ngritur tashmë autoritete kombëtare për standartizimin e përdorimit të emrave tonë gjeografik në dokumentat zyrtarë, cilat ishin procedurat që po ndiqeshin për përdorimin e rregullt dhe të gjithanshëm të të gjitha shkronjave të alfabetit të gjuhës shqipe në dokumentet e udhëtimit të shtetasve shqiptarë, të lëshuara nga firma e kontraktuar nga shteti shqiptar, si dhe gjithçka tjetër që kishte të bënte me këtë çështje, duke synuar në sqarimin sa më të shpejtë dhe përfundimtar të problematikës së parashtruar nga ankuesit.

Pas disa kërkesave tona, Ministria e Punëve të Jashtme konfirmoi se është njohur zyrtarisht që në datën 21.06.2011 me Notën Verbale të Ambasadës të Republikës së Greqisë lidhur me emërtimet e lokaliteteve të saj gjeografike, e cila i bën me dije autoriteteve shqiptare mosnjohjen e dokumenteve publikë të vendeve të treta, të cilat do të përmbanin emra gjeografikë të pasaktë. Ministria e Punëve të Jashtme konfirmoi se po punohet për zgjidhjen e këtij problemi në një kohë të shkurtër por nuk përcaktoi asnjë afat kohor, qoftë edhe të përafërt për zgjidhjen përfundimtare të kësaj problematike.

Duhet theksuar se pavarësisht se nëpërmjet shtypit jemi informuar se autoritetet shqiptare dhe greke kanë rënë dakord për periudha të shkurtra gjatë të cilave është lejuar kalimi i shtetasve pavarësisht problematikës së lartpërmendur në dokumentet e identifikimit, ende kjo problematikë është pa një zgjidhje ligjore dhe pa një qëndrim të qartë dhe transparent lidhur me hapat që do të ndërmerren për zgjidhjen.

Avokati i Popullit në rekomandimet e tij drejtuar autoriteteve shqiptare për adresimin dhe zgjidhjen e kësaj problematike ka vlerësuar se Ministrinë e Punëve të Jashtme prej

kohësh duhet të kishte negociuar me shtetin grek për gjetjen e një zgjidhje të përhershme për problemin e toponimeve greke në dokumentat e udhëtimit të shtetasve shqiptar. Kjo çështje nuk mund të ketë marrëveshje të përkohshme për periudha të caktuara kohore për raste festash apo zgjedhjesh. Shtetasit shqiptar që jetojnë e punojnë në shtetin grek duhet të ndihen të lirë për të lëvizur dhe kaluar kufirin në çdo kohë dhe pa patur pengesa burokratike, për çështje të karakterit politik dhe teknik, të cilat duhet të diskutohen, qartësohen dhe vendosen përfundimisht nga autoritetet shqiptare, në bashkëpunim dhe përputhje edhe me ato greke, duke respektuar standardet ndërkombëtare.

Lidhur me lëshimin e mjeteve të identifikimit dhe dokumenteve të udhëtimit, me të cilat shtetasit shqiptarë po hasin pengesa në pikat e kalimit kufitar me shtetin grek, pikërisht për shkak të shkrimit të gabuar të toponimeve greke, Avokati i Popullit gjykon se autoritetet shqiptare, gjatë negociatave të tyre me autoritetet shtetërore greke, duhet të synojnë fillimisht arritjen e një marrëveshje të përbashkët lidhur me vlefshmërinë e mjeteve aktuale të identifikimit, deri në momentin e zgjidhjes përfundimtare të çështjes së shkrimit të toponimeve greke në dokumentet shqiptare.

Dokumentet e identifikimit të cilat rezultojnë problematike kanë një kosto financiare për shtetasit shqiptarë, dhe këtë kosto, në rast të zëvendësimit të këtyre dokumenteve, në asnjë rrethanë nuk do të duhet ta paguajnë sërish qytetarët, të cilët janë pajisur me këto mjete identifikimi dhe dokumente udhëtimi prej autoriteteve shqiptare, mbi bazën e të dhënave të gjendjes civile që administrohet nga Ministria e Brendshme, por duhet përballuar nga shteti shqiptar.

Në këtë kuadër, Ministria e Brendshme është autoriteti shtetëror i cili duhet të marrë përsipër përgjegjësitë e veta dhe të ushtrojë funksionet dhe kompetencat që i janë ngarkuar me ligj, me qëllim respektimin e kritereve ligjore dhe standardeve ndërkombëtare për pajisjen e shtetasve shqiptarë me dokumente udhëtimi

Duke vlerësuar garantimin e **shërbimit shëndetësor** për qytetarët, si një prej elementëve më të rëndësishëm të një shteti social, si dhe pjesë të rëndësishme të së drejtës që ka çdo individ për të jetuar i shëndetshëm, Avokatit të Popullit ka vazhduar veprimtarinë e tij gjatë vitit 2013 në këtë fushë të të drejtave të njeriut. Duke pasur në fokus trajtimin me dinjitet të pacientit, mbrojtjen dhe garantimin e jetës, bazuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe legjislacionin në fuqi, Avokati i Popullit ka ndërmarrë në vijimësi inspektimeve në Qendrat Spitalore të Shëndetit Mendor, Spitalet Rajonale në të gjithë vendin, si dhe ka trajtuar ankesa individuale ardhur pranë institucionit dhe raste me iniciativë në këtë fushë.

Problematika të çështjeve dhe ankesave që kanë të bëjnë me Ministrinë e Shëndetësisë dhe institucionet në varësi të saj, kanë qenë kërkesa ndaj kësaj Ministrie për tu kuruar jashtë shtetit, mungesa e medikamenteve në spitale, neglizhenca në dhënien e shërbimit shëndetësor, marrëdhëniet e punës, etj.

Lidhur me inspektimet e kryera gjatë vitit 2013, mund të përmendim inspektimet në Spitalin Onkologjik, Tiranë; Spitalin Rajonal Tropojë dhe Kukës; Spitalin Rajonal Korçë; Spitalin Rajonal Përmet; Spitalin Rajonal Peshkopi dhe Bulqizë; Spitalin Rajonal Shkodër. Rëndësia e këtij procesi qëndron jo vetëm në evidentimin e gjendjes së respektimit

dhe zbatimit të ligjit, i cili reflekton respektimin e të drejtave dhe lirive të individit në këto institucione, por dhe për vlerësimin e funksionimit të strukturës institucionale, të përshtatur me profesionalizëm, sipas standardeve të kërkuara konform ligjit, si dhe vlerësimin të kushteve infrastrukturore ekzistuese në ambientet e këtyre institucioneve.

Nga ankesat e shqyrtuara por edhe nga inspektimet e shumta që ne kemi kryer në institucione ku ofrohet shërbimi shëndetësor arrijmë të evidentojmë këto problematika kryesore:

-menaxhimi dhe alokimi i keq i fondeve, keqpërdorim dhe abuzim me to; -mungesa persistente e medikamenteve dhe materialeve të tjera mjekuese në spitale; -pamundësi për kryerjen e analizave për të sëmurët në institucionet publike për mungesa të kiteve dhe reagentëve; -teknologji moderne diagnostikuese e terapeutike e pamjaftueshme në raport me kërkesat dhe nevojat korentë, por edhe mundësitë ekzistuese në vend (Kjo, jo vetëm në spitalet rajonale e periferike, por edhe në ato nacionale qendrore. Edhe atje ku disponohen këto aparatura, për shumë kohë mbeten jashtë funksionimit, sepse mungojnë kontratat e riparimit me kompanitë përkatëse ose janë shkelur ato); -menaxhimi jo i mirë i burimeve njerëzore; -mungesa e mjekëve specialistë që largohen apo dalin në pension në një pjesë të konsiderueshme spitalesh në mbarë vendin; -nuk ka një studim perspektiv të nevojave për mjekë specialistë dhe ngritje shërbimesh të specializuara për të rregulluar dhe planifikuar prodhimin e specialistëve në përputhje me këto nevoja; si dhe -mungesë e llogaridhënies sipas hallkave të hierarkisë.

Lidhur me problematikat e shërbimit shëndetësor, Avokati i Popullit ka hartuar një Raport të Veçantë për situatën e Spitaleve në Shqipëri, të cilin e ka dorëzuar në Kuvendin e Shqipërisë për shqyrtim.

Një tjetër problematikë e rëndësishme e trajtuar nga Avokati i Popullit është ajo që lidhet me **shqyrtimin e ankesave lidhur me ankimet për largimet nga puna në administratën shtetërore** të depozituara nga persona që gëzojnë ose jo statusin e nëpunësit civil, hartimit të rekomandimeve, jo vetëm individuale por edhe atyre me karakter promovues për të ndryshuar/përmirësuar legjislacionin që rregullon marrëdhëniet e punës, në përputhje me standardet ndërkombëtare si dhe ka luajtur një rol të rëndësishëm për garantimin e stabilitetit dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme të Administratës Publike.

Forcimi dhe thellimi i demokracisë në shoqërinë shqiptare, rritja e nivelit të qeverisjes dhe garantimi i plotë e i gjithanshëm i lirive, të drejtave dhe interesave të ligjshme të individëve, kërkon si domosdoshmëri forcimin e shërbimit civil, mbi bazën e parimeve të profesionalizmit, qëndrueshmërisë, pavarësisë dhe integritetit, të paanësisë politike, të transparencës dhe të një shërbimi sa më cilësor ndaj publikut.

Duke u bazuar në parimet themelore të të drejtës për punë (...ndalimi i diskriminimit, mbrojtja sociale, respektimi i disiplinës në punë, mbrojtja e gjithanshme e punës, shpërblimi në punë, respektimi i legjislacionit të punës etj...), të sanksionuara në aktet ligjore të mësipërme, Institucioni i Avokatit të Popullit ka vijuar të ketë prioritet të punës së tij, mbrojtjen e kësaj të drejte, duke trajtuar për vitin 2013, rreth 300 ankesa individuale, ku pretendohej shkelja e marrëdhënieve të punës nga organet e Administratës Publike,

qendrore dhe vendore. Nga këto, 12 raste të largimit nga puna janë nga punonjës të policisë, prej të cilat 11 janë ankesa të bërë nga të larguarit nga policia dhe 1 rast është filluar me iniciativë pas bërjes publike nga media të largimeve nga puna të punonjësve të policisë. Nga 12 rastet e shqyrtuara, 9 prej tyre janë përfunduar dhe 3 janë në shqyrtim. Pas shqyrtimit të rasteve të përfunduara ka rezultuar se, 4 ankesa kanë qenë të padrejta, 4 kanë qenë jashtë juridiksionit sepse çështjet e tyre janë në shqyrtim nga organet gjyqësore dhe 1 ankesë është vlerësuar e bazuar.

Lidhur me administratën publike dhe rregullimin e marrëdhënieve të punës, institucioni i Avokatit të Popullit, po përgatit një raport të veçantë të cilin do ta paraqesë në Kuvendin e Shqipërisë në fillim të vitit 2014.

Sistemi i Sigurimeve shoqërore përbën skemën kryesore të mbrojtjes shoqërore në Shqipëri. Skema e pensioneve luan një rol të rëndësishëm në mbrojtjen shoqërore dhe në luftën ndaj varfërisë.

Gjatë vitit 2013, Avokati i Popullit ka vazhduar trajtimin e ankesave lidhur me sistemin e sigurimeve shoqërore. Pretendimet e shtetasve kanë qenë lidhur me shkelje të të drejtave për shkak të mosllogaritjes së drejtë apo të mosrishikimit të masës së pensioneve të pleqërisë, për mosnjohjen e vjetërsisë së punës, për uljen e masës së pensioneve të parakohshme për vjetërsi shërbimi, për masën e ulët të pensioneve, për kohën e lindjes së të drejtës për të përfituar pensionin e pleqërisë, për mosmarrje të përgjigjes të shqyrtimit të kërkesave ankimore ndaj vendimeve të Degëve të Përfitimeve pranë Drejtorive Rajonale të Sigurimeve Shoqërore, zvarritje në lidhjen e pensionit të pleqërisë, për ndërprerje të padrejtë të pensioneve të pleqërisë, etj.

Të gjitha problematikat e konstatuara nga shqyrtimi i ankesave lidhur me të drejtën për të përfituar nga sistemi i sigurimeve shoqërore, derivojnë nga dispozitat e Ligjit nr.7703 datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Duke i konsideruar të drejta shqetësimet e shtetasve të ndryshëm, Institucioni i Avokatit të Popullit, ka ndërmjetësuar pranë institucioneve shtetërore me anë të rekomandimeve përkatëse për përmirësime apo ndryshime të këtij ligji dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij.

Reforma e pensioneve, e cila prek interesa të gjëra të publikut, përbën një nga elementet më të rëndësishëm në tërësinë e reformave në kuadrin e përafrimit të legjislacionit të Shqipërisë me BE-në. Reforma duhet përgatitur e çuar përpara përmes një vendimmarrjeje e implementimi konsensual politik e social. Në këtë drejtim Avokati i Popullit vlerëson si të nevojshme hapat e mëposhtme:

- Është i domosdoshëm ndryshimi i formulës së llogaritjes së pensionit sipas nenit 32, me qëllim që për pensionet që do të caktohen në vijimësi, të ketë një lidhje më të drejtpërdrejtë të përfitimeve me kontributet e paguara. Për të përmirësuar situatën e përfituesve, por edhe të të tjerëve, të cilët do të përfitojnë në vazhdimësi pension pleqërie, i jemi drejtuar Ministrisë të Financave me rekomandim për marrjen e iniciativës ligjore për ndryshimin dhe përmirësimin e Ligjit Nr.7703 datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, konkretisht të nenit 32 të tij, me qëllim që përfituesit e pensionit të pleqërisë të gëzojnë masën e pensionit të pleqërisë më të favorshëm për ta.

- Invalidët e punës dhe personat që përfitojnë pagesën e aftësisë së kufizuar nuk përfitojnë paketën higjieno-sanitare, paketë të cilën e përfitojnë vetëm kategoria e invalidëve paraplegjikë dhe tetraplegjike. Institucioni i Avokatit të Popullit ka konstatuar se nuk ka asnjë parashikim ligjor që të rregullojë situatën e tyre. Në mbështetje të grupeve në nevojë dhe për përmirësimin e cilësisë së jetës së tyre, i kemi dërguar rekomandim Ministrit të Financave, ish-MPÇSSHB dhe Ministrit të Shëndetësisë për përmirësim të nenit 7 të Ligjit Nr.7889 datë 14.12.1994 “Për Statusin e Invalidit”, të ndryshuar, si dhe të nenit 11 të Ligjit Nr.9355 datë 10.03.2005 “Për Ndihmën dhe Shërbimet Shoqërore”, të ndryshuar, me qëllim që një kategori e caktuar e invalidëve, sipas diagnozës së përcaktuar nga Komisionet Mjekësore të Caktimit të Aftësisë për Punë, të përfitojnë paketën higjieno-sanitare, si shtesë në masën e pensionit të invaliditetit dhe të pagesës së aftësisë së kufizuar.

- Pensionistët, të cilët gëzojnë statusin e veteranit të Luftës Antifashiste Nacional-Çlirimtare nuk kanë përfituar shtesë në masën e shpërblimit të Veteranit të Luftës për periudhën 2008-2012, megjithëse masa e shpërblimit që ata përfitojnë duhet të ndryshojë sa herë që rriten pensionet e pleqërisë, sepse Ligji nr.7874 datë 17.11.1994 “Për Statusin e Veteranit të Luftës Antifashiste Nacional-Çlirimtare të popullit shqiptar”, i ndryshuar, në nenin 8 të tij ka përcaktuar se masa e shpërblimit ndryshon në varësi nga indeksi i çmimeve dhe inflacioni.

Nga analiza e dispozitave ligjore e nënligjore që rregullojnë këtë çështje, kemi konstatuar se me propozim të Ministrit të Mbrojtjes, janë nxjerrë Vendime të Këshillit të Ministrave “Për rritjen e shpërblimit të Veteranëve të Luftës Antifashiste Nacional-Çlirimtare të popullit shqiptar” deri në vitin 2007. Pas këtij viti, kategorisë së pensionistëve që gëzojnë statusin e veteranit të luftës, iu është mohuar e drejta e përfitimit të shtesës së shpërblimit si rezultat i mosxjerrjes së asnjë akti nënligjor në zbatim të ligjit të sipërcituar, me të cilin të rregullohet situata e kësaj kategorie për shkak të mbylljes së veprimtarisë së Komisionit Qendror të Statusit të Luftës Antifashiste Nacional-çlirimtare pranë Ministrisë së Mbrojtjes.

Lidhur me këtë, pas një korrespondence me Ministrinë e Financës dhe Ministrinë e Mbrojtjes, i jemi drejtuar me rekomandim Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë: Për caktimin e organit kompetent, i cili të propozojë në vijimësi projekt-vendimet për rritjen e masës së shpërblimit të veteranëve të luftës; Për paraqitjen dhe miratimin sa më të shpejtë të akteve nënligjore në zbatim të nenit 8 të Ligjit Nr.7874 datë 17.11.1994 “Për statusin e Veteranit të Luftës Antifashiste Nacional-Çlirimtare të popullit shqiptar”, të ndryshuar, për rritjen e shpërblimit të veteranëve të luftës për vitin 2013.

- Mbrojtja e të drejtave të emigrantëve në fushën e sigurimeve shoqërore, mbetet një detyrim ligjor, edhe në kuadër të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit me BE-në, Shqipëria duhet të intensivikojë përpjekjet për nënshkrimin e marrëveshjeve dypalëshe në fushën e sigurimeve shoqërore.

-Të moshuarit mbeten një nga grupet më vulnerabël në Shqipëri. Mungesa e sigurimit të një minimumi të ardhurash, mund t'i çojë të moshuarit dhe familjet e tyre në varfëri. Pikërisht për të garantuar të drejtat e të moshuarve, kërkohet miratimi i Statusit të Moshës së Tretë.

- Një nga problematikat që ende ka mbetur ende pa zgjidhje është ajo e pensioneve të ulëta të ish-minatorëve të nëntokës, ku nga ana e tyre kërkohet miratimi i Statusit të Minatorit. Për këtë çështje aktualisht po ndërmjetësojmë me Ministrinë e Industrisë dhe Energjisë.

Avokati i Popullit thekson faktin se pavarësisht se ndryshimet ligjore të propozuara prej tij kanë një faturë financiare, gjë që mund të kërkojë një kohëzgjatje të caktuar, reformimi i sistemit të sigurimeve shoqërore është një domosdoshmëri.

Pranë institucionit të Avokatit të Popullit, gjatë vitit 2013 janë depozituar e trajtuar një sërë ankesash, ku shtetas të ndryshëm kanë pretenduar mosdhënien e së drejtës për të përfituar **ndihmë ekonomike**, ndërprerjen e ndihmës ekonomike, mosdhënien në kohë të pagesës së ndihmës ekonomike, apo edhe kërkesa për t'u sqaruar lidhur me përfitimet nga legjislacioni i ndihmës ekonomike.

Siç e kemi theksuar edhe në Raportin Vjetor 2012, një nga problemet që lidhet me ndihmën ekonomike për shtetas në nevojë është edhe mosdeklarimi i minimumit jetik në Shqipëri. Kjo çështje kërkon zgjidhje, pasi minimumi jetik, nuk është vetëm një tregues që lidhet me nevojat që ka njeriu për të siguruar mbijetesën në kushtet aktuale, por bazuar në të, përcaktohen edhe nivelet e përfitimeve në skemat e mbrojtjes shoqërore.

Institucioni i Avokatit të Popullit në ushtrim të funksionit të tij kushtetues për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, prioritet të punës së tij ka pasur edhe **të drejtën për strehim** duke u fokusuar kryesisht tek grupet në nevojë sikundër janë endacakët apo të pastrehët; pjesëtarët e komunitetit Rom, etj.

Për vitin 2013 një numër i konsiderueshëm ankesash sikundër edhe në vitin 2012, janë paraqitur lidhur me pasojat që i kanë ardhur familjeve qiramarrëse në banesat e ish pronarëve e subjekteve të shpronësuar, nga zbatimi i Aktit Normativ të Këshillit të Ministrave Nr.3 datë 01.08.2012, "Për lirimimin e banesave pronarëve të ligjshëm nga qytetarët e pastrehë, banues në banesat ish pronë e subjekteve të shpronësuar".

Nga një shqyrtim paraprak që institucioni i Avokatit të Popullit ka bërë për qartësimin e mundësive për realizimin e këtyre mënyrave për strehimin e qiramarrësve në banesat e ish pronarëve, rezulton se ekzistojnë problematika serioze të cilat kërkojnë veprim të shpejtë dhe të koordinuar mirë me të gjitha institucionet përgjegjëse shtetërore, pasi situatë e krijuar përveçse përbën rrezik potencial të krijimit të konflikteve të reja sociale, por gjithashtu ka shtuar ndjeshëm numrin e të pastrehëve në vend.

Së paku në rastet e paraqitura, evidentohet fakti se megjithëse akti normative parashikon trajtimin e qytetarëve të pastrehë, banues në banesat ish pronë e subjekteve të shpronësuar, me kredi 0% interes, apo me banesa sociale, që do t'u jepen nga qeverisja vendore, efektivisht kjo gjë në kushtet aktuale rezulton të jetë e vështirë. Ky konkluzion bazohet edhe në faktin se kërkesave tona për informacion drejtuar Bashkisë Tiranë, mbi mundësinë reale për të trajtuar kërkesat e shumta të qiramarrësve në banesat e ish pronarëve me banesa sociale nuk i është dhënë një përgjigje zyrtare. Po kështu, evidentohet si e porealizueshme mënyra e sistemimit të të moshuarve, të paaftë të kujdesen dhe pa persona të tjerë në ngarkim, në qendrat e përkujdesjes për moshat e treta, sipas shifrave

që zyrtarisht jepen për këtë qëllim nga ministria e linjës. Gjithashtu, vihet re se në pjesën më të madhe të Bashkive në vend ka mungesa të theksuara të fondeve të alokuara për ndërtimin e banesave sociale.

Situata emergjente që synoi të zgjidhte Akti Normativ Nr.3, datë 01.08.2012, rezulton të jetë kthyer në situatë emergjente për një numër të madh individësh, apo familjesh qiramarrëse, banues në banesat ish pronë e subjekteve të shpronësuara.

Avokati i Popullit ka qenë dhe mbetet i angazhuar tërësisht për të kontribuar në gjetjen e një zgjidhje sa më të shpejtë dhe sa më optimale për këto familje dhe individë, të cilët praktikisht janë në një situatë “pa zgjidhje”, pavarësisht çfarë parashikon në dispozitat e tij ky akt normative, angazhim, i cili është përcjellë së fundi edhe në një rekomandim të përsëritur edhe Kryeministrit aktual të Republikës së Shqipërisë.

Në vijim, mbi gjithë problematikat e strehimit, veçanërisht në mbrojtje të shtresave në nevojë, jemi duke hartuar një raport të posaçëm, i cili së shpejti do të përcillet pranë Kuvendit të Shqipërisë.

Edhe gjatë vitit 2013, një numër i konsiderueshëm ankesash i janë drejtuar institucioni të Avokatit të Popullit në lidhje me **organet e pushtetit gjyqësor**. Kryesisht problematikat e rasteve të trajtuara kanë qenë për: - zvarritje të gjata pa shkaqe ligjore dhe shkelje të procedurave gjyqësore të gjykimit nga gjykatat si, për çështje penale ashtu edhe për çështje civile, nga të gjitha shkallët e gjykimit; - shkelje ligjore të ndryshme si, mbajtjen në burg padrejtësisht, kur janë shuar masat e sigurimit, parashikuar nga neni 261/c të Kodit Procedurës Penale, dhe kohëzgjatja e paraburgimit të vuajtur ka qenë më e madhe se masa e dënimit të caktuar nga gjykata; - gjykime të padrejta dhe vendime gjyqësore të marra në mungesë të pandehurit nga gjykata, duke pretenduar se ata nuk kanë pasur njoftim për këto gjykime, dhe se ndaj tyre nuk janë respektuar procedurat ligjore të njoftimit në bazë të ligjit; - pretendime për shkelje të ligjit dhe veprime korruptive të gjyqtarëve; si dhe – ankesa ndaj administratës gjyqësore, për paraqitje me vonesa në dërgimin e dosjeve për gjykim, në mosdhënien e kopjeve të vendimeve gjyqësore, etj. Ankesat e ardhura sipas rastit janë hetuar dhe janë bërë ndërhyrjet e nevojshme, duke synuar në nxjerrjen e shkaqeve të këtyre shkeljeve dhe duke bërë edhe rekomandimet e duhura për ndreqjen, ose mos përsëritjen e këtyre shkeljeve në të ardhmen.

Institucioni i Avokatit të Popullit gjatë veprimtarisë së punës në trajtimin e ankesave të qytetarëve ndaj **organit të Prokurorisë**, ka treguar kujdes në ruajtjen e pavarësisë duke respektuar me rigorozitet dispozitat kushtetuese dhe ligjore. Problematikat e ankesave të qytetarëve ndaj veprimtarisë së organit të Prokurorisë gjatë vitit 2013 konsistojnë në:

- *Moszbatimin e procesit të rregullt ligjor*, për shkak të veprimeve të padrejta të kryera nga Prokuroria, që kanë çenuar të drejtat e shtetasve në procesin penal duke mos respektuar procedurat ligjore. Ankesat e shtetasve në këtë drejtim kanë konsistuar në: zvarritje të pajustificuara në hetimin e procedimeve penale, sidomos për rastet kur çështja është kthyer nga gjykata; në rastet e zëvendësimit të prokurorëve, ose oficerëve të policisë gjyqësore më e theksuar kjo, për hetimet e procedimeve penale të kryera nga policia gjyqësore e Policisë së Shtetit; në mosrespektimin e nenit 287 të Kodit të Procedurës Penale që bën fjalë për regjistrimin e njoftimit të veprave penale dhe Udhëzimit nr.241 datë 22.11.2005,

të Prokurorit të Përgjithshëm, kur edhe pse njihet personi që i atribuohet vepra penale, nuk regjistrohet emri i tij; në arrestimin dhe ngritjen e akuzës të padrejtë; në marrjen e vendimit të padrejtë për mosfillim të procedimeve penale, apo pushime të çështjeve penale për arsye të mosverifikimit të kallëzimit brenda afatit 30 ditor të parashikuar në pikën 2.3 të Udhëzimit nr.3 datë 19.06.2012, të Prokurorit të Përgjithshëm; apo moskryerjes së hetimeve të gjithanshme, sidomos për veprat penale të “Falsifikimit të dokumenteve” për pronësinë, “Shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor”; për mosnjohje të palëve në procesin penal me vendimet për zgjatjet e afatit të hetimit të procedimit penal etj.

- *Mosrespektimin e detyrimit të informimit*, ku në këto raste, organi i Prokurorisë nuk i ka njoftuar shtetasit për mënyrën e zgjidhjes së çështjeve, të cilat fillojnë mbi bazën e kallëzimit penal të bërë prej tyre; nuk ju ka kthyer përgjigje, ose e ka kthyer atë me vonesë për “kërkesa apo memorie me shkrim” të paraqitura nga palët gjatë hetimit (jashtë afatit prej 15 ditë, që parashikon pika 2 e nenit 110 të Kodit të Procedurës Penale); nuk ju ka dhënë kopje të akteve të kërkuara, sidomos për ekspertimet e ndryshme si, autoteknike, mjeko-ligjore, tekniko-grafike të nënshkrimit etj, duke shkelur kërkesat e parashikuara në nenin 105 të Kodit të Procedurës Penale.

- *Moskryerjen e veprimeve të nevojshme prej prokurorëve që merren me ekzekutimin e vendimeve penale, me pasojë qëndrimin e të dënuarit në paraburgim ose burgim, më tepër se koha e vuajtjes së dënimit të përcaktuar në vendimin e gjykatës.*

- *Mosrespektimin e dispozitave procedurale që bëjnë fjalë për “Disponimin e provës materiale”,* parashikuar nga neni 190 i Kodit të Procedurës Penale. Në këto raste shtetasit i janë drejtuar organit të Prokurorisë, lidhur me trajtimin e sendeve prova materiale të sekuestruara gjatë hetimit, të cilat në disa raste u janë kthyer me vonesë personave të interesuar, ose i është lënë gjykatës për të marrë vendim për disponimin e tyre.

- *Në mosrespektimin e detyrimit të organit procedues për njoftimin e palës së dëmtuar nga vepra penale, me të drejtën e saj, për të ngritur padi në procesin penal dhe për të kërkuar shpërblimin e dëmit, sipas nenit 61 të Kodit të Procedurës Penale.* Ky mosveprim ka detyruar palën e dëmtuar, ose familjarët e viktimave apo të dëmtuarve nga vepra penale, për të paraqitur kërkesë padi më vete, para gjykatës me objekt “Shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga vepra penale”. Avokati i Popullit ka bërë studimin dhe ka përgatitur rekomandimin legjislativ me propozime për shtesa dhe përmirësime në nenet 48 dhe 58 të Kodit të Procedurës Penale, me qëllim vendosjen e avokatit mbrojtës në hetimin dhe gjykimin e procedimit penal, për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të ligjshme të viktimës.

Ka edhe raste kur qytetarët i janë drejtuar Institucionit të Avokatit të Popullit me ankesë apo kërkesë, duke pretenduar se pas kallëzimit penal të tyre, organi i Prokurorisë ka vendosur në mënyrë të padrejtë pushimin e hetimit apo mosfillimin e procedimit penal. Këto shqetësime janë shqyrtuar me kujdes dhe qytetarët janë sqaruar për rrugët ligjore që duhen të ndjekin, për t'i kundërshtuar apo ankimuar vendimet e marra nga Prokuroria, bazuar në nenet 291 pika 1 dhe 329 pika 1 e Kodit të Procedurës Penale.

Veprimtaria e Shërbimit të Përmbartimit Gjyqësor Shtetëror apo Privat në përmbushje të misionit për ekzekutimin e detyrueshëm të titujve ekzekutiv, gjatë vitit 2013, në optikën e Institucionit të Avokatit të Popullit lë për dëshiruar, kjo përsa i përket mosrespektimit

në mënyrë rigoroze dhe në afat të procedurave ligjore sikurse parashikohet në aktet normative. Edhe pse në raporte vjetore, të veçanta apo informacione, është vënë në dukje situata në të cilën ndodhet procesi i ekzekutimit të një numri të konsiderueshëm të titujve ekzekutiv si dhe është kërkuar reflektim nga ana e autoriteteve të ngarkuara me ligj për ekzekutimin e titujve ekzekutiv, konstatojmë se, qëndrimet e parregullta në përmbushjen e detyrimeve ligjore përsëriten vit pas viti. Kjo situatë haset veçanërisht në procesin e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë të dhëna në ngarkim të organeve të Administratës Publike. Situata e prezantuar në procesin e ekzekutimit të titujve ekzekutivë, duhet të marrë vëmendjen maksimale për normalizimin e saj, me qëllim ndërprerjen e gjendjes së paligjshmërisë për një numër rastesh si dhe rivendosjen në vend të së drejtës për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor në kryerjen e veprimeve për ekzekutimin e detyrimeve të vendosura sipas vendimeve gjyqësore të formës së prerë.

E drejta e pronës private, si kategori bazike ekonomike-juridike e ndërvarur nga struktura përkatëse politike shoqërore e shtetit, mënyrat e fitimit, shpronësimet dhe kufizimet e saj vetëm për interesa publikë dhe kundrejt një shpërblimi të drejtë, si dhe e drejta për t'u mbrojtur nga cënimet e saj nëpërmjet një gjykimi administrativ ose gjyqësor publik janë të garantuara nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.

Nga gjithë kompleksiteti i kësaj të drejte, ajo e kthimit apo kompensimit të pronave tek të shpronësuarit nga sistemi i kaluar, mbetet një nga çështjet më problematike e të mprehta. Kjo për shkak të kompleksitetit të problemeve të mbartura nga veprimtaria e shumë institucioneve që veprojnë në fushën e të drejtave të pronës dhe të paaftësisë së strukturave shtetërore përkatëse për të garantuar dhe siguruar një zgjidhje të përshtatshme dhe afatgjatë të tyre, të cilat po vijnë duke u akumuluar nga viti në vit.

Institucioni i Avokatit të Popullit në ushtrimin e detyrimeve të tij kushtetuese, brenda tagrave të tij ligjore, i ka kushtuar trajtimin të problemit të pronave kujdesin dhe hapësirën e duhur, për më tepër, që kohët e fundit çështja e implementimit të të drejtës së pronës është klasifikuar nga Komisioni Europian, si një ndër prioritetet për t'í hapur rrugën marrjes së statusit të vendit kandidat.

Ndërmjetësimet, ndërhyrjet apo rekomandimet tona kanë pasur si qëllim zgjidhjen dhe parandalimin e konflikteve individ-organ administrativ, ndikimin në forcimin e konceptit të mirëqeverisjes, ndryshimet dhe përmirësimet në legjislacion dhe forcimin e besimit të qytetarëve tek ky institucion.

Ankesat dhe kërkesat më të shumta dhe për vitin 2013, ndonëse më të ulta se viti i kaluar, janë ndaj Zyrave Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme. Objekti i ankesave të depozituara pranë institucionit tonë dhe pretendimet ndaj këtyre zyrave, konsistojnë për mosdhënie informacioni; për mosregjistrimin fillestar të tokave bujqësore, trojeve dhe apartamenteve në ndërtesat shumëkatëshe ndërtuar në kapërcim të të dhënave në lejet e ndërtimit; vonesa në regjistrimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë për mospajisjen e subjekteve me Çertifikatën e Pronësisë; për mbivendosjet e pronave dhe për vonesa të azhurnimeve dhe futjes në sistem të Zonave Kadastrale në shumë rrethe të vendit.

Avokati i Popullit i është drejtuar shpesh me rekomandime të posaçme strukturave të përfshira në këto çështje. Përveç rekomandimeve për raste specifike, Avokati i Popullit ka rekomanduar ndër të tjera: - shpejtimin dhe thjeshtimin e procedurave për legalizimin e ndërtimeve informale, si dhe urbanizimin dhe integrimin e tyre; - përpunimin e të dhënave dhe përfundimin e regjistrimit fillestar në Zyrat Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për vendimet e dhëna në vite nga Agjencitë e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave dhe te Akteve të Marrjes së Tokës në Pronësi; si dhe - identifikimin e pronave të paluajtshme të lira, bërjen publike të fondit të kompensimit në natyrë të subjekteve të shpronësuar dhe kalimi i tyre në administrimin e Agjencisë të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave.

Ndërkohë duhet vlerësuar fakti, se nga viti në vit, pavarësisht morrisë së problemeve të krijuara në zyrat vendore, ka disa arritje që duhen evidentuar, si ajo e regjistrimit fillestar të pasurive të paluajtshme në rreth 90 % të tyre, dixhitalizimi i të dhënave përfshirë në shtesat dhe ndryshimet e bëra në Ligjin nr. 7829, datë 01.06.1994 "Për Noterinë" dhe Rregulloren "Për përcaktimin e mënyrave, procedurave dhe kushteve për përdorimin e sistemit elektronik "One Stop", sistemi i noterisë"; apo lehtësimi i procedurave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme për të cilat zotërohen dokumenta të ligjshme, por që nuk kanë të përcaktuara sipërfaqen.

Mbrojtja e konsumatorit paraqitet një nga fushat kryesore që lidhet drejtpërdrejtë me mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Rregullimi i kësaj fushe mbështetet në tre shtylla kryesore sikundër janë shëndeti i konsumatorit, sigurimi i konsumatorit dhe mbrojtja e të drejtave dhe interesave ekonomike të konsumatorit. Ligji Nr. 9902 datë 17.04.2008, "Për mbrojtjen e konsumatorit", i ndryshuar, përbën legjislacionin bazë për këtë të drejtë, ku edhe Avokatit të Popullit i njihet një rol i veçantë në nenin 56 të tij për mbrojtjen e interesave të konsumatorit jo vetëm për ankesa individuale, por edhe raste të një komuniteti më të gjerë në të gjithë vendin.

Gjatë vitit 2013, institucioni i Avokatit të Popullit në funksion të ushtrimit të kompetencave kushtetuese dhe ligjore, për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të ligjshme të konsumatorit, ka konstatuar si problematike sigurinë ushqimore dhe mallrat e skaduara të cilat qarkullojnë në treg dhe nuk asgjesohen nga subjektet tregtare. Për këtë rast kemi kërkuar nga autoritete përkatëse monitorime dhe kontrole të vazhdueshme ndaj subjekteve tregtare, asgjesimin e produkteve në rastet kur konstatohen se janë të skaduara dhe vendosjen e masave ndëshkuese ndaj subjekteve tregtare.

Furnizimi me ujë të pijshëm brenda gjithë parametrave higjeno-sanitarë ka qenë një fokus tjetër i veprimtarisë për mbrojtjen e interesave të ligjshme të konsumatorit, duke e konsideruar ofrimin e këtij shërbimi publik si një nevojë thelbësore për individët dhe një të drejtë elementare për ta poseduar lirisht dhe në përputhje me standardet. Për këtë qëllim në rekomandimet e hartuara kemi sjellë në vëmendje të Ndërmarrjeve të Ujësjellës-Kanalizime sh.a në vend, jo vetëm ushtrimin e detyrave funksionale në drejtim të ofrimit të një shërbimi publik sa më cilësor, por edhe respektimin e direktivave të BE-së për mbrojtjen e konsumatorëve dhe veçanërisht ato që lidhen me masat në fushat specifike që ndikojnë drejtpërdrejt dhe kanë rëndësi thelbësore për shëndetin e konsumatorit sikundër është cilësia e ujit të pijshëm.

Problematikë tjetër e hasur gjatë vitit 2013 ka të bëjë me mungesën e furnizimit me energji elektrike dhe ujë të pijshëm, kjo e konstatuar në një pjesë të madhe të rasteve për shkak të moskryerjes së investimeve të reja dhe amortizimit të rrjeteve ekzistuese, (rrjeteve të ujësjellës-kanalizimeve) për shkak të mungesës së fondeve nga organet kompetente. Në rekomandimet tona për këtë problematike kemi synuar (kryesisht ndaj Drejtorisë së Përgjithshme të Ujësjellës-Kanalizimeve dhe ministrisë së linjës), nxitjen për hartimin e projekteve të reja dhe kryerjen e investimeve përkatëse në rastet kur ka amortizim të rrjeteve ekzistuese.

Mbifaturim apo keqfaturimi ka qenë një problematikë e cila është përsëritur në vite si ndaj Kompanisë CEZ Shpërndarje ashtu edhe ndaj Ndërmarrjes së Ujësjellës-Kanalizime. Pasi është konstatuar se faturimi i kryer ndaj shtetasve ka ardhur në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi, referuar kontratave Tip të furnizimit me energji elektrike dhe ujë të pijshëm, kemi rekomanduar marrjen e masave të menjëhershme nga Kompania CEZ Shpërndarje sh.a. dhe Ndërmarrjet e Ujësjellës-Kanalizime sh.a, anulimin e faturimeve, kryerjen e rakordimeve përkatëse dhe korrigjimin e saj mbi bazë të konsumit real të sasisë së energjisë elektrike dhe ujit të pijshëm.

Në përmbushje të detyrimeve kushtetuese për mbrojtjen e lirive dhe interesave të ligjshme të individëve, Institucioni i Avokatit të Popullit monitoron edhe **veprimtarinë e njësive të qeverisjes vendore**, me qëllim që të garantohet mirëqeverisja dhe rritja e cilësisë së shërbimeve ndaj qytetarëve. Në ankesat e trajtuara gjatë vitit 2013 në institucion, janë evidentuar një sërë problematikash të lidhura më pushtetin vendor. Si dhe gjatë vitit të mëparshëm, në administratën e disa organeve të qeverisjes vendore ka probleme me formulimin e akteve administrative, mungesën e referencave ligjore, mënyrën e procedimit administrativ, mosrespektimin e afateve ligjore, shkeljen e parimeve të tilla si bashkëpunimi i administratës me personat private, përfundimin e procedimit me marrjen e një vendimi, të drejtën për të informuar individët, konflikt të interesave në vendimmarrje, lidhjet gjinore apo farefisnore mes pushtetarëve lokal dhe banorëve, duke sjellë edhe subjektivizëm në vendimmarrje, si edhe në ekzekutim të akteve administrative apo planeve konkrete të njësive të qeverisjes vendore. Të gjitha këto probleme sjellin një nivel të ulët shërbimi të administratës ndaj qytetarit, zvarritje në zgjidhjen e problemeve të banorëve, si dhe mohim të standardeve të një administrate në shërbim të individit.

Ashtu si edhe në vitet e kaluara, mungesa e bashkëpunimit të shumë njësive të qeverisjes vendore me komisionet vendore të vlerësimit të titujve të pronësisë pranë prefektëve të qarqeve, sipas ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 "Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore", mbetet ende një nga shkaqet për zvarritje të procedimeve administrative dhe më pas gjyqësore.

Gjithashtu, një shqetësim i madh dhe problematikë serioze që vihet re gjatë shqyrtimit të ankesave që parashtrihen para institucionit të Avokatit të Popullit, është edhe menaxhimi i dobët i territorit në juridiksionin të njësive të qeverisjes vendore, si dhe rritja pa kriter e numrit të ndërtimeve pa leje në mbarë territorin. Ky fenomen u vu re sidomos gjatë periudhës para dhe pas zgjedhjeve parlamentare në Republikën e Shqipërisë.

Edhe gjatë vitit 2013, pranë institucionit të Avokatit të Popullit janë paraqitur ankesa të shumta ndaj I.N.U.V.-ve të bashkive/komunave dhe Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik

Kombëtar, me objekt mosveprimin e tyre në verifikimin e ndërtimeve të paligjshme, marrjen e masave dhe sanksioneve ligjore ndaj kundravajtësve, si dhe mosekzekutim të vendimeve për prishje.

Po kështu, nga ankesat që janë shqyrtuar gjatë vitit 2013, rezulton se nga ana e administratës vendore nuk respektohet dhe nuk zbatohet e drejta për informim gjatë zhvillimit të një procedimi administrativ, ndaj atyre subjekteve të së drejtës administrative që kanë një interes të drejtpërdrejtë ose të ligjshëm në këtë procedim, apo edhe nga personat që janë të përfshirë në këtë procedim, duke qenë në të njëjtën kohë edhe të prekur nga efektet e ekzekutimit të akteve administrative të pushtetit vendor, për të cilat ato nuk kanë marrë dijeni. Më konkretisht kemi vënë re se palët nuk njoftohen për fillimin apo përfundimin e gjykimit administrativ, thirrjen për marrjen pjesë si palë, kur çënohen interesat e tyre, si dhe ka tejkallim të afateve ligjore për vënien në dispozicion të informacionit apo akteve zyrtare që individët kanë kërkuar, duke respektuar procedurat që aplikojnë këto organe të qeverisjes vendore, por që nuk përmbushin më pas detyrimet e tyre ndaj individëve.

E drejta për informim është një nga të drejtat themelore të njeriut, e cila fokusohet tek liria e individit për të marrë informacion nga autoritetet publike për mënyrën se si këto të fundit qeverisin dhe se si menaxhojnë burimet shtetërore, në funksion të mirëqeverisjes. Institucioni i Avokatit të Popullit, është një nga aktorët kryesorë në kuadër të respektimit, promovimit dhe mbrojtjes të së drejtës për informim jo vetëm në këndvështrim të përgjithshëm të funksionit të tij kushtetues, por edhe për faktin se legjislacioni specifik i njeh atij të drejtën e kujdestarit të zbatimit të së drejtës për informim.

Problematika e ndeshur nga Avokati i Popullit gjatë shqyrtimit të çështjeve që lidhen me këtë të drejtë gjatë vitit 2013, ka evidentuar probleme që lidhen me përmbajtjen e dispozitave të ligjit “Për të drejtën e informimit me dokumentet zyrtare”, si dhe me zbatimin konkret dhe njohjen e tyre. Moszbatimi, ose zbatimi jo korrekt i dispozitave ligjore që njohin dhe garantojnë të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare nga Administrata Publike, janë ende çështjet kryesore në këtë fushë, të cilat lidhen me mangësitë e njohurive të nevojshme mbi këtë ligj nga Administrata Publike, si dhe me mangësitë që hasen në vetë dispozitat e ligjit.

Edhe këtë vit theksojmë edhe njëherë faktin se, mbetet imediate, nevoja për përmirësime në Ligjin “Për të drejtën e informimit me dokumentet zyrtare”. Pavarësisht kërkesave tona të vazhdueshme për këtë qëllim ende nuk ka filluar ky proces i rëndësishëm, i cili rekomandohet me forcë edhe në një raport të posaçëm që institucioni i Avokatit të Popullit ka përgatitur për Kuvendin e Shqipërisë mbi të drejtën për informim, në vitin 2013, raport i cili do të dërgohet pas konsultimit me shoqërinë civile në vitin 2014.

Përpjekjet për përmirësimin e regjimit juridik të së drejtës për informim janë zhvillime pozitive që i shërbejnë interesit publik. Por duhet pasur parasysh se ato duhet të ruajnë dhe balancojnë disa vlera të shtetit të së drejtës. Nuk mund të thuhet në vlerësimin tonë se, një balancë e tillë është ruajtur në procesin e përgatitjes dhe përmbajtjen e dy projektligjeve, përkatësisht “Për të drejtën e informimit” dhe “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr.9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të prezantuara gjatë vitit 2013 nga Ministri i Drejtësisë.

Efektivisht draftimi dhe konsultimi për këto drafte ligjesh nuk përfshiu institucionin e Avokatit të Popullit, si aktorin kryesor në këtë fushë. Në korrespondencën zyrtare që kemi mbajtur me Ministrin e Drejtësisë për këtë qëllim kemi theksuar se, mospërfshirja e Avokatit të Popullit në diskutimet për draftimin e një sërë projektligjesh, të cilët rregullojnë regjimin juridik të të drejtave të njeriut të parashikuara shprehimisht në Kushtetutë, përbën shkelje të parimit të luajalitetit kushtetues.

Veç kësaj, mospërfshirja e Avokatit të Popullit në procesin e draftimit të projektligjit “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”, bie ndesh dhe shkel edhe rekomandimet e BE-së mbi rolin dhe detyrat e Avokatit të Popullit, si dhe përbën injorim të një urdhri të qartë të Kryeministrit, lidhur me përfshirjen e Avokatit të Popullit në procesin e draftimit të ndryshimeve ligjore, veçanërisht në fushën e të drejtave të njeriut.

Një problem i dukshëm në projektligjin “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare” është rënia e nivelit të mbrojtjes së të drejtës nga niveli i një institucioni me qëndrueshmëri më të lartë si Avokati i Popullit, i parashikuar shprehimisht në Kushtetutë, në nivelin e institucioneve të pavarura të krijuara me ligj.

Në këto kushte mendojmë se, draftimi dhe miratimi i legjislacionit të ri për mbrojtjen dhe respektimin e të drejtës për informim, duhet në radhë të parë të përfshijë sa më shumë aktorë dhe faktorë të rëndësishëm që i japin kuptim kësaj të drejte, ku padyshim Avokati i Popullit zë një vend primar. Ndryshimet dhe përmirësimet e pritshme dhe të nevojshme të këtij legjislacioni duhet të forcojnë më tej kompetencat dhe rolin që institucioni i Avokatit të Popullit luan natyrshëm në këtë fushë.

Në fokusin e punës së institucionit të Avokatit të Popullit gjatë vitit 2013 ka qenë edhe e **drejta e qytetarëve për të jetuar në një mjedis të shëndetshëm**. Problematikat e ankesave dhe kërkesave të shqyrtuara gjatë vitit 2013 kanë qenë kryesisht të fokusuara shmangien e ndotjeve të ambientit nga agentë të ndryshëm apo aktivitete të paligjshme e të palicënuara, vendosjen e antenave celulare dhe rreziku që u kanoset qytetarëve nga valët që ato transmetojnë, ndotjen e ajrit nga djegiet e lëndëve të rrezikshme, hedhjen e mbeturinave në vende publike, ndotjet akustike, të cilat në tërësinë e tyre dëmtojnë cilësinë e shëndetit dhe jetës së banorëve që jetojnë në zona të prekura nga këto ndotje.

Në krahasim me vitin 2012, gjatë vitit 2013 ka pasur një rritje të numrit të rasteve të shqyrtuara, duke dëshmuar rëndësinë gjithnjë e në rritje që paraqet kjo çështje për institucionin e Avokatit të Popullit dhe qytetarët me ndjeshmëri në mbrojtjen e mjedisit që i rrethon. Për më tepër institucioni i Avokatit të Popullit ka ushtruar kompetencën e tij për të ndjekur me iniciativë çështje të ndryshme me impakt mjedisor.

Duke u bazuar në rastet e trajtuara, Avokati i Popullit thekson se mbrojtja e ambientit në Shqipëri kërkon një vëmendje të veçantë dhe bashkëveprim të të gjithë individëve dhe strukturave shtetërore, për të synuar një përmirësim të kujdesit për shëndetin dhe rritje të cilësisë së jetës.

2. Përmbledhje e Raporteve të Veçanta drejtuar Kuvendit të Republikës së Shqipërisë

Gjatë vitit 2013 institucioni i Avokatit të Popullit ka përgatitur gjithsej 5 raporte të veçanta, të cilat janë dërguar në Kuvendin e Shqipërisë. Përgatitja dhe paraqitja në Kuvend e Raporteve të veçanta bazohet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, nenin 63, pika 2 ku parashikohet se: “Avokati i Popullit raporton përpara Kuvendit kur i kërkohet prej këtij, si dhe mund t’i kërkojë Kuvendit të dëgjohet për çështje që ai i çmon të rëndësishme”, si dhe në nenin 27 të Ligjit Nr.8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, ku thuhet se: “Përveç raportimit vjetor, Avokati i Popullit mund të raportojë para Kuvendit me nismën e tij ose me kërkesën me shkrim të Kryetarit të Kuvendit ose të një grupi deputetësh”. Raportet e veçanta të Avokatit të Popullit janë munduar të sjellin në vëmendje të Kuvendit dhe Ekzekutivit probleme dhe tematika emergjente, të cilat janë gjykuar prej tij se kanë nevojë për t’u adresuar më mirë prej organeve shtetërore, nëpërmjet përmirësimit të kuadrit ligjor, ose përmirësimit të punës së organeve përgjegjëse për trajtimin dhe zgjidhjen e tyre. Më poshtë do të gjeni një përmbledhje të problematikës dhe rekomandimeve të pasqyruara në secilin nga Raportet e Veçanta.

1. Mbi fenomenin e gjakmarrjes

Raporti është depozituar ne Kuvend në datën 22.1.2013

Duke vlerësuar të drejtën e jetës si të drejtën themelore dhe më të rëndësishme të njeriut të mbrojtur me ligj, duke pranuar edhe rrezikun që e kanos çdo ditë këtë të drejtë, Avokati i Popullit ka rimarrë iniciativën për sensibilizimin e institucioneve shtetërore, shoqërisë civile dhe individëve në këtë çështje sensitive dhe ka hartuar një raport të veçantë për fenomenin e gjakmarrjes bazuar në eksperiencën institucionale dhe të dhënave që i janë përcjellë zyrës së Avokatit të Popullit nga Institucione Shtetërore dhe OJF. Një nga sfidat, me të cilat ndeshet shoqëria dhe shteti shqiptar në këtë dekadë është edhe fenomeni i gjakmarrjes dhe hakmarrjes, zakon i trashëguar nga e kaluara e lashtë, i papajtueshëm me parimet e shoqërisë së qytetëruar dhe të shtetit të të drejtës. Ajo sjell pasoja shoqërore të rënda, me marrjen e jetës së njerëzve, me ngujimin e mjaft familjeve, duke i rrënuar ekonomikisht dhe duke i shkëputur nga jeta politike-shoqërore, si dhe duke lënë fëmijët pa shkollë. Pra, është fakt se në vendin tonë shkelen, rrezikohen ose nuk zbatohen disa nga të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, për shkak të fenomenit të gjakmarrjes. Gjakmarrja është fenomen i lokalizuar në disa zona dhe me përmasa të kufizuara, por ajo përbën problem shqetësues dhe prandaj meriton të vlerësohet seriozisht, si nga pikëpamja politike, ashtu dhe ajo shoqërore. Por për fat të keq, organizmat shtetërorë ende nuk kanë arritur të bëjnë vlerësimin e duhur të kësaj shtate të krijuar, si dhe të mendojnë e të punojnë në bashkëveprim të ngushtë me njëri-tjetrin. Këtë e tregon fakti se nuk ka statistika të sakta mbi këtë fenomen dhe pasojat e tij. Avokati i Popullit ka synuar me anë të këtij raporti të posaçëm në sensibilizimin dhe angazhimin më të madh të organeve shtetërore e të shoqërisë civile për parandalimin dhe për luftën kundër krimeve ndaj jetës, veçanërisht kundër gjakmarrjes e hakmarrjes. Gjithashtu Qeveria Shqiptare duhet të ndikojë mbi organet e administratës publike në varësi të saj për vlerësimin e fenomenit të gjakmarrjes, si dhe të forcojë bashkëpunimin e mbështetjen për organizatat joqeveritare për parandalimin e gjakmarrjes dhe hakmarrjes. Organet e Policisë së Shtetit duhet të

marrin masa për parandalimin e konflikteve, për zbulimin, kapjen dhe dorëzimin e gjithë fajtorëve organeve të prokurorisë, duke forcuar edhe bashkëpunimin me Interpolin për ekstradimin e vrasësve, që fshihen jashtë shtetit. Ministria e Arsimit dhe e Shkencës duhet të luajë rol më të madh pozitiv e parandalues për përmirësimin e programeve mësimore, që të sigurohet edukimi i brezit të ri me frymën e tolerancës, kundër vetëgjyqësisë, hakmarrjes e gjakmarrjes, si dhe për trajtimin e mësuesve të zonave, ku është e përhapur gjakmarrja, që të ndihmojnë nxënësit e ngjuar. Problemet sociale të familjeve të ngjuara kërkojnë një angazhim më të madh të shtetit, posaçërisht të Ministrisë së Punës e të Çështjeve Sociale, që, nëpërmjet zyrave rajonale, të ndihmojnë familjet e ngjuara me të ardhura të pamjaftueshme, si dhe për të ulur nivelin e varfërisë e të papunësisë. Organet e prokurorisë duhet të bashkëpunojnë më mirë me policinë dhe të zhvillojnë hetime të shpejta, të plota e objektive, duke ia dërguar çështjet për gjykim, me prova sa më të plota, gjykatës. Gjykatat kanë për detyrë t'i gjykojnë shpejt dhe të caktojnë dënime të drejta për çdo fajtor. Çdo dënim i butë, apo pafajësi e pabazuar i lë shteg vetëgjyqësisë, hakmarrjes e gjakmarrjes vetjake.

2. Mbi problematikat e parashtruara nga ish të dënuarit politikë të regjimit komunist gjatë vitit 2012 e në vazhdim

Raporti është depozituar ne Kuvend në datën 1.4.2013

Gjatë periudhës kohore Shtator-Tetor 2012, një grup personash ish të dënuar politikë të regjimit komunist organizuan një grevë urie, në një ambient të improvizuar me çadra ndërmjet pallateve të banimit, në hyrje të rrugës "Medat Shtylla" Tiranë. Greva e tyre u bë publike nga media, e cila ndërkohë ngriti edhe problemet e shqetësimet e tyre. Ndër të tjera, nga media u ngrit edhe shqetësimi i mungesës së shërbimit mjekësor në ambientet e grevës së urisë gjatë ditëve të para të fillimit të saj. Në këto rrethana, Avokati i Popullit dërgoi tek grevistët një grup pune, i cili mori takim me ta, i pyeti dhe i dëgjoi të gjitha pretendimet dhe kërkesat e tyre, si dhe monitoroi mbarëvajtjen e grevës në mënyrë të vazhdueshme. Ndërkohë, grevistët dhe koordinatorët e tyre u vizituan dhe u takuan disa herë nga vetë Avokati i Popullit, si në ambientet e grevës, ashtu edhe në ambientet spitalore. Veprimtaria e institucionit të Avokatit të Popullit lidhur me trajtimin e ankesave që, lidhen me realizimin e të drejtave të ish të dënuarve politikë të regjimit komunist, ka nxjerrë këto konkluzione:

1. Realisht sot, ish të dënuarit politikë të regjimit komunist përfaqësojnë një nga shtresat shoqërore, e cila ende nuk ka përfituar tërësisht të drejtat që i takojnë, pavarësisht hapave pozitive të ndërmarra nga shteti për trajtimin e tyre. Ndër hapat kryesorë është miratimi nga Kuvendi i Shqipërisë, i Ligjit nr.9831 datë 12.11.2007 "Për dëmshpërblimin e ish të dënuarve politikë të regjimit komunist", i ndryshuar, në zbatim të të cilit kanë dalë një sërë aktesh nënligjore, siç edhe VKM nr.419 datë 14.04.2011 "Për miratimin e afateve dhe të skemës së shpërndarjes së fondeve të dëmshpërblimit për ish të dënuarit politikë të regjimit komunist", apo VKM të tjera që, përcaktojnë normalisht përfituesit e kësteve të dëmshpërblimit financiar.
2. Aktet normative që janë në fuqi në vendin tonë nuk parashikojnë të drejtën e grevës së urisë dhe kjo mangësi ligjore, duhet plotësuar.
3. Veprimet e policisë të kryera me grevistët e urisë duke i hequr dhe mos lejuar futjen e për rrjedhojë përdorimin e lëngjeve (çajit), sheqerit, trisolit dhe kafes në ambientet e grevës janë jo ligjore dhe jo humane.

4. Ndërprerja e komunikimit të grevistëve me organet e medias çënon të drejtën e shprehjes së çdo njeriu për të dhënë opinione, për të dhënë e marrë informacione të garantuar nga neni 22/1 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Gjatë zhvillimit të grevës së urisë, nga policia është çënuar edhe liria e shtypit, e radios dhe e televizionit e garantuar nga neni 22/2 i Kushtetutës.
5. Mjekët e pranishëm megjithë përkushtimin e treguar nuk arritën të kryejnë plotësisht detyrën e tyre për menaxhimin e grevës së urisë, sikurse parashikohet në disa akte ndërkombëtare të miratuara Asambleja Botërore e Mjekësisë dhe Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës.
6. Personeli mjekësor dhe punonjësit e Policisë së Shtetit kanë nevojë që të njihen me aktet ndërkombëtare e rajonale që trajtojnë grevën e urisë dhe të trajtohen në vijimësi lidhur me mënyrën e menaxhimit dhe monitorimit të grevave të urisë.
7. Trajtimi i grevës së urisë nxori në pah mungesën e vullnetit nga ana e organeve përkatëse të administratës shtetërore për zhvillimin e dialogut me grevistët, për gjetjen e zgjidhjeve të pranueshme nga palët, kërkesë që nuk u mor parasysh, as pas ndërhyrjes së Avokatit të Popullit për këtë qëllim.
8. Konstatohet se, procesi i dëmshpërblimit të ish të dënuarve politikë, nuk ka ecur me ritmet e dëshiruara, për shkak të cilat, lidhen kryesisht me ndryshimet që ka pësuar Ligji nr.9831 datë 12.11.2007 “Për dëmshpërblimin e ish të dënuarve politikë të regjimit komunist”, në vitin 2009, me ligjin nr.10111 datë 2.04.2009.
9. Përmbajtja e ligjit bazë (ligji nr.9831 datë 12.11.2007), e ndryshimeve që ai ka pësuar, por edhe e akteve nënligjore të dala në zbatim të tyre (kjo pjesë i referohet VKM nr.419 datë 14.04.2011), ka krijuar konfuzion në ecurinë e pritshme të procesit të dëmshpërblimit nga ana e subjekteve të interesuara dhe efektivisht ka çuar në konkluzionin e perceptuar prej tyre, të moszbatimit të ligjit.
10. Pavarësisht kërkesave të hershme për dëmshpërblim, që janë paraqitur nga subjektet e interesuara, përfaqësues të kategorisë së të internuarve ose të dëbuarve nga regjimi komunist (gërma “b”, e nenit 6, të Ligjit “Për dëmshpërblimin e ish të dënuarve politikë të regjimit komunist”), institucionet përkatëse shtetërore ende nuk kanë ndërmarrë iniciativën legislative për t’i propozuar Këshillit të Ministrave nxjerrjen e akteve përkatëse nënligjore që, do t’i mundësojnë marrjen e dëmshpërblimit kësaj kategorie.
11. Pavarësisht kërkesave të hershme për dëmshpërblim, që janë paraqitur nga subjektet e interesuara, përfaqësues të kategorisë së të internuarve ose të dëbuarve nga regjimi komunist, institucionet përkatëse shtetërore ende nuk kanë ndërmarrë iniciativën legislative për t’i propozuar Këshillit të Ministrave, miratimin e skemës së pensionit me anë të Vendimit përkatës, skemë nga e cila do të përfitojnë dëmshpërblimin këto kategori ish të dënuarish politikë.

12. Procesi kompleks i dëmshpërblimit të ish të dënuarve politikë të regjimit komunist, nxjerr nevojën e miratimit në Kuvendin e Shqipërisë, në një kohë sa më të shpejtë të projektligjit, i cili do t'u japë mundësi trajtimi me dëmshpërblim edhe atyre ish të dënuarve politikë që nuk kanë mundur për arsye të ndryshme të plotësojnë dokumentacionin dhe paraqesin kërkesën, brenda afatit të parashikuar nga Ligji nr.9831 datë 12.11.2007 "Për dëmshpërblimin e ish të dënuarve politikë të regjimit komunist", i ndryshuar.

3. Mbi aksidentin e ndodhur në rrugën nacionale Vlorë –Himarë, në Qafën e Vishës, datë 21 Maj 2012 dhe rolin e strukturave shtetërore në administrimin e pasojave tragjike të këtij aksidenti. Problematikat e identifikuar dhe rekomandimet përkatëse

Raporti është depozituar ne Kuvend në datën 14.01.2013

Informacion për ngjarjen

Në datë 21 Maj 2012 në rrugën nacionale Vlorë –Himarë, në vendin e quajtur Qafa e Vishës, një autobus me targë El 22 72 B, tip Mercedes Benz, prodhim i vitit 1988, ka dalë nga rruga duke rënë në një distancë rreth 60 metra, dhe duke sjellë pasoja të rënda, konkretisht me humbjen e jetës së 13 shtetasve dhe plagosjen e rreth 25 të tjerëve, 2 prej të cilëve u dërguan për kurim më të specializuar në Austri. Në datën 18.05.2012, Avokati i Popullit ka ngritur një grup pune me ekspertë të institucionit, për monitorimin e mënyrës së menaxhimit të situatës së krijuar, me qëllimin e vetëm të gjetjes së mundësive, apo dhe krijimit të strukturave të specializuara sipas parametrave bashkëkohorë, për zgjidhjen sa më optimale të situatave të tilla me pasoja të rënda. Duke marrë shkas nga problematika e konstatuar ne këtë aksident të rënde Avokati I Popullit ka hartuar disa rekomandime përkatëse:

- Ngritja e një strukture unike vetëm për urgjenca të shkëputura nga shërbimet e tjera spitalore e përbërë nga mjekë, infermierë, zjarrfikës, punonjës policie dhe ekspertë të specializuar me mjete speciale për përballim e situatave, pasoje e aksidenteve te renda. Përgatitja e protokolleve te operimit mbi rolet dhe përgjegjësitë e eksperteve ne nivel rajonal dhe qendror;
- Ministria e Shëndetësisë duhet të pajiset me helikopterë profesional -"Helikopterë Sanitare" të cilët janë të pajisur me të gjitha mjetet që ka një sallë operacioni me qëllim ndërhyrjen e menjëhershme mjekësore;
- Ngritja e një heliodromi të përshtatshëm pranë spitalit Ushtarak dhe për spitalet e mëdha rajonale për uljen dhe ngritjen e helikopterëve të përmasave të mëdha, - helikopterët ushtarak në pamundësi të uljes në heliodromin ekzistues të Spitalit Ushtarak, janë ulur në Aeroportin e Rinasit;
- Raporti i përgatitur nga strukturat e policisë rrugore mbi shkaqet e aksidentit, për sa kohë analizon dhe merr në shqyrtim dhe përgjegjësinë e shtetit/

strukturave shtetërore – detyrimet pozitive që duhet të marrë shteti për parandalimin e humbjes së jetëve njerëzore – në këtë aksident duhet të kryhet nga ekspertë të pavarur, ose nga një grup ekspertësh ku shumicën e anëtareve duhet ta përbëjnë ekspertët e pavarur (pavarësisht faktit se nuk janë punonjës në qytetin ku ndodhi aksidenti);

- Rishikimi i procedurës së kontrollit fizik të automjeteve me qëllim rritjen e efektivitetit dhe cilësisë së këtij kontrolli, sidomos atyre mjeteve që shërbejnë për transport publik.
- Plotësimi me sinjalizimin rrugor dhe elementët e tjerë të sigurisë rrugore, sipas dispozitave të Kodit Rrugor, veçanërisht në *pikat e zeza (kthesat e vështira dhe të rrezikshme siç është ajo në fjalë) dhe ndalimin e qarkullimit të automjeteve të transportit publik përgjatë Bregut Jugor, në Qafë- Kërrabe, etj;*
- *Përgatitja e rregulloreve standarde të sigurisë për ekspeditat mësimore të studentëve dhe aktivitetet jashtë shkollore të nxënësve nga ana e Ministrisë së Arsimit;*

Rekomandime të përgjithshme për parandalimin e aksidenteve të rënda

- Hartimi i programeve (fushata sensibilizuese, fletëpalosje, trajnime) për edukimin e popullsisë, veçanërisht të rinjtë rreth sigurisë rrugore;
- Përfshirja e komuniteteve lokale në hartimin e Projekteve të sigurisë rrugore;
- Përfundimi i punimeve në rrugë të merren në dorëzim bazuar në raportin e supervizorit. Supervizorët nuk duhet të jenë përfaqësues të investitorit, me qëllim që të shmangët konflikti potencial i interesit;
- Trajnimi dhe kontrolli i punës së punonjësve të policisë për zbatimin e rregullave të qarkullimit nga përdoruesit e rrugës, shpejtësitë mbi normat e lejuara, përdorimi i alkoolit, përdorimin e rripave të sigurimit në automjete edhe pasagjerët, si dhe përdorimi i kaskave mbrojtëse në motoçikleta etj;
- Rishikimi i procedurës për kualifikimin për t'u pajisur me leje drejtimi, nga ana e drejtuesve të automjeteve, si dhe për rinovimin e saj;
- Eliminimin e rrugëve anësore që dalin në rrugët interurbane kryesore. Eliminimin gjithashtu të vendosjes së reklamave pa kriter, kryerjes së punimeve ndërtimore të palejueshme, ndërtime të kalimeve në nivel që intersektohen me hekurudhën, të cilat në shumë raste kanë qenë shkak për aksidente me pasoja fatale.
- Të ngrihet qendra e kontrollit të trafikut për krijimin e një sistemi informimi mbi trafikun rrugor dhe bllokimet në rrugët kryesore, duke synuar rritjen e sigurisë rrugore, përmirësimin e menaxhimit të trafikut në mes të tjerave dhe nëpërmjet futjes së sistemeve të integruara të menaxhimit të trafikut;
- Sektori privat dhe Organizatat Jofitimprurëse, duhet të nxiten dhe mbështeten për t'u aktivizuar në çështjet e sigurisë rrugore;

- Forcimi i bashkëpunimit ndërsektorial, kryesisht i institucioneve qendrore me ato të organeve vendore;
 - Vendosje bashkëpunimi dhe e një numri telefoni unikal për emergjencat: Urgjencë mjekësore – Polici e Shtetit - Zjarrëfikse
4. **Për të drejtat e fëmijëve jetimë, përfshirë këtu fëmijët e sistemuar në institucionet rezidenciale të përkujdesjes shoqërore, si dhe të fëmijëve që shfrytëzohen për të punuar**

Raporti është depozituar në Kuvend në datën 23.5.2013

Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve përbën një nga drejtimit më të rëndësishme, të politikave të mbrojtjes sociale. Në themel të tyre, pasqyrohen parimet themelore të Konventës për të Drejtat e Fëmijëve, e ratifikuar nga Shqipëria në vitin 1992, detyrimet, që dalin nga objektivat e mijëvjeçarit të ri dhe instrumentet e tjera ndërkombëtare të ratifikuara nga shteti shqiptar, të cilat theksojnë se fëmijët, për shkak të veçorive të moshës, të mungesës së pjekurisë fizike dhe intelektuale, kanë nevojë për mbrojtje dhe vëmendje të veçantë nga familja dhe institucionet shtetërore.

Shkaqet e shfrytëzimit të punës së fëmijëve

Ka shumë arsye që i nxisin fëmijët drejt punës, sidoqoftë faktori më i rëndësishëm mbetet varfëria. Familjet e varfra i shtojnë fëmijët të punojnë në mënyrë që të shtojnë të ardhurat e tyre të pamjaftueshme.

Varfëria është njëkohësisht shkak dhe pasojë e punës së fëmijëve. Varfëria dhe puna e fëmijëve janë komponentët kryesorë të “ekuilibrit të ulët ekonomik” në nivel të familjes, komunitetit dhe vendit. Për këtë arsye, puna e fëmijëve është një pikë themelore për ndërhyrje në masat që merren për zbutjen e varfërisë dhe mbrojtjen sociale.

Përveç varfërisë, ka shumë faktorë të tjerë që kontribuojnë në punën e fëmijëve:

Qëndrimi përkrahës ndaj punës së fëmijëve – Prindërit (mësuesit dhe shoqëria në përgjithësi) mund ta shohin punën e fëmijëve si pjesë të edukimit të tyre, veçanërisht kur arsimimi ekzistues nuk ofron përfitime ekonomike për të rinjtë. Prindërit mund ta mbështesin punën e fëmijëve si një mënyrë për t’i mbajtur fëmijët të sigurt, në disa zona ku fëmijët mund të diskriminohen, apo të jenë subjekt i dhunës në shkolla.

Mjedis jo i favorshëm familjar – familjet me një prind, me kryefamiljar të sëmurë apo të paaftë fizikisht, varësia nga alkooli apo nga droga e prindërve, paaftësia prindërore, si dhe abuzimi e vendosin fëmijën në rrezik të madh për t’u përfshirë në punën e fëmijëve.

Mungesa e qasjes në arsim – kostot e drejtpërdrejta dhe indirekte të edukimit, shpesh janë shumë të larta për prindërit që të mundësojnë ndjekjen e shkollës nga fëmijët e tyre dhe/ose shkollat janë në një distancë shumë të madhe.

Diskriminimi – minoritete apo komunitete të caktuara kanë më pak qasje në arsim apo në tregun e punës, prandaj edhe kjo gjë shton mundësinë që këta fëmijë të kryejnë detyra të caktuara që në moshë të re. Për më tepër, ndarja e punës në bazë gjinore mund t’i detyrojë

meshkujt dhe femrat që të kufizojnë perspektivat e tyre të punës deri në një shkallë të caktuar që nuk kërkon arsimim, por “praktikë pune” që nga moshat e reja, përfshirë dhe punën në shtëpi.

Përhapja e sektorit joformal dhe mungesa e zbatimit të ligjit – Mungesa e kontratave të punës dhe e së drejtës së krijimit të shoqatave kolektive në sektorin joformal e bën më të vështirë mbrojtjen e fëmijëve nga kushtet abuzive të punës, si dhe vetë identifikimin e fëmijëve që punojnë.

Shkalla e lartë e migrimit – migrimi ka luajtur një rol në dobësimin e mbështetjes sociale për fëmijë.

Moszbatimi i parimit të sundimit të ligjit – ka lejuar ekonominë informale të lulëzojë dhe korrupsionin që të pushtojë shumë aspekte të jetës së njerëzve. Kjo gjë ka ndikim të drejtpërdrejtë në; a) rastet e formave të këqija të punës së fëmijëve që kanë lidhje me aktivitetet kriminale (aktivitete të jashtëligjshme, trafikim dhe prostitucion – kur një gjë e tillë është kriminalizuar), dhe b) në zbatimin e ligjeve dhe politikave të lidhura me punën e fëmijëve.

Ekzistenca e përkohshme e një “mungese vlerash” – në të cilin presioni i konsumimit perëndimor në konkurrencë me vlerat tradicionale, si dhe tërheqja personale në masë ekstreme, sjellin: a) prishjen e bazës së vlerave të familjes dhe komunitetit; dhe b) rritjen e rrezikshmërisë ndaj fëmijëve.

Për shkak të mungesës së një mbikëqyrjeje dhe kujdesi të duhur, rruga është bërë vendi kryesor për shoqërizimin e fëmijëve.

Konkluzione:

Nga një analize tërësore e të gjithë informacionit dhe gjetjeve paraprake të sjella në këtë raport, bazuar në kontributin e të gjithë aktoreve të kësaj fushe, në kuadër të respektimit dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve, mund të arrijmë në disa konkluzione:

- Fëmijët jetimë, përfshirë këtu fëmijët e sistemuar në institucionet rezidenciale të përkujdesjes shoqërore dhe fëmijët që shfrytëzohen për të punuar, përfaqësojnë kategori sociale të cilat kanë marrë përpjesëtime shqetësuese në periudhën e tranzicionit dhe që sot njihen si kategori vulnerabël.
- Gjendja reale e tyre dhe dinamika e zhvillimit tërësor të shoqërisë në vend, nxjerrin nevojën e ndërhyrjes shumëplanëshe shtet-shoqëri, për të siguruar një mjedis ku fëmijët e nisin jetën në mënyrën më të mirë të mundshme, ku të gjithë ata, kanë mundësi të shumta për zhvillimin e aftësive të tyre individuale në një mjedis të shëndetshëm dhe inkurajues.

Për të mundësuar krijimin e këtij mjedisi, nevojitet të merren masa në nivel të përgjithshëm për të siguruar:

- Zhvillim ekonomik për të rritur të ardhurat e familjeve dhe standardin jetësor: duke mbështetur rritjen dhe shpërndarjen e burimeve në nivel të përgjithshëm,

si dhe duke mbështetur përpjekjet e familjeve ne nevojë për të krijuar të ardhurat e domosdoshme. Lufta ndaj varfërisë është kryefjala e të gjithë përpjekjes për një zhvillim sa më të mirë të fëmijërisë, të fëmijëve jetime dhe të reduktimit maksimal të shfrytëzimit të punës së fëmijëve;

- Arsim cilësor, gjithëpërfshirës, pa pagesë dhe i detyrueshëm për të shtuar kapitalin njerëzor. Arsimi cilësor do të shërbejë si premise për rritjen e shanseve për të gjetur një punësim sa më të përshtatshëm dhe lëvizshmëri më të madhe ekonomike e sociale për të shpëtuar nga kurthi i varfërisë, si dhe krijimin e një forcë pune më të aftësuar dhe kualifikuar që mund të çojë drejt një ekonomie më konkurruese;
- Zbatim të ligjeve kundër punës së fëmijëve, dhunës ndaj fëmijëve, ligjeve për arsimin e detyrueshëm, si dhe të ligjeve që në mënyrë indirekte synojnë dënimin e individëve abuzues me fëmijët;
- Ndryshim pozitiv në mentalitetin shoqëror ndaj fëmijëve, në rang familjeje, punëdhënësish dhe institucionesh, për eliminimin e punës së fëmijëve;
- Shërbime sociale, si dhe një mbështetje të përshtatshme dhe të vazhdueshme për vete këto kategori fëmijësh, si dhe familjet e tyre, për të përballuar realitetin në të cilin zhvillohet fëmija.
- Marrjen e masave për të reduktuar fenomenin e ekonomisë informale dhe të gjithë pasojave negative që ajo sjell, si dhe një luftë të pandërprere ndaj fenomenit gërryes të korrupsionit, që aktualisht ka pushtuar shumë aspekte të jetës së njerëzve. Ndërtimin e një tregu pune që respekton të drejtat baze të fëmijëve dhe mirëqenien e tyre.
- Puna konkrete për të siguruar një mjedis sa më mirëqenës për kategoritë target në këtë raport, shërben si masë parandaluese për një sere dukurish të tjera negative të shoqërisë sonë, siç është krimi i trafikimit të fëmijëve, përfshirja e vetë fëmijëve në grupe kriminale apo në kryerjen e krimeve të ndryshme, prostituimi etj.

Për fëmijët jetimë

Fëmijët dhe të rinjtë që kanë humbur kujdesin prindëror, vuajnë nga diskriminimi dhe shumë disavantazhe, si pasojë e mosfrimit të shërbimit dhe vëmendjes nga strukturat publike shtetërore. Kuadri aktual ligjor kërkon përmirësime për sa u përket të rinjve që largohen nga përkujdesja, duke adresuar sfidat e tyre, për të zhvilluar strategji më të mira dhe shërbime të tjera për ta. Statusi i përkujdesjes në institucionet rezidenciale vështirëson të ardhmen e të rinjve që largohen nga përkujdesja dhe thekson disavantazhet dhe vulnerabilitetin e tyre. Statusi ligjor i fëmijëve në përkujdesje të moshës 16-18 vjeç nuk është i rregulluar.

Vendi ynë nuk ka një sistem ligjor të mjaftueshëm që mbulon nevojat e të rinjve që janë në përkujdesje apo që dalin nga përkujdesja, veçanërisht të atyre që largohen shumë më herët. Për këtë arsye, është i nevojshëm krijimi i shërbimeve pas përkujdesjes, qëndrimi në përkujdesje deri në përfundim të shkollës së mesme, ngritja e qendrave ditore pritëse që ofrojnë shërbime për të rinjtë (16-18 vjeç) dhe implementimi i politikave të trajnimit profesional dhe punësimit për kategoritë e të rinjve që janë

larguar nga përkujdesja.

Drejtimit i rëndësishëm i masave që duhet të merren në këtë kuadër është nisja e shërbimeve të reja për të rinjtë (fëmijët), informimi dhe këshillimi, shërbime komunitare e pjesëmarrëse dhe advokim për të mbështetur pjesëmarrjen e tyre.

Nevojitet një trajtim adekuat ligjor ndaj individëve jetimë, për përfitimin real të të gjitha lehtësirave që ofron Ligji “Për statusin e jetimit”, por edhe legjislacioni aktual në fuqi, jo vetëm për kohën që këta individë janë nën përkujdesje shoqërore, por edhe pas kalimit të moshës 18 vjeç dhe cilësimit të tyre si të rritur. Strehimi, punësimi, shërbimet përkatëse të përkujdesjes shoqërore, përjashtimi nga taksa të caktuara, janë të drejta të këtyre individëve, që nga ana tjetër kërkojnë një angazhim konkret dhe real të shtetit për plotësimin e tyre.

Del i nevojshëm rishikimi i dispozitave të Ligjit “Për Statusin e Jetimit”, në kushtet kur kompetencat për zbatimin e tij kanë kaluar nga organet e pushtetit qendror, tek organet e qeverisjes vendore dhe kur vetë zhvillimi i shoqërisë shqiptare dhe i marrëdhënieve në tërësi ka evoluar, duke marrë dimensione dhe kuptime të reja.

Në një kuadër të përgjithshëm për kategoritë target të raportit, është e nevojshme të ndërmerren hapa konkrete, për:

- Konsolidimin dhe përmirësimin e sistemit të përkujdesit shoqëror për fëmijët në nevojë.
- Nxitjen e procesit të decentralizimit të shërbimeve dhe shpërndarjen e tyre në komunitet. Krijimin e kapaciteteve dhe mundësive financiare të mjaftueshme në qeverisjen vendore, për ngritjen e shërbimeve të reja në përputhje me nevojat e fëmijëve në nevojë, si dhe një koordinim më të mirë mes këtij pushteti, organeve të qeverisjes qendrore dhe OJF-ve që veprojnë në këtë fushë, për këtë qëllim.
- Ofrimin e shërbimeve cilësore në institucionet publike dhe jopublike të përkujdesit për fëmijët, duke respektuar dhe aplikuar standardet e ambienteve fizike dhe qëndrueshmërinë e marrëdhënieve të punësimit për stafet e specializuara. Në lidhje me standardin për procedurat e mbrojtjes, çdo punonjës i ri në institucion duhet të marrë një trajnim të parë mbi procedurat e mbrojtjes dhe çdo institucion ta vendosë si të detyrueshëm marrjen e këtij trajnimit. Trajnimi duhet të përfshijë përkufizime të qarta mbi konceptin e abuzimit, format dhe manifestimet si dhe pasojat tek fëmijët nga perspektiva e të drejtave dhe zhvillimit të fëmijës.
- Forcimi i cilësisë dhe aksesit në shërbime të tjera të institucioneve rezidenciale për të siguruar përmbushjen e nevojave të fëmijëve. Ky është një aspekt mjaft i rëndësishëm nëse mbajmë parasysh faktin që ky grup fëmijësh ka nevojat të veçanta psikosociale, herë herë janë të traumatizuar, apo kanë probleme të shëndetit mendor. Shpesh herë këto shërbime të specializuara mungojnë, por njëkohësisht mund të ndodhë dhe që nuk njihen..
- Nxitja e deinstitutionalizimit të fëmijëve në qendrat rezidenciale nëpërmjet transformimit të tyre në formën Shtëpi- Familje, ngritja e shërbimeve ditore dhe komunitare brenda këtyre qendrave. Ofrimi i formës së shërbimit Shtëpi-Familje, sikurse në rastin e aplikuar në Shtëpinë e Fëmijës “Zyber Hallulli”, Tiranë, në të gjitha institucionet publike rezidenciale të përkujdesjes shoqërore, në bashkëpunim me

organet e qeverisjes vendore. Promovimi i shërbimeve mbështetëse për fëmijët dhe shërbime alternative, të cilat zbusin institucionalizimin e fëmijëve, shërbimi i kujdestarisë në familje, birësimi dhe rikthimi në familje biologjike.

- Fuqizimi i kapaciteteve që punojmë me fëmijët në nivel qendror dhe rajonal; trajnimi i vazhdueshëm i stafeve të shërbimeve sociale. Vihet re se, njohuritë në lidhje me zbatimin e të drejtave të fëmijëve në praktikën e përditshme, janë ende të kufizuara me gjithë trajnimet që janë ofruar herë pas here nga organizata të ndryshme dhe nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

5. Raport i posaçëm i veprimtarisë së Avokatit të Popullit për punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara (PAK), në institucionet e pushtetit qendror e atij lokal

Raporti është depozituar në Kuvend në datën 23.5.2015

Personat me Aftësi të Kufizuara, si të gjithë personat e tjerë duhet të konsiderohen si persona të mundësive, si persona të barabartë mes të barabartëve, persona me dinjitet të lindur e me të drejta të patjetërsueshme. Avokati i Popullit, si institucion kushtetues, ndër të tjera, prioritet të punës së tij, ka gjithashtu edhe respektimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara. Në këtë kontekst, prej disa kohësh, institucioni i Avokatit të Popullit ka filluar monitorimin në vazhdimësi të respektimit të legjislacionit nga pushteti qendror e ai lokal, për punësimin e personave me aftësi të kufizuara. Procesi apo procedura e punësimit kërkon vëmendje dhe zbatim të legjislacionit nga të gjitha institucionet e subjektet publike e private. Institucioni i Avokatit të Popullit për të bërë monitorimin e zbatimit të këtij ligji u ka dërguar 36 institucioneve të pushtetit qendror dhe qeverisjes vendore, shkresën me subjekt kërkesë për shpjegime në lidhje me këto detyrime ligjore. Kjo iniciativë daton një periudhë afro dy muajore ku gjatë së cilës janë përgjigjur 21 institucione prej të cilave: 11 përgjigje të ardhura prej qeverisjes vendore dhe 10 përgjigje prej pushtetit qendror përfshirë këtu institucione politikëbërëse dhe ato ekzekutuese.

Konkluzione:

1. Nuk është respektuar neni 15 i Ligjit nr. 7995, për punësimin e personave me aftësi të kufizuara, nuk është ruajtur përgjithësisht raporti: 1 PAK i punësuar në çdo 24 persona.
2. Bashkia Kukës dhe Bashkia Pogradec janë institucionet të cilat e kanë respektuar raportin madje edhe e kanë tejkaluar atë duke pasur respektivisht 12 PAK të punësuar nga 218 të punësuar gjithsej dhe 9 PAK nga 121 të punësuar gjithsej.
3. Asnjë institucion nuk ka aplikuar për fonde nga zyra përkatëse e punësimit për të pajisur siç duhet vendin e punës së personit me aftësi të kufizuara.
4. Asnjë institucion nuk ka derdhur në një llogari të veçantë në Fondin e Shërbimit Kombëtar të Punësimit shumën e barabartë me minimumin e pagës për çdo muaj.
5. Bashkia Korçë, pohon se me mbështetjen e UNDP po bëjnë të mundur realizimin e përshtatjes së arsyeshme së ambienteve për PAK.

6. Bashkia Elbasan dhe Bashkia Lezhë pohojnë se kanë pasur inspektive nga Institucionet e Shërbimit Kombëtar të Punësimit dhe Inspektoratit Shtetëror të Punës për zbatimin e dispozitave për PAK në bazë të ligjit të nxitjes së punësimit. Institucionet e tjera nuk shprehen fare për këtë pjesë dhe një pjesë tjetër e tyre shprehet se nuk kanë pasur kontroll.
7. Kryesisht, Ministritë të cilat kanë kthyer përgjigje shprehen se, nuk kanë pasur kërkesa nga këto kategori, duke qenë se rekrutimi i nëpunësve, bëhet në bazë të ligjit të shërbimit civil.
8. Duke qenë se gati gjysma e institucioneve nuk kanë kthyer ende përgjigje, pavarësisht tejkallimit të afatit zyrtar, nuk mund të japim të dhëna të tjera.
9. Po kështu mbetemi ende në pritje të përgjigjeve nga ana e Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimit Kombëtar të Punësimit në lidhje me veprimtarinë e tyre në zbatim të këtij ligji.

Rekomandime

Në përfundim të monitorimit dhe të problematikave të konstatuara për punësimin e personave me aftësi të kufizuara, në zbatim të dispozitave të ligjit 7995 "Për nxitjen e punësimit, gjatë veprimtarisë tonë për periudhën shkurt-mars 2012, përfundimisht mendojmë se gjendja e respektimit të të drejtave dhe lirive të kësaj kategorie, ka nevojë për përmirësim. Nga analiza dhe vlerësimet e sipërcituara rekomandojmë:

1. Hartimin e një akti nënligjor në zbatim të nenit 16 të ligjit nr. 7995/1995 "Për nxitjen e Punësimit" i cili të përcaktojë hollësisht rregullat, mënyrën dhe procedurën e derdhjes së pagës minimale në Fondin Kombëtar të Punësimit. Avokati i Popullit konstaton se ky akt është i vonuar pasi paragrafi i 4 i nenit 16, e autorizon drejtpërsëdrejti nxjerrjen e një akti të tillë nga Këshilli i Ministrave.
2. Realizimin e përshtatjes së arsyeshme të ambienteve për personat me aftësi të kufizuara, në vendin e punës, duke mundësuar kështu heqjen e barrierave e duke siguruar akses të barabartë me të tjerët.
3. Në vijim, duhet që autoritetet shtetërore përgjegjëse, Inspektorati Shtetëror i Punës të kontrollojë zbatimin nga punëdhënësit të dispozitave ekzistuese e atyre që do të ndryshojnë, në mënyrë që të garantojë edhe zbatimin në praktikë të ligjit, nga punëdhënësit publik apo privatë.

KREU II

Veprimtaria e Institucionit të Avokatit të Popullit në zgjidhjen e ankesave konkrete, e ndarë sipas të drejtave dhe lirive të garantuara nga Kushtetuta dhe aktet e tjera ligjore

A. E drejta për informim

Vështrim i Përgjithshëm

E drejta për informim është një nga të drejtat themelore të njeriut, e cila fokusohet tek liria e individit për të marrë informacion nga autoritetet publike, për mënyrën se si këto të fundit qeverisin dhe se si menaxhojnë burimet shtetërore, në funksion të mirëqeverisjes.

E drejta për informim është një e drejtë themelore e individit, e garantuar në nenin 23, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Duke prezantuar një element kyç të jetësimit të demokracisë funksionale, e drejta për informim është afirmuar në një sërë aktesh ndërkombëtare, të cilat njëkohësisht edhe vendosin standarde të **respektimit të saj**, standarde të **cilat janë reflektuar përgjithësisht në legjislacionin vendas që afirmon dhe rregullon specifikisht këtë të drejtë**.

Për një regjim juridik sa më të përputhshëm me standardet **më të mira ndërkombëtare në këtë fushë, prej vitesh janë ratifikuar** shumë prej këtyre akteve nga ana e shtetit shqiptar. Ndërkohë lind nevoja e ratifikimit të akteve të reja ndërkombëtare që sjellin risi dhe konceptim më të mirë të së drejtës për informim, pasi zhvillimet më të fundit në këtë drejtim kanë sjellë edhe një dimensionim të ri të së drejtës për informim.

Disa nga aktet ndërkombëtare më të rëndësishme në këtë fushë, që japin kuptimin dhe vendosin baza konceptuale për të drejtën e informimit janë:

-Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara, në 10 Dhjetor 1948, e cila ndër të drejtat më themelore të njeriut, afirmon edhe drejtën për informim.

-Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut, e hartuar nga shtetet anëtare të Këshillit të Evropës, si një nga përpjekjet e para me efikasitet për të siguruar garancinë kolektive të disa të drejtave të afirmuara në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut.

-Në mbështetje të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut, palët nënshkruese të saj kanë nënshkruar **Paktin Ndërkombëtar mbi të Drejtat Civile dhe Politike**. (Dhjetor 1966). Edhe ky akt i rëndësishëm njeh dhe garanton të drejtën për informim.

-Deklarata e Këshillit të Europës mbi Lirinë e Shprehjes dhe të Informimit, e vitit 1982, shpreh si një nga përparësitë në veprimtarinë e Këshillit të Evropës, aksesin në informacion. Në këtë deklaratë jepen parimet kryesore në lidhje me të drejtën e informimit

dhe rolin që luan kjo e drejtë në shoqëri; “si një kusht i nevojshëm për zhvillimin e shoqërisë”.

-Konventa e Aarhusit “Mbi të drejtën e publikut për informim, pjesëmarrje në vendimmarrje dhe të drejtën për t’iu drejtuar gjykatës, për çështje që lidhen me mjedisin”, e nënshkruar në Konferencën e Ministrave të Mjedisit, të mbajtur në 25 Qershor 1998, në Aarhus, Danimarkë, nga tridhjetë e pesë shtete europiane dhe Bashkimi Evropian. Rëndësi të veçantë merr angazhimi dhe detyrimi që u lind palëve nënshkruese për respektimin e të drejtës së informimit ndaj publikut, në çështjet mjedisore.

-Karta e të Drejtave të Njeriut të vendeve të Bashkimit Evropian, e miratuar në Samitin e Nisës në dhjetor 2000, është teksti i parë zyrtar në botë në fushën e të drejtave të njeriut që sanksionoi zyrtarisht të drejtën e miradministrimit, si të drejtë themelore të njeriut. Përcaktimi në këtë Kartë i të drejtës së miradministrimit (neni 41), të drejtës së aksesit në dokumentet zyrtare (neni 42), të Institucionit të Ombudsmanit (neni 43), janë një zhvillim i ri dhe i konsiderueshëm në zhvillimin e të drejtave të njeriut në gjirin e Komunitetit Evropian.

-Kodi Evropian i Sjelljes së Mirë Administrative, i miratuar nga ana e Parlamentit Evropian në 6 Shtator 2001, qëllim shpjegimin në detaj të Kartës Themelore të të Drejtave të Njeriut të Bashkimit Evropian, dhe më konkretisht të së drejtës për miradministrim dhe se çfarë kupton kjo e drejtë në praktikë. Një pjesë të rëndësishme të përcaktimeve të dhëna në këtë Kod, zë trajtimi i të drejtës për informim, si një e drejtë solidare me të drejtën e miradministrimit.

-Rekomandimi 2002 (2) i Këshillit të Evropës për Aksesin në Dokumentet Zyrtare. Rekomandimi e specifikon të drejtën e informimit, duke u përqendruar tek e drejta e aksesit në dokumentat zyrtare. Parimi i përgjithshëm i dhënë në këtë rekomandim është se, shtetet anëtare duhet të garantojnë të drejtën e të gjithëve për të patur akses, sipas kërkesës, në dokumentat zyrtare që mbahen prej autoriteteve publike.

-Konventa e Këshillit të Evropës “Për aksesin në dokumentet zyrtare”, Tromso, e adoptuar në mbledhjen e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës, më 27.11.2008, krijon detyrime informative edhe për subjekte, si organet legjislative, autoritetet gjyqësore, apo edhe për personat fizikë apo juridikë, për aq sa ata kryejnë funksione publike, apo kur operojnë në fonde publike, në përputhje me legjislacionin vendas.

Në kuadër të legjislacionit të brendshëm, regjimi juridik i së drejtës për informim njih dy ligje kryesore, Ligjin Nr.8503, datë 30.06.1999 “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”, si dhe Kodin e Procedurave Administrative, të miratuar me Ligjin nr. 8485, datë 12.05.1999, i cili e parashikon të drejtën e informimit, si një nga parimet bazë të funksionimit të Administratës Publike.

Gjatë vitit 2013, institucioni i Avokatit të Popullit, ka marrë në shqyrtim 54 ankesa për shkelje të pretenduara të së drejtës për informim. Nga numri i ankesave të marra në total, 18 janë ende në shqyrtim, ndërsa për 37 të tjera ka përfunduar shqyrtimi. Në numrin e ankesave të shqyrtuara, 2 prej tyre janë jashtë kompetencës, 19 ankesa të zgjidhura pozitivisht dhe 15 ankesa të pabazuara. Ankesat e marra në shqyrtim lidhen me

mosrespektimin dhe garantimin e së drejtës për informim gjatë veprimtarisë së organeve të administratës publike, përkatësisht organeve të pushtetit qendror, njësisive të qeverisjes vendor, të enteve publike, si dhe të personave juridikë që ofrojnë shërbime publike.

Analizë e rasteve konkrete

Në ankesën me **nr. 201301736 Doc**, shtetësja R.C ka shprehur shqetësimin për shkelje të së drejtës së informimit ndaj disa kërkesave të ligjshme, për dhënien e dokumentacionit origjinal të lirimit nga detyra, të paraqitura prej saj nga ana e ish-SUQU-së Tiranë, me qëllim paraqitjen e tyre si provë për fillimin e shqyrtimit të kësaj çështjeje në rrugë gjyqësore. Me marrjen në shqyrtim të kësaj çështjeje nga institucioni ynë kemi kërkuar shpjegime nga ana e ish SUQU lidhur me trajtimin e saj. Pas analizës ligjore të çështjes kemi arritur në përfundimin se efektivisht ka ndodhur shkelje e së drejtës për informim ndaj ankueses, ndaj edhe nga ana jonë është rekomanduar marrja e masave për respektimin dhe zbatimin e drejtës për informim ndaj shtetases R.C. Në përgjigje të rekomandimit tonë nga ana e Drejtorit të Spitalit Universitar të Traumës, (ish-Spitalit Ushtarak Qendror Universitar), janë dërguar kopjet autentike të dokumentacionit zyrtar të kërkuar, duke zgjidhur kështu pozitivisht këtë ankesë, pas dërgimit të kësaj kopjeje ankueses.

Në ankesën me **nr. 201300623 Doc**, shtetësja L.I, ka shprehur shqetësimin për shkeljen e së drejtës për informim nga ana e INSTAT Tiranë, sa i përket mosvënies në dispozicion të saj, të dokumentacionit përkatës për plotësimin e procedurave për përfitimin e së drejtës për pension.

Pas marrjes në shqyrtim të çështjes janë kërkuar shpjegime nga ana e këtij institucioni mbi trajtimin e saj dhe më konkretisht, sa i përket refuzimit për vënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar nga ana e ankueses.

Në përgjigjen e dhënë nga ana e INSTAT mbi këtë ankesë, jemi informuar se në përmbushje të kërkesës së ankueses është nënshkruar dokumentacioni i kërkuar dhe i është vënë në dispozicion asaj, me qëllim përmbushjen e procedurave për pension. Duke marrë edhe konfirmimin e ankueses për këtë zhvillim kemi ndërprerë shqyrtimin e kësaj ankese, tashmë të zgjidhur pozitivisht.

Konkluzione

Sikurse edhe në vitin 2012, problematika e ndeshur gjatë shqyrtimit të çështjeve që lidhen me këtë të drejtë, ka evidentuar probleme që lidhen me përmbajtjen e dispozitave të ligjit "Për të drejtën e informimit me dokumentet zyrtare", si dhe me zbatimin konkret dhe njohjen e tyre. Moszbatimi, ose zbatimi jo korrekt i dispozitave ligjore që njohin dhe garantojnë të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare nga Administrata Publike, janë ende çështjet kryesore në këtë fushë, të cilat lidhen me mangësitë e njohurive të nevojshme mbi këtë ligj nga Administrata Publike, si dhe me mangësitë që hasen në vetë dispozitat e ligjit.

Edhe këtë vit theksojmë edhe njëherë faktin se, mbetet imediate, nevoja për përmirësime në Ligjin “Për të drejtën e informimit me dokumentet zyrtare”. Pavarësisht kërkesave tona të vazhdueshme për këtë qëllim ende nuk ka filluar ky proces i rëndësishëm, i cili rekomandohet me forcë edhe në një raport të posaçëm që institucioni i Avokatit të Popullit ka përgatitur për Kuvendin e Shqipërisë mbi të drejtën për informim, në vitin 2013, raport i cili do të dërgohet pas konsultimit me shoqërinë civile në vitin 2014. Në këto rrethana risjellim në vëmendje konstatimet dhe rekomandimet e përmendura në raportet vjetore të institucionit të Avokatit të Popullit në vitet e mëparshme:

“Institucioni i Avokatit të Popullit në pozicionin e kujdestarit të respektimit të së drejtës për informim, ka arritur në konkluzionin se, funksionimi i regjimit të informimit publik në vend vazhdon të ketë probleme të dukshme, arsye e cila, nxjerr nevojën e ndryshimeve dhe përmirësimeve në Ligjin “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”.

Ndryshimet e mundshme të ligjit duhet të konsistojnë në:

- *Zgjerimin e rrethit të subjekteve që kanë detyrim, dhënien e informacionit, duke përfshirë personat fizikë, ose juridikë që përmbushin funksione publike, ose administrative (p.sh. kompanitë private që kanë monopole, ose koncesione për furnizimin me ujë, energji elektrike etj).*
- *Shtesën e kriterëve përjashtimore, që lidhet me parashikimin e një liste shteruese të kriterëve për mosdhënien e informacionit. Ky kriter shihet veçanërisht i nevojshëm në rastet e kërkesave të përsëritura, për të cilat është dhënë një shpjegim i plotë dhe përfundimtar.*
- *Rishikimin e afateve për dhënien e informacionit. Këto afate duhet të jenë më të shkurtra dhe të unifikuara në afatin kohor që, përcaktohet për refuzimin, apo për përmbushjen e kërkesës për informim.*
- *Detyrimin për të orientuar kërkuesin të identifikojë dokumentet që kërkon, pasi administrata ka njohuri më të plota se çfarë dokumentesh zyrtare mban ajo, ose që, për sa të jetë e mundur, orientimin e kërkuesit tek subjekti kompetent që, duhet të japë informacionin e kërkuar sipas ligjit.*
- *Parashikimin shprehimisht në lehtësirat për formën e dhënies së informacionit, në rastet kur ato kërkohen nga personat me aftësi të kufizuara. Një parashikim që duhet shtuar është që, kërkuesit i jepen dokumentet në formatin e preferuar prej tij, duke përfshirë dhe formatin elektronik, përveçse kur kjo paraqet vështirësi teknike të konsiderueshme.*
- *Koston e pagesave për dhënien e informacionit, për të shmangur vendosjen e tarifave tepër të larta dhe abuzive, që efektivisht do të shërbenin si pengesë për realizimin e të drejtës për informim.*
- *Në caktimin konkret të sanksioneve dhe të dëmshpërblimit. Sanksionet për shkelje të dispozitave të ligjit “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”, nuk janë të përcaktuara shprehimisht. Ndërkohë, lidhur me shpërblimin e dëmit, veç një parashikimi të përgjithshëm të dhënë në ligj, nuk ka rregullime specifike që, do të mundësonin zhdëmtimin real në rastet kur vërtetohet një gjë e tillë.*

Zhvillime paralele

Përprojekjet për përmirësimin e regjimit juridik të së drejtës për informim janë zhvillime pozitive që i shërbejnë interesit publik. Por duhet patur parasysh se ato duhet të ruajnë dhe balancojnë disa vlera të shtetit të së drejtës. Nuk mund të thuhet në vlerësimin tonë se, një balancë e tillë është ruajtur në procesin e përgatitjes dhe përmbajtjen e dy projektligjeve, përkatësisht “Për të drejtën e informimit” dhe “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr.9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të prezantuara gjatë vitit 2013 nga Ministri i Drejtësisë.

Efektivisht draftimi dhe konsultimi për këto drafte ligjesh nuk përfshiu institucionin e Avokatit të Popullit, si aktorin kryesor në këtë fushë. *Në korrespondencën zyrtare që kemi mbajtur me Ministrin e Drejtësisë për këtë qëllim kemi theksuar se, mospërfshirja e Avokatit të Popullit në diskutimet për draftimin e një sërë projektligjesh, të cilët rregullojnë regjimin juridik të të drejtave të njeriut të parashikuara shprehimisht në Kushtetutë, përbën shkelje të parimit të luajalitetit kushtetues.*

Veç kësaj, mospërfshirja e Avokatit të Popullit në procesin e draftimit të projektligjit “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”, bie ndesh dhe shkel edhe rekomandimet e BE-së mbi rolin dhe detyrat e Avokatit të Popullit, si dhe përbën injorim të një urdhri të qartë të Kryeministrit, lidhur me përfshirjen e Avokatit të Popullit në procesin e draftimit të ndryshimeve ligjore, veçanërisht në fushën e të drejtave të njeriut.

Një problem i dukshëm në projektligjin “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare” është rënia e nivelit të mbrojtjes së të drejtës nga niveli i një institucioni me qëndrueshmëri më të lartë si Avokati i Popullit, i parashikuar shprehimisht në Kushtetutë, në nivelin e institucioneve të pavarura të krijuara me ligj.

Në projektligjet e propozuara, krijohet një organ i ri i administratës publike, i cili nuk ka një ligj të mirëfilltë specifik organik, por një përzierje kompetencash që të “përplasim” sa në një ligj në një tjetër, pa qartësuar mënyrën se si krijohet organi dhe cili është objekti i tij bazik i aktivitetit.

Mbrojtja e së drejtës për informim është e lidhur pazgjidhshëmrisht me kompetencën e Avokatit të Popullit, për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut në vend, ndërkohë që hartuesit e këtyre dy projektligjeve nuk kuptojnë faktin se, veprimtaria e përditshme e Avokatit të Popullit, në thelb është realizim vital i së drejtës për informim.

Propozimi i projektligjeve tenton heqjen e kompetencave të Avokatit të Popullit, duke synuar kështu në mënyrë të drejtpërdrejtë dobësimin e këtij Institucioni Kushtetues. Heqja e kompetencave njëkohësisht prish balancat kushtetuese dhe deformon qëllimin e mekanizmave të krijuara nga Kushtetuta, veçanërisht, rolin e Avokatit të Popullit si një garanci juridiksionale për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore, që realizohet përmes parashikimit të këtij Institucioni, si një nga subjektet kushtetuese që legjitimohen t’i drejtohen Gjykatës Kushtetuese në respekt të nenit 134, të Kushtetutës. Kalimi i kompetencës një institucioni tjetër të krijuar me ligj krijon pengesa serioze për Avokatin e Popullit, për t’iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese dhe, për rrjedhojë, çënon misionin e këtij Institucioni Kushtetues për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore, haptazi në shkelje të Kushtetutës.

Tentativa për të pakësuar kompetencat e Avokatit të Popullit dhe për t'ia kaluar ato institucioneve të krijuara "në nxitim e sipër", përveç se është denigruese për punën dhe aktivitetin profesional dhe të mirëvlerësuar të Avokatit të Popullit është gjithashtu, një tendencë e kundërt me trendin evropian, i cili synon që kompetencat e së njëjtës fushë të shpërndara midis institucioneve të ndryshme, t'ia kthejë dhe t'ia japë një institucioni të vetëm.

Në këto kushte mendojmë se, draftimi dhe miratimi i legjislacionit të ri për mbrojtjen dhe respektimin e të drejtës për informim, duhet në radhë të parë të përfshijë sa më shumë aktorë dhe faktorë të rëndësishëm që i japin kuptim kësaj të drejte, ku padyshim Avokati i Popullit zë një vend primar. Ndryshimet dhe përmirësimet e pritshme dhe të nevojshme të këtij legjislacioni duhet të forcojnë më tej kompetencat dhe rolin që institucioni i Avokatit të Popullit luan natyrshëm në këtë fushë.

B. Kufizime të lirisë së personit

Veprimtaria e Policisë së Shtetit

Vështrim i përgjithshëm

Institucioni i Avokatit të Popullit gjatë ushtrimit të detyrës në trajtimin e ankesave të qytetarëve ndaj organit të Policisë, duke respektuar dispozitat kushtetuese dhe ligjore ka treguar kujdes në moscënimin e pavarësisë institucionale. Po ashtu, ankesat e qytetarëve janë parë e vlerësuar dhe në fokusin e vështirësisë së punës së punonjësit të policisë, i cili është në kontaktin e parë që ndeshet me veprimtarinë kriminale. Nga ana tjetër, gjatë trajtimit të ankesave, është kërkuar që respektimi i shtetit ligjor të aplikohet në të njëjtën mënyrë si ndaj çdo qytetari ashtu dhe ndaj policisë. Këto ankesa janë trajtuar nga Seksioni i Veçantë i Institucionit të Avokatit të Popullit.

Gjatë vitit 2013, në Institucionin e Avokatit të Popullit janë marrë në shqyrtim 212 ankesë/kërkesa të qytetarëve, për veprime dhe mosveprime të paligjshme të punonjësve të Policisë së Shtetit, nga të cilat janë përfunduar 165 dhe janë ende për shqyrtim 47 ankesa. Në ankesat e përfunduara, 71 ankesa kanë qenë të pabazuara, 9 ankesa jashtë juridiksionit, 29 ankesa jashtë kompetence, 5 ankesa me heqje dorë prej ankuesit, dhe 51 ankesa të zgjidhura në favor të ankuesit. Janë filluar me inisiativë 25 raste për të cilat është urdhëruar kryerja e një hetimi të pavarur administrativ, si dhe janë kryer 7 Inspektive në Komisariate dhe Stacione Policore.

Gjatë këtij viti janë bërë 22 rekomandime nga të cilat 10 kanë qenë për marrjen e masave disiplinore ndaj punonjësve të policisë që kanë kryer shkeljet. E përmendim këtë fakt pasi nuk mund të ketë asnjë përpjekje për të fshehur, falur apo justifikuar ushtrimin e paligjshëm të fuqive shtrënguese nga ana e një punonjësi policie. Etika policore dhe respektimi i standardeve profesionale duhet të shërbejnë për të siguruar se, dhënia e shërbimeve të policisë është e cilësisë më të lartë.

Analizë e rasteve konkrete

Problematikat e rasteve të trajtuara gjatë vitit 2013 konsiston në:

Së pari: Në keqtrajtimin dhe kryerjen e veprimeve të dhunshme ndaj qytetarëve, apo dhe gjatë shoqërimit të tyre në mjediset e Policisë.

E tillë është ankesa me nr.201302676, filluar me inisiativën e Avokati i Popullit, pas bërjes publike në media për keqtrajtimin e disa të rinjve, nga dy punonjës të Komisarariatit të Policisë nr.2 Tiranë. Pas hetimit administrativ u arrit në përfundimin se punonjësit e policisë B.L. dhe A.D., kishin ushtruar dhunë fizike ndaj shtetasve D.S, A.B. dhe D.K. Për rrjedhojë i kemi rekomanduar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë “Fillimin e hetimit për veprën penale të “Kryerjes së veprimeve arbitrare” ndaj punonjësve të policisë”. Rekomandimi është pranuar dhe Prokuroria ka filluar hetimet e procedimit penal.

Në ankesën me nr.201301400 shtetasi E.V. nga Korça, ka ngritur shqetësimin se pas shoqërimit në mjediset e Komisarariatit të Policisë është keqtrajtuar nga punonjësi i Drejtorisë së Policisë së Qarkut E.S. Mbi shqetësimin e këtij shtetasi është urdhëruar kryerja e një hetimi të pavarur administrativ në vënd, dhe në përfundim të tij, i kemi rekomanduar Policisë “Analizën e rastit për kryerje të

veprimeve të paligjshme dhe fillimin e procedimit disiplinor ndaj punonjësit të policisë E.S.". Rekomandimi është pranuar dhe ndaj punonjësit të policisë, është marrë masë disiplinore.

Në ankesën me nr.201301455, shtetasi P.B. nga Tirana ankohej ndaj punonjësve të Komisarariatit të Policisë Nr.2 Tiranë, të cilët gjatë marrjes në mjetin e policisë i kanë vendosur prangat në duar, përdorur fjalë fyese dhe qëlluar me grushte nga fytyra e pjesë të ndryshme të trupit. Edhe në këtë rast, është kryer hetimi i pavarur administrativ dhe në përfundim të tij, i kemi rekomanduar Policisë *"Marrjen e masave për respektimin e dispozitave ligjore për shoqërimin e shtetasve si dhe dhënien e masës disiplinore ndaj punonjësve të policisë, që kanë kryer veprimet e kundërligjshme"*. Rekomandimi është pranuar dhe janë marrë masat disiplinore ndaj punonjësve të policisë që kishin kryer shkeljet.

Në ankesën me nr.201300598, shtetasi R.N. nga Tirana ka ngritur shqetësimin se gjatë vitit 2013, në disa raste është shoqëruar në mënyrë të paligjshme nga punonjësit e Komisarariatit të Policisë nr.4, për çdo problem që ndodhte në lagje, pasi ishte person i dënuar, ndonëse e kishte shlyer dënimin. Mbi këtë shqetësim, i kemi rekomanduar Policisë *"Respektimin rigoroz të kriterëve ligjore për shoqërimin e shtetasve në mjediset e Policisë"*. Rekomandimi është pa përgjigje.

Për rastin me nr.201300979 të bërë publik në media, lidhur me vetëvarjen e shtetasit N.G. në ambientet e Komisarariatit të Policisë nr. 3 Tiranë, pas kryerjes së hetimit të pavarur administrativ i kemi rekomanduar Policisë *"Analizën e ngjarjes, marrjen e masave të menjëhershme për ndërtimin e dhomave të shoqërimit si dhe organizimin e kontrolleve nga strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë në organet e policisë vendore"*. Rekomandimi është vlerësuar dhe është pranuar.

Së dyti: Në mosrespektimin e dispozitave ligjore për rastet e shoqërimit të shtetasve.

I tillë është rasti i ankesës me nr.201300226 i shtetasit GJ.P. nga Shkodra, i cili ishte shoqëruar në Komisarariatit të Policisë për 2 orë, pasi sipas Policisë ishte person i dyshuar për një shqetësim, tek dera e ndërtesës tek një mision fetar, ndonëse sipas përgjigjes së policisë, *"pas verifikimeve të kryera ky person nuk kishte konsumuar elementët e figurës së ndonjë vepra penale"*.

Në ankesën me nr.201301625 shtetasi A.Q. nga Tirana, ankohej ndaj punonjësve të Komisarariatit të Policisë nr.2 për shoqërim të paligjshëm për 5 orë në mjediset e atij Komisarariatit, ndonëse i kishin marrë deklaratime, lidhur me vjedhjen e një lokali "Fast Food", pronarin e të cilit e kishte kushëririn e tij.

Në ankesën me nr.201301547, shtetasja F.H. nga Paskuqani i Tiranës, ankohej ndaj punonjësve të Komisarariatit të Policisë nr.5 për shoqërim të paligjshëm për 7 orë, për një konflikt pronësie që kishte bashkëshorti M.H. me vëllanë e tij XH.H. Në përgjigjen dërguar Institucionit të Avokatit të Popullit jemi informuar se ankuesja është pyetur me cilësinë e "personit që ka dijeni për rrethana të hetimit", pasi ishte filluar procedimi penal për vepra penale të "Kanosjes" dhe "Vetëgjyqësisë".

Ndërsa në ankesën me nr.201301253, shtetasi XH.S. nga Kruja, ankohej ndaj punonjësve të policisë së Komisarariatit Krujë, për mbajtje padrejtësisht si person të shoqëruar për 10 orë, pasi gjatë zhvillimit të seancës gjyqësore për procedimin penal në ngarkim të tij, akuzuar për veprën penale “Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor”, pas konfliktit që ka pasur me familjarët e dëshmitarëve të akuzës, është urdhëruar nga kryetarja e seancës për largimin e tij nga salla e gjyqit. Veprimi i Policisë bie ndesh me nenin 341 të Kodit të Procedurës Penale, çka do të thotë se Policia duhet të zbatonte urdhrin e kryetarit të seancës, duke larguar personin nga salla dhe jo për ta shoqëruar atë në mjediset e Policisë.

Nga analiza e rasteve të trajtuara më sipër, konstatohet se janë shoqëruar në polici persona jashtë kriterëve ligjore të përcaktuara në nenet 11/6, 101/1/ “a” dhe “b” dhe 106 të ligjit nr. 9749, dt. 04.06.2007 “Për Policinë e Shtetit”. Vazhdohet të trajtohen si të shoqëruar persona që kanë kryer, apo dyshohen se kanë kryer vepra penale, për shkak të konflikteve midis tyre, për prishje rendi, për rrahje etj, megjithëse këta persona kanë qenë të identifikuar.

Për rastet kur nga ana e Policisë thirren persona nga të cilët lind nevoja e marrjes së një informacioni, për marrjen e deklarimeve nga Policia Gjyqësore, apo për arsye të tjera pune thirren apo kërkojnë të takohen me drejtues të organit, trajtimi i tyre duhet të bëhet si persona të thirrur dhe kjo të pasqyrohet në një libër më vete, i cili duhet të pasqyrojë hyrjen dhe daljen e personave nga Komisarati i Policisë. Në këto raste, nga ana e punonjësve të policisë duhet të aplikohet e drejta ligjore për “njoftim për paraqitje në polici”, e parashikuar në nenin 100 të ligjit “Për Policinë e Shtetit” dhe jo të bëhet shoqërimi i tyre në organin e Policisë.

Personat e mësipërm mund të thirren nga punonjësi i policisë me urdhër apo fletë thirrje, duke respektuar kërkesat e nenit 312 të Kodit të Procedurës Penale dhe paralajmëruar për shoqërim të detyrueshëm në rast mosparaqitje, pa pasur pengesë të ligjshme.

Vërehet se të shoqëruarve, ju bëhet kontrolli personal dhe merren sendet personale si, aparati celular etj. Ky veprim vjen në kundërshtim me nenin 106, pika 3 të ligjit nr.9749, dt.04.06.2007, “Për Policinë e Shtetit”, në të cilin është parashikuar se: *“Punonjësi i policisë bën kontrollin dhe këqyrjen fizike, me qëllim marrjen e masave mbrojtëse ndaj personave të sëmurë mendorë, të dehurve, të droguarve, ose ndaj personave me sëmundje ngjithëse”*.

Së treti: Në mosvlerësimin me seriozitet apo mosmarrjen e kallëzimeve penale të qytetarëve.

I tillë është rasti me nr.201301552 i ankesës së shtetasit M.O. nga Levani i Fierit, anëtar i Komunitetit Rom, për mosmarrje të kallëzimit penal ndaj shtetasit A.Ç.(djali i kryetarit të një Komune në rrethin e Fierit) për kanosje ndaj djalit të tij I.O., pas një aksidenti automobilistik të ndodhur disa ditë më pare. Shqetësimi i është paraqitur punonjësve të Avokatit të Popullit gjatë kohës që ata që ishin duke marrë ankesa në Komunitetin Rom të Levanit. Menjëherë është ndërhyrë pranë Drejtorit të Policisë së Qarkut Fier, dhe për rrjedhojë situata është vlerësuar, shtetasit i është marrë kallëzim penal dhe materialet hetimore procedurale i kanë kaluar për ndjekje Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Fier.

Në ankesën me nr.201204045, shtetasit E.TH., me detyrë Kryetar i Komunës Liqenas në rrethin e Korçës, ankohej se përfaqësues të Aleancës “Kuç e Zi” Tiranë, kishin dëmtuar sinjalistikën rrugore dhe tabelën e Qendrës Shëndetësore, nën pretekstin se tabelat informuese ishin vetëm në gjuhën maqedonase, si dhe kishin kërcënuar banorët e komunitetit maqedonas. Pas njoftimit të Policisë, nga kjo e fundit nuk është vlerësuar kallëzimi penal. Mbi këtë shqetësim është shkuar në vënd, ku dhe janë kryer verifikimet e nevojshme në Komunë dhe Komisariatit të Policisë. Në përfundim të hetimit, më datën 12.03.2013, i kemi rekomanduar Policisë *“Marrjen e masave për vlerësimin e kallëzimeve të shtetasve, apo njoftimeve për vepra penale, me qëllim dokumentimin dhe kryerjen e veprimeve procedurale nga policia gjyqësore e Policisë së Shtetit”*. Rekomandimi është marrë në shqyrtim, por nuk është pranuar.

Në raste të tjera si, ankesa me nr.201302248 e shtetasit H.K. nga Patosi, ankesa me nr.201301809 e shtetasit P.K. nga Berati, ankesa me nr.201301011 e shtetasi R.H. nga Tirana ndaj kunatës së tij V.H., qytetarët janë paraqitur për të bërë kallëzime penale në Komisariatet e Policisë sidomos për konflikte pronësie, apo dhe vepra penale të tilla si, “fyerje”, “rrahje”, por ato nuk u janë marrë. Pas shqyrtimit të rasteve qytetarët i kemi njohur me dispozitat e neneve 59 e në vijim të Kodit të Procedurës Penale, për paraqitjen e kërkesës së tyre në gjykatë, në cilësinë e të “dëmtuarit akuzues”.

Nga ana e punonjësve të policisë janë marrë dhe kallëzime qytetarëve, për veprat e mësipërme, të cilat sipas nenit 59 të Kodit të Procedurës Penale “I dëmtuari akuzues”, ata vetë duhet t’i drejtohen gjykatës me kërkesë, duke marrë pjesë në gjykim për të provuar akuzën dhe kërkuar shpërblimin e dëmit të shkaktuar. Pas marrjes së kallëzimeve për këto vepra penale, materialet procedurale i janë përcjellë Prokurorisë e cila ka vendosur mosfillimin e procedimit penal. Nga ai moment qytetarët, sa për mossqarim nga Policia e mandej mosnjoftim nga organi i Prokurorisë, janë ankuar në Institucionin e Avokatit të Popullit, për mosvlerësim apo mosdijeni për mënyrën e zgjidhjes së kallëzimeve të tyre. Lidhur me këto ankesa nga ana e jonë, qytetarët janë informuar për rrugën ligjore që duhet të ndjekin.

Së katërtri: Në kryerjen e veprimeve të tjera të kundraligjshme ndaj qytetarëve, që lidhen me etikën policore në komunitet apo dhe në mjediset e zyrave të Policisë, në mosparaqitjen e dokumentit të identifikimit policor në terren, etj.

Në ankesën me nr. 201302869, filluar me iniciativën e Avokatit të Popullit, shtetasi B.A., anëtar i Komunitetit Rom banues në lagjen “Drizë” të Fierit, është ankuar ndaj punonjësve të policisë të cilët, mbi bazën e një plani operacional për kapjen e një personi në kërkim, kanë shkuar në banesën e tij pa uniformë policie me kapuçë dhe pa u identifikuar, duke manifestuar sjellje jo korrekte ndaj tij dhe pjesëtarëve të tjerë të familjes.

Nga hetimi i pavarur administrativ lidhur me ankesën me nr.201301400 të shtetasit E.V. nga Korça, u konstatua se gjatë një konflikti të ndodhur, pas shkuarjes së patrullës së përgjithshme të policisë, punonjësi i policisë E.S. pa uniformë policie, kishte ndërhyrë në këtë konflikt pa paraqitur dokumentin e identifikimit policor.

Veprimet e mësipërme të punonjësve të policisë vijnë ndesh me nenin 6 të Vendimit të K.M. nr.786 datë 04.06.2008, "Për miratimin e rregullores së disiplinës së Policisë së Shtetit", i cili bën fjalë për Detyrimet dhe Normat e Sjelljes gjatë detyrës/shërbimit dhe konkretisht pikën 4 të tij ku thuhet: *"Të identifikohet në çdo rast të kryerjes së shërbimit/detyrës, kur i kërkohet nëpërmjet paraqitjes së dokumentit të identifikimit policor, me përjashtim të rasteve kur është përcaktuar ndryshe, në kryerjen e shërbimeve/detyrave të veçanta"*.

Në rastin me nr.201301541, filluar me iniciativën e Avokatit të Popullit, pas hetimit administrativ, i kemi rekomanduar Policisë *"Marrjen e masave administrative dhe organizative si dhe fillimin e procedimit disiplinor ndaj punonjësve të Drejtorisë së Policisë së Qarkut Kukës F.H dhe A.D"*., pasi gjatë marrjes së deklarimeve së shtetasës A.Ç. në një nga zyrat e katit të tretë të asaj Drejtorie, nuk kishin krijuar kushte normale, e për rrjedhojë shtetasja është hedhur nga dritarja e zyrës, me pasoja në dëmtimin e shëndetit të saj. Rekomandimi është pranuar dhe ndaj personave përgjegjës janë marrë masa disiplinore.

Avokati i Popullit ka marrë në shqyrtim me iniciativë dhe rastin nr.201301398, për ngjarjen e ndodhur gjatë inagurimit të tunelit të Kërrabës, kur punonjës të Gardës së Republikës kanë ushtruar dhunë psikologjike ndaj operatorit E.Ç. të emisionit "Fiks Fare" në televizionin Top-Channel. Në përfundim të hetimit, i kemi rekomanduar Gardës së Republikës *"Analizën e rastit, fillimin e procedimit disiplinor dhe marrjen e masave ndaj punonjësve të Gardës që kanë kryer shkeljet"*. Rekomandimi është marrë në shqyrtim dhe rasti është analizuar, por nuk është marrë asnjë masë disiplinore ndaj personave përgjegjës.

Mbi ankesën e shtetasit E.B. nga Tirana, Avokati i Popullit ka marrë në shqyrtim rastin me nr.201302608, e cila ankohej ndaj punonjësve të Komisarariatit të Policisë Vlorë, për pengim të banorëve për të hyrë në mjediset e pallatit në kompleksin "Jon Resort" pranë Ujit të Ftohtë Vlorë, si dhe vendosjen e shiritave bllokues me mbishkrimin *"Skenë krimi, nuk lejohet kalimi"*. Në përfundim të hetimit administrativ i kemi rekomanduar Policisë *"Marrjen e masave me qëllim ndërprerjen e veprimeve të pabazuara në ligj, të cilat çenojnë të drejtat e qytetarëve të pallatit"*. Rekomandimi është pa përgjigje nga Policia.

Në ankesën me nr.201301862, shtetasja M.K. nga Tirana, ankohej ndaj punonjësve të Komisarariatit të Policisë Nr.6 Tiranë, për kontroll banese pa praninë e familjarëve. Sipas informacionit të Policisë, për këtë rast punonjësit e policisë ishin duke kërkuar e ndjekur bashkëshortin e ankueses shtetasin A.K., ndaj të cilit organi i Prokurorisë kishte filluar procedimin penal për veprën penale të "Kanosjes" ndaj shtetasit S.B.

Së pesti: Në mosmarrjen e masave me qëllim parandalimin e veprave penale të dhunës në familje, apo mosvlerësimit e kallëzimeve për këto raste.

Avokati i Popullit e ka konsideruar dhunën në familje si një fenomen shqetësues të përhapur sidomos kohët e fundit, i cili është problem i gjithë shoqërisë,

kurse detyra dhe misioni i Policisë duhet të jetë marrja e masave efikase për parandalimin e tij, nëpërmjet punës së punonjësit të policisë në komunitet dhe në bashkëpunim me aktorët e tjerë, shoqërinë civile etj.

Të tilla janë rastet e ankesave me nr.201301580 dhe 201301582, filluar me iniciativën e Avokatit të Popullit, pas bërjes publike në median e shkruar lidhur me vrasjet e shtetaseve A.C. dhe V.Ç. Për këto raste, dhe raste të tjera të kësaj natyre ndodhur gjatë vitit 2013, pas të dhënave të dërguara nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit dhe Prokuroria e Përgjithshme është përgatitur materiali në formën e rekomandimit që do t'i drejtohet disa Institucioneve ligjzbatuese.

Në rastin me nr.201302146, filluar me iniciativën e Avokatit të Popullit mbi bazën e medias së shkruar, pas hetimit të pavarur administrativ dhe shkuarjes në vend, në Komunën Allkaj të Lushnjes, shtetasja M.D., persone me aftësi të kufizuara, u konstatua se ishte keqtrajtuar dhe lidhur nga duart e këmbët me tel, prej babait K.D. dhe vëllait E.D. Pas ngjarjes, e dëmtuara ka shkuar për të bërë kallëzim penal në Komisarjatin e Policisë Lushnje, por nga punonjësi i policisë L.P, nuk është bërë vlerësimi i kallëzimit si, dhe përpilimi i kërkesës për lëshimin e urdhrit të mbrojtjes, me qëllim për t'ja dërguar Gjykatës. Gjithashtu, punonjësi i policisë L.P. nuk ka përpiluar vendimin për kryerjen e ekspertimit mjeko ligjor të të dëmtuarës. Ai ka shkuar dhe ka marrë në fshatin Delisufaj të akuzuarit dhe në Komisarjatin e Policisë ka bërë ballafaqim verbal me të dëmtuarën M.D., duke i marrë një deklaratë në të cilën ajo është shprehur se *“ nuk kishte patur asnjë presion nga familja dhe se nuk kanë përdorur dhunë”*. Për qëndrime dhe veprime aspak serioze nga punonjësi i policisë i kemi rekomanduar Policisë *“Marrjen e masave të menjëhershme me qëllim zbatimin e procedurave, për vlerësimin e kallëzimit të shtetases M.D., përpilimin e kërkesës për lëshimin e “ Urdhrit të Mbrojtjes” dhe fillimin e procedimit disiplinor ndaj punonjësit të policisë”*. Rekomandimi është vlerësuar dhe nga Policia janë realizuar sugjerimet e Avokatit të Popullit, si dhe i është dhënë masë disiplinore personit përgjegjës.

Për të njëjtin shqetësim me Iniciativë është shqyrtuar rasti me nr.201301596, mbi dhunën e ushtruar nga bashkëshorti A.H. ndaj shtetases E.H. banuese në qytetin e Durrësit, ndonëse e dëmtuara nuk pranoi marrjen e deklarimeve nga Ndihmës Komisioneri i Avokatit të Popullit.

Shqyrtimi i ankesave të tjera të qytetarëve si, ankesa me nr.201301208 e shtetasit B.Ç. nga Tirana, i cili ankohej për bllokim të padrejtë të “ciklomotorrit”, nga Komisarjati i Policisë nr.1 Tiranë, pas një aksidenti pa pasoja, me një mjet autoveturë. Nga shqyrtimi i rastit dhe pas informacionit të marrë nga Policia, qytetari pasi plotësoi dokumentacionin e nevojshëm, ka marrë ciklomotorrin “Vespa” që e kishte në posedim.

Në ankesën me nr.201302042, shtetasi S.K. nga Libofsha e Fierit, ankohej ndaj Komisarjatisë të Policisë Fier, pasi prej vitit 2007, i kishin bllokuar dhe sekuestruar dy armë gjahu, të cilat i kishte me lejë nga organet kompetente. Pasi është kthyer nga Greqia pas disa viteve, qytetari ka kërkuar marrjen e armëve të gjahut për të cilat ishte premtuar se do t'ja kthenin, veprim i cili nuk është realizuar. Në përgjigjen drejtuar Institucionit të Avokatit të Popullit, Komisarjati i Policisë Fier, informon ndërmjet të tjerave për faktin se bllokimi i armëve qytetarit S.K. ishte bërë pasi djali i tij P.K ishte dënuar për krimin e

vrasjes, me burgim të përjetshëm dhe për rrjedhojë me vendim të Komisionit ankuesit S.K. i ishte hequr leja e armës së gjahut.

Me të njëjtin shqetësim është ankesa e shtetasit XH.K. nga Tirana, cili ankohej ndaj Komisarariatit të Policisë nr.3 Tiranë, për bllokim të një arme gjahu që e kishte me lejë. Pas trajtimit të ankesës, Komisarriati i Policisë nr.3 ka informuar se arma e gjahut ishte bllokuar pasi djali i tij A.K., kishte qëlluar me thikë një person nga Dibra dhe për rrjedhojë me vendim të Komisionit i është hequr leja për armë gjuetie, pasi djali përbënte rrezikshmëri shoqërore.

Vlen të theksohet fakti se gjatë vitit 2013, Institucioni i Avokatit të Popullit ka trajtuar me inisiativë apo mbi bazën e ankesës dhe rastet e Shoqatës së ish të Dënuarve Politikë nga Regjimi Komunist, apo dhe të Shoqatës së Serbëve të Shqipërisë, në këto drejtime:

a) *Për mosrespektim të dispozitave ligjore e proceduriale për rastet e shoqërimit në mjediset e Policisë.*

Të tilla janë ankesat me nr.201300989, 201300754, 201301182 të shtetasit S.T., ankesa me nr.201300912 e shtetasit P.L., ankesa me nr.201301012 e shtetasi F.M., ankesat me nr.201300350 dhe 201300989 të shtetasit F.LL. etj. Këto ankesa kanë konsistuar në shoqërimin e kryetarit dhe anëtarëve të Shoqatës së ish të Dënuarve Politikë me pa të drejtë, kryesisht në mjediset e Komisarariatit të policisë Nr.1 dhe Drejtorisë së Policisë të Qarkut Tiranë.

Mbi këto shqetësime i kemi rekomanduar Policisë *“Marrjen e masave për respektimin rigoroz të kriterëve ligjore për shoqërimin e shtetasve dhe ndërprerjen e menjëhershme të shoqërimit të kundërligjshëm ndaj grupit të personave, ish të dënuar politikë nga regjimi komunist si dhe marrjen e masave disiplinore ndaj punonjësve të policisë që kanë bërë shoqërimin e tyre në Polici”*

b) *Për mosrespektimin e dispozitave ligjore të ligjit “Për tubimet”.*

Në ankesat me nr.201300675, 201300834 dhe 201300989, kryetari i Shoqatës së ish të dënuarve politikë nga regjimi komunist S.T., ankohej ndaj Policisë për faktin se , vendimi për zhvillimin e tubimit paqësor ishte dhënë me vonesë dhe pas afatit të mbarimit të tubimit, apo në raste të tjera punonjësit e policisë jo vetëm që kishin penguar zhvillimin normal të tubimit paqësor, por dhe sjellja e tyre nuk ishte aspak etike dhe linte për të dëshiruar.

Mbi kërkesën e Shoqatës, nga punonjës të Institucionit të Avokatit të Popullit është realizuar dhe monitorimi i zhvillimit të tubimit paqësor datë 13 Maj 2013, pranë monumentit të Burgut të Spaçit, që ishte qëllimi e simbolika e tubimit. Por nga ana e Policisë, tubimi u lejua të zhvillohej tek trotuari para monumentit, veprim i cili nuk na u duk i drejtë për faktin se pengohej dhe lëvizja e lirë e njerëzve.

Mbi këtë shqetësim dhe raste të tjera për tubimet e organizuara nga Shoqata, i kemi rekomanduar Policisë *“Marrjen e masave me qëllim zbatimin dhe respektimin rigoroz të dispozitave të ligjit nr.8773, datë 23.04.2001 “Për Tubimet” si dhe dhënien e masave disiplinore ndaj punonjësve të policisë që kanë penguar zhvillimin normal të tubimit paqësor të Shoqatës”.*

Avokati i Popullit ka vlerësuar dhe trajtuar ankesën me nr.201301191 të Shoqatës së Serbëve të Shqipërisë “Jedinsvo” me seli në qytetin e Fierit, pasi në rrjetin social Facebook ishte bëri thirrje për organizimin e një proteste të paligjshme në qytetin e Fierit, më datën 25.05.2013, e cila do të përfundonte dhe me veprime të paligjshme. Mbi këtë shqetësim punonjës të Avokatit të Popullit kanë shkuar në Fier dhe kanë kontaktuar me drejtues të Shoqatës dhe Drejtorisë së Policisë së Qarkut, nga ku u konstatua se, Policia kishte marrë të gjitha masat e nevojshme me qëllim parandalimin e një situatë të padëshiruar, rezultat i të cilave dhe protesta nuk u zhvillua.

c)Për mbajtjen nën vëzhgim dhe në mënyrë të vazhdueshme të disa anëtarëve të Shoqatës së ish të burgosurve Politikë, duke cënuar lëvizjen e lirë të njerëzve sipas neni 38/1 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë.

Në ankesat me nr.201300567 etj, të shtetasit S.T.është ngritur shqetësimi se ai bashkë me shtetasit F.LL., P.L dhe B.V., ish të përndjekur të regjimit komunist dhe pjesëmarrës në grevën e urisë gjatë muajve Shtator-Tetor 2012, mbaheshin nën vëzhgim 24 orë nga punonjësit e policisë kriminale të Drejtorisë së Policisë së Qarkut Tiranë. Ky fakt është konfirmuar në tre raste dhe nga stafi i Institucionit të Avokatit të Popullit, në momentin që ankuesi me dy shokët e tij ishin paraqitur për të bërë ankesë lidhur me këtë shqetësim.

Për këtë problem i kemi rekomanduar Policisë *“Ndërprerjen e menjëhershme të veprimeve të kundërligjshme të punonjësve të Drejtorisë së Policisë së Qarkut Tiranë ndaj shtetasit S.T etj, ish të dënuar politikë të regjimit komunist”*. Nga ana e Drejtorisë së Policisë së Qarkut Tiranë, nuk ka pasur asnjë reagim pozitiv për zbatimin rekomandimit dhe në përgjigjen drejtuar Institucionit të Avokatit të Popullit, jemi informuar se *“ankuesit nuk mbahen në vëzhgim nga strukturat e Drejtorisë së Policisë së Qarkut Tiranë”*.

Pra, siç shihet Rekomandimet e Avokatit të Popullit për rastet e ankesave të Shoqatës së ish të Burgosurve Politikë ndonëse janë marrë në shqyrtim dhe analizë nga Policia, por prej saj nuk është marrë asnjë masë për ndërprerje të veprimeve të kundërligjshme apo masë disiplinore ndaj personave përgjegjës të shkeljeve.

Konkluzione

Policia e Shtetit vazhdon të ketë problematika që lidhen me shkeljen e të drejtave dhe lirive të qytetarëve si, cënimin e integritetit fizik, keqtrajtimi fizik e psikologjik gjatë kryerjes së veprimeve policore e procedurale dhe privim të lirisë personale prej shoqërimit në organet e policisë pa shkaqe ligjore.

Konstatohet, se në gjashtë mujorin e dytë të vitit 2013, ka një qëndrim më korrekt në vlerësimin me seriozitet për analizën e Rekomandimeve të Avokatit të Popullit si dhe zbatimin të sugjerimeve të tij, në marrjen e masave disiplinore ndaj punonjësve të policisë përgjegjës në kryerjen e shkeljeve.

Avokati i Popullit në trajtimin e ankesë/kërkesave të qytetarëve ndaj Policisë ka qenë i pavarur dhe objektiv duke synuar që në këtë mënyrë të rritet dhe besimi i publikut tek forcat e zbatimit të ligjit, kurse shërbimet policore duhet t'i përshtaten parimeve të demokracisë, llogari-dhënies, rritjes së performancës dhe respektimit të të drejtave të njeriut.

Veprimtaria e Avokatit të Popullit në lidhje me Forcat e Armatosura

Vështrim i përgjithshëm

Sipas nenit 4/2 të Ligjit Nr. 9171, date 22.01.2004 “Për Gradat dhe Karrierën Ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, ushtarakët e Forcave të Armatosura janë ushtarakë të shërbimit aktiv të përhershëm (të karrierës), të shërbimit aktiv të përkohshëm, të shërbimit aktiv të detyrueshëm, si dhe ushtarakë të rezervës.

Për arsye të karakterit të veçantë të detyrës dhe të shërbimit, pjesëtarët e Forcave të Armatosura (aktivë ose në rezervë) por edhe familjarë të tyre, mund të kenë disavantazhe krahasuar me qytetarë të tjerë. Ligji Nr. 9210, date 23.3.2004 “Për statusin e ushtarakut të FA në RSH”, ka parashikuar disa garanci për të zvogëluar këto disavantazhe.

Institucioni i Avokatit të Popullit, si një institucion kushtetues i pavarur luan një rol të rëndësishëm për të siguruar respektimin e këtyre garancive. Gjatë vitit 2013, janë trajtuar 17 ankesa nga subjekte që janë ushtarakë të shërbimit aktiv apo ushtarakë të dalë në rezervë, nga të cilat 10 raste janë përfunduar dhe 7 të tjera janë ende në shqyrtim. Nga rastet e përfunduara, 4 prej tyre kanë qenë të pabazuara në ligj, 2 kanë qenë jashtë kompetencës dhe 4 raste të bazuara në ligj, për të cilat është rekomanduar rivendosja në vend e të drejtës së shkelur.

Objekti i ankesave të paraqitura ka qenë kryesisht si më poshtë:

- Mosplotësim i dokumentacionit për vitet e punës të kryera në FA;
- Nxjerrje pa të drejtë në rezervë;
- Mosnjohje me urdhrin e daljes në rezervë;
- Mosnjohje me dokumenta të dosjes personale;
- Mosmbulim i shpenzimeve për shërbimin shëndetësor;
- Shkelje e të drejtës për të përparuar në gradë;
- Mosshlyerje e detyrimit financiar për lejen vjetore të pakryer, për rastin e vdekjes të familjarit dhe për kohën e kryerjes së specializimit jashtë vendit.

Analiza e rasteve konkrete

Një nga problemet e pazgjidhura të ushtarakëve është ai i rillogaritjes të gabuar të pensioneve. Disa ushtarakë kanë depozituar ankesa në institucionin e Avokatit të Popullit duke pretenduar se, nga ana e sigurimeve shoqërore po bëhet rillogaritja e pensionit, me efekte negative në kundërshtim me kërkesat e Vendimit nr.33 datë 24.06.2010, të Gjykatës Kushtetuese. Kjo problematikë ka ardhur me hyrjen në fuqi të Ligjit nr.10142 datë 15.05.2009 “Për sigurimin shoqëror suplementar të Ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të Punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit e të Punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë”.

Sipas nenit 29/2 të këtij ligji, është bërë rillogaritja e masës së pensioneve duke sjellë uljen e tij në mënyrë drastike. Duke e konsideruar këtë ndryshim të masës së pensionit si cënim të të drejtave të ligjshme të fituara, në muajin Janar 2012, i kemi rekomanduar Ministrin të Financave, rregullimin ligjor të nenit 29 të Ligjit nr.10142, datë 15.05.2009. Megjithëse rekomandimi nuk ka marrë një përgjigje pozitive, Institucioni i Avokatit të Popullit është i vendosur të përsërisë kërkesën e tij deri në zgjidhjen e problemit.

Në ankesat e shqyrtuara nga Zyra e Avokatit të Popullit për vitin 2013, përkatësisht me nr. 201301426, nr. 201301842 dhe nr. 201302108, ushtarakët P.K., E.A. dhe N.N., kanë pretenduar se ju ishte cënuar e drejta e tyre për të përparuar në gradë dhe për t'u kualifikuar në Kursin e Lartë të Oficerit, për shkak të paligjshmërisë të Urdhrit Nr.621, datë 03.04.2013 *"Rregullore për funksionimin, detyrat dhe të drejtat e Komisionit të Lartë dhe Komisioneve të Zakonshme të Karrierës në FARSH"*, si dhe shkeljeve procedurale në procesin e vlerësimit. Në përfundim të hetimit rezultoi se Urdhri i lartpërmendur ishte relativisht i pavlefshëm dhe kishte pasur shkelje procedurale për tre ushtarakët ankues. Për rrjedhojë iu rekomandua Ministrisë së Mbrojtjes, *"Ndryshimi i Rregullores dhe rivlerësimi për përparimin në gradë dhe kualifikimin për ushtarakët ankues"*.

Në ankesën me nr. 201300759, efektiv i FA, shtetasi M.K., ishte ankuar ndaj Komandës të Regjimentit të Mbështetjes, sepse nuk po zbatonte urdhrin e Ministrin të Mbrojtjes për mbulimin e shpenzimeve financiare për një operacion që ai kishte kryer në zemër, për shkak se ishte sëmurë gjatë detyrës. Nga hetimi i rastit rezultoi se, për mungesë fondesh vetëm një pjesë e shumës në të holla ishte kompensuar, megjithëse kishte kaluar një vit nga dita e operacionit. Institucioni i Avokatit të Popullit i rekomandoi Ministrisë së Mbrojtjes, *"Çeljen sa më parë të fondeve për likuidimin e plotë financiar të efektivit të Forcave të Armatosura M.K."*.

Konkluzione

Efektiviteti i Institucionit të Avokatit të Popullit për të zgjidhur në mënyrë të shpejtë ankesat e ushtarakëve varet edhe nga bashkëpunimi me Ministrinë e Mbrojtjes, Shtabin e Përgjithshëm dhe strukturat në varësi të tyre. Referuar letërkëmbimit që kemi pasur në vitin 2013, me këto institucione, mund të themi se bashkëpunimi ka qenë i mirë. Megjithatë, në disa raste, nuk është dhënë informacion për të gjithë kërkesat. Për rrjedhojë kërkesat janë përsëritur disa herë gjë që ka sjellë edhe vonesë në shqyrtimin e rastit. Zbatimi i rekomandimeve mbetet për t'u parë, pasi ato janë bërë në fund të vitit 2013, dhe aktualisht jemi në pritje të shqyrtimit të tyre me seriozitet dhe kthimit të përgjigjeve. Shprehim mendimin se refuzimi ose moszbatimi i disa rekomandimeve të Avokatit të Popullit, të bëra në të kaluarën mund të shpjegojë edhe numrin e vogël të ankesave të paraqitura nga ushtarakët. Për të ardhmen puna e Institucionit të Avokatit të Popullit do të konsistojë dhe me shkuarjen në vend, në reparte ushtarake me qëllim marrjen e ankesë/kërkesave nga oficerë, nënoficerë dhe ushtarë profesionistë.

C. Çështje të administrimit të drejtësisë

E drejta për një proces të rregullt ligjor

Mbrojtja që i afrohet individit nga klauzola e procesit të rregullt ligjor nuk është e kufizuar vetëm në të drejtat që përfshihen në Kushtetutë, por edhe në të drejtat e njohura nga ligji. Formulimi kushtetues i jep një shtrirje të gjerë procesit të rregullt për çdo shkëlqje ligjore. Ai e identifikon procesin e rregullt ligjor si garantues, jo vetëm ndaj veprimeve arbitrare që mund të kryejnë autoritetet shtetërore mbi lirinë, pronën dhe të drejtat e tjera kushtetuese e ligjore të individit, por edhe të procedurave të drejta e të ndershme gjyqësore. Nga përmbajtja e nenit 42 i Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, rezulton se mbrojtja kushtetuese do të jetë e pranishme dhe e domosdoshme në çdo ndërhyrje, në rast se realizohen dy kushte bazë që lidhen me cënimin e të drejtave **e para**, kërkohet që liria, prona dhe të drejtat kushtetuese apo ligjore të janë shkelur, dhe **e dyta** se ky cënim i të drejtave të jetë kryer pa i afruar një gjykim të përshtatshëm dhe të drejtë ligjor.

Rregullimet kushtetuese se askujt nuk mund t'i hiqet liria, përveçse në rastet dhe sipas procedurave të parashikuara në nenin 27 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë ose shpronësimet, janë kufizime në ushtrimin e të drejtës së pronës vetëm për interesa publike, kurse neni 41 i Kushtetutës, pranon privimin e lirisë apo të pronës kundrejt respektimit të procesit të ndershëm dhe të drejtë ligjor. Pothuajse të gjitha të drejtat dhe liritë e njohura nga Kushtetuta dhe ligji mund të kufizohen për arsye të përligjura dhe të justifikueshme, ndërkohë që e drejta për një proces të rregullt ligjor, për çfarëdo lloj rrethane mbetet e pakufizueshme.

Procesi i rregullt ligjor gjendet i parashikuar edhe në nenin 131 shkronja "f" të Kushtetutës, por në këtë rast, si një kompetencë e Gjykatës Kushtetuese kur ajo shqyrton ankesat e individëve. Neni 131 shkronja "f" sanksionon një kompetencë të kufizuar, por edhe të kushtëzuar për të, ku asaj gjykate i njihet e drejta për të shqyrtuar ankesat e individëve për shkëlqjen e të drejtave të tyre kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e këtyre të drejtave. E drejta për një proces të rregullt ligjor nuk është një e drejtë që mund të mbulojë të gjitha të drejtat e tjera kushtetuese të individit. Çështjet që lidhen me mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe që përbëjnë një ndër drejtimit kryesore të jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese, janë reduktuar vetëm në të drejtën për një proces të rregullt ligjor.

Neni 6 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, i cili bën fjalë, "E drejta për një proces të rregullt", rezulton me një formulim më të gjerë se Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë. Në këto dispozita të K.E.D.NJ., krahas të drejtës për gjykim të drejtë dhe publikë dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur, e paanshme dhe e caktuar me ligj, përfshin edhe disa standarde të tjera, të cilat në Kushtetutën e Republikës Shqipërisë, parashikohen në disa dispozita.

Kështu e drejta për t'u dëgjuar përpara se të gjykohet, e drejta për t'u prezumuar i pafajshëm derisa të provohet fajësia, e drejta e të akuzuarit për t'u informuar brenda një afati sa më të shkurtër dhe në gjuhën e tij për akuzën, e drejta e tij për t'u mbrojtur, e drejta të bëjë pyetje dhe për të kërkuar thirrjen e dëshmitarëve, të ndihmës falas nga një përkthyes kur nuk kupton gjuhën e përdorur etj, që përbëjnë sipas nenit 6 të K.E.D.NJ, thelbin e të drejtave, procedurale të procesit të rregullt ligjor, nuk janë pjesë përbërëse e nenit 42 të Kushtetutës. Ka disa rregullime të tjera Kushtetuese, si neni 28, 29, 30, 31,32, 33, 34,

43 dhe 44 të Kushtetutës, të cilat në tërësinë e tyre duke u lexuar së bashku me nenin 42 përafrohen me përmbajtjen e nenit 6 të K.E.D.NJ. Të gjitha këto dispozita kushtetuese japin kuptimin e plotë klauzolës së procesit të rregullt ligjor.

Sa here individi ka shfrytëzuar të drejtën për t'ju drejtuar Gjykatës Kushtetuese, në kuptim të nenit 131 shkronja " f " të Kushtetutës, prirja e tij ka qenë e orientuar nga pretendimi për parregullsinë e gjykimit të zakonshëm. Jurisprudenca Kushtetuese ka analizuar procesin e rregullt ligjor si një parim thelbësor kushtetues duke e identifikuar atë me konceptet e gjykimit të drejtë, që nuk nënkupton vetëm procesin gjyqësor. Sigurisht që nëpërmjet procesit të rregullt ligjor kontrollohen më shumë procedurat e rregullta ligjore, por jashtë këtij parimi kushtetues nuk mbeten edhe procedurat e tjera. Gjykata Kushtetuese nuk ka qenë e rezervuar të analizojë procesin e rregullt ligjor vetëm me procedurat gjyqësore, por ka konkluduar për zbatueshmërinë e tij në procedurat e tjera administrative deri dhe në procedurat parlamentare.

Procesi i rregullt ligjor është analizuar nga jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese pothuaj në të gjitha elementët e saj. Shteti i së drejtës nuk mund të konceptohet pa u njohur individëve të drejtën dhe mundësinë për t'iu drejtuar gjykatës. E drejta për t'ju drejtuar gjykatës, si një nga elementët e procesit të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe të nenit 6 K.E.D.NJ, është trajtuar gjerësisht në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese. Kjo e drejtë që njihet ndryshe dhe si e drejta e aksesit në gjykim, nënkupton jo vetëm të drejtën e individit për t'ju drejtuar gjykatës, por edhe detyrimin e shtetit që t'ju garantojë atyre këtë mundësi. Në rast se mohohet një e drejtë e tillë, procesi konsiderohet jo i rregullt, sepse aksesit në gjykatë është para së gjithash një kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera. Kjo e drejtë e individit përbën garanci për administrimin e mirë të drejtësisë.

E drejta për një gjykim të drejtë në proceset penale, evidentohet nëpërmjet një numri të drejtash, si e drejta për seancë gjyqësore publike, e drejta për t'u mbrojtur ndaj akuzave të ngritura, e drejta për t'u konsideruar i pafajshëm, e drejta për t'u gjykuar pa vonesa të panevojshme, e drejta për të përgatitur mbrojtjen, e drejta për t'u mbrojtur vetë, ose përmes avokatit mbrojtës , e drejta për të thirrur dëshmitarë etj.

Institucioni i Avokatit të Popullit dhe organet e pushtetit Gjyqësor

Vështrim i përgjithshëm

Gjatë vitit 2013, në Institucionin e Avokatit të Popullit janë trajtuar 352 raste, nga të cilat janë përfunduar 260 dhe kanë mbetur për shqyrtim 92 raste të tjera. Gjatë këtij viti janë përfunduar dhe 12 raste të cilat kanë qenë të mbartura nga viti 2012. Në 68 raste, ankesat e qytetarëve janë zgjidhur në favor të tyre. Janë realizuar 13 rekomandime, nga të cilat janë pranuar 12 dhe është në shqyrtim 1 rekomandim. Po ashtu është bërë një rekomandim legjislativ i cili është në shqyrtim.

Duke analizuar rastet e ardhura gjatë këtij viti rezulton se ndaj Gjykatave të Shkallës së Parë, kanë ardhur 93 raste ndaj Gjykatave të Apelit, 24 raste dhe ndaj Gjykatës së Lartë kanë ardhur 17 raste, 2 raste kanë qenë ndaj Gjykatës Shkallës së Parë Për Krimet e Rënda.

Problematikat e rasteve të trajtuara, në mënyrë të grupuar paraqiten si më poshtë:

Së pari: Në kërkesat për ndihmë ligjore falas nga shteti ose të ndërmjetësimit të institucioni të Avokatit të Popullit, në Komisionin Shtetëror të Ndhmës Juridike në Ministrinë e Drejtësisë, për dhënien e kësaj ndihme në 39 raste, në bazë të kërkesave të ligjit nr.10039 datë 22.12.2008, "Për Ndhmën Juridike" të ndryshuar. Personat kanë pretenduar se nuk janë në marrëdhënie pune, nuk kanë të ardhura ekonomike dhe financiare për të zgjedhur dhe marrë një avokat mbrojtës privat, për zgjidhjen e një problemi në rrugë gjyqësore në gjykatë.

Së dyti: Për zvarritje të gjata pa shkaqe ligjore dhe shkelje të procedurave gjyqësore të gjykimit nga gjykatat si, për çështje penale ashtu edhe për çështje civile, nga të gjitha shkallët e gjykimit, ankesa këto të cilat trajtohen duke u bazuar në kërkesat e nenit 25 të Ligjit nr.8454 datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit" me ndryshimet përkatëse.

Së treti: Në ankesa drejtuar Ministrisë së Drejtësisë, për mospagimin e kësteve të planifikuara të dëmshpërblimit financiar, bazuar kjo në kërkesat e Ligjit nr.9831 datë 12.11.2007, "Për dëmshpërblimin e ish të dënuarve politikë të regjimit komunist". Shkaku kryesor i mospagimit të tyre rezulton se ka qenë mungesa e fondeve të mjaftueshme buxhetore të planifikuara.

Së katërti: Për shkelje ligjore të ndryshme si, mbajtjen në burg padrejtësisht, kur janë shuar masat e sigurimit, parashikuar nga neni 261/c të Kodit Procedurës Penale, dhe kohëzgjatja e paraburgimit të vuajtur ka qenë më e madhe se masa e dënimit të caktuar nga gjykata.

Së pesti: Për gjykime të padrejta dhe vendime gjyqësore të marra në mungesë të pandehurit nga gjykata, duke pretenduar se ata nuk kanë pasur njoftim për këto gjykime, dhe se ndaj tyre nuk janë respektuar procedurat ligjore të njoftimit në bazë të ligjit.

Së gjashti: Kur familjarët dhe të afërmit e viktimave të krimit, për disa vepra penale sidomos atë të "Shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor" me pasojë vdekje, kanë pretenduar për shkelje të ligjit dhe veprime korruptive të gjyqtarëve.

Së shtati: Ndaj vendimeve gjyqësore të Gjykatave të Apelit, kur prej tyre ndryshohen masat e sigurimit, dhe ato kthehen në "arrest në burg pa afat", dhe ndaj masave të sigurimit bëhet ankim nga organi i Prokurorisë.

Së teti: Ndaj veprimeve arbitrare dhe të padrejta të organeve të drejtësisë të shteteve të huaja.

Së nënti: Ndaj administratës gjyqësore, për paraqitje me vonesa në dërgimin e dosjeve për gjykim, në mosdhënien e kopjeve të vendimeve gjyqësore, etj.

Analiza e rasteve konkrete

Në ankesën me nr.201201522, shtetasi A.P. nga Shkodra, ankohej ndaj një gjykimi dhe vendimi gjyqësor të Gjykatës Rrethit Gjyqësor Shkodër, e cila me datën 12.03.2012, kishte dënuar padrejtësisht me burgim 53 persona për veprën penale të kultivimit të bimëve narkotike, në zonën e Shkrelit të Rrethit Shkodër, duke pretenduar se ndaj tyre gjykata kishte zhvilluar një proces jo të rregullt ligjor. Nga verifikimi dhe shqyrtimi i kësaj ankese rezultoi se ndaj këtij vendimi gjyqësor ishte bërë ankim në Gjykatën e Apelit Shkodër, dhe për këtë rast është bërë monitorimi i këtij gjykimi, në Gjykatën e Apelit Shkodër. Gjykata e Apelit Shkodër, e cila pasi kishte verifikuar pretendimet e të gjykuarve, kishte vendosur prishjen e vendimit dhe pushimin e gjykimit të çështjes me arsyetim se, në rastin konkret mungonte ana subjektive e kësaj vepre penale.

Po kështu rezultoi se kjo gjykatë kishte gjykuar e dënuar edhe 22 persona të tjerë, për veprën penale të kultivimit të lëndës narkotike, në bazë të nenit 283 të Kodit Penal. Edhe për këtë rast, është kryer monitorimi në Gjykatën e Apelit Shkodër, e cila kishte vendosur prishjen e vendimit Gjykatës së Shkallës së Parë dhe pushimin e gjykimit të çështjes me arsyetimin se, mungojnë elementët e veprës penale, për faktin se të gjykuarit kishin mbjellë kërp industrial dhe jo lëndë narkotike.

Për shkeljet e kryera nga gjyqtarët e shkallës së parë Shkodër në këto gjykime, i kemi bërë rekomandim Ministrit të Drejtësisë dhe KLD-së për të analizuar veprimtarinë gjyqësore dhe marrjen e masave disiplinore ndaj tyre.

Po kështu, nga ana jonë po studiohen dispozitat ligjore përkatëse për të bërë ndryshimet dhe përmirësimet ligjore të nevojshme, në të ardhmen.

Në ankesën me nr.201300325, shtetësja A.N. nga Suedia dhe avokati mbrojtës i saj, janë ankuar për zvarritje gjykimi pa shkaqe ligjore dhe shkeljen e procedurave gjyqësore, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në gjykimin e një çështje civile me objekt, njohjen si trashëgimtarë i radhës së parë i trashëgimlënësit V.V. dhe dorëzimin e trashëgimisë në bazë të kërkesave të nenit 348 të Kodit Civil. Nga verifikimi i kryer rezultoi se kjo çështje gjyqësore nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ishte zvarritur mbi dy vjet, se ajo ishte gjykuar nga disa gjyqtarë të ndryshëm të cilët e zvarrisnin gjykimin e saj për 6 muaj dhe pastaj hiqnin dorë nga gjykimi i saj.

Avokati mbrojtës bazuar në kërkesat e nenit 131/f të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, iu drejtua me kërkesë për gjykim Gjykatës Kushtetuese, duke pretenduar për një proces jo të rregullt ligjor, për mos gjykim brenda një afati të arsyeshëm të kësaj çështje gjyqësore. Gjykata Kushtetuese me vendimin e saj nr.35 datë 17.07.2013, vendosi pranimin e kërkesës dhe konstatimin e cënimit të së drejtës kushtetuese për një proces jo të rregullt ligjor, si pasojë e mosgjykimit të çështjes brenda një afati të caktuar.

Në ankesën me nr.201301508, shtetasi A.M nga Tirana, ankohej ndaj Gjykatës Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila nuk vendoste lirimin e tij nga burgu ndonëse ndodhej në kushtet e

parashikuar nga nenit 261/c të Kodit Procedurës Penale, kur i dënuari kishte përfunduar masën e dënimit të dhënë me burgim nga gjykata. Nga verifikimi ynë rezultoi se me vendimin nr.1113 akti, datë 10.07.2013, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, kishte vendosur shpalljen e moskompetencës së gjykimit dhe aktet i kishte kaluar për shqyrtim Gjykatës Apelit Tiranë. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin e saj dt.12.07.2013, kishte vendosur shuarjen e masës sigurimit dhe lirim të menjëhershëm nga burgu të pandehurit A.M., pasi kohëzgjatja e paraburgimit të vuajtur prej tij ishte më e madhe se masa e dënimit të caktuar nga gjykata.

Mbi këtë shqetësim kemi dërguar rekomandimin, për përmirësimin e dispozitës ligjore të nenit 262 të Kodit Procedurës Penale, në të cilën duhet të parashikohet që, Prokurori të vendosë shuarjen e masës sigurimit në rastet pa marrë vendimi formë të prerë, dhe para se të merret në shqyrtim çështja nga Gjykata e Apelit.

Në ankesën me nr.201300341, shtetasi Z.K. nga Librazhdi, ankohej se me datën 13.02.2005, kishte ndodhur një aksident rrugor me pasojë vdekjen e bashkëshortes së tij Xh.K dhe se gjykata kishte kryer zvarritje të gjata gjykimi pa shkaqe ligjore dhe shkelje në procedurat gjyqësore të gjykimeve të zhvilluara ndaj drejtuesit të mjetit, fajtor për ndodhjen e këtij aksidenti automobilistik. Nga verifikimi i kryer rezultoi se me vendimin gjyqësor nr.56 dt.09.06.2005, të Gjykatës Rrethit Gjyqësor Librazhd, ishte vendosur deklarimi i pafajshëm i të pandehurit B.G.

Ndaj këtij vendimi gjyqësor ishte ankuar organi i Prokurorisë dhe Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin e saj datë 27.01.2006, kishte vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë Librazhd dhe kthimin e çështjes për rigjykim me tjetër trup gjykues. Ndërkohë, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Librazhd shkrihet dhe veprimtaria gjyqësore e saj thithet nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan. Me vendimin nr. 40 datë 30.01. 2008, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan kishte vendosur kalimin e kësaj çështjes penale organit të Prokurorisë Rrethit Gjyqësor Elbasan për hetime të reja.

Me vendimin gjyqësor nr.101 datë 07.03.2013 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan kishte vendosur deklarimin fajtor të shtetasit Maqedonas S.M., për krimin e “Shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor” dhe në bazë të nenit 290/1 të K.Penal, dënimin e tij në mungesë, me 5 vjet burgim, si dhe ndalimin e të pandehurit S.M të drejtojë automjet për një periudhë prej 2 vjetësh. Shkaku i kësaj vonese në gjykim, rezultoi se kishte qenë fakti se i pandehuri ka qenë shtetas maqedonas, dhe ishin vonuar procedurat ligjore të njoftimit dhe të kthimit të përgjigjes së letërporosisë të dërguar nga Autoritetet e Drejtësisë së Republikës së Shqipërisë, në Ministrinë e Drejtësisë së Republikës së Maqedonisë.

Në ankesën me nr.201300376, Shtetësja V.A. nga Korça, ankohej për zvarritje gjykimi pa shkaqe ligjore dhe shkelje të procedurave gjyqësore nga Gjykata e Lartë Tiranë, në lidhje me gjykimin e çështjes penale ndaj të pandehurit O.M., i akuzuar për veprën penale të “Vrasjes me dashje”, ndaj viktimës I.P., ndodhur më datën 18.04.2003, gjatë kryerjes së shërbimit ushtarak. Nga verifikimi i kryer rezultoi se Gjykata e Lartë Tiranë, këtë rast e kishte gjykuar dhe prishur edhe 3 herë të tjera më parë, dhe në përfundim kthimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën e Apelit, për shkelje të ndryshme proceduriale. Pasi u studiuan vendimet gjyqësore, i kemi rekomanduar gjykatës përsheptimin e gjykimit, i cili u pranua dhe Gjykata e Lartë Tiranë, në përfundim vendosi lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Apelit Korçë.

Në ankesën me nr.201302348, shtetasi D.S nga qyteti i Lezhës, anëtar i Komunitetit Egjiptian, ankohej ndaj Gjykatës Shkallës Parë Lezhë, se ndaj tij ishte zhvilluar një proces

jo të rregullt ligjor, duke vendosur prishjen e banesës së tij dhe lirimimin e dorëzimit të truallit, në një kohë që ai kishte aplikuar për legalizim i cili ishte miratuar nga organet kompetente në bazë të ligjit. Ankuesi ka kërkuar të monitorohet gjykimi në Gjykatën e Apelit Shkodër nga Institucioni i Avokatit të Popullit. Gjatë gjykimit të zhvilluar në Gjykatën e Apelit Shkodër, u vendos riçelja e hetimit gjyqësor dhe me paraqitjen e provave të reja shkresore nga ankuesi D.S dhe avokati mbrojtës i tij, Gjykata e Apelit Shkodër, në përfundim vendosi prishjen e vendimit nr.266 datë 02.04.2013, të Gjykatës Rrethit Gjyqësor Lezhë, dhe rrëzimin e kërkesë padisë së ngritur nga paditësi H. M. Pra ankesa e shtetasit D.S., nga Gjykata e Apelit Shkodër u pranua si e drejtë dhe e bazuar në ligj.

Në ankesën me nr.201302275, shtetasi K.K, 13 vjeç nga Elbasani, ankohej ndaj një vendimi gjyqësor me të cilin babai i tij ishte dënuar me 1 muaj burgim, për mos përmbushje të detyrimit ushqimor të fëmijëve të tjerë, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe ai ishte vetëm, pasi nëna e tij ishte ndarë dhe martuar përsëri me një person tjetër. Nga verifikimi i kryer rezultoi se prindërit e të miturit K.K. ishin ndarë nga gjykata dhe ai ishte lënë për rritje dhe edukim nënës, e cila ishte martuar me një burrë tjetër, dhe duke qenë se ankuesi trajtohej keq nga ato ishte larguar dhe qëndronte tek babai i tij në rrethin e Gramshit. Meqenëse babai i tij nuk ishte në marrëdhënie pune dhe nuk paguante detyrimin ushqimor në dobi të fëmijëve, nëna e tij ishte ankuar në Gjykatë e cila e kishte dënuar me gjobë, dhe në rastin e dytë, e kishte dënuar me 1 muaj burgim, vendim gjyqësor ky që kishte marrë formë të prerë, dhe ishte ekzekutuar dhe aktualisht babai i tij, ishte duke vuajtur dënimin në I.E.V.P. Peqin. Mbi këtë shqetësim i kemi rekomanduar Njësisë për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës në Komunë dhe Këshillit të Qarkut Elbasan, për t'i siguruar të miturit K.K. një kujdestar. Rekomandimet u pranuan dhe të miturit iu caktua një kujdestar për t'u interesuar gjatë kohës që babai i tij qëndronte në I.E.V.P. Peqin, duke vuajtur dënimin me burgim.

Në ankesën me nr.201302263 shtetasi I.S. nga Tirana, ankohej për zvarritje gjykimi pa shkaqe ligjore dhe shkeljen e procedurave gjyqësore nga Gjykata e Lartë Tiranë, në shqyrtimin e një çështje civile me objekt, anulimin e urdhrin të mbylljes dhe ndërprerjes së pensionit të pleqërisë nga dt.31.03.2010, nga D.R.S.SH.Tiranë. Ankuesi pretendonte se kërkesa e tij ishte pranuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, por ndaj këtij vendimi ishte ankuar pala e paditur D.R.S.SH. Tiranë dhe Gjykata e Apelit Tiranë, kishte vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës Shkallës së Parë Tiranë dhe rrëzimin e kërkesë padisë. Ndaj këtij vendimi gjyqësor ankuesi kishte ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë, duke kërkuar prishjen e vendimit të Gjykatës Apelit Tiranë, dhe lënien në fuqi të vendimit shkallës së parë. Duke analizuar shkaqet e ankimit, si dhe faktin se ankuesi I.S. ishte 77 vjeç, në gjendje jo të mirë shëndetësore, i kemi rekomanduar Gjykatës Lartë, shpejtimin e gjykimit. Rekomandimi ndodhet akoma në shqyrtim.

Në ankesën e tij me nr.201302074 shtetasi I.D. nga Tirana, ankohej ndaj vendimit nr.860 datë 28.06.2013, të Gjykatës Rrethit Gjyqësor Tiranë marrë në mungesë, me të cilin ai ishte dënuar padrejtësisht me burgim, duke pretenduar se nuk ishte njoftuar për hetimet paraprake dhe gjykimin e zhvilluar nga organet e Prokurorisë dhe të Gjykatës Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Në zbatim të kërkesave të nenit 147/2 të Kodit Procedurës Penale, ku parashikohet se kundër vendimit të dhënë në mungesë, mbrojtësi mund të bëjë ankim vetëm kur është i pajisur me akt përfaqësimit të lëshuar nga i pandehuri në format e parashikuara në ligj, u bënë sqarimet e nevojshme të zgjidhjes së këtij problemi nga ankuesi, nëpërmjet

konsultimit të tij me një avokat mbrojtës. Nga ana tjetër ankuesi u sqarua dhe për faktin se në bazë të Ligjit nr.10039 datë 22.12.2008, "Për Ndihmë Juridike", mund t'i drejtohej me kërkesë Komisionit Shtetëror për Ndihmë Juridike në Ministrinë e Drejtësisë.

Në ankesën me nr.201301723, shtetasi A.R. nga qyteti i Durrësit, ankohej ndaj Gjykatës Lartë Tiranë, për zvarritje gjykimi pa shkaqe ligjore dhe shkeljen e procedurave gjyqësore në gjykimin e çështjes penale ndaj djalit tij L.R., i akuzuar për veprën penale të vjedhjes së pasurisë parashikuar nga neni 134/1 i K.Penal. Ankuesi A.R. pretendonte se djali i tij kishte përfituar nga Amnistia e dalë me rastin e 100 vjetorit të çlirimit të atdheut, me Ligjin nr.107/2012, "Për Dhënie Amnistie", i cili kishte hyrë në fuqi me datën 28.11.2012. Nga verifikimi i kryer rezultoi se dosja e djalit të ankuesit A.R., ndodhej e regjistruar për gjykim në Gjykatën e Lartë Tiranë, me nr.00973/13 akti, në fazë studimi e në pritje për të kaluar në dhomën e këshillimit, dhe se raste të kësaj natyre, nga Gjykata e Lartë do të gjykoheshin me proceduar të shpejtuar.

Në ankesën me nr.201301505, shtetasi K.D. nga qyteti i Durrësit, ankohej për zvarritje gjykimi pa shkaqe ligjore dhe shkeljen e procedurave gjyqësore gjatë gjykimit të një çështje civile nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë. Nga verifikimi i kryer rezultoi se çështja ndodhej për gjykim. Çështja ishte regjistruar për gjykim në gjykatë qysh me datën 23.04.2012, dhe se me gjykimin e saj ishin caktuar disa gjyqtarë të cilët pas disa seancash gjyqësore mbi kërkesën e ankuesit, ato kishin hequr dorë nga gjykimi i saj. Për shkeljet e konstatuara për zvarritjet e gjykimit është njoftuar KLD-ja dhe ankuesi është sqaruar se në bazë të nenit 131/f të Kushtetutës, ai kishte të drejtë t'i drejtohet me kërkesë Gjykatës Kushtetuese, për proces jo të rregullt ligjor për gjykimin brenda një afati të arsyeshëm, duke pasur parasysh qëndrimin e mbajtur nga Gjykata Kushtetuese me vendimin nr.35/2013.

Në ankesën me nr.201302610, shtetësja N.H. nga Kavaja, ankohej ndaj veprimeve të parregullta dhe të paligjshme të një avokati mbrojtës privat, për zgjidhjen e një problemi pensioni, në rrugë gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan. Qytetarja ka marrë sqarimet e nevojshme ligjore dhe në rast pamundësie ekonomike e financiare në bazë të dispozitave ligjore të Ligjit nr.10039 datë 22.12.2008, "Për Ndihmën juridike", mund t'i drejtohej me kërkesë Komisionit Shtetëror për Ndihmë Juridike në Ministrinë e Drejtësisë, për dhënien e ndihmës juridike falas nga shteti.

Veprimtaria e Prokurorisë

Vështrim i përgjithshëm

Prokuroria, funksionon pranë sistemit gjyqësor dhe si organ i centralizuar, ushtron ndjekjen penale dhe përfaqëson akuzën në gjyq në emër të shtetit. Në ushtrimin e kompetencave Prokurorët u nënshtrohen Kushtetutës dhe Ligjeve, duke respektuar parimet e procedimit të drejtë, të barabartë e të rregullt ligjor dhe mbrojtjes së të drejtave, e interesave të ligjshme të individit në procesin penal.

Institucioni i Avokatit të Popullit gjatë veprimtarisë së punës në trajtimin e ankesave të qytetarëve ndaj organit të Prokurorisë, ka treguar kujdes në ruajtjen e pavarësisë duke respektuar me rigorozitet dispozitat kushtetuese dhe ligjore. Trajtimi i ankesë/kërkesave të qytetarëve ndaj veprimtarisë së organit të Prokurorisë, nga Institucioni i Avokatit të Popullit, është parë në këndvështrimin ligjor dhe institucional, por edhe në respekt të detyrës së vështirë dhe me përgjegjësi të Prokurorit, në raste të caktuara edhe ngarkesës së madhe të punës apo shkaqeve objektive në moskryerjen e disa veprimeve hetimore proceduriale.

Gjatë vitit 2013, Institucioni i Avokatit të Popullit ka marrë në shqyrtim 212 ankesa drejtuar organit të Prokurorisë, nga të cilat janë përfunduar 165 ankesa dhe mbeten për shqyrtim 47 ankesa. Nga ankesat e përfunduara, 71 ankesa kanë qenë të pabazuara, 29 ankesa jashtë kompetence, 9 ankesa jashtë juridiksionit, 51 ankesa të zgjidhura në favor dhe 5 ankesa me heqjen dorë nga ankuesi.

Për periudhën e vitit 2013, janë filluar 5 raste me iniciativën e Avokatit të Popullit, kryesisht për raste të bëra publike në media, si dhe në 16 raste është shkuar në vend për verifikime apo kryerjen e hetimeve.

Problematikat e rasteve të trajtuara gjatë kësaj periudhe konsiston në:

Së pari: Moszbatimin e procesit të rregullt ligjor, për shkak të veprimeve të padrejta të kryera nga Prokuroria, që kanë çenuar të drejtat e shtetasve në procesin penal duke mos respektuar procedurat ligjore. Procesi i rregullt ligjor, është trajtuar si një garanci kushtetuese që sanksionohet në nenin 42 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë dhe nenin 6 të Konventës Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut.

Ankesat e shtetasve në këtë drejtim kanë konsistuar në: Zvarritje të pajustificuara në hetimin e procedimeve penale, sidomos për rastet kur çështja është kthyer nga gjykata; në rastet e zëvendësimit të prokurorëve, ose oficerëve të policisë gjyqësore më e theksuar kjo, për hetimet e procedimeve penale të kryera nga policia gjyqësore e Policisë së Shtetit; në mosrespektimin e nenit 287 të Kodit të Procedurës Penale që bën fjalë për regjistrimin e njoftimit të veprave penale dhe Udhëzimit nr.241 datë 22.11.2005, të Prokurorit të Përgjithshëm, kur edhe pse njihet personi që i atribuohet vepra penale, nuk regjistrohet emri i tij; në arrestimin dhe ngritjen e akuzës të padrejtë; në marrjen e vendimit të padrejtë për mosfillim të procedimeve penale, apo pushime të çështjeve penale për arsye të mosverifikimit të kallëzimit brenda afatit 30 ditor të parashikuar në pikën 2.3 të Udhëzimit nr.3 datë 19.06.2012, të Prokurorit të Përgjithshëm; apo moskryerjes së

hetimeve të gjithanshme, sidomos për veprat penale të “Falsifikimit të dokumenteve” për pronësinë, “Shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor”; për mosnjohje të palëve në procesin penal me vendimet për zgjatjet e afatit të hetimit të procedimit penal etj.

Së dyti: Mosrespektimin e detyrimit të informimit, i cili është parë si një nga të drejtat themelore vetiake të individit. Në këto raste, organi i Prokurorisë nuk i ka njoftuar shtetasit për mënyrën e zgjidhjes së çështjeve, të cilat fillojnë mbi bazën e kallëzimit penal të bërë prej tyre; nuk ju ka kthyer përgjigje, ose e ka kthyer atë me vonesë për “kërkesa apo memorie me shkrim” të paraqitura nga palët gjatë hetimit (jashtë afatit prej 15 ditë, që parashikon pika 2 e nenit 110 të Kodit të Procedurës Penale); nuk ju ka dhënë kopje të akteve të kërkuara, sidomos për ekspertimet e ndryshme si, autoteknike, mjekoligjore, tekniko-grafike të nënshkrimit etj, duke shkelur kërkesat e parashikuara në nenin 105 të Kodit të Procedurës Penale.

Në ankesën me nr.201302873, shtetasi L.SH. nga Gramshi, ankohej ndaj Prokurorisë së Rrethit Gjiqësor Elbasan, për mosdhënie të disa akteve të domosdoshme të procedimit penal nr.791 të vitit 2011, për të cilin ishte vendosur pushimi i çështjes në ngarkim të tij. Aktet si, “arresti në flagrance”, kërkesa e Prokurorit dhe vendimi i Gjykatës për “caktimin e masës së sigurimit” etj, qytetarit i nevojiteshin për paraqitjen e kërkesë padi me objekt “shpërblimin e dëmit të shkaktuar” për kohën e qëndrimit padrejtësisht në paraburgim. Rasti është shqyrtuar në vënd dhe organi i Prokurorisë ka vënë në dispozicion të qytetarit L.SH. të gjitha aktet e kërkuara.

Në ankesën me nr.201302873, shtetasi A.B. nga Elbasani, është ankuar ndaj Prokurorisë së Rrethit Gjiqësor Elbasan, për mosdhënie të dokumenteve origjinale për pronësinë mbi tokën, dorëzuar me proces verbal para oficerit të policisë gjyqësore, ndërsa i janë dhënë kopje të atij akti konfirmuar nga sekretaria e atij organi sipas rregullave. Qytetari A.B. këtë shqetësim e ka paraqitur në Gjykatë, duke kundërshtuar vendimin e pushimit të marrë nga organi i Prokurorisë.

Së treti: Moskryerjen e veprimeve të nevojshme prej prokurorëve që merren me ekzekutimin e vendimeve penale, me pasojë qëndrimin e të dënuarit në paraburgim ose burgim, më tepër se koha e vuajtjes së dënimit të përcaktuar në vendimin e gjykatës.

I tillë është rasti i ankesës me nr.201300384, e shtetasit F.SH, nga Durrësi, i cili ankohej ndaj Prokurorisë së Rrethit Gjiqësor Vlorë, për llogaritje gabim prej 9 muaj për kohën e qëndrimit të tij në paraburgim. Mbi këtë shqetësim i është kërkuar informacion organit të Prokurorisë, e cila sqaroi se pas gabimit të bërë në llogaritjen e kohës së qëndrimit në paraburgim, ajo është përsëritur duke u vënë në vend e drejta që i ishte shkelur shtetasit F.SH, person i cili është ekstraduar në Itali, pasi ishte dënuar nga autoritetet gjyqësore italiane, për një vepër tjetër penale.

Në disa raste, shtetasit janë ankuar për mbajtje padrejtësisht në mjediset e Spitalit të Burgut të personave të afërm të familjeve të tyre, në një kohë që duhej të transferoheshin në një Institucion Psikiatrik të Specializuar, jashtë sistemit të burgjeve.

I tillë është rasti i ankesës me nr.201302319 i shtetasit K.B., avokat i klientit V.R., për të cilin Gjykata e Rrethit Gjiqësor Vlorë në vitin 2002, kishte vendosur masën mjekësore “mjekim të detyruar në një institucion mjekësor” por në fakt, ai mbahej në I.E.V.P Krujë.

Ndërkohë, gjykata pasi kishte marrë në shqyrtim vendimin e mëparshëm, me vendimin nr.99, datë 11.04.2013, i cili kishte marrë formë të prerë, kishte vendosur: *“Lënien në fuqi ndaj shtetasit V.R. të masës mjekësore “mjekim i detyruar në një Institucion Mjekësor”, dhe trajtimin e tij pranë Spitalit Psikiatrik Vlorë”*.

Nga shqyrtimi i këtij rasti konstatoam se qëndrimi i organit të Prokurorisë ishte në kundërshtim të plotë dhe të hapur me disa akte normative dhe konkretisht: me nenin 142/3 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë; nenet 24/1, 462, 463 dhe 464 të Kodit të Procedurës Penale; nenet 2,9, 22 etj, të ligjit nr.8331, datë 21.04.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”; nenit 28/1 të ligjit nr.44/2012 “Për shëndetin mendor”; pikën 100.1 të dokumentit “Mbi Rregullat Europiane të Burgut”, miratuar nga Këshilli i Europës dhe deleguar në zbatim me rekomandimin nr.87/3 të Këshillit të Ministrave të vendeve anëtare; nenin 14 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut. Për sa më sipër, i kemi rekomanduar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë *“Ndërprerjen e shkëljes së të drejtave të shtetasit V.R. dhe vënien në ekzekutim menjëherë të vendimit të formës së prerë nr.99, datë 11.04.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, për trajtimin e tij nën masën mjekësore “Mjekim i detyruar” pranë Spitalit Psikiatrik Vlorë”*. Rekomandimi është në shqyrtim nga organi i Prokurorisë.

Pas inspektimeve të kryera, është konstatuar se në Spitalin e Burgut Tiranë dhe I.E.V.P Krujë, pra brenda sistemit të burgjeve ndodhen 112 persona, ndaj të cilëve me vendim gjyqësor është vendosur “mjekim i detyruar në një Institucion Mjekësor”. Mbi këtë shqetësim i jemi drejtuar me rekomandim Ministrive përkatëse duke vënë në dijeni dhe drejtuesit më të lartë të shtetit.

Në ankesën me nr.201301508, qytetari A.M., ankohej ndaj Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, pasi mbahej padrejtësisht në I.E.V.P. 302 Tiranë, ndonëse kishte plotësuar kohën e vuajtjes së dënimit me burgim të dhënë nga gjykata në datën 07.07.2013. Nga verifikimi i rastit, rezultoi se, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin nr.284 datë 15.03.2013, kishte dënuar të pandehurin A.M. me 16 muaj burgim, për veprën penale të “Mbajtjes pa lejë të armëve luftarake dhe municionit”. Ndaj këtij vendimi, i pandehuri kishte bërë ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë, por ai nuk ishte shqyrtuar ende. Meqenëse vuajtja e dënimit mbaronte në datën 07.07.2013, i pandehuri i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me kërkesë për shuarjen e masës së sigurimit. Në seancën gjyqësore Prokurori i çështjes ka kërkuar pranimin e kërkesës së të pandehurit, kurse Gjykata ka shpallur moskompetencën dhe dërgimin e akteve Gjykatës së Apelit Tiranë. Gjykata e Apelit Tiranë, më datën 12.07.2013, ka vendosur prishjen e vendimit gjyqësor të Gjykatës së Shkallës së Parë dhe shuarjen e masës së sigurimit ndaj të dënuarit A.M., dhe mbi kërkesën e Prokurorit, urdhëroi lirimin e menjëhershëm të dënuarit A.M. nga I.E.V.Penale.

Mbi këtë shqetësim, i kemi rekomanduar Prokurorit të Përgjithshëm *“Fillimin e procedimit disiplinor ndaj Prokurorit GJ.K., për shkëljen e nenit 32/d të ligjit nr.8337, datë 12.02.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”*. Rekomandimi është marrë në shqyrtim, por nuk është pranuar.

Së katërti: Mosrespektimin e dispozitave proceduriale që bëjnë fjalë për “Disponimin e provës materiale”, parashikuar nga neni 190 i Kodit të Procedurës Penale. Në këto raste shtetasit i janë drejtuar organit të Prokurorisë, lidhur me trajtimin e sendeve prova

materiale të sekuestruara gjatë hetimit, të cilat në disa raste u janë kthyer me vonesë personave të interesuar, ose i është lënë gjykatës për të marrë vendim për disponimin e tyre. I tillë është rasti i ankesës me nr.201301243, e shtetasit I.M. nga Durrësi, i cili ankohej ndaj Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës, pasi ishte bllokuar e mandej sekuestruar si provë materiale, mjeti autoveturë tip "B.M.Ë.730-D me targa shqiptare, ndonëse mjeti ishte me dokumente të rregullta dhe kishte lëvizur më parë, brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë. Ankuesi I.M., ka ndjekur rrugën gjyqësore duke i kërkuar gjykatës heqjen e sekuestrimit të mjetit dhe aktualisht çështja ndodhet për shqyrtim në Gjykatën e Apelit Durrës.

Në ankesën me nr.201301015, shtetasi K.B. nga Tropoja, ankohej ndaj Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila kishte vonuar kryerjen e veprimeve të nevojshme hetimore me mjetin e tipit "Bens Mercedes" me targa shqiptare, të cilën ai e kishte blerë shtetasit SH.B dhe e posedonte me dokumente të rregullta. Nga shqyrtimi i ankesës u konstatua se mjeti që drejtohej nga shtetasi SH.B. në muajin Mars 2013, ishte larguar nga vendi i aksidentit automobilistik të ndodhur në qytetin e Tiranës. Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë në përgjigjen drejtuar Institucionit të Avokatit të Popullit, informon ndërmjet të tjerave se: *"...lidhur me automjetin me targa AA-204-AA, i cili rezulton të jetë aktualisht në pronësi të shtetasit K.B., ju informojmë se ky automjet është sekuestruar si provë materiale. Automjeti do t'i nënshtrohet ekspertimit dhe në përfundim Gjykata do të disponojë sipas ligjit për këtë provë"*. E përmendëm këtë rast, pasi në pikën 2 të nenit 190 të Kodit të Procedurës Penale "Disponimi për provat materiale", thuhet se: *"Provat materiale mund t'u kthehen personave që u përkasin edhe para mbarimit të procedimit, kur nuk dëmtohet zgjidhja e çështjes"*. Pra, është detyra e organit të Prokurorisë që gjatë fazës së hetimit paraprak të kryejë në një kohë sa më të shpejtë të gjitha veprimet e domosdoshme hetimore, siç është dhe ekspertimi autoteknik i mjetit dhe mandej, të zbatojë dhe detyrimin e përcaktuar në nenin e mësipërm, për t'i kthyer mjetin personit që e posedon edhe gjatë fazës së hetimit.

Së pesti: Veprime të dhunshme të punonjësve të policisë ndaj qytetarëve, me pasoja në shëndetin e tyre. Gjatë këtij viti Avokati i Popullit ka filluar me inisiativë, rastin me nr.201302676, pas bërjes publike në media për keqtrajtimin e disa të rinjve nga dy punonjës të Komisarariatit të Policisë nr.2 Tiranë. Në përfundim të hetimit administrativ u arrit në konkluzionin se punonjësit e policisë B.L. dhe A.D. kishin ushtruar dhunë fizike ndaj tre shtetasve D.S.,A.B. dhe F.K. Për rrjedhojë i kemi rekomanduar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë *"Fillimin e hetimit për veprën penale të "Kryerjes së veprimeve arbitrare", në ngarkim të punonjësve të policisë B.L. dhe A.D."*. Pas shqyrtimit të rekomandimit Prokuroria e ka pranuar atë, duke urdhëruar fillimin e hetimit të procedimit penal nr.7106 të vitit 2013, për veprën penale të "Kryerjes së veprimeve arbitrare", kryer në bashkëpunim.

Së gjashti: Mungesë bashkëpunimi në përpilimin dhe plotësimin e kallëzimeve penale. Në ankesën me nr. 201301014, shtetasi A.G. nga Tirana i është drejtuar Institucionit të Avokatit të Popullit me një letër në formën e "Denoncimit", për kërcënime që i ishin bërë nga persona të paidentifikuar, të cilin e kishte paraqitur në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Qytetari u sqarua në mënyrë të hollësishme për mënyrën e formulimit të kallëzimit penal që duhej t'i drejtohej organit të Prokurorisë, veprën penale *"Përdorimi me keqdashje i thirrjeve telefonike"*, parashikuar nga neni 275 të Kodit Penal, si dhe faktin se organi i Prokurorisë kryen verifikimet brenda një afatit të caktuar prej 30 ditësh. Qytetari gjithashtu është sqaruar dhe me të drejtën e bërjes së kallëzimit drejtuar Policisë

Gjyqësore dhe Prokurorisë, sipas nenit 283 të Kodit të Procedurës Penale.

Së shtati: Në mosrespektimin e detyrimit të organit procedues për njoftimin e palës së dëmtuar nga vepra penale, me të drejtën e saj, për të ngritur padi në procesin penal dhe për të kërkuar shpërblimin e dëmit, sipas nenit 61 të Kodit të Procedurës Penale. Ky mosveprim ka detyruar palën e dëmtuar, ose familjarët e viktimave apo të dëmtuarve nga vepra penale, për të paraqitur kërkesë padi më vete, para gjykatës me objekt *“Shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga vepra penale”*.

Avokati i Popullit ka bërë studimin dhe ka përgatitur rekomandimin legjislativ me propozime për shtesa dhe përmirësime në nenet 48 dhe 58 të Kodit të Procedurës Penale, me qëllim vendosjen e avokatit mbrojtës në hetimin dhe gjykimin e procedimit penal, për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të ligjshme të viktimës.

Në raste të tjera qytetarët i janë drejtuar Institucionit të Avokatit të Popullit me ankesa, duke pretenduar se pas kallëzimit penal në Polici ose Prokurori për dëmtime të shkaktuara në dëm të shëndetit të tyre, Prokuroria ka vendosur mosfillimin e procedimit penal. Pas shqyrtimit të këtyre rasteve, është konstatuar se në konkluzionet e aktit mjeko ligjor, dëmtimet e shkaktuara kanë qenë *“Dëmtime të tjera me dashje”* parashikuar nga neni 90 i Kodit Penal, vepër penale e cila ashtu si edhe disa vepra të tjera, përfshihen në nenin 59 të Kodit të Procedurës Penale *“I dëmtuari akuzues”*.

Qytetarët janë sqaruar me faktin se për këto vepra penale ata *“kanë të drejtë të paraqesin kërkesë në gjykatë dhe të marrin pjesë në gjykim si pale, për të vërtetuar akuzën dhe për të kërkuar shpërblimin e dëmit”*. Nga ana tjetër, qytetarët janë sqaruar dhe për mënyrën e formulimit të kërkesës, depozitimin e saj në sekretarinë e gjykatës e procedura të tjera të domosdoshme. Raste të tilla janë ankesa me nr.201302351 e shtetases A.P. nga Saranda për veprën penale të *“Dëmtimeve të tjera me dashje”*; ankesa me nr.201302194 e shtetasit L.B. nga Tirana për veprën penale *“Shkelja e paprekshmërisë së banesës”* etj.

Ka edhe raste kur qytetarët i janë drejtuar Institucionit të Avokatit të Popullit me ankesë apo kërkesë, duke pretenduar se pas kallëzimit penal të tyre, organi i Prokurorisë ka vendosur në mënyrë të padrejtë pushimin e hetimit apo mosfillimin e procedimit penal. Këto shqetësime janë shqyrtuar me kujdes dhe qytetarët janë sqaruar për rrugët ligjore që duhen të ndjekin, për t'i kundërshtuar apo ankimuar vendimet e marra nga Prokuroria, bazuar në nenet 291 pika 1 dhe 329 pika 1 e Kodit të Procedurës Penale.

I tillë është rasti i filluar me inisiativë me nr.201302122, për ngjarjen automobilistike të ndodhur në datën 31.08.2013, në Bulevardin *“Gjergj Fishta”* Tiranë, në afërsi të pallatit me *“Shigjeta”*, ku drejtuesi i mjetit V.B. ka aksidentuar lehtë fëmijën e mitur L.N., anëtar i Komunitetit Rom. Pas shqyrtimit të rastit u konstatua se, Prokuroria më datën 19.11.2013, kishte vendosur mosfillimin e procedimit penal dhe për këtë babai i të dëmtuarit shtetasi J.N. është sqaruar jo vetëm për të drejtën e kundërshtimit të vendimit të marrë nga prokuroria në gjykatë, në rast se ai do ta çmonte të arsyeshme, por dhe për të drejtën e paraqitjes prej tij, të kërkesë padisë për shpërblimin e dëmit të shkaktuar fëmijës së tij.

Në kërkesën me nr.20132345 shtetasi A.S. avokat i klientes Ç.H. nga Pogradeci, ka ngritur me shqetësim faktin se nga ana e Prokurorisë dhe Gjykatës i është refuzuar përfaqësimi në procesin penal në ngarkim të pandehurit XH.L. akuzuar për vrasjen e shtetasit E.I.,

me qëllim për të mbrojtur interesat e familjarëve të viktimës. Qytetari A.S. u sqarua për qëndrimin e mbajtur nga Institucioni i Avokatit të Popullit, për përgatitjen e rekomandimit legjislativ me këtë objekt.

Një tjetër grup ankesash lidhen me moskthim të përgjigjeve ose kthim me vonesë për letrat (ankesat) drejtuar Prokurorisë së Përgjithshme. I tillë është rasti i ankesës me nr.201302013, e shtetasit J.Z. nga Vlora, i cili ankohej ndaj Prokurorisë së Përgjithshme, për moskthimin e përgjigjes së ankesës së datës 07.03.2013, për akuzë të padrejtë ndaj djalit të tij N.Z., i akuzuar për veprën penale të “Kundërshtimit dhe goditjes së gjyqtarit”. Në përgjigjen drejtuar Institucionit të Avokatit të Popullit, jemi informuar se çështja penale kishte kaluar për gjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier dhe se qytetari J.Z. ishte njoftuar me shkrim për fazën në të cilën ndodhej çështja, por pa përmendur datën dhe numrin e shkresës.

Ndërsa në ankesën me nr.201302681, shtetësja A.K. nga Korça më datën 29 Mars 2013, i është drejtuar Prokurorisë së Përgjithshme me një memorie, nëpërmjet shërbimit FAX, në lidhje me pretendimet që kishte për procedimin penal nr.458 të vitit 2012, për veprën penale të “Ekspertimit të rremë”, filluar mbi bazën e kallëzimit të saj, por që Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Pogradec kishte vendosur pushimin e hetimeve. Nga shqyrtimi i ankesës u konstatua se Prokuroria e Përgjithshme e kishte përcjellë memorien e qytetares në organin e Prokurorisë Pogradec, pas marrjes së vendimit të pushimit.

Në ankesën me nr.201300925, shtetasi B.B. nga Tirana ankohej ndaj Prokurorisë së Përgjithshme, pasi nuk i kishte kthyer përgjigje letrës së tij të datës 04.02.2013. Në përgjigjen drejtuar Institucionit të Avokatit të Popullit, nga Prokuroria e Përgjithshme jemi informuar se në atë Institucion qytetari kishte paraqitur vetëm dokumente pa ankesë ose kërkesë me objekt të caktuar. Në këto rrethana qytetari B.B. është sqaruar për faktin se ankesë/kërkesa e tij duhet të ishte konkrete dhe me objekt të caktuar.

Analizë e rasteve konkrete

Në ankesat e shqyrtuara nga Zyra e Avokatit të Popullit për vitin 2013, përkatësisht me nr.201302061, nr.201302367, nr.201302013, nr.201301478 etj, shtetasit janë ankuar për zvarritje të pajustificuara në hetimin e procedimeve penale. I tillë është rasti i ankesës nr.201302367 i shtetasit E.C. nga Tirana, për zvarritje të pajustificuara në hetimin e procedimit penal nr.3774, filluar në datën 13.07.2013, nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për veprën penale të “Heqjes së paligjshme të lirisë” e kryer në bashkëpunim, për të cilën Prokuroria kishte kërkuar zgjatje të pajustificuar të hetimit për tre muaj, pra deri në datën 13.01.2014.

Në ankesën me nr.201302061, shtetasi P.P. nga Fushë Arrësi, pretendonte se organi i Prokurorisë kishte ngritur akuzë të padrejtë ndaj tij, si dhe zvarritur padrejtësisht hetimet e procedimit penal nr.69 të vitit 2013, i cili bënte fjalë për veprat penale të “Shkatërrimit të pronës”, “Kundërshtim të punonjësit të rendit publik” me dhunë e kryer në bashkëpunim etj. Procedimi penal kishte filluar mbi bazën e ngjarjes më datën 15.04.2013, dhe çështja ishte dërguar për gjykim në datën 07.11.2013.

Mbi shqetësimin e shtetasit P.P. është urdhëruar kryerja e një hetimi të pavarur administrativ dhe në përfundim të hetimit i kemi rekomanduar Prokurorisë *“Zbatimin me korrektësi të dispozitave ligjore procedurale dhe kushtetuese me qëllim zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor”*. Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Pukë në përgjigjen drejtuar Institucionit të Avokatit të Popullit për zvarritjen e hetimit justifikohet me faktin se, hetimet kanë qenë komplekse edhe për shkak të bashkimit të disa procedimeve penale, ndërsa Prokuroria e Përgjithshme citonte se *“...nuk konstatohet të ketë pasur zvarritje në hetim...”*

Në ankesën me nr.201302398, shtetasi F.L.nga Vlora ankohej ndaj Prokurorisë së atij Rrethit Gjyqësor, pasi ishin zvarritur hetimet e procedimit penal nr.91 të vitit 2011, për veprën penale të *“Shpërdorimit të detyrës”* në ngarkim të shtetasit F.Ç. Pas pushimit të çështjes më datën 23.12.2012, ishte vendosur ndarja e një pjese të akteve dhe regjistruar kryesisht procedimi penal nr.104 i vitit 2012. Në përgjigjen e datës 04.12.2013, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka informuar se procedimi penal ndodhej në fazën e hetimit.

Në ankesën me nr.201302354, shtetasja M.P. nga Tirana ankohej për zvarritje të pajustificuara në hetimin e procedimit penal nr.41 filluar datë 09.01.2013, nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për veprat penale të *“Mashttrimit”* dhe *“Falsifikimit të dokumenteve”*, në ngarkim të shtetasit I.A., dhe pavarësisht kryerjes së veprimeve të konsiderueshme hetimore, ato nuk kishin përfunduar edhe pse kishte kaluar 1 vit.

Në ankesën me nr.201300378 shtetasi F.M. nga rrethi i Kolonjës, ankohej ndaj Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Sarandë, pasi jo vetëm kishte zvarritur në mënyrë të pajustificuar hetimet e procedimit penal Nr.525 filluar në datën 20.12.2012, për veprën penale të *“Vjedhjes”*, por dhe se në përfundim, pas 8 muajve kishte vendosur pezullimin e hetimit.

Gjatë shqyrtimit të ankesave të shtetasve për këtë periudhë, është konstatuar se hetimet e procedimeve penale për të cilat nuk njihej autori, zgjaten në mënyrë të pajustificuar dhe pa u kryer hetime të gjithanshme e në vazhdimësi, duke përfunduar në pezullimin e hetimit. Po ashtu, nuk bëhen analiza të përbashkëta të Prokurorisë me Policisë Kriminale, për ecurinë e veprimeve të mëtejshme nga kjo e fundit, me qëllim zbulimin e autorëve të veprave penale dhe vënien e tyre para përgjegjësisë ligjore. Të tilla janë rastet e ankesave me nr.201300868 e shtetasit J.M. nga Tirana, për vjedhje të një sasive të konsiderueshme të hollash prej 1 milion lekë, për të cilën organi i Prokurorisë kishte filluar hetimin e procedimit penal nr.2014 të vitit 2011; ankesa me nr.201301260 e shtetasës V. D. nga Tirana për vjedhjen në banesë të një sasive të konsiderueshme, lekë shqiptare dhe valutë e huaj; ankesa me nr.201300751 e shtetasit H.P. nga Kurbini, lidhur me vrasjen djalit M.P. ngjarje e ndodhur në datën 13.01.2013; ankesa me nr.201302468 e shtetasit A.SH. nga Tirana, për *“Rrëmbim personi”* babain e tij XH.SH, ngjarje e ndodhur në datën 06.06.1997 në zonën e Kurbinit; ankesa me nr.201301726 e shtetasës F.H. nga Lushnja për dëmtim të rëndë shkaktuar nga aksidenti automobilistik, për të cilën Prokuroria kishte filluar hetimet për veprat penale të *“Shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor”* dhe *“Largim nga vendi i aksidentit”* dhe më datën 30.04.2013, kishte vendosur pezullimin e hetimit për mosnjohje të autorit, etj.

Në disa raste të ankesave është konstatuar se organi i Prokurorisë ka vendosur në mënyrë të padrejtë dhe të pabazuar, mosfillimin apo pushimin e procedimit penal, sidomos për veprën penale *“Falsifikimi i dokumenteve”* për pronësinë, *“Shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor”* me pasojë vdekje të personit. Kemi konstatuar se jo në pak raste

verifikimi i kallëzimeve penale të shtetasve bëhet formal, ose tej afateve të përcaktuara në urdhrin e Prokurorit të Përgjithshëm.

Në ankesën me nr.201203269, më datën 19.02.2013 i është Rekomanduar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Pogradec *“Shfuqizimi i vendimit të vendimit të pushimit të çështjes penale nr.228 e vitit 2011, për veprën penale “Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor” me pasojë dëmtimin e rëndë të shtetasës L.D”*. Rekomandimi është marrë në shqyrtim dhe është pranuar duke filluar hetimin e procedimit penal.

Në ankesën me nr.201300321, i është Rekomanduar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan *“Fillimi i hetimit për veprën penale “Trafikimi i femrave” në ngarkim të shtetasve E.B etj, analizimin e rastit dhe marrjen e masave administrative përkatëse”*. Rekomandimi pasi është marrë në shqyrtim nuk është pranuar.

Në ankesën me nr.201300954 i është Rekomanduar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë *“Fillimi i hetimit për veprat penale të “Falsifikimit të dokumenteve” në ngarkim të punonjësve të Z.R.P.P.Tiranë, “Shpërdorimit të detyrës” ndaj Entit Kombëtar të Banesave, si dhe “Kryerje të veprimeve arbitrare”, në ngarkim të përmbauesit gjyqësor B.N”*. Rekomandimi është pranuar dhe janë filluar hetimet e procedimit penal.

Në ankesat e shqyrtuara me nr. 2013012236, nr.201301237, nr.201301238, nr.201301249, nr.201301250, nr.201301251, nr.201301254, nr.201301257, është konstatuar mosinformim i palës së interesuar për ecurinë e hetimit të procedimit penal nr.1494 filluar datë 12.03.2013, për veprën penale të “Mashtrimin”, kryer nga kompania private “Flash Company”, në dëm të pasurisë së një grupi punëtorësh nga Tirana të cilët punonin në amabllazhimin e kartonit;

Në ankesat të tjera, qytetarët i janë drejtuar institucionit të Avokatit të Popullit, për mosdhënie nga organi i Prokurorisë të akteve të ndryshme si, kopje të vendimit të pushimit të çështjes penale, të aktit të ekspertimit tekniko-grafik të nënshkrimit etj. E tillë është ankesa me nr.201301230 e shtetasës S.D. nga Lezha e cila ankohej ndaj Prokurorisë së atij rrethi, për mosdhënie të akteve të procedimit penal nr.516 të vitit 2012, dhe konkretisht aktin e ekspertimit grafik të shkrimit e nënshkrimit nr.3297 të vitit 2013, veprim i cili është realizuar pas dërgimit të shkresës së Institucionit të Avokatit të Popullit dhe ankuesja në takimin me Ndihmës Komisionerin konfirmoi faktin e marrjes së aktit të kërkuar.

Në ankesën me nr.201301207 të shtetasit M.XH. nga Tepelena, ankohej ndaj Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, për mosnjohim të vendimit të pushimit të procedimit penal nr.68, marrë në datën 11.07.2012, për veprat penale të “Vjedhjes” dhe “Shpërdorimit të detyrës”. Pas dërgimit të shkresës dhe komunikimit me prokurorin e çështjes ankuesi M.XH., ka marrë kopjen e vendimit të pushimit të çështjes të cilën e ka ankimuar në gjykatë.

Avokati i Popullit ka marrë në shqyrtim dhe rastin e ankesës me nr.201300651, të shtetasit J.O. nga Gana e Afrikës, për të cilin Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës, kishte filluar procedimin penal për veprën penale të “Falsifikimit të dokumenteve”. Ankesa është trajtuar në vend duke shkuar në I.E.V.P Durrës dhe verifikuar të gjitha pretendimet e shtetasit të huaj J.O. kryesisht për moskuptimin e veprës penale për të cilën akuzohej, masën e dënimit që parashikon ajo vepër penale etj.

Për vitin 2013, shtetas të ndryshëm kanë paraqitur me shqetësim ankesat e tyre ndaj organit të Prokurorisë, për moskryerje të hetimeve objektive për veprat penale të “Shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor” dhe “Mjekim të pakujdesshëm”, me pasoja vdekjen e pjesëtarëve të familjeve të tyre, apo dëmtim të shëndetit. Këto ankesa janë vlerësuar nga Avokati i Popullit si një shqetësim qytetar dhe për pasojat tejet të rënda që ato sjellin.

Në ankesën me nr.201301715, shtetasi B.M. nga Tirana, ankohej ndaj Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kavajë, për kryerje të parregullta të veprimeve hetimore procedurale si, këqyrje të vendit të ngjarjes etj, dhe zvarritje në hetimin e procedimit penal nr.141 filluar në datën 07.04.2013, për veprën penale të “Shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor” me pasoja të rënda në shëndetin e babait të tij F.M etj. Në këtë procedim penal ishin kryer tre ekspertime të ndryshme autoteknike dhe hetimet nuk ishin përfunduar, ndonëse kishin kaluar 9 muaj.

Në ankesat me nr.201300313, nr.20130213 etj, shtetasit janë ankuar ndaj Prokurorisë për vepra penale të kryera nga pakujdesia, që rrezikojnë jetën apo shëndetin në fushën e mjekësisë. I tillë ishte rasti i ankesës së shtetasit B.B. nga Elbasani, i cili kishte kërkuar ndërhyrjen e Institucionit të Avokatit të Popullit, për mjekim të pakujdesshëm me pasojë vdekjen e vëllait të tij T.B., ngjarje e ndodhur në datën 17.12.2011. Pas marrjes së informacioneve nga Qendra Spitalore “Xh. Kongoli” Elbasan, Q.S.U.T. “Nënë Tereza” Tiranë, si dhe vendimit të marrë nga Këshilli Kombëtar i Urdhrit të Mjekëve të Shqipërisë, ankuesi u orientua për të drejtën e paraqitjes së kallëzimit penal në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Elbasan, e drejtë kjo e parashikuar në nenin 283 të Kodit të Procedurës Penale.

Në ankesën me nr.201301199 të shtetasit H.B. nga Përmeti, është kërkuar ndërhyrja e Institucionit të Avokatit të Popullit, me qëllim kryerjen e hetimeve objektive në procedimin penal nr.66 të vitit 2012, për veprën penale të “Mjekimit të pakujdesshëm” me pasojë vdekjen e vajzës së tij E.B. Nga verifikimet e kryera jemi informuar për faktin se nga ajo Prokurori ishin kryer veprime korrekte bazuar dhe në konkluzionet objektive të aktit të ekspertimit mjeko-ligjor nr.868 kryer nga ekspertë të I.M.L.Tiranë. Po ashtu, nga ana e Prokurorit të Përgjithshëm, për objektivitet në hetim ishte caktuar i komanduar, një prokuror i Prokurorisë së një Rrethi tjetër Gjyqësor.

Me të njëjtin shqetësim paraqitet dhe rasti me nr.201302505 i shtetasit N.J. nga Lezha, i cili ankohej për pushim të padrejtë të hetimit të procedimit penal nr.1258 filluar në datën 13.03.2012, me pasojë vdekjen e bashkëshortes së tij D.J, marrë më datën 10 Tetor 2013, nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Për rastet e ankesave të mësipërme kemi konstatuar se nga Prokuroritë në Rrethet Gjyqësore, kryhen ekspertime autoteknike apo mjeko ligjore me konkluzione të nxituara dhe aspak objektive, sidomos në momentin pas ndodhjes së ngjarjes kriminale. Familjarët e viktimave, apo të dëmtuarit nga këto vepra penale, nuk njihen me ecurinë e hetimeve, me vendimet përkatëse për kryerjen e ekspertimit apo konkluzionet e akteve të ekspertimit. Në raste të tjera, nuk merren në konsideratë kërkesat, apo pretendimet e tyre për kryerje të ekspertimeve me grup ekspertësh, pasi ekspertimi i mëparshëm nuk ka qenë korrekt, për hetime të njëanshme duke favorizuar autorët e veprave penale si, drejtuesin e mjetit, apo mjekun dhe personelin tjetër mjekësor.

Konkluzione

Zvarritjet e pajustificuara në hetimin e procedimeve penale nga organi i Prokurorisë janë evidente. Ato kanë ardhur jo vetëm për mosndjekje të kryerjes së veprimeve hetimore në vazhdimësi nga oficerët e policisë gjyqësore, mosdrejtimin e hetimit nga prokurori, por edhe për moskontroll të tyre nga drejtuesit e Prokurorisë.

Nga ana e Policisë Gjyqësore sidomos e Policisë së Shtetit, konstatohen kryerje të veprimeve hetimore procedurale me mangësi e të meta profesionale, më e theksuar për rastet e veprave penale filluar mbi bazën e ngjarjeve kriminale, ku le për të dëshiruar , mosprania e prokurorit në disa raste, për vepra penale me rrezikshmëri shoqërore dhe pasoja të rënda.

Me më tepër përgjegjësi, profesionalizëm dhe objektivitet duhet të konkludohet nga prokurori, për “fajësinë” e autorit të dyshuar të veprës penale pas kryerjes së ekspertimeve, duke shmangur dhe minimizuar kryerjen e disa ekspertimeve.

Palët në procesin penal duhet të njihen me akte të rëndësishme të dosjes hetimore si, vendimet për kryerjen e ekspertimeve, aktet e ekspertimit, apo dhe vendimin përfundimtar si, mosfillimin e procedimit, pushimin e çështjes apo pezullimin e hetimit, ky i fundit pothuajse nuk ju bëhet me dije palëve të interesuara, kallëzuesve dhe palës së dëmtuar nga vepra penale në procesin penal, duke iu mohuar të drejtën e ankimit të tyre në gjykatë.

Më tepër kujdes duhet të tregohet në respektimin dhe zbatimin e nenit 287 të Kodit të Procedurës Penale, cili bën fjalë për Regjistrimin e Njoftimit të Veprës Penale, duke urdhëruar regjistrimin e emrit të personit që i atribuohet vepra penale.

Marrëdhëniet me organin e Prokurorisë kanë qenë përgjithësisht korrekte, dhe bashkëpunuese. Ato kanë konsistuar dhe në takime e komunikime të Ndihmës Komisionerit për një pjesë të konsiderueshme të ankesave të shqyrtuara në vend, me prokurorë të çështjes dhe drejtues të Prokurorive, të cilat mendojmë se kanë qenë mirëkuptuese dhe produktive.

Ndërsakonstatohet mirëkuptim në kthimin e përgjigjeve të kërkesave të Avokatit të Popullit për shpjegime, apo informacione të rastit, por jo gjithmonë sipas afatit të kërkuar bazuar në nenin 19 gërma “ç” paragrafi 1 të Ligjit “Për Avokatin e Popullit”, do të sugjerohet që nga ana e organit të Prokurorisë, Rekomandimet e Avokatit të Popullit të shqyrtohen e vlerësohen me kujdes dhe profesionalizëm, pasi ato i shërbejnë përmirësimit dhe rritjes cilësore të punës së organit të Prokurorisë.

Veprimtaria e Zyrave të Shërbimit Përmbartimor Shtetëror

Vështrim i përgjithshëm

Veprimtaria e Shërbimit të Përmbartimit Gjyqësor Shtetëror apo Privat në përmbushje të misionit për ekzekutimin e detyrueshëm të titujve ekzekutiv, gjatë vitit 2013, në optikën e Institucionit të Avokatit të Popullit lë për dëshiruar, kjo përsa i përket mosrespektimit në mënyrë rigoroze dhe në afat të procedurave ligjore sikurse parashikohet në aktet normative. Gjithashtu, organet e Administratës Publike, në cilësinë e palës debitoare apo të personit të tretë në procesin e ekzekutimit të një numri të konsiderueshëm të titujve ekzekutiv, nuk kanë kryer veprimet për ekzekutim në mënyrë të rregullt, nuk respektojnë afatet ose kryejnë të kundërtën e asaj që me vendim të gjykatës janë të detyruar. Edhe pse në raporte vjetore, të veçanta apo informacione, është vënë në dukje situata në të cilën ndodhet procesi i ekzekutimit të një numri të konsiderueshëm të titujve ekzekutiv si dhe është kërkuar reflektim nga ana e autoriteteve të ngarkuara me ligj për ekzekutimin e titujve ekzekutiv, konstatojmë se, qëndrimet e parregullta në përmbushjen e detyrimeve ligjore përsëriten vit pas viti. Kjo situatë haset veçanërisht në procesin e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë të dhëna në ngarkim të organeve të Administratës Publike.

Kuadri ligjor që garanton zbatueshmërinë e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, si dhe titujve të tjerë ekzekutiv.

E drejta për një proces të rregullt, si një e drejtë themelore e individit, është e garantuar në nenin 42, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe parashikohet dhe në nenin 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut. Kurse në nenin 1 të Protokollit nr.1 të Konventës, parashikohet se: *“Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën që t’i respektohet pasuria e tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara me ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare”*.

E drejta për një proces të rregullt ligjor, në thelb, nuk mund dhe nuk duhet të konceptohet si një e drejtë, e cila qëndron vetëm tek veprimtaria e organeve gjyqësore, pasi ajo fillon dhe nuk mund të përjashtohet edhe në veprimtarinë administrative të organeve të administratës publike me rastin e respektimit të detyrimit të sanksionuar në nenin 142, pika 3, e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, se: *“Organet e shtetit janë të detyruara të ekzekutojnë vendimet gjyqësore.”*

Në funksion të dispozitave kushtetuese dhe të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, janë miratuar një sërë aktesh ligjore dhe nënligjore në të cilat parashikohen të drejtat dhe detyrimet e organit të caktuar me ligj, debitorit, si dhe çdo person i tretë në procesin e ekzekutimit.

Ligji nr. 8116, datë 29.03.1996, Kodi i Procedurës Civile, i ndryshuar, pjesë të tij, Ligji nr.9331, datë 21.04.1998, *“Për ekzekutimin e vendimeve penale”*, i ndryshuar, Ligji nr. 7850, datë 29.07.1994, Kodi Civil i ndryshuar, pjesa e katërt, parashikon veprimet proceduriale, dhe mënyrën e zgjidhjes së çështjeve për Shërbimin e Përmbartimit Gjyqësor Shtetëror,

dhe atë Privat, në procesin e ekzekutimit të titujve ekzekutiv. Rregullat e organizimit dhe funksionimit të Shërbimit të Përmbaramit Gjyqësor parashikohen në Ligjin nr. 8730, datë 18.01.2011, *“Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Përmbaramit Gjyqësor”*, nr.10031, datë 11.12.2008 *“Për Shërbimin Përmbaramor Gjyqësor Privat”*.

Organet e administratës publike në procesin e ekzekutimit të detyrueshëm të titujve ekzekutiv kanë detyrimin për bashkëpunim me Shërbimin e Përmbaramit Gjyqësor sikurse parashikuar në nenin 523 të K.Pr.C. si dhe në aktet nënligjore të nxjerra në funksion të kësaj dispozite, si: Udhëzimi përbashkët i Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Brendshme, Nr. 3880/3, datë 03.06.2011 *“Për procedurat e bashkëpunimit të shërbimit të përmbaramit gjyqësor shtetëror me policinë e shtetit”*. Në funksion të nenit 589 të Kodit të Procedurës Civile, Udhëzimi i Këshillit të Ministrave nr.2, datë 18.08.2011, *“Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të institucioneve buxhetore në llogari të thesarit”*.

Problematikat e konstatuara gjatë procesit të shqyrtimit të ankesave të pranuar për shqyrtim gjatë vitit 2013, lidhur me respektimin e së drejtës për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor si rrjedhojë e mosekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë në një afat të arsyeshëm përgjithësisht janë në evidencuar edhe në vitet e shkuar. Gjatë vitit 2013 janë pranuar për shqyrtim 125 raste, nga të cilat 35 raste janë ndaj Shërbimit Përmbaramor Gjyqësor Shtetëror dhe atij Privat, kurse 90 raste ndaj organeve të Administratës Publike. Në këto ankesa, subjekte të ndryshëm fizikë dhe juridik kanë prezantuar shqetësimin për shkeljen e parimit për zhvillimin e procesit të rregullt ligjor si rrjedhojë e mosekzekutimit në një afat të arsyeshëm të vendimeve gjyqësore të formës së prerë nga ana e organeve të ngarkuar me ligj për ekzekutimin e tyre. Shqetësuese paraqitet kjo situatë në rastin e mospërmbushjes së detyrimeve në të holla apo kryerjen e një veprimi të caktuar nga ana e organeve të Administratës Publike, megjithëse vendimet gjyqësore të pranuar për ekzekutim kanë marrë formë të prerë në një diapazon kohor prej 10 vitesh para vitit 2013.

Mosgëzimi i së drejtës të fituar në rrugë gjyqësore, në një afat të arsyeshëm, prej subjekteve gjyqfitues, edhe pse autoritetet e ngarkuar me ligj prej muajsh e vitesh kanë marrë dijeni apo kanë kryer procedura për ekzekutim, ka detyruar një numër subjektësh gjyqfitues t'i drejtohen Gjykatës Kushtetuese për konstatimin e cënimit të parimit për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor si rrjedhojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësore të formës së prerë në afat të arsyeshëm prej autoriteteve të ngarkuar me ligj për zbatimin e tyre. Në vendimmarrjet e kryera, Gjykata Kushtetuese ka konsideruar se, ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë, përbën një element thelbësor të shtetit të së drejtës e të vetë nocionit të gjykimit të drejtë. Asnjë organ shtetëror nuk mund të vërë në diskutim drejtësinë e vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Çdo organ shtetëror detyrohet të marrë masat përkatëse për zbatimin e tyre. Vetëm pas realizimit të kësaj faze mund të konsiderohet se individi e ka vendosur plotësisht në vend të drejtën e tij të fituar. Procesi i vendosjes në

vend të një të drejte të shkelur, përfshin jo vetëm vendimmarrjen e gjykatave, por edhe veprimet konkrete të organeve përgjegjëse të ngarkuara me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Përmendja nga ana e autoriteteve shtetërore e mungesës së fondeve si justifikim, për të mos respektuar një detyrim financiar që rrjedh nga një vendim gjyqësor i formës së prerë, nuk gjen mbështetje ligjore dhe nuk mund të shërbej si shkak për organet debitore në përmbushjen e detyrimit. Këtij vlerësimi ka qenë dhe është Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut, e cila pas shqyrtimit të të parës çështje shqiptare, të ushtruar nga kreditori, firma e ndërtimit "Qufaj" sh.p.k, për mosekzekutimin e një vendimi gjyqësor të formës së prerë nga Bashkia, Tiranë, nënvizon në Vendimin datë 18.11.2004, se : *"Asgjë, as mungesa e fondeve nga ana e autoriteteve nuk e justifikon mos ekzekutimin e nje vendimi gjyqësor"*.

Procesi i ekzekutimit të detyrimeve në të holla ndaj institucioneve buxhetore me rastin e nxjerrjes së Udhëzimit nr.2, datë 18.08.2011, *"Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të institucioneve buxhetore në llogarit të thesarit"*, prej Këshillit të Ministrave, kryhet në vlerësimin e Institucionit të Avokatit të Popullit, në cënim të së drejtës për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor.

Institucionit i Avokatit të Popullit, duke i vlerësuar në kundërshtim me disa prej parimeve të Kushtetutës si dhe dispozita ligjore të Kodit Civil dhe Kodit të Procedurës Civile, përcaktimet e kryera në Udhëzimin nr.2, datë 18.08.2011, *"Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të institucioneve buxhetore në llogarit të thesarit"*, të Këshillit të Ministrave, ka bërë të mundur gjatë vitit 2013, kërkimin pranë Gjykatës Kushtetuese të shfuqizimit të udhëzimit të sipërcituar si akt i papajtuëshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Kërkesa është shqyrtuar më datë 17.09.2013 dhe pritet shpallja dhe zbardhja e vendimit.

Mosekzekutimi i detyrimit për rikthimin në detyrë të gjyqfituesit, pothuajse në gjitha rastet e pranuar për shqyrtim pranë Avokatit të Popullit, prej organeve të Administratës Publike, me pretendimin se organika është plotësuar apo suprimuar struktura, nuk qëndron. Gjykata Kushtetuese, në jurisprudence e saj, është shprehur se i takon debitorit (organit të Administratës Publike) të gjejë një mundësi zgjidhjeje sa më të përshtatshme për rastet, me qëllim vënien në vend të së drejtës së kreditorit (gjyqfituesit).

Gjatë vitit 2013 e në vijim, janë shqyrtuar si dhe vazhdojnë të shqyrtohen një numër rastesh, me problematikat e lartpërmendura. Edhe pse janë kryer e kryen veprime për ekzekutim prej Shërbimit të Përmbarimit Gjyqësor Shtetëror apo Privat, edhe pse Institucioni i Avokatit të Popullit, për çështjet në proces trajtimi, rast pas rasti, ka ndërhyrë për mundësimin e rivendosjes në vend të së drejtës së shkelur ankuesve, nuk është bërë e mundur në shumicën e rasteve, materializimi i së drejtës të fituar në rrugë gjyqësore prej individëve.

Mospërmbushja prej organeve të Administratës Publike i detyrimeve në të holla, ndaj subjekteve gjyqfitues, përveçse ka cënuar dhe cënon parimin e lartpërmendur, i ka shkaktuar dhe i shkakton buxhetit të shtetit, kosto financiare shtesë. Referuar rasteve të pranuar për shqyrtim pranë Institucionit të Avokatit të Popullit, konstatohet se, shumë prej tyre kanë vite që nuk ekzekutohen, për rrjedhojë, detyrimi financiar i lindur pas marrjes formë të prerë të vendimit gjyqësor rritet për çdo ditë, duke kapur shifra tejet të larta. Nga drejtuesit e organeve debitore, duhet kuptuar se përmbushja e detyrimit në

të holla, sikundër ka vendosur gjykata, përveçse përbën një detyrim kushtetues, është në interes të organit debitor të kryej shlyerjen e detyrimit pa u kërkuar prej gjyqfituesit vënia në ekzekutim e titullit ekzekutiv pranë Shërbimit të Përmbaramit Gjyqësor. Kjo, për faktin se me rastin e vënies në ekzekutim të titullit ekzekutiv pranë Shërbimit të Përmbaramit Gjyqësor rritet masa e detyrimit në të holla për shkak të detyrimit të palës debitore të paguaj dhe shpenzimet përmbaramore. Në vlerësimin e Institucionit të Avokatit të Populli, respektimi i detyrimit të sanksionuar në nenin 142/3 të Kushtetutë se Republikës së Shqipërisë, se : *“Organet e shtetit janë të detyruara të ekzekutojnë vendimet gjyqësore”*, le për të dëshiruar.

Nga trajtimi i ankesave drejtuar Institucionit të Avokatit të Popullit, konstatohet se janë të pakta rastet kur është bërë e mundur kryerja prej organeve të administratës publike debitore, i procedurave për kërkimin nga punonjësi fajtor i kthimit të dëmshpërblimit që ka paguar, si për rastet e dëmeve pasurore dhe jopasurore jashtëkontraktore ashtu dhe ato kontraktore. Kjo situatë kërkon reagim të menjëhershëm të të gjithë drejtuesve të organeve të Administratës Publike në drejtim të zhvillimit të procedurave për ngarkimin dhe vjeljen e detyrimit në të holla punonjësit fajtor, sikurse parashikuar në Ligjin Nr. 8510, date 15.07.1999 *“Për përgjegjësinë jashtëkontraktore të organeve të administratës shtetërore”*, Kodin e Punës, Kodin e Procedurave Administrative, Kodin Civil etj, me qëllim mbrojtjen e interesave të të gjithë taksapaguesve.

Gjatë procesit të shqyrtimit të ankesave të depozituara nga qytetarë të ndryshëm, të cilat kanë të bëjnë me cënimin e së drejtës për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor, Avokati i Popullit, gjatë vitit 2013, ka bërë 54 rekomandime drejtuar autoriteteve të ngarkuar me ligj për ekzekutimin e tyre, nga të cilat 35 janë pa përgjigje, 8 rekomandime të pranuar duke u zgjidhur ankesa dhe në 11 raste rekomandimi është pranuar pjesërisht pa vendosur në vend të drejtën e shkelur qytetarit. Qëndrimi i drejtuesve të organeve të administratës publike, të cilëve u jemi drejtuar me rekomandim, ka qenë i ndryshëm. Për rastet e detyrimit të pagimit të detyrimeve në të holla, përgjithësisht justifikimi ka qenë se nuk disponohen fonde dhe se shlyerja do të kryhet me këste në referim të mundësive financiare si dhe përcaktimeve të Udhëzimit nr.2, datë 18.08.2011, *“Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të institucioneve buxhetore në llogarit të thesarit”*, të nxjerr prej Këshillit të Ministrave.

Në këtë kuadër do të vinim theksin në faktin që angazhimet ndërkombëtare të Shqipërisë po bëhen gjithnjë dhe më konkrete, sidomos në planin e të drejtave të njeriut, të zbatimit të akteve juridike ndërkombëtare dhe të integritimit evropian. Vlerësojmë se, për çështjet që kanë të bëjnë me cënimin e së drejtës për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor si rrjedhojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, që prezantohet për zgjidhje pranë Gjykatës së Strasburgut kundër Shtetit Shqiptar, çenohet autoritetit i shtetit, për një të drejtë të kësaj natyre. Parlamenti Evropian në miratimin e rezolutës për Shqipërinë datë 08.07.2010, ka kujtuar autoritetet në Shqipëri se një nga kushtet e integritimit në BE është reforma në gjyqësor, përfshi zbatimin e vendimeve gjyqësore.

Shërbimi i Përmbaramit Gjyqësor Shtetëror si dhe ai Privat, në procesin e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, kanë hezitur të kryejnë veprimet përmbaramore sikurse parashikuar në Kodin e Procedurës Civile. Veprimet për ekzekutimin e detyrimeve në të holla ndaj institucioneve buxhetore, kemi parasysh këtu vendosjen e masës së sekuestrës mbi llogarinë e palës debitore, apo vendosjen e sanksioneve ndaj debitorit apo personave të tjerë, nuk kryhet sikundër parashikuar në nenin 527, 589, 581, 531, 606

të Kodit të Procedurës Civile. Ndërhyrja e Institucionit të Avokatit të Popullit, për këto raste pranë Shërbimit të Përmbartimit Gjyqësor Shtetëror apo Privat, ka konsistuar në mundësimin e ndërprerjes së cënimit të së drejtës për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor, duke rekomanduar kryerjen e veprimeve përmbartimore sikurse parashikuar në dispozitat ligjore të lartpërmendura, por nuk ka gjetur mirëkuptim prej Shërbimit të Përmbartimit Gjyqësor në respektimin e rekomandimeve të dhëna, për shkak se, përmbartuesit gjyqësor justifikojnë qëndrimin e tyre me respektimin e përcaktimeve të kryera në Udhëzimin Nr.2, datë 18.08.2011, të Këshillit të Ministrave.

Në mospërputhje me parashikimet e akteve ligjore si dhe atyre të nxjerra në funksion të tyre, Shërbimi i Përmbartimit Gjyqësor Shtetëror apo Privat, në procesin e ekzekutimit të titujve ekzekutiv, me rastin e mospërmbushjes së detyrimit në mënyrë vullnetare prej palës debitore, nuk kryen në mënyrë aktive veprimet përmbartimore të cilat do të mund të sjellin ekzekutimin e detyrueshëm të tyre, duke mos luajtur në këtë mënyrë rolin vendimtar që i takon në procesin e ekzekutimit. Në shumicën e ankesave të depozituara pranë Institucionit të Avokatit të Popullit, konstatohet lehtësisht, se, shteti nuk ka marrë përsipër në mënyrë vijuese dhe rast pas rasti, detyrimin për të siguruar palët pjesëmarrëse në procesin e ekzekutimit se, do të kenë mundësi reale të ekzekutojnë titujt ekzekutivë. Për rrjedhojë, e drejta për të pasur akses në gjykatë, për subjektet ankues, është shëndruar në iluzion, për faktin e pazbatueshmërisë së titujve ekzekutiv për një kohë tepër të gjatë. Ndërkohë ka qenë Gjykata Kushtetuese e cila gjatë vitit 2013, e cila ka gjykuar dhe pranuar kërkesat e nëntë subjekteve të ndryshëm, me objekt të njëjtë: *“Konstatimin e cënimit të parimit për një proces të rregullt ligjor si pasojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nga autoritetet e ngarkuara nga ligji, brenda afatit të arsyeshëm, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6/1 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut”.*

Në 125 rastet e pranuar për shqyrtim gjatë vitit 2013, konstatohet se, qytetarët janë ankuar për mosekzekutim të vendimeve gjyqësore në 35 raste ndaj Shërbimit të Përmbartimit Gjyqësor Shtetëror dhe Privat, kurse në 90 raste ndaj organeve të Administratës Publike. Qëndrimi i organeve të Administratës Publike, ndaj të cilave është vendosur gjyqësisht një detyrim i caktuar, nuk vjen në respektim të detyrimit kushtetues, të parashikuar në nenin 142/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Ajo çfarë mund të ndiejnë ata qindra gjyqfitues dhe familjet e tyre është zhgënjimi dhe humbja e besimit të shteti i së drejtës. Ndodhur në këto situata, në dijeninë e Institucionit të Avokatit të Popullit, qytetarë të ndryshëm i janë drejtuar Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në Strasburg, duke kërkuar konstatimin e cënimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si rrjedhojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë në një afat të arsyeshëm, sikurse garantuar në nenin 6/1 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut, miratuar me Ligjin nr. 8137, datë 31.07.1996, nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

Lidhur me numrin e ankesave të pranuar për shqyrtim gjatë vitit 2013, ndaj veprimeve apo mosveprimeve të Shërbimit të Përmbartimit Gjyqësor Shtetëror, rezulton se, numri më i madh është ndaj Zyrës së Përmbartimit Tiranë, gjithsej 8 ankesa. Po kështu, rezulton se 5 ankesa janë ndaj Zyrës së Përmbartimit Fier, 4 ndaj Zyrave të Përmbartimit Durrës dhe Elbasan, 3 ndaj Zyrës së Përmbartimit Shkodër dhe Gjirokastër, 2 ndaj Zyrës së Përmbartimit Korçë dhe nga 1 ndaj Zyrave të Përmbartimit Krujë, Kurbin, Tropojë, Pukë dhe Lushnje.

Analizë e rasteve konkrete

Respektimi i detyrimit për dhënien e shpjegimeve apo informacionit të kërkuar prej Institucionit të Avokatit të Popullit, për një numër rastesh në shqyrtim, nuk është kryer në afatin e parashikuar në ligj, situatë e cila ka ndikuar në mostrajtimin e çështjeve në një afat të arsyeshëm si dhe mundësisë së zgjidhjes në këtë afat. Të tilla janë rastet e ankesave me nr.201204209, nr.201302402, nr.201200869, nr.201200431, nr.201301045, nr.201301252, nr.201301865, nr.201302271, nr.201302325, nr.201301045, etj.

E njëjta situatë konstatohet dhe në qëndrimet e mbajtuara prej organeve të Administratës Publike ndaj rekomandimeve të dhëna prej Institucionit të Avokatit të Popullit. Edhe pse është bërë i ditur afati ligjor për kthimin e përgjigjes rreth rekomandimit të dhënë, pa shkak, organet të cilave ju është drejtuar rekomandimi nuk përmbushin në kohë detyrimin për kthimin e përgjigjes. Të tilla janë rastet e ankesave me nr 201200026, nr.201200706, nr.201200059, nr.201200160, nr.201200244, nr.201201628, nr.201202304, nr.201300640, nr.201300804, nr.201301866, etj.

Ndër rastet të cilat mbartin problematikën e mosekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, vlen të përmendim:

Rasti me nr.doculive 201200489, e shtetasit H.Ç. nga Tirana i cili ankohej për mosekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë Nr. 5658, datë 18.06.2008, të dhënë prej Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë, lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit, Tiranë, me Vendimin nr. 1678, datë 09.12.2009, dhe për të cilin është lëshuar urdhëri i ekzekutimit me Vendimin nr. 177 Akti, datë 25.01.2010, prej Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë, me objekt: *“Detyrimin e palës së paditur Inspektoriati Ndërtimor e Urbanistik pranë Bashkisë, Tiranë, të dëmshpërblejë paditësin me vlerën e objektit të prishur një kat, e regjistruar në ZRPP me nr.1053, datë 15.02.1995 në masën 93 mijë Euro”*. Mbi këtë shqetësim i kemi rekomanduar Kryetarit të Bashkisë, Tiranë: *“Marrjen e masave për dorëzimin e detyrimit financiar në favor të shtetasit H.Ç., sikurse është vendosur nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë, me Vendimin Gjyqësor nr. 5658, datë 18.06.2008”*. Rekomandimi është pa përgjigje.

Rasti me nr.doculive 201302254, e shtetasit E.L. nga Tirana, i cili ankohej për mosekzekutimin e Vendimit Nr.5, date 13.01.2012, të dhënë prej Komisionit të Shërbimit Civil, lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit, Tiranë, me vendimin 51, datë 08.05.2012, dhe për të cilin Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë, ka lëshuar urdhri i ekzekutimit me Vendimin nr. 9751 Akti, datë 09.10.2012, me objekt: *“Shfuqizimin e aktit administrative nr.1567, datë 31.10.2011, të Kryetarit të Bashkisë, Tiranë. Rikthimin e ankuesit në detyrën e specialistit në Sektorin e Rinisë pranë Drejtorisë së Rinisë e Sporteve në Bashkinë e Tiranës dhe pagimin e pages nga moment i ndërprerjes së marrëdhënieve financiare deri në ekzekutimin e vendimit”*. Për këtë i kemi rekomanduar Kryetarit të Bashkisë, Tiranë : *“Marrjen e masave të menjëhershme për përmbushjen e detyrimeve të vendosura sipas Vendimit nr. 5, date 13.01.2012, të Komisionit të Shërbimit Civil, lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit, Tiranë me Vendimin nr. 51, date 08.05.2012, në favor të gjyqfituesit E.L”*. Rekomandimi është pa përgjigje edhe pse me shkresën Nr.K2/E21-3 Prot, datë 13.12.2013, është kërkuar mundësimi i kthimit të përgjigjes.

Rasti me nr.doculive 201301648, ankesa e shtetasës A.XH. nga Tirana, e cila ankohej për mosekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë Nr. 5394, datë 09.07.2007, të

dhënë prej Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë, lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit, Tiranë, me Vendimin nr. 1676, datë 23.10.2008, me objekt: *“Detyrimin e palës së paditur, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë të shpërblejë paditësin A.Xh. me pagën e një viti për zgjidhje të pajustificuar të kontratës së punës, në bazë të pagës mujore në vlerën 39.244 lekë”*. *Detyrimin e palës së paditur Kuvendi i Republikës së Shqipërisë të shpërblejë paditësin A.Xh. me dy muaj pagë për mosrespektim të procedurës së zgjidhjes së marrëdhënieve të punës. Detyrimin e palës së paditur Kuvendi i Republikës së Shqipërisë të shpërblejë paditësin A.Xh. me tre muaj pagë, si shpërblim për vjetërsi”*. Pas rekomandimit Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit, referon si shkak të mosekzekutimit të detyrimit, pamundësinë financiare si dhe ngritjen e rekursit kundër vendimit gjyqësor të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë si dhe Gjykatës së Apelit. Referuar pjesës arsyetuese të Vendimit date 18.11.2004, të Gjykatës Europiane të Drejtave të Njeriut, në shqyrtimin e çështjes shqiptare të ushtruar nga kreditori, firma e ndërtimit “Qufaj”sh.p.k, për mosekzekutimin e një vendimi gjyqësor të formës së prerë nga Bashkia Tiranë, si dhe parashikimeve të nenit 451 të K.Pr.C. kuptohet se, pamundësia financiare apo ngritja e rekursit nuk mund të shërbejnë si shkaqe për mosdorëzimin e detyrimit në të holla palës gjyqësore, ankuesit.

Rasti me nr.doculive 201302780, e shtetasit A.M. nga Tirana ,i cili ankohej për mosekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë Nr. 4460, datë 28.07.2011, të dhënë prej Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë, për të cilin po kjo Gjykatë kishte lëshuar urdhrin e ekzekutimit me Vendimin Nr. 4855 Akti, date 04.10.2013, me objekt : *“Anullimin e vendimit nr.55, datë 19.11.2010, të Komisionit të Shërbimit Civil. Anullimin e vendimit nr.5, datë 25.05.2011, të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, me të cilin është vendosur largimi nga detyra i paditësit A.M. Detyrimin e palës së paditur Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit të kthej paditësin A.M. në pozicionin e Detyrimin e palës së paditur Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit të kthej paditësin A.M. pagën nga data e largimit detyra deri në kthimin në pozicionin e mëparshëm të punës”*. I është rekomanduar Sekretarit të Përgjithshëm pranë MBZHRAU: *“Marrja e masave ligjore për ekzekutimin e detyrimeve të vendosura sipas titullit ekzekutiv, Vendimit Gjyqësor të formës së prerë Nr. 4460, datë 04.15.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, dhënë në favor të shtetasit A.M.”*. Rekomandimi është pa përgjigje.

Rasti me nr. doculive 201302877, ankesa e shtetasës V.M., për mosekzekutimin e Vendimit Nr. 106, datë 29.03.2011, të dhënë prej Komisioni të Shërbimit Civil, lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit, Tiranë, me Vendimin Nr.91, datë 13.10.2011, me objekt : *“Anullimin e procedurave të konkurrimit për pozicionin Specialiste në Sektorin e Financës në Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimit në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve Mbështetëse dhe Integritimit në Ministrinë e Drejtësisë. Detyrimin e Departamentit të Administratës Publike të nxjerrë aktin e emërimit për ankuesen në pozicionin Specialiste në Sektorin e Financës në Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimit në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve Mbështetëse dhe Integritimit në Ministrinë e Drejtësisë”*. Në procesin e shqyrtimit të këtij rasti konstatohet se, Departamenti i Administratës Publike, me Shkresën Nr.1266/2 Prot, date 10.09.2013, kishte mundësuar ekzekutimin e detyrimit të vendosur, por rezulton se Ministria e Drejtësisë nuk kishte bërë të mundur lejimin e ushtrimit të detyrës nga ana

e ankueses V.M. Për këto arsye i kemi rekomanduar Sekretarit të Përgjithshëm pranë Ministrisë së Drejtësisë: *“Marrjen e masave në ekzekutimin e detyrimit të vendosur sipas titullit ekzekutiv, Vendimit Nr. 106, datë 29.03.2011 të dhënë prej Komisionit të Shërbimit Civil, lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit, Tiranë me Vendimin Nr.91, date 13.10.2011, në favor të shtetas V.M.”*. Rekomandimi është pa përgjigje.

Rasti me nr.doculive 201301860, ankesa e shtetasit A.M, e cila ankohej për mosekzekutimin e Vendimit Nr.212, date 26.11.2007, të dhënë nga Komisioni i Shërbimit Civil, lënë në fuqi prej Gjykatës së Apelit, Tiranë, me Vendimin Nr. 101, date 09.09.2008, me objekt: *“Shfuqizimin e aktit administrativ nr. 510, datë 11.06.2006, të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve. Shfuqizimin e aktit administrativ nr.196, date 16.04.2007 të emërimit të z.LI.Ç , Kthimin e ankuesit A.M. në pozicionin e mëparshëm të punës në Degën e Tatimeve, Gramsh, dhe rifitimin e të gjitha të drejtave të parashikuara në ligj”*. Në kushtet e mospërmbushjes së detyrimeve të vendosura i kemi rekomanduar Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve: *“Marrjen e masave të menjëhershme për ekzekutimin e detyrimeve të vendosura sipas Vendimit Gjyqësor të formës së prerë nr.101, datë 09.09.2008, të dhënë prej Gjykatës së Apelit, Tiranë, në favor të shtetasit A.M.”* Në përgjigje të rekomandimit, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, shprehej vetëm për zgjidhjen pjesore të detyrimit në të holla, ndërsa për detyrimin e rikthimit në detyrë të ankuesit A.M, nuk prezantonte asnjë arsye rreth mospërmbushjes së këtij detyrimi.

Rasti me nr.doculive 201301421, ankesa e shtetasit H.K., i cili ankohej për mosekzekutimin e Vendimit Nr.2106, datë 07.03.2008, të dhënë prej Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, lënë në fuqi prej Gjykatës së Apelit Tiranë, me Vendimin Nr. 1949, datë 04.12.09.2008, me objekt: *“Shfuqizimin e aktit administrativ nr. 810. datë 21.08.2007, të palës së paditur Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, për lirimin nga detyra të paditësit H.K. Detyrimin e palës së paditur Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, për të dëmshpërblyer paditësin H.K. me pagën e një viti pune”*. Edhe për këtë rast i kemi rekomanduar Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve: *“Marrjen e masave të menjëhershme për ekzekutimin e detyrimeve të vendosura sipas Vendimit Gjyqësor të formës së prerë nr.2106, datë 07.03.2008, të dhënë prej Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë, në favor të shtetasit H.K.”*. Në përgjigje të rekomandimit të dhënë, Drejtoria e Përgjithshëm të Tatimeve, shprehej se nuk kishte ndjekje përmbarimore siç parashikohet në Udhëzimin nr.2, datë 18.08.2011, të Këshillit të Ministrave. Në këtë qëndrim të shprehur përveç se çenohet e drejta për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor, në mënyrë të parregullt krijohen premisat për rritjen e detyrimit në të holla, për shkak se, kryerja e procedurave për ekzekutim pranë Shërbimit të Përmbarimit Gjyqësor, sjell dhe detyrimin për pagimin e shpenzimeve përmbarimore.

Problematikë tjetër e hasur në procesin e shqyrtimit të ankesave, është pranimi prej Shërbimit të Përmbarimit Gjyqësor, i kërkesës së organit të prokurorisë për vënien në ekzekutim të urdhrit ***të ekzekutimit të lëshuar nga ai organ, për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore penale të formës së prerë, sipas të cilit është vendosur për dënimin me gjobë të subjektit, qëndrim i cili vjen ndesh me parashikimet e 510, 511 të K.Pr.C. Kjo situatë, do të mund të shmangej me rastin e ndryshimeve përkatëse në ligj. Referuar rasteve të pranuar për shqyrtim, Institucioni i Avokatit të Popullit, ka përgatitur rekomandimin përkatës për ndryshimin e kësaj shtate ligjore, drejtuar Ministrisë së Drejtësisë.***

Konkluzione:

Në kushtet kur kjo situatë e prezantuar në procesin e ekzekutimit të titujve ekzekutiv mbart problematika, ndërmarra e masave konkrete për mundësimin e zhvillimit të një procesi të rregullt në ekzekutimin e titujve ekzekutiv është imediate.

Ngritja e një grupi pune për evidentimin e detyrimeve të organeve të Administratës Publike, të rrjedhura nga vendimet gjyqësore të formës së prerë, gjykojmë se është veprimi i duhur i cili duhet kryer në një afat sa më të shkurtër.

Ndodhur në kushtet kur shërbimi i përmbarimit gjyqësor nuk kryen në mënyrë të rregullt veprimet përmbarimore për ekzekutimin e detyrueshëm të titujve, parashikuar në nenet 527, 531, 581, 583, 589, 606 të Kodit të Procedurës Civile, është e nevojshme ndërhyrja prej organit të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Përmbarimit Gjyqësor Shtetëror apo Ministrit të Drejtësisë për Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Privat, nëpërmjet ushtrimit të kompetencave sikurse është parashikuar në nenin 31, dhe 35/dh, të Ligjit nr. 8730, datë 18.01.2001 : “Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Përmbarimit Gjyqësor Gjyqësor” apo Ligjit 10031, date 11.12.2008, “Për Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Privat”.

Përmirësimi i nivelit të bashkëpunimit midis ***Shërbimit të Përmbarimit*** Gjyqësor dhe organeve të tjera si Policia e Shtetit, Inspektorati Ndërtimor dhe Urbanistik Vendor apo Kombëtar, dhe organet e pushtetit vendor, do të sjellë kryerjen e procedurave përmbarimore në një afat të arsyeshëm.

Situata e prezantuar në procesin e ekzekutimit të titujve ekzekutivë, duhet të marrë vëmendjen maksimale për normalizimin e saj, me qëllim ndërprerjen e gjendjes së paligjshmërisë për një numër rastesh si dhe rivendosjen në vend të së drejtës për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor në kryerjen e veprimeve për ekzekutimin e detyrimeve të vendosura sipas vendimeve gjyqësore të formës së prerë.

Ndihma ligjore falas

Ky problem ka gjetur zgjidhje më të mirë me daljen e Ligjit nr.10039 datë 22.12.2008, "Për Ndhmën Juridike", ndryshuar me ligjin nr.143/2013 "Për disa ndryshime në ligjin nr.10039 dt.22.12.2008, "Për Ndhmën Juridike", ligj i cili është botuar në Fletoren Zyrtare nr.83 datë 20 maj 2013.

Në nenin 1 të këtij ligji përcaktohen kushtet, lloji, mënyra dhe procedurat për dhënien e ndihmës juridike falas nga shteti, për mbrojtjen e lirive e të drejtave themelore të individit, si dhe të interesave të tjera të ligjshme të tij.

Nga këto dispozita ligjore del se të drejtën për të përfituar ndihmë juridike falas nga shteti e kanë të gjithë personat të cilët kërkojnë të mbrohen me avokat mbrojtës gjatë procedimit penal në të gjitha fazat e gjykimit dhe për shkak të pamundësisë ekonomike dhe financiare ose që kanë mbetur pa të.

Të drejtën për dhënien e ndihmës juridike falas nga shteti e kanë të gjithë personat që kanë për gjykim në gjykatë, një çështje penale, civile ose një çështje administrative, që nuk kanë mjete të mjaftueshme ekonomike dhe financiare për të paguar një avokat mbrojtës privat, ku futen kryesisht personat që përfshihen në programet e mbrojtjes sociale.

Ndihmë juridike falas nga shteti përfitojnë edhe të miturit për të cilët mbrojtja e tyre është e detyrueshme me ligj dhe kjo ndihmë juridike jepet para ose gjatë procesit hetimor dhe procesit gjyqësor në të gjitha shkallët e tij.

Për disa kërkesa të qytetarëve rezulton se është ndërprerë procedura e vlerësimit të kërkesës për dhënien e ndihmës juridike falas si dhe është refuzuar dhënia e saj për arsye të mosplotësisë të dokumentacionit në përputhje me kërkesat e Ligjit nr.10039 datë 22.12.2008, "Për Ndhmën Juridike", ndryshuar dhe me Vendimin e Komisionit Shtetëror për Ndhmë Juridike Nr.3 datë 25.06.2011, "Për miratimin e formularit të kërkesës për përfitimin e ndihmës juridike dhe dokumentat që duhet t'i bashkëngjiten formularit tip të kërkesës, të ndryshuar si dhe Urdhërin e Ministrit të Drejtësisë Nr.7301/3, datë 19.01.2012, "Për miratimin e rregullores së brendshme të organizimit dhe funksionimit të Komisionit Shtetëror për Ndhmë Juridike".

Lidhur me rishikimin e Ligjit nr.10039, date 22.12.2008, "Për Ndhmën Juridike", Komisioni Shtetëror për Ndhmën Juridike ka finalizuar hartimin e projekt - ligjit "Për një shtesë në Ligjin nr.10039 datë 22.12.2008, "Për Ndhmë Juridike", i cili ka si synim të përjashtojë kategorinë e personave që përfiton ndihmë juridike nga taksat mbi aktet si dhe tarifatat për veprimet e shërbimet e administratës gjyqësore dhe të Ministrisë së Drejtësisë.

Më datën 2 maj 2013, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, ka miratuar Ligjin nr.143/2013, "Për disa ndryshime në Ligjin nr.10039, datë 22.12.2008, "Për ndihmën juridike". Ky ligj mundëson gjithashtu përmirësimin e aksesit në gjykatë në mbrojtje të lirive dhe të të drejtave themelore të individëve. Kjo përbën njëkohësisht edhe një detyrim kushtetues dhe është zbatim i drejtpërdrejtë i nenit 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut. Në këtë ligj janë parashikuar krijimi i klinikave ligjore vendore, të cilat do të afrojnë ndihmë juridike parësore brenda datës 01.04.2014.

Në kuadër të Memorandumit të bashkëpunimit ndërmjet Komisionit Shtetëror për Ndhmën Juridike dhe Avokatit të Popullit të nënshkruar më datën 08.06.2012, gjatë vitit 2013, janë paraqitur 39 kërkesa për ndihmë juridike falas nga shteti, ndërsa Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi i është dërguar 1 rast për ndihmë juridike falas nga shteti.

D. E drejta e Pronës

Vështrim i Përgjithshëm

E drejta e pronës private, si kategori bazike ekonomike-juridike e ndërvarur nga struktura përkatëse politike shoqërore e shtetit, mënyrat e fitimit, shpronësimet dhe kufizimet e saj vetëm për interesa publike dhe kundrejt një shpërblimi të drejtë, si dhe e drejta për t'u mbrojtur nga cënimet e saj nëpërmjet një gjykimi administrativ ose gjyqësor publik janë të garantuara nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.

Këtë buron detyrimi i garantimit të mbajtësit të të drejtës konkrete të një hapësire të lirë në fushën pasurore nëpërmjet mbrojtjes dhe sigurimit të të drejtave të pronës, përdorimit, disponimit dhe mundësitë të organizimit të pavarur të jetës.

Garancia e pronës e ruan sasinë konkrete të të mirave materiale apo frytave të saj, të fituara mbi të gjitha me anë të punës nga ndërhyrjet të pajustificuara të organeve shtetërore.

Fryma e Kushtetutës, në kuptimin e rregullimit të përmbajtjes së pronës private dhe rivendosjes të të drejtës të saj shkelur në vite, respekton barazinë para ligjit, shpalosjen e lirë të personalitetit të pronarëve legjitimë dhe shtetin e të drejtës.

Nga gjithë kompleksiteti i kësaj të drejte, ajo e kthimit apo kompensimit *të saj tek të shpronësuarit nga sistemi i kaluar, mbetet ana më e ndjeshme e saj.*

Regjimi i të drejtës së pronësisë në vitet e zgjatura të tranzicionit ka qenë shpesh i paqëndrueshëm. Proceset e kthimit, por sidomos ai i kompensimit të pronave ka mbetur në kuadrin deklarativ.

Ndërhyrjet dhe ndryshimet në legjislacion përkatës, prej vitit 1991 e në vazhdim, kanë sjellë miratimin e një numri aktesh ligjore dhe nënligjore, për zbatimin e të cilave janë ngritur edhe institucionet dhe instrumentet *përkatëse, detyrë funksionale e të cilave ishte kthimi apo kompensimi i pronës ndaj pronarëve të ligjshëm, zgjidhja e konflikteve administrative* brenda juridiksionit të ushtrimit të kompetencave të tyre.

Në kushtet kur e drejta e pronës ka qenë dhe mbetet një nga prioritetet kryesore për integrimin në Bashkimin Europian, është hartuar një strategji e re me të cilën mendohet të zgjidhet përfundimisht problemi i pronësisë brenda vitit 2020.

Analizë e rasteve konkrete

Institucioni i Avokatit të Popullit në ushtrimin e detyrimeve të tij kushtetuese, brenda tagrave të tij ligjore, i ka kushtuar trajtimin të problemit të pronave kujdesin dhe hapësirën e duhur, për më tepër, që kohët e fundit çështja e implementimit të të drejtës së pronës është klasifikuar nga Komisioni Europian, si një ndër prioritetet për t'í hapur rrugën marrjes së statusit të vendit kandidat.

Ndërmjetësimet, ndërhyrjet apo rekomandimet tona kanë pasur si qëllim zgjidhjen dhe parandalimin e konflikteve individ-organ administrativ, ndikimin në forcimin e konceptit të mirëqeverisjes, ndryshimet dhe përmirësimet në legjislacion dhe forcimin e besimit të qytetarëve tek ky institucion.

Për vitin 2013, janë regjistruar 204 ankesa, kërkesa apo njoftime me objekt të drejtën e pronës, prej të cilave janë zgjidhur në favor të të interesuarve 66 raste, që i korrespondon 34% të totalit.

Për 33 ankesa, ka rezultuar se pretendimet e ankuesve kanë rezultuar të pabazuara, 30 ankesa kanë rezultuar jashtë juridiksionit dhe kompetencave, dhe në 11 raste ka përfunduar procedimi administrativ për shkak të braktisjes së tij nga vetë ankuesi. Pjesa tjetër e ankesave, 64 raste janë ende në proces shqyrtimi nga ana jonë.

Ankesat dhe kërkesat më të shumta dhe për vitin 2013, ndonëse më të ulta se viti i kaluar, janë ndaj Zyrave Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

Së pari duhet vlerësuar fakti, se nga viti në vit, pavarësisht morrisë së problemeve të krijuara në zyrat vendore, ka disa arritje që duhen evidentuar, si ajo e regjistrimit fillestar të pasurive të paluajtshme në rreth 90 % të tyre, dixhitalizimi i të dhënave përfshirë në shtesat dhe ndryshimet e bëra në Ligjin nr. 7829, datë 01.06.1994 "Për Noterinë" dhe Rregulloren "Për përcaktimin e mënyrave, procedurave dhe kushteve për përdorimin e sistemit elektronik "One Stop", sistemi i noterisë"; apo lehtësimi i procedurave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme për të cilat zotërohen dokumenta të ligjshme, por që nuk kanë të përcaktuara sipërfaqen.

Me ndryshimet ligjore të viteve të fundit, sistemi i regjistrimit të pasurive është një realitet konkret kontribues në proceset dhe transformimet e mëdha të ekonomisë tonë.

Objekti i ankesave të depozituara pranë institucionit tonë dhe pretendimet ndaj këtyre zyrave, konsistojnë për mosdhënie informacioni; për mosregjistrimin fillestar të tokave bujqësore, trojeve dhe apartamenteve në ndërtesat shumëkatëshe ndërtuar në kapërcim të të dhënave në lejet e ndërtimit; vonesa në regjistrimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë për mospajisjen e subjekteve me Çertifikatën e Pronësisë; për mbivendosjet e pronave dhe për vonesa të azhornimeve dhe futjes në sistem të Zonave Kadastrale në shumë rrethe të vendit.

Nga ZVRPP-ja është kërkuar një panoramë e përgjithshme mbi progresin e procesit të regjistrimit fillestar të pasurive të paluajtshme në vitet e fundit, numri i zonave kadastrale të mbetura jashtë skemës dhe arsyet e këtyre fenomeneve, vendime të AKKP-së të regjistruara, shkaqet për zvarritjen e procedurave dhe nismat ligjore që mendohet se duhen marrë në interes të përfundimit të regjistrimit dhe azhornimit sidomos të zonave më problematike.

Konkretisht, ankesa me nr. 201204189 Doc. kishte si objekt zvarritjet disa vjeçare në moslëshimin e Çertifikatës së Pronësisë. Pas ndërhyrjes tonë në ZRPP-së Vendore përkatëse, Regjistruesi shprehu gatishmërinë për përfundimin e procedurës me paraqitjen e personit të interesuar.

Një tjetër ankesë, ajo me nr. 201300398 Doc, që kishte të bënte me dhënien i informacionit të plotë shkresor, hartografik të një pasurie të paluajtshme dhe transaksionet në vite me të, u zgjidh po ashtu pozitivisht.

Rreth 40% të praktikëve të trajtuara, kryesisht për mbivendosje pronash, kanë rezultuar jashtë juridiksionit dhe individët janë sugjeruar të ndjekin rrugën gjyqësore.

Numri më i madh i ankesave për vitin 2013 kishin të bënin me ZRPP-të e rretheve Tiranë dhe Shkodër.

Problem mbetet zvarritja e futjes në sistemin e regjistrimit fillestar të jo pak Zonave Kadastrale për shkaqe të ndryshme.

Nga informacionet zyrtare që kemi, rezulton, se në rrethin e Kukësit janë 7 Zona Kadastrale (ZK) që nuk janë futur në sistem; në Pogradec mbetet për trajtim 1 Z.K; në Bulqizë mbeten pa u futur në sistem 10 Z. K.; në Elbasan mbeten pa trajtuar 9 Z.K. që janë në përpunim nga kontraktorët "FINMAPP" dhe "NIRASMAPPING"; në Dibër nga 141 Zona Kadastrale nuk janë futur në sistem 14 pasi nuk është paraqitur në ZVRPP-në vendore produkti i fazës së dytë ose nuk është kryer skanimi apo azhornimi nga ana e kontraktorit CSI-Piemonte; në Mirditë mbeten jashtë sistemit 4 Z.K. që përfaqësojnë 40% të tokës bujqësore; në ZVRPP-në e Bulqizës nuk ka përfunduar regjistrimi fillestar në 10 Z. K. nga 65 që ka në administrim e kështu me radhë. Ndërsa në Durrës janë futur në sistem të gjitha zonat kadastrale.

Shumë ZRPP-ë Vendore nuk kanë shifra të sakta për regjistrimin e vendimeve të AKKP-ve dhe Akteve të Marrjes së Tokës në Pronësi, si dhe për përqindjen e pronësisë apo të përdorimit sipas subjekteve private dhe shtetit.

Problemi i kthimit dhe kompensimit të pronave mbetet një nga çështjet më problematike e të mprehta edhe për të ardhmen. Kjo për shkak të kompleksitetit të problemeve të mbartura nga veprimtaria e shumë institucioneve që veprojnë në fushën e të drejtave të pronës dhe të paaftësisë së strukturave shtetërore përkatëse për të garantuar dhe siguruar një zgjidhje të përshtatshme dhe afatgjatë të tyre, të cilat po vijnë duke u akumuluar nga viti në vit.

Nga ankesat e shqyrtuara nga ana jonë janë zgjidhur pozitivisht çështjet për të drejtën e informimit për trajtimin e dosjeve për njohjen, kthimin ose kompensimin e pronës, si dosja me nr. Doc. 201300447 e shtetases K.F., nga Shkodra, ajo me nr. Doc 201301158 e shtetasit A.E. nga Tirana e tjera.

Për trajtimin e dosjes së ankuesit LL.B., kërkua informacion nga Drejtori i Përgjithshëm e AKKP-së Tiranë, për fondin fizik aktual të vënë në dispozicion të të shpronësuarve nga Qarku i Shkodrës për kompensim e tyre në natyrë. Përgjigja e ardhur, na bënte me dije, se nuk kishte filluar ende ky lloj kompensimi, duke lënë të kuptohej se nuk kishte të dhëna për toka të lira.

Për ankesën e me nr. 201301241 Doc., nga Kryetari i Bashkisë të një qyteti bregdetar, u vumë në dijeni të informacionit shqetësues për faktin, se një pjesë e banorëve, duke pretenduar si të shpronësuar, kanë depozituar në Agjencinë e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave dosjet përkatëse me fakte dhe akte të rreme pronësie për toka, musha fshati, kënetat pyll dhe toka të reja të hapura nga sistemi i kohës, ish prona të cilat nuk kanë lidhje me territorin e qytetit, për të cilat kërkohej ndërmjetësimin e Avokatit të Popullit, për qëndrimin indiferent të AKKP-së duke mos bashkëpunuar me Bashkinë për sa më lart.

Problemin e vlerësuar plotësisht të drejtë dhe si çështje që paraqiste interes të dukshëm publik, në referim të nenit 28/4 të Ligjit nr. 9235, datë 29.07.2004, i ndryshuar, "Për kthimin dhe kompensimin e pronës", i përcollëm një rekomandim Ministrisë së Drejtësisë për bashkëpunimin, bashkërendimin dhe koordinimin e Drejtorisë së Koordinimit pranë asaj Ministrie me AKKP-në Tiranë dhe me Bashkinë e qytetit bregdetar në procesin e shqyrtimit administrative të njohjes, kthimit apo kompensimit të pronave të të shpronësuarve. Ky rekomandim u pranua nga Ministria e Drejtësisë.

Objekti i ankimit për shtetasin A.Gj., dosja me nr.20131175 Doc. ishte vënia në dispozicion të tij nga AKKP-ja e listës së përfituesve për kompensimin financiar nga fondi i vitit 2012. Pas kërkesës tonë për shpjegime ankuesi mori informacionin e duhur për emrat e 33 përfituesve.

Një pjesë e ankesave të qytetarëve kanë rezultuar si të pabazuara, pasi nuk kishin dosje në AKKP apo dosja ishte e paplotësuar me aktet e duhura, shkak për moskalimin në komisionin përkatës zonal.

Nga të dhënat e marra nga AKKP-ja gjatë trajtimit të ankesave të subjekteve të ndryshme, rezulton se nga hyrja në fuqi e Ligjit nr. 9235, datë 29.07.2004 "Për kthimin dhe kompensimin e pronës" dhe deri tani, janë trajtuar dhe marrë vendime për 54.927 dosje. Në zyrat e saj janë ende rreth 7.300 dosje që presin për trajtim dhe vendimmarrje, numër që nuk ka ulje për faktin se shtohen edhe dosjet që janë rivendosur në afat me vendim gjyqësor gjatë dy viteve të fundit.

Centralizimi i procesit të njohjes kthimit dhe kompensimit të pronave në Agjencinë përkatëse vetëm në Tiranë, pas suprimimit të atyre rajonale, ka ndikuar në ngadalësimin e procesit.

Lidhur me kompensimin financiar, gjatë vitit 2013 u kompensuan financiarisht 50 të shpronësuar apo trashëgimtarët e tyre.

Nga viti 2005 kur u kompensuan financiarisht subjektet e para dhe deri në fund të vitit 2013 kanë përfituar afërisht 700 të tillë.

Sipas llogaritjeve të Shoqatës "Pronësi me Drejtësi" kjo faturë shkon deri në 20 miliard Euro.

AKKP-ja disponon aktualisht një fond fizik, në bazë të V.K.M.-në nr. 868, datë 18.06.2008 "Për krijimin e fondit të kompensimit fizik nga fondi i tokës bujqësore", ndryshuar, me sipërfaqe 18.597 ha.

Ndërsa 71.699 ha të tjerë, janë evidentuar si të lira, bazuar në VKM-në nr. 1077, datë 18.06.2008 "Për krijimin e fondit të kompensimit fizik nga fondi pyjor dhe kullusor". AKKP-ja disponon dhe një fond tjetër për kompensimin fizik të objekteve ndërtimore shtetërore,

të cilat do vlerësohen sipas kritereve rigoroze që do privatizohen apo transformohen edhe për procedurat e shitjes.

Vendimet e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtave të Njeriut për mos-kompensimin financiar të subjekteve të shpronësuara në vite, e kanë penalizuar deri tani shtetin shqiptar me rreth 3 milion euro. Ndërkohë janë disa dhjetëra dosje të tjera që presin për gjykim, të cilat së bashku me barrën financiare të sipërcituar, përbëjnë një problem mjaft serioz për shtetin shqiptar dhe angazhimin për zgjidhjen përfundimtare të çështjes së pronave.

Nga verifikimi i korrespondencave zyrtare që kemi pasur me organet e përfshira në procesin e kthimit dhe kompensimit të pronave, rezulton se mungojnë të dhëna të tilla, si numri i vendimeve të AKKP-së dhe Akteve të Marrjes së Tokës në Pronësi të regjistruara në sistem, sa Akte janë në gjykim administrativ në Komisionet Vendore të Verifikimit të Titujve të Pronësisë ose në gjykatë, sa tokë duhet për kompensimin fizik të tjera, kur sipas shoqatave të ish pronarëve duhen afërsisht 50.000 hektarë.

Përparësi duhet të marrë evidentimi sa më i shpejtë i pronave të paluajtshme publike të lira dhe që duhen përdorur për kompensimin fizik të të shpronësuarve, si me kosto shumë më të ulët, se ai financiar

Ankesat lidhur me mosmarrjen në pronësi të tokës bujqësore, në krahasim me vitet e kaluara kanë rënie drastike. Kjo për faktin se procesi i ndarjes dhe rindarjes së tokës bujqësore, si dhe veprimtaria dhe funksionet e komisioneve të tokave në fshat, komuna, bashki, rreth e qark, përfunduan me hyrjen në fuqi të Ligjit nr. 9948, dt. 07.07.2008 "Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore".

Ligji nr. 56/2012, dt. 17.05.2012 "Për një shtesë në ligjin nr. 8053, dt.21.12.1995 "Për kalimin pa shpërblim të tokës bujqësore, të ndryshuar"; ai me nr. 57/2012, dt. 17.05.2012 "Për përfundimin e procesit të kalimit në pronësi të tokës bujqësore të ish-Ndërmarrjeve Bujqësore" dhe V.K.M.-ja nr.222, datë 06.03.2013 "Për përcaktimin e procedurave të kryerjes së procesit të kalimit të tokës bujqësore të ish Ndërmarrjeve Bujqësore në pronësi të përfituesve" kanë ndryshuar llogaritjen e sipërfaqeve të tokave për kompensimit, lënë kompetenca të gjëra kryetarëve të fshatrave, komunave, bashkive dhe këshillave të tyre dhe këshillave të qeverisjes vendore, për trajtimin me tokë bujqësore në pronësi dhe regjistrimin e tyre për subjekte që për shkaqe të ndryshme nuk janë trajtuar për shkaqe të ndryshme.

Ndërsa Ligji nr. 58/2012, datë 17.05.2012 dhe ai me nr. 176/2013 datë 16.12.2013 "Për disa ndryshime në Ligjin nr. 9948, datë 07.07.2008 "Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore" të ndryshuar" shtuan subjektet përfituese, vendosën kriteret për vlefshmërinë ligjore të titujve të pronësisë, krijuan strukturën e Sekretariatit Teknik pranë Komisioni Qeveritar të Tokës, si dhe vendosën që procesi i verifikimit të titujve të pronësisë përfundon në datën 30 Qershor 2016.

E përbashkëta e atyre pak ankesave mbeten zvarritjet tej çdo afati ligjor të shqyrtimit të vlefshmërisë së Akteve të Marrjes së Tokës në Pronësi nga Komisionet Vendore pranë Prefektit të Qarkut dhe mungesa e bashkëpunimit me organet e pushtetit vendor, me zyrat vendore të regjistrimit të pasurive dhe Agjencinë e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave.

Përmendim praktikën me nr. 201300474 doc. me të cilën ankuesi prezantonte pretendimin për zvarritje në shqyrtimin administrative nga K.V.V.T.P.-ja përkatëse e vlefshmërisë të Akteve të Marrjes së Tokës në Pronësi të tre bashkëfshatarëve të tij.

Në interes të shqyrtimit dhe vlerësimit të problemeve konkrete që çënonin pasurinë e paluajtshme të ankuesit, shmangien e konflikteve të mëtejshme që mund të lindin me shtetasit e tjerë që mund të kenë mosmarrëveshje me të për shkak të përplasjes së titujve të pronësisë, si dhe mbrojtjes së vetë interesave shtetërore për pasuritë e shpërndara në mënyrë të paligjshme, kërkuam nëpërmjet rekomandimit angazhimin institucional të Prefektit për përfundimin në një periudhë të afërt kohore të procedimit *të iniciuar për verifikimin e titujve të pronësisë*.

Numri i çështjeve lidhur me problematikën e vlerës së dëmshpërblimit për shpronësimin e pasurive pronë private për interesa publike mbetet konstant, fakt që jep mesazhin, se shpronësimi, si ndërhyrjet e shtetit në të drejtën e pronës së individit duhet të jenë të justifikueshme dhe kufizimet e saj nuk mund të shkojnë përtej qëllimit mbrojtës të cilit i shërben kjo ndërhyrje. Vetë fakti, që Kushtetuta dallon qartë rregullimet për përmbajtjen e pronës nga shpronësimi, nënkupton se kur këto kufij kapërcehen, shpërfillen ose kur shpronësimi për interesa publike bëhet jo me çmimin e real të tregut, procesi është i paligjshëm.

Mbrojtja dhe garantimi i pronës private si dhe shpronësimi i saj për interesa publike, parashikohen në pikat 3, 4 dhe 5 të nenit 41 të Kushtetutës, ku sanksionohet që ligji mund të parashikojë shpronësime ose kufizime në ushtrimin e së drejtës së pronës vetëm për interesa publike, se shpronësimet ose kufizimet lejohen vetëm përkundrejt një shpërblimi të drejtë dhe se për mosmarrëveshjet lidhur me masën e shpërblimit mund të bëhet ankim në gjykatë.

Në zbatim të kësaj norme kushtetuese, Kuvendi ka miratuar Ligjin nr. 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen *në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interesa publike*".

Ankesat janë ndaj masës së shpërblimit ose për zvarritjen disa vjeçare në lëvrimin e tij, rastet e shpronësimeve të trojeve private në qendër të disa qyteteve në qarqet e Elbasanit, Fierit, Tiranës dhe Korçës.

Në kushtet kur vetë ligji në nenin 24 të tij parashikon, se vendimi i Këshillit të Ministrave lidhur me masën e shpërblimit, nëse nuk ankimohet brenda afatit 30 ditor, përbën titull ekzekutiv, ju kemi sugjeruar qytetarëve paraqitjen e padive në gjykatën kompetente.

Gjykojmë me vend *të theksojmë, se kryerja e veprave publike në favor të komunitetit, veçanërisht të përmasave të tilla që ndihmojnë në ngritjen e nivelit ekonomik të vendit, rritjen e cilësisë së jetës të shtetasve, gjithsesi janë për t'u vlerësuar dhe mbështetur, por të ecin paralelisht me zbatimin korrekt të ligjit në mbrojtje të të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të individit*.

Në të tilla kushte Avokati i Popullit ka apeluar për më shumë kujdes dhe profesionalizëm në marrëdhënie me individët dhe me të drejtat që ata gëzojnë, karshi organeve të administratës publike.

Kështu, duke e vlerësuar të argumentuar ligjërisht çështjen me nr. 201300516 Doc. të një grupi të shpronësuar dhe praktikën përkatëse administrative, si shkelje të të drejtave dhe interesave të ligjshme të shtetasve, bazuar të nenin 63, pika 3 të Kushtetutës së Shqipërisë, i rekomanduar Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit trajtimin e menjëhershëm ligjor të ankuesve prona e të cilëve është përdorur për interes publik, për shkak të mospërfundimit të procedurave *për shpronësimin e pronës private të prekur nga projekti për ndërtimin e impiantit të ujërave të përdorura. Përgjigje për këtë praktikë nuk kemi marrë.*

Në rastin e shqyrtimit të shqetësimit të ankuesit G.R., *praktika me nr. 201300472 Doc, i kemi rekomanduar Kryetarit të Bashkisë përkatëse ndërprerja e menjëhershme të ndërhyrjeve dhe veprimeve administrative të paligjshme ndaj pronës private dhe tjetërsimit të saj, veprimeve administrative abuzive që bien ndesh dhe me nenin 1 të Protokollit Shtesë nr. 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Edhe në këtë rast nuk morëm përgjigje, por u konstatua ndërprerja e paligjshmërisë.*

Në praktika të tilla, konstatojmë veprime që prekin dinjitetin e shtetit dhe të personave të caktuar në ushtrimin e funksioneve publike, që çenojnë besimin e komunitetit në to se përsëriten shkelje të parimeve të tilla, si mbrojtja e interesave të pronarëve përkatës, mbizotërimin e interesit publik kundrejt interesave privatë të pronarëve të tyre, garantimi i transparencës, barazia e shtetasve, kompensimin në vlerë përkundrejt një shpërblimi të drejtë dhe element të procedurave paraprake deri në marrjen e Vendimit të Këshillit të Ministrave, mbi kërkesën e subjektit kërkues në favor të të cilit bëhet shpronësimi, të sanksionura në Ligjin nr. 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private, për interesa publike",

Gjykojmë, se referimi i saktë dhe zbatimi rigoroz i parashikimeve ligjore rrit efektivitetin në punë, shmang zvarritjen, si dhe krijon besueshmërinë e organeve të administratës publike në sytë e njerëzve të thjeshtë që presin respektimin e lirive dhe të drejtave të tyre legjitime.

Pushteti vendor duhet të sigurojë qeverisjen, ushtrimin efektiv të funksioneve dhe kompetencave, shërbimet dhe lehtësirat e tjera publike në një nivel sa më afër shtetasve dhe në dobi të bashkësisë.

Kujtojmë, se nenin 14 të Kodi të Procedurave Administrative sanksionohet parimi i përgjegjësisë të organeve dhe punonjësve të administratës publike për dëmet që iu shkaktojnë personave privatë nëpërmjet marrjes së vendimeve të paligjshme, siç është rasti në fjalë.

Këto shkelje të pajustificuara me karakter selektiv na obligojnë të ndërhyjmë institucionalisht në mbrojtje të të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të individëve apo grupeve të individëve nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike, me të gjithë forcën e normave kushtetuese, nenet 60-63 të Kushtetutës dhe të Ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar. Ka rregulla të përcaktuara në akte nënligjore për procedurën e përcaktimit të çmimit sipas zonave kadastrale dhe rretheve, por që në shumë raste nuk respektohen, duke u bërë shqetësim i panevojshëm për subjektet e shpronësuara.

Opinione dhe Rekomandime për vitin në vijim

-Rekomandim për shpejtimin dhe thjeshtimin e procedurave *për legalizimin e ndërtimeve informale, si dhe urbanizimin dhe integrimin e tyre.*

-Rekomandim për përpunimin e të dhënave dhe përfundimin e regjistrimit fillestar në Zyrat Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për vendimet e dhëna në vite nga Agjencitë e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave dhe te Akteve te Marrjes së Tokës në Pronësi.

-Rekomandim për identifikimin e pronave të paluajtshme të lira, bërjen publike të fondit të kompensimit *në natyrë të subjekteve të shpronësuar dhe kalimi i tyre në administrimin e Agjencisë të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave.*

E. E drejta e mbrojtjes shoqërore të punës

Vështrim i përgjithshëm

Liritë dhe të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore parashikohen në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë duke filluar nga *“E drejta për punë”*. Kjo e drejtë, veçanërisht, rregullohet nga dispozitat e Kodit të Punës, i cili ngrihet mbi bazën e Kushtetutës. Sipas nenit 49 të Kushtetutës: *“Secili ka të drejtë të fitojë mjetet e jetesës së tij me punë të ligjshme që e ka zgjedhur apo pranuar vetë”*.

Siguria ekonomike dhe sociale është një aspekt i rëndësishëm i sigurisë njerëzore. Në këtë pikëpamje, e drejta për punë dhe të drejtat gjatë punës luajnë një rol të rëndësishëm për arritjen e sigurisë njerëzore. Të drejtat e punëtorëve janë të sanksionuara në ligji dhe konventa ndërkombëtare të ratifikuara² duke synuar garantimin e kushteve të përshtatshme për punë, mbrojtje kundër diskriminimit dhe shfrytëzimit në vendin e punës. Puna nuk duhet të sigurojë vetëm mirëqenien, por edhe pjesëmarrjen në shoqëri. Për këto arsye, promovimi apo shtytja e standardeve për kushte të përshtatshme të punës, pa shfrytëzim, është kusht për përmirësimin e sigurisë njerëzore.

Deklarata Universale për të drejtat e Njeriut përmban një sërë parimesh të ndërlidhura me të drejtën shoqërore për punën, ku citohet se: *“Gjithkush ka të drejtë për punë, të zgjedhë lirisht profesionin, të ketë kushte të favorshme pune dhe të jetë i mbrojtur nga papunësia”*. *“Gjithkush, pa kurrfarë diskriminimi, ka të drejtë që për punë të njëjtë të marrë rrogë të njëjtë. Gjithkush që punon ka të drejtën për shpërblim të drejtë dhe të favorshëm, në mënyrë që t’i sigurojë atij dhe familjes së tij një jetë që i përgjigjet dinjitetit njerëzor dhe në qoftë se do të jetë e nevojshme, ky shpërblim të plotësohet edhe me mjete të tjera të sigurimit shoqëror.”*³

Duke vijuar, më tej me Kartën Sociale Europiane, të nënshkruar me synimin e arritjeve të kushteve, në të cilat të drejtat mund të realizohen në mënyrë sa më efektive.⁴

Puna megjithëse është e ndërlidhur ngushtë me dinjitetin njerëzor, po ashtu mund të jetë mjet edhe për vetë realizimin dhe kontribuon në zhvillimin e personalitetit.

Duke u bazuar në parimet themelore të të drejtës për punë (...ndalimi i diskriminimit, mbrojtja sociale, respektimi i disiplinës në punë, mbrojtja e gjithanshme e punës, shpërblimi në punë, respektimi i legjislacionit të punës etj...), të sanksionuara në aktet ligjore të mësipërme, Institucioni i Avokatit të Popullit ka vijuar të ketë prioritet të punës së tij, mbrojtjen e kësaj të drejte, duke trajtuar për vitin 2013, rreth 300 ankesa individuale, ku pretendohet shkelja e marrëdhënieve të punës nga organet e Administratës Publike, qendrore dhe vendore.

Nga këto raste rezultojnë të mbyllura 215 ankesa, prej të cilave, në 77 raste pretendimet e ankuesve, lidhur me zgjidhjen e marrëdhënieve të punës, rezultojnë të pabazuara. 8 ankesa kanë rezultuar jashtë juridiksionit dhe kompetencës për shqyrtim nga ana e zyrës tonë, 120 raste janë zgjidhur në favor të ankuesve si dhe për 4 raste ka përfunduar procesi i hetimit administrativ për shkak të heqjes dorë (braktisje e procedimit Neni 102 i Kodit të Procedurës Administrative), nga vetë ankuesi.

² Janë rreth 47 konventa të ratifikuara nga Këshilli i Ministrave dhe ILO (Organizata Ndërkombëtare e Punës

³ Nenet 23-24-25 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut

⁴ Social Charter Section Directorate of Human Rights, Council of Europe, Dhjetor 1999

Gjithashtu, lidhur me shkeljen e të drejtave të punës për punëmarrësit kemi hartuar në ankesa të veçanta edhe 6 rekomandime dhe 85 raste të tjera po vijojnë të trajtohen nga ana jonë gjatë vitit 2014.

Në punën e Avokatit të Popullit, nëpërmjet rekomandimeve që kemi hartuar për vitin 2013, kemi synuar vendosjen e standardeve dhe zbatimin e parimeve të administrimit nëpërmjet ligjit, parimit të proporcionalitetit, sigurisë juridike, mosdiskriminimit, e drejta për t'u dëgjuar në procedurat administrative vendim-marrëse etj. Në gjykimin tonë këto parime të legjislacionit, nga Kushtetuta deri tek ligjet e aktet nënligjore vendosin standarde dhe detyrojnë sjelljen e nëpunësve civilë.

Gjatë trajtimit të rasteve kemi evidentuar edhe shumë të dhëna problematike të natyrës juridike, të cilat kërkojnë zgjidhje dhe jemi duke i përfshirë në një Raport të Posaçëm *"Mbi marrëdhëniet e punës dhe problematikat e Administratës Publike"*, që po hartohet në vijim nga Institucioni i Avokatit të Popullit.

Analizë e rasteve konkrete

1. Në objektin e shumë ankesa apo shpesh herë edhe nga monitorimet e vazhdueshme që kemi ndërmarrë ndaj organeve të administratës publike, kemi konstatuar jo vetëm cënimin e interesave të ligjshme të punëmarrësit lidhur me të drejtën shoqërore të punës, por ky cënim është shoqëruar edhe me ushtrimin e një dhune psikologjike apo presione të vazhdueshme nga punëdhënësi, me veprime të cilat kanë sjellë pasoja direkte dhe kanë penguar ushtrimin e aktivitetit profesional, ku krahas dëmtimit të interesave të ligjshme sociale-ekonomike të individëve (ulje e pagës, apo largime nga puna), mund të jetë shkaktuar edhe një gjendje jo e mirë që ka lidhje me shëndetin apo cënimin e dinjitetit psikologjik, veprime të cilat kanë çuar në uljen e rendimentit të punës, duke vijuar më tej edhe me dëmtim të shëndetit fizik e mendor të individëve.

Për këtë arsye, në kushtet kur e drejta për punë është e lidhur ngushtë me të drejtat e njeriut dhe cënimi i saj nga punëdhënësi me veprime të padrejta, mund të çojë në pasiguri personale, rrezik, kushte jo të shëndetshme dhe të padrejta, e kemi gjykuar si të nevojshëm rishikimin e dispozitave përkatëse të Kodit Punës dhe plotësimet përkatëse në të. Aktualisht në nenit 32 të Kodit të Punës, përcaktohen detyrimet e përgjithshme të punëdhënësit për mbrojtjen e personalitetit të punëmarrësit.

Në këtë nen citohet se:

- "1. Punëdhënësi respekton dhe mbron në raportet e punës personalitetin e punëmarrësit.*
- 2. Ai duhet të parandalojë çdo qëndrim që cënon dinjitetin e punëmarrësit.*
- 3. Punëdhënësi ndalohet të kryejë çdo veprim që përbën shqetësim seksual karshi punëmarrësit dhe nuk lejon kryerjen e veprimeve të tilla nga punëmarrësit e tjerë. Me shqetësim seksual kuptohet çdo shqetësim që dëmton në mënyrë të dukshme gjendjen psikologjike të punëmarrësit për shkak të seksi".*

Pra, parashikohet detyrimi i punëdhënësit për të mbrojtur në raportet e punës personalitetin e punëmarrësit, fakt i cili nënkupton edhe integritetin fizik dhe psikologjik, ku përfshihet nderi personal dhe profesional, sfera e jetës private dhe intime, liria e të shprehurit etj.

Por, duke marrë indicie, edhe nga Kodi Penal Francez, (nenin 222-33-2⁵), ku parashikohet si vepër penale ngacmimi moral, kemi gjykuar si të nevojshme dhe risi për vendin tonë, të bëhet një shtesë në Kodin e Punës të Republikës së Shqipërisë, ku krahas ngacmimit seksual, të parashikohet edhe ndalimi i ngacmimit moral ndaj punëmarrësit.

Për sa më sipër, i kemi sugjeruar Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë/ Ministrisë së Drejtësisë, shtimin e dispozitës dhe plotësimin e nenit 32 të *Ligjit Nr. 7961 datë 12.07.1995, "Kodi Punës i Republikës së Shqipërisë"*, (i ndryshuar) me këtë përmbajtje:

"Punëdhënësi ndalohet të ngacmojë punëmarrësit me veprime të përsëritura që kanë për qëllim ose sjellin si pasojë degradimin e kushteve të punës në një shkallë të tillë që mund të çojë në cënimin e të drejtave dhe të dinjitetit të personit, në prishjen e shëndetit të tij fizik ose mendor ose në dëmtimin e të ardhmes së tij profesionale".

2. Në vlerësimin e Institucionit të Avokatit të Popullit është shumë e rëndësishme të respektohen dhe të garantohen në mënyrë të plotë parimet bazë mbi të cilat mbështetet veprimtaria e organeve të administratës publike sikundër janë:

Parimi i ligjshmërisë,⁶

Organet e Administratës Publike e zhvillojnë veprimtarinë e tyre në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, marrëveshjet ndërkombëtare në të cilat Republika e Shqipërisë aderon, ligjet e Republikës së Shqipërisë, brenda kufijve të kompetencave që u janë dhënë atyre dhe konform qëllimit për të cilat janë dhënë këto kompetenca.

Parimi i mbrojtjes së interesit publik dhe të të drejtave të personave privatë⁷

Administrata publike, në ushtrimin e funksioneve të saj, mbron në çdo rast interesin publik, si dhe të drejtat dhe interesat kushtetuese e ligjore të personave privatë.

Parimi i proporcionalitetit⁸

Veprimet e administratës publike, të cilat për arsye të mbrojtjes së interesit publik ose të të drejtave të të tjerëve, kufizojnë të drejtat themelore të individit të njohura nga Kushtetuta, marrëveshjet ndërkombëtare, ligjet dhe aktet nënligjore, duhet gjithsesi të respektojnë parimin e proporcionalitetit dhe të mos cenojnë thelbin e lirive dhe të drejtave. Kjo do të thotë që veprimet e administratës publike duhet të jenë të tilla që:

- të kërkojnë realizimin e interesave të ligjshme publike;
- të përdorin gjithnjë mjete të përshtatshme dhe në proporcion me qëllimet që synohen të arrihen.

Në çdo rast, organet e administratës publike detyrohen të vlerësojnë nëse është e mundur që qëllimi i kërkuar të realizohet me masa sa më pak represive, pa kompromentuar efektivitetin e tyre.

⁵ Code Pénal Français, Section 3 bis: Du hancèlement moral, article 222-33-2, article 222-33-2-1

⁶ Neni 9 i Kodit të Proçedurës Administrative

⁷ Neni 10 i Kodit të Proçedurës Administrative

⁸ Neni 11 i Kodit të Proçedurës Administrative

Për sa më sipër, respektimi i këtyre parimeve ka qenë pjesë e rekomandimeve tona për ish Kryeministrin e Republikës së Shqipërisë dhe gjithë Bashkive në vend, në periudhën parazgjedhore me qëllim marrjen e masave për nxjerrjen e një urdhri *për ndalimin dhe mosmarrjen pjesë të punonjësve të Administratës Publike në fushatat elektorale të partive politike gjatë orarit zyrtar të punës*

Nëpërmjet rekomandimeve tona kemi synuar jo vetëm respektimin e kuadrit ligjor ekzistues, por edhe sensibilizimin e të gjithë organeve të Administratës Publike në të gjitha nivelet për të mos anashkaluar detyrat funksionale dhe misionin e tyre të ngarkuar nga ligji.

3. Për vitin 2013, krahas të drejtës për mbrojtjen klasike të marrëdhënieve të punës jemi fokusuar edhe në një aspekti tjetër, i cili ka të bëjë me sigurinë dhe kushtet në punë të punëmarrësve.

Duke marrë shkas nga shkrimet e publikuara në mediat e shkruara, lidhur me disa raste të ndodhura ku punëtorë kanë humbur jetën për shkak të mungesës së kushteve dhe sigurisë në punë, në zbatim të Konventës mbi “*Mbrojtjen e shëndetit dhe sigurisë në punë*”, të ratifikuar në vitin 2004, nga vendi ynë, Kodit të Punës, Ligjit Nr. 10237 datë 18.02.2010, “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, kemi kërkuar informacion pranë Inspektoriatit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore lidhur me:

1. Numrin e rasteve të konstatuara për punëmarrësit që kanë pësuar aksidente në punë.
2. Numrin e rasteve të punëmarrësve që kanë rezultuar të paregjistruar dhe nuk i janë bërë pagesat e sigurimeve shoqërore.
3. Masat që janë ndërmarrë për rastet e konstatuara kur aksidenti ka ndodhur për fajësi të rëndë të punëdhënësit.
4. Numrin e rasteve të konstatuara kur punëdhënësi nuk ka pasur autorizimin e duhur administrativ nga inspektori i punës përpara veprimtarisë së ushtruar.

Nga Inspektoriatit Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, evidentohen të dhënat e mëposhtme:

Për periudhën Janar-Shtator 2-13, për të gjithë llojet e aktiviteteve janë regjistruar 64 raste të punëmarrësve të aksidentuar, nga të cilat 12 kanë përfunduar me humbjen e jetës së punëmarrësve.

Lloji i Aktivitetit	Nr.i të aksidentuarve	Me pasojë vdekje
Bujqësi, Pyje, Peshkim	-	-
Miniera, Kariera	20	2
Ndërmarrje prodhuese	11	1
Elektricitet, Gaz, Ujë	3	1
Tregëti, BRH	3	0
Ndërtim	8	5
Telekomunikacion	1	0
Financë, Shërbime	16	2
Aktivitete të tjera	2	1

Numri më i lartë i aksidenteve është regjistruar në subjektet me aktivitet miniera e kariera. Në këtë sektor shkaqet kryesore të ndodhjes së aksidenteve janë shembja material, shpërthime gazi etj.

Shkaqet kryesore të ndodhjes së aksidenteve në sektorin e **prodhimit** janë dëmtimi në makineri, rënia nën tension, rrëzim etj.

Në sektorin e **ndërtimit**, si shkaqe kryesore të aksidenteve të ndodhura, rezultojnë të jetë rënia nga lartësia si dhe goditje nga sende të ndryshme.

Në sektorin e **shërbimeve**, pjesa më e madhe e aksidenteve ka ndodhur si rezultat i moszbatimit të rregullave të sigurimit teknik.

Subjektet në të cilat kanë ndodhur aksidente si dhe janë konstatuar shkelje të legjislacionit të punës janë sanksionuar me gjobë nga ana e inspektorëve të punës, si dhe janë lënë detyra konkrete dhe me afate të përcaktuara për bërjen e vendeve të punës të sigurtat e të shëndetshme.

Për sa më sipër, në vlerësim të situatës së mësipërme, kemi synuar të rekomandojmë marrjen e masave për forcimin e kontroleve në subjektet problematike për sigurinë dhe shëndetin në punë duke ju referuar dispozitave ligjore përkatëse.

4. Një problematikë tjetër e konstatuar nga ana jonë gjatë trajtimit të ankesave ka të bëjë me masën e dëmshpërblimit që duhet të përfitojnë punëmarrësit, sikundër është detyrimi për shpërblimin e vjetërsisë në punë nga organet e administratës, në bazë të neneve 145/152 të Kodit të Punës, duke përmendur si shkak mungesën e fondeve ose duke mos e sqaruar aspak.

Kjo problematikë ka qenë pjesë e rekomandimeve tona për rreth 100 persona në cilësinë e punonjësve të Parkut të Transportit Urban të Udhëtarëve të cilët janë ankuar për largim të padrejtë dhe të paligjshëm nga puna.

Nga evidentimi i objektit të ankesave ka rezultuar një mungesë komunikimi verbal dhe mungesa lidhur me pagesat e pagave mujore prej muajit Janar 2013, problematikë për të cilën kemi rekomanduar ndaj Bashkisë Tiranë:

1. *Lëvrimin e fondeve për Drejtorinë e Parkut të Transportit Urban lidhur me pagesat e pagave mujore ndaj punonjësve të larguar nga puna.*

2. *Pagimin e interesave për shkak të vonësve në pagesën e pagave mujore.*

3. *Pagesën e efekteve financiare për shpërblimin për vjetërsi në punë për shkak të suprimimit të vendeve të punës ndaj punonjësve të larguar nga Parku i Transportit Urban të Udhëtarëve.*

5. Problematikë e mbartur nga viti në vit ka të bëjë me zgjidhjen e marrëdhënieve të punës në kundërshtim me ligjin si dhe mosekzekutimi i vendimeve të formës së prerë të gjykatave e cila krijon pasoja financiare të cilat arrijnë shuma të konsiderueshme. Për pasojë përgjegjësia për vendimmarrjen e jashtëligjshme dhe fatura financiare që rrjedh prej saj nuk duhet t'i faturohet organit të administratës por duhet të jetë më së shumti përgjegjësi individuale e titullarit të organit, si personi që merr vendimin dhe që ka detyrimin ligjor për zbatimin e ligjit.

Lidhur me këtë fakt, kemi rekomanduar ndaj organeve përgjegjëse debitore respektimin e nenit 142/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku thuhet se: *“Organet e Shtetit janë të detyruar të ekzekutojnë vendimet gjyqësore”*, duke vijuar më tej edhe me nenin 6 të Konventës Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore, në të cilën Republika e Shqipërisë ka aderuar.

6. Për shkak të mënyrave të ndryshme me të cilat interpretohen dispozitat e Kodit të Punës në drejtim të pretendimeve të qytetarëve për rikthim në punë të punëmarrësit, kundërshtimit të zgjidhjes së kontratës pa shkaqe të arsyeshme, me zgjidhjen e kontratës pa shkaqe të justifikuara, zyra jonë ka gjykuar se këto pretendime mund të zgjidhen vetëm në rrugë gjyqësore dhe si të tilla nuk i ka hetuar në themel.

Konkluzione

Një nga prioritetet e Shqipërisë për Integrimin në Bashkimin Europian padyshim që mbetet kryerja e hapave thelbësorë, duke përfshirë ndryshimet në Ligjin *“Për Nëpunësin Civil”* dhe forcimin e Departamentit të Administratës Publike, me synimin që të rritet profesionalizimi dhe depolitizimi i administratës publike, si dhe forcimi i qasjes që emërimet dhe ngritja në detyrë të bazohet në transparencë dhe meritë⁹.

Për sa më sipër, Avokati i Popullit në vijim do të synojë trajtimin e ankesave lidhur me të *“Drejtën për mbrojtjen shoqërore në punë”*, duke u fokusuar kryesisht:

- Hartimin e rekomandimeve lidhur me zbatimin e Kushtetutës ku secili ka të drejtë të fitojë mjetet e jetesës së tij me punë të ligjshme, që e ka zgjidhur ose pranuar vetë. Ai është i lirë të zgjedhë profesionin, vendin e punës si dhe sistemin e kualifikimit të vet profesional. Të punësuarit kanë të drejtën e mbrojtjes shoqërore të punës.¹⁰
- Rekomandime për zbatimin e neneve 144-152 të Kodit të Punës¹¹.
- Rekomandime për zbatimin e standardeve dhe parimeve të vendosura nga kuadri ligjor ekzistues që garanton marrëdhëniet e punës nga ana e administratës publike, qendrore dhe vendore.
- Nxjerrjen e përgjegjësive të drejtuesve të institucioneve (dëmi jashtëkontraktor) të cilët, me veprimet e tyre të parregullta dhe të pabazuara, rrisin faturën financiare të detyrimit të shtetit ndaj gjyqfituesve.
- Rritjen e kapaciteteve të stafeve të administratës publike, që janë përgjegjëse për ndjekjen e procedurës për largimin nga puna, me qëllim që të realizohet kuptimi dhe zbatimi i drejtë i procedurës së parashikuar në ligj dhe t’u garantohen punëmarrësve të drejtat e sanksionuara.
- Monitorimin në vijimësi të Administratës Publike për ligjshmërinë dhe zbatimin sa më të drejtë të Ligjit *“Për statusin e nëpunësit civil”*.

⁹ Rekomandimi 6 mbi prioritetet e opinionit të KE-së për Shqipërinë.

¹⁰ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 49 “Liritë dhe të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore”, fq.22

¹¹ Kodi i Punës, Neni 144 “Procedura e zgjidhjes së kontratës së punës nga punëdhënësi” Neni 145 “Shpërblimi për vjetërsi”, Neni 146 “Zgjidhja e Kontratës së Punës pa shkaqe të arsyeshme”, Neni 147 “Zgjidhja e Kontratës në kohë të papërshtatshme”, Neni 148 “Pushimi kolektiv nga puna”, Neni 149 “Përfundimi i kontratës së punës me afat të caktuar”, Neni 150 “Koha e Provës”, Neni 151 “Kontrata me afat të gjatë”, Neni 152 “Shpërblimi për vjetërsinë”, faqe. 78-84

F. E drejta për të përfituar nga sistemi i sigurimeve shoqërore

Vështrim i përgjithshëm

Sistemi i Sigurimeve shoqërore në vendin tonë përbën skemën kryesore të mbrojtjes shoqërore në Shqipëri. Skema e pensioneve luan një rol të rëndësishëm në mbrojtjen shoqërore dhe në luftën ndaj varfërisë.

Sigurimet shoqërore janë të lidhura dhe të kushtëzuara nga legjislacioni kombëtar. Në skemat e sigurimeve shoqërore, shuma e përfitimeve, kushtet e dhënies dhe kohëzgjatja e derdhjeve përcaktohen nga legjislacioni kombëtar. Përgjithësisht, skema sociale përfituese përfshin sigurimin shoqëror dhe ndihmën sociale. Sigurimi shoqëror është baza e sistemit të mbrojtjes sociale. Ai përfshin sigurimin e pensioneve dhe kujdesin shëndetësor. Gjithë shtetasit në Shqipëri për të përfituar nga skema aktuale janë të detyruar të paguajnë kontribute shoqërore dhe shëndetësore, duke u garantuar nga shteti me të ardhmen e plotësimit të nevojave jetike bazë për vete dhe për pjesëtarë të familjes.

Gjatë vitit 2013, pranë institucionit tonë janë depozituar dhe trajtuar 116 ankesa me këtë objekt. Janë përfunduar 97 ankesa, të cilat kanë rezultuar: 54 ankesa të pabazuara, 29 të zgjidhura në favor të ankuesve, 15 rekomandime të pranuar. Janë në proces shqyrtimi 18 ankesa.

Pretendimet e shtetasve kanë qenë lidhur me shkelje të të drejtave për shkak të mosllogaritjes së drejtë apo të mosrishikimit të masës së pensioneve të pleqërisë, për mosnjohjen e vjetërsisë së punës, për uljen e masës së pensioneve të parakohshme për vjetërsi shërbimi, për masën e ulët të pensioneve, për kohën e lindjes së të drejtës për të përfituar pensionin e pleqërisë, për mosmarrje të përgjigjes të shqyrtimit të kërkesave ankimore ndaj vendimeve të Degëve të Përfitimeve pranë Drejtorive Rajonale të Sigurimeve Shoqërore, zvarritje në lidhjen e pensionit të pleqërisë, për ndërprerje të padrejtë të pensioneve të pleqërisë etj.

-Për të gjithë shtetasit shqiptarë, të cilët sot janë kontribues, si dhe ata që janë përfitues, apo edhe për ata që sapo kanë hyrë në këtë skemë, është me rëndësi që të marrin atë përfitim që ata kontribuojnë. Pranë Institucionit të Avokatit të Popullit, lidhur me llogaritjen e masës së pensionit të pleqërisë si për kategorinë e pensionistëve që kanë dalë në pension pleqërie gjatë periudhës 01.01.1994-14.06.2005, por edhe për ata pas kësaj date janë depozituar ankesa për masën e ulët të pensionit që ata gëzojnë në varësi të kategorisë së punës së bërë.

Me zbatimin e ligjit të ri të sigurimeve shoqërore, përpos shumë ndryshimeve në sistemin e sigurimeve shoqërore, kanë dalë edhe probleme që kërkojnë përmirësime të këtij sistemi. Nga shqyrtimi i ankesave, kemi konstatuar se pas llogaritjeve të bëra në zbatim të Ligjit nr.7703 datë 11.05.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, duke qenë se neni 32 paragrafi 3, ka përcaktuar se shuma e përgjithshme e pensionit do të jetë jo më shumë se dyfishi i shumës bazë, ose 75% e pagës neto të 3 viteve rresht në 10 vitet e fundit të punës të personit të siguruar, shumë e cila të jetë më e vogël, ankuesit nuk kanë përfituar masën e pensionit, që ka rezultuar më e favorshme për ta. Nga tre mënyrat e llogaritjes së pensionit të pleqërisë, pas krahasimit të tyre, pensionisti merr shumën më të vogël.

Mendojmë se ka ardhur koha e një reforme në sistemin e sigurimeve shoqërore, me qëllim që për pensionet që do të caktohen në vijimësi, të ketë një lidhje më të drejtpërdrejtë të përfitimeve me kontributet e paguara.

Për të përmirësuar situatën e këtyre përfituesve, por edhe të të tjerëve, të cilët do të përfitojnë në vazhdimësi pension pleqërie i jemi drejtuar Ministrit të Financave me rekomandim për marrjen e iniciativës ligjore për ndryshimin dhe përmirësimin e Ligjit Nr.7703 datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, konkretisht të nenit 32 të tij, me qëllim që përfituesit e pensionit të pleqërisë të gëzojnë masën e pensionit të pleqërisë më të favorshëm për ta.

Referuar përgjigjes së ardhur nga kjo ministri, jemi vënë në dijeni se ndryshimi i ligjit, sa i takon dhënies së pensionit më të favorshëm, shoqërohet me efekte të konsiderueshme financiare. Rekomandimi ynë, si dhe çështje të tjera të skemës së sigurimit shoqëror janë pjesë e diskutimeve që lidhen me reformën e sigurimeve shoqërore, e cila në kohën kur do të jetë ndërmarrë, do të zgjidhë njëherësh edhe sa rekomandohet në shkresën tonë. Prandaj mbetet për t’u rishqyrtuar në një kohë të dytë.

-Invalidët e punës dhe personat që përfitojnë pagesën e aftësisë së kufizuar nuk përfitojnë paketën higjiëno-sanitare, paketë të cilën e përfitojnë vetëm kategoria e invalidëve paraplegjikë dhe tetraplegjike. Institucioni i Avokatit të Popullit ka konstatuar se nuk ka asnjë parashikim ligjor që të rregullojë situatën e tyre.

Ratifikimi nga shteti shqiptar i Konventës së OKB-së “Mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”, duhet të zgjerojë të drejtat dhe përfitimet për personat me aftësi të kufizuara dhe t’u sigurojë atyre gëzimin e të gjitha të drejtave për jetesë normale dhe pa barriera. Dhënia e së drejtës për të përfituar paketën higjiëno-sanitare do të ndikonte sadopak në uljen e varfërisë për këta persona, të cilët nuk gëzojnë statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik.

Në mbështetje të grupeve në nevojë dhe për përmirësimin e cilësisë së jetës së tyre, i kemi dërguar rekomandim Ministrit të Financave, ish-MPÇSSHB dhe Ministrit të Shëndetësisë për përmirësim të nenit 7 të Ligjit Nr.7889 datë 14.12.1994 “Për Statusin e Invalidit”, të ndryshuar, si dhe të nenit 11 të Ligjit Nr.9355 datë 10.03.2005 “Për Ndihmën dhe Shërbimet Shoqërore”, të ndryshuar, me qëllim që një kategori e caktuar e invalidëve, sipas diagnozës së përcaktuar nga Komisionet Mjekësore të Caktimit të Aftësisë për Punë, të përfitojnë paketën higjiëno-sanitare, si shtesë në masën e pensionit të invaliditetit dhe të pagesës së aftësisë së kufizuar.

Nga ana e Ministrisë së Financave na është kthyer përgjigja se vlerësohet iniciativa e Avokatit të Popullit për përmirësim të akteve të sipërcituara, por duke marrë në konsideratë situatën aktuale buxhetore, janë të mendimit se rekomandimi i mësipërm do të shqyrtohet në një fazë të mëvonshme.

-Pensionistët, të cilët gëzojnë statusin e veteranit të Luftës Anifashiste Nacional-Çlirimtare nuk kanë përfituar shtesë në masën e shpërblimit të Veteranit të Luftës për periudhën 2008-2012, megjithëse masa e shpërblimit që ata përfitojnë duhet të ndryshojë sa herë që rriten pensionet e pleqërisë, sepse Ligji nr.7874 datë 17.11.1994 “Për Statusin e Veteranit të Luftës Antifashiste Nacional-Çlirimtare të popullit shqiptar”, i ndryshuar, në nenin 8 të tij ka përcaktuar *se masa e shpërblimit ndryshon në varësi nga indeksi i çmimeve dhe inflacioni*.

Nga analiza e dispozitave ligjore e nënligjore që rregullojnë këtë çështje, kemi konstatuar se me propozim të Ministrit të Mbrojtjes, janë nxjerrë Vendime të Këshillit të Ministrave “Për rritjen e shpërblimit të Veteranëve të Luftës Antifashiste Nacional-Çlirimtare të popullit shqiptar” deri në vitin 2007. Pas këtij viti, kategorisë së pensionistëve që gëzojnë statusin e veteranit të luftës, iu është mohuar e drejta e përfitimit të shtesës së shpërblimit si rezultat i mosxjerrjes së asnjë akti nënligjor në zbatim të ligjit të sipërcituar, me të cilin të rregullohet situata e kësaj kategorie për shkak të mbylljes së veprimtarisë së Komisionit Qendror të Statusit të Luftës Antifashiste Nacional-çlirimtare pranë Ministrisë së Mbrojtjes. Kjo për faktin se kjo ministri nuk ka propozuar draftin për vendimet përkatëse, për t’u diskutuar dhe miratuar nga Këshilli i Ministrave, pavarësisht se edhe pas vitit 2002 ka vazhduar të propozojë projekt-vendime “Për rritjen e shpërblimit të Veteranëve të Luftës Antifashiste Nacional-Çlirimtare të popullit shqiptar”. Pas rekomandimit drejtuar Ministrisë së Financave për nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të nenit 8 të Ligjit Nr.7874 datë 17.11.1994 “Për Statusin e Veteranit të Luftës Antifashiste Nacional-Çlirimtare të popullit shqiptar”, të ndryshuar, dhe një korrespondence të kryer me Ministrinë e Mbrojtjes, kemi marrë përgjigje negative për zgjidhjen e kësaj çështjeje, sepse ata gjykojnë se nuk është në kompetencën e tyre propozimi për aktet nënligjore për rritjen e masës së shpërblimit mujor për personat që gëzojnë statusin e veteranit të luftës. Në këto kushte, bazuar në nenin 102, pika 2 të Kushtetutës së Shqipërisë, ku thuhet shprehimisht se: *“Kryeministri zgjidh mosmarrëveshjet ndërmjet ministrave”*, i jemi drejtuar me rekomandim Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë: Për caktimin e organit kompetent, i cili të propozojë në vijimësi projekt-vendimet për rritjen e masës së shpërblimit të veteranëve të luftës; Për paraqitjen dhe miratimin sa më të shpejtë të akteve nënligjore në zbatim të nenit 8 të Ligjit Nr.7874 datë 17.11.1994 “Për statusin e Veteranit të Luftës Antifashiste Nacional-Çlirimtare të popullit shqiptar”, të ndryshuar, për rritjen e shpërblimit të veteranëve të luftës për vitin 2013.

Jemi në pritje të përgjigjes.

-Një grup ish ambasadorësh të Republikës së Shqipërisë janë ankuar për mosparashikimin në buxhetin e Ministrisë së Punëve të Jashtme të fondit të kontributeve të sigurimeve shoqërore për bashkëshortët/et e nëpunësve të përfaqësive diplomatike të vendit tonë. Në nenin 46, paragrafi 1 të Ligjit nr.9095 datë 03.07.2003 “Për Shërbimin e Jashtëm në Republikën e Shqipërisë” është përcaktuar se: “Për personelin e Përfaqësive Diplomate, koha e qëndrimit jashtë shtetit i njihet për efekt të vjetërsisë në punë dhe të pagesës së kontributit të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore edhe bashkëshortit/es, i cili/e cila shoqëron nëpunësin në përfaqësinë diplomatike”.

Duke qenë se bashkëshortët/et e nëpunësve të përfaqësive tona diplomatike nuk kanë përfituar nga parashikimi i bërë në ligjin e sipërcituar, ndonëse mund të ketë prej tyre që humbasin mjaft për mospërfitim të pensionit që ju takon, i jemi drejtuar me rekomandim Ministrit të Punëve të Jashtme, për përshejtimin e zgjidhjes së problemit të sigurimit të bashkëshortit apo bashkëshortes që shoqërojnë nëpunësit në përfaqësitë tona diplomatike.

Me qëndrimin e mbajtur ndaj këtij rekomandimi, u informuam se është përgatitur një projekt-vendim, i cili përcakton masën e kontributit sipas dy niveleve, njëri për bashkëshortët dhe bashkëshortet e diplomatëve dhe tjetri për bashkëshortët dhe bashkëshortet e personelit teknik dhe administrativ, si dhe përballimin e kontributit nga buxheti i shtetit. Ky projekt-vendim është dërguar për mendim pranë Ministrisë së Financave, Ministrisë së Drejtësisë

dhe në Institutin e Sigurimeve Shoqërore. Pas marrjes së këtyre mendimeve, projektvendimi do të paraqitet për miratim në Këshillin e Ministrave.

-Lidhur me të drejtat e emigrantëve shqiptarë në fushën e sigurimeve shoqërore, institucioni i Avokatit të Popullit, në përputhje me paragrafin e parë të nenit 13 të Ligjit nr.8454 datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, duke u nisur nga ankesa të shtetasve shqiptarë që jetojnë ose kanë jetuar si emigrantë në shtetet fqinj, Itali dhe Greqi, me objekt: mosnjohjen e viteve të punës, filloi me iniciativën e tij këtë çështje. Nga korrespondenca e bërë me Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë lidhur me marrëveshjet në fushën e sigurimeve shoqërore, jemi informuar se pas interesimit dhe insistimit të vazhdueshëm të qeverisë shqiptare për nënshkrimin e marrëveshjeve dypalëshe të mbrojtjes shoqërore, që do të zgjidhë problemet e përfitimit të pensioneve nga emigrantët shqiptarë, diplomacitë e të dy vendeve i janë përgjigjur negativisht, për arsye të krizës ekonomike që ka përfshirë këto vende. Ajo ministri do të vazhdojë përpjekjet për të pasur një marrëveshje bilaterale në fushën e mbrojtjes shoqërore midis Republikës së Shqipërisë dhe Greqisë e Italisë, e cila do të zgjidhë përfundimisht problemin e përfitimeve të emigrantëve, të cilët kanë kontribuar si në Shqipëri, ashtu edhe në Itali e Greqi.

Për të drejtat e emigrantëve shqiptarë, institucioni ynë po përgatit një raport të veçantë, në të cilën është përfshirë edhe çështja e të drejtave të tyre në fushën e sigurimeve shoqërore.

-Të moshuarit mbeten një nga grupet më vulnerabël në Shqipëri. Mungesa e sigurimit të një minimumi të ardhurash, mund t'i çojë të moshuarit dhe familjet e tyre në varfëri. Në shumë raste, të moshuarit që janë në prag të daljes në pension, i largojnë nga puna pa mbushur moshën e daljes në pension dhe pa sigurim. Ky grup-moshe haset në vështirësi për të gjetur punë të re, kur kanë humbur vendin e punës së dikurshme etj. Pikërisht për të garantuar të drejtat e të moshuarve, kërkohet miratimi i Statusit të Moshës së Tretë.

Lidhur me këtë çështje, në vitin 2012 Institucioni ynë ka ndërhyrë pranë ish Ministrisë së Punës Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, nga ku është informuar se Projekt-Ligji ishte parashikuar që në fund të vitit 2012 të shkonte për miratim në Këshillin e Ministrave. Përsëri në muajin Shkurt 2013 iu drejtuam kësaj ministrie për procedurat e ndjekura lidhur me këtë çështje, ku jemi vënë në dijeni se MPÇSSHB në bashkëpunim me ministrinë e linjës dhe grupet e interesit po punonte për hartimin e projektligjit "Për kujdesin e personave të moshës së tretë", i cili ishte parashikuar të miratohej brenda vitit 2013.

Në vijimësi të ndjekjes së kësaj çështjeje, iu drejtuam Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, e cila na informoi se në programin e përgjithshëm analitik të projektakteve për vitin 2013, e ka parashikuar miratimin e projekt-ligjit për moshimin "*Përmirësimi i cilësisë së jetesës dhe plotësimi i nevojave për moshën e tretë*", ku me Urdhër të Ministrisë është ngritur grupi i punës ndërministror për hartimin e këtij projektligji.

Është përgatitur projektligji dhe relacioni përkatës. Kostoja financiare është e lartë dhe po rishqyrtohet edhe njëherë me Këshillin e Ministrave dhe Ministrinë e Financave për miratimin e këtij projektligji për vitin në vazhdimësi.

-Një nga problematikat që ende ka mbetur ende pa zgjidhje është ajo e pensioneve të ulëta të ish-minatorëve të nëntokës, ku nga ana e tyre kërkohet miratimi i Statusit të Minatorit. Për këtë çështje aktualisht po ndërmjetësojmë me Ministrinë e Industrisë dhe Energjisë si dhe Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.

Në Raportin vjetor 2012 kemi ngritur një sërë çështjesh, për të cilat ende nuk është mundësuar një zgjidhje.

- Risjellim në vëmendje, se një ndër problematikat e trajtuara nga institucioni ynë gjatë vitit 2012, ka qenë edhe ajo e një numri ankesash, të shtetasve të cilët gëzojnë pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi dhe pension suplementar. Në ankesat e depozituara, me objekt diskriminimin e bërë në rillogaritjen e masës së pensionit rezultoi se me hyrjen në fuqi të Ligjit nr.10142 datë 15.05.2009 “ Për sigurimin shoqëror suplementar të Ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të Punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit e të Punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë”, sipas pikës 2 të nenit 29 të këtij ligji është bërë rillogaritja e masës së këtyre pensioneve dhe kjo masë jo vetëm është ulur në mënyrë drastike, por këta persona janë shpallur edhe debitorë ndaj Drejtorive Rajonale të Sigurimeve Shoqërore. Duke e konsideruar këtë ndryshim të masës së pensionit si cënim të të drejtave të tyre të ligjshme të fituara, institucioni ynë, iu drejtua Ministrisë së Financave me rekomandimin *për plotësimin e nenit 29 të Ligjit nr.10142 datë 15.05.2009 “Për sigurimin shoqëror suplementar të Ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të Punonjësve të Policisë së Shtetit, të Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit e të Punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë”*. Nga ana e Ministrisë së Financave në vitin 2013 jemi vënë në dijeni se pas diskutimit dhe shqyrtimit të problemit me institucionet përkatëse, rezulton se nisur nga situata aktuale buxhetore dhe financiare, marrja në konsideratë e këtij rekomandimi do të shqyrtohet në një moment me të përshtatshëm, pasi aktualisht implikon efekte të konsiderueshme financiare në buxhetin e shtetit.

-Një tjetër problematikë që është prezantuar në Raportin vjetor 2010, 2011, 2012, ka qenë edhe ajo e masës së ulët të kategorisë së pensionistëve që kanë përfituar pension të parakohshëm në vitet 1993, 1994, 1995. Në vitin 2009 iu drejtuam me rekomandim Ministrit të Financave. Në përgjigjen e ardhur në muajin Qershor 2012 u informuam se në cilësinë e institucionit propozues dhe hartues të akteve ligjore dhe nënligjore në fushën e sigurimeve shoqërore, kërkesa jonë i ishte dërguar për kompetencë Institutit të Sigurimeve Shoqërore, i cili kishte ngritur një grup pune dhe përgatitur një projekt-vendim të Këshillit të Ministrave “Për ngushtimin e diferencave në masën e pensioneve të punonjësve buxhetorë të caktuara gjatë vitit 1993-1994”. Pas shqyrtimit të këtij projekt-vendimi Ministria e Financave na informoi se pas diskutimit dhe shqyrtimit të problemit me institucionet përkatëse, rezulton se projekt-vendimi i paraqitur mbart efekte financiare të konsiderueshme të papërbalueshme për buxhetin e shtetit dhe mbetet për t’u rishqyrtuar në një kohë të dytë.

Analizë e rasteve konkrete

Ankesa me **nr.doculive 201300771**, e cila cila bën fjalë për zvarritje të rillogaritjes së masës së pensionit të pleqërisë të një shtetasi nga qyteti i Lushnjës. Nga shqyrtimi i ankesës rezultoi se ky shtetas pasi kishte plotësuar dhe depozituar dokumentacionin e kërkuar për rillogaritjen e masës së pensionit të tij në zbatim të Ligjit nr.10142 datë 15.05.2009 “Për sigurimin shoqëror suplementar të Ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të Punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të

Shpëtimet e të Punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë”, kishte hasur në zvarritje të rillogaritjes së pensionit prej 6 muajsh. Në këto kushte i rekomanduam Drejtorit të Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Fier, rillogaritjen e masës së pensionit të pleqërisë, rekomandim i cili u pranua dhe ankuesit iu rillogarit masa e pensioni, e cila nga 11562 lekë arriti në 18414 lekë në muaj, duke iu rillogaritur edhe diferencat përkatëse në shumën e 32630 lekëve.

Ankesa me **nr. doculive 201300882**, e një shtetasi nga Vora, i cili ankohej ndaj Agjencisë Lokale të Sigurimeve Shoqërore Vorë për ndërprerje të padrejtë të pensionit të pleqërisë. Sipas shpjegimeve të tij, ankuesi ishte përfitues i pensionit të pleqërisë që prej 23 vitesh dhe në muajin Mars 2013 ishte njoftuar nga nëpunësi i Zyrës Postare në Vorë se duhet të bënte një kërkesë lidhur me kompensimin në masën e 140 lekëve në muaj, të përfituar nga ana e tij, pasi bashkëshortja e tij ka mbushur moshën për pension pleqërie dhe kishte nisur procedura për përfitimin këtij pensioni. Ka rezultuar se pas kërkesës që ky shtetas kishte depozituar, i ishte ndërprerë dhënia e pensionit të pleqërisë për muajt Mars dhe Prill. Kishte kërkuar që të përfitonte masën e pensionit të pleqërisë që i takon konform legjislacionit në fuqi pa kompensimin përkatës, por kishte hasur në indiferencë dhe neglizhencë për të zgjidhur çështjen e tij. Në kushtet që ankuesi ishte pa asnjë të ardhur në familje, sepse i ishte ndërprerë pa të drejtë pensioni i pleqërisë si dhe nuk ishte lidhur ende pensioni i bashkëshortes së tij dhe për pasojë kishte sjellë vështirësi financiare, si për jetesën e përditshme, ashtu edhe në detyrimet e tyre në shlyerjen brenda afateve kohore të pagesës së shpenzimeve të energjisë elektrike, shërbimit të telefonisë si dhe të faturave të ujit, duke e konsideruar këtë çështje si shkelje të të drejtave të tij të ligjshme, i rekomanduam Drejtorit të Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Tiranë për marrjen urgjentisht të masave për dhënien e pensionit të pleqërisë që nga muaji Mars 2013 e në vazhdim. Rekomandimi ynë u pranua dhe ankuesi iu rifitoi të drejtën e gëzimit të pensionit të pleqërisë që nga data e ndërprerjes së pensionit.

Ankesa me **nr. doculive 201301584**, e një shtetaseje nga qyteti i Tiranës, e cila ankohej për zvarritje në lidhjen e pensionit të pleqërisë. Nga shqyrtimi i ankesës, rezultoi se që në muajin Mars 2013, me mbushjen e moshës për përfitim të pensionit të pleqërisë, kishte dorëzuar dokumentacionin dhe aplikuar për të përfituar këtë të drejtë. Megjithatë kishte kaluar një kohë relativisht e gjatë që nga koha e dorëzimit të dokumentacionit, edhe pas interesimit të vazhdueshëm të ankuses pranë Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Tiranë, nuk i është bërë lidhja e pensionit të pleqërisë. Në analizë të akteve ligjore dhe nënligjore që rregullojnë marrëdhëniet në fushën e sigurimeve shoqërore dhe konkretisht të Rregullores Nr.1 datë 21.10.2008 “Për caktimin, administrimin dhe pagesën e pensioneve”, konstatoam se kishin kaluar të gjitha afatet e verifikimit të vjetërsisë së punës së kësaj shtetaseje, ndaj i rekomanduam Drejtorit të Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Tiranë marrjen e masave për lidhjen e pensionit të pleqërisë së saj.

Rekomandimi ynë u pranua dhe ankuses iu lidh pensioni i pjesshëm i pleqërisë që nga data e lindjes së të drejtës, 15.03.2013.

Ankesa me **nr. doculive 201302240**, e një shtetaseje nga qyteti i Shkodrës, e cila ankohej për masën e ulët të pensionit të pleqërisë. Kishte dalë në pension të plotë pleqërie në vitin 2009 dhe fillimisht i është lidhur pensioni në masën e 5000 lekëve në muaj. Pas ndjekjes së rrugës gjyqësore për njohjen e disa viteve pune, kishte bërë kërkesë për rillogaritje të masës së pensionit të pleqërisë, por çështja e saj nuk ishte zgjidhur.

Në analizë të vendimeve gjyqësore, duke e konsideruar të drejtë ankesën e kësaj shtetase, i rekomandua Drejtorit të Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Shkodër rrillogaritjen e masës së pensionit të pleqërisë **bazuar në vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër**, rekomandim i cili u pranua. Ankueses iu bë rishqyrtimi i pensionit dhe iu **caktua** pension i pjesshëm pleqërie në marrëdhënie pune me fshatin në shumën e 9795 lekëve në muaj.

Ankesa me **nr.doculive 201302523**, e cila bën fjalë për mosvënien në dispozicion të dokumenteve zyrtare të kërkuara pranë Degës Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Sarandë. Duke qenë se një shtetasi, me banim në qytetin e Sarandës i ish in bërë ndalesa në masën e pensionit të pleqërisë, për të kërkuar të drejtën e tij, kishte filluar procesin gjyqësor. Meqenëse i nevojiteshin prova shkresore për t'i paraqitur në seancat gjyqësore, ky shtetas nëpërmjet avokatit të tij kishte kërkuar pranë asaj Dege disa herë vënien në dispozicion të dokumenteve, në të cilën ish in përcaktuar ndalesat në masën e pensionit të tij dhe arsyet e kësaj ndalesë.

Nga dokumentacioni bashkangjitur ankesës, rezultoi se më datë 01.08.2013 ishte dërguar një kërkesë për vënien në dispozicion të shkresës mbi arsyen dhe masën e ndalesave nga pensioni i pleqërisë, kopje të vendimit të përllogaritjes së ndalesave si dhe procesverbalin e konstatimit të pagesave tepër, të nënshkruara nga ky shtetas, por nuk kishte marrë asnjë përgjigje.

Nga shqyrtimi i kësaj ankese, duke qenë se kishim të bënim me shkelje të së drejtës për t'u informuar me të gjithë dokumentat përkatës zyrtare, të kërkuar nga ana e ankuesit, i rekomandua Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Vlorë dhënien e plotë të kopjeve të dokumentacionit të kërkuara, në bazë të kërkesës që ishte paraqitur pranë Degës së Sigurimeve Shoqërore Sarandë më datë 01.08.2013.

Rekomandimi u pranua dhe më datë 25.11.2013 ishte vënë në dispozicion i gjithë dokumentacioni i dosjes së pensionit të këtij shtetasi.

Konkluzione

Të gjitha problematikat e konstatuara nga shqyrtimi i ankesave lidhur me të drejtën për të përfituar nga sistemi i sigurimeve shoqërore, derivojnë nga dispozitat e Ligjit nr.7703 datë 11.05.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar. Duke i konsideruar të drejta shqetësimet e shtetasve të ndryshëm, Institucioni i Avokatit të Popullit, ka ndërmjetësuar pranë institucioneve shtetërore me anë të rekomandimeve përkatëse për përmirësime apo ndryshime të këtij ligji dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij.

Reforma e pensioneve, e cila prek interesa të gjëra të publikut, përbën një nga elementet më të rëndësishëm në tërësinë e reformave në kuadrin e përafrimit të legjislacionit të Shqipërisë me BE-në. Reforma duhet përgatitur e çuar përpara përmes një vendimmarrjeje e implementimi konsensual politik e social.

- Është e domosdoshme të ndryshojë formula e llogaritjes së pensionit sipas nenit 32. Sistemi i llogaritjes së pensioneve duhet të ndryshojë, nga llogaritje me paga dhe kufizime shpesh herë diskriminuese, në sistem llogaritjeje me kontribute.

- E konsiderojmë si një padrejtësi që u bëhet personave për vitet e fundit para daljes në pension, për shkak se aftësitë fizike reduktohen dhe mund të kenë paga të vogla dhe shkojnë drejt pensionit minimal si dhe të personave të vetëpunësuar, që megjithëse gjatë karrierës së tyre mund të kenë punuar me paga maksimale dhe kjo mënyrë padrejtësisht u jep pension minimal, ndaj duhet të ndryshojë neni 10 i Ligjit nr.7703 datë 11.05.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar. Kjo për arsye se në këtë nen thuhet se: "Kontributi minimal për personin e punësuar, punëdhënësin dhe të vetëpunësuarin është i barabartë, kurse kontributi maksimal është sa 5 herë kontributi minimal. Masa konkrete e kontributit minimal caktohet nga Këshilli i Ministrave". Ky nen është me të vërtetë diskriminues, sepse diferenca ndërmjet asaj që paguan një person dhe asaj që merr si pension është tepër e madhe. Pra një person që paguan sa për 5 persona që përfitojnë pension minimal, merr vetëm dyfishin e tyre, pra nuk shpërblehet sipas kontributit të derdhur.

-E drejta për pension, lind atëherë kur plotësohen 2 kushtet, mosha dhe vjetërsia kontributive ligjore. Sipas nenit 62 të ligjit të sipërcituar, në rast se kërkesa nuk bëhet brenda vitit, por e kalon periudhën 1 vjeçare, atëherë e drejta për pagesën e pensionit fillon nga data e paraqitjes së kërkesës. Përse duhet të mohohet kjo e drejtë e lindur? Në terminologjinë juridike, në të gjitha rrethanat përcaktohet, se një e drejtë juridike e lindur, nuk mund të mohohet.

-Mbrojtja e të drejtave të emigrantëve në fushën e sigurimeve shoqërore, mbetet një detyrim ligjor, edhe në kuadër të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit me BE-në, Shqipëria duhet të intensifikojë përpjekjet për nënshkrimin e marrëveshjeve dypalëshe në fushën e sigurimeve shoqërore.

Si përfundim, theksojmë faktin se pavarësisht se ndryshimet ligjore të propozuara nga ana e institucionit të Avokatit të Popullit kanë një faturë financiare, gjë që mund të kërkojë një kohëzgjatje të caktuar, reformimi i sistemit të sigurimeve shoqërore është një domosdoshmëri.

G. E drejta për arsimim

Vështrim i përgjithshëm

Arsimimi i shoqërisë është padyshim nevoja e vazhdueshme e një shoqërie për t'u demokratizuar, por edhe e një kombi për t'u zhvilluar. Nisur nga ky fakt, del qartazi se, arsimi është një proces që i hap rrugën së nesërme së vendit dhe garanton një të sotme më të mirë. Si i tillë arsimi duhet të mbajë parasysh dy parime themelore: Së pari edukimin si një proces i zhvillimit të personalitetit, dhe së dyti arsimimin-si një proces i zhvillimit intelektual të subjektit. Ajo që vlen të vihet në dukje është sesa ne i mbajmë parasysh këto, në sistemin tonë arsimor.

Sigurisht që ka përpjekje për të rritur përmbajtjen cilësore të arsimit, por nëse flasim për aspekte të veçanta, zona të veçanta ka rënie të cilësisë në arsim. Në fakt ka shumë për të bërë në Shqipëri në mënyrë që mësuesi të vlerësohet jo vetëm nga qeveria që e paguan, por edhe nga shoqëria në përgjithësi.

Arsimi gjithëpërfshirës është themeli i një shoqërie jo vetëm tolerante, por edhe të begatë. Për të ndërtuar një Shtet gjithëpërfshirës dhe të suksesshëm ekonomikisht, ku çdo individ merr përgjegjësi për mirëqenien e përgjithshme të vendit, rëndësi të veçantë ka edukimi dhe arsimimi qytetar.

Institucioni i Avokatit të Popullit në punën e tij bazohet rigorozisht në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, konkretisht nenit 57/1, që citon *"Kushdo ka të drejtën për arsimim"*. Gjithashtu "E drejta e arsimit", shprehet në nenin 28 të Konventës së OKB "Për të Drejtat e Fëmijës", që ndër të tjera, përcakton se: *"Shtetet Palë njohin të drejtën e fëmijës për arsimim..."*

Vështirësitë në arsimimin e fëmijëve lidhen me shumë faktorë. Të tilla janë, niveli ekonomik i familjes, çështjet e mentalitet, çështjet infrastrukturore, largësia e madhe e shkollës nga vendbanimi në disa zona të vendit, puna e fëmijëve të cilët në realitet duhet të ndjekin shkollën etj.

Konkretisht për vitin 2013 ka pasur në total 80 ankesa, 10 raste me iniciativë, ose 13 inspektime në fushën e arsimit. Rezultojnë të përfunduara 61 ankesa, në proces shqyrtimi 19, 30 të pabazuara, 1 jashtë kompetencës, 20 zgjidhur në favor të ankuesit, 2 heqje dorë, 7 rekomandime të pranuar dhe 1 rekomandim i refuzuar.

Analizë e rasteve konkrete

1. Ankesë për shkollën e mesme në Topojan, Kukës. Nr.doc 201300638.

Pranë institucionit të Avokatit të Popullit kanë paraqitur ankesë, një grup vajzash që frekuentojnë shkollën e mesme të përgjithshme në Komunën Topojan, Kukës. Ato shprehen se shkolla e tyre është kthyer në një lokal, duke devijuar nga misioni që ka, e duke mos qenë të sigurtë në ambientet e shkollës. Konkretisht në oborr të shkollës ndodhet lokali i komunës, që frekuentohej edhe nga persona të dehur, të cilët kishin kërcënuar disa herë vajzat me armë. Nxënësit kërkuan ndihmën e institucionit tonë

për heqjen e këtij lokali, dhe kthimin e dinjitetit të institucionit arsimor, që sipas tyre po nëpërkëmbej nga funksionarë të lartë si kryetari i komunës dhe drejtori i shkollës. Nga verifikimi në vend, është vërejtur se pozicioni i subjektit tregtar është i tillë që qëndrimi në ambiente të këtij subjekti ka pamje vizive me oborrin e shkollës, për shkak se ndarja e pjesëve respektive të dy institucioneve në fjalë është realizuar me gardh hekuri dhe jo me mur. Gjithashtu hyrja për në Komunën Topojan (njëherazi dhe në subjektin tregtar) dhe shkollën e mesme Topojan, konsiston në një rrugë të përbashkët për të dy institucionet. Kështu nxënësit për të hyrë në shkollë, janë të detyruar të kalojnë në të njëjtën derë e cila është përshtatur e tillë në gardhin e hekurit (sipërcituar), që ndan subjektin (objekt i ankesës) me shkollën. Në këtë kontekst duhet theksuar se hyrja e nxënësve përmes kësaj dere, mund të evitohet për shkak se paralel me derën në fjalë ekziston një derë tjetër më e madhe me shufra hekuri, e cila korrespondon vetëm me oborrin e shkollës, por që mbahej e mbyllur pasi shërbente për hyrje-daljen e automjeteve. Pas konstatimit të kësaj situatë ju rekomandua Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës:

- *Marrja e masave për sigurimin e ambienteve të shkollës së mesme të përgjithshme Topojan, Kukës, të shkëputur nga lokali bar-kafe, e cila realizohet nëpërmjet ngritjes së një muri dhe hyrjes së nxënësve nga dera e madhe e shkollës.*

Ministria e Arsimit dhe Shkencës shpjegoi se janë marrë të gjitha masat për zgjidhjen përfundimtare të problemit. Po kështu edhe Ministria e Brendshme në përgjigjen e saj, na shpjegon se në bashkëpunim me Prefektin e Qarkut Kukës problemi është zgjidhur, kjo e fundit në mirëkuptim me Komunën Topojan (konkretisht dalja e derës së lokalit nga oborri i shkollës është mbyllur).

2. Rast me iniciativë për situatën e konviktit të shkollës profesionale, Lezhë. Nr.doc 201300429.

Në “Ora News TV” emisioni “Alarm”, u shfaq një kronikë lidhur me gjendjen e vështirë në konviktin e shkollës profesionale, Lezhë. Konkretisht kronika bënte fjalë për kushtet shumë të këqija në shumë dhoma të katit të fundit të konviktit të vajzave, të cilat kishin lagështirë në mure dhe në tavan. Në disa dhoma suvaja nga lagështira shkëputej nga tavani, dhe binte herë pas here në dysheme dhe mbi krevate. Kjo lagështirë nga pamjet dhe konstatimet e personave të intervistuar ishte e hershme, pasi godina ishte e amortizuar dhe e vjetër.

Në kronikë dha opinionin e tij edhe drejtori i konviktit z.M.K, i cili pohoi se kishte njoftuar Bashkinë e Lezhës, të cilët pas ngritjes së grupit të punës do hartonin preventivin dhe do e paraqisnin në mbledhjen e Këshillit Bashkiak për tu realizuar në buxhetin e vitit 2013. Në intervistën që gazetari i kishte marrë edhe Drejtorit të Arsimit të Bashkisë, ai deklaroi se do zgjidhej situata me akordimin e fondeve. Por realizimi i saj do ndodhte kur koha të ngruhej, pasi izolimi i tarracës dhe rikonstruksioni kërkon kushte atmosferike specifike. Pas konstatimit të kësaj situatë ju rekomandua Bashkisë Lezhë:

- *Marrja e masave të menjëhershme për rikonstruksionin e konviktit të shkollës profesionale, Lezhë për një jetesë normale dhe të sigurtë të vajzave që strehohen në këtë godinë.*

Bashkia Lezhë në përgjigjen e saj na shpjegoi se: Është bërë projekti për ndërhyrjen në tarracën e kësaj godine për eliminimin e lagështirës si dhe janë përgatitur preventivat për bazën materiale të nevojshme dhe gjithë shpenzimet e tjera. Ndërhyrja për përmirësimin e saj do të kryhet menjëherë sapo të sigurohen fondet e nevojshme dhe ta lejojnë kushtet e motit.

3. Rast me iniciativë për gjendjen e shkollës 9-vjeçare “Babrru”. Nr.doc 201300326.

Nisur nga kronika e shfaqur në televizionin News 24 , e cila paraqiste kushte jo normale përpara ambienteve të shkollës 9-vjeçare “Babrru 3” kemi grumbulluar materialet filmike dhe kemi nisur ndjekjen e këtij rasti me iniciativë. Kronika në fjalë informonte për kushtet shumë të këqija përpara kësaj shkolle, pasi një përrua përshkonte hyrjen e shkollës dhe në ditët me shi prindërit detyroheshin t’i merrnin fëmijët në krahë për të kaluar përroit, duke rrezikuar jetën e tyre dhe të fëmijëve, pasi përroi shpeshherë kthehej në lumë. Kjo shkollë frekuentohet nga rreth 300 fëmijë nga mosha parashkollore e deri në klasën e 9-të.

Prindërit dhe fëmijët e intervistuar pohonin se prej muajsh kanë kërkuar zgjidhjen e situatës pranë Komunës Paskuqan, por edhe pse kanë marrë premtime asgjë konkrete nuk është zgjidhur. Situata paraqitej problematike pasi në kronikë tregoheshin fëmijë të pashoqëruar nga prindërit, të lagur deri në gjunjë, të cilëve ju duhet të frekuentonin shkollën me orar të plotë në këto kushte. Shqetësim ishte edhe mungesa e energjisë elektrike në shkollë, e cila pengonte zhvillimin normal të mësimin dhe ndikonte në cilësinë e mësimdhënies, pasi pa energji elektrike laboratorët nuk funksionojnë. Gjithashtu edhe ngrohja me dru zjarri ishte zgjidhur muajin e fundit pasi deri atëherë komuna nuk kishte furnizuar rregullisht shkollën gjatë dimrit. Paradoksi në kronikë ishte ardhja e mësuesve me furgon deri në hyrje të shkollës ndërkohë që prindërit dhe nxënësit torturohen çdo ditë për të hyrë dhe dalë prej saj. Pas konstatimit të kësaj situatë ju rekomandua Kryetarit të Komunës Paskuqan:

- Marrja e masave të menjëhershme (provizore) për kalimin normal dhe të sigurt të përroit përpara shkollës 9-vjeçare “Babrru 3”.
- I sugjeruam që nëse kishin probleme me fondet financiare për rregullimin e situatës, të kërkonin ndihmën e Ministrisë së Mbrojtjes për vendosjen e një ure të përkohshme nga forcat e ushtrisë.
- Ndërtimin konform procedurës ligjore të një ure definitive në muajt në vijim.
- Sigurimin e vazhdueshëm me dru për ngrohje për këtë shkollë 9 vjeçare.

Komuna Paskuqan në përgjigjen e saj, sqaroi se në bazë të studimeve inxhinierike janë marrë masat dhe kanë filluar punimet për sistemimin dhe rehabilitimin e përroit. Këto punime pritet të mbarojnë për disa ditë dhe do zgjidhin këtë problematikë.

4. Rast me iniciativë për regjistrimin e fëmijëve romë të cilët u përzunë nga ish ndërmarrja e dekorit Tiranë. Nr doc 201301507

Gjatë kontakteve me këtë komunitet u konstatua se shumë prej fëmijëve të tyre nuk frekuentonin shkollën. Nga intervistat e marra rezultoi se ishin rreth 90 fëmijë, nga të

cilët 60 të grupmoshave nga 1 deri në 15 vjeç. Shumë prej këtyre fëmijëve nuk ishin të regjistruar në shkolla, për të ndjekur arsimin 9-vjeçar. Një fushë e rëndësishme e zbatimit të të drejtave të fëmijës është arsimi dhe shkolla. Arsimimi i pjesëtarëve të këtij minoriteti, duhet parë jo vetëm si një detyrim kushtetues, por si një nga mënyrat me efikase për integrimin e tyre të plotë në shoqëri. Niveli i ulët arsimor është problem serioz, që pengon integrimin e këtij komuniteti me shoqërinë. Shumica e fëmijëve romë janë analfabetë, dhe kjo për shkak të vështirësive gjuhësore që kanë fëmijët në klasë të parë, të gjendjes tejet të vështirë ekonomike të familjeve të tyre, të largësisë që kanë me vendbanimet e tyre nga institucionet shkollore si dhe të mentalitetit të gabuar të prindërve.

Karakteristikat e jetesës të familjeve romë kanë një ndikim të konsiderueshëm tek fëmijët, të cilët duke mos marrë arsimin e duhur, nuk i përshtaten kërkesave të tregut të punës; mundësitë i kanë shumë më të kufizuara se pjesa tjetër e popullsisë dhe si rezultat sjellin një pamundësi ekonomike për të përballuar jetesën si dhe një sërë problemesh sociale. Pas konstatimeve ju rekomanduam Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës si dhe Drejtorisë Arsimore, Tiranë

- *Marrja e masave për të mundësuar regjistrimin e fëmijëve të Komunitetit Rom, të vendosur pranë ish- Dekorit në rrugën e Kavajës, Tiranë, në shkollat 9-vjeçare pranë vendbanimit aktual të tyre.*

Drejtoria Arsimore Rajonale Tiranë në përgjigjen e saj shpreh angazhimin e saj për regjistrimin e fëmijëve të komunitetit rom në shkollat që ndodhen afër vendbanimit të tyre. Drejtoritë e shkollave ku janë regjistruar fëmijë romë do të ndjekin hap pas hapi frekuentimin dhe përparimin e tyre në shkollë.

5. Rast me iniciativë për gjuhën e shkruar në tekstet shkollore. Nr doc 201302461

Në median e shkruar dhe vizive po flitet nga studiues dhe gjuhëtarë për shkatërrimin e gjuhës shqipe dhe degradimin e saj vit mbas vitit. Tekstet kanë shumë probleme dhe fatkeqësisht këto probleme nuk ndeshen vetëm nga nxënësit, por edhe mësuesit e tyre. Tekste të mbingarkuara, përkthime aspak cilësore, histori e shtrembëruar janë disa nga problemet madhore të testeve shkollore të arsimit parauniversitar. Profesor Gj.Sh, anëtar i Akademisë së Shkencave dhe gjuhëtar i njohur është shprehur se: “Për fat të keq, ka mëse njëzet vjet që, kujdesi i shtetit dhe i institucioneve shtetërore ndaj botimeve e kumtimeve zyrtare ka rënë në mënyrë të pafalshme. Ka pasur shturje e mungesë të disiplinës gjuhësore të shtetit, prej nga ka ardhur edhe kjo gjendje pakujdesie gati masive ndaj gjuhës së shkruar e të folur në zyra, në botime, në gazeta, në radio e në televizione. Shkruhet e flitet dosido, me gabime e thyerje të rënda të normave drejtshkrimore, me fjalor të varfër dhe shpesh edhe të pakrehur nga fjalët e rënda e të papërshtatshme për burokracinë zyrtare, qoftë shtetërore, qoftë private. Fjalët e huaja të panevojshme, terminologjia e pasaktë dhe deri fjalët e pista e ligjërimet krejt të pagdhendura, kanë pasur vend aq shpesh, sa ua kanë neveritur shqiptarëve edhe politikën, edhe funksionet zyrtare të shtetit”. Pas konstatimeve ju rekomanduam Ministrisë së Arsimit dhe Sportit:

- *Ngritjen e një Bordi Këshillimor me gjuhëtarë dhe akademikë të njohur për rishikimin e gjuhës shqipe në tekstet shkollore si një domosdoshmëri e kohës.*

Ministria e Arsimit dhe Sportit sqaron se në zbatim të programit të Qeverisë, kjo e fundit do realizojë një reformë thelbësore të kurrikulës kombëtare dhe të Altertekstit. Reforma do të krijojë mundësi që të përmirësohen edhe standardet e nxënies së gjuhës amtare.

6. Ankesë për Agjensinë Kombëtare të Provimeve. Nr.doc 201301435.

Shtetasit K.H, B.S, E.Xh kanë dhënë provimin e licensës së profesionit dhe pretendonin se dy pyetje janë hartuar gabim. Ata e kanë ankimuar problemin në bazë të rregullores dhe brenda afateve ligjore pasi dy pyetje të provimit, kanë qenë pyetje të pakuptueshme dhe të paplota duke bërë të pamundur përgjigjet. Ankimimi i tyre nuk është marrë parasysh dhe ankuesit, më pas ka vënë në dijeni edhe Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës. Këta qytetarë nuk kishin marrë asnjë përgjigje zyrtare edhe pas afateve ligjore të përcaktuara me ligj. Në analizë të dokumentacionit të paraqitur dhe konkretisht të Rregullores “Për organizimin e provimeve të shtetit dhe profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë”, neni 16 citon se: 1.“Kandidati ka të drejtë të verifikojë përgjigjet e dhëna dhe të ankimojë nëse ka kontestime për rezultatin. 2.Kandidati paraqet ankesën me shkrim, pranë AKP-së, brenda 5 ditëve nga shpallja e rezultateve”. “AKP-ja shqyrton ankesën dhe i kthen përgjigje të argumentuar brenda 30 ditëve. Në rastet kur AKP-ja sugjeron rivlerësimin e rezultatit, kërkohet vendimi i Komisionit të Provimit të Shtetit”. Pas konstatimeve ju rekomanduam AKP-së:

- *“Zbatimi i nenit 16 të Rregullores “Për organizimin e provimeve të shtetit dhe Profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë”, duke rivlerësuar provimin e qytetarëve K.H, B.S, E.Xh”.*

Në përgjigjen e AKP-së ky rekomandim nuk u pranua me argumentin se qytetarët kanë të drejtë të hyjnë përsëri në provimin e shtetit për të përmbushur detyrimet.

7. Ankesë për Bordin e QSUT-së për zgjedhjen si shefe shërbimi. Nr.doc 201300663.

Shtetësja A. B., ka paraqitur një ankesë në lidhje me, zhvillimin dhe problemet ligjore që ajo ka hasur në një procedurë konkurrimi që, është zhvilluar në Fakultetin e Mjekësisë, të Universitetit të Mjekësisë të Tiranës, për zgjedhjen e Shefit të Shërbimit të Laboratorit Klinik-Biokimik-Mikrobiologjik. Sikundër ajo shkruan, punon si pedagoge e brendshme e Shërbimit të Laboratorit Biokimik-Klinik, në Fakultetin e Mjekësisë, të Universitetit të Mjekësisë të Tiranës, prej vitit 1986 dhe si mjeke specialiste e Laboratorit Biokimik-Klinik, në QSUT. Ajo shkruan se është informuar për kriteret vlerësuese dhe përfshirëse në këtë proces zyrtarisht. Në këtë shkresë, ankuesja shprehet se, jepen kriteret të qarta dhe mënyra e pikëzimit gjatë vlerësimit të aktivitetit kërkimor shkencor dhe akademik të kandidatëve, si dhe jepet informacioni se, kriteri për t’u përfshirë në këtë proces është “të paktën 15 vjet pedagog i brendshëm”. Komisioni “Ad hoc”, duke shkelur kriterin përfshirës të eksperiencës akademike ka pranuar dhe përzgjedhur një kandidatë e cila, ka vetëm dy vjet eksperiencë pedagogjike, si pedagoge e brendshme. Fakti është se, sipas ankueses, në këtë shkresë nuk jepej asnjë informacion mbi vlerësimin, pikëzimin dhe renditjen e kandidatëve konkurrues, ndërkohë që mungon transparencja për mënyrën se si janë përzgjedhur kandidaturat që, i janë përcjellë bordit. Për shkak të parregullsive të konstatuara, ankuesja shkruan se ka paraqitur një ankesë pranë Kryetarit të Bordit të QSUT-së - Ministrit të Shëndetësisë, të protokolluar me nr.13-9 datë 14.02.2013, si dhe ka paraqitur edhe një ankesë tek Rektorja e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, në datën 18.02.2013. Pas konstatimeve dhe analizave, i rekomanduam bordit të QSUT-së:

- *Inicimin e procedimit administrativ për konstatimin e pavlefshmërisë absolute të vendimit përkatës, të marrë nga ana e Bordit të QSUT-së për përzgjedhjen e kandidaturës fituese, për pozicionin e Shefit të Shërbimit Laborator Klinik-Biokimik-Mikrobiologji dhe konstatimin e këtij vendimi si absolutisht të pavlefshëm.*
Bordi i QSUT-së nuk ka kthyer përgjigje lidhur me këtë rekomandim.

8. Rast me iniciativë për arsimimin e fëmijëve të ngjuar. Nr doc 201302282

Gjakmarrja në Shqipëri ndonëse e lokalizuar në disa zona, është kthyer në një fenomen shumë shqetësues për shoqërinë tonë, sepse cënon të drejtën më të rëndësishme të njeriut, të drejtën e jetës. Për shkak të saj kanë lindur edhe disa pasoja të tjera negative sikurse mund të përmendim, ngujimin e personave pa dallim gjinie e moshe, duke iu mohuar një sërë të drejtash kushtetuese themelore, si atë të lëvizjes së lirë, të arsimimit, të punësimit, të përfitimit të kujdesit shëndetësor, të votimit, të lirisë së organizimit, të lirisë së bindjes dhe shfaqjes së saj etj.

Ndërkohë shqetësimin e këtij fenomeni dhe sidomos vitet e fundit po e ndiejnë dhe vuajnë edhe disa vende të BE-së, për shkak të numrit në rritje të azilkërkuesve shqiptarë, duke përfshirë edhe ato raste abuzive të personave të cilët pretendojnë se u rrezikohet jeta në Shqipëri për shkak të këtij fenomeni. Gjakmarrja nuk është vlerësuar seriozisht nga strukturat shtetërore, të cilat fatkeqësisht nuk kanë dëshiruar që ta pranojnë atë. Këtë qëndrim e tregon edhe fakti që nuk ka statistika të sakta nga policia për numrin e të vrarëve për gjakmarrje, të familjeve dhe të personave të ngjuar, madje ato nuk administrohen as nga INSTAT-i. Kjo ndodh edhe për faktin se fenomeni është dinamik. Fenomeni është mesjetar, kriminal dhe jo i pastër kanunor. Fëmijët e ngjuar për shkak të rrethanave ku jetojnë rriten me ndjenjën e urrejtjes dhe vuajnë mungesën e shkollimit. Nuk ka asnjë investim nga organet e shtetit dhe të drejtësisë për të nxjerrë personat nga ngujimi. Në këtë kuadër Ministria e Arsimit dhe Sportit duhet të luajë rol më të madh pozitiv për përmirësimin e programeve mësimore, që të sigurohet mirëarsimimi dhe mirëedukimi i brezit të ri me frymën e tolerancës, jo dhunës, pranimin e diversitetit, kundër vetëgjyqësisë, hakmarrjes e gjakmarrjes. Trajnimi i mësuesve të zonave, ku është e përhapur gjakmarrja është i rëndësishëm. Duhet të vazhdojë edhe për disa kohë Projekti "Shansi i dytë", nëpërmjet të cilit të përfitojnë të gjithë fëmijët e ngjuar, dhe jo vetëm ata në qarkun e Shkodrës por edhe në qarqe të tjera të vendit. Pas këtyre konstatimeve i Rekomandua Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve:

- *Marrjen e masave konkrete në identifikimin e familjeve me fëmijë të ngjuar nga gjakmarrja në të gjithë territorin e vendit, dhe mundësinë e arsimit të tyre me prioritet maksimal nga ana e strukturave rajonale arsimore.*

Ministria e Arsimit dhe Sportit në përgjigjen e saj na sqaroi se është e angazhuar në arsimimin e fëmijëve të ngjuar, të cilët duhet të përfitojnë nga e drejta për tu arsimuar si të gjithë nxënësit e tjerë.

Konkluzione

Nga ankesat e ardhura por edhe rastet e nisura me iniciativë nga ana jonë dalin problematikat e kësaj fushe që konkretisht më të spikaturat kanë të bëjnë me: Kurrikulat dhe tekstet mësimore, paraqesin gabime të theksuara; ka probleme me tekstet alternative dhe mënyrën e selektimit të tyre nga ana e bordeve; ka probleme të rekrutimit të mësuesve si dhe heqja e tyre nga puna, transferimet e ndryshme për qëllime politike. Problematikë mbetet arsimimi i fëmijëve të ngjuar, fëmijëve të komunitetit rom apo ato me aftësi të kufizuar. Gjithashtu duhet rishikuar gjuha shqipe në librat dhe tekstet shkollore.

H. Plotësimi i nevojave të shtetasve me strehim

Vështrim i përgjithshëm

Të drejtat dhe liritë themelore sanksionohen në Kushtetutë dhe garantohen nga aktet ndërkombëtare. Objektivat sociale¹² shprehin synimet dhe objektivat e shtetit në përmbushje të të drejtave dhe nevojave sociale për shtetasat në nevojë. Këto objektiva shteti synon t'i realizojë vetë, përmes respektimit të kompetencave kushtetuese dhe mjeteve që disponon si dhe në plotësim të misioneve dhe përgjegjësiive ligjore.

Ato përbëjnë një sanksionim të mirë të modeleve të ofruara nga Karta Sociale Europiane¹³, sipas të cilës palët angazhohen të marrin masat që synojnë nxitjen e aksesit në strehim të një standardi të mjaftueshëm, parandalimin dhe uljen e numrit të të pastrehëve me synim eliminimin e tij gradual dhe vendosjen e çmimit të arritshëm nga ata pa burime të mjaftueshme.

Objektivat Sociale ndryshojnë nga të drejtat dhe liritë themelore, sepse nuk kërkohen si një e drejtë dhe të mund të atakohen në gjykatë. Ato janë një detyrim, i cili mbetet mundësi reale e shtetit, pavarësisht standardeve të përcaktuara në Kushtetutë dhe në akte të tjera ligjore e nënligjore¹⁴.

Institucioni i Avokatit të Popullit në ushtrim të funksionit të tij kushtetues për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, prioritet të punës së tij ka pasur edhe të drejtën për strehim duke u fokusuar kryesisht tek grupet në nevojë sikundër janë endacakët apo të pastrehët; pjesëtarët e komunitetit Rom etj.

Për vitin 2013, kemi trajtuar 183 raste të nisura ex-officio dhe ankesa individuale por edhe raste të nisura ex-officio, prej të cilave 92 ankesa rezultojnë të shqyrtuara nga ana jonë dhe 91 raste të tjera janë ende në proces verifikimi (trajtimi). Nga rastet e përfunduara, rezultojnë se 54 ankesa ose rreth 59% e tyre janë zgjidhur në favor të ankuesve (nga këto ankesa 13 janë përfunduar me rekomandime të pranuar). Për 21 ankesa, pretendimet e ankuesve kanë rezultuar të pabazuara dhe 12 raste rezultojnë jashtë kompetencës dhe juridiksionit të trajtimit nga zyra e Avokatit të Popullit. Gjithashtu, nga ankesat e trajtuara, rezulton se për dy raste rekomandimet dhe sugjerimet e dhëna, nuk janë pranuar dhe zbatuar nga organet e qeverisjes vendore.

Analizë e rasteve konkrete

1. Me vendosjen e demokracisë në vend, trajtimi i pakicave ka marrë një dimension të ri, fakt që duket qartë në angazhimet që janë marrë për këtë qëllim. Zbatimi në praktikë i parashikimeve të akteve themelore, por edhe zbatimi i akteve ndërkombëtare dhe veçanërisht i përcaktimeve të Konventës Kuadër të Këshillit të Europës, "*Për mbrojtjen*

¹² Objektivat Sociale Kreu V i Kushtetutës në Republikën e Shqipërisë

¹³ Karta Sociale Europiane e ratifikuar nga Shqipëria në vitin 2002, neni 31 ku citohet e drejta për strehim

¹⁴ Ligji Nr. 9232 datë 18.05.2004 "Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane", i ndryshuar; VKM Nr.814 datë 03.12.2004 "Për normat e strehimit për familjet që përfitojnë nga programet sociale të strehimit"; VKM Nr. 53 datë 28.01.2005 "Për përcaktimin e dokumentave të nevojshme për të përfutuar strehim"; VKM Nr. 574 datë 29.08.2012 "Për përcaktimin e dokumentave që duhen të paraqesë familja për t'u strehuar sipas njërit prej programeve sociale të strehimit"; Udhëzimit Nr. 6257 datë 02.09.2008 "Mbi përcaktimin e masës së subvencionimit për familjet që përfitojnë kredi të lehtësuara nga shteti" dhe Udhëzimit Nr. 2348 datë 17.04.2008 "Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin Nr. 6257 datë 02.09.2008".

e minoriteteve”, ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në përmirësimin e të drejtave të pakicave. Në këtë drejtim, roli i Avokatit të Popullit ka marrë një rëndësi të veçantë, duke vijuar edhe për vitin 2013 me rekomandime për komunitetin Rom drejtuar organeve të Administratës Publike në nivel qendror dhe vendor.

Nga inspektimet dhe vizitat që janë zhvilluar në disa qendra si dhe ankesat e paraqitura ka rezultuar se kushtet e jetesës në këto qendra ishin të vështira, pasi konkretisht kishte mungesa në lidhjen e sistemit zonal të shpërndarjes së energjisë elektrike, mungesa në furnizimin me ujë të pijshëm, mungesë kanalizimesh dhe sistemin e brendshëm të rrugëve.

Në gjykimin tonë mungesa e kushteve minimale të jetesës në këto qendra banimi, duke mos përjashtuar edhe vendbanime të tjera të këtij komuniteti është një problem serioz. Dokumenta strategjike të formuluar për këtë qëllim, sikundër është Plani Kombëtar i Veprimit 2010-2015 *“Dekada e përfshirjes së Romëve”*, japin rekomandime dhe masa të cilat shkojnë në të njëjtën linjë me përmbushjen e kritereve politike që Bashkimi Europian ka vendosur ndaj vendit tonë si kusht për procesin e integritimit në BE.

Për sa më sipër, me qëllim garantimin e një cilësie jete më të mirë për komunitetin Rom në vend, specifikisht në zonat ku ndodhen qendrat e njohura të vendbanimeve, i kemi rekomanduar Ministrin të Punëve Publike dhe Transportit *“Marrjen e masave konkrete të parashikuara në strategjinë kombëtare për përmirësimin e kushteve të jetesës në komunitetin Rom dhe Planin Kombëtar të Veprimit 2010-2015 në përgjithësi, si dhe në vendbanime konkretet, sikundër godina e ish Repartit Ushtarak të ndodhur në zonën e Sharrës, Tiranë”*.

Gjithashtu, me rekomandimet drejtuar organeve të Administratës Publike qendrore dhe vendore lidhur me komunitetin Rom, kemi kërkuar:

a) Ndryshimin e legjislacionit ekzistues për sa i takon plotësimin të kritereve për të përfituar nga mundësitë që ofron pushteti qendror dhe ai vendor për problemin e strehimit.

b) Thjeshtimin e procedurave të aplikimit pranë zyrave përkatëse për një akses më të gjerë dhe lehtësim në plotësimin e dokumentacionit, për sa i takon problemit të strehimit.¹⁵

2. Për vitin 2013 një numër i konsiderueshëm ankesash sikundër edhe në vitin 2012, janë paraqitur lidhur me pasojat që i kanë ardhur familjeve qiramarrëse në banesat e ish pronarëve e subjekteve të shpronësuara, nga zbatimi i Aktit Normativ të Këshillit të Ministrave Nr.3 datë 01.08.2012, *“Për lirimin e banesave pronarëve të ligjshëm nga qytetarët e pastrehë, banues në banesat ish pronë e subjekteve të shpronësuara”*.¹⁶

Akti Normativ i mësipërm ofron këto mënyra me anë të të cilave do të realizohet strehimi i këtyre subjekteve:

a) Kreditim nga ana e Bankës Kombëtare Tregtare, në kushtet deri në 30 vjet me 0% interes.¹⁷

b) Trajtim me strehim në banesa sociale nga Këshillat Bashkiak, duke pasur përparësi në programet e banesave sociale me qira.¹⁸

¹⁵ Mbi problematikat e gjithë komunitetit Rom kemi hartuar në vitin 2013 raportin e dytë të veçantë, sipas parashikimeve të Ligjit Nr. 8454 datë 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*, I ndryshuar

¹⁶ Problematikë e cila është trajtuar edhe në raportin Vjetor mbi veprimtarinë e Institucionit të Avokatit të Popullit të vitit 2012.

¹⁷ Neni 1, si dhe paragrafi 1, neni 4 I Aktit Normativ të Këshillit të Ministrave Nr.3 datë 01.08.2012.

¹⁸ Ibid, paragrafi 2, neni 4.

- c) Për personat e moshuar, të paaftë të kujdesën dhe pa persona të tjerë në ngarkim, kur nuk dëshirojnë, me deklaram me shkrim, sistemimin me qira apo sipas verifikimit të kryer janë të paaftë të kujdesen për vete, bëhet sistemimi me strehimin e tyre në qendrat e përkujdesjes së moshës së tretë.¹⁹

Nga një shqyrtim paraprak që institucioni i Avokatit të Popullit ka bërë për qartësimin e mundësive për realizimin e këtyre mënyrave për strehimin e qiramarrësve në banesat e ish pronarëve, rezulton se ekzistojnë problematika serioze të cilat kërkojnë veprim të shpejtë dhe të koordinuar mirë me të gjitha institucionet përgjegjëse shtetërore.

Së paku në rastet e paraqitura, evidentohet fakti se megjithëse akti normative parashikon trajtimin e qytetarëve të pastrehë, banues në banesat ish pronë e subjekteve të shpronësuar, me kredi 0% interes, apo me banesa sociale, që do t'u jepen nga qeverisja vendore, efektivisht kjo gjë në kushtet aktuale rezulton të jetë e vështirë.

Ky konkluzion bazohet edhe në faktin se kërkesave tona për informacion drejtuar Bashkisë Tiranë, mbi mundësinë reale për të trajtuar kërkesat e shumta të qiramarrësve në banesat e ish pronarëve me banesa sociale nuk i është dhënë një përgjigje zyrtare. Aq më tepër, kur evidentohet si e porealizueshme mënyra e sistemimit të të moshuarve, të paaftë të kujdesen dhe pa persona të tjerë në ngarkim, në qendrat e përkujdesjes për moshat e treta, sipas shifrave që zyrtarisht jepen për këtë qëllim nga ministria e linjës.

Situata emergjente që synoi të zgjidhte Akti Normativ Nr.3, datë 01.08.2012, rezulton të jetë kthyer në situatë emergjente për një numër të madh individësh, apo familjesh qiramarrëse, banues në banesat ish pronë e subjekteve të shpronësuar.

Avokati i Popullit ka qenë dhe mbetet i angazhuar tërësisht për të kontribuar në gjetjen e një zgjidhje sa më të shpejtë dhe sa më optimale për këto familje dhe individë, të cilët praktikisht janë në një situatë "pa zgjidhje", pavarësisht çfarë parashikon në dispozitat e tij ky akt normative, angazhim, i cili është përcjellë së fundi edhe në një rekomandim të përsëritur edhe Kryeministrit aktual të Republikës së Shqipërisë.

3. Kushtet e vështira klimaterike, temperaturat e ulëta të stinës së dimrit kanë përbërë një nevojë emergjente për hartimin e një rekomandimi drejtuar gjithë njësive të qeverisjes vendore për marrjen e masave të mundshme organizative për përgatitjen e vend-strehimeve apo vend-qëndrimeve provizore për grupe të tilla në nevojë sikundër janë personat endacakë apo të pastrehë dhe pjesëtarë të komunitetit Rom dhe këdo tjetër në nevojë me qëllim parandalimin e situatave që mund të rrezikojnë jetën apo shëndetin e tyre dhe veçanërisht të fëmijëve.

Nga evidentimi i përgjigjeve të njësive të qeverisjes vendore është konstatuar se:

a) në një pjesë të konsiderueshme të Bashkive në vend, përgatitja e vend-strehimeve është problem shumë vjeçar për shkak se ka mungesa fondesh dhe është e pamundur vënia në funksionim e vend-strehimeve provizore ekzistuese.

b) Në një pjesë tjetër evidentohet se nuk ka fare ambiente që mund të përshtaten si vendbanime provizore dhe është e pamundur krijimi i tyre për shkak të kushteve financiare.

c) Mungojnë planet dhe projektet e nevojshme për të adresuar çështje urgjente të strehimit

¹⁹ Ibid, paragrafi 3, neni 4.

4. Gjithashtu, për të krijuar një panoramë më të qartë mbi strehimin në Shqipëri kemi kërkuar informacion ndaj gjithë njësive të qeverisjes vendore lidhur me:

- a) Kriteret që duhet të plotësojnë aplikantët për të përfituar trajtim me banesa sociale;
- b) Numrin e përgjithshëm të aplikantëve që gëzojnë statusin e “të pastrehit”;
- c) Numrin e personave që kanë përfituar trajtim me banesa me kosto të ulët dhe trajtim me banesa sociale me qira’
- d) Fondet e alokuara lidhur me strehimin dhe sa përqind nga buxheti i alokuar përdoret për ndërtimin e banesave me qira.

Në zbatim të Ligjit Nr. 9232 datë 13.05.2004, “Për programet sociale për strehimin e banesave të zonave urbane”, i ndryshuar ka disa kritere për aplikuesit sikundër janë:

- Nuk disponojnë banesa në pronësi (jetojnë me qira ose në ruajtje)
- Familje që banojnë nën normat e strehimit
- Familje njëprindërore
- Persona të moshuar në pension
- Çiftet e reja me moshë totale deri në 60 vjeç
- Personat me aftësi të kufizuar
- Të ardhurat e familjes

Nga evidentimi i pjesës më të madhe të rasteve konstatohet se është në rritje numri i aplikuesve të cilët gëzojnë statusin e “të pastrehit”, situatë kjo edhe pas nxjerrjes së Aktit Normativ të Këshillit të Ministrave Nr.3, datë 01.08.2012, “Për lirimin e banesave pronarëve të ligjshëm nga qytetarët e pastrehë, banues në banesat ish pronë e subjekteve të shpronësuar”, por nga kriteret e mësipërme të vendosura, pjesa më e madhe e aplikantëve nuk janë përfitues për shkak të mospërmbushjes së kritereve.

Gjithashtu, vihet re se në pjesën më të madhe të Bashkive në vend ka mungesa të theksuara të fondeve të alokuara për ndërtimin e banesave sociale.

Në vijim, mbi gjithë problematikat e strehimit, veçanërisht në mbrojtje të shtresave në nevojë, jemi duke hartuar një raport të posaçëm, kjo referuar nenit 27 të Ligjit Nr. 8454, datë 04.02.1999, “Për Avokatin e Popullit”, i cili së shpejti do të përcillet pranë Komisioneve Parlamentare dhe Organeve të Administratës Publike qendrore dhe vendore.

Konkluzione

E drejta për strehim vijon të mbetet një nga objektivat sociale më të çënuara, veçanërisht në drejtim të ofrimit të saj ndaj shtresave vulnerabël të shoqërisë.

Për sa më sipër, Avokati i Popullit në vijim, do të synojë trajtimin e ankesave lidhur me “Plotësimin e nevojave të shtetasve me strehim”, duke u fokusuar kryesisht në:

- Hartimin e rekomandimeve me qëllim nxitjen e organeve të Administratës Publike

qendrore dhe vendore për hartimin e një strategjie për objektivën sociale të strehimit me standarde të vendosura për familjet në nevojë, personat me aftësi të kufizuar, komunitetin Rom dhe të tjerë që nuk marrin ndihma/asistencë sociale.

- Ndjekjen e problematikave të komunitetit Rom për ndryshimin e legjislacionit ekzistues për sa i takon plotësimin të kriterëve për të përfituar nga mundësitë që ofron pushteti qendror dhe ai vendor për problemin e strehimit dhe thjeshtimin e procedurave të aplikimit pranë zyrave përkatëse për një akses më të gjerë dhe lehtësim në plotësimin e dokumentacionit, për sa i takon problemit të strehimit.
- Hartimin e rekomandimeve për alokimi sa më të shpejtë të fondeve të mjaftueshme nga buxheti i shtetit, organeve të qeverisjes vendore për ndërtimin e banesave sociale me të cilat, të mund të trajtohen me përparësi individët, apo familjet qiramarrëse të pastreha, banuese në banesat ish pronë e subjekteve të shpronësuara, sipas kërkesave specifike të bashkive
- Hartimin e rekomandimeve për ndryshimet e mundshme ligjore lidhur me kriteret e vendosura për familjet e pastreha me qëllim trajtimin sipas programeve sociale të strehimit dhe krijimin e mundësive për përfitimin nga to.

I. Ndhimja ekonomike

Vështrim i përgjithshëm

Programi i ndihmës ekonomike ka si qëllim mbrojtjen e personave në nevojë, të cilët nuk janë në gjendje të sigurojnë një standard të përshtatshëm jetese për veten dhe familjen e tyre.

Ligji Nr. 9355 datë 10.03.2005, "Për ndihmën ekonomike dhe përkujdesjen shoqërore", i ndryshuar, përcakton sistemin e ndihmës dhe të përkujdesjes shoqërore për të dhënë ndihmë ekonomike familjeve të shtetasve shqiptarë, të cilëve ju mungojnë të ardhurat dhe mjetet e jetesës krejtësisht, apo i kanë ato të pamjaftueshme. Në rastet kur është e nevojshme dhe e mundshme, në vend të ndihmës ekonomike ose si shtesë e saj, ofrohen shërbime publike të përkujdesjes shtetërore. Familje të varfra apo familje në nevojë konsiderohen familjet që nuk kanë asnjë të ardhur monetare apo materiale dhe po ashtu edhe familje të tjera me të ardhura të pamjaftueshme nga veprimtaria ekonomike, programe të tjera të mbrojtjes shoqërore dhe kapitali.

Objekti i ankesave në këtë fushë ka qenë: ndërprerja e padrejtë e ndihmës ekonomike, mosdhënia e së drejtës për të përfituar ndihmën ekonomike, mosdhënia në kohë e pagesës së ndihmës ekonomike, apo edhe kërkesa për t'u sqaruar lidhur me përfitimet nga legjislacioni i ndihmës ekonomike. Gjatë këtij viti pranë institucionit të Avokatit të Popullit janë depozituar 49 ankesa. Janë përfunduar 44 ankesa dhe konkretisht: 25 ankesa të pabazuara, 2 jashtë kompetence, 1 jashtë juridiksionit, 12 të zgjidhura në favor të ankuesve, 2 rekomandime të pranuar dhe 2 të refuzuara. Janë në poqes shqyrtimi 5 ankesa.

Mosdhënia prej disa muajsh e ndihmës ekonomike si dhe e pagesës së aftësisë së kufizuar pranë bashkive dhe komunave në të gjithë vendin, ka qenë në fokusin e punës së Avokatit të Popullit.

Dhënia e këtyre pagesave filloi në muajin Dhjetor 2013 dhe nga qeveria u premtua se nuk do të ketë më vonesa në dhënie të ndihmës ekonomike dhe aftësisë së kufizuar. Përfitimi i pagesave të prapambetura do të vazhdojë nga muaji Janar 2014 e në vazhdim.

Sistemi ekzistues i ndihmës ekonomike mund të sigurojë të ardhurat e nevojshme për të varfërit, por ai nuk i ndihmon ata që të shpëtojnë nga varfëria. Shumë familje shqiptare jetojnë me pagesat e ndihmës ekonomike, duke mos pasur asnjë të ardhur tjetër në familje.

Gjatë trajtimit të ankesave në këtë fushë, kemi konstatuar se shumë shtetasve nuk u jepet e drejta për të përfituar ndihmë ekonomike, kur nga ana e administratorit shoqëror, pasi bëhet verifikimi për kushtet social-ekonomike, është konstatuar se jetojnë në kushte të mira ekonomike. Pretendimi i tyre ka qëndruar në faktin se nëse plotësohen kushtet për përfitim të ndihmës ekonomike, pavarësisht të pasjes së një banese të mirërregulluar, në kohën e aplikimit për ndihmë ekonomike familja është pa asnjë të ardhur ose me të ardhura të pamjaftueshme, atyre nuk u është dhënë e drejta e përfitimit të ndihmës ekonomike.

Siç e kemi theksuar edhe në Raportin Vjetor 2012, një nga problemet që lidhet me ndihmën ekonomike është edhe mosdeklarimi i minimumit jetik në Shqipëri. Kjo çështje kërkon

zgjidhje, pasi minimumi jetik, nuk është vetëm një tregues që lidhet me nevojat që ka njeriu për të siguruar mbijetesën në kushtet aktuale, por bazuar në të, përcaktohen edhe nivelet e përfitimeve në skemat e mbrojtjes shoqërore.

Analizë e rasteve konkrete

Ankesa me **nr.doculive 201301198**, e cila bën fjalë për një shtetase, nga qyteti i Tiranës, kryefamiljare, e papunë me 3 fëmijë të vegjël në ngarkim, pa asnjë të ardhur. Nuk përfitonte ndihmë ekonomike, pasi kjo familje nuk ishte e regjistruar në gjendjen civile të vendbanimit aktual. Për këtë arsye edhe vajza e saj nuk është regjistruar në një nga shkollat 9 vjeçare, ndërsa fëmija i vogël, 6 muajsh nuk ishte i regjistruar në gjendjen civile.

Që prej 10 vjetësh kjo shtetase së bashku me bashkëshortin e saj, të ndjerë, kishin ardhur nga qyteti i Lushnjës për të banuar në Tiranë. Përpara një viti është bërë regjistrimi në zyrën e gjendjes civile pranë Bashkisë Kavajë, me qëllim që më pas ta transferonin në Tiranë. Mungesa e dokumentacionit pranë zyrës së gjendjes civile të Njesisë Bashkiake nr.11, Tiranë, bënte që kjo familje, tashmë me 4 anëtarë, pa të ardhura jetese, të privohet nga programet e mbrojtjes sociale dhe si pasojë nuk arrinte të përfitonte as nga sistemi i ndihmës ekonomike, as të jetë e regjistruar si punëkërkuese e papunë apo të përfitojë një strehim.

Megjithëse Ligji Nr.10129 datë 11.05.2009 “Për Gjendjen Civile”, i ndryshuar, në Kreun III, në nenin 15, ka përcaktuar afatet për deklarimin, regjistrimin dhe ndryshimin e vendbanimit të shtetasve, ku në pikën 3 të këtij neni thuhet se: *“Në rast ndryshimi të vendbanimit, apo kur një banesë nuk përdoret më për përdorim vetjak apo të familjes, ky ndryshim deklarohet në zyrën e gjendjes civile. Regjistrimi fillestar i vendbanimit apo ndryshimi i tij bëhet jo më vonë se 30 ditë nga ardhja në këtë vendbanim. I njëjti afat zbatohet edhe për deklarimin e banesave që nuk kanë statusin e vendbanimit”*, mungesa e informacionit si dhe mungesa e burimeve financiare për të ndjekur procedurat ligjore, ka bërë që kjo familje të mos figuronte e regjistruar në gjendjen civile pranë Njesisë Bashkiake nr.11, Tiranë. Për t’i ardhur në ndihmë kësaj familje, në mbështetje të nenit 15 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i cili i cilëson të drejtat dhe liritë themelore të njeriut si “të pandashme, të patjetërsueshme e të padhunueshme dhe që qëndrojnë në themel të të gjithë rendit juridik”, duke sanksionuar kështu barazinë pa asnjë lloj diskriminimi të të gjithë shtetasve që jetojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë si dhe bazuar në parimin e Konventës së OKB-së “Për të drejtat e fëmijëve”, që interesi më i lartë i fëmijës duhet të jetë konsiderata parësore e punës së administratës shtetërore, i rekomanduam Kryetarit të Njesisë Bashkiake nr.11, marrjen e masave për të mundësuar: Regjistrimin e kësaj familjeje në regjistrat e zyrës së gjendjes civile të Njesisë Bashkiake nr.11, Tiranë, me qëllim që kjo familje të përfitojë nga skema e mbrojtjes shoqërore si dhe përfitimin e ndihmës ekonomike për familjen e saj.

Pas ndërmjetësimit tonë institucional, nga ana e asaj njësie na u shpreh gatishmëria për të marrë masat e duhura për zgjidhjen e problemeve të saj.

Në ankesën me **nr. doculive 201301486**, një shtetase nga qyteti i Tiranës, ankohej për ndërprerjen e ndihmës ekonomike. Pas ndërmjetësimit tonë institucional me Kryetarin e Njesisë Bashkiake Nr.1, Tiranë, rezultoi se ajo nuk ishte banore e asaj njësie.

Bazuar në VKM nr.787 datë 14.12.2005 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurave dhe të masës së ndihmës ekonomike”, në pikën 5, thuhet shprehimisht se: *“Kur familjet pretenduese ndryshojnë vendbanimin, ato duhet të paraqesin brenda 30 ditëve në vendbanimin e ri një dokument, ku të vërtetohet se kanë përfituar ndihmë ekonomike në vendbanimin e mëparshëm”*.

Me qëllim që kjo shtetase të përfitonte ndihmën ekonomike, i sugjeruam se që të regjistrohej në Njësinë Bashkiake nr.1, duhet të ketë një kontratë qiraje brenda territorit të njësisë administrative, të paktën 1 vjeçare, për ta paraqitur në zyrat e gjendjes civile. Më pas brenda afatit 30 ditor të paraqitej në zyrën e ndihmës ekonomike të Njësisë Bashkiake nr.1 për të dorëzuar dokumentin që të vërtetonte se ka qenë përfituese e ndihmës ekonomike në Njësinë Bashkiake nr.4.

-Nisur nga kronika e transmetuar në News 24 tv, me titull *“Familja Peçi në mjerim të plotë, apel për ndihmë në News 24”*, Institucioni i Avokatit të Popullit, në përputhje me paragrafin e parë të nenit 13 të Ligjit nr.8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, filloi me iniciativën e tij shqyrtimin e kësaj çështjeje. Ajo familje jetonte në kushte shumë të vështira ekonomike. Një nga djemtë ishte i sëmurë mendor, i cili kishte nevojë për përkujdesje. Familja nuk ishte përfituese e ndihmës ekonomike dhe për vetë kushtet në të cilat ndodhej, kishte bërë apel për ndihmë, pasi nuk përballonte dot as nevojat më imediate për jetesën e përditshme.

Duke qenë se kryefamiljari i familjes Peçi nuk ishte paraqitur asnjëherë pranë zyrës së ndihmës ekonomike për të bërë kërkesën për tu futur në skemën e ndihmës ekonomike, i sugjeruam që të paraqitej pranë administratorit shoqëror të Zyrës së Ndihmës Ekonomike të Komunës Kajan për të bërë kërkesën për përfitim të ndihmës ekonomike, sipas dispozitave ligjore.

-Nëpërmjet medias së shkruar dhe konkretisht Gazetës Shqiptare të datës 19.04.2013,

në shkrimin e saj me titull: *“Të moshuarit e azilit të Shkodrës në protestë, 7 muaj pa marrë pensionet”*, u vumë në dijeni se 40 të moshuar, azilantë të Shtëpisë së të Moshuarve, Shkodër, kishin 7 muaj pa marrë shumën prej 6000 lekësh në muaj, të cilën e përdorin për shpenzime vetjake.

Në atë qendër, strehoheshin 73 të moshuar, nga të cilët 31 nuk kishin qenë asnjëherë në marrëdhënie pune dhe përfitonin një shumë mujore si ndihmë vetjake në masën e 6000 lekëve në muaj. Kjo shumë u jepej të moshuarve nga fondi në zërin “602”, ku ishin përfshirë shpenzimet për ushqime, energji elektrike, ujë riparime etj. Në fillim të çdo viti këto fonde akordohen nga MPÇSSHB-ja, por jepen edhe shtesa gjatë vitit, pasi mund të ketë prurje të reja në qendër dhe shtohen shpenzimet. Këtë shumë, të moshuarit e përfitojnë në bazë të VKM-së nr. 114 datë 31.01.2007 “Për përcaktimin e masës së kontributeve të personave që vendosen në institucionet rezidenciale publike të përkujdesit shoqëror”, i ndryshuar me VKM nr.898 datë 10.11.2010, në pikën 3, gërma “ç”, ku thuhet shprehimisht se:

“... Personat e moshuar, që nuk kanë të ardhura, që janë vendosur në shtëpitë rezidenciale publike u jepet një shumë në të holla në dorë në masën 6.000 (gjashtëmijë lekë) në muaj”.

Me qëllim që të moshuarit të përfitonin të drejtën e tyre ligjore, iu drejtuam me rekomandim Ministrit të Financave dhe ish-Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta për marrjen e masave për çeljen e shtesës së fondeve për Shtëpinë e të Moshuarve Shkodër. Në përgjigje të rekomandimit tonë, Ministria e Financave shprehu

gatihmërinë e saj për mbështetje të zgjidhjeve të propozuara nga ana e Institucionit tonë, brenda buxhetit të miratuar për vitin 2013 për MPCSSHB. Ndërsa nga MPCSSHB, na u konfirmua fakti se më datë 08.05.2013 ishte akorduar fondi në vlerën prej 850000 lekësh.

Konkluzione

Pavarësisht se ka filluar zbatimi i projektit për modernizimin e ndihmës ekonomike, nëpërmjet ngritjes së një regjistri elektronik të përfituesve për ndihmën ekonomike dhe përcaktimit të një sistemi vlerësimi të nevojave nëpërmjet pikëzimit, ku verifikimi i të dhënave do të bëhet online, përsëri kërkohet një përmirësim i mëtejshëm në drejtim të:

- Nivelit të përfitimit të ndihmës ekonomike.

- Identifikimit të nevojave të familjeve që përfshihen në skemën e ndihmës ekonomike.

Për shkak të kufizimit (tavanit) prej 8000 lekë në muaj për familje, familjet me shumë anëtarë sipas mekanizmit të sotëm përfitojnë mesatarisht më pak lekë për çdo person, se sa përfitojnë familjet e tjera të varfra që kanë më pak persona në përbërje të tyre. Duhet të rritet taveni maksimal i masës së ndihmës ekonomike për familje.

-Ndihma ekonomike duhet të jepet në kohë dhe të mos ketë më vonesa në dhënien e kësaj ndihme, pasi për përfituesit është burimi i vetëm i jetesës së përditshme. Prandaj duhet të merren masat e nevojshme nga ana e organeve shtetërore për lëvrimin në kohe të kësaj pagese.

Edhe një herë sjellim në vëmendje, se duke qenë se nivelet e përfitimeve në skemat e mbrojtjes shoqërore lidhen me minimumin jetik, kërkesa për përcaktimin e tij mbetet një detyrë ligjore dhe domosdoshmëri jetike për shtresa të caktuara të shoqërisë shqiptare.

J. Mbrojtja e konsumatorit

Vështrim i përgjithshëm

Mbrojtja e konsumatorit paraqitet një nga fushat kryesore që lidhet drejtpërdrejtë me mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Rregullimi i kësaj fushe mbështetet në tre shtylla kryesore sikundër janë shëndeti i konsumatorit, sigurimi i konsumatorit dhe mbrojtja e të drejtave dhe interesave ekonomike të konsumatorit.

Në nenin 4, të Ligjit Nr. 9902 datë 17.04.2008, "Për mbrojtjen e konsumatorit", i ndryshuar, janë përmbledhur parimet bazë të cilat duhet të zbatohen praktikisht në legjislacionin adekuat sikundër janë:

1. E drejta e mbrojtjes së shëndetit, mjedisit dhe sigurisë së jetës;
2. E drejta e mbrojtjes së interesave ekonomike;
3. E drejta e ankimit;
4. E drejta e dëmshpërblimit;
5. E drejta e edukimit;
6. E drejta e marrjes së informacionit;
7. E drejta e përdorimit të shërbimeve publike;
8. E drejta e mbrojtjes ligjore;
9. E drejta e organizimit në shoqata ose bashkime për mbrojtjen e interesave të konsumatorëve dhe e drejta e përfaqësimit të tyre vendimmarrëse.

Ligji Nr. 9902 datë 17.04.2008, "Për mbrojtjen e konsumatorit", i ndryshuar, përbën legjislacionin bazë për këtë të drejtë, ku edhe Avokatit të Popullit i njihet një rol i veçantë në nenin 56 të tij për mbrojtjen e interesave të konsumatorit jo vetëm për ankesa individuale, por edhe raste të një komuniteti më të gjerë në të gjithë vendin.

Për vitin 2013, kemi trajtuar 313 ankesa individuale të qytetarëve dhe raste të ndërmarra me inisiativë, prej të cilave 249 ankesa rezultojnë të shqyrtuara nga ana jonë dhe 64 raste të tjera janë ende në proces verifikimi (trajtimi). Nga rastet e përfunduara, rezultojnë se 208 ankesa ose rreth 83% e tyre janë zgjidhur në favor të ankuesve (nga këto ankesa 23 janë përfunduar me rekomandime të pranuar). Për 34 ankesa, pretendimet e ankuesve kanë rezultuar të pabazuara dhe 4 raste rezultojnë jashtë kompetencës dhe juridiksionit të trajtimit nga zyra e Avokatit të Popullit. Gjithashtu, për tra ankesa ka përfunduar procesi i hetimit administrativ për shkak të heqjes dorë (braktisje e procedimit Neni 102 i Kodit të Procedurës Administrative), nga vetë ankuesi.

Analizë e rasteve konkrete

1. Institucioni i Avokatit të Popullit në funksion të ushtrimit të kompetencave kushtetuese dhe ligjore, për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të ligjshme të konsumatorit ka konstatuar si problematike sigurinë ushqimore dhe mallrat e skaduara të cilat qarkullojnë në treg dhe nuk asgjesohen nga subjektet tregtare. Për këtë rast kemi kërkuar nga autoritete përkatëse monitorime dhe kontrole të vazhdueshme ndaj subjekteve tregtare, asgjësimin e produkteve në rastet kur konstatohen se janë të skaduara dhe vendosjen e masave ndëshkuese ndaj subjekteve tregtare.

Gjithashtu, problematike kemi konstatuar edhe rastin e publikuar në media mbi përmbajtjen e një sasive të lartë të aflatoksinës në qumështin që ka qarkulluar jo vetëm në tregun Shqiptar, dhe ndaj të cilit kemi rekomanduar vendosjen e standardeve mbi cilësinë e produkteve ushqimore, në respektim të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, kur jeta e personit mbrohet me ligj²⁰, me qëllim shmangien e rasteve kur cenohet apo vihet në rrezik jeta e konsumatorit si dhe zbatimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Mbrojtjen e Konsumatorit dhe Mbikëqyrjen e Tregut (2007-2013), të miratuar me VKM-në Nr. 797 datë 14.11.2007.

2. Furnizimi me ujë të pijshëm brenda gjithë parametrave higjeno-sanitarë ka qenë një fokus tjetër i veprimtarisë për mbrojtjen e interesave të ligjshme të konsumatorit, duke e konsideruar ofrimin e këtij shërbimi publik si një nevojë thelbësore për individët dhe një të drejtë elementare për ta poseduar lirisht dhe në përputhje me standardet.

Për këtë qëllim në rekomandimet e hartuara kemi sjellë në vëmendje të Ndërmarrjeve të Ujësjellës-Kanalizime sh.a në vend, jo vetëm ushtrimin e detyrave funksionale në drejtim të ofrimit të një shërbimi publik sa më cilësor, por edhe respektimin e direktivave të BE-së për mbrojtjen e konsumatorëve dhe veçanërisht ato që lidhen me masat në fushat specifike që ndikojnë drejtpërdrejt dhe kanë rëndësi thelbësore për shëndetin e konsumatorit sikundër është cilësia e ujit të pijshëm²¹.

3. Problematikë tjetër ka të bëjë me mungesën e furnizimit me energji elektrike dhe ujë të pijshëm, kjo e konstatuar në një pjesë të madhe të rasteve për shkak të moskryerjes së investimeve të reja dhe amortizimit të rrjeteve ekzistuese, (rrjeteve të ujësjellës-kanalizimeve) për shkak të mungesës së fondeve nga organet kompetente.

Në rekomandimet tona për këtë problematike kemi synuar (kryesisht ndaj Drejtorisë së Përgjithshme të Ujësjellës-Kanalizimeve dhe ministrisë së linjës), nxitjen për hartimin e projekteve të reja dhe kryerjen e investimeve përkatëse në rastet kur ka amortizim të rrjeteve ekzistuese, sikundër kanë qenë rastet e Bashkisë Patos, Lagjes Zinxhira në Gjirokastër, Lagjes "11 Janari" Vlorë, Komunës Bërdicë, Shkodër etj.

²⁰ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Neni 21, "Liritë dhe të drejtat vetjake", faqe. 14

²¹ Direktiva e Ujit të Pijshëm (98/83/KE) datë 03.11.1998, një kompleks normash që synojnë mbrojtjen e shëndetit të njeriut duke vendosur kritere për shëndetin dhe pastërtinë.

4. Mbifaturim apo keqfaturimi ka qenë një problematikë e cila është përsëritur në vite si ndaj Kompanisë CEZ Shpërndarje ashtu edhe ndaj Ndërmarrjes së Ujësjetllës-Kanalizime.

Pasi është konstatuar se faturimi i kryer ndaj shtetasve ka ardhur në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi, referuar kontratave Tip të furnizimit me energji elektrike dhe ujë të pijshëm, kemi rekomanduar marrjen e masave të menjëhershme nga Kompania CEZ Shpërndarje sh.a. dhe Ndërmarrjet e Ujësjetllës-Kanalizime sh.a, anulimin e faturimeve, kryerjen e rakordimeve përkatëse dhe korrigjimin e saj mbi bazë të konsumit real të sasisë së energjisë elektrike dhe ujit të pijshëm.

5. Rast tjetër i nisur ex-officio, ka të bëjë me aplikimin e masave nga Bashkia Kukës për pagesat e faturave të ujit të pijshëm nga ndihma ekonomike, ku për të gjithë përfituesit e ndihmës ekonomike është bërë ndalesa në vlerën 18% për pagesat e faturave të ujit të pijshëm dhe të njëjtën skemë Bashkia e ka aplikuar edhe për vjeljen e taksave vendore në çdo fillim viti.

Avokati i Popullit si një institucioni kushtetues në përmbushje të detyrave të tij funksionale dhe kushtetuese, ka konstatuar se veprimet e Bashkisë për vjeljen e detyrimeve të faturave të ujit të pijshëm, duke bërë ndalesat nga ndihma ekonomike, janë veprime të cilat vijnë në kundërshtim të hapur me ligjin.

Padyshim, që institucioni ynë nuk është pro marrjes së shërbimit publike, në rastin konkret furnizimi me ujë të pijshëm dhe mospagesës së saj nga ana e konsumatorit, por legjislacioni aktual ka parashikuar sanksione të tjera për personat që rezultojnë debitore në lidhje me pagesat e shërbimeve publike.

Referuar nenit 52 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë në pikën "2" të tij²² është parashikuar se: *"Kushdo, kur mbetet pa punë për shkaqe të pavarura nga vullneti i tij dhe kur nuk ka mjete të tjera jetese, ka të drejtën e ndihmës ekonomike në kushtet e parashikuara me ligj".*

Në kuptim të këtij neni, natyra e përfitimit të ndihmës ekonomike për individët të cilët kanë pamundësi punësimi është shprehje e mbrojtjes sociale e realizuar përmes përmbushjes së objektivave social dhe si e tillë realizimi i tyre është i lidhur ngushtësisht me detyrimin e shtetit për të bërë të mundur garantimin dhe sigurimin e mjeteve të përshtatshme për nevojat jetësore.

Gjithashtu, sipas Ligjit Nr.9355 datë 10.03.2005, *"Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore"*, i ndryshuar, në nenin 1 të tij përcaktohet "Qëllim", ku citohet se:

Ky ligj ka për qëllim:

Të përcaktojë ndihmën dhe shërbimet shoqërore për individët dhe grupet në nevojë, të cilat nuk mund të sigurojnë plotësimin e nevojave bazë jetike, zhvillimin e aftësive dhe të mundësive personale dhe ruajtjen e integritetit për shkak të aftësive dhe mundësive të kufizuara ekonomike, fizike, psikologjike e shoqërore.

²² Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Kreu IV, Liritë dhe të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore

Të zbusë varfërinë dhe përjashtimin shoqëror për individët dhe familjet, si dhe të krijojë mundësi për integrimin e tyre, nëpërmjet sigurimit të një sistemi ndërhyrjesh e shërbimesh për përmirësimin e jetesës së tyre

Në analizë të dispozitave ligjore të mësipërme, ndihma ekonomike nuk është gjë tjetër veçse një mbështetje, në para dhe natyrë, për individët me status të veçantë dhe e për familjet në nevojë.

Gjithashtu, sipas dispozitave ligjore në fuqi, e në veçanti në nenin 10 të Kontratës së Furnizimit me ujë të lidhur mes konsumatorit dhe shoqërisë furnizuese parashikohet edhe e drejta e konsumatorit lidhur me pagesën e faturës së ujit të pijshëm.

Në këtë nen citohet se:

1. Konsumatori duhet të paguajë detyrimin brenda datës (28) të muajit pasardhës të sportelet e caktuara të operatorit, nëpërmjet kontove bankare ose sipas mënyrave të tjera për të cilat kanë rënë dakord palët.
2. Nëse pagesa nuk kryhet brenda afatit, konsumatori duhet të paguajë kamatëvonesën sipas legjislacionit në fuqi.
3. Nëse pagesa nuk kryhet brenda 30 ditëve pas kalimit të afatit të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, operatori ka të drejtë të ndërpresë furnizimin me ujë. Operatori mund të ndërpresë furnizimin me ujë vetëm nëse e ka njoftuar me shkrim konsumatorin të paktën 5 ditë përpara. Njoftimi me shkrim duhet të përmbajë edhe tarifën për rilidhjen që zbatohet në këtë rast.

Pra, legjislacioni parashikon sanksione të tjera lidhur me penalizimin e konsumatorëve që nuk bëjnë pagesat e faturave të ujit të pijshëm dhe në asnjë rast nuk parashikohet që të bëhen ndalesat nga burimet e mjeteve të jetesës e aq më tepër nga ndihma ekonomike e personave në nevojë.

Për sa më sipër, pas rekomandimit tonë për marrjen e masave të menjëhershme për anulimin e vjeljes së detyrimeve të faturave të ujit të pijshëm ndaj personave të cilët përfitojnë ndihmë ekonomike pranë Bashkisë Kukës, është bërë edhe ndërprerja e vjeljes së këtij detyrimi në mënyrë të kundraligjshme.

6. Fokus tjetër i veprimtarisë së Avokatit të Popullit për mbrojtjen e të drejtave të konsumatorit dhe veçanërisht për ato grupe në nevojë sikundër janë edhe personat me aftësi të kufizuar, kanë qenë rekomandimet ndaj organeve të Administratës Publike sikundër Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë/Ministria e Financave për lëvrimin e fondeve lidhur me pagesat e subvencionimit të faturave të energjisë elektrike.

Konkretisht, gjatë vitit 2012, Ligji 26/2012 datë 05.04.2012 "Për disa ndryshime në Ligjin Nr. 8098 datë 28.03.1996, "Për statusin e të Verbërit" si dhe Ligjit Nr. 27/2012, "Për disa ndryshime në Ligjin Nr. 8626 datë 22.06.2000, "Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik", neni 12 i tyre pësoi ndryshimet si më poshtë vijon: "Të sëmuret paraplegjikë

dhe tetraplegjikë, si dhe të verbërit të cilët kanë përfituar statusin, përfitojnë kompensim të faturës së energjisë elektrike dhe të faturës së telefonisë fikse. Masa, kriteret dhe procedurat e përfitimit të këtij kompensimi financiar përcaktohen me Vendim të Këshillit të Ministrave”.

Me ndryshimet që pësoi ligji i mësipërm, Kompania “CEZ Shpërndarje”sh.a procedoi me subvencionimin e faturave të energjisë elektrike deri në fund të muajit Prill 2012. Pas kësaj date për të gjithë konsumatorët që gëzojnë statusin e invalidit paraplegjik e tetraplegjik, si dhe të verbërit është proceduar për pagesën e plotë të faturave të energjisë elektrike sipas përcaktimeve të parashikuara në VKM-në Nr. 404 datë 20.06.2012, “Për përcaktimin e masës së kriterëve e të procedurave të përfitimit të kompensimit financiar, për personat me statusin e të verbrit dhe invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik, për faturën e energjisë elektrike dhe faturën e telefonisë fikse”.

Në VKM-në më sipër citohet se:

1. Individëve përfitues të statusit sipas Ligjit Nr.8626, datë 22.06.2000, “Statusi i invalidit, paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar, që kanë nevojë për kujdestar, u jepet kompensim për faturën e energjisë elektrike në masën 2000 lekë në muaj.

2. Individëve përfitues të statusit sipas Ligjit Nr. 8098, datë 28.03.1996, “Për statusin e të verbrit”, të ndryshuar, që kanë nevojë për kujdestarë, u jepet kompensim për faturën e energjisë elektrike, në masën 2000 lekë në muaj.

4. Individëve përfitues të statusit sipas Ligjit Nr. 8626, datë 22.06.2000, “Statusi i invalidit, paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar, dhe individëve përfitues të statusit sipas Ligjit Nr. 8098 datë 28.03.1996, “Për statusin e të verbrit”, të ndryshuar, të cilët nuk kanë nevojë për kujdestar, u jepet kompensim për faturën e energjisë elektrike në masën 1400 lekë në muaj.

6. Masa e Kompensimit llogaritet dhe përfitohet pranë njësisë së qeverisjes vendore ku individi i verbër, paraplegjik dhe tetraplegjik, ka vendbanimin.....

9. Njësitë e qeverisjes vendore i shpërndajnë pagesat për kompensimin e faturës së energjisë elektrike dhe të faturës së telefonisë fikse nga shërbimet bankare ose “Posta Shqiptare” sh.a.

10. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi për vitin 2012, të përballohen nga fondet e miratuara për ish Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

Për sa më sipër, sipas dispozitave ligjore në fuqi nga ana e Bashkive, duhet të ishin paguar çdo muaj subvencionimet e faturave të energjisë elektrike për personat me aftësi të kufizuar, por kjo e drejtë prej muajsh është mohuar për shkak të mungesës së fondeve.

Për sa më sipër, referuar nenit 59 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë në pikën “f” të tij parashikohet se: “Shteti, brenda kompetencave kushtetuese dhe mjeteve që disponon, si dhe në plotësim të nismës dhe të përgjegjësisë private, synon: f) riaftësimin shëndetësor, edukimin e specializuar dhe integrimin në shoqëri të të paaftëve, si dhe përmirësimin në vazhdimësi të kushteve të tyre të jetesës”.

Gjithashtu, edhe sipas Ligjit Nr.108/2012, datë 03.12.2012, *“Për ratifikimin e Konventës së OKB-së për të drejtat e personave me aftësi të kufizuar”*, në pikën 2 të nenit 4, ku parashikohen detyrimet e përgjithshme të shteteve, citohet se: *“Lidhur me të drejtat ekonomike, shoqërore dhe kulturore, çdo shtet palë merr përsipër të ndërmarrë të gjitha masat në masën maksimale të burimeve ekzistuese dhe kur është e nevojshme, në kuadrin e bashkëpunimit ndërkombëtar, me synim për të arritur në mënyrë progresive në realizimin e plotë të këtyre të drejtave pa paragjykim ndaj atyre detyrimeve të paraqitura në këtë Konventë, të cilat sipas ligjit ndërkombëtar janë për zbatim të menjëhershëm”*.

Në analizë të dispozitave ligjore të mësipërme, Institucioni i Avokatit të Popullit, ka synuar që jo vetëm të vërë në lëvizje organet kompetente, por dhe t'i sensibilizojë ato për vetë rëndësinë që ka kjo problematike sikundër është subvencionimi dhe pagesa ndaj personave me aftësi të kufizuar për shërbimet publike të ofruara sikundër është edhe energjia elektrike.

Për sa më sipër, kemi kërkuar marrjen e veprimeve konkrete që kanë të bëjnë me lëvrimin e fondeve përkatëse për realizimin e këtij procesi (subvencionimi i faturave të energjisë elektrike) brenda një kohe sa më të shkurtër me qëllim mbrojtjen dhe përfitimet e të gjitha të drejtave të personave me aftësi të kufizuar për një jetesë sa më normale, pa barriera dhe integrim real ekonomiko-social.

7. Fokus tjetër i veprimtarisë së Institucionit të Avokatit të Popullit ka qenë edhe rasti i publikuar mbi kërkesën e Shoqatës së Transportit Urban për rritjen e çmimit të biletës së transportit urban.

Konkretisht, Shoqata e Transportit të Udhëtarëve ka paraqitur një kërkesë pranë Bashkisë Tiranë për rritjen e çmimit të biletës nga 30 në 70 lekë, duke filluar nga muaji Janar 2014.

Në shkresën drejtuar Bashkisë Tiranë, kemi kërkuar që gjatë trajtimit të kërkesës së Shoqatës së Transportit Urban të mbahen parasysh dy kritere të cilat kanë të bëjnë me standardet e ofruara aktualisht nga transporti urban dhe minimumin jetik të qytetarëve në vend.

Në përgjigjen e dërguar nga Bashkia Tiranë janë marrë në konsideratë dy kriteret e mësipërme dhe është gjykuar se kosto e shërbimit të ofruar nuk ka pse të mbulohet vetëm nga operatorët e transportit publik, por duhet që qeverisja vendore të ndërhyjë duke subvencionuar direkt këtë shërbim nëpërmjet granteve të kushtëzuara për qeverisjen vendore, duke kryer subvencionim social për kategorinë që sipas ligjit përfitojnë transport publik falas dhe duke marrë nisma të tjera lehtësuese si ulja e tvsh-së për transportin publik, heqja e akcizës për karburantin.

Konkluzione

Gjatë përmirësimit të interesave të ligjshme të konsumatorëve në kushtet edhe të aderimit për në Bashkimin European, në respektim të nenit 76 të Marrëveshjes së Stabilizim-Associimit, Institucioni i Avokatit të Popullit do të vazhdojë që t'i japë përparësi fushave me rëndësi thelbësore sikundër janë ushqimi, ofrimi i shërbimeve publike me ujë, energji elektrike, etj.

Për këto raste do të synojmë:

- Rekomandime për harmonizimin e legjislacionit të mbrojtjes së konsumatorit me atë ekzistues të Komunitetit.
- Rekomandime për nxitjen e organeve përkatëse për krijimin e një strategjie të re ndërsektoriale për mbrojtjen e konsumatorit dhe mbikëqyrjen e treguar për vitin 2014 e në vijim.
- Rekomandime lidhur me cilësinë e produkteve ushqimore, në respektim të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.
- Rekomandime për respektimin e Udhëzuesve të Kombeve të Bashkuara si dhe direktivave të BE-së për mbrojtjen e konsumatorëve dhe veçanërisht ato që lidhen me masat në fushat specifike që ndikojnë drejtpërdrejt dhe kanë rëndësi thelbësore për shëndetin e konsumatorit.

K. E drejta për kujdes shëndetësor

Vështrim i përgjithshëm

Sistemi ynë shëndetësor duhet të reflektojë vlerat shtetërore, profesionale dhe shoqërore si dhe nevojën për cilësi të shërbimeve shëndetësore, të ofrojë vlera në kontekstin e ngritjes e të zhvillimit profesional të të gjithë punonjësve të shëndetësisë në secilin nivel.

Konsideratat e përgjithshme të opinionit publik e shohin sistemin shëndetësor si të korruptuar, joefikas dhe të ulët në cilësi. Në qoftë se ato para të shpenzuara jashtë shtetit apo në spitale dhe klinika private brenda vendit, mund të derdhen në shërbimin shëndetësor publik dhe të përdoren për të përmirësuar sistemin shëndetësor, do të ishte shumë më e dobishme. Shqipëria ndodhet ende larg standardeve të sigurimit të një shërbimi shëndetësor brenda parametrave të fqinjëve tanë, e akoma më larg standardeve të BE-së. Nëse nuk ka një angazhim të mjaftueshëm të fondeve, në paga, investime, mirëmbajtje, etj, dhe menaxhim efektiv dhe eficient të burimeve në dispozicion, shifrat do vazhdojnë ta rendisin Shqipërinë si një ndër vendet që nuk investon mjaftueshëm në cilësinë e jetës që iu ofron qytetarëve të saj.

Avokati i Popullit beson se humanizmi i institucioneve shtetërore dhe përgjegjshmëria e tyre ndaj respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të individëve janë gurët e themelit për një shërbim publik të suksesshëm shëndetësor. Idetë për zgjidhjen e shumë mangësive në këtë shërbim kanë mbetur thjesht dhe vetëm në fazën e hartimit të programeve dhe strategjive përkatëse. Veprimtarinë në këtë fushë të të drejtave të njeriut, Avokati i Popullit e ka ushtruar me qëllim trajtimin me dinjitet të pacientit, mbrojtjen dhe garantimin e jetës, bazuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe legjislacionin në fuqi, duke u fokusuar në vijimësinë e inspektimeve në Spitalet Rajonale në Shqipëri, si edhe në raste me iniciativën tonë në këtë fushë. Problematika të çështjeve dhe ankesave që kanë të bëjnë me Ministrinë e Shëndetësisë dhe institucionet në varësi të saj, kanë qenë kërkesa ndaj kësaj Ministrie për tu kuruar jashtë shtetit, mungesa e medikamenteve në spitale, neglizhenca në dhënien e shërbimit shëndetësor, marrëdhëniet e punës etj.

Konkretisht për vitin 2013 ka pasur në total 75 ankesa, 10 raste me iniciativë, ose 7 inspektime në fushën e shëndetësisë. Rezultojnë të përfunduara 61 ankesa, në proces shqyrtimi 14, 28 të pabazuara, 3 jashtë kompetencës, 17 zgjidhur në favor të ankuesit, 5 heqje dorë, 4 rekomandime të pranuar dhe 4 rekomandim të refuzuara nga organet e administratës publike.

Analizë e rasteve konkrete

❖ Inspektim në Repartin e Kirurgjisë Digjестive në QSU-Tiranë nr. doculive 201200222

Konkretisht nga inspektimet në fjalë janë konstatuar ndër të tjera edhe problematika të cilat fatkeqësisht vijnë të mbeten të njëjta vit pas viti.

Në dhomat e pacientëve dhe në dhomën e infermierëve konstatohet lagështirë e theksuar, ndërkohë që pothuaj të gjitha Ë.C.-të e pavionit (në dhomat e pacientëve), rezultojnë me paisje hidrosanitare të prishura. Si rezultat, gjendja në këtë aspekt

do të konsiderohej fare mirë skandaloze edhe në kushte jo spitalore. Furnizimi me medikamente rezultonte problematik, së pari në vazhdueshmërinë e furnizimit me to, ndërkohë që pacientët e shtruar, janë të detyruar të blejnë në subjekte private pothuajse çdo medikament të nevojshëm për trajtimin e tyre. Problematikë tjetër e vërejtur konsistonte në cilësinë e ilaçeve të administruara, që për shkak dhe të politikave të aplikuara në referencë të legjislacionit aktual mbi prokurimet publike, sipas të cilave çmimi më i ulët i ofruar nga pjesëmarrësit në procedurat tenderuese është determinues, janë më të lirat (më pak cilësoret) në treg. Higjena e ambienteve të brendshme të pavionit, megjithë punën e stafit linte për të dëshiruar, kjo për shkak të ambienteve të amortizuara, si dhe moskryerjes së punimeve restauruese për një kohë të gjatë. Gjithashtu, mungesë e furnizimit apo cilësisë së ulët konstatohej dhe në drejtim të detergjentëve për të larë ambientet, ndërsa sapunët gjithmonë për shkak të çmimit më të ulët të ofruar për blerjen e tyre, paraqiten të një cilësie që rëndom shkakton deri dhe mospërdorimin e tyre. Furnizimi i pavionit me pajisje hotelerie ishte i zgjidhur mjaft mirë nëpërmjet kontraktimit të një firme private, e cila kryente në kohë furnizimin me çarçafë, peshqirë dhe batanije. Edhe furnizimi me ushqim ishte zgjidhur në mënyrë të pëlqyeshme përmes tenderimit dhe kryerjes së këtij shërbimi nga një firmë private. Nga komunikimi me stafin e pavionit, problematika e parashtruar kishte të bënte me përmirësimin e kushteve të punës, e që ka të bëjë me arredimin e dhomave të mjekëve dhe të infermierëve, pasi aktualisht orenditë e këtyre ambienteve paraqiten mjaft të amortizuara. Gjithashtu nga stafi i këtij pavioni na u bë me dije se ishte kërkuar nga strukturat drejtuese, transferimi në spitalin e ri të ndërtuar së fundi. (konkretisht e planifikuar për transferim në 2 katet e fundit të spitalit të ri), por ende pa zgjidhje. Sa i përket trajtimit mjekësor, nuk kishte ankesa ku megjithë kushtet e vështira të ambienteve **të punës, përkushtimi i tyre ndaj pacientëve ishte maksimal. Kjo gjë** u pohua nga shumë familjarë të pranishëm në momentin e inspektimit në fjalë.

Pas rikonstatimeve të bëra nga ana jonë është rekomanduar:

- *Marrja e masave për sigurimin e fondeve për transferimin e shërbimit të pavionit të kirurgjisë në godinën e spitalit të ri, ku ndodhet dhe urgjenca e këtij shërbimi.*

Ministria e Shëndetësisë në përgjigjen e saj ndër të tjera thekson angazhimin për sigurimin e një kredie të butë për infrastrukturën fizike dhe teknologji bashkohore mjekësore për këtë shërbim si një prioritet për Ministrinë e Shëndetësisë.

❖ **Inspektim në Spitalin Onkologjik, Tiranë me nr.doculive 201300953**

Me keqardhje na rezulton se edhe në vitin 2013 situata në Spitalin Onkologjik, Tiranë vazhdon problematike si në vitin 2011, inspektuar nga ana jonë. Ky është një spital shumë i rëndësishëm në shërbimit spitalor Kombëtar. Konkretisht nga informacioni i marrë nga Z.Agim Sallaku, shef i shërbimit të spitalit onkologjik na u bë me dije se, buxheti për medikamentin “citostatikë” është ulur nga viti në vit. Në vitin 2009 ka qenë 5.6 milion dollarë dhe më pas ulja ka qenë e ndjeshme, ku së fundmi është ulur në 2.7 milion dollarë. Ky buxhet nuk i përmbush nevojat, pasi fluksi i pacientëve në 20 vitet e fundit është rritur

mbi 2 herë, dhe si rrjedhojë nevoja për trajtimin me citostatikë është në rritje. Gjithashtu vlen të përmendet se 20-30 % e pacientëve janë shtetas kosovarë të cilët paraqiten për ekzaminime dhe vizita pranë këtij spitali. Situata aktuale vinte edhe si pasojë e moszhvillimit ende të procedurave të tenderimit për vitin 2013, nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë. Emergjenca e zgjidhjes së këtij problemi bëhet edhe më imediate veç të tjerash, edhe për faktin se çmimi i citostatikëve është i lartë dhe jo të gjithë pacientët kanë mundësi ta blejnë atë në farmacitë private. Pas konstatimit të kësaj situatë u rekomandua:

- *Marrja e masave të nevojshme për plotësimin e nevojave sipas kërkesave për medikamentin "Citostatikë" në spitalin onkologjik në QSUT, Tiranë.*

Ministria e Shëndetësisë në përgjigjen e saj ndër të tjera citon se për vitin 2014 janë marrë masat për sigurimin e medikamentit citostatik në vlerën 750 milion lekë nga 340 milion që ka qënë në 2013.

❖ **Inspektim në Spitalin Rajonal Tropojë dhe Kukës nr doculive 201301383/84**

Problematikë kryesore dhe shumë e rëndësishme për spitalin e Tropojës ishte mungesa e personelit mjekësor, specialist si: Reanimator, Pediatër, Kardiolog, Patolog i përgjithshëm. Pra nga 12 mjekë që janë në organikë, efektive janë vetëm 5 prej tyre. Një problem tjetër ishte edhe mungesa e fondit për rregullimin e ashensorit të spitalit i nevojshëm dhe domosdoshëm për transportin e pacientëve.

Për Spitalin e Kukësit është hartuar masterplani për rikonstrukcionin e godinës, por ende nuk janë lëvruar fondet nga Ministria e Shëndetësisë. Sistemi i ngrohjes në periudhën e verës nuk ekziston në asnjë repart. Gjithashtu mungon sistemi i ashensorëve për transportin e pacientëve nga njëri kat në tjetrin. Një shqetësim tjetër i paraqitur nga stafi është përballja me sjellje agresive nga të afërmit e pacientëve, në raste të veçanta i personelit të urgjencës, të cilëve shumë herë ju rrezikohet edhe jeta. Pas konstatimit të kësaj situatë u rekomandua:

- *Marrja e masave të nevojshme për plotësimin e nevojave sipas kërkesave për të gjitha problematikat e konstatuara nga ana e institucionit tonë, në Spitalet e Tropojës dhe Kukësit.*

Ministria e Shëndetësisë në përgjigjen e saj citon se në kuadër të reformës në sistemin shëndetësor, Ministria e Shëndetësisë e ka përqendruar punën e saj në drejtim të përmirësimit të infrastrukturës fizike, teknologjisë mjekësore, forcimit të kapaciteteve të burimeve njerëzore si dhe përmirësimit të kuadrit rregullator në Spitalet rajonale Tropojë dhe Kukës.

❖ **Inspektim në Spitalin Rajonal Korçë, nr doculive 201302043**

Një problem shqetësues ishte mungesa në institucion e mjekëve specialistë si neurologë, kirurgë, reumatologë, pediatër, nefrologë, toksikologë etj. Edhe mungesa e aparaturave mjekësore detyron pacientët të kërkojnë zgjidhje tek privatët apo t'i drejtohen QSUT-së, Tiranë. Nevojë për rikonstrukcion kishte pjesa e maternitetit, e cila linte për të dëshiruar në mure apo pamje të përgjithshme. Pas inspektimit ne rekomanduam:

- *Marrjen e masave për plotësimin e nevojave me mjekë specialistë në Spitalin Rajonal Korçë si dhe akordimin e fondeve për rikonstruksionin e maternitetit në këtë spital.*

Ministria e Shëndetësisë në përgjigjen e saj ndër të tjera citon se angazhohet për përmirësimin e infrastrukturës fizike, teknologjisë mjekësore dhe forcimin e kapaciteteve të burimeve njerëzore në Spitalin Rajonal Korçë.

❖ **Inspektim në Spitalin Rajonal Përmet nr. doculive 201302088**

Gjatë këtij inspektimi u konstatuan problematika të shumta dhe konkretisht: ushqimi ishte në nivele të pakënaqshme; sistemi i ngrohjes dhe ai i ftohjes qendror nuk ekzistonte dhe ngrohja realizohej nëpërmjet kaloriferëve që siguroheshin nga vetë të sëmuret. Stafit mjekësor ishte shumë i pakët në numër dhe infermierët e këtij spitali janë të pakualifikuar për punën që kryejnë. Kushte jo të mira higjieno-sanitare të dhomave, tualeteve dhe korridoreve të tij. Gjithashtu edhe furnizimi me artikuj hotelerikë nuk plotësonte nevojat e pacientëve dhe stafit mjekësor, shumë medikamente sigurohen nga vetë pacientët; djegia e mbeturinave spitalore nuk realizohej me anë të autoklavave, sepse ky spital asnjëherë nuk i ka pasur në gjendje pune, por ato mblidhen nga Bashkia e Përmetit dhe asgjësohen. Një problem shumë shqetësues ishte mungesa në institucion e mjekëve specialistë si radiolog, kirurgë, neurolog, pediatër, gjinekolog, etj. Mungesa e aparaturave mjekësore si radioskopia, detyronte pacientët të kërkojnë zgjidhje tek specialistët privatë apo t'i drejtohen QSUT-së, Tiranë. Godina e Spitalit Rajonal të Përmetit ka nevojë për rikonstruksion, dhe pse janë bërë disa riparime kishte pjesë të cilat linin për të dëshiruar, si muret apo pamja e përgjithshme e spitalit. Problemi që ishte shqetësim në këtë spital, bazuar dhe në VKM nr.798, datë 29.09.2010 "Për miratimin e rregullores për administrimin e mbetjeve spitalore", ishte se mbetjet spitalore vazhdojnë të trajtohen duke i hedhur nëpër vende të ndryshme, dhe jo të digjeshin në Krematorium, siç edhe duhet të ndodhë realisht. Pas këtyre konstatimeve rekomanduam:

- *Marrjen e masave për zgjidhjen e problematikave të konstatuara për plotësimin e standardeve në shërbimin spitalor në funksion të pacientit në Spitalin Rajonal Përmet".*

Ministria e Shëndetësisë në përgjigjen e saj ndër të tjera citon se kanë filluar të merren të gjitha masat lidhur me problematiken e krijuar në Spitalin Rajonal Përmet.

❖ **Inspektim në Spitalin Rajonal Peshkopi dhe Bulqizë nr doculive 201203884**

Gjatë këtij inspektimi u konstatuan problematika si: Sistemi i ngrohjes së ambienteve spitalore realizohet me ngrohje qendrore dhe rezulton të jetë një sistem funksional. Furnizimi me medikamente rezulton përgjithësisht i mirë, veçanërisht për pjesën e urgjencës, që sipas drejtuesve të spitalit është edhe shërbimi kryesor në spital. Problematik mbetet realizimi i procesit të prokurimit për blerjen e medikamenteve prej Spitalit Rajonal të Peshkopisë, proces i cili në rast të vonesave, pezullimit, apo të anulimit, ndikon në furnizimin në kohë me medikamente të Spitalit të Rrethit Bulqizë. Një problematikë tjetër e vërejtur ka të bëjë me mungesën e stafit profesional mjekësor, si, mjekë reanimator-anestezist, kirurgë, apo edhe mjekë gjinekologë. Sa i përket trajtimit mjekësor, nuk kishte

ankesa. Kjo gjë u pohua nga pacientë dhe familjarë të tyre, të pranishëm në momentin e inspektimit në fjalë. Përpos këtyre konstatimeve të bëra në kohën e inspektimit, theksojmë se, veçanërisht mungesa e stafit profesional mjekësor është një problem serioz i ngritur edhe në ankesa të tjera të subjekteve sindikaliste që, janë organizuar në industrinë e nxjerrjes së mineraleve në zonën e Bulqizës, apo edhe në emisione, apo rubrika të ndryshme televizive ku është pasqyruar gjendja e shërbimit mjekësor në Spitalin e Bulqizës.

Sipas drejtuesve të këtij institucioni mjekësor, kjo mungesë stafi e ka kthyer realisht spitalin e Bulqizës më tepër në një pikë urgjence se sa në një spital i cili, duhet të ofrojë të gjitha shërbimet spitalore, pasi në këto kushte nuk mund të kryhen ndërhyrje kirurgjikale. Pra në shumë raste, ndërhyrjet e nevojshme kirurgjikale përcillen për ndjekje në Spitalin Rajonal të Peshkopisë, i cili ndodhet rreth një orë larg spitalit të rrethit Bulqizë dhe në rrethanat kur rruga automobilistike që duhet përshtuar deri në këtë destinacion është në gjendje të keqe. Emergjencia e zgjidhjes së këtij problemi bëhet edhe më imediate veç të tjerash edhe për faktin se, veprimtaria e minatorëve në galeritë e minierës së kromit në Bulqizë është një veprimtari me rrezikshmëri të shtuar, gjë që vërtetohet nga aksidentet e shpeshta që kanë ndodhur dhe ndodhin gjatë procesit të punës në këtë minierë. Pas këtyre konstatimeve u rekomandua:

- *Marrja e masave të nevojshme për plotësimin e numrit të stafit profesional mjekësor, me mjekë specialistë si, mjekë reanimator-anestezist, kirurgë, apo edhe mjekë gjinekologë. Gjithashtu, kërkohet të merren masa edhe në lidhje me furnizimin në kohë me medikamente mjekësore, duke zgjidhur me efektshmëri çështjet e vonesave, që shkaktohen për shkak të ecurisë së proceseve të tenderimit prej Spitalit Rajonal të Peshkopisë.*

Ministria e Shëndetësisë ka kthyer përgjigje duke u angazhuar që problematikat e konstatuara do mbahen në konsideratë për zgjidhje në të ardhmen.

❖ Inspektim në Spitalin Rajonal Shkodër, nr. doculive 201300837

Duke mos dashur të bëjmë historikun e Spitalit Rajonal Civil të Shkodrës detyrohemi të sqarojmë se aktiviteti kirurgjikal i këtij spitali vjen pas Tiranës, pasi trajtohen raste shumë të rënda shëndetësore si për pacientët që vuajnë nga sëmundjet e veshkave, pra ata që trajtohen me dializë, pacientët që vuajnë nga sëmundjet e zemrës, si dhe për ata të sëmurë që vuajnë nga sëmundje tumoriale, por trajtimi me fonde që bëhet për spitalin e Shkodrës është minimal dhe patjetër këto mungesa të theksuara fondesh sjellin dhe një cilësi të dobët të shërbimit spitalor, duke i dërguar pacientët të blejnë vetë medikamentet që u nevojiten. Një problem tjetër shqetësues është se nuk është llogaritur asnjëherë kostoja e një operacioni të një patienti dhe në bazë të kësaj të dërgohet një draft vjetor nga Ministria e Shëndetësisë lidhur me përllogaritjen e fondeve.

Problemi i tretë që ishte shqetësim në këtë spital, bazuar dhe në VKM nr. 798, datë 29.09.2010 "Për miratimin e rregullores për administrimin e mbetjeve spitalore" ishte se mbetjet spitalore vazhdojnë të trajtohen duke i hedhur nëpër vende të ndryshme dhe jo të digjeshin në Krematorium. Aparaturat për djegien e mbetjeve spitalore ende nuk janë vendosur në punë.

Problemi i katërt është se në sallën e operacionit të repartit të Kirurgjisë nuk ka sistem ventilimi të ajrit apo sistem ftohje për periudhën e stinës së verës. Po ashtu edhe në disa

reparte të tjera si ai Pediatri dhe Patologjisë mungon ky shërbim. Problemi i pestë ishte cilësia e ushqimit në këtë spital, nuk përdorej nga pacientët dhe ushqimi sigurohej vetë nga të sëmurët. Pas këtyre konstatimeve u rekomandua:

- *Marrja e masave për zgjidhjen e problematikave të konstatuara për plotësimin e standardeve në shërbimin spitalor*”.

Ministria e Shëndetësisë ndër të tjera thekson se mbas rekomandimit bërë nga ana jonë kanë filluar të merren të gjitha masat për zbatimin e tyre.

❖ Rast me iniciativë nr doculive 201301339

Institucioni i Avokatit të Popullit filloi hetimin administrativ për një shkrim në Gazetën Shqiptare, me titull “Mjekja refuzon punën me infermieren me shami...”. Në këtë shkrim bëhej fjalë për një incident ndodhur ndërmjet mjekes endokrinologe F. Gj, me të cilën është caktuar të punojë infermiere I. H. Kjo e fundit është besimtare myslimane dhe mban shami, e për këtë shkak, mjekja i është drejtuar duke i thënë se institucioni është laik dhe se nuk pranohen femrat e mbuluara me shami. Më pas kjo ngjarje ka degjeneruar në konflikt fizik mes drejtorit të spitalit B. S, dhe një të afërmi të mjekes në fjalë, ku palët kanë përfunduar në komisarjat. Institucioni ynë tashmë është investuar lidhur me faktin se një punonjëse e administratës shtetërore, mjekes dhe intelektuale i është drejtuar një besimtareje duke thënë: “Ti je e mbuluar me shami, ky është institucion laik e jo fetar, dhe shteti është laik, ndaj shko e puno në ato institucione ku të lejohet të mbash shami”.

Në morinë e akteve ndërkombëtare, mund të përmendet neni 18 i Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut që përcakton se: “Çdo njeri ka të drejtën e lirisë së mendimit, të ndërgjegjes dhe të fesë, kjo e drejtë nënkupton lirinë për të ndryshuar fenë ose bindjet, vetëm për vetëm apo bashkarisht si në publik ashtu edhe privatisht, nëpërmjet arsimimit, praktikave, kultit dhe kryerjes së riteve”. Në nenin 10/2 të Kushtetutës përcaktohet se “Shteti është asnjans në çështjet e besimit e të ndërgjegjes dhe garanton lirinë e shprehjes së tyre në jetën publike”. Gjithashtu edhe në nenin 24 të Kushtetutës përcaktohet se: “Secili është i lirë të zgjedhë, ose të ndryshojë fenë, ose bindjet, si dhe t’i shfaqë ato individualisht ose kolektivisht, në publik ose në jetën private, nëpërmjet kultit, arsimimit, praktikave ose kryerjes së riteve”, Gjithashtu neni 17/1 i Kushtetutës citon: “Liria e besimit dhe e ndërgjegjes dhe liria e shprehjes së tyre në jetën publike, janë liri individuale të garantuara nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë. Si të tilla, kufizimi i tyre mund të bëhet vetëm me ligj për një interes publik, ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve”. Për më tepër, kufizimi që mund të bëhet në këto raste, nuk mund të çënojë thelbin e lirive dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojë kufizimet e parashikuara në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, parashikon neni 17/2, i Kushtetutës.

Në këto kushte, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut dhe ligjet organike, nuk kufizojnë lirinë e fesë dhe praktikave fetare dhe, si pasojë, nuk mund të diskriminohet një individ vetëm se ai praktikon një besim të caktuar. Natyrshëm lind pyetja se: A mundet që një organ administrativ shtetëror apo punonjës i tij të kufizojë liri të garantuara me Kushtetutë? Sigurisht dhe prerazi “Jo askush”. Liria e shfaqjes së besimit ose të bindjeve nuk mund të bëhet objekt i kufizimeve të tjera, veç

atyre që parashikohen me ligj dhe që janë të domosdoshme në një shoqëri demokratike, për interesa të sigurimit publik, të ruajtjes së rendit, të shëndetit dhe të moralit publik ose të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të tjerëve. Nga ana tjetër detyrimisht në këtë çështje duhet të mbajmë parasysh parimin e përgjithshëm të së drejtës se ajo që nuk pengohet shprehimisht me ligj, lejohet. Në këtë rast veshja dhe mbulimi i kësaj besimtareje, nuk mund të konsiderohet në kundërshtim me normat e bashkëjetesës në një institucion publik, dhe paraqitje e tepruar estetike, pasi nuk pengon procesin profesional si dhe nuk cënon aspak bashkëjetesën në komunitet. Pas këtyre konstatimeve u rekomandua:

- *Marrja e masës disiplinore ndaj mjekes endokrinologe të spitalit Burrel zj. F. Gj.*
- *Angazhimi dhe ndërgjegjësimi i të gjitha strukturave shëndetësore, për mospërsëritjen e rasteve të diskriminimit jo vetëm ndërmjet personelit mjekësor, por edhe ndaj pacientëve që këto struktura trajtojnë.*

Ministria e Shëndetësisë në përgjigjen e saj thekson se i është kërkuar Drejtorisë së Shërbimit Spitalor Mat të marrë masat përkatëse për zbatimin e rekomandimit të Avokatit të Popullit.

❖ Rast me inisiativë nr doculive 201302449

Ekspertë të institucionit inspektuan në muajin Tetor, Qendrën Shëndetësore të Specialiteteve Nr.1, Tiranë. Kjo vizitë mori shkas nga ankesa e një pacienteje të moshuar H.S e cila parashtronte kushtet e këqija ku përballëshin prej muajsh pacientët që merrnin shërbim mjekësor në këtë institucion. Monitorimi kishte si objekt inspektimin, vëzhgimin, mbledhjen dhe vlerësimin e opinioneve, veprimeve dhe praktikave të përmbushjes së detyrimeve ligjore nga personeli i këtij institucioni për respektimin e të drejtave të pacientëve. Kjo qendër shëndetësore përbëhej nga një staf prej rreth 44 mjekë specialistë dhe 40 staf mbështetës infermierë. Zona e mbulimit të kësaj qendre kishte rreth 350 mijë banorë, një numër i konsiderueshëm pacientësh të cilët për të paktën një herë në muaj u duhet të përballen me kushtet dhe të marrin shërbimin e specializuar mjekësor në këto ambiente. Zona territoriale përfshin banorët e Qytetit Studenti, Bërzhitës, Shkozës, Krrabës, Petrelës, Dajtit, Baldushkut si dhe QSH nr.1, 2, 10. Furnizimi me artikujt e nevojshëm si medikamente, kite, reagent, filma etj, ishte normal, me një mungesë të vogël prej rreth 2 javësh për shkak të procedurave të tenderimit, dhe mungesës së drejtorit për arsye shëndetësore prej rreth 3 muajsh. Kur e pyetëm drejtorin z. Progrid, se në rolin e tij si drejtues cili është shkaku i ndërprerjes së punimeve, pasi tabela e vendosur jashtë ambienteve tregon për një investim që duhej të ishte kryer që herët në këtë institucion, ai na pohoi se: “Nuk di asgjë, pasi nuk kam qenë as anëtar i komisionit të tenderimit kryer nga ASHR-ja, dhe Ministria e Shëndetësisë, si dhe nuk kam parë kontratë apo ndonjë dokument lidhur me këtë investim”. Në dijeninë dhe interesimin e tij prej disa kohësh si në ministri ashtu edhe në autoritetin shëndetësor i është thënë se do transferohen diku, por pa zgjidhje. Së fundmi juristja e ASHR-së i ka pohuar se firma investuese nuk ka leje për rikonstrukcionin e godinës së kësaj qendre shëndetësore.

Nga inspektimi në vend i ambienteve të brendshme dhe të jashtme të kësaj godine, rezultoi se muret e katit të parë janë me shumë lagështirë dhe të mykura; pllakat e korridorit të thyera në shumicën e sipërfaqeve; në dhomat e mjekëve dhe laboratorë lagështira

ishte e përmasave skandaloze. Më keq paraqitej situata në dhomën e dermatologes, ku amortizimi kishte arritur deri në kalbje të dritareve nga lagështira. Tuelalet i katit të parë (i vetmi në godinë), ishte jashtë përdorimit dhe i mbyllur nga personeli. Kati i dytë i godinës lëngonte nga amortizimi i dukshëm në tavan që përkon me tarracën e godinës, dhe ku personeli na informoi se kur ka shira të dendura, uji futet brenda ambienteve. Kjo pasi firma ka kryer disa punime para disa muajsh, duke ndërhyrë në tarracë. Skandaloze paraqitej situata në dhomën nr.24, ku ndodhej paisja më e re dhe më e shtrenjtë, e instaluar e quajtur "Audiogramë". Kjo paisje nuk u ofronte shërbim pacientëve kur binte shi, për shkak se ç'binde jashtë, hynte Brenda e kjo situatë konsiderohet e patolerueshme duke rrezikuar jo vetëm dëmtimin e kësaj paisjeje, por edhe mungesën e ofrimit të shërbimit të pacientëve që kishin nevojë për këtë ekzaminim. Pas këtyre konstatimeve u rekomandua:

- *Marrja e masave të menjëhershme për transferimin Qendrës Shëndetësore të Specialiteteve Nr.1, Tiranë, në një ambient të përshtatshëm për trajtimin e pacientëve, në kushte normale dhe dinjitoze, deri në përfundimin e rikonstruksionit e plotë të saj.*

Ministria e Shëndetësisë në përgjigjen e saj, shpjegon se vonesa në punimet për rikonstruksionin e kësaj Qendre Shëndetësore ka ardhur si rezultat i mosmarrjes së lejes së ndërtimit nga ana e Bashkisë së Tiranës. Por për zgjidhjen e situatës është në proces negociimi për marrjen e një godine me qera deri në rikonstruksionin e plotë të saj.

❖ **Rast me iniciativë nr. doculive 201300719**

Shtetësja F.Q. nga Vlora, shpjegoi se vuan nga një sëmundje e rrallë "distonia segmentare", dhe ka rreth 3 vite që sorollatet për të siguruar medikamentin e rrallë "BUTOKS", por të nevojshëm për kurimin e saj. Ajo është në gjendje të vështirë ekonomike dhe me të ardhurat që disponon, konkretisht me pensionin e invaliditetit, nuk e përballon dot blerjen e këtij medikamenti. Rasti i kësaj qytetareje është bërë publik disa herë në median e shkruar dhe vizive, ku prononcimet nga drejtuesit e lartë të Ministrisë së Shëndetësisë kanë qenë premtuese për zgjidhje, por të parealizueshme.

Neni 55 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë përcakton se: *"Shtetasit gëzojnë në mënyrë të barabartë të drejtën për kujdes shëndetësor nga shteti. Kushdo ka të drejtën për kujdes shëndetësor sipas mënyrës së përcaktuar në ligj"*. Ligji nr.10107, datë 30.3.2009 "Për Kujdesin Shëndetësor në Republikën e Shqipërisë" përcakton se: *"E drejta për kujdes shëndetësor është një e drejtë themelore e individit"*. Siç dihet në vitin 2011 Ministria e Shëndetësisë ka ratifikuar "Kartën e Pacientit", një dokument ndërkombëtar. Kjo "Kartë" i ndihmon pacientët të zotërojnë një dokument me të cilin ata do "të mbrohen, do të kompensohen në rast dëmtimi dhe do të kenë akses në shërbimet shëndetësore". Çdo pacient ka të drejtën për akses në shërbimet shëndetësore sipas nevojës vetjake. Shërbimet shëndetësore duhet të garantojnë akses të barabartë për këdo, pa diskriminim, bazuar në të ardhurat financiare, vendbanimin, llojin e sëmundjes apo kohën e marrjes së shërbimit.

Pas këtyre konstatimeve i rekomanduam Ministrisë së Shëndetësisë:

- *"Marrjen e masave për trajtimin e këtij rasti me prioritet dhe gjetjen e një zgjidhjeje ligjore dhe të shpejtë për shtetasen F. Q"*.

Ministria e Shëndetësisë në përgjigjen e saj, është shprehur se po e ndjek shqetësimin e kësaj shtetaseje duke e përcjellë për kompetencë dhe zgjidhje përfundimtare pranë QSU, Tiranë.

Shënim: Institucioni ynë ka hartuar edhe Draft Raportin për monitorimin dy vjeçar të spitaleve në rang vendi, raport që pas shqyrtimit nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë dhe organizatat jofitimprurëse do i niset për shqyrtim Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

Konkluzione

Nga ankesat e shqyrtuara por edhe nga inspektimet e shumta që ne kemi kryer në institucione ku ofrohet shërbimi shëndetësor arrijmë të evidentojmë këto problematika:

Menaxhimi dhe alokimi i keq i fondeve, keqpërdorim dhe abuzim me to; mungesa persistente e medikamenteve dhe materialeve të tjera mjekuese në spitale; pamundësi për kryerjen e analizave për të sëmurët në institucionet publike për mungesa të kитеve dhe reagentëve; teknologji moderne diagnostikuese e terapeutike e pamjaftueshme në raport me kërkesat dhe nevojat korentë, por edhe mundësitë ekzistuese në vend. Kjo, jo vetëm në spitalet rajonale e periferike, por edhe në ato nacionale qendrore. Edhe atje ku disponohen këto aparatura, për shumë kohë mbeten jashtë funksionimit, sepse mungojnë kontratat e riparimit me kompanitë përkatëse ose janë shkelur ato. Menaxhimi jo i mirë i burimeve njerëzore; mungesa e mjekëve specialistë që largohen apo dalin në pension në një pjesë të konsiderueshme spitalesh në mbarë vendin; nuk ka një studim perspektiv të nevojave për mjekë specialistë, dhe ngritje shërbimesh të specializuara për të rregulluar dhe planifikuar prodhimin e specialistëve në përputhje me këto nevoja. Mungesë e llogaridhënies sipas hallkave të hirearkisë.

L. Synimi për një mjedis të shëndetshëm

Vështrim i përgjithshëm

Një ndër prioritetet e punës së Institucionit të Avokatit të Popullit gjatë vitit 2013 ka qenë edhe synimi për një mjedis të shëndetshëm. Problematikat e ankesave dhe kërkesave të shqyrtuara gjatë vitit 2013 kanë qenë kryesisht të fokusuara shmangien e ndotjeve të ambientit nga agjentë të ndryshëm apo aktivitete të paligjshme e të paliçensuara, vendosjen e antenave celulare dhe rreziku që u kanoset qytetarëve nga valët që ato transmetojnë, ndotjen e ajrit nga djegiet e lëndëve të rrezikshme, hedhjen e mbeturinave në vende publike, ndotjet akustike, të cilat në tërësinë e tyre dëmtojnë cilësinë e shëndetit dhe jetës së banorëve që jetojnë në zona të prekura nga këto ndotje. Ky është i njëjti objekt i ankesave të trajtuara edhe më përpara nga ana jonë.

Gjatë vitit 2012 janë regjistruar 23 ankesa në të cilat individë të ndryshëm kanë kërkuar ndërhyrjen e Avokatit të Popullit për zbatimin korrekt të dispozitave ligjore nga organet e administratës publike për të pasur një ambient të pastër dhe mjedis të shëndetshëm, duke përmirësuar në këtë mënyrë edhe cilësinë e tyre të jetesës.

Institucioni i Avokatit të Popullit ka ushtruar kompetencën e tij për të ndjekur me iniciativë çështje të ndryshme me impakt mjedisor. Në këtë kuadër, gjatë vitit 2013 ka filluar shqyrtimi me iniciativë i 8 çështjeve, të cilat paraqisnin një rëndësi të veçantë për një komunitet të gjerë banorësh në një zonë të caktuar.

Nga ankesat e shqyrtuara gjatë vitit 2013, 7 raste janë zgjidhur në favor, 2 kanë qenë në kompetencë të organeve të tjera të administratës publike për t'u ndjekur në vijim nga ana e tyre, ndër të cilat bën pjesë edhe ankesa e parashtruar nga Instituti i Çështjeve Kombëtare për anulimin e lejes për ndërtimin e Xhamisë së Namazgjasë, duke qenë se ndërkohë kishte filluar edhe shqyrtimi gjyqësor me këtë objekt të parashtruar edhe pranë institucionit të Avokatit të Popullit.

Lidhur me çështjet e trajtuara, janë dërguar 3 Rekomandime organeve respektive me qëllim që të merrnin masat e parashikuara në dispozitat ligjore për të siguruar dhe garantuar një mjedis sa më të shëndetshëm jo vetëm për ankuesit që kishin parashtruar pretendimet e tyre pranë Avokatit të Popullit, por edhe për komunitetin e zonës të prekur nga shqetësimet mjedisore. Ndërkohë që 12 ankesa kanë kaluar për shqyrtim në vitin 2014.

Problematika e mjedisit në Shqipëri

Ndotja e ajrit është një nga problemet kryesore mjedisore në qytete e mëdha shqiptare, sidomos në Tiranë. Ndotja ka ardhur si pasojë e shtimit të makinave dhe pakësimit të gjelbërimit urban.

Ndotja e ujërave në Shqipëri vjen si pasojë e hedhjeve të mbeturinave në lumenj e liqene, si dhe derdhjes së ujërave të zeza të papërpunuara.

Mbledhja e mbeturinave në Shqipëri dhe riciklimi i tyre bëhet në nivele primitive. Mbeturinat pothuajse nuk mblidhen fare nëpër fshatra.

Prerjet e pyjeve dhe zjarret janë shkaqet kryesore për shpyllëzimin dhe zhdukjen e pyjeve në Shqipëri.

Ndryshimet klimatike kanë prekur në mënyrë të konsiderueshme dhe Shqipërinë. Rritja e nivelit të detit ka çuar në zhdukjen e disa metrave tokë në bregdet në vit. Gjithashtu, zjarret janë bërë më të shumta në numër për shkak të temperaturave të larta në verë.

Analizë e rasteve konkrete

Ndërgjegjësimi i individëve për të kërkuar mbështetjen dhe reagimin e institucioneve shtetërore për mbrojtjen e mjedisit është gjithnjë e në rritje. Përveç reagimit të institucionit të Avokatit të Popullit për të ndjekur çështje me iniciativë, ka pasur reagime të fuqishme edhe nga grupe apo kategori të caktuara të popullsisë për të sensibilizuar organet shtetërore për një informim të publikut, si dhe një mbrojtje të mjedisit, si një e ardhme dhe pasuri që u takon brezave të tërë. Një reagim i tillë u vu re edhe gjatë protestave të Aleancës kundër Importit të Armëve Kimike, të cilat u ndoqën nga afër nga institucioni i Avokatit të Popullit.

Në krahasim me vitin 2012, gjatë vitit 2013 ka pasur një rritje të numrit të rasteve të shqyrtuara, duke dëshmuar rëndësinë gjithnjë e në rritje që paraqet kjo çështje për institucionin e Avokatit të Popullit dhe qytetarët me ndjeshmëri në mbrojtjen e mjedisit që i rrethon.

Lidhur me ankesat e shqyrtuara dhe të zgjidhura në favor të ankuesve mund të përmendim rastin e iniciuar me iniciativë për ndotjet nga ujërat e zeza në fshatin Lin të Pogradecit. Institucioni i Avokatit të Popullit, në funksion të ushtrimit të kompetencave kushtetuese dhe ligjore, për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të shtetasve nga veprimet apo mosveprimet të organeve të administratës publike, duke marrë shkas nga njoftimet në median e shkruar, ndërmori me iniciativë shqyrtimin e çështjes së derdhjes në bregun e Liqenit të mbetjeve të ngurta dhe ujërave të zeza, kryesisht në fshatin Lin, të cilat po shkaktonin dëmtime dhe ndotje të mjedisit përreth, duke ndikuar edhe në turizmin e zonës.

Problematikat që u evidentuan lidheshin kryesisht me derdhjen e ujërave të ndotura të familjeve dhe bizneseve të fshatit Lin në liqenin e Ohrit, derdhja e inerteve dhe mbetjeve të ngurta përgjatë bregut të Liqenit, si dhe mosfunksionimi i kolektorit të ujërave të zeza, si pasojë e të cilit, ujërat e zeza derdheshin në liqen, e në këtë kuadër, implementimi i këtij sistemi do të sillte një impakt pozitiv jo vetëm për ambientin dhe banorët që popullojnë zonën, por edhe për turistët që kërkojnë të kalojnë ditë të bukura e të qeta, në një mjedis të shëndetshëm.

Për sa më sipër, për nevojat e shqyrtimit të mëtejshëm të kësaj çështje, nga ana e Institucionit tonë u kërkuar nga organet e pushtetit lokal, si dhe një sërë agjencish që ushtrojnë funksionet e tyre në fushën e monitorimit dhe mbrojtjes së mjedisit, një informacion sa më i gjerë rreth kësaj problematike, nëse ishin evidentuar subjekte private

apo familjare që shkaktonin ndotje të liqenit, nëse ishin proceduar subjekte të tilla dhe cilat ishin masat konkrete që ishin marrë ndaj tyre, nëse kishte filluar funksionimi i kolektorit të ujërave të zeza, me qëllim që të shmangej derdhja e tyre në liqen, si dhe gjithçka tjetër që kishte të bënte me këtë çështje, me qëllim që të kishim një shqyrtim sa më objektiv dhe brenda afateve të arsyeshme të këtij problemi.

Avokati i Popullit, pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe qëndrimeve që mbajtën organet e administratës publike të përfshirë në këtë procedim, arriti në konkluzionin se nuk kishte nevojë për ndjekje të mëtejshme të këtij rasti nga ana jonë, duke qenë se pati reagime konkrete nga Prefektura e Qarkut. Bashkia Korçë, Drejtoria e Shëndetit Publik dhe Agjencia Rajonale e Mjedisit të Qarkut, të cilat kishin ushtruar kontrole periodike për evidentimin e situatës dhe marrjen e masave konkrete për përmirësimin e saj.

Ndërkohë nga ana e Bashkisë u konfirmua fakti se tashmë në qytet ishte vënë në funksionim të plotë edhe kolektori i qytetit, i cili grumbullon, largon dhe trajton ujërat e zeza të qytetit.

Konkluzione

Avokati i Popullit thekson në vijimësi edhe të raporteve të mëparshme se mbrojtja e ambientit në Shqipëri kërkon një vëmendje të veçantë dhe bashkëveprim të të gjithë individëve dhe strukturave shtetërore, për të synuar një përmirësim të kujdesit për shëndetin dhe rritje të cilësisë së jetës.

Nga ana jonë konstatohen probleme me hedhjen e mbetjeve dhe trajtimin e përpunimin e tyre, apo edhe respektimin e normave të tjera mjedisore, të cilat në këndvështrimin e parë nuk lënë pasoja, por efektet e tyre janë të rrezikshme për shëndetin dhe jetën e qytetarëve.

Për të pasur një kontroll sa më efikas mbi territorin, është mëse e domosdoshme që Inspektoratet e Mjedisit dhe Agjencitë Rajonale të Mjedisit në rang qarku të evidentojnë detyrat dhe përgjegjësitë që u burojnë nga aktet ligjore dhe nënligjore, mbi bazën e të cilave ato ushtrojnë funksionet e veta. Ashtu si edhe në vitet e kaluara, Avokati i Popullit thekson se duhen evidentuar dhe ndëshkuar rastet e hedhjes në vende të hapura dhe djegia e lirë e mbetjeve, trajtimi i mbetjeve të ndërtimit nga krijimi, transportimi e deri tek asgjësimi i tyre, monitorimi dhe kontrolli i nivelit të zhurmave në qendrat urbane dhe turistike, monitorimi dhe marrja e masave për heqjen e mjeteve motorrike, të rimorkiove, si dhe të pjesëve të tyre të këmbimit, të dala jashtë përdorimit, që ndodhen pranë rrugëve kombëtare, si dhe detyra të tjera që burojnë nga larmia e akteve që rregullojnë çështjet mjedisore.

M. Problematikat e pushtetit vendor gjatë ushtrimit të veprimtarisë së organeve të tij

Vështrim i përgjithshëm

Në përmbushje të detyrimeve kushtetuese për mbrojtjen e lirive dhe interesave të ligjshme të individëve, Institucioni i Avokatit të Popullit monitoron edhe veprimtarinë e njësive të qeverisjes vendore, me qëllim që të garantohet mirëqeverisja dhe rritja e cilësisë së shërbimeve ndaj komunitetit.

Në një analizë të përgjithshme, Avokati i Popullit konstaton se legjislacioni aktual që rregullon funksionimin dhe kompetencat e pushtetit vendor është i plotë, por niveli i zbatimit të tij në veprimtarinë ekzekutive paraqitet i dobët, sidomos në komunat e vendit.

Siç është theksuar edhe më përpara në raportet tona, administrata e disa organeve të qeverisjes vendore ka probleme me formulimin e akteve administrative, mungesën e referencave ligjore, mënyrën e procedimit administrativ, mosrespektimin e afateve ligjore, shkeljen e parimeve të tilla si bashkëpunimi i administratës me personat private, përfundimin e procedimit me marrjen e një vendimi, të drejtën për të informuar individët, konflikt të interesave në vendimmarrje, lidhjet gjinore apo farefisnore mes pushtetarëve lokal dhe banorëve, duke sjellë edhe subjektivizëm në vendimmarrje, si edhe në ekzekutim të akteve administrative apo planeve konkrete të njësive të qeverisjes vendore. Të gjitha këto probleme sjellin një nivel të ulët shërbimi të administratës ndaj qytetarit, zvarritje në zgjidhjen e problemeve të banorëve, si dhe mohim të standardeve të një administrate në shërbim të individit.

Analizë e rasteve konkrete

Nga ankesat e paraqitura pranë institucionit të Avokatit të Popullit, konstatohet një shqetësim i individëve lidhur me detyrimin e komunave dhe bashkive për mbrojtjen e mjedisit, funksion i parashikuar në nenin 10, pika 2/ "f", të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", i ndryshuar, për grumbullimin, largimin dhe përpunimin e mbeturinave, si dhe ligji nr. 8934, datë 05.09.2002 "Për mbrojtjen e mjedisit" që disiplinon marrëdhëniet ndërmjet individit, komunitetit dhe mjedisit. Ky shqetësim është konstatuar edhe më përpara në raportet tona vjetore, por me keqardhje vëmë re se nga ana e njësive të qeverisjes vendore nuk po i kushtohet një rëndësi e veçantë zbatimit dhe respektimit rigoroz të kompetencave të tyre në këtë fushë.

Gjithashtu, një shqetësim i madh dhe problematikë serioze që vihet re gjatë shqyrtimit të ankesave që parashtrihen para institucionit të Avokatit të Popullit, është edhe menaxhimi i dobët i territorit në juridiksionin e këtyre njësive të qeverisjes vendore si dhe rritja pa kriter e numrit të ndërtimeve pa leje në mbarë territorin. Ky fenomen u vu re sidomos gjatë periudhës para dhe pas zgjedhjeve parlamentare në Republikën e Shqipërisë.

Nga ankesat e regjistruar pranë institucionit të Avokatit të Popullit, rezultojnë se 7 ankesa kanë qenë ndaj Prefekturave dhe organeve në varësi siç është Komisioni i Verifikimit të Titujve të Pronësisë, 589 ankesa ndaj Bashkive kundrejt 532 ankesave që ishin paraqitur gjatë vitit 2012, 140 ankesa ndaj Komunave kundrejt 125 ankesave që ishin paraqitur në vitin 2012, si dhe 1 ankesë ndaj Qarkut Berat lidhur me largim të padrejtë të ankuesit nga puna.

Duke pasur parasysh numrin e lartë të ankesave që parashtrohen ndaj këtyre organeve të pushtetit vendor, si edhe rritjen e tyre në raport me vitin paraardhës, institucioni i Avokatit të Popullit konstaton në vijimësi se nga ana e drejtuesve të pushtetit vendor, si edhe punonjësve të këtyre njësive të qeverisjes vendore, ka një zbatim të gabuar dhe jo korrekt të dispozitave ligjore që rregullojnë veprimtarinë e tyre.

Ashtu si edhe në vitet e kaluara, mungesa e bashkëpunimit të shumë njësive të qeverisjes vendore me komisionet vendore të vlerësimit të titujve të pronësisë pranë prefektëve të qarqeve, sipas ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 "Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore" mbetet ende një nga shkaqet për zvarritje të procedimeve administrative dhe më pas gjyqësore, pra efektshmëri të ulët të Komisioneve, mandati i të cilëve, në bazë të ligjit nr. 176/2013 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9948, datë 07.07.2008 "Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore", të ndryshuar, duhet të përfundojë tashmë deri më 30 qershor 2016.

E drejta për informim gjatë procedimit administrativ

Në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë parashikohet se: "E drejta e informimit është e garantuar". Kjo e drejtë parashikohet edhe në ligjin nr. 8503, datë 30.06.1999 "Për të drejtën e informimit për dokumenta zyrtare", në nenin 18 të të cilit parashikohet kompetenca e Avokatit të Popullit për zbatimin e këtij ligji, që siguron dhe garanton transparencën e organeve të administratës publike në marrëdhënie me shtetasit. Kodi i Procedurave Administrative e parashikon të drejtën e informimit si një nga parimet bazë të funksionimit të Administratës Publike. (Kjo përbën bazën ligjore dhe është e njëjtë me raportin e kaluar).

Problematika e shqyrtuar nga ana jonë gjatë vitit 2013 është e njëjtë me vitet e kaluara. Nga ankesat që janë shqyrtuar, rezulton se nga ana e administratës vendore nuk respektohet dhe nuk zbatohet e drejta për informim gjatë zhvillimit të një procedimi administrativ, ndaj atyre subjekteve të së drejtës administrative që kanë një interes të drejtpërdrejtë ose të ligjshëm në këtë procedim, apo edhe nga personat që janë të përfshirë në këtë procedim, duke qenë në të njëjtën kohë edhe të prekur nga efektet e ekzekutimit të akteve administrative të pushtetit vendor, për të cilat ato nuk kanë marrë dijeni. Më konkretisht kemi vënë re se palët nuk njoftohen për fillimin apo përfundimin e gjykimit administrativ, thirrjen për marrjen pjesë si palë, kur çënohen interesat e tyre, si dhe ka tejkallim të afateve ligjore për vënien në dispozicion të informacionit apo akteve zyrtare që individët kanë kërkuar, duke respektuar procedurat që aplikojnë këto organe të qeverisjes vendore, por që nuk përmbushin më pas detyrimet e tyre ndaj individëve.

Shkelje e së drejtës për informim gjatë procedimit administrativ nga A.L.U.I.Z.N.I. në Qarqe

Gjatë shqyrtimit të ankesave rezulton se një pjesë e konsiderueshme shtetasish kërkojnë të informohen zyrtarisht, për ecurinë e procedurës së legalizimit të objekteve të ndërtruara prej tyre pa leje ndërtimi. Avokati i Popullit konstaton se ka ende një numër shumë të lartë qytetarësh që kanë aplikuar prej vitesh pranë zyrave të ALUIZNI në qarqe, por kërkesat e tyre për legalizim nuk janë shqyrtuar ende. Në këtë kuadër, ka tashëm nisma për ristrukturim të është konstatuar një fluks i madh kërkesash për informim lidhur me aplikimin e paraqitur nga shtetas pranë A.L.U.I.Z.N.I.-t të qarkut për legalizimin

e ndërtimeve informale, pronë të tyre, për të cilat nuk kanë marrë asnjë përgjigje. Lidhur me këto raste, Avokati i Popullit konstaton se aktualisht është pezulluar procesi i legalizimit, në kuadër të ristrukturimit të zyrave rajonale të ALUIZNI, për të vijra më pas me shqyrtimin e të gjitha kërkesave të parashtruara prej disa vitesh nga qytetarët. Nga të dhënat e fundit, rezulton se nga rreth 293000 aplikime të paraqitura, janë përfunduar vetëm 22000 aplikime, duke lënë pezull një kategori të tërë qytetarësh, të cilët kanë respektuar procedurat administrative dhe kanë deklaruar ndërtimet e tyre, por ende nuk kanë marrë një përgjigje zyrtare mbi aplikimet e tyre.

Avokati i Popullit mirëpret paketën e re ligjore të Ministrisë së Zhvillimit Urban dhe Turizmit, ku do të parashikohen të gjithë hapat dhe procedurat që do të ndiqen në vijim për procesin e legalizimit.

Në këtë kuadër, vlerësojmë nisma të tilla të cilat do të mund të përmbyllin një proces i cili ka filluar prej vitesh dhe qytetarët e shumtë të mund të pajisen me lejet e legalizimit të objekteve të tyre.

Konkretisht për Agjencinë e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave e Ndërtimeve Informale ka pasur 9 ankesa nga rrethe të ndryshme, të cilat kishin të njëjtin objekt : mungesën e informacionit për fazën e trajtimit të vetdeklarimeve dhe zvarritjen disa vjeçare të procesit të legjitimit ose jo të ndërtimeve pa leje; 7 prej të cilave u zgjidhën pas ndërhyrjeve tona pranë Drejtorive Rajonale dhe qytetarët morën të dhënat e duhura, si në rastet e ankuesve Q.D. nga Elbasani, B.Z. nga Lushnja, B.B. nga Saranada, S.S nga Tirana e tjerë.

Veprimtaria e këtij organi lë shumë për të dëshiruar gjatë funksionimit të tij nga vitin 2006. Ka mungesë efektiviteti dhe bashkëpunim me Këshillat e Rregullimit të Territorit, me Këshillat e Qarqeve, me organet e tjera të qeverisjes vendore dhe Zyrat Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

Janë mijëra dosje që presin për trajtim, bazuar në Ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006, i ndryshuar "Për legalizimin, urbanizimin dhe integritin e ndërtimeve pa leje" dhe VKM-së nr. 438, datë 28.06.2006 "Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave dhe dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar objektet në ndërtim qe legalizohen ose jo".

Zgjidhja e vetme mbetet rifillimi i procesit të legalizimeve masive dhe regjistrimi i tyre fillestar brenda mandatit të qeverisë aktuale.

Mosveprim i organit të administratës vendore

Ankesat e paraqitura pranë Avokatit të Popullit për mosveprim të organeve të administratës vendore, i referohen veprimtarive të I.N.U.V.-ve të bashkive/komunave, si dhe Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik Kombëtar.

Pranë institucionit të Avokatit të Popullit gjatë vitit 2013 janë paraqitur 71 ankesa ndaj INUV dhe INUK me objekt mosveprimin e tyre në verifikimin e ndërtimeve të paligjshme, marrjen e masave dhe sanksioneve ligjore ndaj kundravajtësve, si dhe mosekzekutim të vendimeve për prishje.

Funksionimi i deritanishëm i I.N.U.V.-ve në bashki/komuna filloi me hyrjen në fuqi të Ligjit nr. 9780 datë 16.07.2007 “Për inspektimin e Ndërtimit”, i ndryshuar, i cili kaloi kompetencat për kontrollin dhe zbatimin e ligjshmërisë në fushën e ndërtimit nga Policia e Ndërtimit tek I.N.U.V.-të në bashki/komunë.

Kalimi i këtyre kompetencave nga një organ i centralizuar në varësi të pushtetit qendror, në një organ të krijuar e të varur nga pushteti vendor, kishte si qëllim të përgjithshëm respektimin e autonomisë vendore, në funksion të kryerjes së procesit të decentralizimit. Ndërsa në aspektin praktik, ligji pretendohet të realizonte ekzistencën e një institucioni më të ndjeshëm dhe gjithmonë në mbikëqyrje të veprimtarisë së paligjshme në fushën e ndërtimeve, për vetë afërsinë me qytetarët që ka pushteti lokal. Në të vërtetë, tashmë pas gati gjashtë vjetësh nga dalja e këtij ligji, mund të thuhet se qëllimi për të cilin ai u miratua, ka sjellë rezultat vetëm në aspektin e kontrollit, sa i përket zbatimit të ligjshmërisë në fushën e ndërtimit, brenda territorit administrativ të bashkisë/komunës. Ndërsa në aspektin konkret, atë të ndërhyrjes fizike ndaj objekteve të ndërtuara pa leje ose jashtë lejes së ndërtimit, funksionimi i I.N.U. vendore, lë shumë për të dëshiruar.

Shkelja e të drejtës kushtetuese për të gëzuar lirisht pronën, parashikuar në nenet 41 dhe 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nëpërmjet ndërtimit të objekteve pa leje ndërtimi, gati në të gjitha rastet shoqëruar në mosrespektim të distancave urbane ndërmjet objekteve ekzistuese dhe atyre në ndërtim, përbën një shqetësim serioz të cilin Avokati i Popullit nëpërmjet trajtimit të ankesave individuale ka tentuar ta minimizojë sadopak.

Sigurisht që shkelja e kësaj të drejte, e shfaqur në mënyrën e mësipërme, nuk do të ishte e mundur nëse organet shtetërore të ngarkuara për kontrollin e ligjshmërisë në fushën e ndërtimit, do të tregonin efikasitet në zbatimin e ligjit. Pothuajse në të gjitha rastet e paraqitura, ku evidentohet shkeljes e së drejtës për të gëzuar lirisht pronën, e shprehur me mosekzekutim të vendimeve pa leje nga ana e I.N.U.V.-ve në Bashki/Komuna, konstatohet mosrespektimi i afateve ligjore të parashikuara për ekzekutimin e vendimeve të kësaj natyre, parashikuar në Ligjin nr. 9780 datë 16.07.2007 “Për inspektimin e ndërtimit”, neni 13, “*Dhënia e vendimeve administrative dhe afatet*”, paragrafi i tretë, ku përcaktohet se:

“Vendimet e I.N.U. të bashkisë/komunës/qarkut/kombëtar parashikojnë afate për zbatimin e tyre deri në 60 ditë. Përjashtimisht vendimet për prishjen e ndërtimit të kundraligjshëm kanë afat deri në 30 ditë”.

Pra ligji parashikon një afat 30 ditor për ekzekutimin e vendimit për prishje, e për raste të veçanta deri në 60 ditë, e që do të thotë se janë afate të panegociueshme, pra të detyrueshme për tu respektuar.

- *Problematikat e Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik Vendor*

Përgjithësisht, ankesat që paraqiten pranë Avokatit të Popullit nga shtetas të ndryshëm kanë të bëjnë me mosveprimin ndaj ndërtimeve pa lejen përkatëse nga autoriteti përgjegjës i planifikimit, siç dhe parashikohet nga Ligji nr. 10119, datë 23.04.2009, i ndryshuar, “Për planifikimin e territorit”, nga I.N.U.V. brenda afateve ligjore. Në praktikën e punës, kryesisht në I.N.U.V. të qyteteve të mëdha, vihet re

se inspektoratet funksionojnë deri në momentin e konstatimit të kundravajtes, marrjen e vendimit për dënim me gjobë apo pezullim të punimeve, duke moskryer më asnjë veprim administrativ sa i përket ndërtimit të paligjshëm, në kundërshtim me parashkrimin e nenit 83, “*Ekzekutimi i vendimeve*”, pika 6, të ligjit të sipërpërmendur, në të cilën është përcaktuar qartë se:

“Për punimet e kryera pa leje ose në shkelje të kushteve të lejes, sipas këtij ligji, autoritetet e inspektimit, krahas dënimit për kundërvajtjet e konstatuara, sipas nenit 82 të këtij ligji, i kërkojnë kundërvajtësit të paraqesë pranë autoritetit përgjegjës të planifikimit, sipas seksioneve III, IV e V të këtij kreu, një kërkesë për pajisjen me leje të punimeve të paligjshme ose të kryera në shkelje të kushteve të lejes fillestare”.

Kjo praktikë abuzive që ndjekin një numër I.N.U.V të bashkive të mëdha, ka sjell dhe ekzistencën e një gjendjeje paligjshmërie, pasi e tillë justifikohet nga mosstandartizimi apo harmonizimi i dy ligjeve që rregullojnë veprimtarinë në fushën e ndërtimit. Konkretisht, në germën “d”, nenit 5, të Ligjit nr. 9780 dt. 16.07.2007 “*Për inspektimin e ndërtimit*”, parashikohet shprehimisht “*vendos prishjen e ndërtimit të kundërligjshëm*”, ndërkohë që sipas përcaktimeve ligjore të Ligjit 10119 dt. 23.04.2009, “*Për planifikimin e Territorit*”, i ndryshuar, Seksioni VII, “*Vëzhgimi, Inspektimi, Kundërvajtjet e Dënimet*”, neni 82, “*Kundërvajtjet administrative*”, pika 8, “*Kryerja e punimeve pa leje*”, në asnjë rast I.N.U.Vendor apo I.N.U.Kombëtar nuk ka tagër të marrë vendime për prishje, por vetëm dënim me gjobë, sipas përcaktimeve apo llogaritjeve me bazë koston mesatare të ndërtimit.

Një problematikë tjetër e hasur gjatë shqyrtimit të shumë ankesave nga Avokati i Popullit, nëpërmjet përgjigjeve zyrtare të I.N.U.V. në Bashki të ndryshme të vendit, ka rezultuar mundësia për të shmangur sanksionimin e objekteve të ndërtuara pa leje ndërtimi, tashmë të përfunduara.

Konkretisht, në paragrafin e parë të nenit 12, të Ligjit 9780 dt. 16.07.2007, “*Për inspektimin e Ndërtimit*”, përcaktohet se:

*“Për ushtrimin e përgjegjësive dhe detyrave të parashikuara në këtë ligj, kryeinspektorët/inspektorët kanë të drejtë të hyjnë dhe të ushtrojnë kontroll në mjediset **ku kryhet ndërtimi**”, ndërsa në paragrafin e fundit të këtij neni ndër të tjera përcaktohet :“Nëse identiteti dhe adresa e subjektit të kontrolluar nuk dihen, një kopje e procesverbalit të konstatimit afishohet për 10 ditë në vendpublikimet e bashkisë/komunës/qarkut përkatës dhe në **kantierin e ndërtimit.....**”*

Gjithashtu në ndryshimet e fundit të Ligjit nr. 9780 dt. 16.07.2007 “*Për inspektimin e ndërtimit*”, me anë të Ligjit nr. 10240 dt.25.02.2010, “*Për disa shtesa në Ligjin nr. 9780 dt. 16.07.2007, “Për inspektimin e ndërtimit*”, sipas të cilave mundësohet ndërhyrja e I.N.U.K. në territorin e administruar nga bashkitë/komunat, në nenin 1, pika 2, përcaktohet: “*Ushtrimi i përgjegjësive, sipas pikës 1 të këtij neni, kryhet vetëm kur në **kantierin**, objekt inspektimi, nuk ka filluar apo nuk është në proces një inspektim nga inspektorati vendor*”

Siç konstatohet nga përmbajtja e të dy dispozitave ligjore, në rastin e ushtrimit të kontroleve për zbatimin e ligjshmërisë në fushën e ndërtimit apo urbanistikës, ligji i jep diskrecion organit të inspektoriatit ndërtimor e urbanistik, që të veprojë vetëm në rastet kur punimet për ndërtimin e objektit eventualisht pa leje ndërtimi janë në vijim, ndërkohë që nga praktika e ardhur për shqyrtim, konstatohet se të tilla janë të përfunduara ose në fazën e fundit të ndërtimit.

- *Analizë e rasteve konkrete lidhur me veprimtarinë e Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik Vendor*

Ankesa me **nr.doculive 201300235**, është dërguar nga shtetasi A.A., me banim në Ballsh, me të cilën është ankuar në cilësinë e përfaqësuesit të banorëve të pallatit nr.46, në Lagjen "5 Shkurti", lidhur me mosveprimin e I.N.U.V Bashkia Ballsh ndaj shkeljes së kondicioneve urbanistike të konstruksionit mbajtës të objektit ekzistues, nga fqinji i tij. Institucioni i Avokatit të Popullit, referuar pikës 3, neni 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 21/b të Ligjit nr.8454, datë 04/02/1999, "Për Avokatin e Popullit", të nenit 3 të Ligjit nr.9780, "Për inspektimin e ndërtimit", si dhe duke pasur në vëmendje se rasti në fjalë kishte të bënte me një ankesë të shqyrtuar dhe më parë, por problematika e parashtruar nga ankuesi nuk ishte ezauruar ende plotësisht, ka Rekomanduar:

-Rifillimin dhe përfundimin e procedimit administrativ, referuar Ligjit nr. 9780 datë 16.07.2007 "Për Inspektimin e Ndërtimit", i ndryshuar, lidhur me ndërhyrje në strukturën mbajtëse të objektit ekzistues, kati i parë i një pallati në lagjen "5 Shkurti".

-Ringritjen e një grupi verifikues me specialistë të fushës në varësinë e Bashkisë Ballsh, lidhur me verifikimin e plasaritjeve në apartamentin e ankuesit, në ambiente të përbashkëta të godinës, apo apartamenteve të tjera në këtë pallat.

-Verifikimin, e më pas nëse i tillë rezulton i bazuar, sa i përket pretendimit të paraqitur, lidhur me dëmtim të strukturës mbajtëse të pallatit nga punimet për përshtatjen e ambientit nga banim në ambiente ku ushtrohet aktivitet privat, sanksionimin e ndërhyrjes së paligjshme, ndërkohë që e njëjta procedurë të ndiqet dhe në drejtim të zaptimit të sheshit funksional të pallatit

Në përgjigjen e Kryetarit të Bashkisë Ballsh, jemi informuar se pas verifikimeve në vend, janë konstatuar shkelje të kondicioneve urbane, për të cilat zyrtarisht është marrë vendimi për kthimin e gjendjes së mëparshme nga subjekti kundravajtës, referuar nenit 5, pika ë), të Ligjit nr.9780, "Për inspektimin e ndërtimit", i ndryshuar.

Ankesa me **nr. doculive 201301163**, është dërguar nga shtetasja E.Zh., me banim në Tiranë, ndaj I.N.U.V Bashkia Tiranë lidhur me mosveprimin ndaj ndërtimit të paligjshëm, kat shtesë në pallatin ku jeton, në Rrugën "Medar Shtylla", Tiranë. Për efekt të shqyrtimit të kësaj ankese, Institucioni i Avokatit të Popullit, ka kërkuar shpjegime nga I.N.U.V Bashkia Tiranë sa i përket veprimeve proceduriale të ndjekura për hetimin administrativ të çështjes në fjalë. Në përgjigjen e tij, me nr. 5288/2 prot, datë 21/06/2013, Kryeinspektori i I.N.U.V. Bashkia Tiranë, na informon se për rastin konkret është mbajtur procesverbal-konstatimi me nr serie 008412, datë 10.05.2013, vendim për pezullim punimesh në

ndërtim, me nr.914, datë 20.05.2013, si dhe vendim për dënim me gjobë, nr.1489, datë 20.05.2013. Pavarësisht, përgjigjes së I.N.U.V Bashkia Tiranë, problematika e parashtruar nga ankuesi nuk ishte e ezauruar plotësisht, ndaj dhe për pasojë Institucioni i Avokatit të Popullit, ka rekomanduar Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit pranë Bashkisë Tiranë, ushtrimin e përgjegjësive dhe kompetencave ligjore të parashikuar nga Ligji nr.10119, datë 23/04/2009, "Për planifikimin e territorit", i ndryshuar, për prishjen e katit shtesë të paligjshëm, që po kryhet nga tre banorë të katit të fundit të pallatit pranë Rrugës "Medar Shtylla", Tiranë. Në përgjigjen e Kryeinspektorit të I.N.U.V. Bashkia Tiranë, me nr.11655/2 prot, datë 04/12/2013, jemi vënë në dijeni se nga autoriteti përgjegjës pranë kësaj njësie të qeverisjes vendore, po kryhen të gjitha procedurat ligjore përkatëse për zgjidhjen përfundimtare të çështjes në fjalë.

Ankesa me **nr.doculive 201300916**, është paraqitur nga shtetasi Y.J., banues në qytetin e Durrësit, me të cilën ka shprehur shqetësimin e tij lidhur me mosveprimin e I.N.U.V Bashkia Durrës ndaj ndërtimit të një strukture betoni me qëllim ushtrimin e aktivitetit privat nga fqinji i tij, sigurisht në mungesë të dokumentacionit legjitimues, duke zaptuar kësaj hapësirë publike të përbashkëta. Në këto kushte, me qëllim të shqyrtimit në një kohë sa më të shpejtë të pretendimeve të paraqitura nga ankuesi, eksperti i ngarkuar për ndjekjen e çështjes në fjalë, ka marrë takim me Kryeinspektorin e I.N.U.V Bashkia Durrës, duke verifikuar në vënd praktikën e ndjekur nga organi që kontrollon zbatimin e ligjshmërisë në fushën e ndërtimit brënda territorit administrativ. Nga ky verifikim ka rezultuar se I.N.U.V Bashkia Durrës lidhur me problematikën e parashtruar nga ankuesi, kishte marrë vendimin nr.21, datë 24.05.2013, për prishjen e objektit të paligjshëm, duke shprehur vullnetin e plotë për ekzekutimin e tij brenda afateve të parashikuar nga ligji Nr.9780, "Për inspektimin e ndërtimit", i ndryshuar, neni 13, paragrafi 3.

- *Konkluzione lidhur me veprimtarinë e Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik Vendor*

Përgjatë trajtimit të ankesave individuale që Institucioni i Avokatit të Popullit ka shqyrtuar për vitin 2013, përsa i përket mosveprimeve të organeve të administratës vendore, kryesisht të I.N.U.V.-ve të bashkive/komunave, në fushën e ndërtimit dhe urbanistikës, është vënë re një mungesë e thellë e bashkëpunimit të strukturave përkatëse jo vetëm me qytetarët të cilët janë ankimuar për hovin e rrezikshëm që morën ndërtimet e paligjshme, sidomos gjatë periudhës apatike të krijuar nga zgjedhjet parlamentare të këtij viti, por dhe ndaj Institucionit të Avokatit të Popullit, duke krijuar premisa serioze për ekzistencën e një situate që do të favorizonte ndjeshëm ndërtimet informale përgjatë të gjithë territorit administrativ, si dhe në zona me interes kombëtar. Nisur nga ky fakt, Institucioni i Avokatit të Popullit, pse jo dhe nëpërmjet këtij raporti, shpreh në vazhdimësi nevojën për ndryshimin apo harmonizimin e legjislacionit aktual në fuqi, me qëllim përmirësimin efektiv të punës ndaj veprimtarisë së paligjshme në fushën e ndërtimit.

Respektimi i afateve ligjore

Kjo është e njëjta problematikë e konstatuar edhe në raportin e vitit të kaluar, por që sërish përbën një shqetësim serioz në veprimtarinë e organeve të qeverisjes vendore. Nga mosveprimi në kohë, mjaft subjekte ndërtojnë në shkelje të hapura me lejet e ndërtimit, monitorimi dhe respektimi i të cilave duhet bërë nga INUV, dhe më pas procedojnë më

deklarimin e tyre për legalizim pranë zyrave rajonale të ALUIZNI në rang qarku. Mos respektimi i afateve ligjore, si në trajtimin e ankesave apo kërkesave të personave fizikë dhe juridikë privatë nga organet e administratës vendore, ka qenë dhe mbetet një problem mjaft i mprehtë, i konstatuar nga ana e Avokatit të Popullit prej disa vitesh tashmë.

Konstatimi i kundravajtjeve si dhe mosekzekutimi i vendimeve për prishje të marra nga I.N.U.V.-të brenda afateve ligjore, është tashmë një realitet shqetësues. Aksionet që ndërmerren herë pas here nga INUV janë selektive dhe nuk japin asnjë efekt në shmangien e ndërtimeve pa leje, për të cilat janë ngritur konkretisht këto Inspektorate. Inspektorët respektive nuk ushtrojnë funksionet e tyre që në momentin e fillimit të punimeve të paligjshme, të cilat denoncohen nga individë të ndryshëm të cënuar nga këto punime. Në vijim, Inspektorët justifikohen me pamundësinë për të vepruar pasi tashmë ndërtimet kanë përfunduar, janë të banuara apo kanë shkaqe objektive për shkak të mungesës së mjeteve. Në mjaft Bashki apo edhe në komuna, mosveprimi i INUV dhe respektimi i dispozitave ligjore në fushën e ndërtimit vijon të jetë pasojë e lidhjeve nepotike, të gjinisë, farefisit apo edhe mbi baza të bindjeve politike të drejtuesve vendorë me subjektet që duan të ndërtojnë.

Konkluzione

Përmbushja e dispozitave ligjore dhe respektimi rigoroz i lirive dhe të drejtave të njeriut nga veprimet apo mosveprimet e paligjshme të administratës nga organet e pushtetit vendor, sjell impakt pozitiv për mirëqeverisje nga ana e këtyre organeve. Nga ana e tyre duhet pasur parasysh zbatimi efektiv dhe ushtrimi brenda afateve ligjore i kompetencave dhe funksioneve që u njihen me ligj dhe akte të tjera nënligjore, duke u fokusuar kryesisht në rritjen e pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrje, respektimin dhe përmbushjen e të drejtës së tyre për informim, trajtimin e barabartë të individëve në programet sociale, duke shmangur abuzimet me skemat e përfitimit dhe dhënies abuzive mbi bazën e kriterëve preferencialë të kësaj ndihme, dhënien në kohë të ndihmave ekonomike dhe sociale për familjet, të cilat në mjaft raste i kanë edhe burim të vetëm jetese.

Avokati i Popullit beson se kjo rrit besimin e qytetarëve në organet e pushtetit vendor, përmirëson shërbimet që duhet tu ofrohen banorëve të një zone të caktuar, si edhe kontribuon në përmirësimin e aftësive menaxhuese të administratës lokale, si shërbëtoreshë e të gjithë individëve që janë nën juridiksionin e saj.

N. Trajtimi i ankesave të të përndjekurve politikë

Vështrim i përgjithshëm

Gjatë vitit 2013, Institucioni i Avokatit të Popullit ka trajtuar ankesa, apo kërkesa të individëve ish të dënuar politikë të regjimit komunist, sidhetë trashëgimtarëve të tyre. Viti 2013 regjistron një numër në total të ankesave të marra në shqyrtim për këtë kategori prej 15 ankesash dhe kërkesash.

Sikurse edhe për një vit më parë, problematikat e parashtruara në këto ankesa, apo kërkesa kanë të bëjnë me pretendimet për: mospërfitimin e kësteve të dëmshpërblimit që përfitojnë si ish të dënuar politikë, mospërfitimin në mënyrë të padrejtë të dëmshpërblimit në kushtet e cilësuar nga ligji nr.9831 datë 12.11.2007 “Për dëmshpërblimin e ish të dënuarve politikë të regjimit komunist”, i ndryshuar; caktimin jo korrekt të masës së dëmshpërblimit nga ana e Ministrisë së Drejtësisë; mosgjetjen e eshtrave të të afërmeve ish të dënuar politikë, të vdekur gjatë vuajtjes së dënimit; zvarritjen e procedurave për caktimin e masës së dëmshpërblimit; mundësimin e marrjes së shumës totale të dëmshpërblimit në mënyrë të menjëhershme dhe jo sipas radhës së kësteve të përcaktuara; zvarritjen e procesit të dëmshpërblimit për grupimin e të internuarve, sipas parashikimeve të ligjit.

Nga numri i ankesave dhe kërkesave të marra në shqyrtim gjatë vitit 2013 rezulton se, janë ende në shqyrtim 6 prej tyre, ndërsa për 9 të tjera ka përfunduar shqyrtimi. Nga ankesat dhe kërkesat e përfunduara rezulton se, 2 kanë qenë jashtë kompetencave të Avokatit të Popullit, 3 kanë rezultuar të pabazuara, 4 janë zgjidhur në favor të ankuesve, apo kërkesve.

Edhe në këtë vit i është dhënë përparësi dhe janë trajtuar me kujdes ankesat e drejtuara nga këta individë në një këndvështrim shumë më të gjerë se sa një vit më parë dhe konkretisht sa i përket ecurisë së procesit të dëmshpërblimit të ish të dënuarve politikë të regjimit komunist, procesit të munguar dhe të vonuar njëkohësisht të hapjes së dosjeve, si dhe funksionimit të Task-Forcës për kërkimin, gjetjen dhe identifikimin e personave të ekzekutuar gjatë viteve të regjimit komunist.

- Lidhur me ecurinë e procesit të dëmshpërblimit të ish të dënuarve politikë të regjimit komunist, sa i përket parashikimeve të bëra në Ligjin nr.9831 datë 12.11.2007 “Për dëmshpërblimin e ish të dënuarve politikë të regjimit komunist”, i ndryshuar, theksojmë se mbeten ende problematika të pazgjidhura dhe që kërkojnë veprim të shpejtë dhe konkret.
- Është i nevojshëm realizimi i iniciativës legislative, për një ndryshim në VKM nr.419 datë 14.04.2011 “Për miratimin e afateve dhe të skemës së shpërndarjes së fondeve të dëmshpërblimit, për ish të dënuarit politikë të regjimit komunist”, me qëllim përcaktimin e një afati përfundimtar të arsyeshëm, për përfundimin e procesit të dëmshpërblimit, për ish të përndjekurit politikë të regjimit komunist. Sikurse është evidentuar në rekomandimin tonë drejtuar me shkresën nr.K1/G60-

17 datë 12.02.2013, Ministrit të Drejtësisë, ky akt jo vetëm që është nxjerrë me gati dy vjet vonesë nga koha që ka përcaktuar ligji, por në përmbajtjen e dispozitave të tij, vërehet se, afati i shpërndarjes së fondeve të dëmshpërblimit është kthyer nga një çështje afati taksativ të përcaktuar nga norma, në një afat që varet krejtësisht nga ecuria korrekte e miratimit të plotë dhe përfundimit të dëmshpërblimit të shpërndarjes së kështit të dytë, për të gjithë ish të dënuarit politikë. Realisht, kemi një skemë dëmshpërblimi me shpërndarje në tetë këste të barabarta, por me një afat kohor që njeh vetëm një datë fillimi të procesit dhe jo një datë fikse mbarimi. Përmbajtja e Ligjit nr.9831 datë 12.11.2007, pas ndryshimeve, si dhe e akteve nënligjore të dala në zbatim të tij, veçanërisht e VKM nr.419 datë 14.04.2011, kanë krijuar konfuzion në ecurinë e pritshme të procesit të dëmshpërblimit nga palët e interesuara dhe efektivisht ka çuar në konkluzionin e perceptuar prej tyre, të moszbatimit të ligjit, duke cënuar kështu edhe parimin e sigurisë juridike, që përbën një komponent të rëndësishëm të shtetit të së drejtës. Sa i përket këtij rekomandimi nuk kemi pasur asnjë reagim, ndaj edhe jemi detyruar që t'ia ridërgojmë Ministrit aktual të Drejtësisë në muajin Dhjetor 2013, në pritje të një zgjidhje përfundimtare për këtë çështje.

- Duhet të fillojë trajtimi i kategorisë së të internuarve, kategori e përfaqësuar prej personave të internuar, ose të dëbuar në kampe, nga regjimi komunist me dëmshpërblimin përkatës, sipas kushteve të parashikuara në Ligjin nr.9831 datë 12.11.2007 "Për dëmshpërblimin e ish të dënuarve politikë të regjimit komunist", i ndryshuar. Sikurse është evidentuar nga ana jonë, megjithëse individët e interesuar kanë kohë që kanë paraqitur të gjithë dokumentacionin e nevojshëm zyrtar pranë Ministrisë së Drejtësisë për këtë qëllim, ende nuk ka filluar trajtimi i tyre me dëmshpërblim. Ky proces është bllokuar për shkak të mospërmbushjes së detyrimit nga ana e Ministrisë së Drejtësisë për t'i propozuar Këshillit të Ministrave, miratimin e dëmshpërblimit për këtë kategori ish të dënuarish politikë, me VKM përkatëse. Sa i përket këtij rekomandimi nuk kemi pasur asnjë reagim, ndaj edhe jemi detyruar që t'ia ridërgojmë Ministrit aktual të Drejtësisë në muajin Dhjetor 2013, në pritje të një zgjidhjeje përfundimtare për këtë çështje.
- Duhet të plotësohet baza e nevojshme ligjore, e cila do të mundësojë procesin e dëmshpërblimit financiar për kategorinë e personave të internuar, ose të dëbuar gjatë regjimit komunist të përcaktuara në gjermën "c", të nenit 6, të Ligjit "Për dëmshpërblimin e ish të dënuarve politikë të regjimit komunist", i ndryshuar. Pavarësisht kërkesave të subjekteve të interesuara, Këshilli i Ministrave ende nuk ka miratuar skemën e pensionit me VKM përkatës, skemë nga e cila do të përfitojnë dëmshpërblimin këto kategori ish të dënuarish politikë. Në këto kushte i kemi rekomanduar në fillim të vitit 2013 Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe Ministrit të Drejtësisë, paraqitjen në një kohë sa më të shpejtë të mundshme në Këshillin e Ministrave, të propozimeve për miratimin e skemës së pensionit për kategorinë e të internuarve ose të dëbuarve nga regjimi komunist. Për këtë rekomandim nuk kemi pasur asnjë reagim, ndaj edhe jemi detyruar që t'ia ridërgojmë Ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dhe Ministrit të Drejtësisë në muajin Dhjetor 2013, në pritje të një zgjidhjeje përfundimtare për këtë çështje.

Në disa ankesa të paraqitura, individë të ndryshëm me përkatësi në nënkategori të caktuara përfituese dëmshpërblimi sipas Ligjit "Për dëmshpërblimin e ish të dënuarve politikë të regjimit komunist", i ndryshuar, rezulton se nuk kanë mundur të bëhen pjesë e skemës ligjore të përfitimit pasi kanë dorëzuar paraqitjen e kërkesës dhe dokumentacionit përkatës shoqërues për dëmshpërblim, jashtë afateve të përcaktuara në pikën 2, të nenit 19, të Ligjit nr.9831 datë 12.11.2007 "Për dëmshpërblimin e ish të dënuarve politikë të regjimit komunist", i ndryshuar.

Evidentojmë se, Kuvendi ka ende në procedurë miratimi një projektligj, i cili nëse do të miratohej do të parashikonte një afat të ri paraqitjeje kërkesash dhe dokumentacioni nga individët e interesuar që nuk kanë mundur të kryejnë këtë proces për arsye objektive dhe subjektive nga më të ndryshmet, sipas parashikimeve të Ligjit nr.9831 datë 12.11.2007, i ndryshuar.

Në raste të caktuara, gjatë procesit të shqyrtimit të ankesave, janë vërejtur zvarritje apo edhe mospërgjigje nga ana e institucionit të Ministrisë së Drejtësisë në dërgimin e shpjegimeve zyrtare, gjë që ka ndikuar në afatet e shqyrtimit të tyre nga ana jonë.

- Avokatit i Popullit në kuadër të mbrojtjes dhe respektimit të të drejtave të njeriut, nisur nga ankesa të paraqitura nga individë ish të persekutuar politikë, por edhe në një kuadër më të gjerë angazhimi institucional për krijimin e standardeve të mirëqeverisjes ka vlerësuar dhe vlerëson se, shoqëria jonë meriton të dijë së cilët e qeverisin dhe cilët mbrojnë interesat e saj, përmes një procesi transparent të hapjes së dosjeve.

Në këtë këndvështrim, gjykojmë se një nga çështjet e vonuara dhe ende të pazgjdhura të shoqërisë sonë, e cila vjen nga një eksperiencë paskomuniste, mbetet miratimi i një ligji gjithëpërfshirës e të mbështetur në parimet ekzistenciale të një shoqërie demokratike, për hapjen e dosjeve.

Përpyekjet e bëra deri tani në këtë drejtim, kanë rezultuar të pasuksesshme në kuadër të respektimit të normave, parimeve dhe vlerave demokratike të shtetit të së drejtës dhe si të tilla, nuk janë pasuar ende me një produkt gjithëpërfshirës dhe konsensual, i cili e sheh procesin e hapjes së dosjeve si një kërkesë të kohës, ndonëse pas shumë vitesh nga rrëzimi i sistemit totalitar të mëparshëm.

Nevoja për një ligj të tillë është ndër të tjera e lidhur ngushtë edhe me krijimin e besimit në opinionin publik, për kryerjen e një procesi real të hapjes së dosjeve në vend që, do të bëjë transparencën e krimeve dhe pasojave të tyre nga sistemi i mëparshëm dhe që do të sigurojë të qeverisurit sot se, klasa aktuale qeverisëse dhe individë në nivele të tjera postesh publike, apo edhe përfaqësues të shoqërisë civile, nuk do të mbartin paragjykimin dhe frymën antidemokratike të përsëritjes të asaj ç'ka ndodhur në të shkuarën.

Sot pra, ndodhemi para një ngërçi institucional dhe ligjor, i cili afekton të gjithë jetën politike, sociale dhe psikologjike të shoqërisë shqiptare, për shkak të mungesës së një filtri ligjor, që përputhet me një qëndrim parimor në këtë çështje. Ky ngërç i krijuar tashmë teknikisht edhe për shkak të shfuqizimit të Ligjit nr.10034 datë 22.12.2008 "Për pastërtinë

e figurës së funksionarëve të lartë të administratës publike dhe të të zgjedhurve”, nga ana e Gjykatës Kushtetuese, nxjerr nevojën por edhe detyrimin e aktorëve, të cilët kanë të drejtën e propozimit të ligjeve, të hartimit dhe miratimit të një ligji të ri për hapjen e dosjeve, i cili përmbush të gjitha standardet e kërkuara dhe respekton parimet ku bazohet një shoqëri demokratike.

Shembujt dhe eksperiencat ligjore në këtë drejtim nuk mungojnë ndaj edhe është e arsyeshme dhe e logjikshme që të vlerësohet se, një ligj i ri për hapjen e dosjeve duhet të sigurojë një proces administrativ, i cili:

- Lehtëson aksesin individual në të dhënat që ish shërbimet sekrete kanë mbledhur ndaj personave të interesuar, qofshin këta individë të ndjekur nga ky shërbim dhe që kanë vuajtur pasojat e kësaj veprimtarie, punonjës me kohë të plotë, apo informatorë të vetë shërbimeve sekrete, apo edhe përfitues prej veprimtarisë në fjalë. Realizon bërjen e transparencës për individë të implikuar në veprimtarinë represive shtetërore, deri në nivel të përfaqësuesve të shoqërisë civile.
- Ju siguron entiteteve publike dhe private, aksesin në informacion e sipërcituar, në përputhje me qëllimin e vetë procesit të hapjes së dosjeve.
- Realizon transparencën publike të aktiviteteve represive të ish shërbimeve sekrete, me përcaktimin se, aksesin është personal dhe me kufizime ligjore në publikim.
- Mbron subjektin përkatës të të dhënave nga cënimi i së drejtës për privatësi, cënim i cili mund të shkaktohet nga keqpërdorimi i të dhënave personale të mbledhura nga ish shërbimet sekrete.
- Krijon organe kompetente dhe rregullon funksionimin e tyre, si organe përgjegjëse për kryerjen e procesit të hapjes së dosjeve.

Një ligj i tillë duhet që të ndihmojë në radhë të parë, viktimat e ndjekjes dhe persekutimit nga ish regjimi i mëparshëm, përmes veprimtarisë së shërbimeve sekrete dhe entitetet publike dhe private në radhë të dytë, në kuptimin e pasojave të veprimtarisë represive ndaj të drejtave të individit që ka ndodhur në të shkuarën, për të distancuar këtë veprimtari nga individët që e kanë ushtruar atë, me qëllim që të arrihet në konkluzionin se, “kush është kush” dhe se çfarë vlerash bart dhe duhet të bartë ai, pavarësisht vendit që ka zënë aktualisht në shoqëri.

Ne gjykojmë se, një ligj për hapjen e dosjeve, për më tepër pas kaq vitesh tranzicion, nuk duhet të kthehet në një ligj “represiv” ndaj disa individëve të caktuar, por në një mundësi reflektimi për shoqërinë në tërësi për përqaftimin e disa vlerave që shpesh i kemi dëgjuar të keqpërdorohen për qëllime të çastit nga individë të pushtetshëm që faktikisht kanë zvarritur këtë proces.

Në këto kushte është i nevojshëm rregullimi me një ligj specifik, i cili do të rregullojë proceduralisht dhe institucionalisht këtë proces purifikimi për shoqërinë shqiptare. Duke vlerësuar realisht si një proces të nevojshëm hapjen e dosjeve, institucioni i Avokatit të Popullit përmes një procesi konsultimi me aktorë të shoqërisë civile ka përgatitur një rekomandim i cili do t'i drejtohet së shpejti Qeverisë për të realizuar iniciativën përkatëse ligjore.

- Në institucionin e Avokatit të Popullit, në mënyrë të vazhdueshme janë paraqitur ankesa dhe kërkesa nga Shoqata të të persekutuarve politikë gjatë regjimit komunist, si dhe nga familjarët e personave të ekzekutuar gjatë këtij regjimi, ku kërkohet ndërhyrja e Avokatit të Popullit pranë institucioneve shtetërore kompetente për kërkimin, gjetjen dhe identifikimin e personave të ekzekutuar, gjatë viteve të regjimit komunist, të cilëve ende nuk iu është gjetur vend-varrimi.

Në funksion të kësaj veprimtarie dhe për lehtësimin dhe koordinimin e saj, Këshilli i Ministrave, me Vendimin nr.133 datë 24.02.2010 “Për Krijimin e Task-Forcës për kërkimin, gjetjen dhe identifikimin e personave të ekzekutuar gjatë viteve të regjimit komunist”, ka vendosur krijimin e task forcës në fjalë, duke përcaktuar objektin e punës, përbërjen dhe detyrat e anëtarëve të saj.

Në këto kushte institucioni i Avokatit të Popullit ka filluar në fund të vitit 2013 shqyrtimin dhe një analizë tërësore të problematikës që lidhet me ankesat e sipërcituara, duke kërkuar një informacion të detajuar në lidhje me aktivitetin dhe arritjet e kësaj Task-Force, nga momenti i krijimit të saj, e deri sot. Në informacionin e kërkuar është kërkuar saktësimi i numrit të përgjithshëm të kërkesave të paraqitura pranë Task Forcës, nga subjektet e interesuara, numrin e kërkesave të zgjidhura dhe atyre të refuzuara, si dhe atyre ende pa përgjigje, apo në proces shqyrtimi. Gjithashtu, është kërkuar informacion lidhur me numrin e mbledhjeve të zhvilluara nga kjo strukturë dhe nivelin e bashkëpunimit dhe koordinimit midis ministrive përgjegjëse, për zbatimin e VKM nr.133 datë 24.02.2010, të Këshillit të Ministrave.

Si një problematikë që lidhet me kompleksitetin e çështjeve të individëve ish të persekutuar politikë, gjykojmë se një ndërhyrje e nevojshme duhet të kryhet edhe në kuadër të efektivitetit të kësaj strukture, fakt për të cilin do të dërgohet edhe një rekomandim pas paraqitjes së informacionit të kërkuar për këtë qëllim.

Analizë e rasteve konkrete

Shtetasi F.M., (ankesa **nr.201300646**) ka paraqitur në Institucionin e Avokatit të Popullit një ankesë për moskthimin e një përgjigje dhe mossqarimin nga ana e Ministrisë së Drejtësisë, sa i përket çështjes së mostrajtitimit dhe refuzimit të trajtimit të tij me dëmshpërblim si ish i përndjekur politik, pas paraqitjes së kërkesës dhe dokumentacionit të plotë në këtë institucion për këtë qëllim.

Me marrjen në shqyrtim të kësaj ankese nga ana jonë janë kërkuar shpjegime prej Ministrisë së Drejtësisë, lidhur me arsyet e mosdhënies së një përgjigjeje për këtë rast. Nga përgjigja e dhënë rezultonte se vendimi gjyqësor mbi bazën e të cilit ankuesi ishte dënuar në vitin 1952, nuk parashikonte atë lloj kategori dënimesh të përcaktuara në nenin 4, të Ligjit 9831/2007 i ndryshuar, për përfitimin e dëmshpërblimit financiar. Në këto kushte, duke i bashkëngjitur përgjigjes sonë për ankuesin, një kopje të këtyre akteve mbi bazën ishte bërë vlerësimi mbi refuzimin e kërkesës së ankuesit në Ministrinë e Drejtësisë, kemi përfunduar shqyrtimin e kësaj çështjeje.

Shtetasi N.C (**ankesa nr.201300457**), ka paraqitur një ankesë në Institucionin e Avokatit të Popullit, për mospranim të dokumentacionit të paraqitur me qëllim të dëmshpërblimit ndaj tij si i përndjekur politik nga ana e Ministrisë së Drejtësisë.

Pas marrjes në shqyrtim të çështjes i jemi drejtuar për shpjegime Ministrisë së Drejtësisë, lidhur me zvarritjen e procedurave të shqyrtimit të dokumentacionit të dëmshpërblimit, të paraqitur nga ankuesi.

Në përgjigje, jemi vënë në dijeni nga Ministria e Drejtësisë se, janë mbyllur tashmë procedurat administrative të shqyrtimit të dokumentacionit dhe dosjes së ankuesit, e cila plotëson kërkesat formale të ligjit. Për pasojë edhe praktika e dëmshpërblimit nominal të ankuesit tashmë do të përfshihej në listën që do të dërgojë Ministria e Drejtësisë pranë Këshillit të Ministrave për miratim. Sa më sipër pas zgjidhjes pozitive të çështjes kemi ndërprerë shqyrtimin e saj.

Konkluzione

Fillimi i procesit të dëmshpërblimit të ish të dënuarve politikë të regjimit komunist me hyrjen në fuqi të Ligjit nr.9831 datë 12.11.2007 “Për dëmshpërblimin e ish të dënuarve politikë të regjimit komunist”, i ndryshuar, është pasuar nga ndryshime ligjore të cilat rezultojnë se nuk janë në dijeninë e pjesës më të madhe të kësaj shtrese që, sot pret marrjen sa më parë të dëmshpërblimit financiar. Kjo praktikë e ndjekur dhe me sa duket e pa konsultuar me vetë aktorët kryesorë, aktualisht ka prodhuar një situatë konfuze, ku procesi i dëmshpërblimit ka të njohur vetëm një datë fillimi dhe jo një datë mbarimi.

Trajtimi i procesit në tërësi të dëmshpërblimit, konstaton edhe mungesë të inisiativave legjislative të nevojshme për trajtimin e të gjitha kategorive përfituese të parashikuara në ligj.

Avokati i Popullit, ka dërguar gjatë vitit 2013 disa rekomandime për rregullimin e kësaj gjendjeje, por ende nuk ka veprim nga ana e institucioneve përkatëse shtetërore, gjë që na ka detyruar t’ia ridërgojmë rekomandimet tona Qeverisë së re.

Efektivisht gama e të drejtave të ish të persekutuarve është e gjerë dhe në vëmendje të Avokatit të Popullit, por si çështje prioritare po trajtohen çështjet e dëmshpërblimit financiar, procesit të hapjes së dosjeve si dhe të kërkimit, gjetjes dhe identifikimit të personave të ekzekutuar gjatë viteve të regjimit komunist.

KREU III

Aktiviteti i Avokatit të Popullit në rolin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës në vitin 2013

Përmbajtja

1. Prezantimi i OPCAT dhe funksionet e MKPT në Shqipëri	164
2. Inspektimet e kryera gjatë vitit 2013 në Burgjet dhe Paraburgimet	166
3. Inspektimet periodike me iniciativë dhe rekomandimet e bëra gjatë vitit 2013 lidhur me burgjet dhe paraburgimet.	172
4. Problematikat e sistemit penitenciar dalë nga ankesat dhe konstatimet e kryera gjatë inspektimeve në vitin 2013	189
5. Problematikat e sistemit penitenciar dalë nga shqyrtimi i ankesave individuale të dënuarve/paraburgosurve drejtuar Avokatit të Popullit	192
6. Inspektimet e kryera gjatë vitit 2013 në Qendrat Spitalore	194
7. Problematikat e konstatuara gjatë inspektimeve në Qendrat e Shëndetit Mendor, Spitalin infektiv në Tiranë dhe Qendrën Spitalore të Burgjeve.	195
8. Inspektime lidhur me verifikimin e përmbushjeve të rekomandimeve të Avokatit të popullit ne vizitat monitoruese 2012. (Follow-up visits)	202
9. Implementimi i rekomandimeve te Avokatit te Popullit mbi problematikat e evidentuara nga vizitat monitoruese te vitit 2012.	205
10. Rekomandimet me iniciativë, <i>ad-hoc</i> dhe legislative: Implementimi i rekomandimeve te Avokatit te Popullit mbi problematikat e evidentuara.	206
11. Rekomandimet e Avokatit të Popullit mbi rastet e dhunës së konstatuar në ambientet e IEVP gjatë monitorimit dhe ankesave individuale;	209
12. Rekomandimet të Avokatit të Popullit mbi çështjet migratore në Republikën e Shqipërisë;	212
13. <i>Vizita monitoruese në njësitë e policisë dhe aktiviteti i policisë së shtetit i monitoruar nga MKPT gjatë vitin 2013</i>	<i>214</i>
14. Përmbledhje e rekomandimeve të hartuara nga MKPT gjatë vitit 2013 lidhur me konstatimet e inspektim/monitorimeve të kryera në Drejtoritë e Policisë të Qarqeve dhe Komisariatet në varësi.	223
15. <i>Vështrim i përgjithshëm i aktivitetit të policisë në lidhje me respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut</i>	<i>236</i>
16. Të dhëna për rastet e konstatuara të dhunës, veprimeve arbitrare nga organet e policisë të shqyrtuara nga MKPT gjatë vitit 2013.	240

Zbatimi i detyrave dhe kompetencave të Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës në vitin 2013

Prezantimi i OPCAT dhe funksionet e MKPT në Shqipëri

Republika e Shqipërisë ka nënshkruar Protokollin Opsional të Konventës kundër Torturës dhe Trajtimeve të tjera Çnjerëzore dhe Degraduese (OPCAT)", dhe miratuar atë me Ligjin Nr. 9094, dt.03.07.2003, duke i dhënë Avokatit të Popullit kompetenca të veprojë në rolin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës.

Në përputhje me Protokollin Opsional të Konventës kundër Torturës dhe Trajtimeve të tjera Çnjerëzore dhe Degraduese (OPCAT)", Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës ushtron veprimtarinë e vet bazuar dhe në një sërë aktesh kombëtare ku dy më të rëndësishmet janë Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe Ligji Nr.8454 datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar.

Këto dispozita parashikojnë parimet bazë të inspektimeve në institucionet e vuajtjes së dënimeve dhe garantojnë një aktivitet konform standardeve ndërkombëtare në këtë drejtim, ndërkohë që neni 19/1, i Ligjit Nr.8454, datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, autorizon një veprimtari monitoruese dhe hetimore të pavarur, të gjithanshme dhe të plotë për çdo rast torture, trajtimi çnjerëzor dhe degradues, duke garantuar akses të madh në çdo ambient apo zyrë, ndaj çdo zyrtari pa imunitet dhe mbi çdo dokumentacion, qoftë dhe të klasifikuar, të organeve të administratës publike.

Edhe ndryshimet e kryera me Ligjin Nr. 9888, datë 10.03.2008, në Ligjin Nr.8328 datë 02.04.1998, "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve", bënë të mundur krijimin e një hapësire më të madhe të Avokatit të Popullit në funksionin e tij si Mekanizëm Kombëtar për Parandalimin e Torturës (MKPT) për të kryer detyrat gjatë kontrollit të shërbimeve penitenciare. Në Nenin 74/1 të këtij ligji, Avokatit të Popullit në rolin e MKPT-së, i njihet e drejta si subjekt i veçantë për mbikëqyrjen e zbatimit dhe realizimit të ligjit për të dënuarit dhe paraburgosurit. Institucioni i Avokatit të Popullit gëzon kompetenca për të vëzhguar rregullisht trajtimin e individëve, që u është hequr liria në vendet e ndalimit, arrestimit ose burgosjes, me qëllim që të forcohet, kur është e nevojshme, mbrojtja e individëve nga tortura, trajtimi ose dënimi i egër, çnjerëzor ose poshtërues. Sipas kësaj dispozite, ky Institucion ka të drejtë që të paraqesë në mënyrë specifike raporte dhe rekomandime për organet përkatëse, me qëllim që të përmirësohen trajtimi dhe kushtet e individëve që u është hequr liria dhe të parandalohet tortura dhe trajtimi ose dënimi i egër, çnjerëzor ose poshtërues.

Sipas OPCAT, qëllimi i veprimtarisë së Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës (MKPT) është zbatimi i vizitave të rregullta në të gjitha hapësirat e institucioneve publike ku liria e individit është e kufizuar ose është bërë mbi bazën e një vendimi gjykate ose një urdhër administrativ. Në këtë kuptim, institucione të tilla si burgjet, qendrat e paraburgimit, stacionet policore të paraburgimit, spitalet psikiatrike, repartet ushtarake etj, do të jenë subjekt i inspektimeve të rregullta. Për më tepër, problemet e identifikuara nga këto vizita inspektuese do të përkthehen në rekomandime dhe raporte periodike kombëtare dhe ndërkombëtare të progresit, në mënyrë që të promovohet respektimi i vazhdueshëm i të drejtave të njeriut dhe përmirësimi i standardeve të trajnimit të personelit që shërben në këto ambiente Gjatë vitit 2013 institucioni i Avokatit të Popullit në rolin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës (MKPT) ka konsoliduar dhe përmirësuar strukturën e Njesisë për Parandalimin e Torturës që punon me profesionalizëm në shqyrtimin e çdo fenomeni që sjellë si pasojë

shkelje të të drejtave të njeriut në formën e torturës, trajtimit çnjerëzor dhe degradues. Si rezultat i këtyre përmirësimeve veprimtaria e MKPT ka pasur rritje cilësore në parandalimin e fenomeneve të mësipërme, promovimin e praktikave të mira dhe forcimin e dialogut me autoritetet shtetërore si rezultat i bashkëpunimit të ngushtë me Organizata të Shoqërisë Civile të specializuara të fushës. Këto OJF kanë mbështetur rregullisht MKPT duke ofruar ekspertizë cilësore me mjekë, psikologë, ekspertë edukimi, etj sipas standardeve të OPCAT.

Inspektimet, vizitat dhe çdo kontroll tjetër i kryer në Institucionet e Policisë së Shtetit, në Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (burgje dhe paraburgime), në Spitale Psikiatrike dhe Infektive, në baza dhe reparte ushtarake, në Drejtoritë Rajonale të Kufirit dhe Migracionit si dhe në qendrat e tjera të strehimit të emigrantëve të paligjshëm dhe personave të trafikuar, ka pasur si objektiv të sigurojë një mbulim të plotë monitorues mbi situatën e të drejtave të njeriut në këto organe, të parandalojë shkeljet, si dhe të mbajë një qëndrim zyrtar mbi problematikat e konstatuara.

Gjatë vitit 2013, Avokati i Popullit në rolin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës, ka kryer **108** inspektime, ri-inspektime, kontrole me tematikë të veçantë dhe vizita në vendet e privimit të lirisë dhe institucionet e tjera të përmendura më sipër. Krahas kësaj, kjo të kontakteve direkte në inspektimet e kryera. I gjithë aktiviteti i mësipërm është shoqëruar me **55** rekomandime.

Rekomandimet dhe ndërhyrjet e mësipërme janë fokusuar kryesisht në masat që duhen marrë për respektimin dhe përmirësimin e të drejtave të të dënuarve dhe paraburgosurve, në plotësimin e nevojave të tyre jetësore, shëndetësore dhe arsimore.

Përveç rekomandimeve të mësipërme janë rekomanduar një sërë masash të tjera që kanë synuar kryerjen e investimeve të brendshme infrastrukturore, plotësimin e organikës me punonjës. Është punuar paralelisht me administratën e burgjeve për nxitjen dhe promovimin e veprimtarive që synojnë mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Avokati i Popullit në rolin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës, ka vijuar të kryejë veprimtarinë e tij në inspektimin e ambienteve të Policisë së Shtetit, duke monitoruar e kontrolluar ligjshmërinë dhe rregullsinë e shoqërimit, ndalimit apo arrestimit të individëve, trajtimin e tyre brenda ambienteve të Policisë, kushtet e ambienteve etj.

Aktualisht MKPT-ja po i nënshtrohet një procedure rinovimi dhe freskimi. Pjesëtarë themelues të saj janë larguar në pozicione të rëndësishme në administratën shtetërore, edhe si rezultat i punës së mirë dhe profesionalizmit të treguar si pjesë e MKPT-së, e për rrjedhojë vendet e tyre do të plotësohen me anëtarë të tjerë, të rinj profesionistë me njohuri dhe dëshirë për të çuar më tej punën dhe arritjet e deritanishme. Do të synohet strukturimi i një MKPT-je multidisiplinore, duke përfshirë në të edhe mjekë, psikologë e psikiatër, për të përmbushur detyrimet e OPCAT-it dhe për të rritur pavarësinë dhe profesionalizmin e inspektimeve dhe rekomandimeve.

Padyshim, ashtu si deri tani, do të vazhdojë bashkëpunimi me shoqërinë civile në realizimin e vizitave të përbashkëta duke rritur edhe më tej transparencën e veprimtarisë së organeve të policisë së rendit/burgjeve, etj me qëllim arritjen e standardeve për të cilat përpiqemi bashkërisht.

Jemi të ndërgjegjshëm që përmirësimi i vazhdueshëm i punës së MKPT-së do të jetë sfida jonë e përhershme por besojmë se ashtu si edhe 6 vite më parë kur nisëm këtë rrugëtim, do të dimë të realizojmë pritshmëritë dhe të synojmë më tej.

Inspektimet e kryera gjatë vitit 2013 në Burgjet dhe Paraburgimet

Gjatë vitit 2013, Avokati i Popullit si Mekanizëm Kombëtar për Parandalimin e Torturës, ka kryer **34** inspektime, ri-inspektime, kontrole me tematikë të veçantë dhe vizita në vendet e privimit të lirisë, burgje dhe paraburgime.

Për institucionet e burgjeve dhe paraburgimit, janë **bërë 20** rekomandime, nga të cilat **18** rekomandime janë bërë pas kryerjes së monitorimeve dhe vizitave në institucionet penitenciare nëpërmjet të cilave janë trajtuar çështje të përmirësimit të kushteve dhe trajtimit të të dënuarve dhe paraburgosurve; **2** rekomandime të tjera kanë qenë me natyrë përgjithësuese për standardizimin e kushteve të trajtimit të personave të privuar dhe respektimin e të drejtave të tyre nga administrata e IEVP-ve, etj.

Nga përmbajtja e 20 rekomandimeve vërehen një sërë problematikash të cilat kanë nevojë të ngutshme të shqyrtohen dhe përmirësohen. Ky proces ka nevojë të kalojë me vendimmarrje të organeve të larta shtetërore, pasi në shumicën e rasteve ai ka si pengesë mungesën e fondeve dhe të nxjerrjes së akteve nënligjore për të gjeneruar përmirësime të dukshme të sistemit, si në formë ashtu dhe në përmbajtje.

Aspektet dhe gjetjet kryesore të monitorimit në sistemin e burgjeve dhe paraburgimit gjatë vitit 2013.

Një përmbledhje e aspekteve dhe gjetjeve kryesore nga vizitat monitoruese sipas pesë fushave kryesore, të marra në konsideratë nga ekspertët e MKPT është si më poshtë:

1. Trajtimi i të burgosurve/paraburgosurve
2. Masat mbrojtëse
3. Kushtet materiale
4. Regjimi dhe Aktivitetet
5. Shërbimi shëndetësorë.

Trajtimi

Grupi i monitorimit pati për objektiv të punës së tij mbledhjen e informacionit lidhur me trajtimin e të burgosurve/paraburgosurve, në identifikimin e rasteve të përdorimit të torturës, trajtimit degradues e diskriminues, përdorimit të forcës fizike tej kufijve të parashikuar me akte normative apo të presionit psikologjik ndaj kësaj kategorie, si edhe të rasteve të marrjes së masave disiplinore të “veçimit nga aktivitetet e përbashkëta”. Nga informacioni i marrë, si nga drejtuesit e institucionit, ashtu edhe nga bisedimi në grup dhe në privatësi me të burgosurit/paraburgosurit, grupi monitorues gjatë inspektimeve nuk konstatoi raste flagrante torture apo përdorimi të tepruar të forcës apo dhunë psikologjike nga ana e personelit të I.E.V.P.-ve. Megjithatë u shfaqen ankesa nga të dënuar të veçantë ndaj punonjësve të caktuar të IEVP-ve për ushtrim dhune fizike dhe psikologjike. Shqetësues është fakti se disa nga këto raste lidheshin me ushtrimin e dhunës fizike dhe psikologjike edhe ndaj të miturve. Grupi monitorues zhvilloi një hetim të gjithanshëm lidhur me një ankesë të tillë në IEVP Kavajë duke i kaluar Organit të Prokurorisë dosjet përkatëse për hetime të mëtejshme.

Në optikën e monitorimit të grupit të ekspertëve të MKPT, ishin edhe masat disiplinore, ligjshmëria e marrjes së tyre dhe më pas kushtet dhe korrektësia e ekzekutimit të tyre. Në momentet e monitorimit kishte raste që të dënuar dhe të paraburgosur ishin në dhomat e veçimit me masë disiplinore dhe u takuan dhe u pyetën lidhur me gjendjen e tyre. Në përfundim të vlerësimit të këtyre rasteve ekspertët e MKPT arritën në konkluzion se nuk janë vërejtur raste të shkeljes të rëndësishme në procedurat e ndjekura në zbatim të masave disiplinore. Mbeten problem kushtet e veçimit në këto dhoma të cilët përgjithësisht nuk janë në përputhje me standardet themelore të të drejtave të njeriut duke mos qenë të përshtatshme për të siguruar kushte jetese në respekt të dinjitetit njerëzor.

Institucioni i Avokatit të Popullit mendon se një vëmendje e veçantë duhet treguar për trajnimin e stafit të burgjeve, lidhur me të drejtat e të burgosurve gjatë grevave të urisë, takimeve me familjaret, kontrolleve të të dënuarve, ambienteve ku jetojnë. Gjithashtu në respekt të dinjitetit të të dënuarve, familjarëve dhe fëmijëve të tyre duhen trajtuar me një rëndësi të veçantë kontaktet e të dënuarit me familjaret dhe fëmijët e tyre të mitur duke sistemuar vende të përshtatshme, pasi në disa burgje ato nuk ekzistojnë. Gjithashtu, kemi rekomanduar disa herë dhe vazhdimisht që **të hartohen dhe të miratohen një tërësi e qartë dhe e kuptueshme rregullash dhe procedurash që përshkruajnë në detaje rrethanat në të cilat duhet të jepen lejet shpërblyese dhe të veçanta apo procedurat e punësimit dhe pagesave të të dënuarve/paraburgosurve në IEVP. Këto rregulla dhe procedura duhet të jenë në përputhje të plotë me konventat ndërkombëtare, ligjet dhe aktet e tjera nënligjore të Shtetit Shqiptar për sistemin e burgjeve.**

Masat mbrojtëse.

Grupi monitorues, në zbatim të objektivit të vizitave së tij monitoruese pranë I.E.V.P-ve, kishte qëllim vlerësimin e kushteve dhe trajtimin e personave të dënuar dhe të paraburgosur. Grupi monitorues, inspektoi zbatimin e masave mbrojtëse duke vlerësuar përputhshmërinë e tyre me aktet ligjore vendase dhe standardet ndërkombëtare.

Përgjithësisht zbatoheshin procedurat e pranimit në institucion dhe Komisionet e Pritjes funksiononin në çdo IEVP; kryhej plotësimi i dokumenteve personale e regjistrave; bëhej observimi dhe me pas sistemimi në dhoma sipas kriterëve të përshtatshmërisë. Përgjithësisht nuk u vërejtën raste të shkeljeve së procedurave të pranimit dhe parregullsi në mbajtjen e dokumentacionit.

Procedurat disiplinore gjithashtu ishin objekt i monitorimit nga ana e MKPT dhe nuk u konstatuan shkelje lidhur me procedurat e aplikimit apo të zbatimit të tyre. Komisionet e Disiplinës vepronin sipas dispozitave ligjore në veprimtarinë e tyre.

Lidhur me procedurat e ankesave dhe kërkesave të të burgosurve /paraburgosurve gjatë vitit 2013 është bërë një punë e mirë nga ana e DPB në zbatim të rekomandimeve të Avokatit të Popullit për krijimin e një sistemi pranimi dhe trajtimi të ankesave/kërkesave nga ana e sektorit të edukimit në çdo IEVP dhe respektim të afateve të kthimit të përgjigjeve zyrtare nga ana e institucionit sipas Kodit të Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë. Ky sistem aktualisht funksionon në çdo IEVP.

Kushtet materiale

Grupi i monitorimit të MKPT, konform objektivave të vizitës së tij, mblodhi informacione dhe monitoroi në vend aspektet e ndryshme të kushteve materiale të të burgosurve/paraburgosurve në institucione duke u përqendruar kryesisht në këto aspekte: ushqimi dhe shërbimi në kohë i vakteve, ndriçimi natyral, ventilimi-aspirimi e sistemi ngrohës, respektimi i mundësisë për higjenë personale, kushtet sanitare, veshja, mbipopullimi, kushtet e banimit, etj.

Ushqimi në institucione shërbehej në 3 vakte në kohë të caktuara dhe të shpërndara proporcionalisht gjatë ditës. Nga ana e të burgosurve/paraburgosurve nuk u reklamua sasia e ushqimit, por në shumë raste kishte ankesa lidhur me cilësinë e gatimit dhe larminë e gatimit ndër vakte. Ankesat kryesisht ishin për menynë e njëjtë çdo ditë.

U monitoruan kuzhinat, higjena, kushtet e përgatitjes së vakteve, dokumentacioni përkatës lidhur me menynë ditore e javore, ruajtja e kampioneve në dhoma frigoriferike. Këto kritere u gjetën përgjithësisht konform standardeve ligjore, me përjashtim të faktit se në disa IEVP kampionet nuk ruheshin në dhoma frigoriferike siç e kërkon kuadri ligjor. Përsa i përket furnizimit pa ndërprerje me ujë të rrjedhshëm, I.E.V.P. Elbasan u prezantua me mangësi në këtë drejtim, pasi uji i rrjedhshëm në këtë institucion ishte i kushtëzuar në orare e përkatësisht: 7.00-8.00, 13.00-15.00, 19.00-20.00, pra për rreth 4 orë në ditë. Kufizime të furnizimit me ujë vërejtëm dhe në disa IEVP të tjera.

Disa prej IEVP-ve në vend vijojnë të vuajnë nga probleme të amortizimit dhe kushteve të papërshtatshme të tyre, veçanërisht të lagështirës, dëmtimit të hidroizolimit dhe kanalizimeve. Ka ambiente të palyera, me rrjete elektrike e hidraulike të cilat janë jashtë parametrave teknike, ka mungesa të kokave të dusheve në tualete, nuk sigurohet ndriçimi natyral dhe ajrosja e plotë e qelive, nuk sigurohet ngrohja.

Këto probleme janë ngritur shpesh pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, por mendojmë se ato janë një çështje që nuk i takon vetëm këtij institucioni. Nëse kërkojmë përmirësimin e standardeve të të drejtave të njeriut në vend dhe veçanërisht për të dënuarit, Qeveria Shqiptare dhe Ministria e Drejtësisë dhe ajo e Financave duhet të kenë parasysh se ky proces krahas angazhimit kërkon edhe mbështetjen e duhur financiare.

Megjithë masat e marra për hapjen e institucioneve të reja të vuajtjes së dënimit, mbipopullimi vijon të mbetet një problem kryesor në burgje. Avokati i Popullit e ka nënvizuar shpesh rëndësinë e uljes së numrit të të dënuarve në burgje, duke respektuar standardet e hapësirës për jetesë, pasi mbipopullimi është shkaku kryesor i amortizimit të ambienteve të burgjeve dhe cilësisë së dobët të shërbimeve ndaj të dënuarve.

Jetesa në IEVP përballej dhe me mangësinë e ngrohjes së dhomave dhe ambienteve të përbashkëta. Sistemet qendrore të ngrohjes pothuajse në të gjitha IEVP-të në rastet kur janë të instaluar nuk funksionojnë si rezultat i defekteve teknike ose të mungesës së karburantit. Në shumicën e rasteve të dënuarit/paraburgosurit përdornin batanijet dhe teshat e fjetjes si të vetmet mjete ngrohjeje gjatë ditëve të ftohta të dimrit.

Problematike është dhe konstatimi që në disa IEVP mungon furnizimi me disa prej produkteve bazë të higjenës personale (pastë dhëmbësh, furçë dhëmbësh, shampo, etj.) dhe të detergjenteve të nevojshme për të pastruar qelitë, gjithashtu mospërdorim i uniformave e të dorezave gjatë shpërndarjes së ushqimit dhe mosdizifektim të insekteve.

Në shumicën e dhomave të banimit në IEVP mungojnë dollapët e rrobave dhe ato mbaheshin nga të dënuarit/paraburgosurit në qese plastike ose në thes, kryesisht poshtë shtretërve. Një fakt i tillë i konstatuar nga ana e grupit monitorues vjen në kundërshtim me kërkesat ligjore ndërkombëtare²³.

Regjimi dhe aktivitetet

Grupi monitorues, në zbatim të objektivave të vizitave së tij monitoruese pranë I.E.V.P-ve u fokusua dhe në vlerësimin e respektimit të të drejtës së paraburgosurve dhe të dënuarve për të pasur kontakte me familjarët, 4 herë në muaj, si edhe në lidhje me respektimin e numrit të telefonatave me familjarët respektivisht, 8 telefonata në muaj. Të dyja këto të drejta respektoheshin konform parametrave të kërkuar. Takimi me familjarët zgjaste rreth 30 minuta dhe realizohej në kushte të pranueshme. Të burgosurit/paraburgosurit gjatë bashkëbisedimit me ekspertët shfaqën dëshirën për të pasur mundësi takimi nga afër me familjarët e tyre, sidomos në rastet e takimit me fëmijët e tyre. Këto ambiente ofrohen vetëm në pak institucione të ndërtuar rishtazi (Vlorë, Durrës, Elbasan, Korçë) sipas parametrave ndërkombëtar ose në varësi të kushteve apo të rrethanave që ofron institucioni. Me porosi të drejtuesit të institucionit, takimi në këto raste realizohej në dhomat e takimit me këshilltarin ligjor që kanë institucionet. Në respekt të dinjitetit të të dënuarve, familjarëve dhe fëmijëve të tyre, kontaktet e të dënuarit me familjarët dhe fëmijët e tyre të mitur duhen trajtuar me rëndësi të veçantë duke sistemuar vende të përshtatshme për to, pasi në shumë burgje ato nuk ekzistojnë.

Ndërsa, përsa i përket telefonatave, të burgosurve/paraburgosurve u lejoheshin të bënin telefonatat e parashikuara në ligj gjithashtu dhe telefonata shtesë, si në numër ashtu e pas orarit të shpallur në varësi të kërkesave e rrethanave të bëra prezent prej tyre.

U monitoruan gjithashtu edhe ambientet e vend-takimeve të të dënuarve/paraburgosurve me familjarët. Takimi, realizohej në shumicën e rasteve në ambiente të ndara me xham apo zgara hekuri, ku familjarët qëndronin në njërin anë dhe të dënuarit dhe të paraburgosurit nga ana tjetër. Takimit zgjasin deri në 30 minuta.

Lejohej gjithnjë komunikimi me këshilltarët ligjorë. Sipas Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve, garantohej e drejta e informimit, nëpërmjet mundësisë që kjo rregullore u jep të paraburgosurve për të pasur akses në median elektronike dhe atë të shtypur. Në të gjitha IEVP-të lejohen televizorët dhe radiot.

Grupi i monitorimit u interesua në mënyrë të veçantë lidhur me punësimin në IEVP. Lidhur me këtë, grupi i monitorimit ballafaqoi informacionin e marrë nga të burgosurit e punësuar e verifikoi emrat e tyre me listën zyrtare të të punësuarve të dhënë nga institucioni. Shpërblimet për punën e kryer në të gjitha institucionet (Përveç IEVP Burrel) me ditë ulje nga dënimi. Të dënuarit nuk ishin të pajisur me librezë pune dhe as me atë të kontributeve shoqërore. Po kështu, vazhdon të konstatohet si problem në institucionet e paraburgimit, mospagimi i ditëve respektive të punës, por konvertimi i tyre në ulje dënimi, gjë që nënkupton që të paragjykos të fajshëm kategorinë e të paraburgosurve.

²³ Rregulla 22 e Rregullave Europiane të Burgjeve

Po në këtë kuadër, për punën që kryejnë të paraburgosurit në këto institucione nuk ju paguhet vlera përkatëse e sigurimeve shoqërore, gjë që sjell mosvlerësimin e kohës së punës në institucion si kohe vjetërsie në punë. Sipas informacionit të marrë nga të paraburgosurit e punësuar, disa prej tyre treguan se punonin çdo ditë të javës, pra edhe ditën e dielë, duke u shkelur në këtë mënyrë Kodi i Punës, i cili garanton për të punësuarit, 24 orë pa ndërprerje pushim. Të gjitha këto fakte, vërtetojnë një diskriminim ndërmjet dy kategorive, atyre të të punësuarve të lirë dhe të të punësuarve të paraburgosur.

E drejta për aktivitete në ajër të pastër zbatohet në përputhje me kushtet që ekzistojnë në institucione. E drejta për ajrim zbatohet në mënyrën e duhur. Të gjithë të dënuarit dhe të paraburgosurit sipas sektorëve dëlnin për ajrim dy herë në ditë, aktualisht dy orë paradite dhe një orë pasdite. Ambienti për ajrim në disa IEVP të reja kishte edhe një hapësirë të mbuluar, gjë që u krijonte të burgosurve mundësi më të favorshme për të qëndruar nën ndikimin e kushteve të ndryshme klimaterike. Megjithatë kishte ankesa nga ana e të burgosurve/paraburgosurve për sipërfaqen e vogël në dispozicion për ajrim, e cila kushtëzonte edhe zhvillimin e ndonjë aktiviteti tjetër gjatë kësaj kohe qëndrimi atje. Në IEVP 313 nuk respektohet e drejta e ajrimit sipas parametrave për arsye të mungesës së ambienteve. Mjediset e jashtme dhe të brendshme në burgjet dhe paraburgimet e pa rikonstruktuar nuk janë në përputhje me standardet që kërkohet për një funksionim normal të institucioneve të tilla. Këto mjedise të krijojnë premisa për rehabilitim psiko-social të të burgosurve/paraburgosurve.

Në institucione nuk ofrohet arsimit i detyrueshëm, konform kjo edhe Marrëveshjes ekzistuese midis Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Arsimit për arsimin 9-vjeçar. Nga ana e drejtuesve të institucioneve ekspertëve ju bë me dije se ishin dërguar shkresa zyrtare Drejtorive Rajonale Arsimore të Rretheve, ku kërkohet krijimi i mundësisë nga ana e këtyre Drejtorive për ofrimin e programeve studimore për nxënësit pa arsim apo edhe për ata që nuk e kishin plotësuar arsimin e detyrueshëm. Sipas konstatimeve të eksperteve të MKPT kjo skemë nuk është përmbushur në qëllimin e saj.

Ndërsa, Qendrat Rajonale të Formimit Profesional ishin ofruar për të zhvilluar kurse të formimit profesional në institucione. Në bashkëpunim edhe me stafet e kujdesit psiko-social të institucioneve ka filluar puna përgatitore për krijimin e grupeve pjesëmarrëse. Ata kishin të drejtë të merrnin pjesë edhe në më shumë se një kurs nëse dëshironin. Sipas punonjësve të stafit psiko-social ishte parashikuar që klasat e këtyre kurseve të përbëheshin deri në 10 persona, koha e qëndrimit, rreth 1.30 - 2 orë në këto klasa.

Aktivitetet më të zakonshme në IEVP konsistojnë në mundësinë e të zhvillimit në klasa të lojërave të ndryshme tavoline si: letra, shah, tavëll; të merrnin pjesë në recensionet librash të ndryshme; si edhe të merrnin e librat nga biblioteka e institucionit për të lexuar.

Bibliotekat e institucioneve ishin pasuruar së fundmi me tituj të rinj nga DPBSH. Duke qenë se inventari i bibliotekave nuk kishte përfunduar ende në të gjithë institucionet, në disa prej tyre nuk mund të jepet një informacion më i detajuar rreth titujve apo e numrit ekzakt të tyre. Por, nga ana e të dënuarve/paraburgosurve pati ankesa në lidhje me numrin e kufizuar të aktiviteteve që ofroheshin në institucione. Këto aktivitete, ashtu siç edhe u bë me dije nga ana e stafit të kujdesit psiko-social kushtëzoheshin nga fondet e vëna në dispozicion për këtë qëllim.

E drejta e besimit respektohet në IEVP. Institucionet e reja kanë dhoma kulturi, për besimet e ndryshme. Gjithashtu shumë organizata dhe institucione fetare asistojnë të dënuarit në ushtrimin e besimeve fetare.

Sektori i kujdesit psiko-social në organikë në paraburgime është së bashku me sektorin ligjor. Ai përbëhet nga:

- përgjegjësi i sektorit, i cili ishte edhe juristi i institucionit;
- dy psikologë, por që sipas formimit profesional njëra prej tyre duhet të ishte psikologe, ndërsa tjetra punonjëse sociale;
- dy punonjës socialë.

Psikologjia si edhe punonjësit socialë e kanë të ndarë ngarkesën e punës midis tyre sipas sektorëve. Dosjet psiko-sociale të të paraburgosurve nuk duhen të jenë të hapura. Ato duhet të mbahen në dollap apo sirtarë të mbyllura me çelës. Në disa nga dosjet e shqyrtuara pas marrjes së autorizimeve përkatëse nga ana e të burgosurve/ paraburgosurve, u vu re se ato ishin të përditësuar me informacione për të dënuarit/paraburgosurit. Mungesa e një mjeku psikiatër në institucione për vendosjen e diagnozave dhe identifikim e personave me probleme të shëndetit mendor e vështirësonte edhe punën e specialistëve të këtij sektori.

Nga biseda me stafet e kujdesit psiko-social, nga ana e tyre u shpreh nevoja për pjesëmarrje në trajnime kryesisht mbi çështje të shëndetit mendor. Në dosjet e psikologëve së institucioneve për persona, të cilët mendohej se kishin probleme të shëndetit mendor, por që në mungesë të një mjeku psikiatër ishin pa diagnoza, ishin të pasqyruara plane individuale trajtimi duke u bazuar në DSM- IV (The Diagnostic and Statistical Manual of Mental Disorders, Fourth Edition), si edhe në instrumenta matës për nivelin e ankthit, vetëvlerësimit, etj.. Marrëdhëniet midis stafit dhe të paraburgosurve ishin miqësore, nuk pati ankesa nga ana e të paraburgosurve në lidhje me këtë çështje.

Shërbimi shëndetësor

Pas inspektimit të ambienteve që kanë të bëjnë me kujdesin shëndetësor u konstatuan ambiente fizike të përshtatshme për vizita apo manipulime mjekësore, të pajisura me materiale ndihmëse. Grupi monitorues pati akses në dhomat e farmacistëve dhe dhomat e stomatologut. Grupi monitorues mori kontakt me mjekët, ndihmësmjekët, dhe, në bashkëbisedim me to, u konstatua vështirësia dhe mospajisja e të gjithë të dënuarve/ paraburgosurve me librezë shëndetësore, vështirësia e marrjes së medikamenteve me recetë të rimbursueshme (e cila u konstatua në regjime nga së paku 20 raste).

Gjithashtu në shumicën e IEVP u konstatua domosdoshmëria e prezencës së një mjeku psikiatër (me kohë të pjesshme si në I.E.V.P.-në Korçë) për rastet jo të pakta të të sëmurëve mendorë dhe ish-përdoruesve të substancave. Problematika e këtyre të dënuarve/ paraburgosurve qëndronte si në diagnostikimin jo adekuat, ashtu edhe në trajtimin medikamentoz. Kësaj problematike i shtohet edhe aksesimi jo i mirë për konsulta psikiatrike pranë spitaleve psikiatrikë rajonalë. Vështirësi paraqisnin edhe konsultat e specialiteteve të tjera si dhe analizat laboratorike. Shërbimi stomatologjik nuk funksiononte normalisht në I.E.V.P për shkak të mungesës së aparaturës dhe materialeve ndihmëse.

Shërbimet dentare kryheshin me vështirësi në poliambulancën publike apo në klinika private me shpenzimet e vetë të dënuarve. Gjatë inspektimit nëpër dhomat e të dënuarve/ paraburgosurve, kontaktit dhe intervistave me ta, u konstatuan vështirësitë e përmendura

më lart të mungesës së ilaçeve, të vonesave në konsulta dhe mangësisë së shërbimit dentar brenda institucionit. Edhe në rastet e përzgjedhura nga intervistat, pas shqyrtimit të kartelave të tyre mjekësore, konstatohej një ndjekje e rregullt e problematikave të tyre shëndetësore të paraqitura. Gjithashtu funksiononte mjaft mirë filtri i pranimit gjë që pasqyrohej në plotësimin e mirë të kartelave.

Është një problematikë emergjente, mbajtja në burg, në kundërshtim me ligjin, e personave për të cilët gjykata ka vendosur masën mjekësore “mjekim të detyruar”. Nga informacionet e fundit rezulton se janë rreth 100 persona të tillë.

Problematike mbeten:

- Mungesa e personelit mjekësor, dhe veçanërisht mjekëve psikiatër.
- Mungesa e pajisjeve dhe medikamenteve mjekësore të urgjencës në disa raste, si dhe të pajisjeve dhe medikamenteve të shërbimit stomatologjik .
- Mangësi të shërbimit psikologjik dhe të pasqyrimit në dosje të ndërhyrjeve të ofruara nga psikologët.

Inspektimet me iniciativë dhe rekomandimet e bëra gjatë vitit 2013 në burgje dhe paraburgime.

IEVP Fushë-Krujë nr. dok. 201302517

Avokati i Popullit në rolin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës, kreu një inspektim të përgjithshëm në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale Fushë-Krujë më dt.17.10.2013. Në përfundim të këtij inspektimi, pasi u njoh me të gjithë konstatimet e grupit inspektues, si dhe me problematikat e ngritura nga ana e të dënuarve dhe paraburgosurve, Avokati i Popullit parashtroi konkluzionet përfundimtare, duke dhënë rekomandimet si vijon:

1. Marrjen e masave për ndarjen e të rriturve nga ata të grup-moshës 18-21 vjeçare, duke shmangur kështu bashkëjetesën e një të paraburgosuri të rritur me një 18-21 vjeçar (brenda sektorit të paraburgimit);
2. Marrjen e masave të menjëhershme për eliminimin e furrtareve ekzistuese në dhomat e të burgosurve/paraburgosurve duke intensifikuar periudhën e dizinfektimit të tyre;
3. Të merren masat për furnizimin me energji elektrike dhe ujë të rrjedhshëm në mënyrë të vazhdueshme;
4. Të merren masat e nevojshme për të ulur mbipopullim dhe për të garantuar një shpërndarje të drejtë të të paraburgosurve në dhoma banimi në respekt të standardit të sipërfaqes së banimit për person.

5. Të merren masat e menjëhershme për sigurimin me shtretër, karrige dhe dollape të dhomave për çdo të paraburgosur;
6. Të merren masa të menjëhershme për të siguruar kohën e nevojshme për ajrim në përputhje me përshkrimet e mjekut;
7. Të merren masa për nisjen sa më shpejt të procesit të vënies në punë të dusheve me ujë të ngrohtë;
8. Rregullimi dhe vënia në përdorim të sistemit të ngrohjes për muajt e ftohtë të vitit;
9. Të merren masa për krijimin e një ambienti të përshtatshëm në rastet e takimit të të burgosurve/ paraburgosurve me familjarë të mitur;
10. Të merren masa për të mbajtur aktive kurset e arsimit dhe ato profesionale;
11. Të merren masa e nevojshme nga personeli përgjegjës për të mundësuar këshillime individuale e në grup në dhoma të planifikuara për këshillim;
12. Të plotësohen dosjet psiko-sociale me të dhëna klinike të dekursit dhe plane të drejtuara drejt qëllimeve klinike;
13. Të bëhen përpjekje për një mirëmbajtje dhe higjenë më të mirë të ambienteve spitalore, ambienteve të përbashkëta, si edhe të një numri të madh dhomash të të burgosurve/paraburgosurve si mjet kryesor për një shëndet të mirë fizik e mendor;
14. Të bëhet sa më parë të jetë e mundur furnizimi me medikamente, në mënyrë të veçantë të medikamenteve të urgjencës mjekësore, si edhe të materialeve dentare;
15. Në pamundësi të pajisjes së institucionit me një mjek psikiatër, të shikohet mundësia e pasjes në dispozicion të një mjeku psikiatër të zonës për të kryer vlerësime psikiatrike më të shpeshta dhe më të shumta në numër.

IEVP 313 Tiranë nr. dok. 201302303

Avokati i Popullit në rolin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës, kreu një inspektim të përgjithshëm në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale "Jordan Misja" (313) në Tiranë më dt. 26.09.2013. Në përfundim të këtij inspektimi, pasi u njoh me të gjithë konstatimet e grupit inspektues, si dhe me problematikat e ngritura nga ana e të denuarve dhe paraburgosurve, Avokati i Popullit parashtroi konkluzionet përfundimtare, duke rekomanduar si vijon:

1. Marrjen e masave për mbylljen e këtij paraburgimi, si i papërshtatshëm me standardet e trajtimit të paraburgosurve të parashikuara në legjislacionin kombëtar dhe ndërkombëtar.
2. Marrjen e masave për të ulur mbipopullimin në institucion.
3. Të merren masa për t'u siguruar të paraburgosurve produktet e nevojshme për mbajtjen e higjenës në përputhje me standardet ndërkombëtare.

4. Marrjen e masave të menjëhershme për pajisjen e dhomave të observimit me orënditë e nevojshme me qëllim përmbushjen e respektimit të dinjitetit të të paraburgosurve.
5. Të merren masa për të përshtatur ambiente e për të aktivizuar kurset profesionale e arsimore;
6. Të merren masa për trajnimin mbi vlerësimin me teste, diagnostikimin dhe trajtimin e personave me probleme të shëndetit mendor;
7. Të rritet kapaciteti trajtues me shërbime këshillimore;
8. Të merren masa për plotësimin me profesionalitet të dosjeve;
9. Shtimi sa më parë i një mjeku dhe ndihmësmjeku tjetër;
10. Të pajisen të gjithë të paraburgosurit me librezë shëndetësore si hallka e parë dhe e domosdoshme si për rimbursimin e medikamenteve, ashtu edhe në kryerjen e analizave apo konsultave të tjera mjekësore të specializuara;
11. Të shihet mundësia e vënies në funksion të laboratorit;
12. Të bëhen përpjekje për reduktimin e fenomenit të vonesave në kryerjen e një vizite apo një konsulte mjekësore nëpërmjet filtrimit më të mirë nga ana e personelit të mesëm të ankesave të të paraburgosurve;
13. Të merren masa për kryerjen e një filtri më të mirë të problematikave shëndetësore në Komisionin e Pritjes;
14. Të shtohet numri i konsultave të kryera nga mjeku psikiatër pasi kjo do të ishte më në përputhje me kërkesat e larta për një shërbim të tillë.

IEVP Vlorë nr. dok. 201301783

Avokati i Popullit në rolin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës, kreu një inspektim të përgjithshëm në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale në Vlorë më dt. 12.07.2013. Në përfundim të këtij inspektimi, pasi u njoh me të gjithë konstatimet e grupit inspektues, si dhe me problematikat e ngritura nga ana e të paraburgosurve, Avokati i Popullit parashtrroi konkluzionet përfundimtare, duke rekomanduar si vijon:

Nga inspektimet dhe vizitat e kryera në këtë institucion u konstatuan një sërë problemesh, për të cilat u bënë rekomandimet e mëposhtme:

1. Marrja e masave për eliminimin e lagështirës dhe kryesisht në sektorin 3, me qëllim përmirësimin e kushteve infrastrukturore në pjesët e amortizuara të godinës.
2. Rikonstruktimi i ambienteve të veçimit, observimit dhe tranzitit lidhur me të gjitha mangësitë e hasura në këto ambiente, si dhe krijimin e mundësisë për lejimin e ajrit dhe dritës natyrale nëpërmjet zgjerimit të dritareve nëpër qeli, pa çënuar elementët e sigurisë së institucionit, me qëllim respektimin e të drejtave të të paraburgosurve

konform ligjit dhe eliminimin e pasojave në shëndetin e tyre nga mungesa e ajrit përgjatë qëndrimit në këtë institucion.

3. Marrja e masave për dezinfektimin periodik të institucionit për eliminimin e prezencës së insekteve, me qëllim eliminimin e një epidemie të mundshme si pasojë e mos dezinfektimit në kohë.
4. Furnizimi me produkte higjieno-sanitare në sasi dhe cilësi, lyerja e shtretërve të oksiduar dhe zëvendësimi i enëve të shpërndarjes së ushqimit, me qëllim përmirësimin e kushteve dhe mundësimin e një higjene me parametra bashkëkohorë.
5. Marrja e masave për krijimin e një ambienti takimi për të paraburgosurit me fëmijët e tyre të mitur, me qëllim ofrimin e një ambienti të pranueshëm për fëmijët e mitur përgjatë takimit me prindërit e tyre dhe të përshtatshëm në aspektin psikologjik.
6. Spostimi i aparatit telefonik jashtë kollonës së punonjësit të regjimit, me qëllim sigurimin e privatësisë për të paraburgosurit përgjatë komunikimit të tyre.
7. Përmirësimi i infrastrukturës së ambientit të shërbimit shëndetësorë dhe stomatolog, me qëllim arritjen e standardeve të kërkuara dhe përmirësimin e shërbimit që ofrohet ndaj kësaj kategorie.

Nga përgjigja e ardhur u informuam se rekomandimet u mirëpritën dhe do të merren të gjitha masat për zbatimin e tyre.

IEVP Tepelenë nr. dok. 201301782

Avokati i Popullit në rolin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës, kreu një inspektim të përgjithshëm në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale në Tepelenë më dt. 17.07.2013. Në përfundim të këtij inspektimi, pasi u njoh me të gjithë konstatimet e grupit inspektues, si dhe me problematikat e ngritura nga ana e të dënuar dhe paraburgosurve, Avokati i Popullit parashtrij konkluzionet përfundimtare, duke rekomanduar si vijon:

1. Të merren masa për mbështetje me bazë materiale e financiare për të mundësuar realizimin e aktiviteteve e veprimtarive me karakter edukativ, social, artistik, kulturor e fetar në I.E.V.P. Tepelenë.
2. Të vihet sa më shpejt në funksionim skema e marrëveshjes trepalëshe e rimbursimit të medikamenteve.
3. Të merren masa për përmirësimin e punës në sektorin e kujdesit social që të mundësohet kryerja e këshillimeve dhe realizimi i temave sociale, si dhe që të mundësohet rritja e bashkëpunimit me institucione, me qëllim rehabilitimin e të paraburgosurve.
4. Të evitohet mbipopullimi në sektorin e paraburgimit në këtë IEVP pasi ka mungesa të shumta infrastrukurore çka rëndon edhe situatën shëndetësore të tyre.
5. Të plotësohet organika me psikolog;

6. Të kryhen trajnime për stafin psiko-social me qëllim rritjen e kapaciteteve për trajtim profesional veçanërisht të grupeve vulnerabël;
7. Të parashikohet një ambient i dedikuar për trajtimin psikoterapeutik të të dënuarve;
8. Drejtuesit e këtij institucioni të kërkojnë zbatimin e kohës së punës në bazë të kontratës që kanë me mjekun, stomatologun, ndihmësmjekun farmacist .
9. Të bëhen përpjekjet e duhura për vendosjen e një mjeku me kohë të plotë në këtë institucion.
10. Të merren masa për përmirësimin e shërbimit dentar.
11. Të merren masa të menjëhershme për furnizimin e të paraburgosurve me produkte te domosdoshëm higjeno-sanitare (përveç sapunit)
12. Të merren masat e nevojshme për riparimin dhe vënien ne kapacitet të plotë të dusheve me ujë të ngrohtë në institucion.
13. Të merren masat e nevojshme për ndarjen në sektor të veçantë të paraburgosurve të grup-moshës 18-21 vjeçare, për të evituar kryerjen e aktiviteteve të përbashkëta me të paraburgosurit madhorë.

IEVP Sarandë nr. dok. 201301781

Avokati i Popullit në rolin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës, kreu një inspektim të përgjithshëm në Institucionin e Paraburgimit Sarandë, më dt. 13.07.2013. Në përfundim të këtij inspektimi, pasi u njoh me të gjithë konstatimet e grupit inspektues, si dhe me problematikat e ngritura nga ana e të paraburgosurve, Avokati i Popullit parashitroi konkluzionet përfundimtare, duke rekomanduar si vijon:

1. Gjetjen e fondeve për ndërtimin rishtas të IEVP-së Sarandë në kushtet e standardet e përcaktuara nga kuadri ligjor në fuqi.
2. Deri në marrjen e kësaj mase, të krijohet mundësia që nëpërmjet një fondi të sigurohet një bolier uji të ngrohtë për kuzhinën si një mjet i domosdoshëm për ruajtjen e higjenës dhe shmangien e sëmundjeve.
3. Të merren masa për mbështetje me bazë materiale e financiare për të mundësuar realizimin e aktiviteteve e veprimtarive me karakter edukativ, social, artistik, kulturor e fetar në I.E.V.P.
4. Të vihet sa më shpejt në funksionim skema e marrëveshjes trepalëshe e rimbursimit të medikamenteve.
5. Të merren masa për përmirësimin e punës në sektorin e kujdesit social që të mundësohet kryerja e këshillimeve dhe realizimi i temave sociale, si dhe që të mundësohet rritja e bashkëpunimit me institucione, me qëllim rehabilitimin e të paraburgosurve.

6. Të evitohet mbipopullimi në këtë IEVP pasi ka mungesa të shumta infrastrukturore çka rëndon edhe situatën shëndetësore të tyre.

Për qëndrimin dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor sipas nenit 22 të Ligjit Nr. 8454 dt.04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit".

IEVP Tropojë nr. dok. 201301488

Avokati i Popullit në rolin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës, kreu një inspektim të përgjithshëm në Institucionin e Paraburgimit Tropojë, më dt. 22.06.2013. Në përfundim të këtij inspektimi, pasi u njoh me të gjithë konstatimet e grupit inspektues, si dhe me problematikat e ngritura nga ana e të paraburgosurve, Avokati i Popullit parashtrroi konkluzionet përfundimtare, duke ju rekomanduar si vijon:

1. Të kryhen riparimet dhe ndryshimet e nevojshme për të mundësuar kalimin sa më të shpejtë të të paraburgosurve në ambientet e reja të IEVP Tropojë.
2. Të aktivizohen kurse të formimit arsimor e profesional.
3. Të merren masa për mbështetje me bazë materiale e financiare për të mundësuar realizimin e aktiviteteve e veprimtarive me karakter edukativ, social, artistik, kulturor e fetar.
4. Të gjenden modalitetet që marrëveshja tre palëshe për medikamentet të funksionojë dhe në IEVP- të cilat janë të vendosura në zona ku nuk ka depo farmaceutike.

IEVP Kukës nr. dok. 201301487

Avokati i Popullit në rolin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës, kreu një inspektim të përgjithshëm në Institucionin e Paraburgimit Kukës, më dt. 20.06.2013. Në përfundim të këtij inspektimi, pasi u njoh me të gjithë konstatimet e grupit inspektues, si dhe me problematikat e ngritura nga ana e të paraburgosurve, Avokati i Popullit parashtrroi konkluzionet përfundimtare, duke referuar si vijon:

1. Të merren masa që të aktivizohen kurse të formimit arsimor e profesional;
2. Të merren masa për mbështetje me bazë materiale e financiare për të mundësuar realizimin e aktiviteteve e veprimtarive me karakter edukativ, social, artistik e kulturor;
3. Të nxitet bashkëpunimi me OJF dhe organizma të tjerë me karakter fetar e rehabilitues;
4. Të shikohet mundësia e mbajtjes së dyerve të brendshme të hapura, kur këto nuk bien ndesh me kërkesat e sigurisë;
5. Të të zgjidhet sa më shpejt mungesa e mjekut pasi pa mjekun rrezikohet kujdesi shëndetësor, nuk ka skemë të rimbursimit të ilaçeve, nuk ka vlerësim mjekësor në momentin e pranimit;
6. Të krijohen kushte më të mira higjienike, ajrosje, dritë për një shëndet më të mirë fizik e mendor;

7. Te merren masat e nevojshme që të pajisen dhomat shëndetësore me orenditë dhe pajisjet e nevojshme.

Në përfundim, bazuar në kushte e konstatuara në monitorimin e kryer në vizitën pararendëse, në kushtet e konstatuara në këtë vizite, në progresin apo mundësinë për progres në arritjen e standardeve, si dhe në bisedën me drejtues të institucionit në fjalë, grupi i monitorimit arrin në konkluzionin se kjo IEVP është tejet e amortizuar dhe kushtet e saj dëmtojnë shëndetin fizik dhe mendor të të parburgosurve, çënojnë dinjitetin njerëzor të tyre, dhe, në kushtet kur nuk ka asnjë mundësi që këto të korrigojnë, rekomandohet mbyllja e kësaj IEVP-je dhe shpërndarjen e të parburgosurve në vend parburgim të tjera të afërta.

IEVP Elbasan nr. dok. 201301200

Avokati i Popullit në rolin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës, kreu një inspektim të përgjithshëm në Institucionin e Parburgimit Elbasan, më dt. 14.05.2013. Në përfundim të këtij inspektimi, pasi u njoh me të gjithë konstatimet e grupit inspektues, si dhe me problematikat e ngritura nga ana e të parburgosurve, Avokati i Popullit parashtrori konkluzionet përfundimtare, duke rekomanduar si vijon:

1. Marrjen e masave të menjëhershme nga DPB për lehtësimin e numrit të të parburgosurve në këtë institucion.
2. Marrja e masave për rregullimin me furnizimit me ujë të rrjedhshëm, duke përdorur depozita për mbajtjen e ujit apo edhe hapjen e puseve.
3. Rekomandohet marrja e masave për vendosjen e një telefoni fiks dhe adaptimin e një ambienti për dush, në dispozicion për dhomat e observimit.
4. Instalimi urgjent në zonën e daljes në ajrim, në katin e parë, ndërmjet godinës 1 dhe 2, tek shkallët e kamerave të nevojshme të sigurisë.
5. Marrja e masave për rregullimin e menjëhershëm të sistemit të aspirimit në ambientet e dusheve. Këto rregullime t'i kërkojnë firmës që ka bërë ndërtimin, përpara se të merret në dorëzim ambienti.
6. Marrjen e masave të nevojshme për riparimin e stolave të dëmtuar në disa dhoma të parburgimit.
7. Vënia në dijeni e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve lidhur me çështje të trajtimit ligjor për të parburgosurit e punësuar, e konkretisht lidhur me detyrimin për pagesë, për regjistrimin e tyre në sigurimet shoqërore, për respektimin e të drejtës për pushim të pandërprerë 24 orësh një dite në javë, etj.
8. Mbajtja e dosjeve psiko-sociale të të parburgosurve në dollape me çelës.
9. Të shikohet mundësia për të krijuar bashkëpunime me OJF e institucione të tjera që veprojnë në zonën e Elbasanit për të ofruar shërbime e aktivitete plotësuese për të parburgosurit.
10. Krijimi i një ambienti të përshtatshëm nga ana psiko-sociale në dhomën e takimit të të parburgosurve me fëmijët e tyre.

11. Plotësimin e palestrës me pajisjet e nevojshme dhe vënien në funksion të saj sa më shpejt.
12. Zbatimi i Marrëveshjes së Bashkëpunimit me MASH për zhvillimin e kurseve arsimore në I.E.V.P. Elbasan.
13. Të zhvillohen sesione trajnimi mbi çështje të shëndetit mendor për sistemin e burgjeve për stafin psiko-social.
14. Që mjeku të jetë me kohë të plotë në këtë IEVP
15. Shtimi me së paku një ndihmësmjek në organikë për tu përdorur në raste mungesash apo lelesh të ndihmësmjekëve të tjerë.
16. Vendosja e një marrëveshjeje bashkëpunimi institucional me spitalin rajonal për të pasur akses për të gjitha llojet e konsultave, ekzaminimeve apo analizave të domosdoshme.
17. Të shqyrtohet mundësia e punësimit me kohë të pjesshme të një mjeku psikiatër.
18. Vënia në funksionim i kujdesit stomatologjik i cili mungon në institucion.
19. Të bëhet më shumë përpjekje për sigurimin e medikamenteve për të paraburgosurit nga vetë institucioni dhe në një kohë sa më të shkurtër, duke e bërë më të funksionueshme marrëveshjen trepalëshe për rimbursimin e medikamenteve.

IEVP Berat nr. dok. 201301035

Avokati i Popullit në rolin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës, kreu një inspektim të përgjithshëm në Institucionin e Paraburgimit Berat, më dt. 03.05.2013. Në përfundim të këtij inspektimi, pasi u njoh me të gjithë konstatimet e grupit inspektues, si dhe me problematikat e ngritura nga ana e të paraburgosurve, Avokati i Popullit parashtron konkluzionet përfundimtare, duke ju rekomanduar si vijon:

1. Marrjen e masave të nevojshme për përfundimin dhe vënien në efikasitet sa më shpejt të godinës së re të paraburgimit në Berat.
2. Marrjen e masave të menjëhershme për lehtësimin e mbipopullimit të paraburgosurve në këtë institucion duke bërë një shpërndarje të tyre në institucione të tjera dhe transferimin e menjëhershëm të të dënuarve me vendim gjyqësor të formës së prerë nga ambienti i paraburgimit në ambientet e burgimit.
3. Marrjen e masave të menjëhershme për ruajtjen në kushte frigoriferike të kampioneve të ushqimit.
4. Marrjen e masave të nevojshme lidhur me trajtimin ligjor për të paraburgosurit e punësuar, e konkretisht lidhur me detyrimin për pagesë, për regjistrimin e tyre në sigurimet shoqërore, për respektimin e të drejtës për pushim të pandërprerë të paktën 24 orë në javë.
5. Marrjen e masave të nevojshme për krijimin e kushteve të përshtatshme për trajtimin psiko-social të të paraburgosurve;

6. Marrjen e masave të nevojshme për trajnimin e personelit për hartim planesh të përshtatshme terapeutike;
7. Marrjen e masave të nevojshme për krijimin e kushteve për ruajtjen korrekte të të dhënave personale psiko-sociale të të paraburgosurve;
8. Marrjen e masave të nevojshme për krijimin e kushteve për fillimin e kurseve profesionale e arsimore;
9. Marrjen e masave të nevojshme për mirëmbajtjen dhe sistemimin e librave;
10. Marrjen e masave të nevojshme për krijimin e një fondi për plotësimin e nevojave bazike për higjenë e veshmbathje për personat në nevojë dhe pa mbështetje financiare;
11. Marrjen e masave të nevojshme për funksionimin e skemës së furnizimit me medikamente mjekësore me qëllim që administrimi i tyre të jetë funksional dhe më i shpejtë;
12. Marrjen e masave të nevojshme për transferimin e të sëmurëve mendorë në institucione të specializuara për të paraburgosur të tillë;
13. Marrjen e masave të nevojshme për të bërë të mundur punësimin e një mjeku psikiatër me kohë të pjesëshme pasi nevojat për vlerësimet e tij janë në rritje sidomos në kushtet aktuale të kësaj IEVP-je;
14. Marrjen e masave të nevojshme për përmirësimin e kujdesit dentar në institucion;
15. Marrjen e masave të nevojshme për pajisjen e dhomave ekzistuese që përdoren për vizitë dhe trajtim mjekësor me orenditë dhe mjetet e domosdoshme për të dhënë një shërbim të tillë.

IEVP Lezhë nr. dok. 201300723

Avokati i Popullit në rolin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës, kreu një inspektim të përgjithshëm në IEVP Lezhë, më dt. 20.03.2013. Në përfundim të këtij inspektimi, pasi u njoh me të gjithë konstatimet e grupit inspektues, si dhe me problematikat e ngritura nga ana e të burgosurve dhe paraburgosurve, Avokati i Popullit parashtrori konkluzionet përfundimtare, duke rekomanduar si vijon:

1. Marrjen e masave të menjëhershme për rregullimin e telave të korrentit të paizoluara dhe instalimin e prizave në ambientet e dhomave, si dhe të dusheve. I.E.V.P. Lezhë, paraqitet me neglizhencë në marrjen e masave për sigurimin e jetës dhe shëndetit të të paraburgosurve, në kuadër të mosmarrjes së masave lidhur me vendosjen e prizave e izolimeve të telave dhe në vendet e çelësave, si edhe të dusheve të të paraburgosurve, të cilat në kushtet e vërejtura paraqesnin rrezik për jetën dhe shëndetin e të paraburgosurve.
2. Marrjen e masave të menjëhershme për mbulimin e të gjithë seksioneve me aparate telefoni fiks në mënyrë që të krijohet mundësia për respektimin e numrit të telefonatave dhe akses në përdorimin e tyre nga të paraburgosurit. Problematike

paraqitej situata në lidhje me respektimin e standardit të komunikimit telefonik me familjarët, e konkretisht mundësia e kushtet e ofruara nga institucioni, për respektimin e këtij standardi.

3. Marrjen e masave të menjëhershme për sigurimin si të ujit të rrjedhshëm 24 orë në dite, ashtu edhe të energjisë elektrike 24 orë në ditë. U konstatua furnizimi me orar të reduktuar si me ujë të rrjedhshëm, ashtu edhe me energji elektrike. Kjo mangësi së bashku me mospajisjen me mjete të higjenës personale si shampo, pastë dhëmbësh, etj e detergjent e mjete pastrimi, qese plehrash, etj. mjete si këto, tregojnë se institucioni i I.E.V.P. Lezhë në planin e krijimit të kushteve për respektimin e higjenës së përbashkët dhe të asaj personale, paraqitet me probleme. Në kuadër të respektimit të standardeve në lidhje me higjenën personale, u konstatua se ambientet e duheve ekzistojnë, por ishin përgjithësisht jo funksionale, çka përbënte një standard tjetër të shkelur nga ana e këtij institucioni.
4. Bërjen prezent përpara Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve të situatës së mbipopullimit në institucion duke i kërkuar asaj marrjen e masave për lehtësimin e numrit të të paraburgosurve nëpërmjet transferimit dhe shpërndarjes së tyre në institucione të tjera paraburgimi. Një nga problemet më shqetësuese në këtë institucion ka qenë dhe mbetet ende në përmasa shqetësuese, mbipopullimi, i cili sjell jo vetëm shkelje të standardit të sipërfaqes e kurbaturës për person, por edhe rrezikon jetën dhe shëndetin duke përdorur krevate 3 katëshe, apo duke u detyruar të flenë për tokë.
5. Verifikimin e menjëhershëm të personave në listën e punësimit dhe plotësimin e saj edhe me personat që realisht punojnë, por nuk figurojnë si të tillë. Verifikimin e menjëhershëm të ditëve të punës për secilin nga të punësuarit, transparencën e ditëve të punës për secilin nga të punësuarit, një detyrim ky i institucionit. Të vihet në dijeni Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve lidhur me çështje të trajtimit ligjor për të paraburgosurit e punësuar, e konkretisht lidhur me detyrimin për pagesë, për regjistrimin e tyre në sigurimet shoqërore, për respektimin e të drejtës për pushim të pandërprerë 24 orë një ditë në javë, etj.. U konstatuan shkelje në lidhje si me mos përfshirjen e personave që punojnë në listat e të punësuarve, ashtu edhe me mostrajtimin financiar të tyre. Gjithashtu, vlerësohet si diskriminim trajtimi i të paraburgosurve të punësuar, të cilët i nuk përfitojnë njësoj si të punësuarit e lirë të drejtat që burojnë nga Kodi i Punës dhe Ligji për Sigurimet Shoqërore.
6. Krijimin e një seksioni të veçantë për të paraburgosurit e moshës 18-21 vjeçare. Në këtë institucion u konstatua se nuk kishte një sektor të veçantë për grup moshën 18-21 vjeçare dhe se kjo grupë moshë detyrohej të banonte e të kryente aktivitetet e përbashkëta së bashku me grup moshën e të paraburgosurve të rritur që banonin në të njëjtin sektor.
7. Rikonstruktimin e ambienteve të brendshme pasi mungesa e prizave, xhamat e thyer, etj., paraqesin rrezikshmëri për jetën e të paraburgosurve.
8. Krijimin e një mjedisi të brendshëm për palestër.
9. Mundësimin një fondi të posaçëm për bazë materiale me qëllim lehtësimin e organizimit të aktiviteteve me natyrë rehabilituese e sportive.

10. Plotësimin e organikës me psikologë.
11. Kryerjen e trajnime për stafin mbi shënimet në dosje dhe planet e trajtimit.
12. Pajisjen e menjëhershme me medikamente të urgjencës mjekësore.
13. Ndryshimin e kushteve të ambientit të spitalit duke e bërë atë të dallueshme nga pjesa tjetër e I.E.V.P.-së.
14. Pajisjen e dhomës së mjekut dhe infermierisë me mobiliat dhe materialet e tjera të duhura mjekësore, për të pasur një ambient të përshtatshëm për të kryer vizitën dhe manipulimet mjekësore.
15. Funksionim më i mirë i skemës së rimbursimit të barnave, pasi kishte vonesë në furnizimin me medikamentet.
16. Pajisjen e kësaj I.E.V.P.-je me një autoambulancë tjetër pasi ajo aktuale ishte e papërshtatshme.
17. Funksionim më i mirë i Komisionit të Pritjes.

IEVP Durrës nr. dok 201300442

Avokati i Popullit në rolin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës, kreu një inspektim të përgjithshëm në Institucionin e Paraburgimit Durrës, me dt 07.02.2013. Në përfundim të këtij inspektimi, pasi u njoh me të gjithë konstatimet e grupit inspektues, si dhe me problematikat e ngritura nga ana e të paraburgosurve, Avokati i Popullit parashtroj konkluzionet përfundimtare, duke rekomanduar si vijon:

1. Marrjen e masave të menjëhershme për identifikimin e personave nga radhët e punonjësve të sigurisë, të cilët kanë ushtruar dhunë ndaj të paraburgosurve dhe nuk kanë raportuar ngjarjen tek eprorët e tyre dhe në regjistrat përkatës, gjithashtu marrjen e masave disiplinore ndaj tyre sipas ligjit;
2. Rritjen e aksesit të transparencës nga ana e të paraburgosurve, kjo jo vetëm nëpërmjet garantimit të se drejtës për ankesë, por edhe nëpërmjet punës këshilluese të punonjësve sociale e atyre të edukimit;
3. Marrjen e masave të menjëhershme për mbulimin e ambienteve jashtë fokusimit të kamerave të sigurisë me kamera vëzhguese, me qëllim transparencën e veprimeve të punonjësve të sigurisë;
4. Marrjen e masave për sigurimin e ujit të rrjedhshëm 24 orë në ditë, nëpërmjet përdorimit të depozitave të ujit dhe motor-pompës, ose të hapjes së puseve brenda në institucion; Kërkimi ose përdorimi i një fondi me zë të veçantë, për shpenzime për këtë qëllim;
5. Vënien në funksionim të kaldajës, si dhe të dusheve, të cilët në shumicën e rasteve ishin jashtë funksionit;

6. Gjetjen e menjëhershme të zgjidhjes për të paraburgosurin, i cili nuk realizonte të drejtën e tij të ajrimit, duke i realizuar atij ajrimin në një kohë të ndryshme nga ajo e sektorit ku ai banonte, ose zhvendosjen e tij në një sektor tjetër me qëllim shmangien e konflikteve;
7. Verifikimin e menjëhershëm të personave në listën e punësimit dhe plotësimin e saj edhe me personat që realisht punonin, por nuk figuronin si të tillë. Verifikimin e ditëve të punës për secilin nga të punësuarit, transparencën e ditëve të punës për secilin nga të punësuarit, nga ana e institucionit;
8. Kryerja e trajnimeve për stafin psiko-social me qëllim rritjen e kapaciteteve për trajtim profesional dhe dokumentim korrekt në dosje;
9. Përmirësimi i programeve individuale të trajtimit për personat e kategorive vulnerabël;
10. Rishpërndarje e shërbimeve të ofruara: Shërbimi i psikologut duhet të kenë mundësinë që të mbikëqyrin procesin e hartimit të planeve të ndërhyrjes nga specialistët e tjerë me qëllim sigurimin e shërbimeve sa më profesionale dhe efektive;
11. Mundësimi i një fondi nga institucioni për mjete didaktike e sportive si dhe për pajisjen e klasave;
12. Pajisja e kësaj IEVP-je me aparaturë dentare;
13. Plotësimi me mjekë specialistë psikiatër.
14. Plotësimi i organikës me psikologë sipas parashikimit në organikë;

IEVP Lushnje nr. dok. 201300587

Avokati i Popullit, në rolin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës në mbështetje të nenit 19/1 të Ligjit nr.8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, inspektoi në datën 27 Shkurt 2013, I.E.V.Penalë Kosovë Lushnjë.

Në përputhje me procedurën e zhvillimit të monitorimit, grupi monitorues zhvilloi fillimisht takimin me drejtorin e institucionit dhe i komunikoi atij qëllimin e vizitës. Nga ana e drejtorit të këtij institucioni u shpreh gatishmëri për të realizuar të gjitha kërkesat e grupit monitorues. Në vijim, u zhvilluan konsultime me Shefin e Policisë të Burgut, Shefin e Regjimit të Brendshëm të IEVP-së, Shefin e Logjistikës si dhe me zyrtarë të tjerë të këtij institucioni. Grupi monitorues kontaktoi privatisht me personat e privuar nga liria, inspektoi të gjitha ambientet ku ata qëndrojnë, si dhe u njoh me të gjithë dokumentacionin e pasqyruar në regjistrat dhe aktet përkatëse.

Në përfundim të këtij inspektimi, pasi u njoh me të gjithë konstatimet e grupit inspektues, si dhe me problematikat e ngritura nga ana e të paraburgosurve, Avokati i Popullit parashtraj konkluzionet përfundimtare, duke rekomanduar si vijon:

1. Marrjen e masave të nevojshme për të ulur nivelin e mbipopullimit në institucion dhe respektimin e standardit në hapësirën jetike për çdo të dënuar në m² dhe m³.

2. Marrjen e masave për eliminimin e lagështirës në dhoma, kuzhinë dhe në gjithë godinën në tërësi, si dhe lysterjen e ambienteve me qëllim përmirësimin e kushteve konform standardeve të kërkuara.
3. Riparimin në vazhdimësi të pajisjeve hidrosanitare në të gjitha ambientet e kësaj IEVP-je.
4. Marrjen e masave për kryerjen e dezinfektimit në të gjitha ambientet, me qëllim parandalimin e një epidemie të mundshme dhe mundësimin e një higjence me parametra bashkëkohore.
5. Plotësimin e skemës së monitorimit, nëpërmjet vendosjes së kamerave në të gjitha ambientet që aktualisht janë të pamonitoruara.
6. Vendosjen e posterave me të drejtat e të dënuarve, në të gjitha ambientet e këtij institucioni.
7. Plotësimin me të gjitha medikamentet e nevojshme të kutisë së ndihmës së shpejtë.
8. Zëvendësimin e pajisjeve akomoduese në ambientet ku ofrohet shërbimi shëndetësor, si dollape, karrige, tavolina, etj.
9. Marrjen e masave për ripozicionimin dhe riparimin e kaldajës së ngrohjes qendrore në institucion.
10. Marrjen e masave për ndërtimin e ambienteve të kultit me qëllim që tu krijohet mundësia të dënuarve për të ushtruar ritet fetare.
11. Marrjen e masave për paisjen e institucionit me autoambulancë për transportin e të dënuarve të sëmurë.
12. Marrjen e masave për mbulimin me strehë të një pjese të ambienteve të ajrimit, me qëllim funksionimin e tyre dhe në rastet kur moti është me reshje, apo me temperatura të larta.
13. Marrjen e masave për pasurimin e bibliotekës së këtij institucioni me tituj të rinj librash
14. Marrjen e masave për furnizimin me materialet e nevojshme për riparim dentar.
15. Marrjen e masave nga ana e DPB për ekzaminim të specializuar të katër të dënuarve pranë kësaj IEVP-je, për të cilët nga kjo e fundit është paraqitur kërkesë zyrtare.

IEVP Korçë nr. dok. 201301156

Avokati i Popullit, në rolin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës në mbështetje të nenit 19/1 të Ligjit nr.8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, inspektoi në datat 15-16 Prill 2013, IEVP Korçë.

Në përfundim të këtij inspektimi, pasi u njoh me të gjithë konstatimet e grupit inspektues, si dhe me problematikat e ngritura nga ana e të paraburgosurve, Avokati i Popullit parashtron konkluzionet përfundimtare, duke rekomanduar si vijon:

1. Marrjen e masave të menjëhershme për eliminimin e rasteve të ushtrimit të dhunës ndaj shtetasve të dënuar/paraburgosur nga punonjësit e policisë së burgjeve.
2. Marrjen e masave të menjëhershme për përmirësimin e cilësisë së ushqimit për të dënuarit dhe paraburgosurit.
3. Marrjen e masave për krijimin e një dhome të veçantë për takime me fëmijë të mitur.
4. Marrjen e masave me qëllim vendosjen e një aparati telefonik në ambientin e veçimit dhe në sektorin 2 të paraburgimit të këtij institucioni.
5. Marrjen e masave për të siguruar që të gjithë të dënuarit e të paraburgosurit, të jenë të pajisur me sasinë e mjaftueshme të produkteve bazë të higjenes personale (përfshirë pastë dhëmbësh, furçë dhëmbësh, shampo, etj.) si edhe me materialet e nevojshme për të pastruar dhomat e tyre.
6. Përmirësimin e shërbimeve psikologjike dhe pasqyrimin në dosje të ndërhyrjeve të ofruara për të burgosur/paraburgosur ish përdorues të lëndëve narkotike, me prapambetje apo me probleme të shëndetit mendor, si dhe në drejtim të burgosur/paraburgosurve që nuk kanë kontakte me familjarët.
7. Marrjen e masave për mbulimin me strehë të një pjese të ambienteve të ajrimit, me qëllim funksionimin e tyre dhe në rastet kur moti është me reshje, apo me temperatura të larta.
8. Plotësimin e skemës së monitorimit, nëpërmjet vendosjes së kamerave në të gjitha ambientet që aktualisht janë të pamonitoruara.
9. Vendosjen e posterave me të drejtat e të dënuarve, në të gjitha ambientet e këtij institucioni.
10. Ndërprerjen e menjëhershme të kryerjes së ajrimit të të paraburgosurve në ambiente të mbyllura dhe nxjerrjen e tyre në ajër të pastër.
11. Reduktimin e orarit të punës deri në masën e zbatimit të dispozitave përkatëse të Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë, të të dënuarve/paraburgosurve të punësuar në këtë institucion.

IEVP Peqin nr. dok. 20131483

Avokati i Popullit, në rolin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës në mbështetje të nenit 19/1 të Ligjit nr.8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, inspektoi në datën 06.06.2013, IEVPenale Peqin.

Në përfundim të këtij inspektimi, pasi u njoh me të gjithë konstatimet e grupit inspektues, si dhe me problematikat e ngritura nga ana e të paraburgosurve, Avokati i Popullit parashtron konkluzionet përfundimtare, duke rekomanduar si vijon:

1. Marrjen e masave për eliminimin e mbipopullimit në IEVP Peqin.
2. Përcaktimin dhe publikimin e kapacitetit zyrtar akomodues të ambienteve të paraburgimit në IEVP Peqin.

3. Funksionimin e ambienteve të observimit, në përputhje me misionin ligjor të ekzistencës së tyre.
4. Marrjen e masave për prezencën më të shpeshtë të stafit mjek/ ndihmësmjek brenda rregjimit të IEVP-së.
5. Mbajtja në vëmendje për fillim vitin 2014, të problematikës së furnizimit me vonesë me medikamente nga depo farmaceutike e kontraktuar aktualisht, me qëllim kontraktimin e një subjekti të tillë në distance më të afërt me këtë IEVP.
6. Marrjen e masave të menjëhershme për përmirësimin e cilësisë së ushqimit për të dënuarit dhe paraburgosurit.
7. Ruajtjen në kompone figuriferike të ushqimit për banorët me regjim ushqimor të kushtëzuar për shkak të sëmundjeve, si diabetikët, etj.
8. Marrja e masave të menjëhershme për shtimin e numrit të EC të përbashkëta në katër sektorë të Sigurisë së Lartë ku nuk ka EC në dhomat e banimit, riparimin e pajisjeve hidrosanitare aktualisht të prishura në këto ambiente, si dhe vënien në funksion të të gjithë dusheve në paraburgim.
9. Marrja e masave në lidhje me furnizimin me ujë të rrjedhshëm 24 orë.
10. Marrjen e masave për krijimin e një dhome të veçantë për takime me fëmijë të mitur.
11. Marrjen e masave për të siguruar që të gjithë të dënuarit e të paraburgosurit, të jenë të pajisur me sasinë e mjaftueshme të produkteve bazë të higjenes personale (përfshirë pastë dhëmbësh, furçë dhëmbësh, shampo, etj.) si edhe me materialet e nevojshme për të pastruar dhomat e tyre.
12. Marrjen e masave për pajisjen e dhomave të banimit në ambientet e paraburgimit me dollapë për mbajtjen e rrobave.
13. Marrjen e masave për mbulimin me strehë të një pjese të ambienteve të ajrimit, me qëllim funksionimin e tyre dhe në rastet kur moti është me reshje, apo me temperatura të larta.
14. Plotësimin e skemës së monitorimit, nëpërmjet vendosjes së kamerave në të gjitha ambientet që aktualisht janë të pamonitoruara.
15. Vendosjen e posterave me të drejtat e të dënuarve, në të gjitha ambientet e këtij institucioni.

IEVP Krujë nr. dok. 201301718

Avokati i Popullit, në rolin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës në mbështetje të nenit 19/1 të Ligjit nr.8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, inspektoi në datën 26.07.2013, IEVP Krujë.

Në përfundim të këtij inspektimi, pasi u njoh me të gjithë konstatimet e grupit inspektues, si dhe me problematikat e ngritura nga ana e të paraburgosurve, Avokati i Popullit parashtrij konkluzionet përfundimtare, duke rekomanduar si vijon:

1. Sistemimin e menjëhershëm të personave me probleme të shëndetit mendor që mbahen në burg në kundërshtim me ligjin, në pavione psikiatrike që administrohen nga Ministria e Shëndetësisë, deri në ngritjen e institucioneve të posaçme mjekësore sipas përcaktimit të ligjit.
2. Rikonstruktionin tërësor të godinës së IEVP Zahari Krujë.
3. Plotësimin urgjent të organikës me dy mjek psikiatër.
4. Pajisjen e IEVP me automjet autoambulancë.
5. Vënien në funksion të linjës së re të furnizimit me energji elektrike, si dhe rikonstruktionin e linjës së brendshme të furnizimit me energji.
6. Marrjen e masave për furnizimin me ujë 24 orë.
7. Vendosjen e posterave me të drejtat e të dënuarve, në të gjitha ambientet e këtij institucioni.
8. Marrjen e masave për krijimin e një dhome të veçantë për takime me fëmijë të mitur.
9. Mbulimin me strehë të një pjesë të ambienteve të ajrimit.

IEVP Burrel nr. dok. 201301772

Avokati i Popullit, në rolin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës në mbështetje të nenit 19/1 të Ligjit nr.8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, në datën 27.06.2013 inspektoi IEVPenale Burrel.

Në përfundim të këtij inspektimi, pasi u njoh me të gjithë konstatimet e grupit inspektues, si dhe me problematikat e ngritura nga ana e të paraburgosurve, Avokati i Popullit parashtron konkluzionet përfundimtare, duke rekomanduar si vijon:

1. Marrjen e masave për riparime, mirëmbajtje, eliminim lagështire dhe lyerje të dhomave të të dënuarve.
2. Përmirësimin e ambienteve të përbashkëta të jetesës duke kryer sa më parë riparimet e nevojshme të banjove në sektorin e sigurisë së lartë, në mënyrë të veçantë eliminimin e lagështirës, tubacionet e prishura, kokat e dusheve, ndriçueset dhe lidhjet elektrike sipas standardeve të sigurimit teknik.
3. Përmirësimin e furnizimit me ujë të pijshëm nga degëzimi i ujës-jellësit në sektorë duke zgatur kohën e furnizimit me ujë
4. Marrjen e masave për përmirësimin e cilësisë së ushqimit.
5. Marrjen e masave për të siguruar që të gjithë të dënuarit të jenë të pajisur me sasinë e mjaftueshme të produkteve bazë të higjenes personale (përfshirë pastë dhëmbësh, furçë dhëmbësh, shampo, etj.) si edhe me materialet e nevojshme për të pastruar qelitë e tyre.

6. Vijimësinë e marrjes së masave të nevojshme për arsimimin e detyruar të personave analfabet dhe atyre që nuk kanë përfunduar arsimin e detyruar.
7. Marrjen e masave të nevojshme për të siguruar trajtim mjekësor në institucion me kohë të plotë.
8. Sigurimin e ngrohjes në sektorët sipas standardeve të parashikuara në rregulloren e burgjeve.
9. Sigurimin dhe vënien në përdorim të një ambienti për ushtrimin e besimeve fetare nga të dënuarit.
10. Përmirësimin e ambienteve të takimeve me familjarët dhe krijimin e një dhome të veçantë për takime me fëmijë të mitur.
11. Përmirësimin e shërbimeve psikologjike dhe pasqyrimin në dosje të ndërhyrjeve të ofruara.

IEVP Mine Peza nr. dok. 201302441

I.E.V.P. "Mine Peza" (302), Tiranë, u inspektua nga ekspertët e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës në datë 27 shtator 2013. Në përfundim të këtij inspektimi, pasi u njoh me të gjithë konstatimet e grupit inspektues, si dhe me problematikat e ngritura nga ana e të paraburgosurve, Avokati i Popullit parashtrij konkluzionet përfundimtare, duke rekomanduar si vijon:

1. Marrja e masave për ulje të mbipopullimit në këtë IEVP konsiderohet urgjente, ndër të tjera edhe për shkak se Infrastruktura e IEVP 302, "Mine Peza", nuk është fleksibël për akomodimin e përshtatshëm në dhoma të personave mbi kapacitetin zyrtar.
2. Marrjen e masave, për eliminimin e lagështirës në ambiente banimi dhe në ambientet e dusheve.
3. Marrjen e masave për përdorimin e ambienteve të veçimit dhe observimit vetëm në funksionet respektive të ekzistencës së tyre.
4. Në zbatim të legjislacionit ndërkombëtar të pranuar nga shteti shqiptar përmes procedurës së ratifikimit, rekomandohet marrja e masave adekuate për krijimin e ambienteve të veçanta për qëndrimin në vete të paraburgosurve të rinj nga ata madhorë.
5. Marrjen e masave për hapjen e njësisë tregtare brenda IEVP-së.
6. Vënien në kushte më funksionuese të skemës së rimbursimit të medikamenteve.
7. Marrjen e masave për plotësimin e të gjithë të paraburgosurve me librezë shëndetësore si elementi kryesor për funksionimin e skemës së rimbursimit të medikamenteve.
8. Marrjen e masave për përmirësimin e higjenës në dhomat e të paraburgosurve, nëpërmjet furnizimit të tyre me produkte larës, si dhe qese mbeturinash.

9. Reduktimin e orarit të punës deri në masën e zbatimit të dispozitave përkatëse të Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë, të të paraburgosurve të punësuar në këtë institucion.
10. Marrjen e masave për krijimin e një dhome të veçantë, ose të përshtatjes së ambienteve ekzistuese për takime me fëmijë të mitur.
11. Plotësimin e skemës së monitorimit, nëpërmjet vendosjes së kamerave në ambjentin që aktualisht është i pamonitoruar.

Problematikat e sistemit penitenciar dalë nga ankesat dhe konstatimet e kryera gjatë inspektimeve në vitin 2013.

Pavarësisht insistimit të Avokatit të Popullit, edhe gjatë vitit 2013 vazhdojnë të mbeten pa zgjidhje problematika të identifikuara për të cilat është theksuar nevoja e ndryshimeve të menjëhershme. Për rrjedhojë, detyrohemi të sjellim përsëri në vëmendjen tuaj problematikat e ngritura edhe në raportin vjetor të vitit 2012 të Institucionit të Avokatit të Popullit, si më poshtë:

-Gjatë vitit 2013 shumë prej burgjeve dhe paraburgimeve në vend vijojnë të vuajnë nga probleme të amortizimit dhe kushteve të papërshtatshme të tyre, veçanërisht të lagështirës (Burgjet 325,313 Tiranë, Rogozhinë, Tepelenë, Lezhë, Kosovë e Lushnjës, Burrel, Paraburgimet Berat, Sarandë, 313 dhe 302 Tiranë), mungesës së ujit, sidomos gjatë periudhës së verës (Burgjet Rogozhinë, Krujë, Paraburgimi Elbasan), kushteve jashtë standardeve të tualeteve, dusheve, ambienteve të ajrimit, dhomave të izolimit, mungesës së ambienteve të edukimit, ushtrimit të riteve fetare, veprimtarisë sportive etj (Burgjet Burrel, Lezhë, Tepelenë, Kosovë e Lushnjës dhe Paraburgimet Sarandë, Berat, 313 dhe 302 Tiranë). Avokati i Popullit ka rekomanduar dhe insiston që të mbyllet burgu i Burrelit, të vazhdojnë të transferohen të sëmurët mendorë nga Burgu Krujë etj, në një institucion të specializuar shëndetësor sipas parametrave dhe standardet përkatëse. Gjatë inspektimeve dhe ri-inspektimeve të kryera gjatë vitit 2013, në të gjitha këto institucione është përsëritur nevoja urgjente për investime kryesisht të pjesshme që do të përmirësojnë ndjeshëm kushtet ekzistuese. Këto probleme janë ngritur shpesh pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, por mendojmë se ato janë një çështje që nuk i takon vetëm këtij institucioni. Nëse kërkojmë përmirësimin e standardeve të të drejtave të njeriut në vend dhe veçanërisht për të dënuarit, Qeveria Shqiptare dhe Ministria e Drejtësisë dhe ajo e Financave duhet të kenë parasysh se ky proces krahas angazhimit kërkon edhe mbështetjen e duhur financiare

- Një nga problematikat kryesore që vijon të mbetet shqetësuese për Avokatin e Popullit është mosgjethja e një zgjidhjeje përfundimtare për strehimin në një ambient spitalor jashtë sistemit të burgjeve të personave që kanë marrë masë nga gjykata për mjekim të detyruar në respektim të ligjit Nr.44 "Për shëndetin mendor" dhe vendimeve të Gjykatave të vendit. Avokati i Popullit e ka ngritur çdo vit këtë çështje dhe nuk është pajtuar me situatën në të cilën ende këta persona mjekohen brenda ambienteve të sistemit të burgjeve. Gjatë vitit 2013, jemi vënë në dijeni se nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë po merren masat që të ndërtojnë një institucion të veçantë për të trajtuar këta persona sipas ligjit, ashtu siç ka

rekomanduar edhe Avokati i Popullit. Ndërtimi i një institucioni të ri sipas standardeve ndërkombëtare do të ishte një zgjidhje ligjore²⁴.

-Një problem tepër serioz që vazhdon të ngrihet në mjaft komunikime konfidenciale me të dënuarit dhe paraburgosurit është ai i korrupsionit në segmente të administratës së burgjeve. Ky korrupsion ka bërë që të pretendohet për cënim të rëndë të të drejtave dhe trajtimit të individëve brenda këtyre institucioneve. Avokati i Popullit megjithëse është përpjekur të verifikojë disa raste të denoncuarra për korrupsion, e ka pasur mjaft të vështirë të mundësojë zbardhjen e së vërtetës. Nisur nga gjetja periodike e sendeve të ndaluara në qeli të veçanta, apo nga trajtimi i pabarabartë që u bëhet disa të dënuarve dhe paraburgosurve në vend, në mënyrë indirekte lihet të kuptohet se korrupsioni në sistemin penitenciar është prezent dhe përbën kërcënim për mbarëvajtjen e trajtimit të të drejtave të individëve të dënuar ose të paraburgosur. Kemi rekomanduar disa herë dhe vazhdimisht që **të hartohen dhe të miratohen një tërësi e qartë dhe e kuptueshme rregullash dhe procedurash që përshkruajnë në detaje rrethanat në të cilat duhet të jepen lejet shpërblyese dhe të veçanta apo procedurat e punësimit dhe pagesave të të dënuarve/paraburgosurve në IEVP.** Këto rregulla dhe procedura duhet të jenë në përputhje të plotë me konventat ndërkombëtare, ligjet dhe aktet e tjera nënligjore të Shtetit Shqiptarë për sistemin e burgjeve.

- Megjithë masat e marra për hapjen e institucioneve të reja të vuajtjes së dënimit, mbipopullimi vijon të mbetet një problem kryesor në burgje. Avokati i Popullit e ka nënvizuar shpesh rëndësinë e uljes së numrit të të dënuarve në burgje, duke respektuar standardet e hapësirës për jetesë, pasi mbipopullimi është shkaku kryesor i amortizimit të ambienteve të burgjeve dhe cilësisë së dobët të shërbimeve ndaj të dënuarve

-Institucioni i Avokatit të Popullit mendon se një vëmendje e veçantë duhet treguar për trajnimin e stafit të burgjeve, lidhur me të drejtat e të burgosurve gjatë grevave të urisë, takimeve me familjarët, kontrolleve të të dënuarve, ambienteve ku jetojnë. Gjithashtu në respekt të dinjitetit të të dënuarve, familjarëve dhe fëmijëve të tyre duhen trajtuar me një rëndësi të veçantë kontaktet e të dënuarit me familjarët dhe fëmijët e tyre të mitur duke sistemuar vende të përshtatshme, pasi në disa burgje ato nuk ekzistojnë. Gjithashtu, kemi rekomanduar disa herë dhe vazhdimisht që **të hartohen dhe të miratohen një tërësi e qartë dhe e kuptueshme rregullash dhe procedurash që përshkruajnë në detaje rrethanat në të cilat duhet të jepen lejet shpërblyese dhe të veçanta apo procedurat e punësimit dhe pagesave të të dënuarve/paraburgosurve në IEVP.** Këto rregulla dhe procedura duhet të jenë në përputhje të plotë me konventat ndërkombëtare, ligjet dhe aktet e tjera nënligjore të Shtetit Shqiptarë për sistemin e burgjeve.

-Rastet e torturës dhe të ushtrimit të dhunës fizike dhe psikologjike ndaj të paraburgosurve dhe të burgosurve nga punonjësit e policisë së burgjeve mbeten fokusi kryesorë i detyrës funksionale të MKPT. Për këtë problem ka pasur disa ankesa, por në tre raste gjatë vitit 2013 janë provuar pretendimet e ankuesve për ushtrim torture nga punonjësit e policisë së burgjeve, si në IEVP Kavajë, Korçë, 313 Tiranë. Për këto raste i është rekomanduar organit të prokurorisë fillimi i hetimeve për veprën penale të torturës dhe veprimeve arbitrare.

Misioni i MKPT është: “Parandalimi” i torturës dhe trajtimit ose dënimit çnjerëzor e degradues duke u fokusuar tek e ardhmja dhe jo tek e shkuara. Sidoqoftë,

²⁴ Me miratimin e ligjit të ri nr. 44/2012 “Për Shëndetin Mendor”, i cili është i standardeve bashkëkohore dhe përgatitjen e nxjerrjen e akteve nënligjore në bazë e për zbatim të tij, besojmë se ky problem shqetësues disa vjeçar do të gjej zgjidhje përfundimtare

pjesë integrale e mandatit parandalues të MKPT është vlerësimi i reagimeve të institucioneve pas konstatimit të rasteve të keqtrajtimit.

Besimi në ndalimin e torturës dhe formave të tjera të keqtrajtimit zhvlerësohet sa herë që punonjësit e policisë që ushtrojnë dhunë nuk vihen para përgjegjësitë për veprimet e tyre. Kur merret informacion për keqtrajtim dhe nuk ka një reagim të menjëhershëm dhe efikas, personat e prirur për të ushtruar dhunë do të mendojnë se nuk do ndëshkohen. Në këtë mënyrë, gjithë përpjekjet për të promovuar parimet e të drejtave të njeriut përmes rekrutimit të merituar dhe trajnimeve profesionale do të tronditen. Dështimi për të ndërmarrë masat e duhura nga kolegët, drejtuesit, dhe autoritetet hetuese, do të ndikojnë në degradimin e vlerave që përbëjnë themelin e shoqërive demokratike.

Në të kundërt, kur punonjësit e burgjeve që urdhërojnë, autorizojnë, lejojnë, apo ushtrojnë dhunë vihen para drejtësisë për veprimet ose mosveprimet e tyre, atëherë jepet një mesazh i qartë se sjellje të tilla nuk do të tolerohen. Përveç respektimit të ligjit, një mesazh i tillë do të siguronte publikun e gjerë se askush nuk qëndron mbi ligjin, madje as ata që janë përgjegjës për zbatimin e tij.

Moslejimi i pandëshkueshmërisë duhet fillojë në çdo institucion. Ndodh shpesh që kolegët ndihmojnë njeri-tjetrin kur ka dyshime për raste keqtrajtimi ose ata tentojnë të mbulojnë veprimet e paligjshme të kolegëve. Duhet ndërmarrë një fushatë ndërgjegjësuese, përmes trajnimeve dhe shembujve personale, në mënyrë që të promovohet një kulturë që e konsideron jo-profesionale dhe pengesë në karrierë mbështetjen dhe mbulimin e akteve të kolegëve që keqtrajtojnë të dënuarit.

Së fundmi, askush nuk duhet të dyshojë në angazhimin e Avokatit të Popullit për të luftuar pandëshkueshmërinë. Ky angazhim do të jetë i pranishëm në çdo nivel. Kur të jetë e nevojshme, MKPT nuk do të hezitojnë të veprojnë edhe përmes deklaratave deri në instancat më të larta politike dhe shtetërore për të dhënë mesazhin e qartë: “tolerancë zero” ndaj ushtrimit të torturës dhe formave të tjera të keqtrajtimit në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale.

Ankesa dhe kërkesa të paraqitura nga të dënuarit dhe të paraburgosurit.

Nga trajtimi i 220 ankesë-kërkesave kanë përfunduar 193 dhe janë në ndjekje 27 prej tyre. Nga të përfunduarat, 51% të rasteve janë zgjidhur në favor, 49% raste të pabazuara.

Objekti i ankesave të ndjekura për vitin 2013 kryesisht ka të bëjë me shkeljen e të drejtave të burgosurve gjatë vuajtjes së dënimit në institucionet e privimit të lirisë dhe që i drejtohen administratës të burgut ose Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve. Ato kanë qenë për përmirësimin e kushteve materiale në burg, për refuzim të padrejtë të kërkesave për leje, për dhënie mase disiplinore të padrejtë, për veprime të kundraligjshme të punonjësve të policisë (dhunë fizike ose psikologjike, veprime poshtëruese, shkelje e privatësisë etj.), refuzim të kërkesës për transferim në një burg tjetër dhe ankesa për shërbimin shëndetësor. Gjithashtu ka patur edhe ankesa ndaj Ministrisë së Drejtësisë për moskthimin e përgjigje të kërkesave të tyre për falje, ndaj organit të prokurorisë për mosllogaritje në dënim të kohës së paraburgimit, si dhe ankesa ndaj gjykatave dhe vendimeve gjyqësore për dënime të padrejta. Ndërkohë ka pasur edhe kërkesa për të dhënë shërbim ligjor falas.

Problematikat e sistemit penitenciar dalë nga shqyrtimi i ankesave individuale

Vështrim i përgjithshëm

Gjatë vitit 2013, janë paraqitur gjithsej 220 ankesa individuale që lidhen me të drejtat e të burgosurve, nga të cilat 193 janë mbyllur dhe 27 janë ende në shqyrtim. Nga rastet e mbyllura 51% kanë rezultuar të pabazuara në ligj dhe 49% janë zgjidhur në favor të ankuesit gjatë shqyrtimit.

Ankesat janë paraqitur nga të burgosurit dhe familjarë të tyre. Të burgosurit mund të na njohin me ankesën e tyre duke na dërguar një letër nëpërmjet postës ose duke na telefonuar në numrin e institucionit. Shërbimi i kontaktit me anë të telefonit është kthyer në një mënyrë e parapëlqyer nga të burgosurit për të paraqitur ankesa, veçanërisht në vitin 2013. Gjatë bisedës telefonike, punonjësi i Zyrës të Avokatit të Popullit do të sqarojë detajet e ankesës për të përcaktuar nëse ajo është ose jo kompetencë e institucionit. Nëse ankesa është jashtë kompetence, i burgosuri këshillohet për rrugën ligjore që ai duhet të ndjekë. Nëse ankesa pranohet, ajo regjistrohet dhe i burgosuri njoftohet me një shkresë për veprimet që po ndiqen dhe me numrin e punonjësit që po shqyrton rastin. Gjatë orarit zyrtar, i burgosuri mund të telefonojë në numrat e institucionit për t' u siguruar që ankesa e tyre ka mbërritur. Falë programit elektronik të regjistrimit të ankesave i burgosuri vihet në dijeni në një kohë të shkurtër.

Siç do të mund të lexoni më poshtë, objekti i ankesave është i larmishëm. Disa ankesa mund të duken pa peshë por, duhet të kemi parasysh se të burgosurit kanë pak pavarësi në jetën e tyre dhe në këto kushte, edhe një shqetësim i vogël mund të ketë pasoja të mëdha. Megjithatë secila ankesë e pranuar pasqyron një situatë individuale. Numri më i madh i ankesave ka të bëjë me cilësinë e shërbimit shëndetësor; moskthim përgjigje kërkesës për të përfituar leje të veçantë; refuzim i kërkesës për të përfituar leje shpërblyese; moslirim për arsye të plotësisimit të dënimit; mbajtje e padrejtë në dhomën e veçimit; moskthim përgjigje kërkesës për t' u transferuar në një institucion tjetër; refuzim i kërkesës për tu transferuar në një institucion tjetër për asye shëndetësore dhe të afërsisë me vendbanimin e familjes; masë disiplinore e padrejtë; cilësia e ushqimit; mungesë e ngrohjes.

Analiza e rasteve konkrete

Punësim në burg është një kontribut i rëndësishëm në rehabilitimin e të burgosurve dhe në përgatitjen e tyre për t' u integruar në shoqëri. Punësimi ndikon pozitivisht tek të burgosurit edhe në forma të tjera. Për shumë prej tyre të ardhurat nga punësimi do të shërbenin për të blerë kartat telefonike për të folur me familjarët dhe miqtë dhe artikuj të tjerë si ushqime, detergjentë etj. Pa këto të ardhura, është e lehtë që një i burgosur të futet në borxh duke sjellë edhe pasoja. Puna gjithashtu i jep të dënuarve një ndjenjë disipline dhe qëllimi, ndërsa të burgosur të papunësuar i kalojnë ditët të mbyllur në dhomat e tyre duke shkaktuar mërzi dhe izolim.

Megjithëse puna e të burgosurve duhet të paguhet, kjo e drejtë e tyre vazhdon të mos zbatohet për shkak të mos nxjerrjes së akteve nënligjore. Në lidhje me shpërblimin e punës të të burgosurve, më datë 04.03.2013 i është dërguar rekomandim Ministrisë së Drejtësisë, ku është kërkuar hartimi i projekt vkm-së për përcaktimin e kriterëve të shpërblimit të punës të të burgosurve dhe dërgimin e tij sa më parë për miratim në

Këshillin e Ministrave. Aktualisht jemi në pritje të përgjigjes nga Ministria e Drejtësisë. Të burgosurit duhet të vuajnë dënimin në një institucion sa më afër vendbanimit të familjes. Të burgosurit shpesh pretendojnë se, kërkesa për t'u transferuar në një institucion që ndodhet afër vendbanimit të familjes pranohet vetëm nëse ke mundësi financiare të paguash për të përfituar këtë të drejtë. Nga hetimi i ankesave për moskthim të përgjigjes për kërkesën për transferim ose për refuzim të saj ka rezultuar se, disa prej tyre janë zgjidhur gjatë shqyrtimit të rastit, domethënë DPBurgjeve ka qenë në procedurën e vlerësimit të kërkesës dhe i burgosuri është transferuar në institucionin e dëshiruar. Në disa raste i burgosuri nuk është transferuar për shkak të mbipopullimit të institucionit ku ka kërkuar të transferohet.

Burgjet duhet të jenë vende të disiplinuar me rregulla të qarta në mënyrë që të burgosurit dhe punonjësit e burgjeve të dinë kufijtë ligjor të veprimeve të tyre. Disa masa disiplinore të dhëna ndaj të burgosurve për shkelje kanë qenë objekt ankese.

Kur marrin në shqyrtim një ankesë për masë disiplinore të padrejtë, roli i Institucionit të Avokatit të Popullit nuk është të rivlerësojë faktet por, të sigurojë që procedura e ndjekur të jetë e drejtë. I burgosuri duhet të dalë para Këshillit Disiplinor, të dëgjohet dhe të njihet me shkrim për arsyet e masës së dhënë. Nga rastet shqyrtuara ka rezultuar se kjo procedurë është respektuar.

Një pjesë e mirë e të dënuarve do të kthehen të lirë në shoqëri. Në dritën e këtij fakti është e domosdoshme të bëhen përpjekje për të siguruar që të dënuarit të kenë të lehtë rikthimin në liri. Gjatë vuajtjes së dënimit të burgosurit kanë humbur autoritetin e vendimmarrjes për veprime të përditshme si, koha kur të hanë, të flenë dhe të flasin. Për një person që lirohet pas një periudhe të gjatë dënimi, dalja në shoqëri mund të jetë e vështirë sidomos kur nuk ke mbështetjen e familjes. Një rol të rëndësishëm në këtë kalim luan e drejta e të dënuarit për të përfituar leje shpërblyese. Kjo leje disa ditore i jep mundësi të dënuarit të rikrijojë kontaktet e humbura. Refuzimi i kërkesës për leje shpërblyese ka qenë objekt i disa ankesave të shqyrtuara nga Institucioni i Avokatit të Popullit. Në rastet e ankesave të të dënuarve për leje shpërblyese dhe leje të veçantë, Institucioni i Avokatit të Popullit nuk mund të ndërhyjë për të dhënë ose jo leje, por vetëm për të verifikuar procedurën e shqyrtimit të këtyre kërkesave. Nga hetimi i këtyre rasteve ka rezultuar se arsyeja e refuzimit të tyre ka qenë mungesa e besueshmërisë lidhur me qëndrimin e të dënuarit jashtë institucionit. Institucioni nuk ka pasur garanci se jeta dhe shëndeti i të dënuarit nuk do të cënohej gjatë lejes ose i dënuari mund të cënonte jetën dhe shëndetin e të tjerëve. Për të vlerësuar këtë mundësi institucioni ka marrë informacion nga policia e shtetit dhe familjarët e të dënuarit.

Konkluzione

Është detyrë e institucioneve shtetërore që të marrin masa për rehabilitimin e të burgosurve nëpërmjet punësimit të tyre, programeve dhe shërbimeve. Meqenëse puna luan një rol të rëndësishëm në rehabilitimin e të burgosurve, është një përfundim logjik që duhet të përdoret çdo përpjekje për të nxitur punësimin në burgje dhe puna e kryer të paguhet. Mungesa e përgjigjes deri më sot për rekomandimin e bërë për shpërblyimin e punës të të burgosurve tregon se vullneti mungon.

Për sa i përket bashkëpunimit me Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve dhe drejtoritë e burgjeve mund të themi se ky bashkëpunim vazhdon të jetë i frytshëm. Në disa raste ka pasur vonesa në kthimin e përgjigjeve nga drejtoritë e burgjeve, gjë që mund të shpjegohet me periudhën paszgjedhore.

Inspektimet e kryera gjatë vitit 2013 në Qendrat Spitalore

Kuadri ligjor mbi bazën e të cilit Mekanizmi ka ushtruar rolin e tij për respektimin e dispozitave ligjore sipas përkatësisë institucionale është, ligji Nr.8432, datë 14.12.1998 “Për Azilin në Republikën e Shqipërisë”, VKM Nr. 589 datë 28.08.2003 “Për ngritjen dhe vënien në funksion të Qendrës Kombëtare Pritëse të Viktimave të Trafikimit”, ligji Nr. 44/2012 “Për Shëndetin Mendor”, ligji Nr. 10107 datë 30.03.2009 “Për Kujdesin Shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në bazë të Nenit 74/1, pika a, të Ligjit Nr.9888 dt. 10.03.2008 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr.8328, dt. 16.04.1998 i ndryshuar “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të të paraburgosurve”.

Inspektimet me tematika të planëzuara, janë kryer nga Avokati i Popullit, në Qendrat Spitalore të Shëndetit Mendor, Qendrën Spitalore të Burgjeve Tiranë, dhe Paraburgimet për të mitur. Në këto institucione janë evidentuar problematikat lidhur me kushtet dhe mënyrën e trajtimit të shtetasve nga administrata dhe stafi përgjegjës në përputhje me dispozitat ligjore sipas fushës përkatëse.

Gjithashtu është monitoruar mënyra funksionale e strukturës institucionale si dhe kushtet infrastrukturore.

Një rol specifik luan dhe trajtimi i ankesave të shtetasve ndaj institucioneve të lartpërmendura duke ndjekur dhe verifikuar hap pas hapi procedurën e realizuar nga këto institucione në zgjidhjen përfundimtare të ankesës në favor të shtetasve.

Në fokus të përmbushjes së misionit të tij kushtetues, Avokati i Popullit ndjek respektimin dhe zbatimin e ligjit mbi institucionet e lartpërmendura si vijon;

-Plotësimi i të gjitha kushteve sipas dispozitave ligjore për personat me probleme të shëndetit mendor dhe trajtimi i tyre me profesionalizëm nga stafi mjekësor, dhe kryesisht rehabilitimi i tyre me terapi psiko-sociale, si specifike për këto funksione. Monitorimi i segmenteve të caktuara në këto institucione ku aplikohet terapia intensive si procedura për rastet e veçanta në lidhje me kufizimin fizik, mënyrat e përdorimit të forcës me mjetet e standardizuara dhe ambientet në të cilat praktikohet kjo procedurë, si dhe forma e shtrimit të detyrueshëm dhe të pavullnetshëm, konform ligjit dhe procedurave të ndjekura. Përmirësimi i kushteve në ambientet e rikreacionit për fëmijët me prapambetje mendore, me të gjitha mjetet e nevojshme për rehabilitim psiko-social intensiv, me qëllim përshkallëzimin e gjendjes së mëparshme dhe ndryshimin gradual të tyre në raport me diagnostikimin fillestar.

-Respektimi me korrektësi i dispozitave ligjore në Institucionet e Ekzekutimeve të Vendimeve Penale për meshkuj, femra dhe të mitur, në lidhje me kushtet dhe trajtimin e tyre të parashikuar në ligjin Nr.9888 dt 10.03.2008 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr.8328, dt 16.04.1998, i ndryshuar “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të të paraburgosurve”, për kujdesin shëndetësor ndaj tyre, kuotat financiare në shërbim të nevojave personale të kësaj kategorie, riaftësimin në jetën sociale me forma punësimi brenda institucionit, angazhimin total në aktivitete shoqërore, shkollimin me arsim për kategori të ndryshme, liçensimin nëpërmjet kurseve profesionale, ndikimin e stafit përgatitor kujdestar për të mundësuar rehabilitimin shoqëror të tyre etj.

Problematikat e konstatuara gjatë inspektimeve në Qendrat e Shëndetit Mendor, Spitalin infektiv në Tiranë dhe Qendrën Spitalore të Burgjeve.

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës, ka kryer inspektime dhe kontrole tematike në Qendrat Spitalore të Shëndetit Mendor, Qendrën Spitalore Infektive pranë QSUT-së, Qendrën Spitalore të Burgjeve Tiranë.

Inspektimet në Qendrat Spitalore, Qendrat Sociale, kanë një rol të madh në evidentimin e problematikave në këto institucione lidhur me kushtet dhe mënyrën e trajtimit të shtetasve në përputhje me dispozitat ligjore sipas fushës përkatëse. Rëndësia e këtij procesi qëndron jo vetëm në respektimin dhe zbatimin e ligjit për të drejtat dhe liritë e individit në këto institucione, por dhe për mënyrën funksionale të strukturës institucionale si dhe kushtet infrastrukturore në ambientet e këtyre institucioneve.

Gjithashtu për arritjen e këtij procesi një rol specifik është trajtimi me rigorozitet nga MKPT i ankesave të shtetasve në lidhje me të gjitha institucionet e lartpërmendura.

Avokati i Popullit gjatë inspektimeve të kryera dhe të monitorimit në institucionet e shëndetit mendor konstaton se edhe pse kushtet fizike në mjediset e disa spitaleve ishin përmirësuar, ato nuk përmbushnin standardet dhe mbeteshin me problematikën e mungesës së stafit. Në inspektimet e Spitaleve Psikiatrike në shkallë vendi ndër vite konstatohet se një numër i konsiderueshëm pacientësh të cilët qëndrojnë në këto institucione prej një periudhe tejet të gjatë kohore. Kryesisht prezenca e këtyre pacientëve ndihet në Spitalin Psikiatrik Vlorë dhe Elbasan, ku numri i tyre varion deri në 130 shtetas. Pjesa më e madhe e këtyre pacientëve janë të braktisur nga familjarët dhe nuk janë kronik-akut, por i përkasin rasteve me prapambetje mendore apo epileptikë. Edhe pse ligji për Shëndetin Mendor nuk parashikon institucionalizimin apo qëndrimin e përhershëm të tyre në këto institucione, nga strukturat përkatëse nuk ka ambiente të posaçme për këto raste tejet specifike. Gjithashtu rekomandimet përmbajnë pika mbi rishikim të buxhetit dhe aspektit organizativ të sistemit të kujdesit të shëndetit mendor në vend.

Mbipopullimi në Spitalin e Vlorës është një problem në të cilin rëndon dhe përfshirja e shtetasve të sëmurë mendorë të braktisur nga familjarët e tyre ndër vite. Është rekomanduar dhënia e fondeve për ndërtimin e Spitalit Psikiatrik në Vlorë. Investimi ka filluar dhe godina të reja po ndërtohen në perimetrin e spitalit ekzistues. Ndërtesat ekzistuese në këtë institucion janë jashtë standardit dhe të amortizuara nga lagështira, infrastruktura e papërshtatshme, rrjetet hidrike dhe kanalizime të amortizuara etj.

Edhe pse janë ndërtuar 2 godina me rolin e shtëpizave-rehabilituese në Vlorë, përsëri nuk plotësojnë nevojat e prurjeve të reja, pasi kapaciteti i tyre arrin deri në 30 pacientë. Aktualisht ka vështirësi në realizimin e deinstitutionalizimit të pacientëve kronik, pasi Qendrat Rehabilituese nuk ofrojnë kapacitetin dhe stafin përkatës në raport me numrin e pacientëve. Për pasojë një numër i konsiderueshëm i pacientëve janë të shtruar në spitalet psikiatrike dhe qëndrimi i gjatë në këto institucione dëmtojnë mundësinë për përmirësim apo rehabilitim.

Nga inspektimet e kryera, në institucionet ku trajtohen persona me aftësi të kufizuar mendore, është vënë re dhe është rekomanduar për mungesë të mjeteve shtrënguese (të fiksimit) bashkëkohore dhe protokolleve të përdorimit të tyre, ambiente konform specifikave për kryerjen e terapive intensive, mungesë të stafeve task-forcë për rastet emergjente, mungesë në raportin mjek-pacient, infermier-pacient dhe kujdestar-pacient, mungesë të programeve rehabilituese dhe riintegruese me aktivitete brenda dhe jashtë institucionit.

Problematika të konstatuara dhe të trajtuara nga MKPT në rekomandimet përkatëse janë, trajnimet afat-mesme dhe afat-gjata për stafin kujdestar dhe infermier, krijimi i një regjistri të posaçëm për pasqyrimin e shtrimeve të pavullnetshme dhe kryesisht për procesin e trajtimit mjekësorë në fazën e 48 orëshit e më pas, sekretimi dhe plotësimi i të gjitha rubrikave konform ligjit për të gjithë regjistrat, monitorimin periodik të parametrave fizik të pacientëve, problemet dentare.

Gjithashtu ka një mangësi të theksuar në elementët profilaktike - specifikuese dhe kryesisht në atë laboratorik, pasi këto institucione në përbërjen e tyre nuk kanë ambiente laboratorike, ndërkohë që përgjatë terapive intensive ose prurjeve të pacientëve nga jashtë në periudhë krize nevojitet një rezultat i shpejtë i parametrave fizik të pacientëve. Gjithashtu bashkëpunimi i raportit mjek-psikolog për hartimin e një plani trajtimi specifik për çdo pacient është pothuajse inekzistent në çdo spital.

Pacientët që trajtohen në Qendrën Spitalore të Burgjeve, kanë pothuajse të njëjtat problematika, por këto pacientë vuajnë ndjeshëm mundësimin e aktiviteteve të ndryshme rehabilituese dhe ri-integruese. Specifika e institucionit nuk mundëson lehtësimin e qëndrimit në "gjendje shtrati", pasi zbatohet Rregullorja e Përgjithshme e Burgjeve në praktikën ditore. Problemet infrastrukturore dhe ato financiare të reduktuara ndër vite, ndikojnë ndjeshëm në përmirësimin e kushteve të jetesës për pacientët duke pasur parasysh që godina ekzistuese është e amortizuar dhe pasojat e saj ndikojnë në shëndetin e pacientëve. Gjithashtu mungesa e stafit ndikon në disa sektorë si (kujdestarë, social, rehabilitues, infermieror etj), si dhe në rastet e paraplegjikëve që trajton ky institucion.

Problematikat e konstatuara për vitin 2013 në inspektimet e kryera në Qendra Spitalore, Qendra e Azilkërkuesve, Qendra e Viktimave të Trafikut, Instituti i të Miturve Kavajë, janë pasqyruar me rekomandimet si më poshtë;

Nr.Dok.201301766 (ende në proces shqyrtimi)

Inspektim në Qendrën Spitalore të Burgjeve në Tiranë

Gjatë vizitës monitoruese në Qendrën Spitalore të Burgjeve në Tiranë, përfaqësuesit e Institucionit të Avokatit të Popullit, morën kontakt me drejtuesit e institucionit për të ezauruar një bisedë paraprake mbi gjendjen aktuale në QSB, si dhe të dhëna mbi kapacitetin, organikën e institucionit etj. Më pas u zhvillua vizita monitoruese në të gjitha ambientet dhe kryesisht në pavionet femra/meshkuj, dhomat e mjekëve, infermieritë, kuzhina, observacion, ambientet e ajrimit, ambientet ku zhvillohen aktivitetet psiko-sociale etj.

Gjatë inspektimit u zhvilluan takime me pacientët e të gjitha pavioneve, nga të cilët u referuan problematika të ndryshme, të cilat janë trajtuar nga Institucioni i Avokatit të Popullit si ankesa. Gjithashtu u bë këqyrja e kartelave klinike të pacientëve dhe e dosjeve psiko-sociale me qëllim vlerësimin e trajtimit dhe gjendjes së tyre shëndetësore dhe psikologjike.

Pas monitorimit përfaqësuesit e Avokatit të Popullit zhvilluan takimin përfundimtar me drejtuesit e institucionit dhe stafit mjekësor, për të konkluduar mbi konstatimet gjatë inspektimit të cilat u pasqyruan në rekomandimin përkatës:

-Marrjen e masave për sigurimin dhe shtimin e fondeve të nevojshme për rikonstruksionin e ambienteve të QSB duke eliminuar të gjitha problematikat e konstatuara në infrastrukturë dhe kryesisht të lagështirës, si dhe eliminimin e problematikave në jetën

e përditshme të pacientëve që lidhen me pamjaftueshmërinë financiare që konstatohet në këtë qendër nga reduktimi ndër vite i buxhetit të tij.

-Marrjen e masave për krijimin e menjëhershëm të një ambienti takimi për pacientët me familjarët e tyre me parametra bashkëkohor, me qëllim respektimin e të drejtave konform legjislacionit në fuqi dhe trajtimin e tyre sipas standardeve të kërkuara gjatë kurimit në këtë institucion.

- Marrjen e masave për sigurimin e një autoambulance me standarde bashkëkohore dhe eliminimin e transportimit të pacienteve me mjetin aktual, me qëllim shmangien e situatave shëndetësore të padëshiruara gjatë transportimit të tyre me pamundësinë për intervent emergjent.

- Marrjen e masave për krijimin e menjëhershëm dhe vënien në funksionim të dhomës së veçantë të observimit për rastet e diagnostikuara me probleme të shëndetit mendor me masa izolimi.

- Marrjen e masave për trajnimin e stafit rehabilitues dhe kryesisht atë psiko-social, me qëllim përmirësimin e cilësisë së shërbimit me të gjitha programet e duhura (riaftësuese, riintegruese) dhe kryesisht të shërbimit kundrejt pacientëve me probleme të shëndetit mendor. Ndryshimin e praktikës së deritanishme për kryerjen e të gjitha aktiviteteve sociale gjatë kohës së ajrimit dhe kryerjen e tyre jashtë kësaj kohe.

-Krijimin e programeve specifike në orare të përshtatshme, me qëllim përmirësimin e kushteve për rehabilitimin dhe ndikimin pozitiv në nivel psiko-social, për të dënuarit dhe të paraburgosurit (specifikisht të rasteve që trajtohen me mjekim të detyruar) dhe shfrytëzimin e kohës konform rregullores së institucionit për eliminimin e qëndrimit të kësaj kategorie për një kohë të gjatë të mbyllur në ambientin e tyre.

- Marrjen e masave për lyerjen e shtretërve të oksiduar, furnizimin me veshmbathje për pacientët në nevojë, mundësimin e kryerjes së pastrimit higjieno-vetjak në ambientet ku ofrohet ky shërbim sipas nevojave të tyre personale, me qëllim përmirësimin e kushteve në dobi të pacientëve që trajton kjo qendër.

- Marrjen e masave për trajnimin e stafit infermier dhe kujdestar me qëllim ofrimin e një shërbimi sa me profesional, kryesisht ndaj personave me probleme të shëndetit mendor si pacient në numër dominues në këtë qendër dhe të atyre me aftësi të kufizuar.

Nr.Dok.201302376 (ende në proces shqyrtimi)

Inspektim në Spitalin Psikiatrik Civil në Vlorë

Gjatë vizitës monitoruese në Spitalin Psikiatrik në Vlorë, përfaqësuesit e Institucionit të Avokatit të Popullit, morën kontakt me drejtuesit e institucionit dhe zhvilluan një bisedë paraprake mbi gjendjen aktuale në këtë institucion, si dhe u morën të dhëna mbi kapacitetin, organikën e institucionit, gjendjen aktuale të pavioneve, ecuria e punimeve të godinës së re etj. Më pas u zhvillua vizita monitoruese në të gjitha ambientet dhe kryesisht në repartet ku trajtohen pacientët kronik dhe akut (femra/meshkuj), repartin e pranimit, dhomat e mjekëve, infermieritë, ambientet e ngrënies, ambientet e 2 Shtëpizave, ambientet ku zhvillohen aktivitetet psiko-sociale, dushet dhe tualetet etj.

Gjatë inspektimit u zhvilluan takime me pacientët e të gjitha pavioneve, si dhe u këqyrën kushtet që ofroreshin në dhomat e tyre dhe në ambientet e jashtme. Gjithashtu u bë verifikimi i rasteve me shtrim të pavullnetshëm dhe respektimi i procedurave konform ligjit të shëndetin mendor, si dhe u verifikuan rastet e prurjeve të reja në këtë institucion.

Pas monitorimit përfaqësuesit e Avokatit të Popullit zhvilluan takimin përfundimtar me drejtuesit e institucionit dhe stafit mjekësor, për të konkluduar mbi konstatimet gjatë inspektimit të cilat u pasqyruan në raportin e inspektimit me rekomandimet përkatëse:

-Përfundimin brenda afatit të caktuar të godinës së re, si dhe shmangien e shtimit të pacientëve në të gjitha repartet e spitalit dhe kryesisht në repartin e pranimit, duke bashkëpunuar me spitalin rajonal për rastet jo-specifike (narkotik/alkoolik), me qëllim lehtësimin sadopak të gjendjes së krijuar në Spitalin Psikiatrik në Vlorë, pasi kushtet aktuale në godinat ekzistuese ku strehohet edhe pjesa më e madhe e pacientëve të këtij spitali, lënë për të dëshiruar.

- Marrjen e masave për shtimin e stafit psiko-social dhe krijimin e personelit task-forcë për pavionet me mbipopullim, për rastet specifike që kanë nevojë të prezencës së kujdestarisë, me qëllim ofrimin e një shërbimi dhe përkujdesjeje ndaj pacientëve brenda standardeve të kërkuara.

- Marrjen e masave për sigurimin e të gjithë pacientëve femra/meshkuj me veshmbathje stinore dhe kryesisht dimërore, si dhe mundësimin e ngrohjes së ambienteve ku ata qëndrojnë, me qëllim eliminimin e situatave të padëshiruara me pasojë në shëndetin e kësaj kategorie.

- Lëvrimin e fondeve për ti mundësuar këtij spitali një repart pranimi me të gjitha pajisjet profilaktike (laborator, mjete shtrënguese, aparaturat kardio-vaskulare,etj) konform specifikës së shërbimit bazuar në kriteret mjekësore për shëndetin mendorë, me qëllim ofrimin e një shërbimi dinjitoz dhe profesional sipas standardeve të kërkuara, me qëllim respektimin dhe përmirësimin e kushteve mjekësore dhe jetësore gjatë rehabilitimit të kësaj kategorie pacientësh.

-Marrjen e masave për ndërhyrjen e menjëhershme në përmirësimin e gjendjes së krijuar në repartin e femrave mbi të gjitha problematikat e referuara (higjenë,veshmbathje,staf), me qëllim trajtimin e tyre me dinjitet dhe profesionalizëm, si dhe evitim e situatave të padëshiruara në këtë repart me pasojë epidemike dhe shëndetësore.

Nr.Dok.201301401(nuk kanë marrë përgjigje).

Vizitë monitoruese në Spitalin Infektiv në QSUT Tiranë

Gjatë vizitës monitoruese në Spitalin Infektiv në QSUT Tiranë, përfaqësuesit e Institucionit të Avokatit të Popullit, kontaktuan me shefin e shërbimit të spitalit infektiv për zhvilluar një bisedë paraprake mbi gjendjen aktuale në këtë institucion, si dhe u morën të dhëna mbi kapacitetin, organikën e institucionit, gjendjen aktuale të pavioneve, investimet e reja, aparaturat, etj. Më pas u zhvillua vizita monitoruese në të gjitha ambientet dhe kryesisht në repartet ku trajtohen pacientët me sëmundje të rënda infektive dhe kryesisht në ambientin ku trajtohen pacientët me virusin HIV. Gjithashtu u vizituan ambientet

karantinë në të cilat ishte adaptuar sistemi 24 orësh "Spitali Ditor" për emergjencat civile, Klinikën Ambulatore, dhomat e mjekëve, infermieritë, dushet dhe tualetet etj.

Gjatë inspektimit u zhvilluan takime me pacientët e të gjitha pavioneve të cilët u shprehën mbi kushtet dhe trajtimin e tyre gjatë qëndrimit në këtë spital. Gjithashtu u bë verifikimi i procedurave të shtrimit të pacientëve sipas referencave diagnostikuese për eliminimin e ri-kontaminimit të tyre gjatë qëndrimit në këtë institucion.

Pas monitorimit përfaqësuesit e Avokatit të Popullit zhvilluan takimin përfundimtar me shefin e shërbimit të spitalit infektiv dhe stafin mjekësor, për të diskutuar mbi konstatimet gjatë inspektimit të cilat janë pasqyruar në raportin e monitorimit së bashku me rekomandimet përkatëse:

- Marrjen e masave të nevojshme për gjetjen e fondeve për të përfunduar e kompletuar konform parametrave mjekësor shërbimin ndaj pacientëve në Klinikën Ambulatore dhe Spitalin Ditor, për kryerjen e rikonstruksionit në pavionin e parë për eliminimin e plotë të lagështirës dhe zgjerimin e ambienteve në Spitalin Infektiv.

- Marrjen e masave me qëllim përmirësimin e kushteve të pacientëve dhe të stafit infermier duke i pajisur me mjete akomoduese të reja dhomat e pacientëve dhe të infermierive të çdo pavioni.

- Marrjen e masave për vënien në funksionim të dusheve duke i pajisur ata me pjesët e nevojshme.

- Marrjen e masave për kalimin definitiv të punonjësve me kontratë në këtë spital dhe shtimin në organikë me punonjës task- forcë për pritjen e emergjencave ambulatore dhe me punonjës sipas sektorëve (barrelëmbajtës, transportues mostrash biologjike, infermier në kabinetin endoskopik dhe fibroskanerit, mjek dhe infermier në Spitalin Ditor, si dhe mjek dhe infermier për Klinikën Ambulatore IST, Hepatitet dhe CO infeksionet).

Nr.Dok.201302307(ende në proces shqyrtimi)

Vizitë monitoruese në Qendrën e Azilkërkuesve

Gjatë vizitës monitoruese në Qendrën e Azilkërkuesve, përfaqësuesit e Institucionit të Avokatit të Popullit, kontaktuan me drejtuesit e kësaj qendre për zhvilluar një bisedë paraprake mbi gjendjen aktuale në këtë institucion, si dhe u morën të dhëna mbi popullimin aktual, prurjet e reja, kapaciteti, organikën e institucionit, gjendjen aktuale të godinave, investimet e reja etj. Më pas u zhvillua vizita monitoruese në të gjitha ambientet dhe kryesisht në ambientet ku qëndrojnë azilkërkuesit, ambientet e ngrënies dhe gatimit, ambientet e aktiviteteve sociale dhe sportive etj. Gjatë inspektimit u zhvilluan takime me azilkërkuesit të cilët u shprehën mbi kushtet dhe trajtimin e tyre gjatë qëndrimit në këtë qendër. Gjithashtu u bë verifikimi i dosjeve psiko-sociale dhe programeve rehabilituese që zhvillohen për këtë kategori.

Pas monitorimit përfaqësuesit e Avokatit të Popullit zhvilluan takimin përfundimtar me drejtuesit e këtij institucioni dhe stafin psiko-social, për të ndarë konstatimet gjatë inspektimit të cilat u pasqyruar në raport inspektimit së bashku me rekomandimet përkatëse:

- *Lëvrimin e fondeve për rikonstruksionin e godinës gjithëpërfshirëse, me qëllim përmirësimin e kushteve të jetesës dhe eliminimin e lagështirës në ambiente, e cila është në nivel shqetësues për shëndetin e azilkërkuesve.*

-Trajtimin e ndihmës financiare mujore të personave që strehon qendra siç përcakton ligji nr 1060, dt.26.01.2009,“Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr 8432, datë 14.12.1998, “Për Azilin në Republikën e Shqipërisë”.

-Krijimin e kushteve financiare për shtimin e numrit të punonjësve me psikolog, kujdestar, mjek ose infermier, si dhe marrjen e masave për krijimin e një ambienti ambulator me qëllim ofrimin e ndihmës së parë mjekësore në këtë qendër.

-Shtimin e kuotës ushqimore dhe implementimin në meny *të ushqimit dietetik për rastet specifike dhe* pajisjen e përfituesve me veshje stinore kryesisht ato dimërore, si dhe pajisjen e qendrës me mjete argëtimi për të miturit.

- Marrja e masave për pajisjen e kësaj qendre me shërbim stomatologjik për çdo përfitues, me qëllim përkujdesjen ndaj tyre konform ligjit, si dhe trajnimin e stafit psikosocial afat-mesëm dhe afat-gjatë.

Nr.Dok.201301402 (ende në proces shqyrtimi)

Vizitë monitoruese në Qendrën Pritëse të Viktimave të Trafikut

Gjatë vizitës monitoruese në Qendrën Pritëse të Viktimave të Trafikut , përfaqësuesit e Institucionit të Avokatit të Popullit, kontaktuan me stafin e kësaj qendre dhe zhvilluan një bisedë paraprake mbi gjendjen aktuale në këtë institucion, si dhe u morën të dhëna mbi numrin e përfituesve, prurjet e reja, kapaciteti, gjendjen aktuale të godinave, investimet e reja etj. Më pas u zhvillua vizita monitoruese në të gjitha ambientet dhe kryesisht në ambientet ku qëndrojnë përfituesit, ambientet e ngrënies dhe gatimit, ambientet e aktiviteteve sociale dhe sportive etj. Gjatë inspektimit u zhvilluan takime me përfituesit të cilët u shprehën mbi kushtet dhe trajtimin e tyre gjatë qëndrimit në këtë qendër. Gjithashtu u bë verifikimi i dosjeve mjekësore dhe psiko-sociale, si dhe programet rehabilituese-riintegruese që zhvillohen nga stafi përkatës për këtë kategori.

Pas monitorimit përfaqësuesit e Avokatit të Popullit zhvilluan takimin përfundimtar me drejtuesit e këtij institucioni dhe stafin psiko-social, për të ndarë konstatimet e dala gjatë inspektimit të cilat u pasqyruan në raportin e inspektimit së bashku me rekomandimet përkatëse.

Marrjen e masave për mundësimin e lëvritit të një buxheti të mjaftueshëm për këtë qendër, lëvrimin e fondeve për riparime dhe punime restauruese, me qëllim eliminimin e problematikave ekzistuese ne godinat ekzistuese (rikonstruksion, mirëmbajtje dhe restaurime), si dhe ofrimin e kushteve të jetesës për përfituesit konform standardeve të përcaktuara në dispozitat ligjore në fuqi.

Marrjen e masave për lidhjen e një marrëveshje me Drejtorinë Rajonale Arsimore Tiranë, për të mundësuar aksesin për edukim të personave të strehuar pranë kësaj qendre të cilët i përkasin moshës së arsimit të detyruar, me qëllim rikthimin e tyre sa parë në procesin mësimor, ndjekjen e arsimit të detyruar dhe vazhdimin e ciklit përkatës, për të mos

humbur vitin shkollor, në përputhje me të drejtën e çdo individi për të përfituar të drejtën e arsimimit falas. Këto masa të shërbejnë edhe për fëmijët e moshës 3-6 vjeç *që gjenden në qendër*.

Të përcaktohen të drejtat dhe detyrat e këtij institucion shtetëror, shërbimet që duhet të ndërmerren ky institucion për t'u siguruar një jetë normale viktimave të trafikut, si dhe statusin, të drejtat dhe detyrat që gëzojnë personat e strehuar pranë kësaj qendre, në përputhje me nenin 6 të Ligjit nr. 90/2012 datë 27.09.2012 "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore".

Marrjen e masave për pajisjen e personave të strehuar me veshmbathjet e munguara (triko, këpucë, pantallona etj), për një trajtim human dhe dinjitoz të tyre.

Marrjen e masave për të shfrytëzuar të gjitha mundësitë për të vënë në funksion këndin e lojërave *për të miturit, për të plotësuar nevojën e tyre për argëtim të paktën brenda ambienteve të qendrës, si dhe për rikthimin në gjendje pune të mjeteve kompjuterike, brenda ambienteve të kësaj qendre*.

Nr.Dok.201300588 (ende në proces shqyrtimi)

Vizitë monitoruese në Institutin e të Miturve në Kavajë

Gjatë vizitës monitoruese në Institutin e të Miturve në Kavajë, përfaqësuesit e Institucionit të Avokatit të Popullit, morën kontakt me drejtuesit e institucionit për të zhvilluar një bisedë paraprake mbi gjendjen aktuale në këtë institucion, si dhe të dhëna mbi kapacitetin, organikën e institucionit, kushtet dhe trajtimi i të miturve etj. Më pas u zhvillua vizita monitoruese në të gjitha ambientet dhe kryesisht në qelitë e çdo të mituri, dushe dhe tualete, klasa mësimore, ambiente këshilluese, ambientet e aktiviteteve psiko-sociale dhe lojërave sportive, ambientet e izolimit, ambientet e punimeve artizanale, dhoma e mjekut dhe e stomatologut, infermiera, kuzhina, ambientet e ajrimit, etj.

Gjatë inspektimit u zhvilluan takime me të miturit e paraburgosur dhe të dënuar, nga të cilët u referuan problematika të ndryshme, të cilat janë trajtuar nga Institucioni i Avokatit të Popullit si ankesa. Gjithashtu u bë këqyrja e kartelave klinike të të miturve dhe e dosjeve psiko-sociale me qëllim mbarëvajtjen e gjendjes së tyre shëndetësore dhe psikologjike, si dhe programet zhvillimore me objekt rehabilitimin dhe riaftësimin e të miturve gjatë vuajtjes së dënimit.

Pas monitorimit përfaqësuesit e Avokatit të Popullit zhvilluan takimin përfundimtar me drejtuesit e institucionit, për të ndarë konstatimet gjatë inspektimit të cilat u pasqyruan në raportin e monitorimit së bashku me rekomandimet përkatëse si vijon:

-Marrjen e masave për shtimin në organikën e institucionit, punonjës të policisë të rolit bazë për mbikëqyrjen e dhomave të izolimit dhe ambienteve gjatë natës, me qëllim ofrimin e një shërbimi sa më cilësor ndaj të miturve, si dhe punësimin e një punonjësi IT part-time për riparimin e mjeteve kompjuterike dhe defekteve të tjera (zilet e emergjencës në dhoma) që mund të çenojnë sigurinë e të miturve në këtë institucion.

- Riparimin sa më parë të dusheve dhe pajisjeve hidrosanitare, sigurimin e produkteve higjeno-sanitarë sipas kuotës mujore të parashikuar në rregulloren e brendshme institucionale, si dhe lysterja e mureve ne sektorët e të miturve dhe në dhomat e tyre, me qëllim ofrimin e kushteve konform standardeve të kërkuara.

- Marrjen e masave për shtimin e një stomatologu në organikën mjekësore, me qëllim mundësimin e këtij shërbimi brenda ambienteve të këtij institucioni, pasi pajisjet për këtë shërbim ndodhen në këtë institucion.

-Sigurimi i mjeteve për zhvillimin e aktiviteteve sportive dhe riparimin e fushës së futbollit me tapetin mbrojtës, me qëllim mosdëmtimin e gjymtyrëve të të miturve gjatë lojës, si dhe trajnimin afat-mesëm dhe afat-gjatë të stafit psiko-social, me qëllim përmbushjen e misionit të tyre kundrejt riintegritimit në shoqëri të të miturve para lirimit të tyre.

-Rishikimi i menysë ushqimore lidhur me larminë e asortimenteve përmbajtës, shtimi i racionit të bukës, përmirësimi i cilësisë së qumështit, si dhe rishikimi i kontratës bankare me subjektin përkatës, me qëllim mos privimin e të miturve nga e drejta për të blerë produkte brenda institucionit ku ata vuajnë dënimin.

-Paisja e të miturve me produkte hotelerike (shtroje, çarçaf etj), si dhe mundësimi me mjete lvanterike çdo sektor ku mungon një e tillë, me qëllim përmirësimin e kushteve të të miturve gjatë qëndrimit në këtë institucion.

-Rishikimi i të gjithë ambienteve të brendshme të cilat nuk monitorohen nga sistemi i kamerave dhe vendosja e monitorëve vëzhgues në to, me qëllim parandalimin e situatave të padëshiruara që çenojnë sigurinë e të miturve.

Inspektive lidhur me verifikimin e përmbushjeve të rekomandimeve të Avokatit të popullit ne vizitat monitoruese 2012. (Follow-up visits)
Inspektim me iniciativë në IEVPenale 313 (sektori i të miturve) në Tiranë, lidhur me verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit ne vizitën monitoruese 2012

- Lysterja e qelive dhe ambienteve në tërësi në regjimin e të miturve dhe femrave në Institucionin e Paraburgimit 313, riparimin e dusheve dhe furnizimin me kosha mbeturinash dhe produkte higjeno-sanitare të çdo qelie, me qëllim përmirësimin e cilësisë jetike dhe higjenës vetjake të personave që gjenden në këto ambiente.*(realizuar)*

- Kryerja e te gjitha restaurimeve në regjimin e femrave dhe eliminimin e lagështirës në qeli, dushe dhe tualete.*(e perealizuar)*

- Përshpejtimi i procesit për pajisjen e qelive të të miturve me mjete akomoduese të reja, si dhe pajisja e këtij regjimi me një sistem qendror ventilues, me qëllim evitimin e temperaturave të larta përgjatë stinës së verës, si dhe pajisjen e shërbimit stomatologjik me produktet e nevojshme për mjekime dentare me qëllim përmirësimin e cilësisë së këtij shërbimi në regjimin për të miturit. *(e perealizuar)*

Inspektimi me iniciativë në IEVPenale 313 (sektori i grave) në Tiranë, mbi zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit ne vizitën monitoruese 2012.

-Eliminimi i lagështirës në qelinë nr.10 dhe shfrytëzimin e mundësisë për largimin nga kjo qeli të paraburgosurat. *(e perealizuar)*

-Hartimin e një plan masash për rimetimin e suvasë, punime rikonstruktive në tualete, eliminimin e kablllove elektrike të pambrojtura dhe zëvendësimin e pllakaveqeramike të thyera. *(realizuar)*

-Instalimin e ventilatorëve të brendshëm, shtimi i një mjeti lavaxterik, paisjen e shërbimit stomatologjik me produkte për riparime. *(e perealizuar)*

Inspektimi me iniciativë në IEVPenale 302 në Tiranë, mbi zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit ne vizitën monitoruese 2012

-Eliminimi i lagështirës kryesisht në sektorin nr 3. *(e realizuar pjesërisht)*

-Rikonstruktimi i ambienteve të veçimit, observimit dhe tranzitit. Krijimi i mundësisë për ndriçim natyral dhe ajrimin nëpërmjet zgjerimit të dritareve të qelive pa çënuar elementët e sigurisë. *(e perealizuar)*

-Kryerjen e dizenfektimit periodik për eliminimin e prezencës së insekteve*(realizuar)*

-Furnizimin periodik me produkte higjeno-sanitarë, lysterjen e shtretërve të oksiduar dhe zëvendësimin e enëve të ushqimit. *(realizuar)*

-Krijimi i një ambienti takimi për të paraburgosurit me të miturit, nxjerrjen e aparatit telefonik nga kollona e punonjësit të regjimit dhe përmirësimi i infrastrukturës së ambientit shëndetësorë dhe stomatolog. *(e realizuar pjesërisht)*

Inspektimi me iniciativë në IEVPenale në Berat, lidhur me verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit ne vizitën monitoruese 2012

. -Përfundimi i godinës së re. *(e realizuar pjesërisht)*

-Riparimi i dusheve, lysterja e ambienteve, furnizimi me produkte higjeno-sanitar, paisjen e qelive me kosha mbeturinash të mbuluar, mbulimi i kutive të shpërndarjes elektrike dhe tendosjen e kablllove elektrik në lartësinë e duhur. *(realizuar)*

-Krijimi i një ambienti social-edukativ, rifreskimi i literaturës bibliotekare dhe shtimi i programeve riintegruese. *(e perealizuar)*

-Shtimi në organikë me personel infermier dhe stomatolog, krijimi i një dhome mjeku dhe përsheptimi i procedurave për Marrëveshjen Tre-palëshe për listën e barnave të rimbursueshëm dhe tërheqjen e medikamenteve. *(e realizuar pjesërisht)*

-Fillimi i implementimit të marrëveshjes për arsimim. *(e realizuar pjesërisht)*

Inspektimi me iniciativë në Qendrën Spitalore të Burgjeve në Tiranë, lidhur me përmbushjen e rekomandimeve të Avokatit të Popullit ne vizitën monitoruese 2012

-Paisjen me produkte higjeno-sanitare në të gjitha repartet. Nderimi i pajisjeve hotelerike, lysterjen e shtretërve të oksiduar dhe riparimin e dusheve. *(realizuar pjesërisht)*

-Krijimi i një dhome të veçantë observimi dhe paisjen me mjete të shtrëngimit fizik, si dhe zgjatja e kordonit të aparateve telefonik dhe shtimi i rampeve për paraplegjikët/tetraplegjikët. *(e realizuar pjesërisht)*

-Përmirësimi i programeve riintegruese dhe riaftësuese, zgjerimi i ambientit të edukimit, plotësimi me mjete literare bibliotekën dhe paisjen me mjete pune për konkretizimin e aktiviteteve rekreative. *(e realizuar pjesërisht)*

-Rishikimi i menysë ushqimore dhe realizimi i një ambienti takimi me familjarët sipas standardeve. *(e perealizuar)*

-Ruajtja e medikamenteve sipas parametrave farmaceutik, plotësimi i medikamenteve të munguara dhe adaptimi i mjekimeve alternative sipas specifikës diagnostifikuese. *(realizuar)*

-Ruajtja e kampionit ushqimor sipas rregullores së burgjeve, sigurimi i një mjete ambulator sipas standardeve dhe evitimi i ekspozimit të mjeteve të forcës nga punonjësit e sigurisë, brenda ambienteve spitalore. *(e realizuar pjesërisht)*

Inspektimi me iniciativë në Spitalin Psikiatrik në Tiranë, lidhur me zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit në vizitën monitoruese 2012 .

-Nderimi i xhamave të dritareve, pajisjeve hotelerike dhe akomoduese, lysterjen e mureve dhe riparimi i problematikave në infrastrukturën e brendshme të pavioneve. *(e perealizuar)*

-Vendosja e dyerve në tualete, paisjen me produkte higjeno-sanitare, mundësimi i ujit të pijshëm 24 orë pa ndërprerje. *(realizuar pjesërisht)*

-Rregullimi i ambientit të ngrënies, krijimi i një hapësire për takime me familjarët në çdo repart, vënien në funksion të alarmit dhe vënien në funksion të ashensorit. *(realizuar pjesërisht)*

-Shtimin e programeve riaftësuese dhe riintegruese dhe pasqyrimin e tyre me axhendë përkatëse. Krijimi i një formulari ankesë-kërkese për pacientët paisjen me mjete për konkretizimin e aktiviteteve psiko-sociale. *(realizuar)*

-Shtimi i personelit infermier, përzgjedhja e personelit task-forcë, trajnimi i stafit në përgjithësi, krijimi i stafit rregullues të brendshëm për riparime etj. *(realizuar pjesërisht)*

-Rishikimi i ambientit observim-izolim sipas standardit, ajrimin e pacientëve për moslënien e tyre gjendje shtrati. *(realizuar pjesërisht)*

-Ruajtja e medikamenteve sipas parametrave farmaceutik, plotësimi dhe sigurimi i medikamenteve të munguara dhe paisja e spitalit me rripa sigurimi. *(e perealizuar)*

-Funksionimi i oborrit tek reparti i të miturve, krijimi i ambientit për prindërit e tyre, sigurimi i mjeteve akomoduese në ambientin e pritjes dhe zgjerimi i repartit për të miturit, pasi është i vetmi në llojin e tij për pacient të mitur në të gjithë vendin. *(realizuar pjesërisht)*

Implementimi i rekomandimeve të Avokatit të Popullit mbi problematikat e evidentuara nga vizitat monitoruese të vitit 2012.

Për problematikat e konstatuara në IEVP-të dhe Spitalin e Burgut, theksojmë se është bërë zbatueshmëria e disa prej pikave të rekomanduara por mbeten problematike çështjet si;

- Infrastruktura jashtë standardit në disa IEVP.
- Trajtimi i problemeve shëndetësore dhe diagnostifikimi i tyre në kohë.
- Shtimi në organikë i stafit psiko-social, psikiatrik, infermieror (QSB).
- Paisja e qelive me mjete ventilimi gjatë stinës së verës.
- Shtimi i programeve rehabilituese dhe rriaftësuese kryesisht në institucionet ku qëndrojnë të miturit.
- Trajnimet e vazhdueshme të stafit shëndetësorë.
- Trajnime afat-gjata për stafin psiko-social
- Krijimi i mundësive për rehabilitimin e personave me probleme të shëndetit mendor në institucionet përkatëse.
- Reduktimi i buxhetit të QSB-së ndër vite.

Për problematikat e konstatuara në Qendrat Spitalore, theksojmë se është bërë zbatueshmëria e disa prej pikave të rekomanduara por mbeten problematike çështjet si;

- Infrastruktura tejet e amortizuar.
- Mungesë stafi në sektorët shëndetësor në raport me numrin e pacientëve që trajtojnë këto institucione (mjek-pacient, infermier-pacient).
- Mungesë e mjeteve shtrënguese dhe ambienteve për ushtrimin e terapive intensive në përputhshmëri me profilaktikën diagnostifikuese.
- Mungesë laboratorike në repartet e pranimit specifikisht të shëndetit mendor dhe stafeve task-forcë të specializuar.
- Mungesë në numër të stafit psiko-social për konkretizimin programeve rehabilituese.
- Qëndrimi në gjendje shtrimi i pacientëve të braktisur nga familjet e tyre me specifike epileptike dhe prapambetje mendore.
- Shtimi në numër i Shtëpizave në shkallë vendi.

Të tilla vizita riinspektuese (follow up visits) lidhur me përmbushjen e rekomandimeve të Avokatit të Popullit për vitin 2012, gjatë vitit 2013 janë zhvilluar gjithsej 29. Në komisariate policie gjithsej 12, në Burgje/ Paraburgime dhe QSB gjithsej 17. Nga tërësia e vizitave riinspektuese (follow up visits) rezulton e njëjta situatë përmbushje e përshkruar në rastet krahasimore të mësipërme.

Rekomandimet me inisiativë, *ad-hoc* dhe legislative: Implementimi i rekomandimeve të Avokatit të Popullit mbi problematikat e evidentuara.

Mbi problematikat e evidentuara në rekomandimet e sipërpërmendura, Zyra e Avokatit të Popullit, në rolin e MKPT, ka monitoruar nga afër përpjekjet për të përmirësuar mangësitë, si dhe për të mbajtur një komunikim dhe bashkëpunim me qëllim përmbushjen e rekomandimeve.

Të gjitha institucionet e përfshira kanë pranuar dhe miratuar problematikat e evidentuara në rekomandimet përkatëse dhe kanë konfirmuar angazhimin për implementimin e tyre. Avokati i Popullit vë në dukje se edhe pse rekomandimet janë pranuar nga institucionet respektive, vetëm një pjesë e tyre është implementuar, ndërkohë që një pjesë e rekomandimeve janë përmbushur pjesërisht ose situata ka ngelur e pandryshuar.

Rekomandimi për IEVP Lezhë nr. dok. 201301595

Rekomandohet analizimi dhe normalizimi i situatës së krijuar në IEVP Shën Koll, sipas problematikave të evidentuara në këtë rekomandim.

Avokati i Popullit pasi u njoh nga media vizive lidhur me grevën e urisë të disa të dënuarve në IEVP Shën Koll, Lezhë, në përmbushje të kompetencave kushtetuese dhe ligjore që rregullojnë veprimtarinë e Institucionit të Avokatit të Popullit, dërgoi menjëherë në vend një grup pune për hetimin administrativ të këtij rasti.

Në përputhje me zhvillimin e procedurave hetimore, grupi i punës fillimisht kreu një takim me Drejtorin e institucionit dhe i komunikoi atij qëllimin e vizitës.

Në vijim, ekspertët e Avokatit të Popullit kanë marrë takim më vete në dhomat respektive me të dënuar të Godinës 2, "Siguri e Zakonshme" të kësaj IEVP-je. Gjatë intervistave, nga ana e këtyre të fundit janë parashtruar një sërë problematikash, të cilat renditen më poshtë:

-Ndikimi nga ana e administratës së IEVP Shën Koll për të votuar një subjekt të caktuar politik.

-Kufizimi i orarit të ajrimit për të dënuarit e Godinës 2, "Siguri e Zakonshme", të IEVP Shën Koll, Lezhë.

-Cilësia e ulët e Ushqimit

-Mbipopullimi.

Nga të dhënat e administruara me stafin drejtues të IEVP Shën Koll, rezulton se kapaciteti zyrtar i Sigurisë së Zakonshme është 411 persona, ndërkohë që aktualisht banojnë 432 të dënuar. Në fakt gjatë intervistave me të dënuar banues në godinën e lartpërmendur, mbipopullimi vërehet nëpërmjet përdorimit të krevateve me tre kate, apo qëndrimit në dhoma me kubaturë jashtë parametrave të përcaktuar në Rregulloren e Drejtorisë së Përgjithshme së Burgjeve²⁵, ku strehoheshin deri 5 të dënuar.

Për sa më sipër, u rekomandua:

-Fillimi i procedurës administrative për marrjen e masës disiplinore ndaj Drejtorit të I.E.V.Penale Shën Koll, z. Kastriot Piroli, për shkak të vendosjes nga ana e funksionarit publik të burimeve njerëzore të administratës publike në favor të një subjekti të caktuar politik.

- Marrjen e masave për mospërsëritjen në çdo lloj forme apo mënyre në të ardhmen e ndikimit politik nga ana e administratës së IEVP Shën Koll, në vullnetin e të dënuarit/paraburgosurit zgjedhës, me qëllim votimin e tij në favor të subjekteve politike pjesëmarrëse në zgjedhje vendore apo qendrore.

- Marrja e masave urgjente për zgjidhjen në një kohë sa më të shpejtë të situatës konfliktuale në Godinën 2, "Siguria e Zakonshme" në IEVP Shën Koll, Lezhë.

- Marrjen e masave urgjente për përmirësimin e cilësisë së ushqimit në IEVP Shën Koll, Lezhë, si dhe ushtrimin e kontrolleve nga ana e strukturave përkatëse të DPB²⁶, me qëllim nxjerrjen e përgjegjësive individuale ndaj personave që mbulojnë këtë aspekt të funksionimit të IEVP-së. Marrjen e masave për uljen e mbipopullimit në të gjithë sektorët e sigurisë së zakonshme në IEVP Shën Koll, Lezhë.

Në vijim e në përgjigje të dokumentit të lartpërmendur, nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve është përcjellë përgjigje kryesisht kundërshtuese të cilën po e komentojmë krahasimisht me pikat e rekomandimit të MKPT.

- *Fillimi i procedurës administrative për marrjen e masës disiplinore ndaj Drejtorit të I.E.V.Penale Shën Koll, z. Kastriot Piroli, për shkak të vendosjes nga ana e funksionarit publik të burimeve njerëzore të administratës publike në favor të një subjekti të caktuar politik.*

- *Marrjen e masave për mospërsëritjen në çdo lloj forme apo mënyre në të ardhmen e ndikimit politik nga ana e administratës së IEVP Shën Koll, në vullnetin e të dënuarit/paraburgosurit zgjedhës, me qëllim votimin e tij në favor të subjekteve politike pjesëmarrëse në zgjedhje vendore apo qendrore.*

Lidhur me dy pikat e lartpërmendura z. Dibra shprehet kategorik në kundërshtinë se diçka e tillë ka ndodhur, ndërkohë që nga intervistat me të dënuar të pasqyruara dhe në proces verbalet e mbajtura, nga ana e këtyre të fundit fakti i kërkimit të votës në favor të një prej subjekteve politike pjesëmarrës në zgjedhje, shprehet mjaft qartë. Gjithsesi, elementi që kondicionoi e për më tepër e bëri të detyrueshme përfshirjen e pikave rekomanduese të lartpërmendura në dokument, ishte pranimi i çfarë kishte ndodhur nga ana e Drejtorit të IEVP Lezhë në prani dhe të Drejtuesit të Sektorit Ligjor të IEVP-së.

- *Marrja e masave urgjente për zgjidhjen në një kohë sa më të shpejtë të situatës konfliktuale në Godinën 2, "Siguria e Zakonshme" në IEVP Shën Koll, Lezhë.*

Në përgjigje të kësaj pike të rekomandimit, z. Dibra ka anashkaluar tërësisht faktin se nga ana jonë është sqaruar fillimisht se oraret e ajrimit në Godinën 2 janë respektuar nga IEVP Lezhë konform përcaktimeve të Rr.P.B., e më tej nga MKPT është sqaruar se të dënuarit nuk i konsumonin oraret në fjalë për shkak të gjendjes konfliktuale të krijuar, për zgjidhjen e të cilës administrata e IEVP prej kohësh nuk kishte reaguuar.

Pavarësisht përgjigjes, nga informacionet që disponoj rezulton se rekomandimi i MKPT në këtë drejtim është zbatuar nëpërmjet transferimit në godina të tjera të IEVP si dhe në IEVP Vaqarr, të dënuarve pjesëmarrës në konfliktin në fjalë.

- *Marrjen e masave urgjente për përmirësimin e cilësisë së ushqimit në IEVP Shën Koll, Lezhë, si dhe ushtrimin e kontrolleve nga ana e strukturave përkatëse të DPB, me qëllim nxjerrjen e përgjegjësive individuale ndaj personave që mbulojnë këtë aspekt të funksionimit të IEVP-së.*

Sërish në përgjigje z. Dibra mohon cilësinë e dobët të ushqimit, ndërkohë që sipas informacioneve që disponoj prej inspektimit në fjalë ushqimi i kësaj IEVP-je është përmirësuar ndjeshëm, ku dhe nuk kanë munguar kontrole me këtë objekt nga DPB(pikë e rekomandimit)

-Marrjen e masave për uljen e mbipopullimit në të gjithë sektorët e sigurisë së zakonshme në IEVP Shën Koll, Lezhë.

Z. Dibra në përgjigje fillon të shpjegojë krahasimisht me shifrat e popullimit të IEVP se të tillë në IEVP Lezhë nuk ka në ambientet e të dënuarve, por ka në paraburgim. Në përmbajtje të rekomandimit shpjegohet mjaft qartë mbipopullimi në sigurinë e zakonshme sipas gjendjes faktike të konstatuar por dhe bazuar në shifrat e administruara të përfuara nga vetë administrata e IEVP Lezhë.

Rekomandimi nr. dok. 201301768

Rekomandim lidhur me zbatimin e detyrimeve ligjore për përgatitjen dhe nxjerrjen e akteve nënligjore në bazë e për zbatim të neneve 18 pikat 1 e 2, 27 pika 5 gërma “ç” dhe 28 pika 2 të Ligjit 44/2012 dt. 19.04.2012 “Për Shëndetin mendor”, i ndryshuar.

Në përmbushje të kompetencave kushtetuese dhe ligjore, Avokati i Popullit nëpërmjet inspektimeve periodike pranë mjediseve ku janë të akomoduar persona me çrregullime të shëndetit mendor, ka monitoruar në vazhdimësi respektimin e të drejtave dhe të standardeve që u ofrohen personave të kësaj kategorie me qëllim përmirësimin e trajtimit dhe kushteve të pacientëve dhe sigurimin e respektimit të plotë të të drejtave të njeriut pranë institucioneve në fjalë.

Konkretisht janë kryer vizita monitoruese pranë QSB Tiranë dhe Institucioni i Veçantë Zahari Krujë, gjatë të cilave përveçse janë vërejtur probleme të karakterit infrastrukturor, është konstatuar gjithashtu se në kushte privimi lirie, pavarësisht se gjykata ndaj tyre ka marrë vendim me mjekim të detyruar dhe jo dënim me burgim, pranë dy institucioneve në fjalë mbahen 111 persona.

Ne gjykonim se nxjerrja e akteve nënligjore në fjalë në një kohë sa më të shpejtë, konsiderohet e domosdoshme përderisa në to do të përcaktohen së pari standarde të ofruara në mënyrë të barabartë, e së dyti do të përcaktohen procedurat që do të ndiqen sa i përket masës së kufizimit fizik të pacientëve të akomoduar në struktura të posaçme, theksoj më se nxjerrja e këtyre akteve nënligjore do të krijonte mundësinë që ligji i sipërpërmendur të vihej plotësisht në zbatim.

Për sa më sipër dhe me qëllim vënien në zbatim sa më shpejt të këtij ligji shumë të rëndësishëm, Avokati i Popullit paraqiti rekomandime:

1. Përgatitjen dhe miratimin sa më shpejt të akteve nënligjore të parashikuara në nenet 18 pika 1 dhe 27 pika 5 shkronja “ç”, të Ligjit nr. 44/2012 “Për shëndetin mendor”.
2. Përgatitjen dhe dërgimin për miratim në Këshillin e Ministrave të akteve nënligjore të parashikuara në nenet 18 pika 2 dhe 28 pika 2 të ligjit nr. 44/2012 “Për shëndetin mendor”.

Lidhur me këtë rekomandim nuk ka pasur një përgjigje nga ana e institucioneve përgjegjëse.

Çështje të trajtuara me inisiativë nga Avokati i Popullit, mbi problematikat e konstatuara gjatë monitorimeve, sipas fushave përkatëse.

Rekomandimet e Avokatit të Popullit mbi rastet e dhunës së konstatuar në ambientet e IEVP gjatë monitorimit dhe ankesave individuale;

Gjatë monitorimeve në institucione ku privohet liria e individëve, janë paraqitur ankesa nga shtetas të cilët vuajnë dënimin në këto institucione, me objekt dhunën fizike apo verbale të ushtruar ndaj tyre nga punonjës të regjimit të brendshëm apo sigurie. Avokati i Popullit, në rolin e MKPT ndaj çdo pretendimi që në fokus kishte “dhunën”, ka ushtruar kompetencat e tij ligjor duke ngritur një grup ekspertësh për verifikimin e këtyre rasteve. Gjatë vitit 2013 janë paraqitur disa raste, për të cilat është kryer verifikimi i tyre, për të cilat janë paraqitur materialet procedurale pranë institucioneve përkatëse. Ankuesve u është shkelur e drejta themelore e garantuar nga neni 25 i Kushtetutës dhe neni 3 i Konventës Evropiane për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të Njeriut, *për t’iu mos u nënshtruar torturës, dënimin apo trajtimin mizor, çnjerëzor ose poshtërues.*

Rekomandimi Nr. Dok.201301221 (nuk ka kanë marrë përgjigje)

Rekomandojmë fillimin e hetimeve ndaj shtetases B.B për veprën penale të “Torturës” parashikuar nga neni 86 i K.Penal, të ndryshuar.

Drejtuar: Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë

Në datën 22.05.2013 ekspertët e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës pranë Avokatit të Popullit gjatë kryerjes së një vizite monitoruese në sektorin e grave në IEVP 313 Tiranë shtetësja E.M, paraqiti para ekspertëve një ankesë për dhunim fizik të saj nga një punonjëse policie. Sipas ankueses, në datën 19.05.2013, rreth orës 12.00, ajo ndodhej në qelinë nr. 10, të sektorit të grave së bashku me tre të paraburgosurat Dh.K, B. I dhe B. B.

Ankuesja sqaron arsyet e ushtrimit të dhunës fizike ndaj saj nga punonjësja e policisë, si dhe reagimin shoqëve të dhomës të cilat kanë ndërhyrë për ti ndarë ato.

Nga pyetja e tyre rezultoi se ato të treja e kishin parë ngjarjen e ndodhur në qelin e tyre, dhunimin fizik të ankueses nga punonjësja e policisë të regjimit të grave. Nga deklaratimet e tyre dhe veprimeve procedurale u provuan pretendimet e ankueses për dhunimin fizik të saj nga punonjësja e Policisë së Burgjeve.

Gjithashtu nga këqyrja e regjistrit të administruar nga personeli mjekësor i IEVP 313 Tiranë rezultoi se, në datën 19.05.2013 ankuesja është vizituar nga punonjësit e këtij personeli dhe ka marrë mjekim, qetësues “diazepan”.

Ndërkohë nga ana ekspertëve që hetuan këtë rast u pyet edhe punonjësja e Policisë së Burgjeve lidhur me pretendimet e paraqitura ndaj saj nga ankuesja, por ajo nuk pranoi që të ketë dhunuar fizikisht atë. Pavarësisht qëndrimit mohues të saj, theksojmë se pretendimet e ankueses u provuan nga provat e administruara.

Në përfundim të hetimit administrativ të kësaj ankese kemi arritur në konkluzionin se kryerja e këtij veprimi nga punonjësja e Policisë së Burgjeve të regjimit të grave në IEVP 313 Tiranë, është çnjerëzor dhe përmban elementët e figurës së veprës penale të “Torturës” .

Ankueses i është shkelur e drejta themelore e garantuar nga neni 25 i Kushtetutës dhe neni 3 i Konventës Evropiane për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të Njeriut, *për t'iu mos u nënshtruar torturës, dënimit apo trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtëruës. Në përfundim të hetimit ju rekomandua* Prokurorisë së Rrethit Gjyqësorë Tiranë për fillimin e hetimeve në ngarkim të shtetasës B. B me detyrë punonjëse e Policisë së Burgjeve në IEVP 313 Tiranë, për veprën penale të "Torturës" parashikuar nga neni 86 i K.Penal, të ndryshuar.

Rekomandimi Nr. Dok. 201300875 (i pranuar)

Rekomandojmë fillimin e hetimeve ndaj shtetasve Altin Sulo dhe Bizantin Agolli për veprën penale të "Kryerjes së veprimeve arbitrare", parashikuar nga neni 250 i K.Penal, të ndryshuar.

Drejtuar: Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Korçë

Në institucionin e Avokatit të Popullit ka paraqitur ankesë shtetasi D.P, i cili shpjegon se kishte marrë një lajm për aksidentin automobilistik të vëllait ky lajm e tronditi shumë dhe nga dëshpërimi (por pa pasur asnjë qëllim të keq) ka goditur derën e qelisë disa herë. Pas disa minutash është hapur dera e qelisë së tij dhe kanë hyrë 2 punonjësit e policisë të regjimit të brendshëm të IEVP Korçë. Sipas ankuesit, pasi dy punonjësit e policisë kanë hyrë në qeli, janë afruar drejt tij dhe konkretisht tek shtrati ku ai ndodhej, e kanë goditur atë me shkelma. Konkretisht me shkelm në pjesën e majtë të kraharorit dhe në pjesën poshtë brinjës në krahun e majtë.

Ankuesi D. P sqaron se sjellja e punonjësve të policisë ishte jo normale pasi ata nuk e pyetën atë se çfarë kishte ndodhur, por filluan të ushtronin dhunë ndaj tij duke e goditur. Ankuesi pretendon se nga goditjet e punonjësve të policisë ai ka pasur dhimbje të forta e të vazhdueshme në kraharor dhe për këtë arsye në datën 02.04.2013 është shoqëruar në dhomën e mjekut për të kryer ekzaminimet përkatëse. Sipas ankuesit, këtë ngjarje e kanë parë edhe shtetasit A. H, N.J dhe E. Z të cilët në momentin e ngjarjes ndodheshin në të njëjtën qeli me atë.

Meqenëse ankuesi në ankesën e paraqitur pretendonte se kishte dëshmitarë shtetasit A. H, N. J dhe E, Z, në datën 15.04.2013 ata u pyetën me procesverbal nga ekspertët e Avokatit të Popullit rreth kësaj ngjarjeje.

Nga pyetja e tyre rezultoi se ata të tre e kishin parë ngjarjen që ka ndodhur në qelin e tyre ndërmjet David Plasaj dhe punonjësve të policisë të regjimit të brendshëm të IEVP Korçë. Nga deklarimet e dëshmitarëve u provuan plotësisht pretendimet e ankuesit për goditjet e ushtruara ndaj tij nga punonjësit e policisë. Gjithashtu dëshmitarët sqaruan edhe arsyen e goditjes së derës nga ankuesi D, P, e cila kishte ndodhur si pasojë e mërzitjes pasi ai kishte marrë lajmin për aksidentimin e vëllait të tij.

Në përfundim të shqyrtimit të kësaj ankese kemi arritur në konkluzionin se kryerja e këtij veprimi nga punonjësit e policisë të regjimit të brendshëm të IEVP Korçë, përmbajnë elementët e veprës penale të "Kryerjes së veprimeve arbitrare", parashikuar nga neni 250 i K.Penal. Këtë veprime arbitrare ata e kane kryer duke qenë në cilësinë e funksionarit shtetëror si punonjës të policisë së burgjeve në IEVP Korçë. Për sa me sipër Avokati i Popullit i është drejtuar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësorë Korçë me rekomandimin për fillimin e hetimeve në ngarkim të shtetasve A. S dhe B. A me detyrë punonjës së policisë së burgjeve në IEVP Korçë, për veprën penale të "Kryerjes së veprimeve arbitrare" parashikuar nga neni 250 i K.Penal, të ndryshuar.

Me shkresën Nr.1/7 Prot., datë 01.07.2013, Drejtuesi i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësorë Korçë z. Ferdinand Elezi, referon se mbi bazën e kallëzimit nga Institucioni i Avokatit të Popullit është regjistruar procedimi penal Nr.686 për veprën penale të “Kryerjes së veprimeve arbitrare” parashikuar nga neni 250 i K. Penal.

Rekomandimi Nr. Dok. 201300613 (i pranuar)

Rekomandojmë fillimin e ndjekjes penale në ngarkim të punonjësit të Policisë së Burgjeve efektiv në Institutin e të Miturve në Kavajë, për veprën penale të “Torturës” parashikuar nga neni 86 i K.Penal, i ndryshuar.

Drejtuar Prokurorisë së Rrethit gjyqësorë Kavajë

Gjatë inspektimit nga përfaqësues të Institucionit të Avokatit të Popullit në Institutin e të Miturve në Kavajë, është paraqitur një ankesë në formën e peticionit, nga disa shtetas të mitur të cilët vuajnë dënimin në Institutin e të Miturve në Kavajë (S.T, R.M, M.H, M.H, S.T, O.S, A.L dhe D.T). Këta të mitur pretendonin se ishin keqtrajtuar nga punonjësi i Policisë së Burgjeve, shtetasi A. N.

Për verifikimin e pretendimeve të ankuesve Avokati i Popullit ka marrë vendim për nisjen e një hetimi të pavarur. Sipas shpjegimeve të dhëna nga të miturit, punonjësi i Policisë së Burgjeve, ka shfaqur vazhdimisht një sjellje të dhunshme ndaj tyre dhe kryesisht në ditën e parë të vuajtjes së dënimit, ky punonjës është futur në qelin e të miturve dhe pretendohet se i ka goditur në pjesën e fytyrës duke u shprehur se kjo sjellje është në shenjë mirëseardhje në këtë institucion.

Të gjithë të miturit e lartpërmendur e deklarojnë një fakt të tillë nën prezencën e bashkëvuajtësve të tyre. Gjithashtu të miturit shprehen se veprime të ngjashme nga ana e këtij punonjësi janë kryer në ambiente ku pjesërisht nuk monitorohen nga kamerat e sigurisë dhe kryesisht brenda qelive.

Të miturit përgjatë deklarimeve të tyre sqarojnë se ndihen të trembur dhe nën kërcënimin e punonjësit në fjalë përgjatë shërbimit të tij në sektorin e tyre. Ata pohojnë njëzëri se prezenca e tij ju ka krijuar shpesh herë gjendje ankthi dhe kryesisht në orët e para të mëngjesit, ku ky punonjës ju hyn në qeli dhe ju afrohet pranë shtretërve të tyre, duke i qëlluar nën pretekstin e zgjimit për në aktivitete shkollore.

Punonjësi i policisë i cili ka kryer veprime me ankuesit, u pyet me procesverbal nga grupi i punës. Ndonëse pranonte që kishte kryer veprime me të miturit e lartpërmendur, ai nuk pranon që t'i kenë keqtrajtuar ata fizikisht sikurse pretendojnë ankuesit.

Në përfundim të shqyrtimit dhe hetimit të kësaj çështjeje dhe dokumentacionit të administruar arritëm në konkluzionin se, ndaj shtetasve të mitur është ushtruar dhune fizike dhe psikologjike, për faktin se të miturit gjatë marrjes në pyetje dëshmojnë imtësisht rastet e dhunës së ushtruar ndaj tyre dhe bashkëvuajtësve të tyre.

Trajtimi i tyre nga punonjësi i Policisë së Burgjeve është çnjerëzor dhe degradues. Nga përmbajtja ky veprim është kriminal, sepse nga ky punonjës janë konsumuar elementët e veprës penale të “Torturës”. Dhuna e ushtruar ndaj të miturve është bërë me qëllim ndëshkimit të tyre në kushte pambrojtshmërie, duke cënuar rëndë të drejtat e tyre të

parashikuara në legjislacionin në fuqi. Kjo dhunë është shoqëruar me cënueshmërinë e privatësisë së tyre në qeli dhe me një ndikim të fortë në gjendjen e tyre psikologjike.

Ankuesve u është shkelur e drejta themelore e garantuar nga neni 25 i Kushtetutës dhe neni 3 i Konventës Evropiane për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të Njeriut, *për t'iu mos u nënshtruar torturës, dënimit apo trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtërues. Lidhur me konstatimet e mësipërme Avokati i Popullit i rekomandoi* Prokurorisë së Rrethit Gjyqësorë Kavajë fillimin e ndjekjes penale në ngarkim të punonjësit të Policisë së Burgjeve efektive në Institutin e të Miturve në Kavajë, A.N, për veprën penale të “Torturës”, parashikuar nga neni 86 i K.Penal, të ndryshuar.

Me shkresën Nr.09 Prot., datë 06.01.2014, Drejtuesi i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësorë Kavajë znj. Ornela Rrumbullaku, referon se mbi bazën e kallëzimit nga Institucioni i Avokatit të Popullit është regjistruar procedimi penal Nr.104 për veprën penale të “Torturës”, parashikuar nga neni 86 i K.Penal, të ndryshuar.

Rekomandimet me inisiativë të Avokatit të Popullit mbi çështjet migratore në Republikën e Shqipërisë;

Avokati i Popullit si promotor i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, vë në dukje një dinamikë të re mbi çështjet migratore, marrë shkas nga informacioni ku rezulton se politika BE-së mbi migracionin, e cila deri tani ka qenë e fokusuar në drejtim të garantimit të një zone sigurie, lirie lëvizjeje brenda zonës së BE-së nëpërmjet harmonizimit të politikave kombëtare të vendeve anëtare të saj, tashmë është fokusuar drejt një partnerशिpi në mes vendeve të BE-së dhe vendeve jo anëtare të BE-së, drejt qasjes globale mbi migracionin. Disa vende të BE-së, veçanërisht vendet e reja të saj janë tashmë të angazhuara në hartimin e Strategjive Kombëtare mbi Migracionin dhe Planeve të tyre të Veprimit, pikërisht të orientuar ndaj kësaj politike të re migratore të BE-së.

Ndërkohë që politika migratore e BE-së është e fokusuar tashmë drejt një partnerशिpi me vendin tonë dhe kur vende të ndryshme të saj kanë përgatitur strategji të posaçme kombëtare mbi migracionin dhe plane të detajuara veprimi, nëpërmjet të cilave përcaktojnë politika të qarta partneriteti në këtë drejtim, Shqipëria nuk mund të garantojë partneritet me politika të copëzuara migratore në strategji të ndryshme sektoriale, por kërkohet një Strategji Kombëtare mbi Migracionin dhe Plan i detajuar Veprimi.

Dinamika migratore e Shqipërisë, përcaktimi i qartë i politikës migratore të Shqipërisë, menaxhimi në frymën e partneritetit të migracionit, përjasja drejt politikës migratore të BE-së, koordinimi i aktiviteteve dhe veprimtarive në mes strukturave shtetërore dhe jo shtetërore brenda dhe jashtë vendit në drejtim të menaxhimit të migracionit, si dhe siguri i mbështetjes së partnerëve ndërkombëtar në këtë drejtim diktojnë në nevojën e hartimit të një Strategjie të re Kombëtare mbi Migracionin dhe të një Plani të detajuar të Veprimit.

Mungesa e kësaj strategjie do të krijojë premisa për shkeljen e të drejtave të shtetasve shqiptarë, të huaj ose pa shtetësi (që ndodhen në territorin e vendit tonë si rezident të rregullt ose jo), të cilët përfshihen në problemin e migracionit.

Rekomandimi Nr. Dok. 201301007 (nuk kanë marrë përgjigje)

Drejtuar Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë lidhur me: "Hartimin dhe miratimin e Strategjisë së re Kombëtare mbi Migracionin dhe të një Plani të detajuar Veprimi"

Dinamika migratore e Shqipërisë, përcaktimi i qartë i politikës migratore të Shqipërisë, menaxhimi në frymën e partneritetit të migracionit, përqsja drejt politikës migratore të BE-së, koordinimi i aktiviteteve dhe veprimtarive në mes strukturave shtetërore dhe jo shtetërore brenda dhe jashtë vendit në drejtim të menaxhimit të migracionit, si dhe sigurimi i mbështetjes së partnerëve ndërkombëtar në këtë drejtim diktojnë nevojën e hartimit të një Strategjie të re Kombëtare mbi Migracionin dhe të një Plani të detajuar të Veprimit.

Ne gjykojmë se mungesa e kësaj strategjie do të krijojë premisa për shkeljen e të drejtave të shtetasve shqiptarë, të huaj ose pa shtetësi (që ndodhen në territorin e vendit tonë si rezident të rregullt ose jo), të cilët përfshihen në problemin e migracionit.

Rekomandimi Nr. Dok. 201301007 (i pranuar)

Drejtuar Ministrit të Brendshëm z. Flamur Noka për "Shpalljen e pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ, Urdhrit Nr. 90, datë 30.05.2012 të Ministrit të Brendshëm, "Për dokumentet që duhet të paraqesin shtetasit shqiptarë për ndryshimin e emrit/mbiemrit në zyrat e gjendjes civile dhe procedurën që duhet të ndjekë nëpunësi i gjendjes civile".

Me shkresën nr.4467/1 Prot, datë 12.08.2013 të Ministrisë së Brendshme, dërguar nga Sekretari i Përgjithshëm z. Isuf Çela, referohet përgjigja lidhur me procedurat për dokumentet që duhet të paraqesin shtetasit shqiptarë për ndryshimin e emrit/mbiemrit në zyrat e gjendjes civile dhe procedurën që duhet të ndjekë nëpunësi i gjendjes civile, si vijon;

Ligji nr.10129, datë 11.05.2009 "Për gjendjen civile", i ndryshuar, ka pësuar ndryshime përsa i përket procedurës së parashikuar për ndryshimin e emrit/mbiemrit të shtetasve, të cilat janë miratuar me ligjin nr.130/2013.

Për pasojë, me hyrjen në fuqi në datën 29.05.2013 të ligjit të ri për gjendjen civile, janë shfuqizuar dhe dispozitat që rregullonin ndryshimin e emrit/mbiemrit sipas aktit nënligjor, Urdhrit Nr.90, datë 30.05.2012 të Ministrit të Brendshëm.

Rekomandimi Nr. Dok. 201301007 (nuk kanë marrë përgjigje)

Drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit për: "Shpalljen e pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ të Zv/Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit Nr. 8671, datë 30.11.2012 "Mbi kontrollin e shtetasve shqiptarë që kalojnë kufirin".

Nga përmbajtja e këtij akti administrativ, që mund të konsiderohet urdhër sepse në përmbajtjen e tij ka elementë urdhërues rezulton në mënyrë të qartë se, të gjithë shtetasit shqiptarë të kategorisë "INAD", që kthehen nga policitë e vendeve Schengen/BE-së, me Akt Refuzim-Hyrje, me arsyen për shkak të informacionit në SIS (Sistemi Informativ Schengen); ata të kategorisë "DEPORTIV", që kthehen nga policitë e vendeve Schengen/BE-së, të shoqëruar me dokumentacion përkatës (Urdhra-Largimi, Urdhra-Dëbimi, Ndalim-Hyrje), pas datës së liberalizimit të vizave (datë 15.12.2010); ata të kategorisë "DEPORTIV", që kthehen nga policitë e vendeve Schengen/BE-së dhe janë të pa shoqëruar me dokumentacion përkatës (Urdhra-Largimi, Urdhra-Dëbimi, Ndalim-Hyrje, SIS), pas datës së liberalizimit të vizave (datë

15.12.2010), të cilët janë përsëritës më shumë se një herë dhe rezultojnë të regjistruar në Sistemin TIMS si të "DEPORTUAR" me arsyet e mësipërme, do t'u refuzohet dalja në kufirin shqiptar kur ata kanë si destinacion vendet e Schengen/BE-së, ku udhëtohet pa viza".

VIZITA MONITORUESE NË NJËSITË E POLICISË DHE AKTIVITETI I POLICISË SË SHTETIT I MONITORUAR NGA MKPT PËR VITIN 2013

Në funksionin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës, Avokati i Popullit gjatë vitit 2013 ka kryer dhe 65 inspektive, ri-inspektive dhe kontrole tematike në të gjitha strukturat e Policisë së Shtetit në vend. Janë hartuar dhe paraqitur 11 rekomandime, në lidhje me përmirësimin e standardeve të të drejtave dhe trajtimit të individëve që strehohen në këto institucione drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë. Njëkohësisht janë ndjekur 31 ankesa të shtetasve në drejtim të organeve të policisë të ndara sipas problematikave: 18 për ushtrim të dhunës fizike nga punonjës policie, 10 për shoqërim të paligjshëm në ambientet e policisë dhe 3 të ndryshme. Nga ankesat shqyrtuara janë përfunduar 25 prej tyre nga të cilat, 5 në favor të ankuesve për të cilat janë bërë rekomandime organeve përkatëse, 3 janë zgjidhur në favor të ankuesve gjatë procesit të shqyrtimit, 10 kanë qënë të pabazuara, 5 janë nxjerrë jashtë juridiksionit dhe 2 janë arkivuar pasi ankuesit kanë hequr dorë. Ndërsa 6 ankesa janë në shqyrtim. Gjithashtu janë hartuar dhe drejtuar organeve të Policisë së Shtetit 6 rekomandime lidhur me mbrojtjen e të drejtave të shtetasve nga veprimet apo mosveprimet e punonjësve të policisë.

Objektivat specifike të monitorimit

Monitorimet kishin si objekt inspektimin, kryerjen e vizitave, vëzhgimin, mbledhjen dhe vlerësimin e të dhënave, veprimeve dhe praktikave të përmbyshjes së detyrimeve ligjore nga personeli policor për respektimin e të drejtave të personave të shoqëruar, ndaluar apo arrestuar nga ana e personelit policor. Monitorimi përfshinte:

- trajtimin e të shoqëruarve, ndaluarve apo arrestuarve nga ana e personelit policor (nga aspekti ligjor, mjekësor dhe psikologjik);
- shqyrtimin nëse janë respektuar masat mbrojtëse të parashikuara nga dispozitat ligjore për personat e shoqëruar, ndaluar apo arrestuar (e drejta e informimit; njoftimi i heqjes së lirisë për të afërmit apo palë të tretë; aksesimi për të përfituar shërbim mjekësor; aksesimi për t'u mbrojtur me avokat);
- kushtet materiale;
- personelin e policisë.

Metodologjia

Këto monitorime u realizuan nëpërmjet analizës së disa burimeve:

1. Marrjes e takimeve me përfaqësues të administratës së institucioneve (shef komisariati/zëvendës)
2. Këqyrjes së ambienteve të shoqërimit dhe dhomave të sigurisë (fotografimi dhe përshkrimi).

3. Këqyrjes së administrimit të dokumentacionit mbi personat e shoqëruar, ndaluar, arrestuar.
4. Intervistimit të personave të shoqëruar, të ndaluar, ose arrestuar;
5. Intervistimit të punonjësve të policisë.

Mënyra e grumbullimit dhe kontrollimit të informacionit përpara, gjatë dhe pas vizitës

Përpara vizitave, bazuar në metodologjinë e inspektimeve të MKPT, grupi i monitorimit mblodhi të gjithë informacionin ligjor të nevojshëm për procesin e monitorimit (kode, ligje, vendime të Këshillit të Ministrave, urdhra dhe udhëzime). Monitorimi kaloi nëpër fazën e planifikimit të problematikës ku do përqendrohej, identifikimin real të performancës, të treguesve që kanë progres dhe të atyre treguesve që kanë nevojë për përmirësim.

Referenca ligjore

Arrestimi dhe ndalimi i personave të dyshuar për vepra penale rregullohet nga Kodi i Procedurës Penale (KPP), që është në fuqi prej gushtit të vitit 1995 (me ndryshimet e mëvonshme). Një i dyshuar për kryerjen e një vepre penale mund të mbahet nga policia në bazë të kompetencave të tyre deri në 96 orë. Nëse prokurori nuk urdhëron lirimin e menjëhershëm, ai brenda 48 orëve nga arrestimi ose ndalimi, kërkon vleftësimin e masës në gjykatën e vendit ku është kryer arrestimi ose ndalimi. Mos respektimi i këtij afati bën që arrestimi ose ndalimi të humbasë fuqinë^{27,28}. Më pas gjyqtari ka një afat prej 48 orësh nga momenti i paraqitjes në gjykatë të kërkesës së prokurorit, për të mbajtur një seancë gjyqësore dhe për të shpallur vendimin për vleftësimin e arrestimit ose ndalimit dhe caktimin e masës së sigurimit personal ndaj personit.²⁹

Personat për të cilët gjykata ka vendosur masën e sigurimit “arrest me burg” duhet të transferohen në Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale.

Përsa i përket identifikimit të personit ndaj të cilit zhvillohen hetimet, Kodi i Procedurës Penale (KPP) në nenin 295 të tij ka përcaktuar afatin deri në dymbëdhjetë orë, kohë në të cilën policia lejohet të mbajë çdo person që refuzon të japë identitetin e tij ose dyshohet për përdorimin e një identiteti të rreme. Më tej, në përputhje me Ligjin “Për policinë e shtetit”³⁰, një person mund të merret në ambientet e Policisë, për një periudhë që nuk i kalon dhjetë orë, në rastet e mëposhtme: për mbikëqyrjen e të miturit për qëllime edukimi ose për shoqërimin e tij në organin kompetent, ose kur një person është përhapës i një sëmundjeje ngjitëse, i paaftë mendërisht dhe i rrezikshëm për shoqërinë.³¹

Fillimisht grupi i monitorimit mori kontakt me Zv. Drejtorin e Policisë së Qarkut Korçë, dhe më pas me shefin e seksionit të Patrullave të Përgjithshme dhe sigurisë së objekteve i cili shoqëroi grupin e monitorimit përgjatë vizitës së tij në ambientet e komisariatit. Personave të kontaktuar iu bë me dije qëllimi i vizitës.

Në momentin që grupi i monitorimit do të vizitonte dhomat e sigurisë nga personeli i policisë u regjistruan të dhënat personale tek regjistri i takimeve të personave të ndaluar/arrestuar me mbrojtësit e të drejtave të njeriut (OJF).

²⁷ Neni 258 par 1, i KPrP

²⁸ Neni 257 i KPrP

²⁹ Neni 258 par 2; neni 259 i KPrP

³⁰ Ligji nr. 9749, dt 04.06.2007, i ndryshuar, nenet 11, pika 6 dhe 101, pika 1

³¹ Neni 101, pika 1 e ligjit 9749, dt 04.06.2007

TRAJTIMI I PERSONAVE TË SHOQËRUAR/TË NDALUAR/ TË ARRESTUAR***Tortura dhe keqtrajtime të tjera***

Gjatë inspektimit të kryer në Drejtorinë e Policisë të Qarkut Korçë, grupi i monitorimit kreu intervista të personave të ndaluar/të arrestuar, nga të cilët shumica ishin meshkuj por në disa raste dhe femra. Pjesa më e madhe e personave të intervistuar nga grupi i monitorimit konfirmuan se ata ishin trajtuar në mënyrë korrekte përgjatë kohës së qëndrimit në arrest policor. Nuk u bë prezent nga pjesa më e madhe e të intervistuarve pretendim për trajtim denigrues, jo human apo për ushtrim dhune fizike apo psikologjike. Gjithsesi grupi i monitorimit, gjatë intervistimeve që ka pasur me persona të dyshuar nga policia për kryerje të veprave penale, ka marrë dijeni për një numër ankesash për keqtrajtim fizik të pretenduar prej këtyre personave, të ushtruar nga punonjës të policisë, kryesisht në momentet e para të ndalimit/ të arrestimit.

Shtetasit e intervistuar nuk ishin, në çdo rast, në gjendje të raportnin identitetin e punonjësit të policisë të cilin ata e akuzonin për keqtrajtim. Disa prej tyre raportuan se në më shumë se një rast, gjatë ndalimit të tyre kishin qenë prezente punonjës policie pa uniforme, gjë që e bën të pamundur identifikimin e këtyre të fundit. Ankesat konsistojnë në ushtrim të dhunës fizike kryesisht në goditje me shuplaka në fytyrë dhe në kokë; me çok në kokë, shkop gome në duar, si dhe në ushtrim të dhunës verbale, konkretisht në fyerje dhe ofendime ndaj të ndaluarve/ të arrestuarve.³²

Në grupin e personave të ndaluar/të arrestuar, nga grupi i monitorimit u intervistuan edhe persona të mitur (3 persona të mitur në Komisariatit Korçë). Dy prej të intervistuarve pohuan se ata i ishin nënshtruar keqtrajtimit fizik nga policia (shuplaka në veçanti në fytyrë) në kohën e arrestimit dhe /ose gjatë marrjes në pyetje.³³ Shtetasit e mitur A.J. dhe S.T. konfirmuan që në datë 15.04.2013 rreth orës 16.30 janë paraqitur pranë stacionit të policisë Maliq me vullnetin e tyre të lirë, të shoqëruar nga personi që kishte bërë deponimin e kallëzimit për ta. Në momentin e paraqitjes në stacionin e policisë, kanë qenë të pranishëm 2 persona, njëri specialist i policisë dhe tjetri ishte polici i zonës.

Shtetasit A.J. dhe S.T. pretenduan që në momentin e marrjes në pyetje nga punonjësit e policisë ishte ushtruar dhunë fizike ndaj tyre. Shtetasi S.T. pretendonte që punonjësi i policisë e kishte goditur 2-3 herë me pëllëmbë në fytyrë ndërsa ishte vetëm. Ndërsa shtetasi A.J. pretendonte që punonjësi i policisë e kishte goditur 1 herë me pëllëmbë në fytyrë në prezencë të shtetasit S.T, brenda stacionit të policisë Maliq. Gjatë këqyrjes objektive nuk kishte shenja dhunimi si dermishje, hematoma apo plagë.

Po ashtu në të njëjtin komisarjat (Korçë) u raportua ushtrim dhune nga shtetasi E. M. në momentin e ndalimit nga punonjësit e policisë, pranë shtëpisë së tij në fshat. Ai u ankua për ushtrim të dhunës fizike, 4-5 goditje me pëllëmbë në fytyrë dhe kokë dhe gjuajtje me shkop gome në pëllëmbët e duarve, brenda makinës së policisë. Ai u ankua gjithashtu për dhunë verbale nëpërmjet fyerjeve me fjalë të rënda. I pyetur për identitetin e punonjësve të policisë të cilët ai akuzonte për dhunë, sqarimet nuk ishin të plota (ai dha me tepër përshkrim të tyre por jo identitetin). Ne trup nuk kishte asnjë gjurmë të dhunës së raportuar, si dermishje, hematoma apo plagë, dhe gjendja psikologjike e personit në momentin e intervistimit ishte stabël.

³² Neni 28, pika 5 e Kushtetutës, Neni 3 i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, ku përcaktohet që "askush nuk duhet të jetë objekt torture ose trajtimi ose dënimi çnjerëzor ose degradues"; Manuali i Rregullave dhe Procedurave Standarde për trajtimin dhe sigurimin e personave të arrestuar dhe të ndaluar, në njësitë policore", miratuar me Urdhrin nr. 763, datë 27.09.2011 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit kreu 1, par. 3, pika 3.1, germa a dhe d;

³³ Neni 37 b. i Konventës Për Të Drejtat e Fëmijës;

Gjatë qëndrimit në komisariat nuk kishte asnjë ankesë për keqtrajtim apo dhunë fizike/verbale.

Po ashtu, shtetasi B.L. u ankua për intimidim dhe cenim fizik nga ana e punonjësve të policisë në momentin e ndalimit. Ky shtetas u kontaktua prej grupit të monitorimit në momentet e para pas arrestimit të tij. Gjatë intervistës shtetasi B.L. dukej i irrituar dhe irritimi i tij lidhej kryesisht me motivin e arrestimit. Në momentin e intervistimit nuk u konstatuan plagë/hematoma që rezultojnë nga dhuna fizike, mbi asnjë nga personat e intervistuar.

Gjendja psikologjike e të intervistuarit ishte e qetë dhe nuk dëshmonte për pasoja të shkaktuara nga keqtrajtimi. Të intervistuarit nuk dëshmuar frikë, intimidim, për të raportuar keqtrajtimin e tyre.

Mbajtja në ndalim/arrestim në një vend jozyrtar

Pjesa më e madhe e personave të intervistuar nga grupi i monitorimit konfirmoi se procesi i ndalimit/arrestimit, dërgimit në komisarate, deri në vendosjen në dhomat e sigurisë ishte kryer konform procedurave ligjore të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale, Ligjin “Për policinë e shtetit” dhe Manualin e Rregullave dhe Procedurave Standarde për trajtimin dhe sigurimin e personave të arrestuar dhe të ndaluar, në njësitë policore”, miratuar me Urdhër nr. 763, datë 27.09.2011 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit (më poshtë Manuali). Megjithatë gjatë disa intervistave të kryera, nga shtetasit e ndaluar/arrestuar pati pretendime që nuk janë shoqëruar direkt në komisaritet e policisë, por ka pasur raste që kanë qëndruar gjatë në makinën e policisë, përpara se të dërgoheshin në komisarate.

Gjithashtu gjatë intervistave të kryera nga grupi i monitorimit janë verifikuar pretendime prej shtetasve të ndaluar/arrestuar që ka pasur mospërputhje mes kohës (orës) kur ishin ndaluar apo arrestuar me orën e shënuar në procesverbalet e arrestimit në flagrancë. Gjatë intervistimit shtetasi E. M. pretendoi që momenti i parë i kontaktimit me punonjësit e policisë dhe i bërjes me dije të arrestimit ishte dt. 14.04.2013, ora 07:30-8.00 e mëngjesit ndërsa proces-verbal arresti në flagrancë, mbante datën 14.04.2013, ora 13:30. E njëjta situatë u pretendua edhe prej 2 shtetasve të mitur A.J. dhe S.T. të cilët konfirmuan që pavarësisht se në stacionin e policisë Maliq ishin paraqitur në datë 15.04.2013 rreth orës 16.30, procesverbali i arrestit në flagrancë të cilin e mbanin me vete, mbante datën 15.04.2013, ora 20.30.

Përdorimi i forcës dhe armëve të zjarrit

Ashtu siç është përshkruar edhe në dispozitat e ligjit “Për policinë e shtetit”³⁴ punonjësi i Policisë mund të përdorë forcën për të përmbushur një synim të ligjshëm vetëm kur kjo është e nevojshme dhe vetëm nëse të gjitha masat e tjera janë të pasuksesshme apo të pamundura. Përdorimi i forcës nga organet policore bëhet në nivelin minimal të forcës së nevojshme gjithmonë në përputhje me parimin e përpjesëtueshmërisë. Niveli i forcës duhet të vijë i përshkallëzuar ndërmjet mundësive të parashikuara nga ligji që përfshijnë bindje me fjalë, shtrëngim fizik, mjete goditëse, mjete me lëndë kimike paralizuese, mjete me goditje elektrike, qen policie dhe armë zjarri.

Manuali i rregullave dhe procedurave standarde për trajtimin dhe sigurimin e personave të arrestuar dhe ndaluar në njësitë policore (Kreu IX, pika 2), parashikon përdorimin e mjeteve të forcës dhe shtrëngimit fizik në rastet për të shmangur:

³⁴ Neni 118, ligji nr. 9749, dt 04.06.2007

- a. Përpjekjet për t'u larguar me forcë/arratisur nga dhomat e sigurisë, sallat e gjykatave, qendrat spitalore apo nga mjetet gjatë transportit të tyre;
- b. Dhunën ndaj të ndaluarve/arrestuarve të tjerë ose personelit të shërbimit;
- c. Veprime të dhunshme për të dëmtuar shëndetin apo vetëvrarë;
- d. Dëmtimin e rëndë të sendeve, pajisjeve e orendive të përbashkëta të dhomave të sigurisë;
- e. Kundërshtimin apo rezistencën aktive dhe pasive në zbatimin e urdhrave për lëvizje apo transferimin e detyrueshëm.

Ndërsa në lidhje me përdorimin e armëve të zjarrit³⁵, përdorimi i tyre nga organet e policisë së shtetit parashikohet për të frenuar ose paralizuar veprimet e kundërligjshme të personit të ndaluar/arrestuar, kur mjetet e tjera nuk kanë dhënë rezultat. Përdorimi i armëve të zjarrit në lidhje me personat e ndaluar/ të arrestuar si masë ekstreme frenimi mund të bëhet në rastet kur:

- personi që ka kryer, është duke kryer ose ka të dhëna të mjaftueshme se ka kryer një krim të rëndë, përpiket t'i shpëtoj ndalimit ose arrestimit;
- personat të arrestuar a të ndaluar tentojnë të largohen nga vendet e kryerjes së dënimit, dhomat e paraburgimit ose vendet ku mbahen për t'u shoqëruar nga personat që i shoqërojnë ose nga mjetet me të cilat transportohen;

Nga informacionet e grumbulluara gjatë vizitave nuk rezultoi asnjë rast i përdorimit të mjeteve të forcës dhe shtrëngimit fizik, si dhe asnjë rast i përdorimit të armëve të zjarrit nga ana e policisë ndaj shtetasve të ndaluar/arrestuar me qëllim përmbushjen e një synimi të ligjshëm sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Ndalimi/arrestimi dhe kontrolli

Nisur nga informacionet e grumbulluara gjatë vizitave, nga kontaktet me personat e ndaluar/arrestuar dhe nga shqyrtimi i regjistrave të evidentimit të personave të ndaluar/arrestuar rezultoi se, në disa raste, personat ishin arrestuar nga policia para orës së evidentuar në procesverbalin e arrestimit në flagrancë dhe jo në kushte flagrante, siç pasqyrohej në procesverbal. Lidhur me sa më sipër u konstatuan paqartësi në përcaktimin dhe evidentimin e rasteve të ndalimit të personit me atë të arrestimit në flagrancë. Në bazë të nenit 251 të K. Pr. Penale, personi i kapur në flagrancë (në kryerje e sipër ose menjëherë pas kryerjes së një vepre penale), kur janë kriteret e parashikuara në këtë nen, duhet arrestohet menjëherë sapo ai kapet dhe pa e mbajtur atë në gjendje shoqërimi 10 orë.

Kështu mund të përmendet rasti i shtetasit E. M. i cili pretendoi që momentin e bërjes me dije të arrestimit ishte dt. 14.04.2013, ora 07:30-8.00 e mëngjesit, teksa dilte nga shtëpia, ndërsa procesverbal arresti në flagrancë, mbante datën 14.04.2013, ora 13:30. E njëjta situatë u pretendua edhe prej 2 shtetasve të mitur A.J. dhe S.T. të cilët konfirmuan që pavarësisht se në stacionin e policisë Maliq ishin paraqitur me vullnetin e tyre të lirë në datë 15.04.2013 rreth orës 16.30, procesverbali i arrestit në flagrancë të cilin e mbanin me vete, mbante datën 15.04.2013, ora 20.30.

³⁵ Ligji nr. 8290, dt.24.02.1998 "Për përdorimin e armëve të zjarrit"

MASA THEMELORE MBROJTËSE

E drejta e informimit

Gjatë vizitave të bëra në ambientet e komisariateve të policisë, u konstatua që përgjithësisht si në ambientet e komisariateve (korridore, zyra të oficerëve të policisë gjyqësore) ashtu dhe brenda dhomave të sigurisë ishin afishuar të drejtat e personave të shoqëruar/të ndaluar/ të arrestuar. Gjatë intervistave të bëra me shtetasit e ndaluar/të arrestuar, një pjesë e tyre pohuan që ishin njohur me të drejtat e tyre nga ana e punonjësve të policisë që në momentin e parë të ndalimit/arrestimit. Megjithatë gjatë intervistave të kryera u konstatuan gjithashtu raste të personave të ndaluar/të arrestuar të cilët nuk kishin marrë informacionin e nevojshëm për ekzistencën e të drejtave të tyre, që në momentin e parë të privimit të lirisë.

Mungesa e informacionit të shtetasve të ndaluar/të arrestuar për të drejtat e tyre është shoqëruar me mungesë të aksesit për të njoftuar familjarët për faktin e privimit të lirisë si dhe/ose me mungesë të aksesit për avokat që nga momenti i fillimit të privimit të lirisë ndaj shtetasit të ndaluar/arrestuar³⁶. Shtetasja F.K. pretendoi që është njohur me të drejtat e personave të ndaluar/ të arrestuar jo në momentin e arrestimit por ditën e nesërme. Gjatë intervistimit të bërë nga grupi i monitorimit, shtetasi i arrestuar E.M. konfirmoi që nuk ishte njohur me të drejtat e tij, nuk ishte bërë me dije për të drejtën për të mos folur, si dhe as i ishte ofruar avokat mbrojtës.

Mungesa e të drejtës së informimit u konstatuan në veçanti nga intervistat e kryera me persona të mitur të arrestuar të cilët pavarësisht se kishin nënshkruar deklaratën e njoftimit për të drejtat, pretenduan që nuk kishin marrë dijeni për të drejtat e tyre sikundër nuk iu është shpjeguar e drejta për të mos folur³⁷.

Gjatë monitorimeve u konstatua që në ambientet e komisariateve mungonin të afishuara të drejtat e personave të shoqëruar/ndaluar/arrestuar në gjuhë të huaj, në përputhje me dispozitat në fuqi.

Lajmërimi i familjarëve³⁸

Nga informacionet e mbledhura gjatë vizitave, u konstatua që në shumë raste, personave të ndaluar u është dhënë mundësia për të folur me një të afërm. Megjithatë, një numër i personave të ndaluar/të arrestuar të cilët u morën në intervistë u ankuan se nuk kanë pasur mundësi të njoftonin familjarët menjëherë pas privimit të tyre nga liria.³⁹ Pas pretendimit të ngritur nga ankuesit, grupi monitorimit këqyri procesverbalet e arrestimit në flagrancë të këtyre shtetasve të cilët konfirmonin pretendimet e ngritura nga personat e arrestuar të marrë në intervistë.

Gjatë vizitës u konstatua që në disa ambiente sigurie nuk kishte aparat telefonik, me qëllim që të ndaluarit/arrestuarit të komunikonin me familjarët e tyre⁴⁰.

³⁶ Neni 255 i KPrP

³⁷ Neni 35 dhe neni 255 i KPrP

³⁸ Neni 31, germa "a" e Kushtetutës

³⁹ Neni 255, pika 4 i KPrP

⁴⁰ Kreu V, pika 6.1, germa "f" e Manualit

Aksesi shërbim mjekësor

Ashtu siç është përshkruar edhe në Manualin e rregullave dhe procedurave standarde për trajtimin dhe sigurimin e personave të arrestuar dhe ndaluar në njësitë policore (Kreu II, pika 7), për personat e arrestuar/ndaluar përpara akomodimit në sistemin e dhomave të sigurisë bëhet intervistimi dhe verifikimi nga ana e mjekut për shenja dhune, keqtrajtimi apo sëmundje të ndryshme. Gjithashtu dispozitat parashikojnë që çdo person i ndaluar/arrestuar duhet të jetë subjekt i një vizite mjekësore (kundrejt dëshirës) nga mjeku/ndihmësmjeku i drejtorisë apo komisarariatit të policisë brenda 12 orëve nga ndalimi/arrestimi.

E drejta për të pasur shërbim mjekësor (duke përfshirë edhe mjekë të zgjedhur nga vetë i ndaluar/arrestuari) shoqërohet në Manual edhe nga e drejta për të përfituar shërbim mjekësor falas gjatë kohës së qëndrimit në dhomat e sigurisë (Kreu III, pika 1.9, 1.10). Zbatimi i duhur i këtyre dispozitave përbën garanci ndaj keqtrajtimit të mundshme nga policia. Nga informacionet e mbledhura gjatë vizitave u vërejt që të ndaluarit/arrestuarit përgjithësisht kishin akses për t'u vizituar nga mjeku, por me vullnet të lirë në shumë raste refuzonin t'i nënshtroheshin vizitës mjekësore.

Në Komisarariatet e Policisë të cilët i janë nënshtroar rikonstruksioneve dhe veprojnë konform Manualit janë të pajisur me dhomë të veçantë për mjekun, në përputhje me standardet normative, me krevat të fiksuar, ku mbahen regjistri i vizitave, kartelat klinike të personave të ndaluar ku detajohet data, ora dhe këqyrja objektive, si dhe ankesat klinike.

Aksesi për avokat

Nga kontaktet dhe informacionet e mbledhura gjatë vizitave u vërejt që disa prej të intervistuarve gëzonin aksesin për t'u mbrojtur me një avokat që në momentin e parë të privimit nga liria,⁴¹ duke bërë të mundur që avokati të ishte i pranishëm gjatë marrjes në pyetje nga ana e policisë. Megjithatë nga intervistat e zhvilluara u vërejtën gjithashtu vonesa në aksesin për të pasur avokat, duke marrë deklarata formale nga personat e ndaluar/të arrestuar pa praninë e mbrojtësit. Një pjesë e personave të arrestuar pretenduan që pavarësisht se kishin kërkuar praninë e një mbrojtësi kryesisht, por përgjatë kohës së qëndrimit të tyre në dhomat e sigurisë nuk kishin marrë asnjë kontakt me të.

Nga intervistat e zhvilluara u ngritën pretendime nga disa të arrestuar dhe në veçanti nga të arrestuar të mitur që në momentin e arrestimit dhe të marrjes në pyetje nuk kanë pasur pranë as avokatin mbrojtës, as psikologun dhe as prindin, pretendim i cili u mbështet edhe nga mungesa e nënshkrimeve të këtyre personave në procesverbalin e arrestimit në flagrancë. Nga intervistat e kryera me shtetasin B.L madhor dhe shtetasin A.H. i mitur, u konstatua që po pyeteshin pa iu siguruar mbrojtja e detyrueshme me avokat, si dhe asistencë psikologjike⁴², pavarësisht pranisë së psikologut në ambientet e komisarariatit.

U konstatua se psikologu që ushtronte këtë detyrë në komisariatin e Korçës nuk kishte arsimin universitar përkatës. Megjithë trajnimet e ofruara në fushën e psikologjisë dhe të shërbimeve psikologjike duket i pamundur sigurimi i standardeve **të një ndihme profesionale në rastet kur ky shërbim ofrohet nga një jo-profesionist**. Gjithashtu u konstatua fakti që të ndaluarit/arrestuarit, e kishin të pamundur për të bërë zgjedhjen së mbrojtjes, pasi lista e avokatëve mbrojtës nuk ishte e afishuar.

⁴¹ Neni 53 i KPrP

⁴² Nenet 35 dhe 49 i KPrP

PROCEDURA LIGJORE

Koha e ndalimit/arrestimit në polici

Nga informacioni i mbledhur gjatë vizitave, nga grupi i monitorimit u konstatua që përgjithësisht personat e ndaluar/të arrestuar ishin pajisur me deklaratën për njohjen me të drejtat e tyre, me kopje të procesverbalit të ndalimit/arrestimit, si dhe me kopje të procesverbalit të kontrollit personal⁴³. Nga këqyrja e procesverbaleve të personave të ndaluar/arrestuar nuk u konstatua ndonjë rast në shkelje të afatit prej 96 orë të parashikuar në disa akte nënligjore për të mbajtur personin e ndaluar/arrestuar nga policia⁴⁴.

Aksesi për t'u gjykuar

Seanca gjyqësore për vleftësimin e masës për personat e ndaluar/arrestuar u konstatua e kryer brenda periudhës prej 48 orëve të qëndrimit të personit të ndaluar/arrestuar në ambientet e policisë. Pjesa më e madhe e personave të ndaluar ishte në pritje të zhvillimit të seancës gjyqësore për vleftësimin e masës.

GARANCI PROCEDURIALE

Regjistrimi audio dhe video

Sistemi i dhomave të sigurisë në shumicën e komisariateve monitorohej nga kamera, por të dhënat e tyre nuk ruheshin në kasete apo DVD. Në komisariate janë të instaluar pajisjet e regjistrimit audio-viziv për të bërë kontrollin dhe monitorimin e ambienteve por ruajtja e informacionit të grumbulluar në serverat e Komisarariatit është vetëm provizore, pra kontrolli tregonte vetëm gjendjen e momentit, nuk shërbente për të evidentuar situata apo raste të ndodhura qoftë edhe një ditë më parë.

Regjistrat

Gjatë inspektimeve u vërejt prezenca e mangësive në plotësimin e librit të personave të shoqëruar/ndaluar dhe arrestuar lidhur me pasqyrimin e të gjitha veprimeve të policisë, si koha dhe arsyeja e shoqërimit/ndalimit apo arrestimit, shenjat e lëndimit, emri i zyrtarit, i cili ka kryer veprimet, vendi ku është mbajtur, koha kur personi ka mbërritur në mjediset e policisë, kur është informuar për të drejtat e tij, kur është pyetur, si dhe kur ka pasur kontakte me një anëtar të familjes, një avokat ose një mjek. Vazhdimi i trajtimit të të dyshuarit për kryerje të një vepre penale si i shoqëruar. Ndërkohë që veprime të tilla vijjnë në kundërshtim me nenin 11/6, 101/5, 103/1 dhe 107 të Ligjit Nr.9749, datë 04.06.2007 "Për Policinë e Shtetit".

⁴³ Kreu III, pika 1.14 e Manualit

⁴⁴ Neni 28, par 2 i Kushtetutës; neni 258, pika 1 KPrP

KUSHTET MATERIALE

Dhomat e sigurisë dhe të shoqërimit:

Ambiente sigurie jashtë standardeve të kërkuara në ligj mbeten ato në Komisaritet e Policisë Elbasan, Pogradec, Peshkopi, Burrel, Berat, Lushnjë, Krujë, Shkodër, Vlorë, Sarandë si dhe në Komisaritet e Policisë Nr.1, 2 dhe 3 Tiranë.

Ambiente shoqërimi jashtë standardeve të kërkuara në ligj mbeten ato në Komisaritet e Policisë Elbasan, Gramsh, Librazhd, Peqin, Devoll, Ersekë, Pogradec, Peshkopi, Burrel, Bulqizë, Berat, Çorovodë, Kuçovë, Mirditë, Kurbin, Lushnje, Mallakastër, Krujë, Shijak, Shkodër, Pukë, Malsi e Madhe, Tepelenë, Përmet, Vlorë, Sarandë, Delvinë, Has, Tropojë si dhe Komisaritet e Policisë Nr.1, 2, 3, 4 dhe 6 Tiranë.

Komisariatet e Policisë që i janë nënshtruar një rikonstruksioni janë konform standardeve . Kushtet në dhomat e sigurisë janë në përputhje të plotë me ato kushte që parashikohen në procedurat standarde të punës dhe në manualin e trajtimit të personave të ndaluar dhe arrestuar. Janë krijuar dhoma shoqërimi për meshkujt, femrat dhe për të miturit. Dhoma e intervistimit për takimin me avokat, me oficerë të policisë gjyqësore, është sipas standardit, me tavolina, karrige të fiksuara dhe instalimet në mur. Ka dhomë të veçantë për mjekun, në përputhje me standardet normative. Në ambientet e brendshme të dhomave të sigurisë janë afishuar të drejtat e personave të ndaluar dhe të arrestuar. Në korridorin e brendshëm të dhomave të sigurisë ka citofon, i cili funksionin. U konstatua që nëpër dhomat e sigurisë nuk funksiononin sinjalet e montuara në mur për kontakt me punonjësën e shërbimit në rast nevojë⁴⁵.

Trajtimi ushqimor

Gjatë monitorimit në Komisariate, pas intervistimit me personat e ndaluar/arrestuar u konstatuan raste të mungesës së trajtimit me ushqim të personave të ndaluar/arrestuar sipas dispozitave normative në fuqi.⁴⁶

Gjatë kontaktimit me stafin policor në disa Komisariate u konstatua ekzistenca e një kontrate shërbimi “catering” ndërmjet këtij institucioni dhe një subjekti privat, në lidhje me trajtimin ushqimor të personave të ndaluar/arrestuar⁴⁷. Gjatë verifikimit u konstatua që në dokumentacionin për mënyrën e trajtimit me ushqim të personave të ndaluar/arrestuar nuk kishte të përcaktuar:

- Kuotën në lekë për racion ditor ose vakt ditor për çdo të ndaluar/arrestuar.
- Sasinë e ushqimeve që i garantohet çdo personi e bazuar në sasinë e nevojshme të kalorive.

Gjithashtu gjatë monitorimit në shumicën e rasteve u konstatua që personeli i kuzhinës nuk ishte i pajisur me librezë ushqimore. Kutia e ruajtjes së mostrave ushqimore të gatuar nuk kishte dokumentet e nevojshme (nuk kishte fletoren e regjistrimit të personit që e administronte ruajtjen, orën e vendosjes në kuti, si dhe emrin e llojit të ushqimit në ruajtje). Gjithashtu u konstatua edhe mungesa e kampionëve të ushqimit në kutinë e ruajtjes së tyre në kundërshtim me dispozitat normative në fuqi⁴⁸.

⁴⁵ Kreu V, pika 4.3, germa “c” e Manualit

⁴⁶ Kreu IV, pika 2.1 dhe 2.2 e Manualit

⁴⁷ Kreu IV, pika 2.4 e Manualit

⁴⁸ Kreu IV, pika 2.5 e Manualit

Grupe në situata vulnerabël

Gjatë monitorimit u konstatua që vetëm Komisariati i Policisë Korçë kishte dhoma sigurie nga të cilat një për të mitur, një për femra dhe tre për meshkuj madhorë. Në lidhje me dhomat e shoqërimit u konstatua ekzistenca e tre dhomave të shoqërimit në përputhje me kërkesat e parashikuara në dispozitat normative lidhur me sigurimin e kushteve materiale për garantimin të drejtave të grupeve në situata vulnerabël. Ishte për t'u vlerësuar në mënyrë të veçantë dhoma e shoqërimit për të miturit e realizuar me mbështetjen e fondacionit *Save the Children*, pasi ishte në përputhje të plotë me dispozitat normative, duke siguruar kushte normale për shoqërimin e personave të mitur.

Përmbledhje e rekomandimeve të hartuara nga MKPT gjatë vitit 2013 lidhur me konstatimet e inspektim/monitorimeve të kryera në Drejtorinë e Policisë të Qarqeve dhe Komisariatet në varësi.

Nr. Dok. 201300132/3	
-----------------------------	--

Rekomandime për inspektimin e bërë në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Shkodër dhe Komisariatet në varësi të saj.

1. Ndërtimin ose rikonstrukcionin e ambienteve të shoqërimit në Komisariatet e Policisë Shkodër, Pukë dhe Malësi e Madhe sipas kërkesave të ligjit nr.9749, datë 04.06.2007 "*Për Policinë e Shtetit*" dhe në zbatim të Letër-Porosisë së Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit Nr.703, dt. 07.08.2008, duke krijuar ambiente të përshtatshme, dinjitoze, të pajisura me orenditë e nevojshme për qëndrim, të ndara më vete për femra, meshkuj dhe të mitur.
2. Ndërtimin ose rikonstrukcionin e ambienteve të reja të sigurisë në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Shkodër sipas kërkesave të Ligjit Nr.9749, datë 04.06.2007 "*Për Policinë e Shtetit*", Manualit "*Për Rregullat e Trajtimit e Sigurimin e të Ndaluarve dhe Arrestuarve në Dhomat e Sigurisë në Njësitë Policore*".
3. Plotësimin me përgjegjësi të librit të personave të shoqëruar, ndaluar dhe arrestuar.
4. Respektimin e dispozitave ligjore të K.Pr.Penale lidhur me shënimin në procesverbal të çastit (orës së saktë) të arrestimit apo ndalimit të shtetasve dhe të mos trajtohen fillimisht si të shoqëruar.
5. Vendosjen e sistemit të monitorimit në ambientet e shoqërimit, sigurisë dhe në veçanti atij të intervistimit në DPQ Shkodër dhe në të gjithë Komisariatet e Policisë në varësi të kësaj drejtorie. Monitorimi duhet të filloj nga hyrja e ndërtesës së komisaritit, me qëllim për të mos pasur asnjë moment shkëputje deri në ambientin ku personi do qëndrojë.
6. Krijimi i dhomave të monitoruara të intervistimit të shtetasve nga Oficerët e Policisë Gjyqësore, në Drejtorinë e Policisë Qarkut Shkodër dhe në komisaritet në varësi të saj.

Nr. Dok. 201300136/2	
-----------------------------	--

Rekomandime për inspektimin e bërë në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Tiranë dhe Komisaritet e Policisë në varësi të saj.

1. Vënien menjëherë në funksionim të ambienteve të reja të sigurisë në Drejtorinë e Policisë Qarkut Tiranë, si dhe nxjerrjen jashtë funksionit të ambienteve të sigurisë në Komisaritet e Policisë Nr.1, 2, 3 dhe 6 Tiranë

2. Ndërtimin e ambienteve të shoqërimit në Komisaritet e Policisë Nr.1, 2, 3, 4 dhe 6 Tiranë sipas kërkesave të ligjit nr.9749, datë 04.06.2007 "*Për Policinë e Shtetit*" dhe Letër-Porosisë së Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit Nr.703, dt. 07.08.2008, me qëllim për të krijuar ambiente të përshtatshme, dinjitoze, të pajisura me orenditë e nevojshme për qëndrim, të ndara më vete për femra, meshkuj dhe të mitur.

3. Të bëhen ndryshime konstruktive në ambientet e sigurisë në Komisaritet e Policisë Nr.5 Tiranë dhe atë Kavajë me qëllim plotësimin e standardeve të përcaktuara në Manualin "*Për Rregullat e Trajtimin e Sigurimin e të Ndaluarve dhe Arrestuarve në Dhomat e Sigurisë në Njësitë Policore*".

4. Nga strukturat drejtuese të organeve qendrore e vendore të policisë të punohet me të gjithë efektivat për njohjen e ligjit "*Për Policinë e Shtetit*" dhe zbatimin me rigorozitet të kritereve ligjore lidhur me rastet e shoqërimit të shtetasve në organet e policisë, si dhe për trajtimin dinjitoz të tyre.

5. Heqjen e sendeve që reflektojnë dhunë në zyrat e oficerëve të policisë gjyqësore ku merren në pyetje personat e ndaluar dhe arrestuar.

6. Në Komisariatin e Policisë nr.1 Tiranë duhet të realizohet sa më shpejt të jetë e mundur:

- Largimi i dhomës së paraqitjes për njohje nga ambienti i shoqërimit dhe kthimin e saj në dhomë shoqërimi për femra dhe të mitur ose lënien e saj në funksionin që ka dhe krijimin e ambienteve të reja për shoqërimin.

- Heqja nga funksioni e dhomës së shoqërimit, që ndodhet brenda ambienteve të sigurisë, për personat e dehur dhe përdorues droge.

7. Plotësimin me përgjegjësi të rubrikave të librit të personave të shoqëruar, ndaluar/arrestuar duke i dhënë një rëndësi të veçantë njoftimit të familjarëve, të afërme apo personit që i shoqëruari beson, orës së njoftimit të tyre, emrit të të njoftuarit si dhe numrit të telefonit të tij.

8. Të vihet në funksion libri për ankesat e shtetasve të shoqëruar, ndaluar/arrestuar, si dhe të bëhet nënshkrimi nga vet shtetasi pasi ai lihet i lirë. Vendosija e kësaj të dhëne do të parandalojë mundësinë e abuzimit të punonjësve të policisë me arsytën dhe kohën e shoqërimit të tyre.

9. Respektimin e dispozitave ligjore të K.Pr.Penale lidhur me shënimin në procesverbal të çastit (orës së saktë) të arrestimit apo ndalimit të shtetasve dhe të mos trajtohen fillimisht si të shoqëruar.

10. Vendosijen e sistemit të monitorimit në ambientet e shoqërimit, sigurisë dhe në veçanti atij të hetimit në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Tiranë dhe në të gjithë Komisaritet e Policisë në varësi të saj. Monitorimi duhet të filloj nga hyrja e ndërtesës së organit, me qëllim për të mos pasur asnjë moment shkoputje deri në ambientin ku personi do të qëndrojë.

11. Marrjen e masave të nevojshme për të siguruar ujë të rrjedhshëm, në ato Komisariate Policie ku ai mungon, si dhe të vendosen dushe në ambientet e sigurisë.

Nr. Dok. 201300501/2	
-----------------------------	--

Rekomandime për inspektimin e bërë në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Durrës dhe Komisaritet në varësi të saj.

1. Përfundimin në kohë dhe sipas kërkesave të ligjit nr.9749, datë 04.06.2007 "Për Policinë e Shtetit" të ambienteve të shoqërimit dhe të sigurisë, në Komisaritin e Policisë Durrës.
2. Ndërtimin e ambienteve të reja të shoqërimit dhe të sigurisë në Komisaritin e Policisë Krujë sipas kërkesave të Ligjit Nr.9749, datë 04.06.2007 "Për Policinë e Shtetit", Letër-Porosisë së Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit dhe Manualit "Për Rregullat e Trajtimit e Sigurimin e të Ndaluarve dhe Arrestuarve në Dhomat e Sigurisë në Njësitë Policore".
3. Plotësimin me përgjegjësi të librit të personave të shoqëruar, ndaluar dhe arrestuar.
4. Nga strukturat drejtuese të organeve qendrore e vendore të policisë të punohet me të gjithë efektivat për njohjen e ligjit "Për Policinë e Shtetit" dhe zbatimin me rigorozitet të kritereve ligjore lidhur me rastet e shoqërimit të shtetasve në organet e policisë, si dhe për trajtimin dinjitoz të tyre.
5. Respektimin e dispozitave ligjore të K.Pr.Penale lidhur me shënimin në procesverbal të **çastit (orës së saktë) të arrestimit apo ndalimit të shtetasve dhe të mos trajtohen fillimisht si të shoqëruar.**
6. Vendosjen e sistemit të monitorimit në ambientet e shoqërimit, sigurisë dhe në veçanti atij të hetimit në të dy Komisaritet e Policisë. Monitorimi duhet të filloj nga hyrja e ndërtesës së komisaritetit, me qëllim për të mos pasur asnjë moment shkëputje deri në ambientin ku personi do qëndrojë.
7. Marrjen e masave të nevojshme për vendosjen e telefonit në ambientet e sigurisë në të dy Komisaritet e Policisë.
8. Të vihet në funksion libri për ankesat e shtetasve të shoqëruar, ndaluar/arrestuar.

Nr. Dok. 201300726/2	
-----------------------------	--

Rekomandime për inspektimin e bërë në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Fier dhe Komisaritet e Policisë në varësi të saj.

1. Ndërtimin e ambienteve të reja të shoqërimit në Komisaritet e Policisë Lushnje dhe Mallakastër sipas kërkesave të ligjit nr.9749, datë 04.06.2007 "Për Policinë e Shtetit" dhe në zbatim të Letër - Porosisë së Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit Nr.703, dt. 07.08.2008, duke krijuar ambiente të përshtatshme, dinjitoze, të pajisura me orenditë e nevojshme për qëndrim, të ndara më vete për femra, meshkuj dhe të mitur.
2. Riparimin e të gjitha të metave të konstatuara, të cilat janë pasqyruar më sipër, në ambientet e shoqërimit në Komisaritin e Policisë Fier.
3. Ndërtimin e ambienteve të reja të sigurisë në Komisaritin e Policisë Lushnje sipas kërkesave të Ligjit Nr.9749, datë 04.06.2007 "Për Policinë e Shtetit", Manualit "Për Rregullat e Trajtimit e Sigurimin e të Ndaluarve dhe Arrestuarve në Dhomat e Sigurisë në Njësitë Policore".

4. Riparimin e të gjitha të metave të konstatuara, të cilat janë pasqyruar më sipër, në ambientet e sigurisë të Komisarariatit të Policisë Fier si dhe vënien në funksion të sistemit të ngrohjes.

5. Plotësimin me përgjegjësi të librit të personave të shoqëruar, ndaluar dhe arrestuar.

6. Trajnimin në vazhdimësi të gjithë efektivit të policisë për njohjen e ligjit “Për Policinë e Shtetit” dhe zbatimin me rigorozitet të kriterëve ligjore lidhur me rastet e shoqërimit të shtetasve në organet e policisë.

7. Respektimin e dispozitave ligjore të K.Pr.Penale lidhur me shënimin në procesverbal **të çastit (orës së saktë) të arrestimit apo ndalimit të shtetasve dhe të mos trajtohen fillimisht si të shoqëruar.**

8. Vendosjen e sistemit të monitorimit në ambientet e shoqërimit, sigurisë dhe në veçanti atij të hetimit në të gjithë Komisarariatet e Policisë ku ai mungon. Monitorimi duhet të filloj nga hyrja e ndërtesës së komisarariatit, me qëllim për të mos pasur asnjë moment shkëputje deri në ambientin ku personi do qëndrojë.

9. Transferimin nga ambientet e policisë, në institucionet e paraburgimit dhe burgimit, në varësi të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, të të gjithë të paraburgosurve ndaj të cilëve është vendosur masa e sigurimit “*arrest në burg*” dhe e të ndaluarve për efekt të ekzekutimit të vendimit penal të dënimit të tyre në mungesë me burgim.

10. Emërimin në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Fier në funksionin e psikologut të një specialisti me arsimin përkatës.

Nr. Dok. 201300963/2	
-----------------------------	--

Rekomandime për inspektimin e bërë në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Korçë dhe Komisarariatet në varësi të saj.

1. Marrjen e masave të nevojshme për ndërtimin e ambienteve të shoqërimit në Komisarariatet e Policisë, Pogradec, Devoll dhe Ersekë sipas kërkesave të ligjit nr.9749, datë 04.06.2007 “Për Policinë e Shtetit” dhe në zbatim të Letër-Porosisë së Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit Nr.703, dt. 07.08.2008, duke krijuar ambiente të përshtatshme, dinjitoze, të pajisura me orëditë e nevojshme për qëndrim, të ndara më vete për femra, meshkuj dhe të mitur.

2. Marrjen e masave të nevojshme për ndërtimin e ambienteve të reja të sigurisë në Komisarariatet e Policisë Pogradec sipas kërkesave të Ligjit Nr.9749, datë 04.06.2007 “Për Policinë e Shtetit”, Manualit “Për Rregullat e Trajtimit e Sigurimin e të Ndaluarve dhe Arrestuarve në Dhomat e Sigurisë në Njësitë Policore”.

3. Marrjen e masave të menjëhershme për korrigjimin e mangësive të konstatuara në librin e personave të shoqëruar/ndaluar dhe arrestuar me qëllim standardizimin sipas kërkesave të përcaktuara në Ligjin Nr.9749, datë 04.06.2007 “Për Policinë e Shtetit” dhe Manualin “Për Rregullat e Trajtimit e Sigurimin e të Ndaluarve dhe Arrestuarve në Dhomat e Sigurisë në Njësitë Policore”. Në libër të pasqyrohen të gjitha veprimet e policisë duke i kushtuar një rëndësi të veçantë kohës dhe arsyes së shoqërimit/ndalimit apo arrestimit, vendit ku është mbajtur, kohës kur personi ka mbërritur në mjediset e policisë, kur është informuar për të drejtat e tij, kur është pyetur si dhe kur ka pasur kontakte me një anëtar të familjes, një avokat, një mjek apo psikolog kur ai është i mitur.

4. Marrjen e masave të menjëhershme për të garantuar që çdo person i shoqëruar, ndaluar apo arrestuar nga policia, për çfarëdo arsye, të informohet menjëherë në momentin e ndalimit për të drejtat që i njeht ligji procedural penal. Kjo gjë kërkon që në momentin e ndalimit personit ti njoftohen në mënyrë të përmbledhur të drejtat e tij, dhe më pas në vendin ku do të merret në pyetje ose do të kryhen veprimet e tjera procedurale ti vihen në dispozicion materiale të shkurtra informuese në një gjuhë të kuptueshme për të, ku listohen të drejtat e personit të shoqëruar, ndaluar apo arrestuar. Ju takon organeve të Policisë së Shtetit që të vërtetojnë përmbushjen e këtij detyrimi ligjor.
5. Marrjen e masave të nevojshme nga strukturat drejtuese të organeve qendrore e vendore të Policisë së Shtetit për njohjen e të gjithë efektivit me ligjin *"Për Policinë e Shtetit"* dhe zbatimin me rigorozitet të kriterëve ligjore lidhur me rastet e shoqërimit të shtetasve në organet e policisë, si dhe për trajtimin dinjitoz të tyre.
6. Marrjen e masave për trajnimin e vazhdueshëm e periodik të punonjësve të policisë, me qëllim eliminimin e formave të keqtrajtimit të personave të shoqëruar dhe ndaluar/arrestuar si veprime të papranueshme dhe të dënueshme. Përveç kësaj, rëndësi më e madhe duhet t'u jepet metodave moderne, shkencore të hetimit penal, përmes investimeve në pajisje dhe trajnimin të personelit, në mënyrë që të mund të zmadhohet numri dhe lloji i provave të mbledhura në ngarkim të të pandehurit, duke minimizuar rëndësinë që ka në hetimin dhe gjykimin e çështjes pranimi ose jo prej tij i kryerjes së veprës penale.
7. Marrjen e masave për sigurimin e ndihmës juridike që në momentin që personit i privohet liria dhe sigurimin e përfaqësuesit ligjor falas, për të gjithë kategorinë e personave që nuk kanë mundësi financiare për ta siguruar atë.
8. Marrjen e masave për sigurimin e ndihmës së detyrueshme juridike dhe psikologjike në rastet e arrestimit apo ndalimit të personave të mitur si dhe për njoftimin e familjarëve të tyre.
9. Marrjen e masave për trajtimin me ushqim sipas normave të përcaktuara në urdhrin e përbashkët Nr.432, datë 10.03.2008 të Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Shëndetësisë.
10. Marrjen e masave për respektimin me korrektesë të dispozitave ligjore të K.Pr.Penale lidhur me shënimin në procesverbal **të çastit (orës së saktë) të arrestimit apo ndalimit të shtetasve dhe mostrajtimin e tyre fillimisht si të shoqëruar.**
11. Marrjen e masave për vendosjen menjëherë të posterave për të drejtat ligjore të personave të shoqëruar në Komisaritet e Policisë Ersekë dhe Stacionin e Policisë Maliq.
12. Marrjen e masave për vendosjen e sistemit të monitorimit në ambientet e shoqërimit, sigurisë dhe në veçanti atij të hetimit në të gjithë Komisaritet e Policisë të DPQ Korçë ku ai mungon. Monitorimi duhet të fillojë nga hyrja e ndërtesës së organit të policisë, me qëllim për të mos pasur asnjë moment shkëputjeje deri në ambientin ku personi do qëndrojë.
13. Marrjen e masave për vendosjen e telefonit me numër në ambientet e sigurisë në Komisaritetin e Policisë Korçë, me qëllim që të ndaluarit/arrestuarit të kenë mundësi të komunikojnë më familjarët e tyre sipas përcaktimeve të bëra në Manualin *"Për Rregullat e Trajtimin e Sigurimin e të Ndaluarve dhe Arrestuarve në Dhomat e Sigurisë në Njësitë Policore"*.
14. Marrjen e masave për transferimin e menjëhershëm nga ambientet e policisë, në institucionet e paraburgimit dhe burgimit, në varësi të Drejtorisë së Përgjithshme të

Burgjeve, të të gjithë të paraburgosurve ndaj të cilëve është vendosur masa e sigurimit “*arrest në burg*” dhe e të ndaluarve për efekt të ekzekutimit të vendimit penal të dënimit të tyre në mungesë me “*burgim*”.

15. Marrjen e masave për vënien menjëherë në funksion të librit për ankesat e shtetasve të shoqëruar, ndaluar/arrestuar duke i kushtuar rëndësi të veçantë rubrikave për pasqyrimin e shenjave të lëndimit, emri i zyrtarit, i cili ka kryer veprimet si dhe vendi ku është mbajtur.

Nr. Dok. 201300974/2	
-----------------------------	--

Rekomandime për inspektimin e bërë në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Lezhë dhe Komisariatet në varësi të saj.

1.Në Komisariatin e Policisë Lezhë të vendosen lavamanë në tualetet e dhomave të shoqërimit si dhe të zëvendësohen dyer e hekurit me dyer druri sipa përcaktimit të bërë në Letër – Porosinë e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit Nr.703, dt. 07.08.2008 “*Për njohjen e raportit vlerësues paraparak të delegacionit të CTP-së dhe marrjen e masave për plotësimin e rekomandimeve të tij*”.

2.Përfundimin e ndërtimit të ambienteve të shoqërimit në Komisariatin e Policisë Kurbin sipas kërkesave të ligjit nr.9749, datë 04.06.2007 “*Për Policinë e Shtetit*”.

3.Marrja e masave për korrigjimin e mangësive të konstatuara në librin e personave të shoqëruar/ndaluar dhe arrestuar me qëllim standardizimin sipas kërkesave të përcaktuara në Ligjin Nr.9749, datë 04.06.2007 “*Për Policinë e Shtetit*” dhe Manualin “*Për Rregullat e Trajtimin e Sigurimin e të Ndaluarve dhe Arrestuarve në Dhomat e Sigurisë në Njësitë Policore*”. Në libër të pasqyrohen të gjitha veprimet e policisë duke i kushtuar një rëndësi të veçantë kohës dhe arsyes së shoqërimit/ndalimit apo arrestimit, vendit ku është mbajtur, kohës kur personi ka mbërritur në mjediset e policisë, kur është informuar për të drejtat e tij, kur është pyetur si dhe kur ka pasur kontakte me një anëtar të familjes, një avokat, një mjek apo psikolog kur ai është i mitur.

4.Marrja e masave të menjëhershme për të garantuar që çdo person i shoqëruar, ndaluar apo arrestuar nga policia - për çfarëdo arsye – të informohet menjëherë në momentin e ndalimit për të drejtat që i njeh ligji procedural penal. Kjo gjë kërkon që në momentin e ndalimit personit ti njoftohen në mënyrë të përmbledhur të drejtat e tij, dhe më pas, në vendin ku do të merret në pyetje ose do të kryhen veprimet e tjera procedurale ti vihen në dispozicion materiale të shkurtra informuese në një gjuhë të kuptueshme për të, ku listohen të drejtat e personit të shoqëruar, ndaluar apo arrestuar. Është detyrim i organeve të policisë së shtetit që të vërtetojnë përmbushjen e këtij detyrimi ligjor.

5.Të vazhdohet në mënyrë intensive trajnimi i personelit policore me kurrikulat përkatëse për njohjen dhe zbatimin me rigorozitet të kriterëve ligjore lidhur me rastet e shoqërimit të shtetasve në organet e policisë, si dhe për trajtimin dinjitoz të tyre.

6.Të merren në analizë të gjitha rastet e trajtimit të personave të ndaluar/arrestuar si të shoqëruar si dhe të fillojë procedimi disiplinorë ndaj atyre punonjësve të policisë që do të bëjnë këtë shkelje.

7.Vendosjen e sistemit të monitorimit në ambientet e shoqërimit, sigurisë dhe në veçanti atij të hetimit në të gjithë Komisariatet e Policisë ku ai mungon. Monitorimi duhet të fillojë nga hyrja e ndërtesës së komisarariatit, me qëllim për të mos pasur asnjë moment shkaputje deri në ambientin ku personi do qëndrojë.

8.Vendosjen menjëherë të posterave për të drejtat ligjore të personave të shoqëruar, ndaluar/arrestuar në të gjitha dhomat e shoqërimit dhe të sigurisë.

9.Vendosjen e posterave për respektimin e të drejtave të njeriut nga punonjësit e policisë, për ndalimin e dhunës etj. Këto postera të vendosen si në ambientet e shoqërimit dhe të sigurimit, ashtu edhe në zyra e në ambiente **të tjera të policisë**.

10.Marrjen e masave të nevojshme për vendosjen e telefonit me numër në ambientet e sigurisë në Komisaratin e Policisë Lezhë, me qëllim që të ndaluarit/arrestuarit të kenë mundësi të komunikojnë më familjarët e tyre sipas përcaktimeve të bëra në Manualin *“Për Rregullat e Trajtimit e Sigurimin e të Ndaluarve dhe Arrestuarve në Dhomat e Sigurisë në Njësitë Policore”*.

11.Të vihet menjëherë në funksion libri për ankesat e shtetasve të shoqëruar, ndaluar/arrestuar duke i kushtuar rëndësi të veçantë rubrikave për pasqyrimin e shenjave të lëndimit, emri i zyrtarit, i cili ka kryer veprimet si dhe vendi ku është mbajtur.

Nr. Dok. 201301155/2	
-----------------------------	--

Rekomandime për inspektimin e bërë në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Berat dhe Komisaritet në varësi të saj.

1. Ndërtimin e ambienteve të shoqërimit në Komisaritet e Policisë, Berat, Kuçovë dhe Çorovodë sipas kërkesave të ligjit nr.9749, datë 04.06.2007 *“Për Policinë e Shtetit”* dhe në zbatim të Letër–Porosisë së Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit Nr.703, dt. 07.08.2008, duke krijuar ambiente të përshtatshme, dinjitoze, të pajisura me orenditë e nevojshme për qëndrim, të ndara më vete për femra, meshkuj dhe të mitur.

2. Ndërtimin e ambienteve të reja të sigurisë në Komisaratin e Policisë Berat sipas kërkesave të Ligjit Nr.9749, datë 04.06.2007 *“Për Policinë e Shtetit”* dhe Manualit *“Për Rregullat e Trajtimit e Sigurimin e të Ndaluarve dhe Arrestuarve në Dhomat e Sigurisë në Njësitë Policore”*.

3. Marrjen e masave për korrigjimin e mangësive të konstatuara në librin e personave të shoqëruar, ndaluar/arrestuar me qëllim standardizimin sipas kërkesave të përcaktuara në Ligjin Nr.9749, datë 04.06.2007 *“Për Policinë e Shtetit”* dhe Manualin *“Për Rregullat e Trajtimit e Sigurimin e të Ndaluarve dhe Arrestuarve në Dhomat e Sigurisë në Njësitë Policore”*. Në libër të pasqyrohen të gjitha veprimet e policisë duke i kushtuar një rëndësi të veçant kohës dhe arsyes së shoqërimit, ndalimit apo arrestimit, vendit ku është mbajtur, kohës kur personi ka mbërritur në mjediset e policisë, kur është informuar për të drejtat e tij, kur është pyetur si dhe kur ka pasur kontakte me një anëtar të familjes, një avokat, një mjek apo psikolog kur ai është i mitur.

4. Analizimin, nxjerrjen e përgjegjësisë dhe fillimin e ecurisë disiplinore ndaj OPGJ Rrapo Xhavora për shkeljen ligjore të bërë ndaj shtetasit Rafaen Laze, rast i cili është përshkruar më sipër. Për shkak të veprimeve të tij të kundërligjshme, vlerësimi i arrestit në flagrancë nga Gjykata është bërë me 24 orë vonesë.

5. Marrjen e masave të menjëhershme për të garantuar që çdo person i shoqëruar, ndaluar apo arrestuar nga policia, për çfarëdo arsye, të informohet menjëherë në momentin e ndalimit për të drejtat që i njeht ligji procedural penal. Kjo gjë kërkon që në momentin e ndalimit personit ti njoftohen në mënyrë të përmbledhur të drejtat e tij dhe më pas, në vendin ku do të merret në pyetje ose do të kryhen veprimet e tjera procedurale ti vihen në dispozicion materiale të shkurtra informuese në një gjuhë të kuptueshme për të, ku listohen të drejtat e personit të shoqëruar, ndaluar apo arrestuar.

6. Marrjen e masave të nevojshme nga strukturat drejtuese të organeve qendrore e vendore të policisë për njohjen e të gjithë efektivave të policisë të ligjit *“Për Policinë e Shtetit”* dhe zbatimin me rigorozitet të kriterëve ligjore lidhur me rastet e shoqërimit të shtetasve në organet e policisë, si dhe për trajtimin dinjitoz të tyre.

7. Respektimin me korrektesë të dispozitave ligjore të K.Pr.Penale lidhur me shënimin në procesverbal të çastit (orës së saktë) të arrestimit apo ndalimit të shtetasve dhe të mos trajtohen ata fillimisht si të shoqëruar.

8. Vendosjen e sistemit të monitorimit në ambientet e shoqërimit, sigurisë dhe në veçanti atij të hetimit në të gjithë Komisaritet e Policisë ku ai mungon. Monitorimi duhet të filloj nga hyrja e ndërtesës së komisaritetit, me qëllim për të mos pasur asnjë moment shkëputje deri në ambientin ku personi do qëndrojë.

9. Marrjen e masave të nevojshme për vendosjen e telefonit me numër në ambientet e sigurisë në Komisaritetin e Policisë Berat, me qëllim që të ndaluarit/arrestuarit të kenë mundësi të komunikojnë më familjarët e tyre sipas përcaktimeve të bëra në Manualin *“Për Rregullat e Trajtimin e Sigurimin e të Ndaluarve dhe Arrestuarve në Dhomat e Sigurisë në Njësitë Policore”*.

10. Marrjen e masave të nevojshme për transferimin e menjëhershëm nga ambientet e policisë, në institucionet e paraburgimit dhe burgimit, në varësi të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, të të gjithë të paraburgosurve ndaj të cilëve është vendosur masa e sigurimit *“arrest në burg”* dhe e të ndaluarve për efekt të ekzekutimit të vendimit penal të dënimit të tyre në mungesë me *“burgim”*.

11. Marrjen e masave për vënien menjëherë në funksionim të librit për ankesat e shtetasve të shoqëruar, ndaluar/arrestuar duke i kushtuar rëndësi të veçantë rubrikave për pasqyrimin e shenjave të lëndimit, emri i zyrtarit, i cili ka kryer veprimet si dhe vendi ku është mbajtur.

Nr. Dok. 201301372/2	
-----------------------------	--

Rekomandime për inspektimin e bërë në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Elbasan dhe Komisaritet në varësi të saj.

1. Ndërtimin e ambienteve të shoqërimit në Komisaritet e Policisë Librazhd sipas kërkesave të ligjit nr.9749, datë 04.06.2007 *“Për Policinë e Shtetit”* dhe në zbatim të Letër-Porosisë së Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit Nr.703, dt. 07.08.2008, duke krijuar ambiente të përshtatshme, dinjitoze, të pajisura me orenditë e nevojshme për qëndrim, të ndara më vete për femra, meshkuj dhe të mitur.

2. Ndërtimin e ambienteve të reja të sigurisë në Komisaritet e Policisë Elbasan sipas kërkesave të Ligjit Nr.9749, datë 04.06.2007 *“Për Policinë e Shtetit”*, Manualit *“Për Rregullat e Trajtimin e Sigurimin e të Ndaluarve dhe Arrestuarve në Dhomat e Sigurisë në Njësitë Policore”*.

3. Plotësimin me përgjegjësi të librit të personave të shoqëruar, ndaluar dhe arrestuar.

4. Trajnimin e punonjësve **të policisë nga strukturat përkatëse të organeve** qendrore e vendore të Policisë së Shtetit me qëllim njohjen e ligjit *“Për Policinë e Shtetit”* dhe zbatimin me rigorozitet të kriterëve ligjore lidhur me rastet e shoqërimit të shtetasve në organet e policisë.

5. Respektimin e dispozitave ligjore të K.Pr.Penale lidhur me shënimin në procesverbal të **çastit (orës së saktë) të arrestimit apo ndalimit të shtetasve dhe të mos trajtohen fillimisht si të shoqëruar.**

6. Vendosjen e sistemit të monitorimit në ambientet e shoqërimit, sigurisë dhe në veçanti atij të hetimit në të gjithë Komisaritet e Policisë të DPQ Elbasan ku ai mungon. Monitorimi duhet të filloj nga hyrja e ndërtesës së komisaritetit, me qëllim për të mos pasur asnjë moment shkëputje deri në ambientin ku personi do qëndrojë.

7. Marrjen e masave të nevojshme për vendosjen e telefonit në ambientet e sigurisë në Komisaritetin e Policisë Elbasan.

8. Analizimin dhe nxjerrjen e përgjegjësive për rastet e konstatuara në Komisaritet e Policisë Elbasan dhe Librazhd, ku të dyshuarit si autor të mundshëm të kryerjes së veprës penale apo me cilësinë e personit që tregon rrethana të dobishme për hetimin janë trajtuar si të shoqëruar.

9. Marrjen e masave të nevojshme për trajtimin në çdo kohë me ushqim të personave të ndaluar/arrestuar.

10. Marrjen e masave të nevojshme për krijimin e një dhome për mbajtjen e sendeve personale për personat e ndaluar/arrestuar si dhe dhënien e një kopje të procesverbalit të kontrollit personal.

11. Vënien në funksionim të librit të ankesave të shtetasve të shoqëruar, ndaluar/arrestuar.

Nr. Dok. 201301441/2	
-----------------------------	--

Rekomandime për inspektimin e bërë në Drejtorinë e Policisë Qarkut Dibër dhe Komisaritet në varësi të saj.

1. Ndërtimin ose përshtatjen e ambienteve të shoqërimit në Komisaritet e Policisë Dibër, Burrel dhe Bulqizë sipas kërkesave të ligjit nr.9749, datë 04.06.2007 “Për Policinë e Shtetit” dhe Letër-Porosisë Nr. 703, datë 07.08.2008 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit “Për njohjen e raportit vlerësues paraprak të delegacionit të CPT-së dhe marrjen e masave për plotësimin e rekomandimeve të tij”.

2. Ndërtimin e ambienteve të sigurisë në Komisaritet e Policisë Dibër dhe Burrel sipas kërkesave të ligjit nr.9749, datë 04.06.2007 “Për Policinë e Shtetit” dhe Manualit “Për Rregullat e Trajtimit e Sigurimin e të Ndaluarve dhe Arrestuarve në Dhomat e Sigurisë në Njësitë Policore”.

3. Vendosjen e sistemit të monitorimit në ambientet e shoqërimit dhe të sigurisë. Monitorimi duhet të fillojë nga hyrja e ndërtesës së Komisaritetit të Policisë, duke mos pasur asnjë moment shkëputje deri në ambientin ku personi do qëndrojë.

4. Ndryshimin në strukturën organike, të funksionit të kryeinfermierit dhe zëvendësimin me një mjek.

5. Vazhdimin e trajnimit, për personelin policorë, me kurrikulat përkatëse, me qëllim njohjen dhe zbatimin me rigozitet të kritereve ligjore lidhur me rastet e shoqërimit të shtetasve në organet e policisë, si dhe për trajtimin dinjitoz të tyre.

6. Respektimin e dispozitave ligjore të K.Pr.Penale lidhur me shënimin në procesverbal **të castit (orës së saktë) të arrestimit apo ndalimit të shtetasve, me qëllim, për të mos i trajtuar ata fillimisht si të shoqëruar.**

7. Të merren në analizë të gjitha rastet e trajtimit të personave të ndaluar/arrestuar si të shoqëruar si dhe të fillojë procedimi disiplinorë për të gjithë ata punonjës policie që bëjnë këtë shkelje.

8. Rikonstruksionin e ambienteve ku përgatitet ushqimi për të ndaluarit/arrestuarit si dhe zëvendësimin e pajisjeve me të reja ose sigurimin e ushqimit me nënkontraktorë privat.

9. Plotësimin me përgjegjësi të rubrikave në librin e shoqërimit, ndalimit/arrestimit të shtetasve.

10. Të vihet në funksion libri për ankesat e shtetasve të shoqëruar, ndaluar/arrestuar.

Nr. Dok. 201302285/2	
-----------------------------	--

Rekomandime për problematikat e konstatuara gjatë monitorimit të bërë në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Kukës dhe Komisariatet në varësi të saj.

Trajtimi i të ndaluarve/arrestuarve në përputhje me të drejtat e njeriut

1. Në bazë të informacioneve të mbledhura gjatë vizitës rekomandohet që autoritetet policore të marrin masat e nevojshme për të luftuar të gjitha format e keqtrajtimit nga policia. Të gjithë oficerët e policisë duhet të jetë të ndërgjegjshëm për të kuptuar se asnjë formë keqtrajtimi e personave të shoqëruar/ndaluar/arrestuar nuk është e pranueshme dhe do të dënohen në përputhje me rrethanat. Për këtë qëllim rëndësi duhet t'i jepet investimit në mjete të përshtatshme hetimi dhe në burime njerëzore të kualifikuar, në mënyrë që të zvogëlohet mundësia e mbledhjes së të dhënave për kryerjen e një vepre penale vetëm nëpërmjet rrëfimit.

Rekomandohet sensibilizimi i punonjësve të policisë në lidhje me efektet dhe pasojat e dhunës fizike dhe psikologjike mbi personat e shoqëruar/ndaluar/arrestuar, papajtueshmërinë në çdo rast të ushtrimit të dhunës mbi këta persona dhe pasojat që mund të shkaktojë përdorimi i dhunës mbi karrierën e tyre. Rekomandohet gjithashtu të organizohen trajnime me punonjësit e policisë për njohjen dhe respektimin e të drejtave të personave të shoqëruar/ndaluar/arrestuar.

2. Nga vrojtimet e bëra gjatë vizitës u evidentua nevoja për përforsim të kuadrit ligjor për sa i përket sanksionimit të të drejtave të personave të shoqëruar/ndaluar/arrestuar, si dhe trajtimit të tyre. Dispozitat e ligjit "Për policinë e shtetit" pavarësisht jo në mënyrë të plotë, trajtojnë të drejtat e personave të shoqëruar nga policia, trajtim i cili mungon për personat e ndaluar/arrestuar. Rekomandohet të përfshihen në ligjin "Për policinë e shtetit" sanksionimi i të drejtave të personave të shoqëruar/ndaluar/arrestuar, si dhe garancitë ligjore për realizimin e këtyre të drejtave.

3.Rekomandohet që çdo rast raportimi nga ana e personave të shoqëruar/ndaluar/arrestuar për keqtrajtim fizik nga ana e policisë gjatë arrestimit, duhet hetuar dhe personat përgjegjës duhen ndëshkuar dhe dërguar përpara drejtësisë.

E drejta për informim

4. Rekomandohet që autoritetet policore të marrin masat e nevojshme për të siguruar që të gjithë personat e ndaluar/arrestuar nga policia të informohen plotësisht për të drejtat themelore që nga fillimi i heqjes së lirisë së tyre, nëpërmjet dhënies së informacionit të qartë me gojë që në fillim nga ana e policisë, duke u plotësuar me fletë informative mbi të drejtat themelore të personave të shoqëruar/ndaluar/arrestuar menjëherë pas mbërritjes së personave në fjalë në ambientet e policisë. Rekomandohet që fletët informative të pasqyrojnë të drejtat dhe detyrimet e personave të shoqëruar/ndaluar/arrestuar edhe në gjuhën angleze dhe italiane, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

5. Rekomandohet që gradualisht të shtrihet për publikun e gjerë dhënia e informacionit mbi të drejtat e personave të shoqëruar/ndaluar/arrestuar, nëpërmjet promovimit të të drejtave, nxjerrjes së broshurave të ndryshme, apo informimit në organet e medias.

E drejta për të kontaktuar me familjen

6. Analizimi i mësipërm shtrihet edhe për të drejtën për të kontaktuar me familjen, e cila nga informacionet e grumbulluara rezultoi e realizuar në mënyrë të pjesshme. Rekomandohet që, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, autoritetet policore të marrin masat e nevojshme për të siguruar që të gjithë personat e ndaluar/arrestuar nga policia të kontaktojnë me familjarët në momentin më të parë të arrestimit/ndalimit, si dhe ta pasqyrojnë qartësisht këtë gjë në procesverbalet përkatëse dhe në regjistrat e shtetasve të shoqëruar/ndaluar/arrestuar.

E drejta e personit të ndaluar/arrestuar për të kontaktuar me avokat

7. Nisur nga analiza e mësipërme mbi aksesin e personave të ndaluar/arrestuar për avokat rekomandohet që autoritetet shqiptare të marrin masa rigoroze për të zbatuar detyrimin ligjor për të dhënë mundësi personit të ndaluar/arrestuar për t'u mbrojtur, e përfaqësuar nga një avokat që nga momenti i fillimit të privimit të lirisë. Për të bërë të mundur realizimin e plotë të kësaj të drejte në komisariatet e policisë si dhe pranë dhomave të sigurimit duhet të ketë një kopje të listës së avokatëve anëtarë pranë Dhomës së Avokatisë, të mundshëm për të kontaktuar me personat e ndaluar/arrestuar.

8. Rekomandohet që të merren masat e nevojshme nga organet policore për informimin e personave të ndaluar/arrestuar për të drejtën e një avokati mbrojtës dhe për mundësinë reale për të kontaktuar me një të tillë, përpara se të kryhet hetimi. Dorëheqja nga një e drejtë e tillë nga ana e personave të ndaluar/arrestuar duhet bërë me vullnetin e tyre të lirë dhe të jetë e pasqyruar me shkrim në dokumentacionin përkatës.

Respektimi i të drejtave të të miturve të ndaluar/arrestuar

9. Në veçanti grupi i monitorimit e pa të nevojshme të ndalej në respektimin e të drejtave të personave të mitur të ndaluar/arrestuar nga policia. Nisur nga analiza e mësipërme mbi aksesin e të miturve të ndaluar/arrestuar për informim për të drejtat e tyre, praninë e prindërve, akses për avokat, akses për psikolog rekomandohet që autoritetet shqiptare të marrin masa rigoroze për të mos lejuar në asnjë rast që i mituri të merret në pyetje pa praninë e avokatit mbrojtës, pavarësisht heqjes dorë nga e drejta për të pasur avokat mbrojtës.

10. Gjithashtu rekomandohet që autoritetet shqiptare të marrin masa për të zbatuar me rigorozitet praninë e psikologut dhe prindit në çdo gjendje dhe shkallë të procedimit⁴⁹, duke punësuar në stafin e komisariatit specialist përkatës në fushën e psikologjisë. Rekomandohet që posti i psikologut të okupohet nga një profesionist i fushës, me arsim universitar përkatës, gjë e cila rrit mundësinë për dhënie ndihme të kualifikuar dhe profesionale në këtë fushë.

Zhvillim të kurseve trajnuese për përditësim të parimeve dhe koncepteve ligjore

11. Duke qenë se gjatë monitorimit u konstatuan raste të mospërputhjes së orës apo të momentit të flagrancës me situatën e përshkruar në procesverbalet e arrestimit në flagrancë, duhet t'i kushtohet vëmendje e veçantë konceptit të arrestit në *flagrancë*, për të garantuar që policia të mos i tejkalojë kompetencat e saj në ndalimin e personave. Për këtë arsye rekomandohet zhvillimi i kurseve trajnuese për përditësimin e parimeve dhe koncepteve ligjore, në mbrojtje të të drejtave të njeriut, respektimit të ligjit dhe për plotësim të njohurive në zbatim të ligjit nr. 9749, dt. 04.06.2007 "Për Policinë e Shtetit".

Kushtet materiale

12. Ndërtimin e ambienteve të shoqërimit në Komisaritet e Policisë Tropojë dhe Has sipas kërkesave të ligjit dhe akteve normative.

13. Rekomandohet pajisja e personave të ndaluar/arrestuar me materiale të përshtatshme për fjetje, duke respektuar kërkesat higjieno-sanitare të parashikuara në aktet normative.

14. Heqjen menjëherë nga ambientet e shoqërimit të dhomës së përgjimit të fshehtë, me mjete teknike si dhe mospërsëritjen e kësaj dukurie në të ardhmen.

15. Vendosjen e sistemit të monitorimit në ambientet e shoqërimit dhe të sigurisë, në komisaritet e policisë Tropojë dhe Has. Monitorimi duhet të fillojë nga hyrja e ndërtesës së komisariatit të policisë, duke mos pasur asnjë moment shpëputje deri në ambientin ku personi do qëndrojë, si dhe mundësimin e ruajtjes së tyre në një afat jo me pak se një javë.

Nr. Dok. 201302288/2	
-----------------------------	--

Rekomandime për problematikat e konstatuara gjatë monitorimit të bërë në Komisaritetin e Policisë Pukë dhe Stacionin e Policisë Fushë-Arrëz.

Trajtimi i të ndaluarve/arrestuarve në përputhje me të drejtat e njeriut

1. Nga vrojtimet e bëra gjatë vizitës u evidentua nevoja për përforsim të kuadrit ligjor përse i përket sanksionimit të të drejtave të personave të shoqëruar/ndaluar/arrestuar, si dhe trajtimit të tyre. Dispozitat e ligjit "Për policinë e shtetit" pavarësisht jo në mënyrë të plotë, trajtojnë të drejtat e personave të shoqëruar nga policia, trajtim i cili mungon për personat e ndaluar/arrestuar. Rekomandohet të përfshihen në ligjin "Për policinë e shtetit" sanksionimi i të drejtave të personave të shoqëruar/ndaluar/arrestuar, si dhe garancitë ligjore për realizimin e këtyre të drejtave.

E drejta për informim

2. Rekomandohet që autoritetet policore të marrin masat e nevojshme për të siguruar që të gjithë personat e ndaluar/arrestuar nga policia të informohen plotësisht për të drejtat themelore që nga fillimi i heqjes së lirisë së tyre, nëpërmjet dhënies së informacionit të qartë me gojë që në fillim nga ana e policisë, duke u plotësuar me fletë informative mbi të drejtat themelore të personave të shoqëruar/ndaluar/arrestuar menjëherë pas mbërritjes së personave në fjalë në ambientet e policisë. Rekomandohet që fletët informative të pasqyrojnë të drejtat dhe detyrimet e personave të shoqëruar/ndaluar/arrestuar edhe në gjuhën angleze dhe italiane, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

3. Rekomandohet që gradualisht të shtrihet për publikun e gjerë dhënia e informacionit mbi të drejtat e personave të shoqëruar/ndaluar/arrestuar, nëpërmjet promovimit të të drejtave, nxjerrjes së broshurave të ndryshme, apo informimit në organet e medias.

E drejta për të kontaktuar me familjen

4. Analizimi i mësipërm shtrihet edhe për të drejtën për të kontaktuar me familjen, e cila nga informacionet e grumbulluara rezultoi e realizuar në mënyrë të pjesshme. Rekomandohet që, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, autoritetet policore të marrin masat e nevojshme për të siguruar që të gjithë personat e ndaluar/arrestuar nga policia të kontaktojnë me familjarët në momentin më të parë të arrestimit/ndalimit, si dhe ta pasqyrojnë qartësisht këtë gjë në procesverbalet përkatëse dhe në regjistrat e shtetasve të shoqëruar/ndaluar/arrestuar.

E drejta e personit të ndaluar/arrestuar për të kontaktuar me avokat

5. Nisur nga analiza e mësipërme mbi aksesin e personave të ndaluar/arrestuar për avokat rekomandohet që autoritetet shqiptare të marrin masa rigoroze për të zbatuar detyrimin ligjor për të dhënë mundësi personit të ndaluar/arrestuar për t'u mbrojtur, e përfaqësuar nga një avokat që nga momenti i fillimit të privimit të lirisë. Për të bërë të mundur realizimin e plotë të kësaj të drejte në komisariatet e policisë si dhe pranë dhomave të sigurimit duhet të ketë një kopje të listës së avokatëve anëtarë pranë Dhomës së Avokatisë, të mundshëm për të kontaktuar me personat e ndaluar/arrestuar.

6. Rekomandohet që të merren masat e nevojshme nga organet policore për informimin e personave të ndaluar/arrestuar për të drejtën e një avokati mbrojtës dhe për mundësinë reale për të kontaktuar me një të tillë, përpara se të kryhet hetimi. Dorëheqja nga një e drejtë e tillë nga ana e personave të ndaluar/arrestuar duhet bërë me vullnetin e tyre të lirë dhe të jetë e pasqyruar me shkrim në dokumentacionin përkatës.

Respektimi i të drejtave të të miturve të ndaluar/arrestuar

7. Në veçanti grupi i monitorimit e pa të nevojshme të ndalë në respektimin e të drejtave të personave të mitur të ndaluar/arrestuar nga policia. Nisur nga analiza e mësipërme mbi aksesin e të miturve të ndaluar/arrestuar për informim për të drejtat e tyre, praninë

e prindërve, akses për avokat, akses për psikolog rekomandohet që autoritetet shqiptare të marrin masa rigoroze për të mos lejuar në asnjë rast që i mituri të merret në pyetje pa praninë e avokatit mbrojtës, pavarësisht heqjes dorë nga e drejta për të pasur avokat mbrojtës.

8. Gjithashtu rekomandohet që autoritetet shqiptare të marrin masa për të zbatuar me rigorozitet praninë e psikologut dhe prindit në çdo gjendje dhe shkallë të procedimit, duke punësuar në stafin e komisariatit specialist përkatës në fushën e psikologjisë. Rekomandohet që posti i psikologut të okupohet nga një profesionist i fushës, me arsim universitar përkatës, gjë e cila rrit mundësinë për dhënie ndihme të kualifikuar dhe profesionale në këtë fushë.

Zhvillim të kurseve trajnuese për përditësim të parimeve dhe koncepteve ligjore

9. Duke qenë se gjatë monitorimit u konstatuan raste të mospërputhjes së orës apo të momentit të flagrancës me situatën e përshkruar në procesverbalet e arrestimit në flagrancë, duhet t'i kushtohet vëmendje e veçantë konceptit të arrestit në *flagrancë*, për të garantuar që policia të mos i tejkalojë kompetencat e saj në ndalimin e personave. Për këtë arsye rekomandohet zhvillimi i kurseve trajnuese për përditësimin e parimeve dhe koncepteve ligjore, në mbrojtje të të drejtave të njeriut, respektimit të ligjit dhe për plotësim të njohurive në zbatim të ligjit nr. 9749, dt. 04.06.2007 "*Për Policinë e Shtetit*".

Kushtet materiale

10. Ndërtimin e ambienteve të shoqërimit në Komisaritet e Policisë Pukë sipas kërkesave të ligjit dhe akteve normative.

11. Vendosjen e sistemit të monitorimit në ambientet e shoqërimit, në Komisaritin e Policisë Pukë. Monitorimi duhet të fillojë nga hyrja e ndërtesës së komisaritetit të policisë, duke mos pasur asnjë moment shkëputje deri në ambientin ku personi do qëndrojë, si dhe mundësimin e ruajtjes së tyre në një afat jo me pak se një javë.

Vështrim i përgjithshëm i aktivitetit të policisë në lidhje me respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut

Në funksionin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës, Avokati i Popullit në rolin e MKPT ka kryer dhe 65 inspektime, ri-inspektime dhe kontrole tematike në të gjitha strukturat e Policisë së Shtetit në vend. Janë hartuar dhe paraqitur 11 rekomandime, në lidhje me përmirësimin e standardeve të të drejtave dhe trajtimit të individëve që strehohen në këto institucione. Gjithashtu dhe 6 rekomandime lidhur me rastet e konstatuara të dhunës, veprimeve arbitrare nga organet e policisë.

Problematikat e konstatuara gjatë inspektimeve në komisaritet e policisë dhe rekomandimet përgjithësuese

Ndërtimin apo rikonstruksionin e ambienteve të shoqërimit dhe të sigurisë në të gjitha organet e Policisë së Shtetit, sipas kërkesave të ligjit Nr.9749, datë 04.06.2007 "*Për Policinë e Shtetit*", manualit "*Për Rregullat e Trajtimit e Sigurimin e të Ndalarve dhe Arrestuarve në Dhomat e Sigurisë në Njësitë Policore*".

Trajnimin e punonjësve të policisë së shtetit, me qëllim njohjen dhe zbatimin rigoroz të akteve normative gjatë shoqërimit, ndalimit apo arrestimit të shtetasve në organet e policisë, si dhe trajtimin dinjitoz të tyre.

Këto problematika, i janë adresuar strukturave të Policisë së Shtetit në vazhdimësi nga institucioni i Avokatit të Popullit, si dhe është kërkuar zgjidhja e tyre në mënyrë të vazhdueshme e konstante.

Në përmbushje dhe në zbatim të sa më sipër, Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit ka hartuar Programin e Punës për përmbushjen e rekomandimeve të Avokatit të Popullit, si dhe ka ngritur grupin e punës për ndjekjen dhe zbatimin e detyrave në përmbushje të këtyre rekomandimeve.

Në programin e punës përcaktohen masa dhe detyra konkrete që duhet të merren për realizimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit. Për disa nga këto detyra janë vendosur edhe afate.

Gjatë inspektimeve të zhvilluara gjatë këtij viti konstatohet se nga disa organe të Policisë së Shtetit janë bërë disa përmirësime dhe konkretisht;

-Miratimi i plan-veprimeve konkrete nga Drejtoritë e Policisë së Qarqeve dhe Komisaritet e Policisë për strukturat në varësi të tyre për zbatimin e programit të lartpërmendur;

-Ndërtimi i ambienteve të reja të shoqërimit dhe të sigurisë sipas standardeve bashkëkohore në Drejtorinë e Policisë Qarkut Tiranë dhe Komisaritin e Policisë Durrës.

-Reagim pozitiv, konkretizuar nëpërmjet përcjelljes pranë Komisionit të Ligjeve të Kuvendit të Shqipërisë, në zbatim të rekomandimeve të Avokatit të Popullit paraqitur pranë Ministrin të Brendshëm dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, gjatë viteve të mëparshme për ndryshimin dhe përmirësimin e Ligjit nr. 9749, datë 04.06.2007 "Për Policinë e Shtetit".

-Vendosja në çdo Komisariat Policie i një trajneri, me qëllim trajnimin e vazhdueshëm të punonjësve të policisë që shërbejnë në ambientet e shoqërimit dhe të sigurisë;

-Standardizimi i librit të personave të shoqëruar/ndaluar dhe arrestuar sipas kërkesave të përcaktuara në Ligjin Nr.9749, datë 04.06.2007 "Për Policinë e Shtetit" dhe manualin "Për Rregullat e trajtimit e sigurimin e të ndaluarve dhe arrestuarve në dhomat e sigurisë në njësitë policore".

-Vendosja pothuajse në të gjitha organet e policisë të librit të ankesave të personave të shoqëruar, ndaluar, ose arrestuar;

-Bashkëpunimi i strukturave të policisë dhe hapje me shoqërinë civile, me të cilën janë lidhur disa marrëveshje;

-Heqja e sendeve që reflektojnë dhunë në zyrat e oficerëve të policisë gjyqësore dhe ato ku merren në pyetje personat e ndaluar dhe arrestuar.

-Krijimi i ambienteve të reja të intervistimit të shtetasve në Komisaritet e policisë Elbasan dhe Pogradec.

-Vendosja pothuajse në të gjitha ambientet e shoqërimit dhe të sigurisë të tabelave me të drejtat e personave të shoqëruar, ndaluar/arrestuar.

-Përdorimi pothuajse në të gjithë Komisaritet e Policisë e një formular tip ku janë listuar të drejtat e personit të shoqëruar, ndaluar/arrestuar.

Krahas arritjeve pozitive janë konstatuar edhe një numër i konsiderueshëm problematikash që lidhen me kushtet e ambienteve të shoqërimit e të sigurisë, si dhe me mënyrën e zbatimit të ligjit nga punonjësit e Policisë së Shtetit gjatë shoqërimit/ndalimit dhe arrestimit të shtetasve, si dhe me mënyrën e trajtimit të tyre në këto ambiente, të cilat çënojnë të drejtat dhe liritë e qytetarit.

Lidhur me ambientet e shoqërimit dhe të sigurisë.

1.Ambiente shoqërimi jashtë standardeve të kërkuara në ligj mbeten ato në Komisaritet e Policisë Elbasan, Gramsh, Librazhd, Peqin, Devoll, Ersekë, Pogradec, Peshkopi, Burrel, Bulqizë, Berat, Çorovodë, Kuçovë, Mirditë, Kurbin, Lushnje, Mallakastër, Krujë, Shijak, Shkodër, Pukë, Malsi e Madhe, Tepelenë, Përmet, Vlorë, Sarandë, Delvinë, Has, Tropojë si dhe Komisaritet e Policisë Nr.1, 2, 3, 4 dhe 6 Tiranë.

2.Ambiente sigurie jashtë standardeve të kërkuara në ligj mbeten ato në Komisaritet e Policisë Elbasan, Pogradec, Peshkopi, Burrel, Berat, Lushnjë, Krujë, Shkodër, Vlorë, Sarandë si dhe në Komisaritet e Policisë Nr.1, 2 dhe 3 Tiranë.

Lidhur me trajtimin e personave të shoqëruar, ndaluar dhe arrestuar;

- Prezenca e mangësive në plotësimin e librit të personave të shoqëruar/ndaluar dhe arrestuar lidhur me pasqyrimin e të gjitha veprimeve të policisë, si koha dhe arsyeja e shoqërimit/ndalimit apo arrestimit, shenjat e lëndimit, emri i zyrtarit, i cili ka kryer veprimet, vendi ku është mbajtur, koha kur personi ka mbërritur në mjediset e policisë, kur është informuar për të drejtat e tij, kur është pyetur, si dhe kur ka pasur kontakte me një anëtar të familjes, një avokat ose një mjek.

-Vazhdimi i trajtimit të të dyshuarit për kryerje të një vepre penale si i shoqëruar. Ndërkohë që veprime të tilla vijnë në kundërshtim me nenin 11, pika 6, të Ligjit Nr.9749, datë 04.06.2007 "Për Policinë e Shtetit".

-Plotësimi i procesverbalit të ndalimit apo arrestimit në flagrancë të shtetasve jo në orën faktike të kapjes së tyre. Bazuar në nenet 144, 250 të K.Pr.Penale, shënimi në procesverbal i çastit (orës) së arrestimit në flagrancë ose të ndalimit është një element i rëndësishëm mbi bazën e të cilit fillojnë të llogariten efektet e paraburgimit. Ndërsa në bazë të nenit 258 të K.Pr.Penale, nga çasti (ora) e arrestimit ose ndalimit fillon afati i 48-të orëve, brenda të cilës prokurori kërkon vleftësimin e masës së sigurimit në gjykatën e vendit ku është kryer arrestimi ose ndalimi.

-Mbajta e provave materiale në zyrat e oficerëve të policisë gjyqësore, për mungesë të një ambienti të veçantë.

- Mungesa pothuajse në pjesën më të madhe të komisariateve të policisë të sistemeve monitoruese për të mbajtur të survejuar ambientet e shoqërimit dhe të sigurisë Përrjashtoj komisaritet e policisë Korçë, Tiranë dhe Durrës

- Mungesa në disa raste e njoftimit të familjarëve apo personit të besuar, ora e njoftimit të

tyre, emri i të njoftuarit dhe numri i telefonit.

-Mos dhënia e ndihmës juridike që në momentin kur personit i privohet liria.

-Mos sigurimi në çdo rast i përfaqësimit ligjor falas, për të gjithë kategorinë e personave që nuk kanë mundësi financiare për ta siguruar atë.

-Mungesa e ndihmës së detyrueshme juridike dhe psikologjike, në rastet e arrestimit apo të ndalimit të një mituri. Rasti më flagrant mbetet ai në Komisariatet e Policisë Korçë, ku gjatë inspektimit u gjetë një i mitur i cili pyetej pa psikolog, edhe se në atë moment psikologu i Drejtorisë së Policisë Qarkut Korçë ishte prezent dhe po shoqëronte grupin e inspektimit, nuk ishte njoftuar për të marrë pjesë gjatë pyetjes të shtetasit të mitur.

-Mungesa në disa Komisariate/Drejtori Policie të formularëve informues për të drejtat e personave të shoqëruar, të ndaluar, apo arrestuar kur këta janë shtetas të huaj.

- Kushte të papërshtatshme dhe mungesë aftësish organizative për trajtimin me ushqim, konform normave për trajtimin me ushqim të përcaktuar në urdhrin e përbashkët Nr.432, datë 10.03.2008 të Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Shëndetësisë. Komisaritet e policisë Korçë, Pogradec, Vlorë, Sarandë, Gjirokastër, Shkodër dhe Elbasan.

-Kushte të pa përshtatshme për trajtim mjekësor si dhe mungesë të funksionit organik mjek në dy drejtori policie. Më konkretisht.

-Në Drejtorinë e Policisë Qarkut Dibër dhe Berat nuk ka ambient me qëllim kryerjen e kontrollit mjekësor.

-Në drejtoritë e policisë Dibër dhe Kukës, të ndaluarve/arrestuarve vazhdonte t'ju bëhej kontrolli mjekësor në spitalet rajonale, Burrel, Bulqizë, Peshkopi, Kukës, Has dhe Tropojë, për shkak se në organikën drejtorive të policisë në fjalë nuk ka të përcaktuar në organigramat përkatëse mjek të përgjithshëm, i cili të ketë një ambient (dhomë) të përshtatshme për të bërë vizita dhe për të mbajtur medikamentet mjekësore të nevojshme. Ky funksion ishte vendosur në përbërje të Sektorit të burimeve njerëzore i emërtuar "Kryeinfermier".

-Në informacionin e marrë nga punonjësit e policisë së rendit, në këtë Drejtori Policie, mësuam se mungesa e funksionit të mjekut, në disa raste kishte sjellë shqetësime në punën e këtij sektori, për faktin se mjekët e spitaleve rajonale rekomandonin që të ndaluarve/arrestuarve, t'ju bëhej trajtimi mjekësor brenda ambienteve spitalore edhe kur ata nuk kishin nevojë për një gjë të tillë. Këto veprime të personelit mjekësorë jo vetëm që e kompromentonin pozitën e tyre, por krijonin gjithashtu sforcime në shërbimet e policisë së rendit, pasi në strukturën e këtij sektori nuk janë parashikuar forca të veçanta, për ruajtjen e të ndaluarve/arrestuarve, brenda ambienteve spitalore.

Të dhëna për rastet e konstatura të dhunës, veprimeve arbitrare nga organet e policisë shqyrtuara nga MKPT gjatë vitit 2013.

Prezantimi i rasteve dhe rekomandimet konkrete:

Nr. Dok. 201300567/3	
-----------------------------	--

Rekomandojmë ndërprerjen e menjëhershme të veprimeve të punonjësve të policisë të Drejtorisë së Policisë Qarkut Tiranë, për mbajtjen në vëzhgim të fshehtë të shtetasit Skënder Tufa dhe tre ish të përndjekur politik të regjimit monist, ish-grevistët e urisë, Fatmir Lloçi, Petrit Lipe dhe Besim Valeri.

1. Ndërprerjen e menjëhershme të veprimeve të punonjësve të policisë të Drejtorisë së Policisë Qarkut Tiranë, për mbajtjen në vëzhgim të fshehtë të shtetasit Skënder Tufa dhe tre ish të përndjekur politik të regjimit monist, ish-grevistët e urisë, Fatmir Lloçi, Petrit Lipe dhe Besim Valeri.
2. Ndërprerjen e menjëhershme të shoqërimeve të paligjshëm ndaj grupit të personave, ish të dënuar politikë nga regjimi komunist si dhe marrjen e masave për respektimin rigoroz të kriterëve ligjore për shoqërimin e shtetasve në mjediset e policisë.
3. Shqyrtimin me seriozitet dhe objektivitet të këtij rasti. Fillimin e ecurisë disiplinore dhe dhënien e masave disiplinore ndaj punonjësve të policisë që kanë bërë, si dhe personave që kanë urdhëruar, shoqërimin në mjediset e policisë të shtetasve Skënder Tufa, Fatmir Lloçi, Petrit Lipo dhe Besim Valeri.
4. Përgjithësimin e këtij rasti me qëllim mos përsëritjen nga ana e punonjësve të Policisë së Shtetit të shkeljes së të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, objekt i këtij rekomandimi në të ardhmen.

Nr. Dok. 201300567/6	
-----------------------------	--

Rekomandim për ndërprerjen e menjëhershme të veprimeve të kundërligjshme të punonjësve të Drejtorisë së Policisë të Qarkut Tiranë ndaj shtetasit Skënder Tufa etj., ish të dënuar politik të regjimit komunist.

1. Marrjen e masave të menjëhershme për ndërprerjen e veprimeve të kundërligjshme të Drejtorisë së Policisë të Qarkut Tiranë, për shoqërimin herë pas here në polici dhe mbajtjen në vëzhgim të shtetasve Skënder Tufa, Fatmir Lloçi, Petrit Lipe dhe Besim Valeri.
2. Shqyrtimin dhe analizimin me seriozitet dhe objektivitet të këtij rasti, fillimin e ecurisë disiplinore dhe dhënien e masave disiplinore ndaj punonjësve të policisë që kanë urdhëruar vëzhgimin e shtetasit Skënder Tufa.
3. Përgjithësimin e këtij rasti me qëllim mos përsëritjen nga ana e punonjësve të Policisë së Shtetit të shkeljes së të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në të ardhmen.

Nr. Dok. 201300598/7	
-----------------------------	--

Rekomandim për respektimin rigoroz të kriterëve ligjore për shoqërimin e shtetasve në mjediset e policisë.

1. Marrjen e masave për respektimin rigoroz të kritereve ligjore për shoqërimin e shtetasve në mjediset e policisë.
2. Ndërprerjen e menjëhershme të shoqërimeve të paligjshme në organin e policisë të shtetasit Oltion Nurçe.
3. Shqyrtimin me seriozitet e objektivitet të këtij rasti dhe nxjerrjen e përgjegjësive konkrete. Fillimin e ecuresë disiplinore dhe dhënien e masës disiplinore ndaj oficerit të policisë gjyqësore Jetnor Xhaferri i cili ka urdhëruar punonjësit e policisë për shoqërimin në mjediset e policisë të shtetasit Oltion Nurçe.

Nr. Dok. 201300979/4

Rekomandime lidhur me ngjarjen e vetëvarjes së shtetasit N. K në ambientet e shoqërimit të Komisarariatit të Policisë Nr.3 Tiranë.

1. Analizimin e ngjarjes së vetëvarjes së shtetasit N. K në ambientet e shoqërimit të Komisarariatit të Policisë Nr.3 Tiranë dhe nxjerrjen e përgjegjësive administrative të drejtuesve të Drejtorisë së Policisë së Qarkut Tiranë dhe të Komisarariatit të Policisë Nr.3 Tiranë, të cilët nuk kanë marrë masat e nevojshme për ndërtimin e ambienteve të shoqërimit konform ligjit dhe organizimin e shërbimeve të policisë me qëllim parandalimin e ngjarjeve të padëshirueshme brenda mjediseve të policisë
2. Përgjithësimin e rastit të vetëvarjes së shtetasit Ndue Kolthi dhe të shkaqeve të ndodhjes së kësaj ngjarjeje në të gjitha organet e policisë vendore me qëllim rritjen e cilësisë së shërbimit policorë dhe parandalimin e ngjarjeve të ngjashme në të ardhmen.
3. Rishikimin dhe përmirësimin e *“Plan-vendosjes së shërbimeve të policisë së rendit”* në Komisariatin e Policisë Nr.3 Tiranë dhe në të gjitha organet vendore të policisë në shkallë vendi, si dhe plotësimin e tyre me numrin e punonjësve të policisë të domosdoshëm për të kryer sa më mirë dhe me cilësi të lartë detyrat funksionale. Nëse ky shërbim nuk mund të mbulohet me punonjës policie, të shikohet mundësia e ndërtimit të një sistemi monitorimi të ambienteve të shoqërimit nga zyra e specialistit të informacionit.
4. Marrjen e masave të menjëhershme për ndërtimin e dhomave të shoqërimit të shtetasve në Komisariatin e Policisë Nr.3 Tiranë dhe në të gjitha Komisarariatet e Policisë në shkallë vendi, ku ato mungojnë, sipas kërkesave të ligjit nr. 9749, datë 04.06.2007 “Për Policinë e Shtetit” dhe në zbatim të Letër - Porosisë së Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit Nr. 703, dt. 07.08.2008, duke krijuar ambiente të përshtatshme, dinjitoze, të pajisura me orenditë e nevojshme për qëndrim, të ndara me vete për femrat, meshkujt dhe të miturit, si dhe pa dyer apo zgara hekuri dhe pa shula e dryna.
5. Marrjen e masave të nevojshme nga strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit për organizimin e kontroleve në organet e policisë vendore lidhur me zbatimin e detyrave të përcaktuara në ligj, në Letër - Porosi, Urdhra, Udhëzime, si dhe të Rekomandimeve të Avokatit të Popullit që lidhen me problemet e përshkruara më sipër.

Nr. Dok. 201301432/2

Rekomandim për respektimin rigoroz të kritereve ligjore për shoqërimin e shtetasve në mjediset e policisë.

1. Marrjen e masave për respektimin rigoroz të kriterëve ligjore për shoqërimin e shtetasve në mjediset e policisë.
2. Shqyrtimin me seriozitet e objektivitet të këtij rasti dhe nxjerrjen e përgjegjësisve konkrete. Fillimin e ecurisë disiplinore dhe dhënien e masës disiplinore ndaj punonjësve të policisë që kanë bërë shoqërimin e shtetasve Sh. Sh dhe F. R në mjediset e policisë.

Nr. Dok. 201302125/3

Rekomandim për fillimin e procedimit disiplinorë ndaj punonjësve të Patrullës së Përgjithshme B. T dhe H.H si dhe OPGJ L. F efektiv në Komisaratin e Policisë Nr.2 Tiranë.

1. Fillimin e procedimit disiplinorë ndaj dy punonjësve të Patrullës së Përgjithshme të policisë dhe Oficerit të Policisë Gjyqësore L. F konform nenit 76 të Ligjit nr.9749, datë 04.06.2007 “Për Policinë e Shtetit”.
2. Shkeljet ligjore të konstatuara në këtë rast të përgjithësohen, me qëllim që raste të tilla të shkeljes së të drejtave të shtetasve të mos përsëriten në të ardhmen.

KREU III

Roli proaktiv i Institucionit të Avokatit të Popullit

1. Pritja e qytetarëve

Hyrje

Pritja e qytetarëve dhe kryerja e shërbimeve me etikë, kulturë dhe profesionalizëm në momentin e paraqitjes të ankesave pranë Institucionit të Avokatit të Popullit, përbën një detyrim ligjor, por njëkohësisht është dhe një nga prioritetet kryesore të punës së institucionit, për të cilën është krijuar dhe funksionon Drejtoria e Shërbimeve ndaj Qytetarëve. Ky ndryshim strukturor, nga eksperiencia e deritanishme, ka ngritur nivelin e trajtimit të ankesave të qytetarëve në një nivel më të lartë.

Zyra e pritjes dhe shërbimeve ndaj qytetarit, që në fillesat e institucionit ka qenë dhe mbetet pika e parë e kontaktit të qytetarëve me institucionin. Nëpërmjet kësaj zyre, qytetarët njihen me natyrën e institucionit të Avokatit të Popullit nga pikëpamja kushtetuese dhe ligjore, asistohen në plotësimin e formularëve të ankesave, si dhe këshillohen dhe orientohen qytetarët për rrugët ligjore që duhet të ndjekin, kur ankesat janë jashtë sferës të juridiksionit dhe kompetencës të Avokatit të Popullit.

Nisur nga objekti i ankesave, në zyrën e pritjes qytetarët informohen gjithashtu dhe mbi legjislacionin në fuqi që mbron të drejtën e pretenduara prej tyre, si dhe me institucionet e administratës publike (qendrore dhe lokale) që e garantojnë dhe kanë detyrim ligjor mbrojtjen e saj.

Mbrojtja dhe promovimi i të drejtave dhe lirive të njeriut, është parë e lidhur ngushtësisht me rritjen e rolit pro aktiv dhe cilësisë së punës të stafit të ndihmëskomisionerëve. Një nga masat e rëndësishme që është ndërmarrë në këtë aspekt, është ngritja dhe funksionimi çdo ditë i një komisioni “*ad-hoc*” me përbërje nga ekspertë të seksioneve dhe Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës, të cilët në rolin e një “*zyrë këshillimi*”, në varësi të objektit të ankesave bëjnë klasifikimin e tyre, “*ankesa brenda juridiksionit dhe kompetencës*” për t’u shqyrtuar më tej nga ekspertët sipas të drejtës që mbulojnë, si dhe, në “*këshillime dhe orientime*” për ankesat që nuk janë objekt i kuadrit ligjor, mbi të cilin funksionon institucioni i Avokatit të Popullit.

Kjo mënyrë e klasifikimit të ankesave, ka sjellë uljen e numrit fiktiv të ankesave të shqyrtuara, ka shkurtuar kohën e shqyrtimit të çështjeve që nuk janë në juridiksionin dhe kompetencën e Avokatit të Popullit dhe kthimin e përgjigjeve qytetarëve brenda afateve

të përcaktuara në Kodin e Procedurave Administrative dhe Rregulloren e Brendshme të institucionit.

Ndërkohë nga pikëpamja procedurale, shqyrtimi i ankesave ka vazhduar dhe kryhet për çështje që janë në objektin e punës të Avokatit të Popullit, të cilat i janë nënshtruar një procedure hetimi më të plotë të së drejtës të pretenduar nga qytetarët apo subjektet fizike dhe juridike ndaj administratës publike; kryerjen e një numri më të madh të inspektimeve në zyrat e administratës publike, në varësi të objektit të ankesës; rritjen e numrit të ankesave të shqyrtuara me iniciativë, nisur nga problematika që qytetarët i kanë bërë publike në median e shkruar dhe atë vizive; dhe pa dyshim rritjen e numrit të rekomandimeve kundrejt administratës publike, etj., masa këto që kanë ndikuar në rritjen e performancës të punës të stafit të ekspertëve, por dhe në cilësinë e përgatitjes të rekomandimeve sipas fushës dhe të drejtës, në mbrojtje të interesit të qytetarëve nga shkeljet e administratës publike.

Zyra e pritjes së qytetarëve ka shërbyer njëkohësisht dhe si një “filtër” për ankesat e adresuara Avokatit të Popullit nëpërmjet postës, zyrave rajonale, “Ditëve të hapura”, në adresat zyrtare të E-mail dhe Facebook, numrit të telefonit të publikut 0689034648 i cili qëndron hapur gjatë 24 orëve, si dhe numrit jeshil 0800 1111.

Ky proces i marrjes së ankesave të qytetarëve është bërë i njohur për publikun gjatë kontakteve të drejtpërdrejta me qytetarët në organizimin e “Ditëve të Hapura”, si dhe përmes afishimit të pikave të kontaktit në faqen zyrtare të internetit të institucionit, pranë zyrave rajonale, në drejtoritë dhe komisariatet e policisë, në të gjithë sistemin e IEVP-ve, spitalet psikiatrike, etj.

Për vitin 2013 numri i ankesave, kërkesave apo njoftimeve të depozituara nga qytetarët në institucionin e Avokatit të Popullit, ka shkuar në 4346 ankesa. Nga të cilat, 2943 ankesa janë konsideruar “*brenda juridiksionit dhe kompetencës*” të Avokatit të Popullit dhe, 1403 ankesa janë konsideruar si “*këshillime dhe orientime*” për qytetarët.

Konkretisht:

❖ Zyra e pritjes së AP	1826	ankesa
❖ Ankesa me postë	1607	“
❖ Ditë të hapura	362	“
❖ Zyrat rajonale	274	“
❖ Ankesa online	286	“
❖ Ankesa me telefon	121	“

Pritja e qytetarëve

Një ndër instrumentet kryesorë, që luan një rol kyç dhe thelbësor në funksionimin e institucionit të Avokatit të Popullit, është Zyra e Shërbimeve ndaj Qytetarit.

Gjatë vitit 2013, pranë kësaj zyre kanë paraqitur ankesat e tyre 1826 qytetarë, prej të cilave, 1009 ankesa kanë ndjekur procedurën e parashikuar në Rregulloren e Brendshme të institucionit, atë të regjistrimit dhe shqyrtimit të mëtejshëm nga ana e ndihmëskomisionerëve të seksioneve, në varësi të objektit të ankesës.

Nga ana tjetër, një numër prej 817 ankesash, objekti i të cilave kanë qenë jashtë juridiksionit dhe kompetencës së Avokatit të Popullit, janë kategorizuar si *“këshillime dhe orientime verbale”* që u janë dhënë qytetarëve nga ana e specialistëve, duke i këshilluar mbi rrugën ligjore që duhet ndjekur, si dhe duke i orientuar drejt institucioneve publike për të kërkuar të drejtën e pretenduar prej tyre.

Zyra e Shërbimeve ndaj Qytetarëve, ka kryer në të njëjtën kohë dhe funksionin e dhënies të *“këshillimeve dhe orientimeve ligjore në rrugë shkresore (zyrtare)”*, përsa i përket numrit të ankesave të ardhura në institucionin e Avokatit të Popullit nëpërmjet postës, adresës elektronike dhe rrjeteve sociale, të cilat janë konsideruar nga komisioni *“ad-hoc”*, *“jashtë juridiksionit apo kompetencave”*. Numri i këshillimeve dhe orientimeve të paraqitura qytetarëve në mënyrë shkresore arrin në 586 raste të ankesave.

Më poshtë do të gjeni tabelën e *“këshillimeve dhe orientimeve”* shkresore dhe verbale, për llojet e ankesave të cilësuar *“jashtë juridiksionit dhe kompetencës”* së Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2013:

Nr.	Grupi i Ankesave	Numri i këshillimeve
1	Ankesa ndaj vendimeve të gjykatave dhe prokurorive	370
2	Ankesa për konflikte civile	219
3	Ankesa ndaj subjekteve private	195
4	Kërkesa për përfaqësim në gjykatë	166
5	Ankesa vënie në dijeni	50
6	Ankesa ndaj institucioneve të shteteve të huaja	34
7	Konflikte në familje	81
8	Të tjera (Ankesa të paqarta, kërkesa për ndihmë financiare, kërkesa për punësim, ankesa për mospërfitim të tokës bujqësore, etj)	288
9	Totali	1403

Nga sa pasqyrohet, përqindjen më të lartë të këshillimeve prej 26% e zënë përgjigjet ndaj ankesave të qytetarëve kundër vendimeve të gjykatave shqiptare të të gjitha niveleve, si dhe kundër vendimeve të prokurorive të rretheve gjyqësore, mbi mosfillimet e procedimeve penale apo pushimet e çështjeve. Në këto raste, qytetarët janë orientuar të ndjekin brenda afateve ligjore rrugën e ankimit sipas shkallëve të sistemit gjyqësor, ashtu si, kundër vendimeve të marra nga prokurorët e çështjeve në prokuroritë e rretheve gjyqësore t'i drejtohen me ankesë Prokurorit të Përgjithshëm, në bazë dhe të nenit 24/5 të Kodit të Procedurës Penale.

Një pjesë e konsiderueshme e ankesave (20%) janë kategorizuar jashtë sferës së juridiksionit të Avokatit të Popullit, për shkak se ankesat kanë qenë pa objekt të qartë dhe anonime; kërkesa për punësim; kërkesa për ndihma financiare; ankesa për mospërfitim të tokës bujqësore mbi bazën e ligjit nr. 7501, datë 19.07.1991 etj. Lidhur me këto ankesa, qytetarët janë këshilluar për të saktësuar objektin e ankesës dhe institucionin përgjegjës publik që ka shkelur të drejtën e pretenduar prej tyre, ndaj dhe një pjesë ankesave janë ridërguar institucionit të Avokatit të Popullit nga ana e qytetarëve, pas saktësimit të objektit të ankesës.

Siç paraqitet më lartë, në masën 16% të këshillimeve dhe orientimeve e zënë ankesat me objekt "konflikte civile midis individëve", për shkak të cënimit të të drejtës së pronësisë të pretenduara nga palët, dhe në përmbajtjen e të cilave kërkohet ndërhyrja e institucionit të Avokatit të Popullit për zgjidhjen e konfliktit. Në përgjigjet e këtyre ankesave, qytetarët janë këshilluar t'i drejtohen gjykatës për zgjidhjen e të gjitha llojeve të konflikteve.

Të shumta në numër (14 %) janë edhe ankesat që qytetarët kanë paraqitur ndaj subjekteve private, në objektin e të cilave parashtrohen pretendime ndaj punëmarrësve, si zgjidhje të menjëhershme të kontratave të punës në mënyrë të pajustificuar, apo pretendime mbi mosrespektimin e kushteve të kontratave të punës, etj. Qytetarët në këto raste, janë këshilluar dhe orientuar për t'iu drejtuar gjykatave, duke respektuar të drejtat, detyrimet dhe afatet ligjore që përcaktohen në Kodin e Punës.

Gjithashtu pranë Avokatit të Popullit, janë paraqitur një numër kërkesash nga ana e qytetarëve (12%) për përfaqësimin në gjykatë nga ana e ekspertëve të institucionit për çështje të dërguara në gjykatë prej tyre. Në rastet e këtyre kërkesave, qytetarët janë njohur me moskompetencën tonë për të përfaqësuar asnjë palë në gjykatë, si dhe janë orientuar për të kontaktuar me avokatë privat. Kur qytetari ankohet për mospasjen e mundësive financiare për të lidhur një avokat privat, në kuadër të memorandumit të bashkëpunimit, kërkesat e tyre i janë deleguar për kompetencë Komisionit Shtetëror për Ndihmë Juridike Falas pranë Ministrisë së Drejtësisë.

Konfliktet brenda familjes deri dhe kërcënimet për jetën, janë një numër të vogël i ankesave, por shumë problematikë për shoqërinë tonë (6%). Në rastin e këtyre ankesave, qytetari është këshilluar dhe orientuar, të bashkëpunojë ngushtësisht me organet e policisë për parandalimin e ngjarjeve ose të bëjë denoncim me shkrim pranë organit të policisë dhe atij të prokurorisë për ndjekjen e mëtejshme të çështjes, deri në gjykatë. Në rastet e kërcënimeve të jetës të grave dhe të fëmijëve, ankuesit janë këshilluar të kërkojnë urdhra mbrojtje në gjykatë.

Një kategori tjetër e ankesave të qytetarëve janë, ato drejtuar organeve të administratës publike, duke vënë në dijeni edhe institucionin e Avokatit të Popullit mbi problematikën e shprehur (4%). Nisur nga objekti i këtyre ankesave, qytetarët janë këshilluar të kërkojnë të drejtën e pretenduar institucionit të cilit ai i është drejtuar dhe, në rast të mungesës së vullnetit për të sqaruar qytetarin, të mos dhënies së informacionit, apo moskthimit të përgjigjes brenda afateve të përcaktuara në Kodin e Procedurave Administrative dhe Ligjit “Për Informimin”, kemi orientuar t’i drejtohen menjëherë institucionit të Avokatit të Popullit, për ta konsideruar dhe shqyrtuar si një të drejtë kushtetuese dhe ligjore ankesën e qytetarit.

Objekt tjetër i ankesave të këshilluara, janë ankesat e pretenduara nga qytetarët shqiptarë, ndaj vendimeve të gjykatave të shteteve të huaja, kryesisht në lidhje me shkeljen e të drejtave dhe procedurave gjatë gjykimit të çështjes në gjykatë. Gjithashtu ka pasur një numër të ankesave drejtuar Avokatit të Popullit, për shkelje të të drejtave të qytetarëve ndaj autoriteteve të shteteve të huaja brenda dhe jashtë vendit.

Në rastet e ankesave më specifike, Avokati i Popullit, nëpërmjet autoritetit që jep ligji dhe marrëveshjeve ndër-institucionale me organizmat ndërkombëtarë, i është drejtuar për kompetencë Ombudsmanëve homologë, për ta konsideruar çështjen brenda kuadrit ligjor të vendeve përkatëse, duke vënë në dijeni dhe qytetarin. Në pjesën më të madhe të rasteve, qytetarët janë këshilluar dhe orientuar, të kontaktojnë avokat privat të shteteve përkatëse, për ndjekjen e çështjes në gjykatë.

2. Veprimtaria e Zyrave Rajonale dhe “Ditët e Hapura”

Zyrat rajonale

Në vizionin e Avokatit të Popullit, shprehur qartë dhe në Strategjinë e institucionit për vitin 2013-2015, me qëllim mbrojtjen efektive të të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshëm të qytetarëve, institucioni i Avokatit të Popullit operon nëpërmjet Zyrave rajonale të hapura në disa prej qendrave më të mëdha urbane, sipas shpërndarjes gjeografike të vendit. Aktualisht janë hapur dhe funksionojnë 4 zyra rajonale nga 6 zyra që është objektivi i Avokatit të Popullit, në kuadër të dhe të Strategjisë së institucionit.

Qëllimi i hapjes të zyrave rajonale për institucionin e Avokatit të Popullit, është që t’u krijojë qytetarëve një akses më të madh dhe zgjidhje më të shpejtë të ankesave të tyre ndaj administratës publike, kryesisht me organet e pushtetit vendor, si dhe të shkurtojë distancën fizike mes qytetarit dhe institucionit, për të aplikuar në marrjen e ankesave.

Nisur nga mundësitë, duke parë dhe shpërndarjen e ankesave në vite sipas zonave gjeografike të vendit, janë përcaktuar dhe 6 bashkitë kryesore për ngritjen e Zyrave rajonale në Bashkinë Fier, Shkodër, Berat, Sarandë, Pogradec dhe Kukës.

Duke shfrytëzuar kapacitetet e brendshme njerëzore, mundësitë financiare të institucionit dhe në bashkëpunim me organet e pushtetit vendor, është bërë e mundur hapja dhe funksionimi prej vitesh i zyrave rajonale në Bashkitë Fier dhe Shkodër.

Zyra rajonale Fier është krijuar në muajin maj të vitit 2012 nëpërmjet një memorandumi bashkëpunimi ndërmjet Avokatit të Popullit dhe Bashkisë Fier duke mundësuar ofrimin e ambienteve për pritjen e ankesave të qytetarëve, ndërmjetësimin në vend mes qytetarit dhe zyrave të pushtetit vendor dhe atij lokal në trajtimin e ankesave, si dhe orientimin e këshillimin e tyre për zgjidhjen e çështjeve të paraqitura në ankesat e qytetarëve, nga ana e përfaqësuesve të Avokatit të Popullit, çdo ditë të premtë të javës.

Ndërkohë, Zyra rajonale e Shkodrës funksionon që prej nëntorit të vitit 2006 në sajë dhe të një marrëveshje trepalëshe ndërmjet institucionit të Avokatit të Popullit, “Save the Children Albania” dhe “SIDA”. Kjo zyrë, përveç funksionit të pritjes të qytetarëve për marrjen dhe këshillimin e tyre për ankesat ndaj administratës publike, ka kryer dhe funksionin e një nënseksioni dhe një organi monitorues i të drejtave të fëmijëve sipas Konventës të së Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri.

Një ndër objektivat kryesore gjatë vitit 2013, si pjesë e Strategjisë së institucionit të Avokatit të Popullit për 2013-2015, për të qenë një institucion proaktiv në shërbim të qytetarëve dhe sa më pranë tyre, në kuadër të një projekti pilot në bashkëpunim me shoqërinë civile

dhe pushtetin vendor, ka qenë zgjerimi i Zyrave rajonale në 2 bashki të tjera, me qëllim krijimin e lehtësirave për ata qytetarë të cilët në mospasje të mundësive financiare për të ardhur nga zona të largëta drejt Tiranës, t'u krijohet mundësia e paraqitjes së ankesave pranë Zyrës rajonale më të afërt në distancë gjeografike. Në këtë kuadër, për vitin 2013 është mundësuar hapja e dy zyrave të tjera rajonale në Bashkinë e Beratit dhe të Sarandës dhe është në poqes firmosja e memorandumeve më përfaqësuesit e pushtetit vendor në bashkitë Pogradec dhe Kukës, si dhe hapja e zyrave pranë tyre.

Mbi bazën e frymës dhe nënshkrimit të memorandumeve të bashkëpunimit me bashkitë respektive të qyteteve, si dhe me grupet e shoqërisë civile të asaj zone, kemi shprehur vullnete të përbashkëta për marrjen dhe zgjidhjen në kohë të ankesave të qytetarëve, vënien në dispozicion të një zyre brenda ambienteve të bashkive për ushtrimin e kompetencave të Avokatit të Popullit, si dhe caktimit të një personi kontakti, me kontribut vullnetar pa shpërblim nga vetë grupet e shoqërisë civile, në cilësinë e përfaqësuesit të Zyrës rajonale të institucionit të Avokatit të Popullit.

Gjatë vitit 2013 ka pasur një numër total prej 276 ankesash nga zyrat rajonale. Në Zyrën Rajonale Fier janë pranuar për shqyrtim duke u cilësuar brenda kompetencës së institucionit të Avokatit të Popullit 95 ankesa të qytetarëve dhe 99 ankesa të tjera janë cilësuar si "këshillime dhe orientime" që janë dhënë në rastin kur problematika e shprehur ka qenë jashtë objektit të institucionit. Për Zyrën rajonale Shkodër numri i ankesave të pranuar për shqyrtim ka arritur në 67 ankesa dhe 7 ankesa për "këshillime dhe orientime". Të pakta në numër kanë qenë ankesat e marra në Zyrat rajonale Berat dhe Sarandë nisur nga fakti i kohës së pakët të funksionimit të këtyre zyrave.

Më poshtë po paraqesim një pasqyrë të ankesave të trajtuara në Zyrat rajonale:

Zyrat Rajonale	Ankesa të pranuar	Këshillime dhe orientime	Totali
Zyra Rajonale Fier	95	99	194
Zyra Rajonale Shkodër	67	7	74
Zyra Rajonale Berat	0	8	8
Totali	162	114	276

Ditët e Hapura

Një instrument tjetër i përdorur nga ana e institucionit të Avokatit të Popullit me qëllim promovimin e lirive dhe të drejtave të qytetarëve është edhe organizimi i takimeve për marrjen e ankesave me qytetarët në rrethe të ndryshme të vendit, mbi bazën e një programi të miratuar më parë me organet e pushtetit vendor, të cilësuar si "Ditë të hapura".

Takimi i Avokatit të Popullit me qytetarët gjatë ditëve të hapura, me qëllim dëgjimin dhe marrjen e ankesave, ka rritur performancën e Institucionit në sytë e qytetarëve, besueshmërinë në ndërmjetësimin mes administratës publike dhe qytetarit për zgjidhjen e ankesave të tyre, si dhe konsiderohet një mjet efikas për njohjen e realitetit dhe pengesat që hasin qytetarët nga moszgjidhja në kohë e ankesave të tyre nga ana e organeve të pushtetit lokal dhe atij vendor.

Gjatë viti 2013 janë realizuar shumë takime në bashki dhe komuna të vendit në kuadër të “Ditëve të Hapura”, si në: Peshkopi, Burrel, Elbasan, Cërrik, Peqin, Shkodër, Fier, Pogradec Ersekë, Ballsh, Durrës, Fushë Krujë, Kurbin, Korçë, Sarandë, Lushnjë, Berat, Vlorë, etj.

Avokati i Popullit dhe në veçanti ekspertë të tij, krahas detyrës për verifikimin e çështjeve në ngarkim dhe gjatë kontrolli të zbatimit të rekomandimeve nga organet e pushtetit vendor, kanë organizuar dhe takime me qytetarët thuajse në çdo bashki dhe komunë të vendit, me qëllim mbledhjen dhe trajtimin e ankesave të qytetarëve.

Numri total i qytetarëve të pritur gjatë Ditëve të Hapura ka arritur 362 për vitin 2013. Në këto ankesa rast pas rasti qytetarët janë këshilluar për rrugët që duhet të ndjekin në lidhje me ankesën e shprehur ose u janë pranuar çështjet për trajtim të mëtejshëm prej institucionit të Avokatit të Popullit.

3. Marrëdhëniet me median

Institucioni i Avokatit të Popullit është transparent dhe sigurohet që informacioni mbi veprimtarinë e tij të jetë gjithnjë i arritshëm nga qytetarët, partnerët ndërkombëtarë apo palë të interesuara, nëpërmjet pasqyrimit të tij në media. Synimi ynë konstant është të rrehojmë vëmendjes së autoriteteve qendrore dhe vendore mbi domosdoshmërinë e përmirësimit të të drejtave dhe lirive të qytetarëve nëpërmjet prezantimit publik të problematikës së tyre. Kjo ka sjellë rrjedhimisht një bashkëpunim të fortë dhe të vazhdueshëm gjatë këtij viti mes Avokatit të Popullit dhe mediave në vend. Performanca dhe pritshmëritë e larta të krijuara në publik gjatë këtij viti kanë vërtetuar se institucioni i Avokatit të Popullit, jo vetëm ka punuar ngushtësisht me mediat bazuar në qëllimin e sipërcituar, por edhe që ky bashkëpunim ka qenë i frytshëm për sa i përket paraqitjes në publik të problematikës së lidhur me të drejtat e njeriut. Prej fillimit të mandatit, u deklarua publikisht se mediat dhe shoqëria civile do të ishin aleatët e Avokatit të Popullit gjatë këtij mandati dhe mund të thuhet se ndërveprimi i përbashkët ka qenë i dukshëm gjatë viteve 2012-2013. Asnjëherë më parë në historinë e institucionit, prezantimi dhe diskutimi i problematikës së të drejtave të njeriut nga Avokati i Popullit nëpërmjet mediave nuk ka qenë si në nivelet e dy viteve të fundit.

Dëshmia e qartë e efikasitetit të këtij bashkëpunimi me median mund të konstatohet jo vetëm në njohjen që publiku ka tashmë për prezencën dhe rolin e Avokatit të Popullit, por edhe në një numër çështjesh që janë shndërruar në tema të ditës për opinionin publik nëpërmjet televizioneve, gazetave dhe mediave të tjera kombëtare. Mund të përmendet këtu debati që Avokati i Popullit inicioi për të drejtat e personave LGBT deri tek e drejta e tyre për martesë. Kjo çështje u përcoll me shpejtësi në një debat publik në të gjitha mediat e vendit.

Duhet theksuar se bashkëpunimi me median gjatë këtij viti ka qenë i frytshëm, por edhe i dyanshëm. Veprimtaria e Institucionit të Avokatit të Popullit ka qenë shpesh e përzgjedhur si tematikë qendrore në median e përditshme, por nga ana tjetër edhe mediat kanë shërbyer shpesh për nxitjen e veprimeve institucionale nga ana e stafit tonë, në fushat që lidhen me të drejtat e njeriut. Avokati i Popullit, kabineti i tij dhe administrata e institucionit kanë kontakte të vazhdueshme institucionale, direkte dhe nëpërmjet zyrës së shtypit, me gazetarë dhe përfaqësues të mediave print, mediave online dhe atyre audiovizive. Aktivitetet e rëndësishme të Avokatit të Popullit kanë gjetur interesimin e mediave në gazeta, televizione dhe sajtet online kryesore në vend. Avokati i Popullit, anëtarë të stafit dhe kabineti kanë qenë po ashtu në vijimësi prezent në media në të gjitha rastet që media dhe publiku kanë kërkuar përfshirjen dhe angazhimin tonë, por veçanërisht në rastet kur detyra dhe ligji na obligojnë të rrehojmë vëmendjen mbi problematikën që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut në Shqipëri.

Institucioni i Avokatit të Popullit si burim informacioni

Institucioni i Avokatit të Popullit gjatë vitit 2013 ka qenë në vazhdimësi pikë referimi dhe burim lajmi për mediat dhe operatorët e tyre. Vlen të përmendet se falë institucionit të Avokatit të Popullit në muajin dhjetor organizohet në Tiranë konferenca më e rëndësishme për të drejtat e njeriut. Për herë të parë, Avokati i Popullit hapi një platformë debati dhe dialogu me të gjithë aktorët e shoqërisë për çështjet e të drejtave të njeriut. Avokati i Popullit Igli Totozani, me rastin e Ditës Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut, organizoi në datat 9-10 dhjetor një konferencë kombëtare, më e madhja e mbajtur ndonjëherë për të drejtat e njeriut në Shqipëri.

Të pranishëm në këtë konferencë kanë qenë:

Z. Vangjel Dule, nënkryetar i Parlamentit të Shqipërisë

Znj. Albana Vokshi, deputete e Parlamentit të Shqipërisë, kryetare e Komisionit për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë

Z. Ilirjan Celibashi, ministër për Marrëdhëniet midis Qeverisë dhe Parlamentit

SH.T.Z. Ettore Sequi, ambasador i Delegacionit të BE-së në Shqipëri

Z. Aleksandër Arvizu, ambasadori i SHBA-së, etj.

Në fjalën e tij në nisje të konferencës, Avokati i Popullit, Igli Totozani deklaroi se pranë institucionit do të ngrihet një bord këshillimor i përbërë nga 25 persona. “Ata do të jenë përfaqësues të shoqërisë civile, profesionistë të së drejtës universitare, persona me rol publik të rëndësishëm, do të vendosim së bashku si do të veprojmë, të kemi dialog të vazhdueshëm e të qëndrueshëm me shoqërinë civile në vend, si dhe t’i japim hapësirë asaj për të shprehur më fort rolin e saj”.

Totozani shtoi më tej se synohet që të diskutohen bashkërisht sfidat që i presin.

“Duam të krijojmë një shembull komunikimi publik në shtetin tonë, sesi organet do të duhet të komunikojnë në mënyrë të vazhdueshme me shoqërinë civile dhe të fusim një element të ri të mirëqeverisjes, që është vendimmarrja gjithëpërfshirëse”.

Gjatë diskutimeve në këtë tryezë, ambasadori amerikan në Shqipëri, Aleksandër Arvizu, ka theksuar se duhet të nxitet Kuvendi që të diskutojë propozimet e Avokatit të Popullit, për më shumë të drejta të komunitetit rom.

“Duke iu referuar ‘Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut’, do të vlerësoja faktin që të gjithë njerëzit kanë lindur duke pasur të drejta të barabarta dhe të patjetërsueshme.

Shqipëria ka qenë gjithmonë një shembull për të drejtat e njeriut. Nxsisim Kuvendin për të diskutuar rreth rekomandimeve të Avokatit të Popullit për çështjen e romëve. Perfeksioni është i vështirë të arrihet për çdo komb. Ne duhet të vazhdojmë të përpiqemi gjithmonë drejt një unioni sa më të përsosur dhe mendoj se e njëjta gjë është e vërtetë edhe në Shqipëri. Ne duhet të vijojmë drejt një unioni më të përsosur. Kuvendi ka miratuar ligje të rrepta kundër urrejtjes, por ende mungon një strehë e përhershme për romët”, tha ambasadori.

Ndërkohë ambasadori i Bashkimit European në vendin tonë theksoi se në Shqipëri duhet të ketë më shumë dialog sa u përket çështjeve të të drejtave të njeriut. Sequi i drejtoi një mesazh edhe rinisë.

“Të ketë sa më shumë dialog sa i përket të drejtave të njeriut. Përpiquni t’u dedikoheni të drejtave të njeriut, përpiquni të siguronit një të ardhme më të mire, për t’u bërë qytetarë më të mirë të BE”.

Duke iu rikthyer axhendës së vitit që lamë pas, në fokusin e punës së Avokatit të Popullit kanë qenë sërish çështjet delikate për shoqërinë, por që kanë gjetur gjithnjë përkrahjen dhe angazhimin e institucionit në kuadër të mbrojtjes së lirive dhe të drejtave të njeriut si:

- Çështja e komunitetit rom
- Çështja për personat LGBT
- Banorët e përmbytur në Shkodër
- Fenomeni i gjakmarrjes
- Greva e urisë e ish-të dënuarve politikë
- Problematika e qeramarrësve dhe banesat e ish-pronarëve
- Zgjedhja e komisionerit të ri nga radhët e personave me aftësi të kufizuar
- Problemi i pagesave të personave me aftësi të kufizuar
- Të drejtat e fëmijëve
- Të drejtat e grave
- Të drejtat e minoriteteve, etj.

Një nga prioritetet e punës së Avokatit të Popullit gjatë vitit 2013 ka qenë përmirësimi i kushteve të jetesës për komunitetin rom. Në një intervistë dhënë për DË Avokati i Popullit

Igli Totozani do të shprehej: “Integrimi i romëve në shoqërinë shqiptare, mbetet një sfidë për qeverinë e re.

“Gjëja më e rëndësishme që kemi bërë në gjatë kësaj periudhe është që në bashkëpunim me organizatat romë dhe me shoqërinë civile (janë rreth 26 shoqata me të cilat kemi punuar ngushtësisht, disa ndërkombëtare dhe disa kombëtare), kemi arritur të kuptojmë defektet e sistemit tonë social, që është numri i pakufijshëm i kritereve, që disa nga grupet sociale nuk arrijnë dot t’i tejkalojnë. Kështu që mbesin në ‘provim’ dhe nuk përfitojnë nga të mirat modeste të sistemit social shqiptar.

Ajo që ne kemi propozuar, është një trinom rekomandimesh të rëndësishme, të firmosura bashkërisht nga Avokati i Popullit dhe nga 26 shoqatat e shoqërisë civile, pjesë e të cilave edhe mjaft organizata të rëndësishme të huaja e vendase dhe federata romë. Ato i janë dërguar:

Ministrit të Mirëqenies dhe Rinisë z. Erjon Veliaj,

Ministrit të Brendshëm z. Saimir Tahirit

Ministres së Zhvillimit Urban dhe Turizmit znj. Eglantina Gjermani.

Intervista të Avokatit të Popullit, z. Igli Totozani në televizionet kombëtare

Gjatë vitit 2013 nën drejtimin e institucionit, vetë Avokati i Popullit, z. Igli Totozani, ka qenë i pranishëm në intervista në studiot televizive, të cilat kanë qenë të fokusuar:

1- Mbi punën dhe fokusin institucional të Avokatit të Popullit

2- Mbi tema dhe çështje të caktuara, të cilat janë trajtuar nga Avokati i Popullit dhe stafi i tij.

Me daljet e drejtpërdrejta të Avokatit të Popullit në media është synuar veçanërisht promovimi i të drejtave të grupeve vulnerabël, problematikave të ndryshme, promovimi i imazhit dhe punës së institucionit, qartësimi i kompetencave të Avokatit të Popullit, si dhe mbrojtjes që ai u bën të drejtave, lirive, interesave të ligjshme të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme të organeve të administratës.

Gjatë vitit 2013 Avokati i Popullit, z. Igli Totozani, ka qenë prezent në këto studio televizive dhe emisione:

- Emisioni Studio 24- /News 24
- Intervista e mbrëmjes- Patrik Sadikaj/ Ora News

- Intervista në studio për çështje të ndryshme/ A1 Report
- Intervistë në Studio- ABC Televizion
- Igli Totozani ne Jamais Vu Ora News
- Emisioni 7 pa 5 ne Vision+
- Intervista në Channel One
- Interviste dhënë për Zërin e Amerikës
- Interviste dhënë për Deutsche Welle
- Pjesëmarrës në emisionin Studio e hapur ne News24
- Intervistë e Avokatit te Popullit të Shqipërisë dhe Polonisë në News24
- Emisioni Opinion në TV Klan
- Emisioni Exclusive –Europa që dua- Top-Channel

Komisionerë, përfaqësues nga kabineti, ndihmës komisionerë dhe anëtarë të Institucionit të Avokatit të Popullit kanë qenë gjithashtu të pranishëm në televizion për të diskutuar mbi çështje të cilat lidhen drejtpërdrejt me respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut. Ekspertë të stafit tonë kanë qenë pjesëmarrës në studio televizive të Top Channel, Top News, News 24, Ora News, A1Report, Vizion Plus, Channel One , UTV, etj.

Intervista për edicionet informative janë dhënë thuajse për të gjitha televizionet ku do përmendim:

News 24

Ora News,

Vizion Plus,

Top Channel,

Top News,

A1 Report,

TVSH,

UTV,

Albanian Screen,

Tv Koha,

Tv Klan,
Channel One,
Scan Tv,
Planet Tv,
Shijak Tv, etj.

Avokati i Popullit prezent në faqet e opinioneve të të përditshmeve shqiptare

Jo vetëm në intervista dhe debate televizive, por edhe në faqet e opinioneve dhe komenteve të të përditshmeve shqiptare, Avokati i Popullit, z. Igli Totozani, ka qenë mjaft i pranishëm. Në fokus të opinioneve dhe komenteve kanë qenë të drejtat e njeriut, respektimi i tyre, çështje të legjislacionit dhe zbatimit të tij çfarë mund të përmirësohet, çfarë mund të ndryshohet për të përmirësuar cilësinë dhe standardet e jetesës së grupeve në nevojë siç janë: komuniteti rom, të drejtat e grave, të drejtat e fëmijëve, fenomeni i gjakmarrjes, personat me aftësi të kufizuar, komuniteti LGBT etj.

Faqet Online

Gjatë vitit 2013 lajmet e Avokatit të Popullit kanë pasur një pasqyrim të gjerë në mediat dhe portalet online si: Balkanweb, Top Channel, Tema, Panorama, Republika, Shekulli, Shqiptarja.com, Mapo, Shqip, Dita, Ama-News, Gazeta Start, NOA, Gazeta Idea, etj.

Pasqyrimi në media dhe portale Online i këtyre lajmeve ka sjellë dy elementë kryesorë në punën e Institucionit:

- Informacioni dhe lajmi mbi aktivitetin e Avokatit të Popullit është bërë universal, pra i aksesueshëm nga çdo vend i botës;
- Të gjithë artikujt mund të gjenden në website zyrtar www.avokatipopullit.gov.al/ në seksionin Media dhe AP.
- Analiza e veprimtarisë së institucionit e parë nën këndvështrimin e ri të krijuar nga reagimet e publikut dhe lexuesve.

Reagimet e publikut dhe sugjerimet qytetarëve të ardhura direkt nëpërmjet medimeve, kanë shërbyer si ndihmë për të ripërcaktuar pika orientimi në punën e Avokatit të Popullit bazuar në prioritetet, pritshmëritë dhe ndjeshmëritë e opinionit publik.

Institucioni i Avokatit të Popullit dhe veprimtaria e tij e pasqyruar në mediat ndërkombëtare

Një nga ngjarjet që pati jehonë në median ndërkombëtare edhe gjatë vitit 2013 ishte mbrojtja dhe përpjekjet që Institucioni i Avokatit të Popullit ka vazhduar të japë për të drejtat e komunitetit rom si dhe mbrojtja që i ka bërë Avokati i Popullit personave LGBT në Shqipëri.

Ngjarjet në fjalë gjetën trajtim në media prestigjioze ndërkombëtare si:

- Reuters
- The Associated Press
- Huffington Post
- ANSA
- Radio Free Europe
- Repubblica
- Washington Post
- Voice of America (VOA)
- Daily News
- BalkanInsight
- BBC,
- Bota Sot
- Zëri
- Revista ELLE
- Prishtina Press
- Deutsche Welle

Intervista në televizionet lokale

Veç mediave qendrore në vend, Avokati i Popullit ka qenë prezent në mediat lokale të qyteteve që ka vizituar në kuadër të “Ditëve të Hapura”. Intervistat në studio në televizionet lokale kanë pasur si qëllim informimin e komunitetit të zonës mbi veprimet dhe mosveprimet e administratës, kompetencat dhe aktivitetin e institucionit të Avokatit të Popullit, si dhe përgjigje direkte mbi problematika lokale që kanë të bëjnë me kuadrin ligjor të detyrave dhe prioriteteve të Avokatit të Popullit.

4. Komunikimi nëpërmjet faqes zyrtare të web-it dhe medias sociale

www.avokatipopullit.gov.al ky është web saiti zyrtar i institucionit të Avokatit të Popullit. Saiti është lançuar për herë të parë në vitin 2009 dhe duhet të pranojmë që nuk është ndër web-saitet më të mirë, për këtë arsye ai i është nënshtruar një ndryshimi radikal. Ky websait i ri, i cili u financua me fondet e Mbretërisë së Danimarkës, synon të jetë më i aksesueshëm nga qytetarët, të ketë mundësi komunikimi me qytetarët dhe sigurisht t'u vijë sa më në ndihmë qytetarëve me informacionet dhe shërbimet që ai ofron.

Tashmë web saiti i ri i institucionit të Avokatit të Popullit, i cili ka vetëm pak kohë që është bërë funksional ofron një mundësi për qytetarët të gjejnë jo vetëm informacionet e nevojshme, por ç'është më e rëndësishmja dhe risia kryesore e faqes është aplikimi i ankesave online.

Qytetarët tashmë mund të depozitojnë një ankesë në institucionin e Avokatit të Popullit, pa qenë e nevojshme të drejtohen në zyrat e tij, mund ta bëjnë këtë fare thjeshtë nëpërmjet internetit. Po në këtë mënyrë, ata do të kenë dhe mundësi që jo vetëm të bëjnë një ankesë online, por edhe të ndjekin se në ç'fazë është trajtimi i ankesës së tyre.

Një tjetër risi e këtij websaiti të ri është rubrika e transparencës. Gjithnjë kemi dëshiruar të japim një shembull pozitiv për institucionet e tjera dhe administratën publike. Stafi i institucionit të Avokatit të Popullit është i vendosur të jetë sa më transparent me qytetarin, për këtë arsye është vendosur që faqes së transparencës t'i kushtohet një vëmendje e veçantë.

Në këtë faqe ne kemi si synim të paraqisim institucionin tonë "të zhveshur". Seksionet që do të përbëjnë këtë faqe janë: rrogat, shpenzimet për tendera, blerjet, udhëtimet zyrtare, shpenzimet për mirëmbajtjen e institucionit, pozicionet për vende të lira pune, donacionet, financimet e huaja, etj.

Komunikimi i dyanshëm me qytetarët është mjaft domethënës për punën tonë dhe njëkohësisht na orienton të përkushtojmë vëmendje të veçantë ndaj problemeve që shqetësojnë qytetarët. Për të marrë opinione nga qytetarët, kemi menduar që saitin ta bëjmë interaktiv. Kemi mundësuar komentet nga ana e qytetarëve, dhe gjithashtu ata do të jenë vendimmarrës në temat që ne do t'i zgjedhim si ndër më prioritaret dhe do të fokusohemi në aktivitetin tonë. Në websait çdo muaj do të zhvillojmë një sondazh, ku përgjigjet e dhëna për sondazhin do na orientojnë drejt asaj çka është prioritare në funksion të mbrojtjes të të drejtave dhe lirive të qytetarëve.


Sigurisht për studentët, për studiuesit dhe për të interesuarit, saiti ofron një mundësi të mirë për të shfrytëzuar materialet, rekomandimet, bazën ligjore dhe raportet e institucionit të Avokatit të Popullit. Të gjitha këto materiale të prodhuara nga institucioni i Avokatit të Popullit do të jenë të pasqyruara në këtë sajt.

Për të qenë sa më pranë qytetarëve në faqen e Avokatit të Popullit, përveç kontakteve të zyrave qendrore dhe atyre rajonale (të numrave të telefonave dhe emailit) janë publikuar dhe dy numra telefoni në shërbim të qytetarëve. Në dispozicion të publikut është numri celular 0689034648. Ky numër është i hapur 24 orë, çdo ditë të javës. Qytetarët mund të dërgojnë në mënyrë të përmblendhur me SMS problemin, si dhe adresën e plotë të ankuesit dhe më pas kontaktohen nga ekspertë të Institucionit të Avokatit të Popullit. Ndërsa për personat që ndodhen në Institucionet e Vuajtjes së Dënimit, komunikimi realizohet përmes telefonatave të drejtpërdrejta. Gjithashtu për këta qytetarë shërben edhe telefoni falas 0800 1111 gjatë orarit zyrtar 08:30 deri 16:30, nga e hëna në të premte.

Një rëndësi e veçantë gjithashtu në websait i kushtohet zyrave rajonale. Në projektin e financuar nga Mbretëria e Danimarkës është parashikuar hapja e 6 zyrave rajonale. Deri tani është mundësuar çelja e 4 zyrave rajonale, konkretisht: në Shkodër, në Fier, në Berat dhe në Sarandë. (një informacion më të zgjeruar rreth aktivitetit të këtyre zyrave e gjeni në Kreun III, Pika 2 “Veprimtaria e Zyrave Rajonale dhe “Ditët e Hapura”.

Për një periudhë disa mujore websaiti nuk ka qenë funksional. Shkak për këtë ka qenë sulmi që është bërë ndaj websaitit të institucionit të Avokatit të Popullit. Konkretisht, prej datës 5 Maj 2013, Faqja zyrtare e Avokatit të Popullit www.avokatipopullit.gov.al ka qenë e pa aksesueshme. Faqja u sulmua nga hackera me emrin Ismalic Ghosts Team me mesazhin: “To be, or not to be”.

Nga stafi i Avokatit të Popullit u punua maksimalisht që faqja të rikthehej në gjendjen e mëparshme, vetëm se dëmtimi që u bë nga sulmi i hacker-ave, ishte shume i madh dhe rikuperimi kërkoi disa muaj kohë.



Numri i vizitoreve nga VITI 2009-2013					
	VITI 2009	VITI 2010	VITI 2011	VITI 2012	VITI 2013
Janar	0	6,332	4,377	4,919	0
Shkurt	1,014	5,892	1,454	4,839	0
Mars	5,084	6,312	2,665	4,844	0
Prill	5,547	6,364	4,297	4,690	0
Maj	5,512	6,369	4,433	5,642	10,230
Qershor	4,676	5,310	3,346	4,538	10,975
Korrik	3,260	3,637	2,284	4,466	11,621
Gusht	2,963	3,118	2,099	3,927	7,805
Shtator	4,508	4,574	2,955	5,671	8,252
Tetor	5,706	5,799	3,551	6,674	9,881
Nëntor	6,213	6,192	3,980	6,596	13,043
Dhjetor	5,632	4,685	4,443	8,009	20,868
Totali	50,115	64,584	39,884	64,815	92,675⁵⁰

Avokati i Popullit dhe rrjetet sociale

Vitet e fundit mediat sociale kanë ndryshuar zakonet dhe sjelljet e përditshme të një pjese të madhe të qytetarëve, duke u bërë një kanal gjithnjë më i rëndësishëm për tu informuar, për të komunikuar, për të vendosur dhe për të mbajtur lidhje.

Një nga synimet që na ka udhëhequr në punën tonë është dëshira për të zhvilluar dialogun dhe marrëdhëniet me qytetarët, ndaj nuk kishim si ta injorim këtë mundësi komunikimi që na ofrojnë mediat sociale.

Institucioni i Avokatit të Popullit përveç faqes zyrtare, komunikon me qytetarët dhe nëpërmjet platformës Facebook.

E kemi cilësuar këtë platformë si një mjet, nëpërmjet të cilit do të arrijmë të rrisim nivelin e përfshirjes demokratike të qytetarëve dhe pjesëmarrjen e tyre jo vetëm në vendimet që marrim, por edhe në përcaktimin e prioriteteve të institucionit.

Sipas të dhënave të ofruara nga rrjeti, platforma Facebook ka qenë më e vizituara në rang botëror përse i përket vitit 2013. Dihet tashmë që prej vitesh numri i vizitorëve të kësaj platforme është rritur dhe nga shqiptarët. Çdo ditë e më tepër shtohen shqiptarët përdorues të kësaj platforme.

Institucioni i Avokatit të Popullit është prezent në Facebook që prej Marsit të vitit 2012.

⁵⁰ Për periudhën janar-prill 2013 nuk është e mundur të reflektohet numri i vizitorëve, pasi websaiti i institucionit të Avokatit të Popullit nuk ka qenë funksional.

Gjatë kësaj kohe në këtë platformë komunikimi kemi arritur :

- Të promovojmë njohuritë mbi fusha të të drejtave të njeriut që kanë interes për publikun

Gjatë vitit që kaloi në faqen e institucionit të Avokatit të Popullit në Facebook janë bërë gjithsej 180 ankesa nga qytetarët. Jemi përpjekur me çdo kusht që gjithsecili prej tyre të kishte një përgjigje. Duke i ndarë në kategori:

- Këshillime dhe orientime (jo të gjitha ankesat e bëra në profilin e institucionit të Avokatit të Popullit kanë qenë brenda juridiksionit. Në këtë rast qytetarëve ju është dhënë ndihma e duhur duke i këshilluar si duhet të veprojnë dhe duke u orientuar se në çfarë institucioni duhet të depozitojnë shqetësimin, apo ankesën e tyre).
- Ankesa, të cilat janë cilësuar nga ekspertët si brenda juridiksionit të institucionit të Avokatit të Popullit, u është kërkuar qytetarëve të paraqiten në institucion me dokumentet përkatëse për të regjistruar ankesën.

Përballja me këtë ndryshim kulturor të thellë në komunikim, konsiderohet nga institucioni i Avokatit të Popullit si një mundësi unike për të përmirësuar komunikimin me qytetarët dhe vetëdijësimin për të drejtat dhe liritë e tyre. Ndaj prezenca në rrjetet sociale, për Institucionin e Avokatit të Popullit ka qenë gjatë këtij viti dhe do të vijojë të jetë në vazhdimësi, një prioritet në fushën e komunikimit dhe marrëdhënieve me qytetarët.

- Të bashkëpunojmë me qytetarët (duke shkëmbyer informacione, duke dhënë orientime, këshillime, etj)
- Të përfshijmë qytetarët në përcaktimin e prioriteteve të punës së institucionit
- Të ndajmë vendimet, informacionet dhe aktivitetet me qytetarët
- Ta shndërrojmë qytetarin jo vetëm në një marrës të mesazheve tona, por në një partner
- Të ilustrojmë aktivitetet e institucionit dhe funksionin e tyre

5. Bashkëpunimi i institucionit të Avokatit të Popullit me organizatat jofitimprurëse

Siç pati premtuar në fillim të mandatit të tij dy vite më parë, Avokati i Popullit edhe përgjatë vitit 2013 vijoi të bashkëpunojë ngushtësisht me organizatat e shoqërisë civile. Puna e filluar gjatë vitit 2012 me nënshkrimin e 117 marrëveshjeve me organizatat e shoqërisë civile në të gjithë vendin, u çua edhe më tej përgjatë vitit 2013 duke u formalizuar me krijimin e një rrjeti të shoqërisë civile. Në fund të vitit 2013, më 10 Dhjetor me rastin e shënimit të Ditës Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut, institucioni lançoi krijimin e një Bordi Këshillimor të shoqërisë civile me funksione këshillimore pranë Avokatit të Popullit. I ndërtuar në përputhje me mendimin strategjik që institucioni ka zhvilluar për mirëqeverisjen dhe vendim-marrjen, Bordi synon të sigurojë një komunikim të vazhdueshëm dhe të qëndrueshëm me Shoqërinë Civile përmes dy elementëve shumë të rëndësishëm:

1. Elementit për një komunikim të efektshëm publik dhe
2. Elementit të për një vendimmarrje sa më gjithëpërfshirëse

Në përputhje me Kartën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat dhe Liritë Universale të Njeriut, Kartën Europiane të të Drejtave të Njeriut dhe Parimet e Parisit për Institucionet Kombëtare të të Drejtave të Njeriut, Bordi është konceptuar si një strukturë e pavarur dhe e gjithë puna e tij do të përshkohet nga paanësia dhe objektiviteti. Përbërja e Bordit siguron një përzierje të përfaqësuesve të organizatave të shoqërisë civile të zgjedhura në mënyrë të pavarur nga vetë organizatat të anëtarësuara në koalicione dhe aleanca në Tiranë, një numër organizatash nga rajonet më të rëndësishme në vend, si dhe aktivistë e personalitete me kontribute të shquara publike në fusha të ndryshme të jetës. Duke ardhur nga fusha dhe pjesë të ndryshme të vendit, anëtarët e bordit bartin në vetvete diversitetin e veprimit dhe mendimit, parime mbi të cilat ngrihet shoqëria jonë.

Bordi Këshillimor për të Drejtat e Njeriut krijohet si një strukturë e pavarur, me qëllime konsultative dhe këshillimore. Ai i siguron Avokatit të Popullit këshilla dhe konsulencë në fushën e mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave të njeriut. Bordi bën propozime për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave dhe studion rreziqet e cenimit të këtyre të këtyre të drejtave nga procese të ndryshme shoqërore, por edhe nga progresi i shkencës dhe teknologjisë. Pluralizmi i këtij Bordi krijon një mjedis dialogu të përhershëm midis Avokatit të Popullit dhe shoqërisë civile. Bordi e kryen misionin e tij me seriozitet e paanësi, dhe propozimet e tij bëhen gjithnjë në frymë konstruktive e bashkëpunuese.

Me qëllim që të gjithë anëtarët të sjellin kontributin e tyre në fushën e kompetencave dhe aspiratave përkatëse, Bordi funksionon në mënyrë demokratike me qëllim arritjen

e konsensusit dhe maksimizimin e rezultateve të punës së tij. Bordi do të shërbeje si organ këshillues i avokatit të popullit duke u fokusuar kryesisht në: a) analizën e projekt-ligjeve/akteve që i propozohen parlamentit; (b) monitorimin e zbatimit praktik të ligjeve, me qëllim identifikimin e progresit të bërë dhe nevojës për përmirësime; (c) promovimin e të drejtave, veçanërisht të atyre që lidhen me fëmijët, personat në nevojë dhe grupet vulnerabël; (d) Identifikimin dhe propozimin e fushave kryesore të ndërhyrjes së Avokatit të Popullit për vitin pasardhës. Mbledhjet e Bordit do të jenë të hapura. Mund të ftohen të marrin pjesë anëtare të qeverisë, përfaqësues të komunitetit ndërkombëtar, përfaqësues të qarqeve akademike dhe universitare, ekspertë të ndryshëm, etj. Avokati i Popullit gëzon diskrecionin institucional lidhur me dobinë dhe zbatueshmërinë e këshillave dhe rekomandimeve.

Siç u tha më sipër më datë **9 dhe 10 dhjetor 2013**, Avokati i Popullit organizoi një Konferencë dyditore me titull: “Bashkë për të Drejtat e Njeriut”. Konferenca përfshiu gjashtë sesione, tre për secilën nga ditët, me fokus të drejtat e fëmijëve, të drejtat e grave, të drejtat e grupeve LGBT, të drejtat e fëmijëve dhe familjeve të ngujuara nga gjakmarrja, të drejtat e personave me aftësi të kufizuara dhe të drejtat e minoriteteve. Për të pasur një komunikim më të mirë publik midis Shoqërisë Civile dhe Institucioneve Shtetërore, konferenca u konceptua si platformë e hapur ku pjesëmarrësit e shumtë do të thoshin fjalën e tyre, si një hapësirë e rëndësishme debati, ku punonjësit e Avokatit të Popullit do të dëgjonin dhe mbanin shënim problemet dhe sugjerimet e pjesëmarrësve, përgjatë të gjitha sesioneve.

Në fjalën e tij të hapjes Z. Igli Totozani falënderoi të gjithë të pranishmit e konferencës, përfaqësues të shoqërisë civile, të administratës publike, pushtetit vendor, përfaqësuesit e parlamentit, komunitetit ndërkombëtar, si dhe miqtë ambasadorë të shteteve europiane. Një falënderim të veçantë shprehu për Mbretërinë e Danimarkës, për të gjithë ndihmën financiare, që i jep institucionit të Avokatit të Popullit, si edhe Save the Children si një nga bashkorganizatorët dhe bashkëfinancuesit e këtij eventit. Gjatë dy ditëve të konferencës, u diskutua mbi idetë dhe problemet e shoqërisë civile, në një dialog të hapur me përfaqësuesit e qeverisë, ku u ndërthurën debate midis ministrash e ambasadorësh, me kontributet e shoqërisë civile dhe punonjësve të institucioneve të pavarura. Disa nga shifrat që ngërthejnë suksesin e konferencës janë si vijon: 234 pjesëmarrës, 61 panelistë, 6 institucione qeveritare, 5 ambasadorë, 12 organizata ndërkombëtare: 26 OJF; 6 anëtarë të parlamentit, 2 institucione të pavarura, etj. Gjatë përgatitjeve të konferencës, ishte rënë dakord që diskutimet dhe kontributet të përfshiheshin në një raport të posaçëm për konferencën dhe të të shërbenin si kujtesë për problemet e ngritura dhe zgjidhjet e propozuara në mënyrë që palët përkatëse të ndërmerrnin hapat e duhura. Raporti i cili u përgatit nga pjesëtarë të stafit të Avokatit tashmë është shpërndarë në institucionet përkatëse të shtetit, organizatat ndërkombëtare dhe organizatat e shoqërisë civile.

Në vijim jepet një përmbledhje kronologjike e aktiviteteve të Avokatit të Popullit me shoqërinë civile gjatë vitit 2013.

Më **13.02.2013** Avokati i Popullit mori pjesë në Konferencën Shkencore Ndërkombëtare “Shqipëria dhe Pakicat Kombëtare, Etnike dhe Kulturore.” Konferenca organizohej nga Fakulteti i Drejtësisë i Universitetit “Marin Barleti” në bashkëpunim me Institutin Shqiptar për Çështje Publike, pranë këtij Universiteti. Në fjalën e tij zoti Totozani vuri në pah faktin se pakicat janë një pasuri si për çdo vend, edhe për Shqipërinë. Më tej ai vuri në pah klimën përgjithësisht pozitive që ekziston në Shqipëri në lidhje me trajtimin e pakicave, por theksoi se problemet mbeten të shumta dhe kërkojnë vëmendje të menjëhershme. Si hapa të rëndësishëm për t’u ndërmarrë nga shteti shqiptar, ndër të tjera ai përmendi edhe nevojën e hartimit të një ligji të posaçëm për pakicat dhe përkufizimin zyrtar të termit pakicë.

Avokati i Popullit, z. Igli Totozani mori pjesë më datën **21.02.2013** në workshopin me temë “Zhvillimi i demokracisë përmes Barazisë Gjinore”. Gjatë fjalës së mbajtur në këtë aktivitet, ndër të tjera, z. Totozani theksoi se nuk mund të ketë demokraci nëse gjysma e shoqërisë vazhdon të keqtrajtohet e të dhunohet nga gjysma tjetër. Që demokracia të zërë rrënjë në vendin tonë do të duhet që 100% e qytetarëve të marrin pjesë në të në mënyrë të barabartë. Masa të tilla si kuota prej 30 për qind në listat e deputetëve që hartohen nga partitë, janë një hap i parë në drejtim të rritjes së pjesëmarrjes në grave në politikëbërje, por një masë e tillë nuk është zgjidhja magjike e problemit, për më tepër që është një masë e cungët jo vetëm në përmbajtje por edhe në mënyrën sesi mund të jetësohet në listat e partive në zgjedhjet e pritshme.

Më **03.05.2013** Avokati i Popullit bëri një deklaratë për mediat ku theksoi se në vitin 2003 Këshilli i Europës hartoi një rekomandim, sipas të cilit asnjë nga gjinitë nuk mund të përfaqësohet në një instancë vendimmarrëse me më pak se 40%. Ky rekomandim bazohet në konceptin e pjesëmarrjes së ekuilibruar gjinore me theks të veçantë e të posaçëm në pjesëmarrjen e grave në parlament dhe qeverisje. Dhjetë vjet pas këtij rekomandimi Shqipëria ka ende shumë për të bërë.

Dëshirojmë të theksojmë se formula për përfaqësimin e grave në listat partiake për zgjedhjet parlamentare, përtej çdo dyshimi, nuk është më e mirëpritura nga Avokati i Popullit dhe shoqëria civile, por ashtu siç është ajo duhet të zbatohet nga subjektet elektorale. Duke i hapur rrugë pjesëmarrjes së ekuilibruar të grave në parlament, partitë do të jepnin një mesazh të qartë të vullnetit për ndryshime reale në skemën e vendimmarrjes politike të vendit.

Avokati i Popullit, z. Igli Totozani priti në zyrën e tij më **07.06.2013** Kryetarin e Unionit të Gazetarëve, z. Aleksandër Çipa dhe znj. Anila Basha. Gjatë takimit, z. Çipa ngriti shqetësimin e tij në lidhje me vendimin e KQZ-së për pranimin e kasatave të regjistruara

nga partitë për pasqyrimin e aktivitetit të tyre në periudhën parazgjedhore. “ Vendimi i KQZ është një precedent, i cili dhunon pavarësinë e informimit dhe deformat misionin e medias. Protestën e tij në lidhje me vendimin e KQZ, Unioni i Gazetarëve po e paraqit në institucionet shqiptare, të cilat mbrojnë Kushtetutën. Me këtë vendim shkelen nene të Kushtetutës për të drejtën e informimit. Avokati i Popullit do të duhet të japë një kontribut institucional në mbrojtje të Kushtetutës” - është shprehur z. Çipa.

Nga ana e tij, Avokati i Popullit, z. Igli Totozani, falënderoi Unionin e Gazetarëve për besimin dhe shtoi: “ Jemi institucioni i të drejtave të njeriut dhe organi kujdestar për ligjin për të drejtën e informimit. Në parim jemi për pacenueshmërinë e lirisë së mediave. Unë kam ngritur një grup pune, i cili deri ditën e hënë do të përgatisë një qëndrim zyrtar të institucionit të Avokatit të Popullit për këtë çështje. Do të hartohet një rekomandim, i cili do t’i drejtohet KQZ-së, por ky nuk do të jetë mjeti i vetëm që do të përdoret” – ka theksuar z. Totozani.

Më 17 – 10 qershor 2013 Avokati i Popullit, z. Igli Totozani ka marrë pjesë në Workshopin Rajonal, mbajtur në Beograd me temë “Të drejtat e njeriut të lesbikeve, gayve, biseksualëve dhe transgjinjorëve (LGBT), trajtim i barabartë dhe lufta kundër diskriminimit” Dinjiteti i lindur për çdo qenie njerëzore, pa dallim ose kufizim dhe refuzimi i diskriminimit të çdo lloji, janë parime bazë të dimensionit njerëzor. Por personat lesbike, gay, biseksualë, transgender dhe intersex vijnë të jenë viktimë të dhunës, intolerancës dhe diskriminimit. Janë krijuar disa instrumente ndërkombëtare krijuar me qëllim adresimin e kësaj çështjeje. Një rezolutë për orientimin seksual është miratuar nga Këshilli për të Drejtat e Njeriut i OKB, në qershor 2011. Komiteti i Ministrave i Këshillit të Europës ka miratuar rekomandimin CM/ Rec (2010)5 mbi masat për luftën kundër diskriminimit bazuar në orientimin seksual dhe identitetin gjinor. Ndërsa është bërë progres, dhuna, intoleranca dhe diskriminimi kundër personave LGBTI vijon të jetë një problem serioz. Të drejtat e komunitetit LGBTI janë të drejta të njeriut dhe ata si çdo qenie tjetër njerëzore duhet të gëzojnë të drejtën për t’u mbledhur lirisht, protestuar lirisht, shprehur hapur opinionet e tyre, madje edhe për të krijuar familje e rritur fëmijë, u shpreh z. Totozani.

Avokati i Popullit, z. Igli Totozani me ftesë të veçantë të Komisionerit për Zgjerim dhe Politikën e Fqinjësisë, z. Štefan Füle, referoi më **20. 06.2013** në Konferencën mbi Lirinë e shprehjes dhe Medias në Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë, e cila u mbajt në Bruksel. Ai mbrojti lirinë e shprehjes dhe të medias si një nga shtyllat e demokracisë dhe qytetarisë duke vënë në dukje se pa media nuk ka demokraci, nuk ka zhvillim. Kjo është veçanërisht e rëndësishme në vende si ato të Ballkanit Perëndimor, ku traditat demokratike janë larg të qenit të konsoliduara. Ai bëri thirrje që qeveritë të qëndrojnë të baraslarguara nga të gjitha mediat pa dallim në mënyrë që ato të jenë realisht të pavarura në punën e tyre.

Një thirrje tjetër ai drejtoi për mediat dhe gazetarët që ata të respektojnë misionin si dhe kodin etik e moral të profesionit të tyre.

Më **11 Korrik 2013** Avokati i Popullit deklaroi se do t'i bashkëngjitet nismës së shoqërisë civile për krijimin e një ligji të ri për hapjen e dosjeve. Në një intervistë të dhënë në Ora News, për Drejtorin e Informacionit, z. Patrik Sadikaj, Avokati i Popullit Igli Totozani deklaroi se shoqëria shqiptare ka nevojë imediate të pastrojë vetveten nga trashëgimia komuniste.

Avokati i Popullit, z. Igli Totozani ka pritur më datë **25.07.2013** në zyrën e tij një grup organizatash të Shoqërisë Civile në mbrojtje të mjedisit. Në fjalën e tij gjatë takimit, Avokati i Popullit u shpreh se institucioni që ai drejton mbron qytetarët nga veprimet e paligjshme dhe të parregullta të administratës, por edhe promovon të drejtat e njeriut. Z. Totozani ka siguruar besimtarët që Avokati i Popullit mbështet ngritjen e një xhamie, që qytetarët myslimanë të mos ndihen të diskriminuar, por ashtu si çdo besimtar tjetër të kenë dhe ata kultin e tyre të faljes. Ne si institucion funksionojmë në bazë të ankesave të qytetarëve, ne këtë e konsiderojmë një ankesë dhe për këtë qëllim do caktojmë një grup ekspertësh që do ndjekin çështjen dhe do të shqyrtojnë gjithë ankesat e paraqitura sot nga organizatat e Shoqërisë Civile"- përfundoi fjalën e tij gjatë takimit z. Totozani.

Zoti Sazan Guri, nga ana e tij paraqiti një sërë pretendimesh se përse këto ndërtime nuk duhet të bëhen në vendin e caktuar dhe saktësoi se grupi i organizatave të Shoqërisë Civile që kanë në fokus të punës së tyre mjedisin, nuk kanë asgjë kundër komunitetit mysliman dhe veprës fetare.

Më **09.08.2013** Avokati i Popullit bëri një Deklarate lidhur me situatën e komunitetit rom. Kjo deklaratë është në vazhden e përfshirjes aktive të institucionit të Avokatit të Popullit përgjatë gjithë muajit gusht në mbrojtje të të drejtave të komitetit rom të zhvendosur nga banesat e tyre përballë Pallatit me Shigjeta në Tiranë. Që në ditët e para të aksionit të firmës së ndërtimit për t'i zhvendosur romët në funksion të ngritjes së një godine shumëkatëshe, Avokati bëri thirrje që Qeveria dhe Bashkia e Tiranës të shikonin ligjshmërinë e këtij aksioni dhe të merrnin masat e duhura që familjet të strehoheshin, të kishin aksesin e duhur në shërbimin shëndetësor parësor si dhe të kishin mundësi të dërgonin fëmijët e tyre në shkollë brenda një rrezeje të arsyeshme. Në këtë deklaratë u publikuan një numër rekomandimesh drejtuar institucioneve shqiptare, ndër të cilat edhe Rekomandimi drejtuar Komisarariatit nr. 2 për situatën e komunitetit Rom dhe Rekomandimi drejtuar Kryetarit të Bashkisë Z. Lulzim BASHA për hapat që duhen ndërmarrë për një zgjidhje emergjente dhe afatmesme të problemeve të këtij komuniteti.

Më **30 Gusht 2013**, me anë të deklaratë për mediat, Institucioni i Avokatit të Popullit, me keqardhje konstatoi sërish një problem të përsëritur në lidhje me pagesat e aftësisë

së kufizuar. Në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, ka pasur vonesa në lidhje me kryerjen e pagesës mujore të personave me aftësisë së kufizuara. Shqetësimet u konstatuan nga ndihmëskomisionerët e AP në terren, por janë përcjellë edhe nga vetë përfaqësuesit e organizmave të këtyre personave.

Nisur nga kjo situatë, iu tërhoq vëmendja në mënyrë publike Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta si dhe Ministrisë së Financave, për realizimin menjëherë të këtyre pagesave. Personat me Aftësi të Kufizuara, dhe të drejtat e tyre përbëjnë një nga misionet më të rëndësishme të institucionit të Avokatit të Popullit. Ata janë pjesë e rekomandimit 11, të përcaktuar nga BE për Shqipërinë, dhe në këtë kontekst por jo vetëm, zhvillimet në legjislacionin dhe politikat për personat me aftësi të kufizuara, si dhe zbatimi i tyre, kanë qenë objekt i diskutimeve, vlerësimeve dhe rekomandimeve të institucionit tonë.

Konferencën Ndërkombëtare Mbi situatën arsimore të romëve në Europën Juglindore, Avokati i Popullit e ndoqi nga **24-25 shtator 2013**, në Bon, Gjermani. Në fjalën e tij ai vuri në dukje se Ky është një rast më shumë për të sjellë në vëmendje dhe reflektuar mbi sfidat me të cilat përballet ky komunitet në secilin prej vendeve tona. Është pikërisht momenti të reflektojmë se vetëm 2 vjet nga përfundimi i Dekadës së Romëve e cila u shpall në vitin 2005 me shumë shpresë se do të hidhte bazat e integritit të romëve në shoqëritë tona, me keqardhje shohim se ata vazhdojnë të jetojnë të zhytur në varfëri, diskriminim dhe përjashtim.

Si institucion, Avokati i Popullit e ka theksuar që në fillimet e veta se në mënyrë që Romët të integrohen në shoqëri, nuk mjafton vetëm barazia përpara ligjit siç është sanksionuar legjislacionet e të gjitha vendeve tona. Avokati i Popullit në Shqipëri u ka kërkuar institucioneve ligjvënëse e ligjzbatuese që të ulin pragun e kriterëve që Romët duhet të kapërcejnë për të qenë përfitues të atyre përfitimeve modeste që ofron sistemi shqiptar i asistencës sociale. Pra, kemi kërkuar që për një periudhë kohe të caktuar romët të jenë objekt i një diskriminimi pozitiv që do t'i lejonte ata të arrinin të njëjtin nivel me qytetarët mesatarë. E kemi kërkuar këtë për shërbimet bazë si ato që kanë të bëjnë me regjistrimin në zyrat e gjendjes civile, në shkolla e në sistemin parashkollor, në programet e strehimit social, në programet e trajnimit dhe punësimit, etj. Gjatë qëndrimit të tij në Bon, ai dha edhe një intervistë për Radion Dojce Vele rreth gjendjes së Romëve në Shqipëri.

Avokati i Popullit bëri një deklaratë për media me rastin e Ditës Ndërkombëtare të të Moshuarve, më **1 tetor 2013**. Në deklaratë ai shpreh mirënjohjen dhe respektin për vlerat dhe kontributin e tyre dhënë ndër vite. Të moshuarit mbeten një nga grupet më vulnerabël në Shqipëri. Mungesa e sigurimit të një minimumi të ardhurash, bën që kjo kategori sociale të mos marri shërbimin e duhur shëndetësor, të mos ketë të ardhura të mjaftueshme për të përballuar jetesën dhe shpesh herë të mbetet dhe pa përkrahje.

Duke i vlerësuar të moshuarit për kontributin e tyre dhe duke ditur nevojën për kujdes të kësaj shtrese, duhet të eliminojmë neglizhencën dhe përjashtimin e tyre nga shoqëria, duke ndërtuar kështu një shoqëri për të gjitha moshat.

Për të garantuar të drejtat e të moshuarve, për siguri sociale, për të punuar, për akses në shërbimet e kujdesit shëndetësor, etj, kërkohet miratimi i Statusit të Moshës së Tretë.

Avokati i Popullit, si një institucion që garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, ka në prioritetet e punës së tij mbrojtjen e të drejtave të të moshuarve.

Nëpërmjet rekomandimeve të tij drejtuar pushtetit qendror dhe lokal Avokati i Popullit ka kërkuar përmirësimin e kushteve të jetesës në qendrat ditore dhe rezidenciale për të moshuarit si dhe zbatimin e standardeve të kërkuara për t'i mundësuar këtij grupi shoqëror një jetë sa më dinjitoze dhe të sigurt, me qëllim që të ndihen të barabartë me të gjithë anëtarët e tjerë të shoqërisë

Më **26.11.2013** Avokati i Popullit nisi konsultimin me shoqërinë civile për emrat që do t'i propozojë Kuvendit të Shqipërisë, për postet e Komisionerëve pranë këtij institucioni.

Gjatë kësaj jave Avokati i Popullit, z. Igli Totozani po zhvillon takime të ngjeshura me përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile si: gratë, fëmijët, PAK, romët, gjakmarrja si dhe aktivistë të fushave të tjera. Komisionerët votohen nga Parlamenti me shumicë të thjeshtë dhe mandati i tyre është 3 vjeçar. Avokati i Popullit synon që kandidaturat që do t'i propozohen Kuvendit të jenë nga juristët më të njohur, mundësisht me kontribut në shoqërinë civile, të papërfshirë në politikë dhe të paanshëm. Komisionerët zgjidhen ndër juristët më të shquar, për një mandat 3-vjeçar me të drejtë rizgjedhjeje.

Në tryezën e rrumbullakët që do organizoi në **28 tetor 2013**, institucioni i Avokatit të Popullit ftoi edhe zotin Erion Veliaj, Ministër i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, zonjën Lindita Nikolla, Ministre e Arsimit dhe Sportit, zonjën Elona Gjebrea, Zv. Ministre e Brendshme dhe zotin Gjon Radovani, Zv. Ministër i Zhvillimit Urban dhe Turizmit.

Avokati i Popullit dhe përfaqësues të shoqërisë civile dhe Komisioneren kundër Diskriminimit prezantuan rekomandimet, të cilat kanë për qëllim përmirësimin e gjendjes së minoritetit rom.

Për Ministrinë e Arsimit: Në përputhje me pikën 1, të nenit 81, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, rekomandojmë realizimin e iniciativës legislative, për disa përmirësime në Ligjin Nr. 69, datë 21.06.2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të cilat do të parashikojnë dhe garantojnë integrimin në arsim të fëmijëve Romë, nga niveli parashkollor, e deri në nivelet e tjera më të larta të arsimit.

Për Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë: rekomandojmë parashikimin e kriterëve lehtësuese për përfitimin e ndihmës ekonomike me qëllim qasjen e përshtatshme dhe të mundshme për individët, pjesëtarë të minoritetit rom, pasi kriteret aktuale nuk mund të arrihen dhe efektivisht kanë natyrë përjashtuese për këtë minoritet.

Për Ministrinë e Brendshme: rekomandojmë që për mbrojtjen e interesave jetësore të minoritetit Rom në Shqipëri, të ndërmerret iniciativa për ndryshime në Ligjin Nr. 10129 datë 11.05.2009 “Për Gjendjen Civile”, në mënyrë që brenda një afati të kufizuar kohor të lehtësohen nga afatet e parashikuara në ligj, si dhe t’u njihet mundësia e regjistrimit apo ndryshimit të vendbanimit edhe nëse nuk plotësojnë dokumentacionin e parashikuar për këtë qëllim, në gjendjen civile ku janë vendosur aktualisht.

Për Ministrinë e Zhvillimit Urban dhe Turizmit: rekomandojmë rishikimin e ligjit “Për programet sociale për strehimin e banorëve në zonat urbane”, konsiderimin e këtij minoriteti si kategori prioritare dhe lehtësimin e kriterëve ligjore për përfitimin e strehimit, pasi individët e minoritetit rom ndihen të përjashtuar nga skema e strehimit që ka aplikuar shteti shqiptar, pasi kriteret e vendosura janë të paarritshme nga ky komunitet.

Avokati i Popullit dhe shoqëria civile vlerësojnë se pa ndërmarrë të gjitha reformat e sipërpërmendura, si: të përfitojnë strehim, përkrahje sociale, përkujdesje shëndetësore dhe edukim arsimor njësoj si të gjithë qytetarët e tjerë, minoriteti rom do të mbetet i përjashtuar.

Më datën **02. 12. 2013** Avokati i Popullit mori pjesë në seancën dëgjimore në Komisionin e Punës për Dhunën me Bazë Gjinore. Ndër të tjera ai u shpreh se dhuna me bazë gjinore, e veçanërisht dhuna ndaj grave në familje, vazhdon të mbetet një fenomen mjaft i përhapur dhe problematik për shoqërinë tonë. Numri i grave viktime të dhunës në familje në 2012 dhe 2013 është mjaft shqetësues (23 gra gjatë 2012 dhe 27 gra gjatë 2013).

Në këtë situatë është emergjente konsolidimi i mëtejshëm i mekanizmave të referimit për dhunën në familje, e në këtë drejtim koordinimi ndërmjet institucioneve qendrore dhe vendore duhet të përmirësohet, si edhe duhet të ngrihen strukturat që mungojnë, konkretisht streha publike dhe shërbimet sociale përkatëse për viktimat. Një tjetër rekomandim është fakti që integrimi gjinor duhet të jetë pjesë e gjithë politikave sociale, ekonomike dhe politike në Shqipëri për të arritur një zhvillim të qëndrueshëm nëpërmjet shfrytëzimit të potencialit të plotë njerëzor të vendit, sikurse dhe garantimit të gëzimit të këtyre arritjeve nga të gjitha grupet shoqërore. Kërkohej zbatimi i masave të parashikuara në Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe kundër Dhunës me Bazë Gjinore dhe asaj në Familje 2011-2015, të cilat kërkojnë krijimin e procedurave dhe

mundësive për nënkontraktimin e OJF-ve, për të ofruar shërbimet përkatëse për viktimat e kësaj dhune. Aplikimi i politikave lidhur me pjesëmarrjen e grave dhe vajzave nga skemat e mbështetjes me të ardhura, në programe aktive punësimi, formimi profesional dhe ri-trajnimi me synim përmirësimin e gjendjes ekonomike të grave, janë qasje që do të kontribuojnë në përmirësimin e gjendjes së grave dhe vajzave. Z. Igli Totozani kërkoi përmirësimin e punës së organeve të policisë dhe drejtësisë, me qëllim identifikimin e autorëve të veprave penale të dhunës ndaj grave dhe dënimin e tyre në një kohë sa më të shkurtër. Ai vuri në dukje se ngritja dhe forcimi i mekanizmave për barazinë gjinore në nivel qendror dhe vendor, veçanërisht shpejtimi i procesit për emërimin e nëpunësve gjinorë në strukturat e ministrive dhe të nëpunësve vendorë për çështjet gjinore në bashkitë e vendit do të ndihmojë ndër të tjera edhe në ngritjen e nivelit të ndërgjegjësimit dhe emancipimit gjinor.

6. Bashkëpunimi i institucionit të Avokatit të Popullit me zyrat homologe dhe organizata të tjera ndërkombëtare

Hyrje

Institucioni i Avokatit të Popullit e konsideron komunitetin ndërkombëtar një aleat dhe partner të rëndësishëm në realizimin e objektivave të tij në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut.

Rëndësia që Avokati i Popullit i kushton marrëdhënieve ndërkombëtare, është theksuar edhe në Rregulloren e Brendshme të institucionit. Ky dokument i jep rëndësi ndërveprimit të ngushtë të Avokatit të Popullit dhe punonjësve të institucionit me partnerët ndërkombëtarë për ti mundësuar në këtë mënyrë zbatimin në praktikë të përpjekjeve të promovimit dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut.

Në këtë kontekst, gjatë vitit 2013 është fuqizuar Sektori i Koordinimit, Marrëdhënieve me Jashtë dhe Integritimit European pranë Avokatit të Popullit, i cili aktualisht përbëhet nga dy specialistë dhe një shef sektori. Detyra kryesore e këtij sektori është koordinimi i aktiviteteve të organizuara me zyrat homologe, organizmat ndërkombëtarë brenda dhe jashtë vendit si dhe me partnerë të tjerë në fushën e të drejtave të njeriut, duke fuqizuar bashkëpunimin dhe bashkëveprimin. Komunikimi dhe procesi i shkëmbimit të përvojës në arenën ndërkombëtare ka një rëndësi të veçantë në kuadër të përditësimit me standardet më të mira europiane dhe ndërkombëtare në fushën e të drejtave të njeriut.

Gjatë vitit 2013, Sektori i Koordinimit, Marrëdhënieve me Jashtë dhe Integritimit European ka pasur një komunikim të vazhdueshëm me partnerët ndërkombëtar brenda dhe jashtë

vendit. Ky ndërveprim ka konsistuar kryesisht në ndarjen e informacionit mbi gjendjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në Shqipëri si dhe në ndarjen raporteve të veçanta dhe rasteve specifike të trajtuara nga ana e institucionit.

Në vijim paraqitet aktiviteti ndërkombëtar i institucionit të Avokatit të Popullit, ku gjatë vitit 2013 shënohet një rritje e pranisë dhe kontributit nga ana e institucionit në arenën ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Aktiviteti ndërkombëtar i institucionit të Avokatit të Popullit gjatë vitit 2013 mund të strukturohet në këto fusha kryesore: 1) Aktiviteti në rrafshin dypalësh; 2) Aktiviteti në rrafshin shumëpalësh, në kuadrin e organizatave rajonale, europiane dhe ndërkombëtare; 3) Anëtarësia në organizatat dhe rrjetet ndërkombëtare dhe 4) Projekte me mbështetjen ndërkombëtare.

1) Aktiviteti në rrafshin dypalësh

Gjatë vitit 2013, është shënuar një rritje e bashkëpunimit dhe ndërveprimit me institucionet homologe. Kjo ka bërë të mundur shkëmbimin e eksperiencave më të mira me institucionet e ombudsmanëve në Evropë dhe rritjen e përvojës së institucionit të Avokatit të Popullit në arenën ndërkombëtare.

Në këtë kuadër, me datë 3-5 shkurt 2013, Avokati i Popullit vizitoi Avokatin e Popullit të Kosovës në Kosovë. Kjo vizitë kishte synimin që të përforcojë më tej bashkëpunimin ndërmjet dy institucioneve homologe, si dhe mes aktorëve të tjerë të dy vendeve që veprojnë në fushën e të drejtave të njeriut, përfshirë këtu shoqërinë civile (pjesë e delegacionit ishin dhe përfaqësues të shoqërisë civile në vend).

Fuqizimi i bashkëpunimit ndërmjet Avokatit të Popullit të Shqipërisë dhe Avokatit të Popullit të Kosovës u konkretizua akoma më tej gjatë vizitës së z. Sami Kurteshi, Avokati i Popullit i Kosovës, gjatë vizitës së tij në Tiranë me datë 1-3 maj 2013, me ftesë të z. Igli Totozani. Gjatë kësaj vizite u nënshkrua një marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet dy institucioneve homologe ku ndër të tjera fokus të veçantë pati rritja e bashkëpunimit ndërmjet Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës (pranë Avokatit të Popullit në Shqipëri) dhe Njësisë për Mekanizmin për Parandalimin e Torturës (pranë Avokatit të Popullit në Kosovë). Gjithashtu u vendos një bashkëpunim i dy institucioneve në shkëmbim praktikash mbi procesin e trajtimit të ankesave të qytetareve si dhe në ndihmë reciproke sa i përket angazhimit dhe bashkëpunimeve në rrjetet rajonale, europiane dhe ndërkombëtare të institucioneve kombëtare për të drejtat e njeriut.

Nga ana tjetër, gjatë vizitës së tij zyrtare në Poloni me datë 13 mars 2013, Avokati i Popullit mori pjesë në konferencën “Sfidat kryesore të Ombudsmanit në shekullin e XXI”

organizuar nga Grupi i Vishegradit me Ombudsmanët e vendeve të Ballkanit Perëndimor. Gjatë takimit dypalësh me Ombudsmanen e Polonisë, znj. Irena Lipowicz, u diskutuan mundësitë e ndryshme të bashkëpunimit, ndër të tjera dhe specializimin afatgjatë të ekspertëve të institucionit të Avokatit të Popullit, pranë institucionit të Ombudsmanit në Poloni.

Ndërkohë më datë **13-15 tetor 2013, Ombudsmania e Polonisë, znj. Irena Lipowicz**, me ftesë të Avokatit të Popullit, ishte e pranishme për vizitë zyrtare në Tiranë. Në kuadër të kësaj vizite u mbajt dhe një seminar lidhur me përmirësimin e standardeve të të drejtave të njeriut dhe bashkëpunimi me shoqërinë civile, me temë “Mbrojtja e të drejtave të njeriut dhe roli i Ombudsmanit”, datë 14 tetor 2013. Ky seminar u organizua bashkërisht me Ambasadën Polake në Shqipëri. Pjesëmarrës në këtë seminar ishin përfaqësues të ndryshëm të institucioneve publike, ndërkombëtare dhe shoqërisë civile, përfshirë këtu Kryetarin e Kuvendit, z. Ilir Meta, Ambasadorin e Bashkimit Europian në Shqipëri, z. Ettore Sequi etj. Gjithashtu, në kuadër të këtij bashkëpunimi Ambasada e Polonisë dhe institucioni i Ombudsmanit të Polonisë, organizuan një vizitë studimore të tre përfaqësuesve të shoqërisë civile pranë Ombudsmanit të Polonisë.

Më datë 4-5 Korrik 2013, Avokati i Popullit, z. Igli Totozani zhvilloi një zyrtare dy ditore në Athinë, me ftese të Ombudsmanes së Greqisë, znj. Calliope Spanou. Gjatë takimit me znj. Spanou u diskutua rreth punës së institucioneve në mbrojtje të të drejtave të njeriut. Gjithashtu pjesë e bisedimeve ishte dhe çështja e toponimeve, për të cilën të dy institucionet i bënë thirrje të dy qeverive të gjejnë rrugën e mirëkuptimit në të mirë të fëmijëve. Mes institucioneve homologe u ra dakord të zhvillohen takime të përbashkëta të përvitshme dhe kontakte të vazhdueshme që të ndihmojnë qytetarët në vendet reciproke. Avokati i Popullit zhvilloi dhe një vizitë në burgje ku shqiptarë vuanin dënimin si dhe pati takime me organizata të ndryshme në mbrojtje të të drejtave të shqiptarëve në Greqi, ku ndër të tjera u diskutua mbi gjendjen e emigrantëve shqiptarë në Greqi, mundësinë për tu krijuar hapësira për votimin në Ambasadë, mbështetjen e emigrantëve të kthyer në Shqipëri si dhe për përpjekjen për ngritjen e një qendre kulturore në Greqi për emigrantët shqiptarë.

Gjithashtu, Avokati i Popullit luan një rol aktiv në rrjetet rajonale. Ai është një nga anëtarët themelues të Rrjetit Rajonal të Mekanizmat Kombëtare të Parandalimit të Torturës (MKP), e cila është krijuar në Beograd në fillim të vitit 2013. Institucioni i Avokatit të Popullit ka vendosur dhe mban lidhje të drejtpërdrejta dypalëshe me Ombudsmanët në rajon, përfshirë këtu Ombudsmanin e Kosovës, Malit të Zi, Serbisë, Greqisë, Maqedonisë etj. Kontakte të drejtpërdrejta mbajnë edhe anëtarët e tjerë të stafit dhe në mënyrë të veçantë, punonjësit e Mekanizmit për Parandalimin e Torturës ndërveprojnë aktivisht me homologët e Mekanizmave të vendeve të tjera.

Nga ana tjetër, lidhje të drejtpërdrejta mbahen me Ombudsmanët në nivel evropian, përfshirë këtu Ombudsmanin e BE, Danimarkës, Spanjës, Francës, Norvegjisë etj.

2) Aktiviteti në rrafshin shumëpalësh, në kuadrin e organizatave rajonale, europiane dhe ndërkombëtare

Gjatë vitit 2013, është fuqizuar akoma dhe më tej bashkëpunimi i institucionit të Avokatit të Popullit me organizata të ndryshme ndërkombëtare brenda dhe jashtë vendit, përfshirë këtu Organizatën e Kombeve të Bashkuara (OKB), Këshillin e Europës, OSBE, UNDP, UNICEF etj.

Në këtë kuadër, Zyra e Kombeve të Bashkuara në Shqipëri dhe Avokati i Popullit janë zotuar të punojnë së bashku për çështje me interes të përbashkët.

Në këtë kuadër, në mars të vitit 2013, në bashkëpunim me Zyrën e UNDP në Shqipëri u zhvillua seminari 3 ditor me temë “Roli i Avokatit të Popullit në nxitjen e barazisë dhe mosdiskriminimit” me qëllim forcimin e kapaciteteve të punonjësve të institucionit të Avokatit të Popullit në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të grave, LGBT, minoritetit Rom dhe personat me aftësi të kufizuara.

Nga ana tjetër, me mbështetje të programit TAIEX të Bashkimit Evropian, për të fuqizuar kapacitetin e anëtarëve të stafit të institucionit të Avokatit të Popullit dhe për të rritur akoma dhe më tej aftësitë profesionale, janë realizuar 5 vizita studimore pranë Ombudsmanëve në vendet e Bashkimit Evropian. Në secilën nga këto vizita kanë marrë pjesë nga 3 punonjës të institucionit dhe përkatësisht këto vizita janë realizuar pranë Ombudsmanit të Danimarkës, Ombudsmanit të Spanjës (2 vizita), Ombudsmanit të Francës (2 vizita) dhe Ombudsmanit të Polonisë. Falë kësaj mbështetje të Bashkimit Evropian janë forcuar gjithashtu dhe marrëdhëniet e bashkëpunimit dhe ndërveprimit me institucionet homologe. Në vizitat studimore të zhvilluara gjatë vitit 2013 morën pjesë në total 17 punonjës të Avokatit të Popullit.

Gjithashtu, me 20-22 nëntor të vitit 2013, një tjetër seminar i përbashkët u zhvillua në bashkëpunim me Zyrën e Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut, me temë “Përdorimi i treguesve për zbatimin dhe vlerësimin e të drejtave të njeriut”. Seminari në fjalë, në të cilin morën pjesë përfaqësues të ndryshëm nga institucione publike shqiptare, synoi të rrisë ndërgjegjësimin dhe të tregojë rëndësinë e përdorimit të informacionit statistikor dhe treguesve të tjerë në promovimin dhe monitorimin e zbatimit të të drejtave të njeriut në Shqipëri.

Viti 2013, shënoi dhe një rritje të pranisë së Avokatit të Popullit në arenën ndërkombëtare. Kështu, më 7 maj të 2013, Avokati i Popullit mori pjesë në sesionin e 26 vjetor të Komitetit

Ndërkombëtar Koordinues të Institucioneve të Drejtave të Njeriut (ICC) në Gjenevë, ku u zgjodh anëtar i 2 bordeve të rëndësishme ndërkombëtare, përkatësisht pranë Bordit të Rrjetit Rajonal Evropian dhe Byrosë së ICC-së. Byroja e ICC-së, e cila është e përbërë në total nga 16 anëtarë që përfaqësojnë 4 rajone të ndryshme të botës, është një nga organet më të rëndësishme të ICC. Gjithashtu, institucioni i Avokatit të Popullit, mori pjesë në mbledhjen e Byrosë së ICC-së, që u mbajt në Accra, Gana, në datat 25 dhe 26 nëntor 2013. Gjatë kësaj mbledhje, ndër të tjera, u diskutua mbi Planin Strategjik 2013-2015 të ICC si dhe mbi zhvillimet më të fundit ndërkombëtare në fushën e të drejtave të njeriut. Nga ana tjetër, në kuadër të ICC-së, Avokati i Popullit është në proces ri-akreditimi të statusit “A”, sipas procedurave të ri-akreditimit çdo 5 vite.

Duke pasur parasysh rëndësinë që Avokati i Popullit i kushton njohjes me instrumentet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, stafi i institucionit i ka bërë këto dokumente si pjesë të pandashme të punës së përditshme. Në këtë kuadër, institucioni i Avokatit të Popullit jo vetëm analizon konventat dhe raportet ndërkombëtare por dhe ndjek zbatimin e tyre nga ana e institucioneve të administratës publike në Shqipëri, duke nxitur ato në zbatimin e rekomandimeve përkatëse për të përmirësuar situatën e të drejtave të njeriut në përputhje me parimet dhe rekomandimet e përmendura në të.

Në këtë linjë, në qershor të vitit 2013, Avokati i Popullit dorëzoi në Komitetin e të Drejtave të Njeriut të OKB-së një raport të pavarur (paralel) nga shteti shqiptar për zbatimin e Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike në Shqipëri dhe punën e Avokatit të Popullit në këtë drejtim. Komiteti i të Drejtave të Njeriut pranë OKB-së trajtoi raportin e dytë të Shqipërisë dhe dokumentin e paraqitur nga Avokati i Popullit në sesionin e 108 të Komitetit të të Drejtave të Njeriut të OKB-së.

Gjithashtu, stafi i Avokatit të Popullit bashkëpunon ngushtë me strukturat dhe mekanizmat e të drejtave të njeriut në nivel evropian. Këtu mund të përmendim bashkëpunimin intensiv me Komisionin Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës (ECRI). Avokati i Popullit ka dërguar raporte paralele ECRI-it dhe ka ushtruar presion ndaj qeverisë për të zbatuar rekomandimet e ECRI-it. Raste të tilla janë rekomandimet e ECRI për përmirësimin e gjendjes së minoritetit Rom dhe atyre në përmirësimin e situatës së minoriteteve etnike në Shqipëri.

Në këtë rast Avokati i Popullit i ka dërguar këto rekomandime në vitin 2013:

- 1) Rekomandim “Për përmirësimin e kuadrit ligjor për njohjen dhe mbrojtjen e pakicave në vendin tonë, në përputhje me dispozitat e Këshillit të Evropës “Konventa Kuadër për mbrojtjen e minoriteteve kombëtare” paraqitur Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë.

- 2) Rekomandimi “Për përmirësimin e ligjit për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” (ligji nr. 69, datë 21.06.2012)” drejtuar Ministrit të Arsimit dhe Shkencës.
- 3) Rekomandimi “Për përmirësimin e ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi” (ligji nr. 10221, datë 04.02.2010)” drejtuar Ministrit të Drejtësisë dhe Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.
- 4) Rekomandimi “Për masat për përmirësimin e kushteve të jetesës së romëve etnoghjuhësore minoritetet” drejtuar Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës.

Nga ana tjetër, në kuadër të të drejtave të komunitetit LGBT, veprimtaria e institucionit të Avokatit të Popullit në këtë drejtim ka qenë gjithmonë në bashkëpunim të ngushtë me organizatat e shoqërisë civile, grupet e interesit dhe partnerët ndërkombëtarë, përfshirë këtu Zyrën e Këshillit të Evropës në Tiranë. Në bashkëpunim të ngushtë me Zyrën e Këshillit të Evropës në Tiranë, Avokati i Popullit ka përgatitur një sërë rekomandimesh për përmirësimin e legjislacionit, përfshirë këtu ndryshime në Kodin e Familjes. Nga ana tjetër, vlen të përmendet këtu rekomandimi për ndryshime në Kodin Penal, duke përfshirë si rrethanë rënduese kryerja e një veprë penale për shkak të arsyeve që kanë të bëjnë me orientimin seksual dhe identitetin gjinor⁵¹.

Falë bashkëpunimit me OSBE, në kuadër të projektit “Praktikat më të Mira për Integrimin e Romëve (PMIR)” i cili financohet nga Bashkimi Evropian dhe zbatohet nga Zyra e OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR), në qershor të 2013 është bërë e mundur punësimi i një Koordinatori Rom për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me qëllim që të mbështesë institucionin e Avokatit të Popullit në procedurat e ankesave; në sigurimin e informacionit të duhur sipas kërkesave të paraqitura si dhe në bashkëpunimin me autoritetet relevante në fushën e barazisë dhe mos diskriminimit të romëve⁵².

Gjithashtu në kuadër të bashkëpunimit me OSBE, Avokati i Popullit, z. Igli Totozani mori pjesë në konferencën e nivelit të lartë të organizuar nga zyra e OSBE me temë “Toleranca dhe Anti-Diskriminimin”, e cila u mbajt me datë 21-22 maj 2013 në Tiranë, Shqipëri.

Roli aktiv i institucionit të Avokatit të Popullit doli në dukje dhe më 28 nëntor të vitit 2013, gjatë mbledhjes së Kongresit të tetë të Shoqatës së Ombudsmanëve dhe Mediatorëve Frankofonë, të mbajtur në Senegal, ku Avokati i Popullit, z. Igli Totozani u zgjodh Anëtar i Këshillit Administrativ. Këshilli Administrativ është një nga organet kryesore drejtuese

⁵¹ Ky rekomandim u pranua dhe në maj 2013 Kodi Penal është ndryshuar në përputhje me rekomandimin në fjalë.

⁵² Për gjysmën e parë të vitit 2014, ky pozicion mundësohet nga mbështetja e dhënë në kuadër të UNDP.

të kësaj organizate, anëtarët e të cilit zgjidhen një herë në dy vjet. Ky këshill merr vendime të rëndësishme për organizatën, në periudhat midis mbledhjeve të Asamblesë së Përgjithshme.

Ndër seminarët dhe aktivitetet e tjera të organizuara në bashkëpunim me organizata ndërkombëtare, mund të përmendim:

- **Më datë 24 shtator 2013**, pranë Avokatit të Popullit u zhvillua aktiviteti i lancimit të opinionit të Komisionerit për të Drejtat e Njeriut pranë Këshillit të Evropës, z. Nils Muižnieks, lidhur me “Shqyrtimin e Pavarur dhe Efektiv të Ankesave kundër Policisë”. Në këtë aktivitet, midis të tjerash u trajtua roli i Avokatit të Popullit në shqyrtimin e ankesave kundër policisë. Gjatë aktivitetit u theksua se një trajtimi i shpejtë, transparent, profesional, dhe gjithëpërfshirës do të ndihmonte jo vetëm në krijimin e kushteve për një riparim sa më të shpejtë të pasojave të shkeljes dhe rehabilitimin e viktimës, por edhe për të ruajtur të fortë besimin në shtetin ligjor. Detyrimi dhe dedikimi i institucionit të Avokatit të Popullit për mbrojtjen dhe garantimin e të drejtave të njeriut prej veprimeve dhe/ose mosveprimeve të jashtëligjshme të policisë dhe forcave të rendit do të vazhdojë të jetë i njëjtë dhe i pa ndryshuar në të mirë të demokracisë dhe të shtetit të së drejtës në Shqipëri. Nga ana e tij z. Muiznieks theksoi rëndësinë e rolit të institucionit të Avokatit të Popullit në punën që ka bërë për sa i përket ankesave që kanë ardhur ndaj policisë.
- **Më datë 3 dhjetor 2013**, institucioni i Avokatit të Popullit në bashkëpunim me zyrën e **UNICEF** në Shqipëri organizuan një tryeze të rrumbullakët mbi: “Rolin e zyrës së Ombudsmanit në monitorimin e të drejtave të fëmijëve”. Aktiviteti synoi rritjen e ndërgjegjësimit mbi të drejtat e fëmijëve dhe nevojën për krijimin e Seksionit për të drejtave të fëmijëve pranë Avokatit të Popullit në Shqipëri, sipas rekomandimeve të Komitetit të të Drejtave të Fëmijëve (Tetor 2012) në Shqipëri.
- Në kuadër të ditës ndërkombëtare të të drejtëve të njeriut, me **datë 9 dhe 10 dhjetor 2013**, institucioni i Avokatit të Popullit organizoi Konferencën Kombëtare për të Drejtat e Njeriut me temë “2013 një vit të drejtat tona: bilanc dhe perspektiva”. Në këtë konferencë morën pjesë nëpunës nga institucioni i Avokatit të Popullit, nëpunës të institucioneve të tjera publike, përfaqësues nga përfaqësitë diplomatike të akredituara në vendin tonë, përfaqësues të organizatave ndërkombëtare, përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile, etj. Organizimi i këtij eventit u mundësua falë dhe mbështetjes nga Save the Children.

- **Më datë 17 dhe 18 dhjetor 2013**, u zhvillua trajnimi mbi të drejtat e fëmijëve: **“Save the Children dhe zyra e Avokatit të Popullit”**, organizuar nga organizata Save the Children. Trajnimi kishte për synim përditësimin dhe rifreskimin e njohurive të stafit të Avokatit të Popullit mbi të “Drejtat e Fëmijëve”. Në trajnim morën pjesë 10 anëtarë të stafit të Avokatit të Popullit.

2.1. Takime të Avokatit të Popullit me përfaqësuesve të ndryshëm të përfaqësive diplomatike, organizatave ndërkombëtare dhe personaliteteve në fushën e të drejtave të njeriut.

Gjatë vitit 2013, përfaqësues të ndryshëm të organizatave ndërkombëtare brenda dhe jashtë vendit, përfaqësive diplomatike të akredituara në Shqipëri si dhe personalitete në fushën e të drejtave të njeriut, u takuan me Avokatin e Popullit. Ndër këto takime mund të përmendim:

- **Takim me Kryetaren e Këshillit Kombëtar Zviceran, znj. Maya Graf, datë 05.04.2013**

Më 05.04.2013, kryetarja e Këshillit Kombëtar të Konfederatës Zvicerane, znj. Maya Graf zhvilloi një takim me Avokatin e Popullit, z. Igli Totozani. Znj. Graf shprehu interesin e saj në lidhje me situatën e demokracisë në Shqipëri dhe për detyrat e Avokatit të Popullit lidhur me problematikat e hasura më së shumti nga ky institucion në drejtim të mbrojtjes të të drejtave të njeriut. Znj. Graf shprehu falenderimin e saj për disponibilitetin e z. Totozani për të qenë kaq i hapur dhe transparent mbi punën e institucionit të Avokatit të Popullit në Shqipëri dhe se kjo është një shenjë pozitive për një vend të vogël si Shqipëria.

- **Takimi i Avokatit të Popullit me znj. Dunja Mijatovic, përfaqësuese e OSBE-së për Lirinë e Medias, datë 17.09.2013.**

Takimi i znj. Mijatovic me z. Totozani u përqendrua kryesisht tek gjendja e medias në Shqipëri, ligji për të drejtën e informimit, për të cilën institucioni i Avokatit të Popullit është kujdestar dhe gjithashtu tek mundësitë e bashkëpunimit dhe ndërhyrjes në fushat që ka nevojë. Znj. Mijatovic u shpreh e sigurt për gjetjen e rrugëve të bashkëpunimit dhe shkëmbimit të eksperiencave dhe opinioneve mbi lirinë e medias.

- **Takimi i Avokatit të Popullit me z. Jan Jarab, përfaqësuesi Rajonal për Evropën, i Komisionerit të Lartë të OKB-së për të Drejtat e Njeriut, datë 4.11.2013.**

Në këtë vizitë z. Jarab shoqërohej nga znj. Yesim Uruc, Drejtore e UNDP në Shqipëri, z. Detlef Palm, përfaqësues i UNICEF në Shqipëri dhe znj. Entela Lako, analiste programi në zyrën e UNDP në Shqipëri. Z. Jarab përgëzoi dhe vlerësoi Avokatin e Popullit për punën e bërë dhe kontributin e dhënë në mbrojtje të të drejtave të njeriut, veçanërisht atë të grupeve vulnerabël siç janë: romët, LGBT, gratë e dhunuara, fëmijët etj. Nga ana e tij, Avokati i Popullit, z. Igli Totozani, njohu z. Jarab me situatën e gjendjes së të drejtave të njeriut në Shqipëri dhe i prezantoi punën dhe vizionin e tij në krijimin e një kulture të të drejtave të njeriut në Shqipëri. Nga ana tjetër, palët shprehen angazhimi e tyre për forcimin e bashkëpunimit.

Nga ana tjetër, Avokati i Popullit ka pasur takime të shumta e periodike dhe me përfaqësues të tjerë të komunitetit ndërkombëtar, brenda dhe jashtë vendit, përfshirë këtu: Ambasadorin e Shteteve të Bashkuar në Shqipëri, z. Alexander A. Arvizu; Kreun e Delegacionit të Bashkimit Evropian në Shqipëri, z. Ettore Sequi; Koordinatorin Rezidente të Kombeve të Bashkuara në Shqipëri, znj. Zineb Touimi-Benjelloun; Kreun e Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, z. Florian Raunig; Shefin e Zyrës së Këshillit të Evropës në Tiranë, z. Marco Leidekker; Ambasadorin i Danimarkës në Shqipëri, z. Mads Sandau-Jensen; Ambasadorin e Britanisë së Madhe në Shqipëri, z. Nicholas Cannon; Ambasadorin e Polonisë në Shqipëri, z. Marek Jeziorski; Ambasadorin e Izraelit në Shqipëri, z. David Cohen; të Ngarkuarin me Punë të Ambasadës së Suedisë në Shqipëri, z. Patrik Svensson; ish-Ombudsmanin Slloven dhe përfaqësues të PNUD Shqipëri; anëtarin e Parlamentit Evropian, znj. Tanja Fajon; Përgjegjës të projektit të përbashkët të BE dhe Këshillit të Evropës, z. Rainer Hofmann; etj.

Gjithashtu, dhe anëtarë të tjerë të stafit të institucionit të Avokatit të Popullit kanë mbajtur marrëdhënie të ngushta me partnerët ndërkombëtar, sipas fushave të së drejtës, duke pasur një komunikim të vazhdueshëm mbi gjendjen e të drejtave të njeriut në vend.

2.2. Vizitat, takimet dhe prania e Avokatit të Popullit në aktivitetet rajonale, ndërkombëtare e shumëpalëshe:

- **Vizitë e Avokatit të Popullit në Gjenevë, Zvicër, 18-20 mars 2013.**

Në kuadër të bashkëpunimit të institucionit të Avokatit të Popullit me Zyrën e Komisionerit të Lartë për të Drejtat e Njeriut, z. Igli Totozani dhe një delegacion i institucionit, zhvilluan një vizitë studimore në zyrën e Komisionerit të Lartë për të Drejtat e Njeriut në Gjenevë,

Zvicër. Gjatë vizitës së tij në Gjenevë, z. Totozani mori pjesë në punimet e Sesionit të 22 të Këshillit të OKB-së për të Drejtat e Njeriut në Gjenevë. Vizita në fjalë u fokusua në rritjen e bashkëpunimi të institucionit të Avokatit të Popullit me OKB-në dhe në veçanti me Zyrën e Komisionerit të Lartë për të Drejtat e Njeriut.

Gjatë kësaj vizite, z. Totozani u prit në një takim të veçantë nga Komisioneri i Lartë i OKB-së për të Drejtat e Njeriut, znj. Navanethem Pillay. Gjatë takimit, pasi dëgjoi një panoramë të përgjithshme të punës së Avokatit të Popullit, znj. Pillay e përgëzoi z. Totozani për rolin e rëndësishëm që institucioni i Avokati të Popullit luan në vazhdimësi në vendosjen e standarteve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut në Shqipëri, si dhe për punën e bërë dhe mesazhet publike të dhëna në lidhje me promovimin e të drejtave të grupeve vulnerable në vend. Rëndësi e veçantë u tregua nga të dyja palët mbi rolin që institucioni i Avokatit të Popullit luan në promovimin e të drejtave të njeriut, si dhe kontributin e vyer që ai po jep në vazhdimësi në procesin e integritimit European të vendit. Po kështu, znj. Pillay vlerësoi angazhimin aktiv dhe konstruktiv të treguar nga Avokati i Popullit në bashkëpunimin me institucionet kombëtare të të drejtave të njeriut në rajonin e Ballkanit.

Në fund të takimit, znj. Pillay e siguroi z. Totozani për mbështetjen që Zyra e saj dhe strukturat e tjera të OKB-së do të kenë për forcimin e mëtejshëm të institucionit të Avokatit të Popullit. Z. Totozani dhe znj. Pillay shprehën angazhimin e tyre për të forcuar më tej bashkëpunimin me qëllim përmirësimin e standarteve të të drejtave të njeriut në vend dhe më gjerë në rajon.

- **Vizitë e Avokatit të Popullit në Strasburg, Francë, me datë 30-31 maj 2013.**

Me ftesë të z. Stephanos Stavros, Sekretariatit të Përgjithshëm të Komisioni Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës (ECRI), z. Igli Totozani, Avokati i Popullit, mori pjesë në seminarin e organizuar nga ECRI në Strasburg, Francë. Ndër të tjera, takimi u fokusua në pavarësinë, efikasitetin dhe marrëdhëniet e institucioneve kombëtare të të drejtave të njeriut me organizatat e shoqërisë civile.

- **Vizitë e Avokatit të Popullit në Aman, Jordani në datat 10 dhe 11 qershor 2013.**

Me ftesë të AOM (Asociacioni i Obudsmenëve të Mesdheut), z. Igli Totozani, Avokati i Popullit i Republikës së Shqipërisë mori pjesë në takimin e shtate të Shoqatës së Ombudsmenëve të Mesdheut (AOM), e cila u mbajt në kryeqytetin e Jordanisë, Aman. Në këtë takim u zhvillua Konferenca me temë “Drejt një trajtim më të mirë të ankesave kundër të administratës”. AOM është një organizatë e krijuar në vitin 2008, e cila ka për qëllim promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut në vendet e Mesdheut, bazuar në parimet demokratike dhe të qeverisjes së mirë.

- **Vizitë e Avokatit të Popullit në Beograd, Serbi, me datë 16-19 qershor 2013.**

Me ftesë të Komisionit Evropian, në kuadër të programit P2P i Komisionit Evropian, z. Igli Totozani, Avokati i Popullit mori pjesë në seminarin rajonal për të drejtat e LGBT-ve, trajtimi i barabartë dhe lufta kundër diskriminimit. Seminari rajonal kishte për qëllim njohjen e pjesëmarrësve me politikën dhe programet e BE-së që lidhen me trajtimin e barabartë, luftën kundër diskriminimit dhe të drejtat e qytetarëve të komunitetit LGBT, si dhe për të ofruar mundësitë e shkëmbimit dhe komunikimit ndërmjet tyre dhe me organizata të tjera të shoqërisë civile në nivel evropian aktive në këtë fushë.

- **Vizitë e Avokatit të Popullit në Bruksel, Belgjikë, me datë 19-21 qershor 2013.**

Me ftesë të z. Štefan Füle, Komisioneri Evropian për Zgjerimin dhe Politiken e Fqinjësisë, z. Igli Totozani, Avokati i Popullit, mori pjesë në konferencën “Speak Up!2” mbi “Lirinë e Shprehjes dhe Medias në Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë, e cila u mbajt në Bruksel. Z. Totozani referoi në Sesionin e III-të të Konferencës me temë “Roli i Parlamentit në mbrojtjen e lirisë së shprehjes dhe medias”, ku ndër të tjera vuri në dukje rëndësinë e krijimit të mekanizmave që krijojnë një kulturë të lirisë së shprehjes e qarkullimit të informacionit.

- **Vizitë e Avokatit të Popullit në Berlin, Gjermani, me datë 24-28 qershor 2013.**

Me ftesë të Ministrisë së Jashtme të Republikës Federale të Gjermanisë, z. Igli Totozani, Avokati i Popullit i Republikës së Shqipërisë, zhvilloi disa takime me Kryetaren e Komisionit të Peticioneve të Parlamentit Gjerman, përfaqësues të Ministrisë Federale të Gjermanisë, Ministrisë së Jashtme Federale, si dhe me përfaqësues të tjerë të organizatave të shoqërisë civile, ku ndër të tjera u diskutua mbi bashkëpunimin juridik ndërkombëtar, dialogun mbi shtetin ligjor, zgjidhjen e konflikteve si dhe mbi dosjet e Sigurimit të Shtetit të Ish-Republikës Demokratike të Gjermanisë.

- **Pjesëmarrje e Avokatit të Popullit në seminarin zhvilluar në Danilovgrad, Mali i Zi, me datë 10-11 shtator 2013.**

Seminari për Ombudsmanët e rajonit: “Shkolla Rajonale e Administratës Publike, ReSPA”. Në seminarin në fjalë, z. Totozani gjatë fjalës së tij theksoi rëndësinë e bashkëpunimit rajonal ndërmjet institucioneve kombëtare të të drejtave të njeriut si dhe vlerësoi rolin e rëndësishëm të shoqërisë civile dhe medias në arritjen e standardeve më të larta në fushën e të drejtave të njeriut.

- **Pjesëmarrje e Avokatit të Popullit** në konferencën zhvilluar në Bonn, Gjermani më datë 24-25 shtator, 2013.

Avokati i Popullit, z. Igli Totozani mori pjesë në konferencën ndërkombëtare e fokusuar mbi “Gjendjen arsimore të romëve në (dhe nga) Europa Juglindore: Synimet dhe Realiteti”, e cila u mbajt në Bonn, Gjermani. Z. Totozani referoi në panelin e II-të, “Strategjitë e Integritimit: Institucionet shtetërore dhe OJF-të”, ku ndër të tjera përshkroi situatën e minoritetit Rom në Shqipëri.

- **Vizitë e Avokatit të Popullit në Madrid, Spanjë, datë 26-28 shtator 2013.**

Në kuadër të bashkëpunimit të institucionit të Avokatit të Popullit me homologun e tij Spanjoll, z. Igli Totozani, ka marrë pjesë në Ceremoninë e hapjes së 30 vjetorit të institucionit të Ombudsmanit të Spanjës në Madrid. Në këtë takim u mbajt dhe një tryezë e rrumbullakët me temë “Sfidat e ardhshme të institucioneve të të drejtave të njeriut”.

- **Vizitë e Avokatit të Popullit në Vjenë, Austri, me datë 7-8 tetor 2013.**

Me ftesë të z. Thorbjørn Jagland, Sekretar i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës dhe z. Alan Miller, Drejtor i Agjencisë për të Drejtat Themelore (FRA), z. Igli Totozani, Avokati i Popullit mori pjesë në konferencën me temë “Forcimi i mbrojtjes së të drejtave themelore” e cila u mbajt në Vjenë, Austri. Konferenca u fokusua në trajtimin e çështjeve të tilla si ndikimi i situatës aktuale ekonomike në institucionet kombëtare të të drejtave të njeriut; organet përgjegjëse për garantimin e barazisë dhe institucionet e ombudsmanit për mbrojtjen e të drejtave themelore të njeriut.

- **Vizitë e Avokatit të Popullit në Zagreb, Kroaci, me datë 7-8 nëntor 2013.**

Me ftesë të Ombudsmanit të Kroacisë dhe UNDP-së në Kroaci, z. Igli Totozani, Avokati i Popullit mori pjesë në seminarin ndërkombëtar “Institucionet e Ombudsmanit në Evropën Jug-Lindore: Aderimi në Bashkimin Evropian dhe Rishikimi Periodik Universal”. Gjatë seminarit në fjalë u diskutua mbi rëndësinë e Rishikimi Periodik Universal si dhe mbi kontekstin e të drejtave të njeriut në kuadër të aderimit në BE.

- **Vizitë e Avokatit të Popullit në Romë, Itali, në datat 17-19 nëntor 2013.**

Me ftesë të Komitetit Koordinues të Ombudsmanëve të Italisë z. Igli Totozani, Avokati i Popullit i Republikës së Shqipërisë mori pjesë në “Takimin koordinues të Ombudsmanëve të Italisë”. Gjatë takimit në fjalë, z. Igli Totozani, Avokati i Popullit mori pjesë në mbledhje e Ombudsmanëve të Italisë, ku ndër të tjera u diskutua mbi fuqizimin e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve homologe në kuadër të mbrojtjes së të drejtave të migrantëve në vendet respektive.

- **Vizitë e Avokatit të Popullit e Avokatit të Popullit në Prishtinë, Kosovë, me datë 4 dhjetor 2013.**

Me ftesë të Këshillit të Europës në Prishtinë dhe Zyrës së Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut, z. Igli Totozani, Avokati i Popullit i Republikës së Shqipërisë mori pjesë në Konferencën Rajonale “Institucionet e Avokatit të Popullit dhe sfida e gjyqësorit për mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut; praktikat më të mira europiane dhe eksperiencia rajonale”. Gjatë kësaj konference Avokati i Popullit mbajti një fjalim mbi modelet e ndryshme të bashkëpunimit mes institucioneve të Ombudsmanëve dhe Gjykatave Kushtetuese.

Anëtarë të tjerë të stafit të institucionit të Avokatit të Popullit morën pjesë në seminare dhe konferenca ndërkombëtare, ndër to mund të përmendim:

- Me ftesë të OSBE, përfaqësuesi nga zyra e Avokatit të Popullit mori pjesë në takimin e dytë të Grupit të Punës për Vet-qeverisjen, i cili u mbajt në datat 28-30 maj, në Sarajevë, Bosnje dhe Hercegovinë. Ky takim u organizua në kuadër të projektit “Praktikat më të Mira për Integrimin e Romëve”, i cili financohet nga BE dhe zbatohet Zyra e OSBE-së për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR). Qëllimi i takimit ishte shkëmbimi i përvojave dhe praktikave të mira në fushën e integritit të romëve me qeverisjen vendore, shoqatat dhe institucionet të cilat janë përgjegjëse për respektimin e të drejtave të njeriut.
- Me ftesë të Ministrit të Jashtëm të Mbretërisë së Hollandës, përfaqësuesi nga zyra e Avokatit të Popullit mori pjesë në konferencën ndërkombëtare të ICPD mbi të drejtat e njeriut, të mbajtur në Hollandë me datë 07-10 korrik 2013. Konferenca u fokusua mbi çështjet e zhvillimit dhe të drejtave të njeriut.
- Me ftesë të Institutit Ndërkombëtar të Ombudsmanit (IOI), dy përfaqësues të institucionit të Avokatit të Popullit morën pjesë në seminarin në fushën e anti-korrupsionit. Seminari në fjalë u zhvillua në Vjenë, Austri, me datë 15-18 shtator 2013.
- Me ftesë nga OSBE, dy përfaqësues të institucionit të Avokatit të Popullit morën pjesë në Konferencën rajonale “Sfida të Posaçme për Shqyrtimin e Ankesave mbi Diskriminimin në Baza Etnike - Shkëmbim i Përvojave të Praktikantëve të Rajonit” e cila u mbajt me datë 25-27 shtator në Ohër, Maqedoni. Konferenca mundësoi një forum për shqyrtimin krahasues të legjislacionit anti-diskriminues në Evropën Jug-Lindore si dhe mundësoi diskutimin mbi sfidat që hasen nga organet relevante që merren me shqyrtimin e ankesave mbi diskriminim në baza etnike.

- Me ftesë të Institutit Danez të të Drejtave të Njeriut, përfaqësuesi nga zyra e Avokatit të Popullit mori pjesë në “Dialogun Arabo-Europian të Institucioneve Kombëtare të të Drejtave të Njeriut” që u zhvillua në Kopenhagen, Danimarkë, me datë 25-27 shtator 2013. Në kuadër të kësaj konference, u hartua dhe deklarata e përbashkët e institucioneve kombëtare të të drejtave të njeriut në lidhje me pavarësinë dhe përgjegjësinë e këtyre institucioneve.
- Me ftesë të z. Kjell Arne Bratli, Komisioneri Parlamentar për Forcat e Armatosura i Norvegjisë, përfaqësuesi nga zyra e Avokatit të Popullit mori pjesë në konferencën e pestë ndërkombëtare për ombudsmanët në lidhje me forcat e armatosura, e cila u mbajt në Oslo, me datë 20-22 tetor 2013. Konferenca u fokusua në çështjet që kanë të bëjnë me barazinë gjinore, veteranët dhe zhvillimin e kapaciteteve.

Me datë 4-6 nëntor 2013, falë bashkëpunimit me Save the Children, përfaqësuesi të institucionit të Avokatit të Popullit morën pjesë në takim të tematik të organizuar nga CRONSEE “Fëmijët në Lëvizje”, në Zagreb, Kroaci. Takimi kishte si synim kryesor njohjen me praktikën më të mirë dhe përvojat e vendeve të Evropës Juglindore në lidhje me fëmijët në lëvizje të pashoqëruar.

- Me datë 13-15 nëntor 2013, përfaqësuesi të institucionit Avokatit të Popullit morën pjesë në takim për planifikimin strategjik të Rrjetit Europian të Institucioneve Kombëtare të të Drejtave të Njeriut (ENNHRI). Takimi, i cili u mbajt në Budapest, Hungari, kishte për qëllim finalizimin e dokumentit strategjik të ENNHRI, si dhe diskutimin e çështjeve të ndryshme që kanë të bëjnë me zhvillimin dhe aktivitetet e këtij rrjeti në të ardhmen. ENNHRI përfshin 41 institucione kombëtare të të drejtave të njeriut nga i gjithë kontinenti evropian. Qëllimi i ENNHRI është fuqizimi i institucioneve kombëtare të të drejtave të njeriut në Evropë, duke mbështetur zhvillimin e kapaciteteve të këtyre të fundit, krijimin e tyre në të gjitha shtetet e Evropës dhe duke mbështetur akreditimin në Komitetin Ndërkombëtar Koordinues të Institucioneve të të Drejtave të Njeriut (ICC). Institucioni i Avokatit të Popullit përveç anëtarësisë së plotë në ENNHRI, është veçanërisht aktiv në hartimin e disa prej projekteve të këtij rrjeti si dhe në mbështetjen ndaj sekretariatit të ENNHRI me anë të asistencës së ofruar nga Sektori i Koordinimit, Marrëdhënieve me Jashtë dhe Integritetit Europian të institucionit të Avokatit të Popullit. Avokati i Popullit është anëtar i disa prej grupeve tematikë të punës të ENNHRI dhe ka një rol aktiv në grupin e punës për Azilin dhe Migracionin. Në kuadër të grupit të punës mbi Azilin dhe Migracionin, përfaqësuesi i Avokatit të Popullit mori pjesë në mbledhjen e këtij grupi pune që u mbajt me datë 12-13 dhjetor 2013 në Bruksel (Belgjikë), ku ndër të tjera u diskutua mbi zhvillimet e fundit në fushën e azilit dhe migracionit si me mbi statusin e azilkërkuesve në zonën e Bashkimit Evropian

3) Anëtarësia në organizatat dhe rrjetet ndërkombëtare

Institucioni i Avokatit të Populli duke pasur në vëmendje rëndësinë e bashkëpunimit me institucionet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, është aktualisht anëtar me të drejta të plota në 8 prej shoqatave/organizatave ndërkombëtare të ombudsmanëve, si më poshtë:

1. Institutit Ndërkombëtar të Ombudsmanit (IOI) krijuar në 1978, anëtar që nga viti 2000.
2. Institutit European të Ombudsmanit (EOI) krijuar në 1988, anëtar që nga viti 2000.
3. Shoqatës së Ombudsmanit dhe Mediatorit Frankofon (AOMF), krijuar në 1998, anëtar që nga viti 2000.
4. Shoqatës së Ombudsmanit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës (USOA) krijuar në 1977, anëtar që nga viti 2006.
5. Shoqatës së Ombudsmanit të Ndërkombëtar (IOA) krijuar në 1977, anëtar që nga viti 2007.
6. Shoqatës së Ombudsmanit të Vendeve Mesdhetare (AOM), krijuar në 2008, anëtar që nga viti 2009.
7. Komiteti Koordinues Ndërkombëtar për Institucionet Kombëtare të të Drejtave të Njeriut (ICC), krijuar më 1993. Institucioni i Avokatit të Popullit është akredituar në ICC për herë të parë në vitin 2004 dhe riakredituar më 2008.
8. Së fundmi, institucioni i Avokati i Popullit është anëtarësuar më 10.01.2014 në Rrjetin European të Institucioneve Kombëtare të të Drejtave të Njeriut (ENNHRI).

4) Projekte me mbështetjen ndërkombëtare

Që nga fundi i vitit 2012, institucioni i Avokatit të Popullit është duke zbatuar projektin me titull “Mbështetje danez të Avokatit të Popullit Shqiptar: Arritja e të komuniteteve lokale, shoqërisë civile dhe mediat (2012-2015)”, i cili financohet nga Mbretëria e Danimarkës dhe është mbështetur në zbatimin e tij nga Instituti Danez për të Drejtat e Njeriut. Ky projekt është i përbërë nga pesë shtylla kryesore: 1) Hartimi i një plani strategjik me një kohëzgjatje prej disa vitesh për institucionin e Avokatit të Popullit; 2) Përmirësimi i sistemit teknologjik të (IT) institucionit; 3) Forcimi i partneritetit me shoqërinë civile dhe mediat; 4) Forcimi i partneritetit me njësitë e qeverisjes vendore; 5) Përmirësimi i nivelit të inspektimeve në sistemin e paraburgimit dhe në institucionet penitenciare.

Në kuadër të këtij projekti, për herë të parë që nga krijimi i tij, institucioni i Avokati i Popullit ka zhvilluar një Plan Strategjik që mbulon periudhën 2013-2015. Ky Plan Strategjik përcakton katër fusha strategjike të ndërhyrjes së punës së institucionit të Avokatit të Popullit në vitet e ardhshme, parashikon disa projekte për çdo fushë të ndërhyrjes, si dhe përcakton treguesit e performancës për matjen e progresit në arritjen e prioriteteve dhe objektivave të institucionit. Plani Strategjik, i cili është në dispozicion edhe në gjuhën shqipe dhe angleze, shpjegon në detaje se si Avokati i Popullit do të marrë një rol më aktiv në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut në shoqërinë shqiptare. Avokati i Popullit është i vetëdijshëm se nuk do të jetë faktori i vetëm aktiv në realizimin e Planit Strategjik në vitet në vijim, pasi progresi i rendit të të drejtave të njeriut në Shqipëri kërkon angazhimin e aktorëve të ndryshëm në shoqëri. Duke pasur parasysh këtë, plani strategjik është hartuar nëpërmjet një procesi të gjerë konsultimi midis stafit të institucionit me përfaqësues të institucioneve të tjera publike dhe organizatat e shoqërisë civile. Ky proces gjithëpërfshirës ka garantuar që pikëpamjet e palëve të ndryshme përfshirë këtu edhe partnerët, si dhe planet për veprime konkrete të përbashkëta, të jenë pjesë e Planit Strategjik.

Me **datë 2 tetor 2013**, institucioni i Avokatit të Popullit bëri prezantimin zyrtar të “Planit Strategjik 2013-2015 të Institucionit të Avokati të Popullit”. Gjatë prezantimit të tij morën pjesë përfaqësues të ndryshëm nga institucionet publike, nga përfaqësitë diplomatike të akredituara në Shqipëri, organizata të ndryshme ndërkombëtare si dhe përfaqësues të shoqërisë civile në vend.

7. Plani Strategjik dhe Plani i Veprimit për institucionin e Avokatit të Popullit 2013 – 2015

Falë mbështetjes të Mbretërisë së Danimarkës, institucioni i Avokatit të Popullit i është nënshtruar procesit të hartimit të Planit Strategjik për periudhën 2013-2015. Ky dokument kaq i rëndësishëm, i cili është i pari Plan Strategjik për institucionin e Avokatit të Popullit, përshkruan një sërë prioritetesh dhe fusha ndërhyrjesh, të cilat synojnë të përmbushin mandatin e Avokatit të Popullit, të promovojnë dhe të mbrojnë të drejtat e njeriut në Shqipëri.

Fushat e ndërhyrjes të parashikuara në Planin Strategjik, ku dob të fokusohet vëmendja dhe puna e institucionit të Avokatit të Popullit janë si më poshtë:

Fusha e parë e ndërhyrjes strategjike: Institucionet Publike aplikojnë standardet e të drejtave të njeriut dhe veprojnë në përputhje me praktikën administrative;

Fusha e dytë e ndërhyrjes strategjike: Një kulturë e të drejtave të njeriut në Shqipëri;

Fusha e tretë e ndërhyrjes strategjike: Praktikrat më të mira të Institucionit të Avokatit të Popullit;

Fusha e katër e ndërhyrjes strategjike: Bashkëpunimi ndërkombëtar.

Rruga që u ndoq për hartimin e këtij Plani Strategjik, ishte përcaktimi i vizionit dhe misionit të punonjësve dhe institucionit të Avokatit të Popullit.

Vizioni ynë: Një shoqëri që udhëhiqet nga parimet e të drejtave të njeriut, e ku institucionet shtetërore veprojnë në mënyrë transparente, të drejtë, të përgjegjshme dhe efektive.

Misioni ynë: Promovimi dhe mbrojtja e të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike, si dhe të tretëve që veprojnë për llogari të saj. Krijimi dhe zhvillimi i një kulture të qeverisjes së mirë, e cila nënkupton administrim të mirë, transparencë dhe llogaridhënie të administratës publike para qytetarëve të Shqipërisë, si dhe forcim të përgjithshëm të sundimit të ligjit, elementë të domosdoshëm për funksionimin e demokracisë dhe integrimin në Bashkimin European.

Vlerat që udhëheqin institucionin e Avokatit të Popullit: profesionalizëm, pavarësi dhe paanshmëri, transparencë, bashkëpunim, i arritshëm, proaktiv, jo-diskriminues

- I. **Fusha e parë e ndërhyrjes:** Institucionet Publike aplikojnë standardet e të drejtave të njeriut dhe veprojnë në përputhje me praktikën administrative

Kjo fushë ndërhyrje ka si qëllim dhe objektiv të përgjithshëm të sigurohet që institucionet publike të veprojnë në përputhje me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe praktikat më të mira administrative.

Pjesë e kësaj fushe ndërhyrjeje janë dhe projektet si më poshtë:

Projekti I : Koordinimi me institucionet e pavarura të qeverisjes

Ka si qëllim koordinimin më të mirë me institucionet e pavarura për një akses më efektiv për qytetarët. Nëpërmjet këtij projekti synohet të arrihet koordinimi mes institucionit të Avokatit të Popullit dhe institucioneve të tjera të pavarura. Rezultatet e pritshme nga zbatimi i këtij projekti janë: sigurimi i praktikave më të mira në lidhje me qasjet më efektive ndaj qytetarëve. Informimi dhe realizimi i punës për drejtimin konkret të kërkesave ndaj komisioneve parlamentare dhe ministrive për mbështetje ndaj ndryshimeve legjislative për këtë qëllim. Institucionalizimi i bashkëpunimit me institucionet e pavarura.

Projekti II : Fuqizimi i përgjegjshmërisë, transparencës dhe kapaciteteve të institucioneve publike në lidhje me të drejtat e njeriut

Ka si qëllim fuqizimin e kapaciteteve dhe transparencës së institucioneve të administratës publike (në nivel qendror dhe lokal) në mënyrë që të adresohen të drejtat e qytetarëve të shkelura nga organet e administratës publike. Nëpërmjet këtij projekti synohet të arrihet Administrata Publike. Rezultatet e pritshme nga zbatimi i këtij projekti janë: Identifikimi dhe rekomandimi ndaj institucioneve publike i praktikave më të mira administrative. Punonjësit e administratës publike njihen me çështjet e të drejtave të njeriut të evidentuara gjatë punës së Institucionit të Avokatit të Popullit dhe trajnohen mbi praktikat më të mira administrative për zbatimin e duhur të legjislacionit përkatës, me qëllim rritjen e kapacitetit identifikues dhe trajtues të rasteve të shkeljes të së drejtave të njeriut. Prodhimin dhe shpërndarjen pranë institucioneve publike të materialeve promovuese mbi të drejtat e njeriut dhe detyrimet e administratës publike. Përgatitja dhe ndarja me aktorët relevantë të raporteve vjetore, raporteve të veçanta dhe raporteve studimore. Realizimi i paraqitjes së kërkesave pranë Gjykatës Kushtetuese për shfuqizimin e akteve normative, të cilat bien ndesh me Kushtetutën e Shqipërisë dhe/ose me marrëveshjet ndërkombëtare.

Projekti III: Mbrojtja e grupeve vulnerabël

Ka si qëllim mobilizimin dhe motivimin e stafit të të gjitha institucioneve publike për të siguruar një mbrojtje efektive të të drejtave të grupeve vulnerabël. Nëpërmjet këtij projekti synohet të arrihet Administrata Publike (qendrore/vendore). Rezultatet e pritshme nga zbatimi i këtij projekti janë: Identifikimi gjatë inspektimeve të rasteve të

torturës, trajtimit çnjerëzor dhe degradues të shtetasve shqiptarë nga ana e administratës publike dhe dorëzimi i tyre në Prokurori për fillimin e procedimit penal ndaj autorëve të veprave penale. Dërgimi i rekomandimeve për përmbushjen e standardeve më të larta të të drejtave të njeriut institucioneve respektive, si dhe për përmirësimin e kushteve të jetesës dhe sigurimin e shërbimeve cilësore në institucionet e inspektuara. Njohja e personelit të institucioneve ku janë kryer inspektimet, me problemet dhe çështjet e identifikuar gjatë inspektimeve të kryera nga Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës.

II. Fusha e dytë e ndërhyrjes strategjike: Një kulturë e të drejtave të njeriut në Shqipëri

Kjo fushë ndërhyrje ka si qëllim dhe objektiv të përgjithshëm të kontribuojë në krijimin e një kulture që respekton të drejtat e njeriut në Shqipëri nëpërmjet bashkëpunimit të ngushtë me shoqërinë civile dhe median.

Pjesë e kësaj fushe ndërhyrjeje janë dhe projektet si më poshtë:

Projekti I: Ndërtimi i partneriteteve me organizatat e shoqërisë civile, veçanërisht me ato në nivel komunitar.

Ka si qëllim krijimin e sinergjisë midis aktivitetit të Avokatit të Popullit dhe aksioneve të shoqërisë civile. Nëpërmjet këtij projekti synohet bashkëpunimi me organizatat e shoqërisë civile që veprojnë në nivel komunitar, për të përçuar vizionin e të drejtave të njeriut në jetën e komuniteteve dhe grupeve sociale si: të moshuarit, njerëzit me aftësi të kufizuara, romët, pjesëtarët e LGBT, gratë, fëmijët, minoritetet, etj. Rezultatet e pritshme nga zbatimi i këtij projekti janë: Politika të përbashkëta dhe bashkëpunim mes OJF dhe AP, krijimi i bordit këshillimor, krijim i nën-bordeve, lobim për ndryshime ligjore, akte nën ligjore, materiale për informim publik për komunitetin dhe OJF-të, trajnimi i anëtarëve të OJF-ve për çështje të të drejtave të njeriut.

Projekti II: Fuqizimi i bashkëpunimit të Avokatit të Popullit me median

Ka si qëllim krijimin e partneritetit të ndërsjelltë midis Avokatit të Popullit dhe mediave në shërbim të informimit të publikut dhe krijimit të kulturës të së drejtave të njeriut. Nëpërmjet këtij projekti synohet bashkëpunimi me media të pavarura në nivel lokal dhe kombëtar; media me influencë në publik, reporterë dhe gazetarë të njohur me integritet. Rezultatet e pritshme nga zbatimi i këtij projekti janë: Krijimi i rrjetit të gazetarëve për të ndërvepruar me institucionin e Avokatit të Popullit, intervista, deklarata për media, prezencë në debatet publike mbi çështjen e të drejtave të njeriut, informimi i publikut në lidhje me çështje të ndryshme të të drejtave të njeriut nëpërmjet gazetës së Avokatit

të Popullit, faqja zyrtare e Avokatit të Popullit e aksesueshme nga të gjithë, numër më të madh ndjekësish në rrjetet sociale, në bashkëpunim me institutin e medias trajnim i gazetarëve mbi të drejtat e njeriut, leksione të hapura në departamentin e gazetarisë, stazh profesional për studentët.

Projekti III: Institucioni i Avokatit të Popullit dhe bashkëpunimi me sektorin e arsimit

Ka si qëllim rritjen e kapaciteteve të strukturave arsimore në fushën e të drejtave të njeriut në nivel qendror dhe lokal. Nëpërmjet këtij projekti synohet bashkëpunimi me strukturat e Ministrisë së Arsimit përgjegjëse për arsimin, drejtoritë arsimore në nivelin e bashkive dhe komunave, institute për zhvillimin e arsimit. Rezultatet e pritshme nga zbatimi i këtij projekti janë: Diskutime në tavolina të rrumbullakëta çdo vit, eventit i Ditës së Derës së Hapur për fëmijët zhvillohet çdo vit, përgatitja dhe shpërndarja e materialeve të informimit mbi të drejtat e fëmijëve, edukatorët e arsimit shkollor dhe parashkollor pajisen me njohuri mbi çështjet e të drejtave të njeriut

III. **Fusha e tretë e ndërhyrjes strategjike:** Praktikant më të mira të Institucionit të Avokatit të Popullit.

Kjo fushë ndërhyrje ka si qëllim dhe objektiv të përgjithshëm përmirësimin cilësor të punës së administratës së Avokatit të Popullit për ta bërë atë pikë referimi jo vetëm për shpejtësinë dhe profesionalizmin me të cilën trajton ankesat dhe problematikat që lidhen me to, por edhe për tregimin e vlerave më të larta qytetare dhe humane në trajtimin e ankesave dhe ankuesve. Ky përmirësim do sjellë një sistem efikas vlerësimi dhe menaxhimi i cili do jetë vendimtar për zhvillimin afatgjatë të Institucionit.

Pjesë e kësaj fushe ndërhyrjeje janë dhe projektet si më poshtë:

Projekti I: Profesionalizëm më i lartë i stafit të Avokatit të Popullit

Ka si qëllim fuqizimin e kapaciteteve institucionale dhe profesionale për ofrimin e shërbimeve cilësore. Target grupi i synuar në këtë projekt është stafi i institucionit të Avokatit të Popullit. Rezultatet e pritshme nga zbatimi i këtij projekti janë: Fuqizimi i kapaciteteve institucionale dhe profesionale për ofrimin e shërbimeve cilësore; stafi i institucionit të Avokatit të Popullit trajnohet mbi çështje të përgjithshme dhe specifike të të drejtave të njeriut bazuar në modulet e hartuara; stafi i institucionit të Avokatit të Popullit trajnohet për hartimin dhe konceptimin e rekomandimeve dhe raporteve të Institucionit; një qendër informimi mbi të drejtat e njeriut (online dhe fizike), e krijuar dhe pajisur me dokumente, akte ligjore, raporte, libra, etj. e cila pasqyron dhe veprimtarinë Institucionit të Avokatit të Popullit.

Projekti II: Zhvillimi organizativ i institucionit të Avokatit të Popullit

Ka si qëllim rritjen e standardeve të punës të institucionit, nëpërmjet ristrukturimit organizativ të tij. Target grupi i synuar është stafi i institucionit të Avokatit të Popullit. Rezultatet e pritshme nga zbatimi i këtij projekti janë: Struktura (termat e referencës) dhe organograma e Institucionit janë në përputhje me objektivat e strategjisë; ligji organik i Avokatit të Popullit dhe aktet nënligjore përkatëse ndryshohen dhe miratohen respektivisht, në mënyrë që të rritet efikasiteti dhe fleksibiliteti; procedurat e menaxhimit të dosjeve (ankesave) përmirësohen me qëllim rritjen e eficiencës; marrëdhëniet ndërmjet stafit përmirësohen përmes funksionimit të mekanizmave të brendshëm të institucionit.

KREU IV

Informacion i përgjithshëm lidhur me veprimtarinë e institucionit të Avokatit të Popullit

1. Struktura e zyrës së Avokatit të Popullit gjatë vitit 2013

Mbështetur në nenin 35, të ligjit 8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, në rregulloren e brendshme si dhe në vizionin e Avokatit të Popullit, po paraqesim strukturën organizative të institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2013.

Gjatë hartimit dhe miratimit të kësaj strukture është pasur parasysh që, kjo strukturë të shërbejë për një funksionim sa më efikas të Institucionit të Avokatit të Popullit, në mbrojtjen dhe forcimin e të drejtave të njeriut.

Një nga synimet kryesore gjatë hartimit dhe miratimit të strukturës për vitin 2013, ka qënë rritja në mënyrë të vazhdueshme e numrit të stafit të ekspertëve, si dhe rritja e aftësive dhe njohurive profesionale të tyre profesionale. Në hartimin e strukturës organizative u pasqyruan nevojat që kishte institucioni, në mbështetje edhe të rekomandimeve të institucioneve ndërkombëtare, shoqërisë civile etj. Në strukturën organizative janë zbatuar dhe reflektuar vendimet dhe rekomandimet e Komisionit të Shërbimit Civil, Raporti i Misionit të EURALIUS-it, si dhe përcaktimet e dhëna në ligjin nr.8454 dt.04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, plotësuar me ligjin 8600 dt.10.04.2000, ndryshuar me ligjin nr.9398, dt.12.05.2005, ligjin nr.8549 dt.11.11.1999 “Statusi i Nëpunësit Civil”.

Avokati i Popullit me urdhrin nr.98 dt.24.09.2012, miratoi strukturën organizative, e cila kishte këto grupime të punonjësve, sipas kategorive të mëposhtme.

- 4 punonjës të zgjedhur nga Kuvendi (Avokati i Popullit + 3 Komisionerë)
- 4 punonjës të Kabinetit (Drejtor Kabineti + 3 Këshilltarë)
- 29 punonjës me Status të Nëpunësit Civil
- 10 punonjës në sektorin mbështetës.

Kjo strukturë rregulloi raportet midis sektorit mbështetës dhe sektorit të zbatimit të politikave, duke i dhënë prioritet këtyre të fundit. Në fund të muajit dhjetor 2013 struktura e Institucionit të Avokatit të Popullit rezulton si vijon:

- Drejtor drejtorie në organikë tre (aktualisht dy)

- Përgjegjës sektori tre
- Specialistë gjashtë
- Ndhimëskomisionerë 17, të cilët janë të ndarë në tre Seksione dhe tek Mekanizmi Kombëtar i Parandalimit të Torturës.

Seksioni i Organeve të Administratës merret me ankesat dhe kërkesat ndaj organeve të administratës qendrore, pushtetit vendor dhe të tretëve që veprojnë për llogari të tyre.

Seksioni i Shërbimeve të Veçanta merret me ankesat dhe kërkesat ndaj policisë, shërbimit sekret, burgjeve, forcave të armatosura dhe pushtetit gjyqësor,

Seksioni i Përgjithshëm, trajton ankesat, apo kërkesat që nuk përfshihen në dy seksionet e para, bashkëpunon me organizatat joqeveritare, si dhe bën studime në fushën e zbatimit të të drejtave dhe lirive të njeriut.

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës, inspekton trajtimin e individëve të cilëve ju është hequr liria në vendin e ndalimit, arrestimit ose burgosjes, harton raporte dhe rekomandime për organet përkatëse për të parandaluar torturën, trajtimin, ose dënimin e egër çnjerëzor, ose poshtërues.

Struktura aktuale rregulloi vartësinë e të gjithë punonjësve, të cilët gëzojnë statusin e nëpunësit civil nga Sekretari i Përgjithshëm, duke pasur parasysh procedurën ligjore që nga rekrutimet, propozimet për largimet nga puna, dhënien e masave disiplinore, vlerësimin e arritjeve të rezultateve në punë etj. Ndërsa prej Komisionerëve, ndihmëskomisionerët kanë varësi tekniko metoike.

Një risi tjetër është edhe krijimi i drejtorisë së shërbimeve ndaj qytetarit, e cila në përbërjen e saj ka 7 punonjës, përkatësisht një drejtor, 2 përgjegjës dhe 4 specialistë. Të gjitha rekrutimet e punonjësve në këto pozicione, u bënë në zbatim të ligjit nr.8549 datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil".

Kjo drejtori është e përbërë nga sektori i pritjes së qytetarëve dhe sektori i marrëdhënieve me jashtë. Objekti kryesor i kësaj drejtorie është forcimi i marrëdhënieve me qytetarin, si dhe zgjerimi i bashkëpunimit me zyrat homologe jashtë vendit, zbatimi i detyrave që lidhen me procesin e integritetit, si dhe plotësimin e kritereve për marrjen e statusit të vendit kandidat për në BE.

Sektori i marrëdhënieve me jashtë do të mbështesë dhe koordinojë zbatimin e projektit të mbështetur nga qeveria daneze "Forcimi i Ombudsmanit shqiptar: Më pranë komuniteteve lokale, shoqërisë civile dhe medias 2012-2015".


Raporti i bashkëpunimit të institucionit të Avokatit të Popullit me median është shumë i rëndësishëm, pasi është media ajo që përcjell tek publiku imazhin dhe punën reale në mbrojtje të të drejtave dhe lirive të njeriut. Për këtë arsye, me urdhrin nr.186 prot. datë 28.10.2013, Avokati i Popullit miratoi strukturën e institucionit, ku në përbërje të kabinetit u shtua edhe një këshilltar, i cili do të mbulojë marrëdhëniet me mediat e ndryshme. Pjesë tjetër e punës së tij është ndjekja e aktiviteteve të projektit danez, “Mbështetja daneze ndaj institucionit të Avokatit të Popullit në Shqipëri: me anë të përfshirjes së komuniteteve lokale, shoqërisë civile dhe medias”. Këshilltari për mediat do të ndjekë eventet, të cilat janë parashikuar të mbahen në gjashtë rajone të vendit dhe të cilat do të transmetohen në televizionet kombëtare dhe ato lokale.

Këshilltari për mediat do të ndjekë botimin e gazetës që institucioni i Avokatit të Popullit synon të publikojë për promovimin e të gjitha aktiviteteve, që do të zhvillojë për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut.

Hapja dhe mirëmbajtja e kanalit në “Youtube”, si dhe zhvillimi i një plani për mirëmbajtjen e faqes së internetit të paraqitura në mediat sociale është një tjetër prioritet që projekti danez synon të arrijë përmes rritjes së prezencës së institucionit të Avokatit të Popullit në rrjetet sociale, si një domosdoshmëri e kohës.

Institucioni i Avokatit të Popullit me mbështetjen e projektit danez ka hartuar dhe po implementon planin strategjik për periudhën 2013-2016.

Struktura e institucionit të Avokatit të Popullit



2. Buxheti i Institucionit për vitin 2013

Për vitin 2013, Institucionit të Avokatit të Popullit, në zbatim të Ligjit nr.119/2012 datë 17.12.2012 “Për Buxhetin e vitit 2013”, i është akorduar një buxhet në shumën 90,450,000 lekë. Me shkresën nr. 15368/79, datë 18.10.2013, të Ministrisë së Financave, “Mbi Zbatimin e Aktit Normativ nr. 6, datë 04.10.2013”, janë bërë ndryshime në pakësim të shpenzimeve operative, në vlerën e 3.000.000 lekë, duke i çuar fondet e buxhetit të institucionit për vitin 2013, në total 87,450,000 lekë.

Tabela e mëposhtme jep një pamje të ndarjes së shpenzimeve buxhetore të Institucionit sipas kategorive ekonomike të shpenzimeve dhe i krahasuar:


Nr. Llog.	Emërtimi	Plani fillestar	Shtesa & Paksime	Plani i ndryshuar	Fakti
600	Paga	65,000,000	-3,600,000	61,400,000	56,173,582
601	Sigurime	8,000,000	-400,000	7,600,000	7,299,905
602	Shpenz. Operative	13,450,000	1,000,000	14,450,000	13,845,607
604	Transf. brendshëm		816,000	816,000	811,109
605	Kuota anëtarësimi	1,000,000		1,000,000	953,547
606	Trans. Buxh. Fam.		158,000	158,000	158,000
231	Invest.(Pajisje)	3,000,000		3,000,000	1,021,318
	TOTALI	90,450,000	-2,026,000	88,424,000	80,263,068

Buxheti i Avokatit të Popullit për vitin 2013 sipas zërave

Nr.	Emërtimi	Plan	Fakt	në %	Ndryshimi
1	Paga	61,400	56,174	91%	-5,226
2	sigurime shoqërore	7,600	7,300	96%	-300
3	shpenzime operative	15,450	14,799	96%	-651
4	Investime	3,000	1,021	34%	-1979
	Totali	87450	79,294	91%	-8,156

Struktura e Shpenzimeve 2013

■ Paga ■ Sigurime Shoqërore ■ Shpenzime Operative ■ Investime



Realizimi i fondit të pagave reflekton strukturën dhe organikën, lëvizjet e brendshme dhe të jashtme. Ai rezulton të jetë realizuar në masën 91 përqind. Gjatë vitit 2013, numri mesatar i punonjësve ka qenë 44 punonjës, nga 48 punonjës që ka qenë kufiri i miratuar me ligjin e lartpërmendur. Mosrealizimi i fondit të pagave ka ardhur si rezultat i ekzistencës së një vendi vakant të një komisioneri dhe në fund të periudhës, me mbarimin e mandatit të dy komisionerëve të tjerë në detyrë ky numër i vendeve vakante u shtua në tre. Nga ana tjetër, si rezultat i lëvizjes së punonjësve të institucionit tonë në detyra të tjera, në institucionin e Avokatit të Popullit u krijuan edhe tre vende vakante në Njësinë e Parandalimit Kundër Torturës.

Shpenzimet operative të miratuara për institucionin tone, me gjithë ndryshimet gjatë vitit ushtrimor, kanë qënë në vlerën 14,450,000 lekë, ndërkohë që në fund të vitit, niveli i realizimit të shpenzimeve operative rezulton në nivelin 96 përqind përkundrejt planit. Për vitin 2013 shpenzimet operative, janë përdorur për pagesat e faturave për energji elektrike, ujë, komunikim telefonik (Albtelecom, vodafon), internet, abonime në gazeta, shërbim postar, karburant, pjesë këmbimi automjetesh, shpenzime siguracioni, dieta për shërbime brenda e jashtë vendit, shërbime mirëmbajtje fotokopje e printera, shpenzime pritje-përcjellje të delegacioneve të huaja, blerje kancelerie, materiale pastrimi. Theksojmë se, pjesa dërmuese e shpenzimeve për institucionin tonë kanë shkuar për udhëtim e dieta, karburant, pjesë këmbimi automjetesh shërbimi postar e komunikim telefonik.

Gjithashtu, duke qenë anëtare e organizatave ndërkombëtare si Association des Ombudsmans et Mediateurs de la Francophonie (AOMF), European Ombudsman Institute (EOI), Association of Mediterranean Ombudsmen (AMO), International Ombudsman Institute (IOI), International Coordinating Committee (ICC), një pjesë e buxhetit është përdorur për shlyerjen e detyrimeve që lidhen me kuota anëtarësimi, të cilat janë kryer në kohën e duhur dhe që pasyrohen sipas tabelës më sipër.

Investimet për vitin 2013, kanë qenë 3,000,000 lekë dhe në fund të vitit niveli i realizimit të tyre ka qenë në masën 34 përqind, përkundrejt planit. Me buxhetin e akorduar për investimet (shiko tabelën e mësipërme) është shpenzuar për blerje pajisje zyresh. Ky mos realizim ka ardhur si pasojë e mos kryerjes në kohë të procedurës së tenderimit për rikonstruksionin e tarracës së godinës së institucionit, në vlerën prej 747,168 lekë dhe bllokimit të këtij fondi nga Dega e Thesarit. Për këtë arsye ky detyrim ngelet debitor i pashlyer për vitin 2014.

3. Statistika përmbledhëse e vitit 2013

Për periudhën e viti 2013 pranë institucionit të Avokatit të Popullit janë depozituar 4346 ankesa, nga të cilat 1403 ankesa kanë qenë këshillime, nga këto 817 këshillime verbale dhe 586 këshillime shkresore. Ankesa të shqyrtuara për vitin 2013 që kanë qenë pjesë e objektit të institucionit të Avokatit të Popullit janë 2943.

Gjatë shqyrtimit të këtyre ankesave të bëra nga institucioni i Avokatit të Popullit rezultojnë se janë mbyllur 2777 ankesa dhe janë si më poshtë:

Jashtë Juridiksionit janë	108 ankesa,
Jashtë Kompetence janë	193 ankesa
Të Pabazuara janë	643 ankesa
Rekomandime të Refuzuar	28 ankesa
Rekomandime të Pranuar	177 ankesa
Të Pranuar pa Rekomandim	1074 ankesa
Heqje Dorë	54 ankesa

Për vitin 2013 ankesa që kalojnë për trajtim në vitin 2014 janë 666 ankesa të cilat janë në proces. Nga zyrat Rajonale Fier dhe Shkodër janë marrë 274 ankesa.

2943 ankesa janë shpërndarë sipas Seksioneve:

Seksioni i Përgjithshëm	884 ankesa
Seksioni i Veçantë	685 ankesa
Seksioni i Administratës	1147 ankesa
Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës	220 ankesa
Sekretari i Përgjithshëm	7 ankesa

Tabelat në vijim japin në mënyrë grafike një informacion rreth ankesave që janë trajtuar gjatë vitit 2013 nga Institucioni i Avokatit të Popullit. Këto grafike shpjegojnë dhe një ndarje të ankesave sipas: viteve, ankesa të zgjidhura, sipas qyteteve, sipas të drejtave, sipas Ministrive, etj.






Tabela e mëposhtme jep në mënyrë grafike informacion mbi mënyrën se si janë trajtuar nga ana e Institucionit të Avokatit të Popullit ankesat adresuar institucionit tonë, ku 9% janë konsideruar jashtë kompetence, 5% jashtë juridiksionit, 28% të pabazuara, 55% të pranuar, 1% të refuzuara, si dhe 2% heqje dorë nga qytetari.




Ndarja e ankesave sipas mënyrës së trajtimit dhe zgjidhjes



Më poshtë kemi paraqitur ankesat që janë punuar dhe mbyllur brenda vitit 2013. Nga 2277 ankesa që janë trajtuar dhe kanë gjetur zgjidhje janë: në favor të qytetarit janë 1251 ankesa ose 55%, ndërsa ankesa që janë mbyllur dhe nuk janë në favor të qytetari janë 1026 ankesa ose 45%.




Krahasimi i ankesa brenda juridiksionit e të zgjidhura për vitet 2000-2013




Grafikët e mëposhtëm tregojnë rrethet nga të cilat vijnë qytetarët që kanë paraqitur rastet e tyre në Institucionin e Avokatit të Popullit, si dhe reflektojnë shpërndarjen e trajtimit të ankesave sipas seksioneve të Institucionit, shpërndarjen e tyre sipas të drejtës së shkelur, si dhe ndarjen sipas ministrive përkatëse dhe organeve apo enteve të tjera të administratës publike në vartësi të tyre.

Shpërndarja e rasteve të regjistruara gjatë vitit 2013 sipas rretheve




Më poshtë kemi paraqitur sesi janë ndarë ankesat sipas Seksioneve për vitin 2013:


Seksioni i Përgjithshëm 30%, Seksioni i Veçantë 23%, Seksioni i Administratës 39%, Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës (MKPT) 8%.



Shpërndarja e ankesave të regjistruara gjatë vitit 2013 sipas institucioneve




Grafiku për rastet jashtë juridiksioni (A3) dhe jashtë kompetence (A2)




Rastet e mbartura në vite

Institucioni i Avokatit të Popullit për vitin 2013 përveç ankesave që janë regjistruar dhe punuar në vitin 2013 ka vazhduar punën edhe me ankesat e prapambetura të vitit 2012 të cilat janë trajtuar në vitin 2013. Nga viti 2012 kanë qenë 577 ankesa, nga këto 380 janë mbyllur në vitin 2013, ndërsa 197 ankesa kalojnë në vitin 2014 për tu zgjidhur. Më poshtë i kemi paraqitur si janë zgjidhur sipas Seksioneve këto ankesa:



Për vitin 2013 ankesat që kanë mbetur pa zgjidhur janë 666 dhe këto ankesa kalojnë për t'u trajtuar në vitin 2014.

Në vitin 2013 nga ankesat e zgjidhura të vitit 2012 janë bërë 122 rekomandime dhe nga këto 83 janë pranuar dhe 39 janë refuzuar. Ankesa që janë zgjidhur pa rekomandim por në favor të qytetarëve janë 232. Këto ankesa i kemi paraqitur edhe me grafikët e mëposhtëm.



Shtojca

Lista e Rekomandimeve Legjislative dhe Kërkesa drejtuar Gjykatës Kushtetuese

Rekomandime Legjislative:

A. Seksioni i veçantë

1. Rekomandim drejtuar Ministrisë së Drejtësisë “Për një shtesë dhe ndryshim të nenit 262 të ligjit nr.7905 datë 21.03.1995, Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë”.
2. Rekomandim drejtuar Këshillit të Ministrave “Për ndryshimin e VKM nr.190, datë 03.05.1995 “Për statusin e veteranit të luftës kundër pushtuesve nazifashistë”.
3. Rekomandim drejtuar Ministrisë së Drejtësisë “Propozime për shtesa dhe përmirësime në nenet 48,58 dhe 326 të Kodit të Procedurës Penale, për vendosjen e avokatit mbrojtës në procedimin dhe gjykimin penal për mbrojtjen e të drejtave të ligjshëm të viktimës si dhe ankimit ndaj vendimit të pezullimit të hetimeve”.

B. Seksioni i Përgjithshëm

4. Rekomandim drejtuar Ministrisë së Financave për “Nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të nenit 8 të Ligjit Nr.7874 datë 17.11.1994 “Për statusin e Veteranit të Luftës Antifashiste Nacional-Çlirimtare të popullit shqiptar”, të ndryshuar.”
5. Rekomandim drejtuar Ministrisë së Financave për “Marrjen e iniciativës ligjore për ndryshimin dhe përmirësimin e Ligjit Nr.7703 datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, konkretisht të nenit 32 të tij, me qëllim që përfituesit e pensionit të pleqërisë të gëzojnë masën e pensionit të pleqërisë më të favorshëm për ta.”
6. Rekomandim drejtuar Ministrisë së Financave, Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe Ministrisë së Shëndetësisë për “Përmirësim të nenit 7 të Ligjit Nr.7889 datë 14.12.1994 “Për Statusin e Invalidit”, të ndryshuar, si dhe të nenit 11 të Ligjit Nr.9355 datë 10.03.2005 “Për Ndihmën dhe Shërbimet Shoqërore”, të ndryshuar, me qëllim që një kategori e caktuar e invalidëve, sipas diagnozës së përcaktuar nga Komisionet Mjekësore të Caktimit të Aftësisë për Punë, të përfitojnë paketën higjieno-sanitare, si shtesë në masën e pensionit të invaliditetit dhe të pagesës së aftësisë së kufizuar.”

7. Rekomandim drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme për *“Marrjen e masave të shpejta për zgjidhjen e problemit të pagesës së kontributit të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për bashkëshortët/et, që shoqërojnë nëpunësin në përfaqësinë diplomatike.”*
8. Rekomandim drejtuar Kryeministrit të Shqipërisë:
*“-Për caktimin e organit kompetent, i cili të propozojë në vijimësi projekt-vendimet për rritjen e masës së shpërblimit të veteranëve të luftës.
 -Për paraqitjen dhe miratimin sa më të shpejtë të akteve nënligjore në zbatim të nenit 8 të Ligjit Nr.7874 datë 17.11.1994 “Për statusin e Veteranit të Luftës Antifashiste Nacional-Çlirimtare të popullit shqiptar”, të ndryshuar, për rritjen e shpërblimit të veteranëve të luftës për vitin 2013.”*
9. Rekomandim drejtuar Ministrisë së Drejtësisë *“Për përmbushjen e detyrimeve ligjore, për nxjerrjen e akteve nënligjore për trajtimin e të internuarve nga regjimi komunist, në zbatim të parashikimeve të Ligjit nr.9831 datë 12.11.2007 “Për dëmshpërblimin e ish të dënuarve politikë të regjimit komunist”, i ndryshuar.”*
10. Rekomandim drejtuar Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe Ministrisë së Drejtësisë *“Për nxjerrjen e Vendimit të Këshillit të Ministrave që, do të përcaktojë skemën e pensionit, për të internuarit ose të dëbuarit, në përputhje me parashikimet e ligjit “Për dëmshpërblimin e ish të dënuarve politikë të regjimit komunist”, i ndryshuar.”*
11. Rekomandim drejtuar Ministrisë së Drejtësisë *“Për një ndryshim në VKM nr.419 datë 14.04.2011 “Për miratimin e afateve dhe të skemës së shpërndarjes së fondeve të dëmshpërblimit, për ish të dënuarit politikë të regjimit komunist.”*
12. Rekomandim drejtuar Kryeministrit të Shqipërisë *“Për ndryshimin dhe përmirësimin e bazës ligjore, që do të mundësojë trajtimin me strehim në një kohë sa më të shpejtë të mundshme, të individëve, apo familjeve qiramarrëse, banues në banesat ish pronë e subjekteve të shpronësuara.”*
13. Rekomandim drejtuar Kryeministrit të Shqipërisë *“Për plotësimin e kuadrit ligjor, për njohjen dhe mbrojtjen e minoriteteve në vendin tonë, në përputhje me përcaktimet e Konventës Kuadër të Këshillit të Europës “Për mbrojtjen e minoriteteve.”*
14. Rekomandim drejtuar Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës *“Për disa përmirësime në ligjin nr. 69 datë 21.06.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë.”*
15. Rekomandim drejtuar Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Punës Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta *“Për disa përmirësime në ligjin nr.10221 datë 4.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi.”*
16. Rekomandim drejtuar Ministrisë së Drejtësisë *“Për disa ndryshime në Kodin Penal”, ku ndër të tjera u rekomandua që në nenin 50, germa “j”, të Kodit Penal, të shtohet si rrethanë rënduese kryerja e veprës penale, e shtyrë nga motive që kanë të bëjnë*

me orientimin seksual dhe/ose identitetit gjinor, si dhe u rekomandua ndryshimi i neneve 119/a dhe 119/b të Kodit Penal, ku të parashikohet si vepër penale shpërndarja e materialeve homofobike dhe fyerjes nëpërmjet rrjetit kompjuterik për motive të orientimit seksual dhe/ose identitetit gjinor.

C. Seksioni i Administratës

17. Rekomandim drejtuar Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës *“Për ushtrimin e kompetencave kushtetuese dhe ligjore nga ana e M.E.T.E.-s, me qëllim inicimin e procedurave të ndryshimit të VKM Nr. 275, datë 26.04.2010 “Për ristrukturimin e shoqërive tregtare me kapital shtetëror “Albetrol” sh.a Patos, “Uzinës Mekanike” Patos shp.k., dhe të Uzinës Mekanike të Naftës Kucovë” sh.p.k., pranë Këshillit të Ministrave lidhur me përfitimin e shpërblimit të vjetërsisë në punë të naftëtarëve të larguar nga kompania “Albetrol” sha, në vitin 2010.”*
18. Rekomandim drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme lidhur me *“Marrjen e masave urgjente për negocimin dhe zgjidhjen e problemit të toponimeve greke në dokumentat e udhëtimit të shtetasve shqiptarë”.*
19. Rekomandim drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë për çështjen e anëtarëve të komunitetit rom në kampin e ish_Dekorit lidhur me *hartimin e kuadrit për ofrimin e kujdesit dhe asistencës mjekësore.*
20. Rekomandim drejtuar ERE dhe Ministrisë së Financave *“Për marrjen e masave të menjëhershme për anulimin e faturimit të tarifës së televizionit të përfshirë në faturat e energjisë elektrike”.*
21. Rekomandim drejtuar Ministrisë së Transporteve dhe Infrastrukturës *“Për hartimin e kuadrit ligjor për rritjen e sigurisë rrugore”.*
22. Rekomandim drejtuar Ministrisë së Brendshme *“Për hartimin e kuadrit ligjor për rritjen e efektivitetit të punonjësve të policisë rrugore”.*
23. Rekomandim drejtuar Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta *“Për hartimin e kuadrit ligjor për ndërhyrje urgjente të MPCSSHB në kampin e romëve”.*
24. Rekomandim drejtuar Ministrisë së Bujqësisë lidhur me *kryerjen e procedurave për rivlerësimin e akteve dhe përfshirjen e banorëve të Komunës Anamali në listat e dëmshpërblimit.*
25. Rekomandim drejtuar Ministrisë së Drejtësisë *“Për plotësimin e Ligjit Nr. 7961 datë 12.07.1995, “Kodi Punës i Republikës së Shqipërisë”, (i ndryshuar) në nenin 32 të tij”, duke shtuar si dispozitë ligjore në pikën 4 edhe ngacmimin moral të punëmarrësit, nga ana e punëdhënësit.*

D. Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës

26. Rekomandim drejtuar Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Shëndetësisë lidhur me zbatimin e detyrimeve ligjore për përgatitjen dhe nxjerrjen e akteve nënligjore në bazë e për zbatim të neneve 18 pikat 1 e 2, 27 pika 5 gërma “ç” dhe 28 pika 2 të Ligjit 44/2012 dt. 19.04.2012 “Për Shëndetin mendor”, i ndryshuar.
27. Rekomandim drejtuar Ministrisë së Drejtësisë “Për marrjen e masave të menjëhershme për zbatimin e ligjit “Për Shëndetin Mendor” lidhur me trajtimin e personave me ç'rregullime të shëndetit mendor që kanë kryer vepra penale për të cilët gjykata ka vendosur mjekimin e detyruar në një institucion mjekësor.”
28. Rekomandim drejtuar Kryeministrit të Shqipërisë për “Hartimin dhe miratimin e Strategjisë së re Kombëtare mbi Migracionin dhe të një Plani të detajuar Veprimi.”
29. Rekomandim drejtuar Ministrisë së Brendshme për “Shpalljen e pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ, Urdhrit Nr. 90, datë 30.05.2012 të Ministrit të Brendshëm, “Për dokumentet që duhet të paraqesin shtetasit shqiptarë për ndryshimin e emrit/mbiemrit në zyrat e gjendjes civile dhe procedurën që duhet të ndjekë nëpunësi i gjendjes civile”.
30. Rekomandim drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit për “Shpalljen e pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ të Zv/Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit Nr. 8671, datë 30.11.2012 “Mbi kontrollin e shtetasve shqiptarë që kalojnë kufirin”.

Kërkesa drejtuar Gjykatës Kushtetuese:

- Kërkesë për shfuqizimin si të papajtuëshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, të Udhëzimit nr.2, datë 18.08.2011, “Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të institucioneve buxhetore në llogari të thesarit”, të Këshillit të Ministrave.

